**Prof. Dr. Gjyljeta Mushkolaj / Prof. Dr. Visar Morina /
Johan van Lamoen LL.M.**

Komentar

LGJK
Ligji për Gjykatën Kushtetuese
të Republikës së Kosovës

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

I publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Autorët:

Gjyljeta Mushkolaj / Visar Morina / Johan van Lamoen

Kontribuesit:

Flakron Sylejmani, në emër të Projektit për Reformën Ligjore - GIZ

Lektorët:

Isa Bajçinca
Skënder Berisha
Mehmet Dashaj

© 2014 Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Gjyljeta Mushkolaj / Visar Morina / Johan van Lamoen

Të gjitha të drejtat rezervohen. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk pranon çfarëdo përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk është përgjegjëse për aktualitetin, korrektësinë, tërësinë ose cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informacioneve të dhëna, përfshirë edhe informacionet që janë të pakompletuara ose të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe GIZ janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi/dyfishimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj., në publikimet e tjera, pa pëlqimin e GIZ dhe të autorëve. Nëse ndonjë pjesë a shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria a pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Korrik 2014

E shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i këtij Komentari është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti Reforma Juridike në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Zhvillim Ekonomik (BMZ).

Falënderim

Hartimi i një komentari shpesh përbën një aktivitet kompleks dhe të vështirë, ndoshta po aq të vështirë sa edhe vetë hartimi i një ligji. Kjo është për shkak se përcaktimi i qëllimit, që do të thotë i kuptimit dhe qëllimit të normës juridike dhe interpretimi i saj nga këndvështrimi gjuhësor, hapësinor dhe kohor, paraqet një sfidë të madhe dhe përgjegjësi për autorët. Kjo gjë vlen edhe për Komentarin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, një projekt që është realizuar me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë dhe të Deutschen Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – (GIZ).

Për këtë qëllim, ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për ndihmën që ka ofruar Federata Gjermane përmes mbështetjes bujare financiare dhe asistencës së ofruar teknike në hartimin e këtij Komentari. Dëshirojmë të falënderojmë veçanërisht udhëheqësin e projektit të "Projektit për Reformë Juridike në Kosovë" – z. Volkmar Theobald, i cili siguroi mbështetje të pakursyer gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij Komentari. Një ndihmë të konsiderueshme në implementimin e këtij projekti ka ofruar edhe z. Flakron Sylejmani, këshilltar i lartë ligjor në Projektin për reformë juridike të GIZ-it në Kosovë. Z. Sylejmani ka ofruar një ndihmë të konsiderueshme në koordinimin e aktiviteteve për përfundimin e punës dhe ka ofruar këshilla profesionale në lidhje me përmbajtjen e këtij Komentari. Falënderime të veçanta shkojnë edhe për recensentët gjermanë, komentet dhe sugjerimet e të cilëve kanë qenë shumë të vlefshme për finalizimin e këtij Komentari. Së fundi, ne dëshirojmë të theksojmë se ky Komentar erdhi pas përpjekjeve intensive dhe punës ekipore disavjeçare të autorëve. Prandaj, duam të shprehim falenderimin tonë të veçantë për familjet tona dhe për durimin e tyre të treguar në rrjedhën e hartimit të këtij Komentari.

Ne shpresojmë se ky Komentar do të mirëpritet nga komuniteti ligjor në Kosovë e më gjerë, dhe do të kontribuojë në avancimin e mendimit juridik dhe për zbatimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Parathënie

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (BMZ), si pjesë e mundimeve të saj për të përmirësuar cilësinë e literaturës juridike në Kosovë, ka kënaqësinë t'ju paraqesë komentarin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh faktin që gjer më tani procesi i implementimit dhe zbatimit të Kushtetutës së Kosovës është ballafaquar me pengesa, e posaçërisht me mungesën e interpretimit e njëtrajtshëm të dispozitave, u pa si e nevojshme të ofrohet interpretimi i ligjit nga ekspertë për të nxjerrë kuptimin e duhur e të saktë.

Komentari ofron shpjegime dhe sqarime të neneve të Kushtetutës dhe jep udhëzime për zbatim të saktë dhe të duhur, sipas teorisë dhe praktikës lokale e ndërkombëtare, pa lënë anash arritjet juridike në këtë fushë. Prandaj ky komentar do t'i ndihmojë profesionistët juridikë në institucionet e Kosovës, në ministritë, gjykatat, prokuroritë e në fakultetet juridike, si dhe të gjithë bashkëpunëtorët profesionalë që të kuptojnë dhe të zbatojnë ligjin në mënyrë të duhur për kryerjen e detyrave të tyre.

Kjo më tutje do të kontribuojë në krijimin e sigurisë juridike, në mbrojtjen e interesit të palëve në procedurë dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

Duke qenë i pari i këtij lloji, presim që komentari të bëhet një mjet i çmueshëm për komunitetin e profesionistëve juridikë dhe një kontribut i çmuar për drejtësinë në Kosovë.

GIZ - Projekti i Reformës Ligjore në Kosovë – dëshiron të falënderojë autorët e këtij komentari dhe stafin akademik, ekspertët ligjorë dhe bashkëpunëtorët e tyre, të cilët ndihmuan në këtë punim, që ky publikim dhe ato të ardhshmet të jenë të dobishme për profesionistët në fushën e drejtësisë e shkencave juridike dhe të jetë dobiprurës për popullin e Kosovës në përgjithësi.

Volkmar Theobald
Menaxheri i Projektit
Projekti i Reformës Ligjore GIZ
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

FJALËT E AUTORËVE

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës më 15 qershor 2008, u zbatua Kapitulli VIII [Gjykata Kushtetuese] i Kushtetutës me miratimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L-21), më datën 16 dhjetor 2008.

Me iniciativën e Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) (tani Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GIZ), subjekt i Qeverisë Federale të Gjermanisë për bashkëpunim ndërkombëtar, nga disa ekspertë të së drejtës kushtetuese në Kosovë u kërkua që të hartojnë komentarin, i cili do të ishte një mjet i dobishëm në duart e praktikuesve të drejtësisë, të studentëve dhe të palëve të tjera të interesuara gjatë shqyrtimit të dispozitave të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: LGJK, Ligji për Gjykatën Kushtetuese ose thjesht Ligji). Megjithatë, theksojmë që mendimet e shprehura në komentar nuk pretendohet të jenë të vetmet mendime të mundshme, po janë mendime për të cilat janë pajtuar autorët.

Nganjëherë, autorët ishin të mendimit që fjalët e një neni të caktuar (ose një pjesë të nenit) të Ligjit ose të një rregulle të caktuar (ose një pjesë të rregullës) të Rregullores së Punës, dukeshin të pasakta ose jo plotësisht të kuptueshme. Në këso rastesh, autorët sugjeruan ndryshimin e mundshëm të neneve ose rregullave të tilla (ose të pjesëve të tyre).

Bashkë me informacionet dhe referencat e përmendura në vetë tekstin dhe në fusnota, këto mendime kanë për qëllim të orientojnë lexuesin në kërkimin e tij/saj për një kuptim më të mirë të Ligjit. Pasi një numër i madh i neneve të Ligjit janë plotësuar me Rregulloren e Punës përkatëse, e miratuar nga Gjykata Kushtetuese, autorët e panë si të pashmangshme që, gjatë komentimit të ndonjë neni të veçantë të Ligjit, të komentojnë gjithashtu edhe Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja), që plotëson nenin përkatës. Për më tej, praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës përmendet sa herë që Gjykata është marrë me interpretimin e ndonjë neni ose rregulle. Gjithashtu, për të vendosur një nen ose rregull të veçantë në perspektivë më të gjerë, autorët e kanë ndier të nevojshme që një referim tek dispozitat e ngjashme në vendet fqinje ose në vende të tjera nganjëherë mund të jetë ndihmesë.

Disa fjalë të veçanta duhet të thuhen për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), e cila, në bazë të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare] të Kushtetutës dhe bashkë me marrëveshjet dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, të përmendura në këtë nen, zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe, në raste konflikti, kanë prioritet ndaj dispozitave dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Madje, sipas nenit 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore

të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e themeluar në bazë të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, përgjatë këtij komentari dhe kudo që të jenë të zbatueshme, janë gjetur referenca për nenet gjegjëse të KEDNJ-së, të Rregullave të Gjykatës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Megjithatë, duhet të theksohet që ky botim paraqet vetëm tentimin e parë për të komentuar në mënyrë të duhur dispozitat e Ligjit dhe Rregullat relevante. Kjo nënkupton që teksti i komentarit nuk duhet të shikohet si i skalitur në gurë, po të konsiderohet si një mjet i cili evoluon pandërprerë, varësisht nga mënyra se si i zbaton Gjykata Kushtetuese dispozitat e neneve dhe rregullave në praktikën ditore. Lidhur me këtë, autorët mirëpresin gjithashtu komentet dhe sugjerimet që mund të sjellin një botim të dytë, të përmirësuar, të komentarit dhe përmbajtjes së tij. Për këtë arsye, ftohen lexuesit e komentarit, që të ngrenë zërin e tyre sa herë që mendojnë të jetë e duhur, përmes e-mailave ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Në fund, po jo më pak e rëndësishme, autorët duan të falënderojnë përzemërsisht GIZ-in për përzgjedhjen e tyre që të shkruajnë këtë komentar, i cili, shpresojmë, do të kontribuojë në kuptimin më të mirë të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese në kornizën e Kushtetutës dhe të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Prishtinë,
Gusht 2014

QËLLIMI I KOMENTARIT

Siç u tha në Parathënie, qëllimi i komentarit është që t'i ofrohet komunitetit juridik në Kosovë një mjet i dobishëm, i cili do t'i ndihmonte në kuptimin e lehtë dhe më të mirë të dispozitave të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Rregullave të Punës relevante të Gjykatës. Më tutje, komentari përmban udhëzime për fushëveprimin dhe qëllimin e këtyre dispozitave. Nga perspektiva strukturore, komentari përfshin një analizë juridike të secilës dispozitë të Ligjit, mbështetur me materiale të tjera juridike dhe, kudo që ishte e mundur, me referenca te *travaux préparatoires* (punët përgatitore) si një burim i rëndësishëm dallues për sa i përket kuptimit të disa dispozitave të veçanta.

Pasi jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është ende në etapat e para, janë bërë referenca në përvojën e gjykatave të tjera kushtetuese në vendet fqinje dhe të tjera, kudo që ishte e përshtatshme. Për më tepër, me qëllim të ofrimit të një përmbledhjeje dhe analize krahasuese të dispozitave kushtetuese, për të cilat këto gjykata kushtetuese janë kompetente që t'i interpretojnë në praktiken e tyre të jurisprudencës, dispozitat e tilla janë të përmendura në tekst ose në fusnota për të tërhequr vëmendjen e lexuesit për njëtrajtshmërinë e konsiderueshme të shpeshtë në legjislacionet e ndryshme që mbulojnë çështjet kushtetuese.

Veç kësaj, siç u tha në Parathënie, në komentar një rol i rëndësishëm i jepet jurisprudencës së Strasburgut, për të treguar rreshtimin e vendimeve të Gjykatës në linjë me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, sipas përcaktimit në nenin 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] të Kushtetutës, është detyruese.

Përmbajtja

Parathënie 5
Fjalët e autorëve.....7
Qëllimi i komentarit.....9
Përmbajtja.....11
Bibliografia.....17
Lista e shkurtesave 35
Udhëzimet për përdoruesit e komentarit.....37
Hyrje 39
I. Historiku i Ligjit 39
II. Fushëveprimi i Ligjit 41
III. Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese 42
IV. Raporti ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta 42
Ligji (nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.....47
KREU I: Organizimi i Gjykatës Kushtetuese 47
1. Dispozitat e përgjithshme 47
Neni 1 [Fushëveprimi i Ligjit] 47
Neni 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese].....50
Rregulla 1 [Dispozitat e përgjithshme] 52
Rregulla 14 [Seancat administrative] e Rregullores së Punës.....52
Neni 3 [Selia dhe simbolet].....58
Rregulla 2 [Selia e Gjykatës] e Rregullores së Punës 60
Rregulla 3 [Simboli dhe vula e Gjykatës] e Rregullores së Punës.....61
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese 62
Neni 4 [Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtarëve] 62
Neni 5 [Papajtueshmëria e funksionit].....68
Neni 6 [Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese].....72
Neni 7 [Emërimi dhe fillimi i mandatit] 80
Neni 8 [Përfundimi i mandati] 84
Neni 9 [Përfundimi i mandatit para kohës].....87
Rregulla 5 [Dorëheqja e gjyqtarëve] e Rregullores së Punës 92
Rregulla 6 [Procedurat për shkarkim] e Rregullores së Punës 93
Rregulla 11 [Dorëheqja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit] e Rregullores së Punës 97
Neni 10 [Detyrat e gjyqtarëve] 98
Neni 11 [Kryetari dhe Zëvendëskryetari] 101
Rregulla 10 [Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit] e Rregullores së Punës 104
Rregulla 12 [Funksionet e Kryetarit] e Rregullores së Punës 107
3. Administrimi i Gjykatës Kushtetuese.....109
Neni 12 [Sekretaria].....109
Rregulla 15 [Sekretariati] e Rregullores së Punës.....115
Rregulla 16 [Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm] e Rregullores së Punës 116

Rregulla 17 [Personeli i Sekretariatit] e Rregullores së Punës.....120
Neni 13 [Këshilltarët Juridikë].....122
Rregulla 18 [Këshilltarët juridikë] e Rregullores së Punës.....123
Neni 14 [Buxheti] 129
Rregulla 20 [Buxheti dhe taksat] e Rregullores së Punës 131
Neni 15 [Pagat e Gjyqtarëve].....132
KREU II: Procedura 135
1. Dispozitat e përgjithshme procedurore 135
Neni 16 [Rregulla e përgjithshme].....135
Neni 17 [Parimi i Publicitetit].....137
Rregulla 22 [Qasja në punën e Gjykatës] e Rregullores së Punës 145
Rregulla 23 [Qasja në dosje dhe dokumente] e Rregullores së Punës 147
Rregulli 24 [Informacionet për statusin e procedurës] i Rregullores
së Punës 153
Rregulla 41 [Pjesëmarrja në seancë dëgjimore] e Rregullores së Punës.....153
Neni 18 [Përjashtimi i gjyqtarit] 156
Rregulla 7 [Procedurat për përjashtim] e Rregullores së Punës.....160
Neni 19 [Marrja e vendimeve].....165
Rregulla 4 [Përparësia e gjyqtarëve] e Rregullores së Punës.....169
Rregulla 58 [Mendimet mospajtuese] e Rregullores së Punës.....171
Rregulla 59 [Mendimi konkurrues] e Rregullores së Punës 173
Neni 20 [Vendimet] 175
Rregulla 39 [E drejta e dëgjimit dhe heqja dorë] e Rregullores së Punës.....180
Rregulla 56 [Llojet e vendimeve] e Rregullores së Punës 182
Rregulla 57 [Përmbajtja e vendimeve] e Rregullores së Punës 183
Rregulla 60 [Teksti përfundimtar i aktgjykimit dhe arkivimi] e Rregullores
së Punës 185
Neni 21 [Përfaqësimi].....188
Neni 22 [Procedimi i kërkesës].....190
Rregulla 8 [Emërimi i Gjyqtarit raportues] e Rregullores së Punës.....203
Rregulla 9 [Përcaktimi i kolegjeve shqyrtuese] e Rregullores së Punës.....204
Rregulla 28 [Fillimi i procedurës] e Rregullores së Punës 205
Rregulla 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] e Rregullores
së Punës 206
Rregulla 30 [Regjistrimi i kërkesës dhe i përgjigjes] e Rregullores
së Punës 216
Rregulla 33 [Emërimi i Gjyqtarit raportues] e Rregullores së Punës.....218
Rregulla 34 [Raporti i Gjyqtarit raportues] e Rregullores së Punës.....220
Rregulla 35 [Kolegjet shqyrtuese] e Rregullores së Punës 222
Rregulla 36 [Kriteret e pranueshmërisë] e Rregullores së Punës.....224
Rregulla 37 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] e Rregullores së Punës 237
Rregulla 38 [Aktgjykimet testuese] e Rregullores së Punës 238
Neni 23 [Tërheqja e palës].....240
Rregulla 32 [Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes]ei Rregullores së Punës.....241
Neni 24 [Shqyrtimi verbal] 242
Rregulla 40 [Orari i seancave dëgjimore] e Rregullores së Punës.....243

Rregulla 41 [Pjesëmarrja në seancë dëgjimore] e Rregullores së Punës.....244
Rregulla 42 [Njoftimi për seancë dëgjimore] e Rregullores së Punës 246
Rregulla 43 [Procedura gjatë seancës dëgjimore] e Rregullores së Punës.....247
Rregulla 44 [Këshillimet dhe votimi] e Rregullores së Punës 250
Neni 25 [Provat].....254
Rregulla 45 [Paraqitja e dëshmive nga palët] e Rregullores së Punës 255
Rregulla 46 [Thirrjet e dëshmitarëve] e Rregullores së Punës.....257
Rregulla 47 [Dëshmia e dëshmitarëve] e Rregullores së Punës.....262
Rregulla 48 [Ekspertët] e Rregullores së Punës.....265
Rregulla 49 [Vërejtjet kundër dëshmitarëve dhe ekspertëve] e Rregullores
së Punës 269
Rregulla 50 [Kompensimi i dëshmitarëve dhe i ekspertëve] e Rregullores
së Punës 270
Rregulla 51 [Dokumentet] e Rregullores së Punës 272
Rregulla 52 [Inspektimi i vendit të ngjarjes ose i objektit] e Rregullores
së Punës 275
Rregulla 53 [Amicus Curiae] e Rregullores së Punës.....276
Neni 26 [Bashkëpunimi me organet e tjera publike] 278
Rregulla 57 [Përmbajtja e vendimeve], paragrafi 5, e Rregullores së Punës 280
Rregulla 63 [Zbatimi i vendimeve] e Rregullores së Punës.....281
Neni 27 [Masat e përkohshme].....292
Rregulla 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] e Rregullores së Punës 296
Rregulla 55 [Vendimi për masa të përkohshme] e Rregullores së Punës 297
Neni 28 [Shpenzimet e procedurës].....304
KREU III: Procedurat e veçanta 306
1. Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 113 [Juridiksioni
dhe palët e autorizuara], paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës
së Republikës së Kosovës 306
Neni 29 [Saktësimi i kërkesës] 307
Neni 30 [Afatet].....310
2. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët
e autorizuara], paragrafi 3 (1) të Kushtetutës 311
Neni 31 [Saktësimi i kërkesës] 312
Rregulla 67 [Kërkesa] e Rregullores së Punës 314
Neni 32 [Afatet].....314
3. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët
e autorizuara], paragrafi 3 (2) të Kushtetutës 316
Neni 33 [Saktësimi i kërkesës] 318
Neni 34 [Afati].....319
4. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët
e autorizuara], paragrafi 3 (3) të Kushtetutës 319
Neni 35 [Afati].....321
5. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët
e autorizuara], paragrafi 3 (4) të Kushtetutës 322
Neni 36 [Efekti suspensiv].....323
Rregulla 70 [Aktgjykimi] e Rregullores së Punës 324

Neni 37 [Afatet] 325
6. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 3 (5) të Kushtetutës 326
Neni 38 [Saktësimi i kërkesës] 326
Neni 39 [Afatet] 327
7. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 4 të Kushtetutës 328
Neni 40 [Saktësimi i kërkesës] 328
Neni 41 [Afatet] 329
8. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 5 të Kushtetutës 329
Neni 42 [Saktësimi i kërkesës] 331
Neni 43 [Afati] 332
9. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 6 të Kushtetutës 337
Neni 44 [Saktësimi i kërkesës] 338
Neni 45 [Afatet] 339
Rregulla 71 [Njoftimi] e Rregullores së Punës 339
Rregulla 72 [Anulimi i procedurës] e Rregullores së Punës 341
Rregulla 73 [Tërheqja] e Rregullores së Punës 342
10. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 7 të Kushtetutës 343
Neni 46 [Pranueshmëria] 344
Neni 47 [Kërkesa individuale] 345
Neni 48 [Saktësimi i kërkesës] 358
Neni 49 [Afatet] 362
Rregulla 27 [Llogaritja e periudhës kohore] e Rregullores së Punës 367
Neni 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] 368
Rregulla 74 [Aktgjykimi] e Rregullores së Punës 370
11. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 377
Neni 51 [Saktësimi i kërkesës] 380
Rregulla 75 [Parashtrimi i kërkesës] e Rregullores së Punës 383
Neni 52 [Procedura para gjykatës] 386
Rregulla 76 [Njoftimi] e Rregullores së Punës 386
Neni 53 [Vendimi] 387
Rregulla 77 [Aktgjykimi] e Rregullores së Punës 389
Rregulla 64 [Masa e përkohshme] e Rregullores së Punës 389
Rregulla 65 [Aktgjykimi]ei Rregullores së Punës 390
12. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara], paragrafi 9 të Kushtetutës së Kosovës 393
Neni 54 [Afati] 394
Rregulla 78 [Pranueshmëria për shqyrtim] e Rregullores së Punës 399
Rregulla 79 [Shqyrtimi nga Gjykata] e Rregullores së Punës 400
KREU IV: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare 401
Neni 56 [Rastet Paraprake] 404

Neni 57 [Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] 405
Neni 58 [Hyrja në Fuqi] 405
Shtojca 1: Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës 407
Shtojca II: Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 126-3/ 2013, e datës 17 qershor 2013 424
INDEKSI/LISTA E FJALËVE KYÇE 457

Bibliografia

Arnold, Prof. Rainer — Universiteti i Regenburgut, raporti "The decisions of the German Federal Constitutional Court and the binding force for ordinary courts", konferenca "Interrelations between the Constitutional Court and Ordinary Courts", Baku, Azerbajxhan, 9-10 nëntor 2006, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit, CDL-JU(2006)047 (mund të shkarkohet në: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282006%29047-e).

Barnstedt, Elke Luise — Drejtoreshë e Gjykatës Kushtetuese Federale, Gjermani, raporti "The Constitutional Court Budget as one of the Guarantees of the Independence of Constitutional Justice", Seminar "The Budget of the Constitutional Court: a determining factor of its independence", Sarajevë, 14-15 tetor 2004, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës, CDL-JU(2004)059 (mund të shkarkohet në: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282004%29059-e).

Barnstedt, Elke Luise — 2004. Drejtoreshë e Gjykatës Kushtetuese Federale, Gjermani, raporti "The Constitutional Court budget as one of the guarantees of the independence of constitutional justice", Komisioni i Venedikut, Seminar "The budget of the Costitutional Court: a determining factor of its independence, Sarajevë, 14-15 tetor (mund të shkarkohet në: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282004%29056-e

Borrajo Iniesta, Ignacio — Tribunali Kushtetues, Spanjë, raporti "Limits of Fact, Law and Remedies: Myths and Realities of Constitutional Review of Judicial Decisions, Constitutional Court of Spain Experience", konferenca "The Limits of Constitutional Review of the Ordinary Court's Decisions in Constitutional Complaint Proceedings", Brno, Republika e Çekisë, 14-15 nëntor 2005, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Çekisë, CDL-JU(2005)068 (mund të shkarkohet në:

http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282005%29068-e).

Bross, Siegfried — Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese Federale të Gjermanisë, raporti "Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany", konferenca "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice", me rastin e 10-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbajxhanit, Baku, Azerbajxhan, 14-15 korrik 2008, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit, CDL-JU(2009)001 (mund të shkarkohet në: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282009%29001-e.

Buyse, Antoine — The Pilot Judgment Procedure at the European Court of Human Rights: Possibilities and Challenges, Universiteti i Utrechtit, Fakulteti juridik, (Holandë); Instituti i Holandës për të Drejtat e Njeriut (SIM); Universiteti i Utrechtit, Fakulteti juridik, 27 nëntor 2009; Nomiko Vima (The Greek Law Journal), Vol. 57, fq. 1890-1902, 2009 (mund të qaset/kërkohet në SSRN: http://ssrn.com/abstract=1514441)

Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane — Temat e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane nga viti 1972: www.vfgh.gv.at/cms/vfgh-kongress/en/downloads/en/themes.pdf.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë — Drejtësia Kushtetuese: Funksionet dhe Marrëdhënia me autoritetet e tjera publike, Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane, Raporti kombëtar i përgatitur për Kongresin XV të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, http://www.confeuconstco.org/en/common.home.htlm (Kliko në Kongresi XV).

Gjykata Kushtetuese e Bosnjë e Hercegovinës — Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane, Raporti kombëtar: "Constitutional Justice: Functions and Relationship with the Other Public Authorities", përgatitur për Kongresin XV të Konferencës së

	Gjykatave Kushtetuese Evropiane. Gjithashtu. Gjithashtu, shih raportet e tjera kombëtare të përgatitura nga gjykatat e tjera kushtetuese evropiane për kongresin XV në ueb-faqen e konferencës: http://www.confeuconstco.org/en/common.home.htlm. (Kliko në kongresin e XV).
Gjykata Kushtetuese e Kroacisë	Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane, raporti kombëtar "The Constitutional Court, the Other Courts and the Constitutionality Review", përgatitur për Kongresin XII të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane. Gjithashtu, shih raportet e tjera kombëtare të përgatitura nga gjykatat e tjera kushtetuese evropiane për Kongresin XII në ueb-faqen e konferencës: http://www.confeuconstco.org/en/common.home.htlm. (Kliko në kongresin XII).
Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë	Drejtësia Kushtetuese: Funksionet dhe Marrëdhënia me autoritetet e tjera publike, Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane, Raporti kombëtar i përgatitur për Kongresin XV të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane nga Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë. http://www.confeuconstco.org/en/common.home.htlm. (Kliko në kongresin XV)
Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE),	Opinioni nr. 1 (2001), për Vëmendjen e Ministrave të Këshillit të Evropës për "Standards concerning the Independence of the Judiciary and the Irremovability of Judges", (Rekomandimi nr. R(94) për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve dhe rëndësinë e Standardeve dhe çfarëdo standardi tjetër ndërkombëtar për problemet ekzistuese në këto fusha), Këshilli i Evropës, KKGJE (2001) OP nr. 1 (gjendet në: http://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1046405&Site=COE).
Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE)	Opinioni nr. 3 (2002) për vëmendjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, sidomos etika, sjellja e papranueshme dhe paanshmëria. 19 nëntor 2002 (Gjendet në: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/CCJE%20Opinion%203_EN.pdf).

Doli, Dren	Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strength and Weaknesses, German Law Journal, Vol. 11 nr. 08, 1 gusht 2010.
Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) Këshilli i Evropës Demokracia përmes ligjit	Collection Science and technique of Democracy, nr. 10, The role of the constitution in the consolidation of the rule of law, Bukuresht, 8-10 qershor 1994, Procedura.
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Departamenti për zbatimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi "Execution of Judgments of the European Court of Human Rights – Introduction", Këshilli i Evropës, H/Exec (2004)2, azhurnuar në: 2006 (http://www.coe.int/Human_rights/execution/)
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Çështjet kryesore të praktikës gjyqësore "The Concept of Possessions", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, azhurnuar më: 23/01/2007 (dokumenti mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int (Case-Law - Case-Law Analy-sis)
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Çështjet kryesore të praktikës gjyqësore "Individual Petition", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, azhurnuar më 31/12/2007 (dokumenti mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int (Case-Law - Case-Law Analysis)
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Çështjet kryesore të praktikës gjyqësore "Exhaustion of Domestic Remedies", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, azhurnuar më 28/04/2006 (dokumenti mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int (Case-Law - Case-Law Analysis).
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Çështjet kryesore të praktikës gjyqësore "Six-Month-Rule", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, azhurnuar më 13/03/2006 (dokumenti mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int (Case-Law - Case-Law Analysis).
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Çështjet kryesore të praktikës gjyqësore "Compatibility Ratione Temporis", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, azhurnuar më 31/12/2006 (dokumenti mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int (Case-Law - Case-Law Analysis).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Udhëzim praktik për kriteret e pranueshmërisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2009 dhe azhurnuar më 31 mars 2011. (Ky Udhëzim mund të shkarkohet nga Analy-sis-Admissibility).
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Procedura për pilotgjykimet, Rregulla 61 e Rregullores së Gjykatës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botim i GJEDNJ-së, 18/03/2011 (mund të shkarkohet nga www.echr.coe.int)
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	Rregullorja e Gjykatës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Regjistri i Gjykatës, Strasburg, 6 maj 2013 (Rregullat mund të shkarkohen nga www.echr.coe.int).
Eynde, Laura Van den	An Empirical Look at the Amicus Curiae Practice of Human Rights NGO's before the European Court of Human Rights," Dissertation at Stanford Law School. www.globalgovernancewatch.org/docLib/20140115_on_Amicus_Curiae_Practice_of_NGOs_at_ECHR.pdf. Netherlands Quarterly of Human Rights, Vol. 31/3, 271-313, 2013.
Ford, Christian et. al.	"Neotrustship or Mistrustship? The "Authority Creep "Dilemma in United Nations Transitional Administration. Vanderbild Journal of Transnational Law, 2008.
Stahn, Carsten.	"Constitution without a State? Kosovo under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government", 14 Leiden Journal of International Law, (2001).
Stahn, Carsten	"The United Nations Transitional Administrations in Kosovo and East Timor: A first Analysis", 5 Max Planck Yearbook of United Nations Law (2001).
Marshall, David & Inglis, Shelley	"The Disempowerment of Human Rights-Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo", 16 Harvard Human Rights Journal (2003), 96-145.
Yannis, Alexandros	"The UN as Government in Kosovo", 10 Global Governance, (2004).

Tunheim, John. "Rule of law and the Kosovo constitution."". Minn. J. Int'l L. 18 (2009):

Schwartz, Herman. "The New East European Constitutional Courts" Mich. J. Int'l L. 13 (1991)

Ferejohn, John, & Pasquale Pasquino. "Constitutional adjudication: lessons from Europe". Tex. L. Rev. 82 (2003): 1671

Report of the Czech Const. Court. 'The relations between the Constitutional Courts and the other national courts, including the interference in this area of the action of the European courts' "http://www.confeuconstco.org"http://www.confeuconstco.org)

Van Alstyne, et. al. "A Critical Guide to Marbury v. Madison."". Duke Law Journal (1969): 1-47; Marshall, Chief Justice John. "Marbury v. Madison." 2013-6-19]. http://laws. flndlaw, corn/US/5/137, html (1803).

Weller, Marc. "The Vienna negotiations on the final status for Kosovo". International Affairs 84.4 (2008): 659-681.

Kelsen, Hans. Pure Theory of Law. The Law Book Exchange, 2003

Stone Sweet, Alec. "Constitutional Courts and Parliamentary Democracy (Special Issue on Delegation)". West European Politics 25 (2002): 77-100

Miller, Mark Judicial independence and judicial accountability: searching for the right balance: when congress attacks the federal courts. 56 Case Western Reserve Law Review, 1015 (2006);

Jackson, Vicki C Fair and Independent Courts: A Conference on the State of the Judiciary: Packages of Judicial Independence: The Selection and Tenure of Article III Judges 95 Georgetown Law Journal. 965 (2007)

Jackson, Vicki & Mark Tushnet Comparative constitutional law. New York: Foundation Press, 1999

Kommers, Donald & Russell Miller. The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany: Revised and Expanded. Duke University Press, 2012

Kommers, Donald "The federal constitutional court in the German political system". Comparative Political Studies 26.4 (1994): 470-491

Morrison, Fred L. "Constitution of Bosnia-Herzegovina, The". Const. Comment.13 (1996): 145; Yee, Sienho. "New Constitution of Bosnia and Herzegovina, The". Eur. J. Int'l L.7 (1996): 176

Szasz, Paul C. "The protection of human rights through the Dayton/Paris peace agreement on Bosnia.". American Journal of International Law (1996): 301-316.

Epstein, Lee, & Jeffrey A. Segal. Advice and consent: The politics of judicial appointments. Oxford University Press, 2005

Lively, Donald E. "Supreme Court Appointment Process: In Search of Constitutional Roles and Responsibilities, The". S. Cal. L. Rev. 59 (1985): 551.

Kane Jr, John L. "Public Perceptions of Justice: Judicial Independence and Accountability". Journal of the National Association of Administrative Law Judiciary 17.2 (2013)

Geyh, Charles Gardner. "Judicial Selection Reconsidered: A Plea for Radical Moderation". Harv. JL & Pub. Pol'y 35 (2012): 623

Kelemen, R. Daniel. "The political foundations of judicial independence in the European Union". Journal of European Public Policy 19.1 (2012): 43-58

Seibert-Fohr, Anja. Judicial Independence in Transition. Vol. 233. Springer, 2012

Kelemen, Katalin. "Appointment of constitutional judges in a comparative perspective—with a proposal for a new model for Hungary". Acta Juridica Hungarica 54.1 (2013): 5-23.

Zurn, Michael, et al. Rule of Law Dynamics: In an Era of International and Transnational Governance. Cambridge University Press: 2012.

Tadros, Victor. "The Ideal of the Presumption of Innocence". Criminal Law and Philosophy (2013): 1-19.

Duff, R. A. "Pre-trial detention and the presumption of innocence". Oxford University Press, Forthcoming (2012): 12-31.

Weiß, Wolfgang. "Human rights in the EU: rethinking the role of the European convention on human rights after Lisbon". European Constitutional Law Review 7.1 (2011): 64-95.

Thomas, Clarence. "Judging". U. Kan. L. Rev. 45 (1996): 1

Kaufman, Irving R. "The Essence of Judicial Independence". Columbia Law Review (1980): 671-701.

Fuchs, Claudia/Lachmayer, Konrad The Right to a Fair Trial in the Case-Law of the Austrian Constitutional Court, www.icl-journal.com, Vol 3, 1/2009, 2.

Gentili, Gianluca Comparison of European Systems of Direct Access to Constitutional Judges: Exploring Advantages for the Italian Constitutional Court, 1 June 2012, 2012 Italian Journal of Public Law, Issue 1, p.159 (2012).

Graber, Mark A. Dred Scott and the Problem of Constitutional Evil. New York, Cambridge University Press (2006).

Guettler, Vojen Gjyqtar, Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke, Raport "Executions of judgments of the Constitutional Court of the Czech Republic", Seminar "The Efficiency of Constitutional Justice in a Society in Transition", Jerevan, Armeni, 6-7 tetor 2000, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim Gjykatën Kushtetuese të Armenisë, CDL-JU(2000)040 (mund të shkarkohet nga http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282000%29040-e).

Harutyunyan, Gagik Hoffmann-Riem, Wolfgang (anëtar gjerman), Omejec, Jasna (anëtar zëvendësues, kroat), në komentet e të cilëve u bazua "Opinion on Draft Amendments to the Law on the Constitutional Court of Latvia", miratuar nga Komisioni i Venedikut në mbledhjen e 80-të plenare (Venedik, 9-10 tetor 2009), CDL-AD (2009) 042. www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)042

Hasani, Enver and Cukalovic, Ivan Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, GIZ, 2013.

Hasani, Enver Constitutional Protection of the Head of State: The case of Kosovo, ICL Journal | Vol 7 | 2/2013 | 128

Hasani, Enver,/ Doli, Dren/ Mekanizmi i ankesës kushtetuese si mjet i mbrojtjes

Korenica, Fisnik Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo, European Yearbook on Human Rights 2012, Editoi Wolgang Benedek, Wolfram Karl and Manfred Novak, faqet 383 – 400.

Jackson, Vicky & Tushnet, Mark Comparative Constitutional Law, 461(1999) Comparative Constitutional Law, 2nd Ed. (University Casebooks)

Klein, Oliver Asistent hulumtues, Gjykata Kushtetuese Federale, Gjermani, Raport "The Federal Constitutional Court's relation to the German ordinary courts, Konferenca "Interrelations between the Constitutional Court and Ordinary Courts", Baku, Azerbajxhan, 9-10 nëntor 2006, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit (mund të gjendet në: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282006%29045-e)

Korenica, Fisnik Taking Care of Strasbourg: The Status of the European Convention on Human Rights and the Case-law of the European Court of Human Rights in Kosovo's Domestic Legal System, Liverpool Law Review, Botuar në rrjet më 20 dhjetor 2011, http://link.springer.com/article/10.1007/s10991-011-9098-9.

Kuijer, Martin Universiteti i Amsterdamit, Raport "Applicability of Article 6 ECHR", Instituti Bullgar i Drejtësisë, përfshirë edhe bazën ekzistuese të të dhënave në kornizën e projektit "Promoting Efficiency of the Bulgarian Judiciary in the Area of Human Rights Protection", zbatuar nga BLHR Foundation nga nëntori 2005 gjer në gusht 2006, Kapitulli 4.6, Constitutional courts, Faqe 23 deri 25.

Kuijer, Martin — The Blindfold of Lady Justice, Judicial Independence and Impartiality in Light of the Requirements of Article 6 ECHR, Wolf Legal Publishers 2004.

Kutris, Gunars — Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, Raport "Authority of the Constitutional Court as the Precondition of Execution of the Decisions", Konferenca "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice", Baku, Azerbajxhan, 14-15 korrik 2008, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit, CDL-JU(2008)028. www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(2008)028-e

Lopez Guerra, Luis — The Role and Competences of the Constitutional Court, Raport i Luis Lopez Guerra, Collection Science and technique of democracy, No. 10, The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law, Bukuresht, 8-10 qershor 1994, Procedura, Komisioni Evropian për demokraci përmes Ligjit, Këshilli i Evropës (CDL-STD(1994)010, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-STD%281994%29010-e

Marko, Joseph — The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective, Review of Central and East European Law, 33(2008), fq. 437-450.

Maurer, Andreas — The Federal Constitutional Court's Emergency Powers to Intervene: Provisional Measures pursuant to Article 32 of the Federal Constitutional Court Act. German Law Journal (2001), http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=70

Mavcic, Arne — The budget of the constitutional court, control and management with respect to the independence and autonomy of the court, a paper that describes the structure and the forms of regulation of the financial basis of the activity of constitutional courts in comparative perspective", dokument i prezantuar në seminarin e organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e

Hercegovinës, Sarajevë, 14-15 tetor 2004, mund të gjendet në http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-JU(2004)066prog.

Mavcic, Arne — Gjykata Kushtetuese, Slloveni, Kontribut me shkrim për mini konferencën "Constitutional Court Decisions – Slovenia", Takimi i 8-të i Këshillit të përbashkët për drejtësi kushtetuese, mini konferencë për Effects and execution of constitutional review decisions, Tallin, 19 qershor 2009, organizuar nga Komisioni i Venedikut, CDL-JU(2009)010 (duhet të gjendet në ueb-faqe)

Mavcic, Arne — Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë, raport "The Constitutional Court budget as one of the guarantees of the independence of constitutional justice", seminar "The budget of the Constitutional Court: a determining factor of its independence", Sarajevë, 14-15 tetor 2004, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës, CDL-JU(2004)056, http://venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282004%29056-e#

Mazak, Jan — Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, anëtar sllovak i Komisionit të Venedikut, raport "The European Model of Constitutional Review of Legislation", Exchange of Views between the Southern African Judges Commission and the Venice Commission, 17 mars 2006, CDL-JU(2006)016, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282006%29016-e

Mole, Nuala/Harby, Catharina — Article 6 of the European Convention on Human Rights, Human rights handbooks, No. 3, Drejtoria e përgjithshme për të drejtat e njeriut, Këshilli i Evropës, 2001, 2006 (botimi I, 2001; botim II gusht 2006).

Myjer, Egbert — Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, praktika standarde gjyqësore për dëgjimin e dëshmitarëve, 2005, prezantuar në Konferencën e 10-të të Asociacionit Ndërkombëtar të Prokurorëve për

Dhunën në Familje, Kopenhagë, 28 gusht –1 shtator 2005 (mund të shkarkohet nga www.iap-association.org).

Paczolay, Peter — Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë, Raport "Experience of the Execution of Constitu-tional Court's Decisions declaring Legislative Omission in Hungary", Konferenca "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice", me rastin e 10-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbajxhanit, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit, CDL-JU(2008) 029, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282008%29029-e

Pinelli, Cesare — Universiteti Macerata, Romë, Itali, Raport "Concept and Practice of Judicial Activism in the Experience of some Western Constitutional Democraties", Konferenca Ndërkombëtare me rastin e 15-vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Estonisë, "Political Questions in Constitutional Review: What is the Dividing Line between Interference with Policy-Making and Routine Constitutional Review?", Tallin, Estoni, 6-7 shtator 2007, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Estonisë, CDL-JU(2007)029, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282007%29029-e.

Puskas, Valentin Zoltan — Enforcement of the Constitutional Court Decisions, Constitutional Law Review, www.constcourt.ge/files/Journal_2012_eng.pdf

Rawls, John — Political Liberalism, New York: Columbia University Press, 1993.

Raport — Raport i Komisionit të Venedikut (Këshilli i Evropës) për përbërjen e gjykatave kushtetuese, më 17 shkurt 1997. http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-STD(1997)020.aspx.

Ribicic, Ciril — Strengthening Constitutional Democracy, Konferenca Botërore për Drejtësi Kushtetuese, Kejptaun, 23-24

janar 2009, tema “Influencial Constitutional Justice: its influence on society and on developing a global human rights jurisprudence”, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut dhe Komisioni i Venedikut, www.venice.coe.int/WCCJ/WCCJ_papers_E.asp.

Roli i gjykatës kushtetuese — Procedura, UniDem Seminar, Bukuresht 8-10 qershor 1994, në konsolidimin e rregullit?????? të Komisionit të Venedikut, shkenca dhe teknika e demokracisë, ligji. nr. 10. www.nbpublish.com

Rozakis, Christos — The Right to a Fair Trial in Civil Cases, Judicial Studies Institute Journal, faqet 96 – 106, 2004.

Sabareanu, Ruxandra — Sekretar i Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë, Raport “Communicating the Decisions of the Constitutional Court to the Public (How Communication Theory Could be used for Publicity of the Constitutional Court Decisions)”, CDL-JU(2006)056, http://www.venice.coe.int/webforms/events/default.aspx?id=616

Saiz Arnaiz, Prof. Alejandro — Universiteti i Vendit Bask, Spanjë, Raport “Techniques of constitutional interpretation by the European Constitutional Courts”. Puntori “Principles of Constitutional Control, Techniques of Constitutional and Statutory Interpretation”, Kiev, 5-6 qershor 1998, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Ukrainës, ARD/CHECCHI dhe Komisioni i Venedikut, CDL-JU(1998)024, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%281998%29024rev-e

Shala, Arbëresha Raca — The Ombudsperson in the Constitutional Jurisprudence of Kosovo, Kosova Anayasa Hukukunda Ombudsman, Universiteti Anadolu, Journal of Social Sciences. www.anadolu.edu.tr/sites/default/files/files/19.pdf

Sieveking, Rosanna — Wissenschaftliche Mitarbeiterin, Gjykata federale Kushtetuese, Karlsruhe, Gjermani, Raport “Case-law on constitutional protection of economic rights of citizens in Germany”, Seminar “Economic transition: property rights, restitution, pensions and other issues concerning the constitutional protection of economic

rights of citizens", Bishkek, 27-28 prill 2001, CDL-JU(2001)25, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282001%29025-e

Hirschl, Ran. Constitutional theocracy. Harvard University Press, 2011.

Solyom, Laszlo, Eotvos The Role of Constitutional Courts in the Transition to Democracy with Special Reference to Hungary, International Sociology, mars 2003, Vol. 18(1): 133-161, SAGE.

Sovdat, Jadranka Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, Raport "The Organisation of the Work of Legal Advisors in Support of the Decision-Making of the Constitutional Court, Presentation and Experience of the Constitutional Court of Slovenia", Konferenca e tretë e sekretarëve të përgjithshëm të gjykatave kushtetuese dhe trupave ekuivalente, Bled, Slloveni, 29-30 shtator 2005, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë, CDL-JU(2005)041, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282005%29041-e

Spirovski, Igor Gjyqtar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, ish-anëtar zëvendësues i Komisionit të Venedikut, Raport "The competence of the Constitutional Court to Control the conformity of Laws with International Treaties: New Trends in Constitutional Justice", Seminar "The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws with International Treaties", Podgoricë, Mali i Zi, 3 nëntor 2009, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi dhe OSBE-në, CDL-JU(2009)036, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD%282009%29036-e

Spirovski, Igor Gjyqtar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Raport Independence of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia: Guarantees and Challenges, Kongresi i 2-të i Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese,

Rio de Zheneiro, 16-17 janar 2011 “Separation of Powers and Independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies”, organizuar nga Gjykata Supreme Federale e Brazilit dhe Komisioni i Venedikut, Letrat.

Stack, Kevin M. — The Practice of Dissent in the Supreme Court. The Yale Law Journal. 105:8, 2235-2259, (1996).

Steinberger, Helmut — Models of Constitutional Jurisdiction, Science and Techniques of Democracy, No. 2, Strasburg (1993), Komisioni Evropian për demokraci përmes ligjit, Këshilli i evropës. CDL-STD(1993)002 (të kërkohet në ueb-faqe).

Suumann, Gea — Analist, Gjykata Supreme, Estoni, Raport “Execution and Effect of Constitutional Review Judgments, the Supreme Court Practice in 2004 – 2008”, Takimi i 8-të i Këshillave të Përbashkët për Drejtësi Kushtetuese, mini konferencë Effects and execution of constitutional review decisions, Tallin, 19 qershor 2009, organizuar nga Komisioni Venedikut, CDL-JU(2009)012, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282009%29012-e

Theunis, Jan — Zyrtar ligjor në Gjykatën Kushtetuese të Belgjikës, Raport “The interrelations between the Constitutional Court and ordinary courts, Konferenca “Interrelations between the Constitutional Court and Ordinary Courts, Baku, Azerbajxhan, 9-10 nëntor 2006, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerbajxhanit, CDL-JU(2006)046, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282006%29046-e

Tuori, Kaarlo — Prof. i jurisprudencës, Universiteti i Helsinkit, Finlandë, Anëtar i Komisionit të Venedikut, Raport “Combining Abstract Ex Ante and Concrete Ex Post Review: the Finnish Model, Unidem Seminar “Definition and Development of Human Rights and Popular Sovereignty in Europe”, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Goethe, Frankfurt

am Main, Gjermani, dhe me Universitetin e Helsinkit, Finlandë, 15-16 maj 2009, CDL-UD(2010)011, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-UD%282010%29011-e

Tuori, Kaarlo — Universiteti i Helsinkit, Zëvendëskryetar i Komisionit të Venedikut, Raport "Rights, Democracy and Local Self-Governance Social Rights, Konferencë Ndërkombëtare me rastin e 15-vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Estonisë, "Political Questions in Constitutional Review: What is the Dividing Line between Interference with Policy-Making and Routine Constitutional Review?", Talin, Estoni, 6-7 shtator 2007, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Estonisë, CDL-JU(2007)031, http://solrtest.bsz-bw.de/vufind/Record/DE-208275097641/Description

Ugur Erdal/Hasan Bakirci/ Boris Wijkstrom — Article 3 of the European Convention on Human Rights, A Practitioner's Handbook (OMCT (World Organisation against Torture) Handbook Series Vol. 1, 20 korrik 2006).

Varvarovsky, Pavel — The Budget of the Constitutional Court: Control and Management. Prezantim i Komisionit të Venedikut në punëtorinë e mbajtur në Kiev, Ukrainë, 19-21 janar 1998, CDL-JU (1998)009, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%281998%29006-f

Komisioni i Venedikut — Dokumentet kryesore referuese www.venice.coe.int/WebForms/pages/default.aspx?=01_main_reference_documents&lang=en

Komisioni i Venedikut — Referendums in Europe – an Analysis of the Legal Rules in European States, raport i miratuar në Këshillin për Zgjedhje Demokratike në takimin e 14-të (Venedik, 20 tetor 2005) dhe Komisioni i Venedikut në takimin e 64-t plenar, CDL-AD(2005)034 (mund të shkarkohet nga: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282005%29034-e).

Komisioni i Venedikut — Techniques of constitutional interpretation by the European Constitutional Courts, Raport i prof.

Alejandro Saiz Arnaiz, Universiteti i Vendit Bask, Spanjë, Punëtori "Principles of Constitutional Control, Techniques of Constitutional and Statutory Interpretation", Kiev, 5-6 qershor 1998, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Ukrainës, ARD/ CHECCHI dhe Komisioni i Venedikut, CDL-JU(1998) 024 (mund të shkarkohet nga: http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282005%29034-e).

Komisioni i Venedikut — STUDY on Individual Access to Constitutional Justice, Miratuar nga Komisioni i Venedikut në takimin e 85-të plenar (Venedik 17-18 dhjetor 2010) në bazë të komenteve të Harutyunyan, Gagik, anëtar armen i Komisionit të Venedikut, Nussberger, Angelika, anëtare zëvendësuese nga Gjermania, Paczolay, Peter, anëtar hungarez, CDL-AD(2010)039rev, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282010%29039rev-e

Venice Commission — Code of Good Practice in Electoral Matters, Guidelines and Explanatory Report, Miratuar nga Komisioni i Venedikut në takimin e 52-të plenar (Venedik 18-19 tetor 2002, CDL-AD(2002)23 rev, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD%282002%29023rev-e

Venice Commission — Code of Good Practice of Referendums, Miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në takimin e 19 plenar (Venedik, 16 dhjetor 2006) dhe Komisioni i Venedikut në takimin e 70 plenar (Venedik, 16-17 mars 2007) në bazë të kontributeve të Pieter van Dijk (anëtar, Holandë), Francois Luchaire (anëtar, Andorrë) dhe Giorgio Malinverni (anëtar, Zvicër), CDL-AD(2007)008rev, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282007%29008rev.aspx

Venice Commission — Raport Composition of constitutional courts, më 17 shkurt 1997 www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-STD(1997)020.aspx?pdfflile=.

Wagner, Britta — Sekretari i Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese, Austri, Raport "Effects and Execution of Constitutional Court Judgments", Takimi i 8-të i Këshillit të Për-

bashkët për Drejtësi Kushtetuese, mini-konferenca "Effects and execution of constitutional review decisions", Tallin, 19 qershor 2009, organizuar nga Komisioni i Venedikut, CDL-JU(2009)013, CDL-JU(2009)013, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282009%29013-e

Wagnerova, Eliska, Zëvendëskryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke, Raport "Types of Judgments as a Contribution to the Efficiency of Decision-Making at the Constitutional Court", Konferenca "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice," me rastin e 10-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Azerbejxhanit, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Azerjbexhanit, CDL-JU(2008)030, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-JU%282008%29030-e

Wedam Lukic Dragica Gjyqtare, Gjykata Kushtetuese, Slloveni, Raport "The Limits of the Review of Decisions of Ordinary Courts in Constitutional Complaint Proceedings before the Constitutional Court of the Republic of Slovenia", Konferenca Limits of Consti-tutional Review of Ordinary Court's Decisions in Constitutional Complaint Proceedings, Bërno, Republika Çeke, 14-15 nëntor 2005, organizuar nga Komisioni i Venedikut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës Çeke, CDL-JU (2005)060, http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU%282005%29060-e

Wildhaber, Luzius Judicial Impartiality Under the European Convention on Human Rights, letër pune mund të gjendet në http://www.concourt.am/hr/ccl/vestnik/2.12-2001/wildhaber-eng.htm.

LISTA E SHKURTESAVE

BVerfGG	Bundesverfassungsgerichtsgezetz (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, me ndryshime, data e botimit 12.03.1951).
DIFID	Departamenti i MB-së për Zhvillim Ndërkombëtar
EComHR	Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, i shfuqizuar me Protokollin 11 të KEDNJ-së në vitin 1998.1
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore e 3 shtatorit 1953, me ndryshime.
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ESDP	Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje
EWMI	East West Management Institute
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
Fondacioni IRZ	Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik
KFOR	Forca për Kosovën
LGJK	Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese i datës 16 dhjetor 2008, me ndryshime.
LPK	Ligji nr. 3/L006 për Procedurën Kontestimore i datës 30 qershor 2008, me ndryshime
OBKT	Organizata Botërore Kundër Torturës
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i themeluar me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, datë 10 qershor 1999.
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

UDHËZIME PËR LEXUESIT E KËTIJ KOMENTARI

Komentari ka një strukturë të qartë dhe të thjeshtë. Teksti i çdo neni të Ligjit dhe çdo rregulle të Rregullores së Punës pasohet nga komentet. Komentet e paragrafëve të ndryshëm të një neni dhe të paragrafëve përkatës të rregullave mund të dallohen si vijon: për komentet e paragrafit të një neni të ligjit, komentet përkatëse paraprihen në margjinën e numrave korrespondues të paragrafit me numra arabë (1, 2, etj.), ndërsa për paragrafët e një rregulle, komentet përkatëse paraprihen në margjinën e numrave korrespondues të rregullës me numra romakë (I, II, etj.).

Bashkëngjitur me këtë komentar janë Ligji për Gjykatën Kushtetuese i datës 16 dhjetor 2008, me ndryshime, dhe Rregullorja e Punës e datës 23 nëntor 2010, me ndryshimet e fundit të bëra më 17 qershor 2013. Më tutje, në fund të komentarit lexuesi do të gjejë indeksin e fjalëve kyçe, me referencë në terminologjinë më të rëndësishme juridike.

Hyrje

I. Historiku i Ligjit

Miratimi i Kushtetutës së Kosovës (9 prill 2008) dhe, në bazë të saj, i Ligjit nr. 03/L-21 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (16 dhjetor 2008) (në tekstin e mëtejmë "ligji") mundësoi themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që shënoi një pikë të rëndësishme kthese në procesin e konsolidimit të demokracisë kushtetuese dhe të sundimit të ligjit në Kosovën e pavarur. Ky veprim gjithashtu përfaqëson rilindjen e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila u suprimua në fillim të vitit 1990, pas heqjes së autonomisë kushtetuese të Kosovës më 28 mars 1989, kur parlamenti serb miratoi ndryshime kushtetuese, të cilat kufizuan në mënyrë të konsiderueshme autonominë kushtetuese të Kosovës, të përcaktuar me Kushtetutën e ish-RSFJ-së të vitit 1974 dhe me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974.[1] Që atëherë ishin bërë përpjekje të vazhdueshme për të rivendosur sistemin e kontrollit kushtetues në vend. Në vitin 1999 Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë ("Marrëveshja e Rambujesë") kishte përcaktuar formimin e një gjykate kushtetuese 9 anëtarëshe me një prani ndërkombëtare prej pesë gjyqtarëve ndërkombëtarë, për të siguruar përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe për të mbrojtur liritë dhe të drejtat kushtetuese.[2] Një marrëveshje e tillë nuk u implementua, kurse korniza institucionale e përcaktuar sipas saj nuk u jetësua kurrë në praktikë. Nevoja për të themeluar një sistem të kontrollit kushtetues (për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës) ishte artikuluar nga përfaqësuesit vendorë gjatë hartimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë. Në prill të vitit 2001 ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë nën udhëheqjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)[3] ishin mandatuar për të hartuar një dokument kushtetues, i cili të mundësonte ndërtimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe bartjen graduale të autorizimeve nga Misioni i Kombeve të Bashkuara tek organet e përkohshme të vetëqeverisjes.[4] Megjithatë, propozimi për themelimin e Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, qe refuzuar nga UNMIK-u me justifikimin se një hap i tillë tejkalonte frymën dhe kufizimet e përcaktuara me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nr. 1244, me arsyetimin se kjo do të reflektonte atribut të shtetësisë, prandaj do të prejudikonte

---

[1] Për një pasqyrë të detajuar të historisë kushtetuese të Kosovës shih Joseph Marko në Jochen Abr Frowein dhe Christiane E. Philipp, Max Planck Yearbook of United Nations Law [Volume 5 of Max Planck Yearbook of United Nations Law] (Martinus Nijhoff Publishers, 2001) f. 116.

[2] Shih nenin V (6) të Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje (The Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo). Teksti i plotë i Marrëveshjes në gjuhën angleze gjendet në <http://www.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html>.

[3] Grupi punues i themeluar nga UNMIK-u për hartimin e Kornizës Kushtetuese, u drejtua nga z. Johan van Lamoen, njëri prej hartuesve të këtij Komentari.

[4] Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së u miratua në qershor të vitit 1999. Rezoluta autorizoi një prani ndërkombëtare ushtarake dhe civile në Kosovë për një kohë të pacaktuar. Për më tepër, Rezoluta autorizoi një forcë ushtarake nën drejtimin e NATO-s (KFOR) për t'u kujdesur për rendin dhe qetësinë ndërsa UNMIK-ut i ishte dhënë roli i administrimit të Kosovës për një periudhë të përkohshme me qëllim të transferimit gradual të përgjegjësive administrative tek institucionet e zgjedhura vetëqeverisëse.

statusin përfundimtar të Kosovës.[5]Neni 9.4.11 i Kornizës Kushtetuese kishte parashikuar vetëm krijimin e Kolegjit të Veçantë për Çështje Kushtetuese në kuadër të Gjykatës Supreme, për të trajtuar çështje rreth Kornizës Kushtetuese, për të vendosur, ndër të tjera, nëse ndonjë ligj i miratuar nga Kuvendi do të ishte në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese si dhe me instrumentet juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, ky Kolegj i veçantë nuk u funksionalizua kurrë; kështu që neni në fjalë nuk fitoi ndonjë rëndësi praktike kushtetuese.[6] Përfundimisht, koncepti për ngritjen e gjykatës kushtetuese si pjesë fundamentale e arkitekturës kushtetuese të Kosovës triumfoi në "bisedimet e Vjenës" për statusin politik të Kosovës nën udhëheqjen e Emisarit Special të OKB-së, z. Martti Ahtisaarit, i cili në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (së këndejmi "Propozimi Gjithëpërfshirës"), të datës 26 mars 2007, kishte përcaktuar formimin e një gjykate kushtetuese nëntanëtarëshe, për të siguruar mbrojtjen e kushtetutshmërisë.[7]

Më pas, Grupi Punues i përbërë nga 21 anëtarë hartoi Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës, bazuar në parimet e zhvilluara në Propozimin Gjithëpërfshirës dhe, më 2 prill 2008, Projektkushtetuta u certifikua nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i mandatuar në bazë të nenit 1 [Objektivat] të Aneksit IX [Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar] të Propozimit Gjithëpërfshirës për të mbikëqyrur zbatimin e Marrëveshjes dhe për të përkrahur përpjekjet e duhura të autoriteteve të Kosovës.[8]

Më 9 prill 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (prandaj "Gjykata Kushtetuese") zuri një pozitë institucionale të rëndësishme. Deri në kohën e hartimit të këtij Komentari, Kushtetuta është ndryshuar me 23 amendamente kushtetuese. Përveç amendamentit kushtetues që ka fuqizuar Kuvendin e Kosovës për të dhënë amnistinë, pjesa tjetër e amendamenteve kushtetuese u miratua në funksion të përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur. Një pjesë e këtyre gurthemeleve të drejtësisë kushtetuese në Kosovë janë vendosur për shembull në nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII të tij [Gjykata Kushtetuese], ku Kushtetuta përcakton që Gjykata Kushtetuese

---

[5] Për më shumë, rreth administrimit ndërkombëtar në Kosovë, shih Christian E. Ford and Ben A. Oppenheim, "Neotrusteeship or Mistrusteeship? the "Authority Creep" Dilemma in United Nations Transitional Administration", 41 *Vanderbilt Journal of Transnational Law*, (2008), 55 - 105; Alexandros Yannis, "The UN as Government in Kosovo", 10 Global Governance, (2004), 67-81; Carsten Stahn, "Constitution without a State? Kosovo under the United Nations Constitutional Framework for Self-Government", 14 Leiden Journal of International Law, (2001), 531-561; Carsten Stahn, "The United Nations Transitional Administrations in Kosovo and East Timor: A first Analysis", 5 Max Planck Yearbook of United Nations Law (2001), 105-183; David Marshall and Shelley Inglis, "The Disempowerment of Human Rights-Based Justice in the United Nations Mission in Kosovo", 16 Harvard Human Rights Journal (2003), 96-145.

[6] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Neni 9.4.11. Dokumenti mund të gjenden në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/FrameworkPocket_ENG_Dec2002.pdf.

[7] Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 27 Mars 2007 adreson 1) nevojën për funksionimin e një demokracia multi-etnike 2) nxjerjen e kushtetutës së Kosovës 3) statusin e Kosovës në marrëshënje ndërkombëtare 3) të drejtat e minoriteteve dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre 4) decentralizimi 5) sistemi i drejtësisë 6) trashëgëmia kulturore dhe fetare 7) kthimin e refugjatëve 8) zhvillimin ekonomik dhe 9) sigurinë. Teksti i plotë i Propozimit Gjithëpërfshirës është i arritshëm në www.unosek.org/.../statusproposal.html.

[8] Ibid.

është "autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën";[9] mirëpo edhe neni 113 [Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që numëron palët e autorizuara, të cilat kanë të drejtën juridike të referimit të çështjeve para Gjykatës dhe përcakton çështjet që mund të referohen tek Gjykata. Duke vendosur procedurën e ankesës kushtetuese në nenin 113.7, individët (si dhe personat juridikë nga neni 21, paragrafi 4 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës)[10] fituan një instrument të fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.

Dispozitat kushtetuese lidhur me Gjykatën Kushtetuese u zbatuan me miratimin e Ligjit nr. 03/l-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008, i cili rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues dhe parimet themelore procedurore lidhur me procedimin e një kërkese kushtetuese. Procesi për hartimin e projektligjit për Gjykatën Kushtetuese u iniciua në maj të vitit 2008, kur u formua Grupi punues për themelimin e Gjykatës Kushtetuese, në kuadër të të cilit morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare, përfshirë ekspertë juridikë vendorë dhe ndërkombëtarë.[11]

Dy nga autorët e këtij Komentari, përkatësisht znj. Gjyljeta Mushkolaj dhe z. Visar Morina, kanë pasur nderin të kenë qenë anëtarë të këtij grupi punues.

II. Fushëveprimi i ligjit

Ligji për Gjykatën Kushtetuese zbaton nenet 112 [Parimet e Përgjithshme], 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese], 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], 117 [Imuniteti] dhe neni 118 [Shkarkimi] i kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës.

Në veçanti, Neni 1 [Fushëveprimi] i Kapitullit I [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese], Nënkapitulli 1 [Dispozitat e Përgjithshme] të Ligjit, përcakton si vijon: "*Ky ligj rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të*

[9] Për më shumë informacione në lidhje me veçoritë e procesit, shih Joseph. "The new Kosovo constitution in a regional comparative perspective". *Review of Central and East European Law* 33, no. 4 (2008): 437-450.; Shih po ashtu Tunheim, John. "Rule of law and the Kosovo constitution". *Minn. J. Int'l L.* 18 (2009): 371.

[10] Neni 21.4 i Kushtetutës përcakton: "Të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me këtë Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

[11] Grupi i Përbashkët Punues u kryesua nga Prof. Dr. Arsim Bajrami, në atë kohë Ministër i Administratës Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe aktualisht profesor i së Drejtës kushtetuese në Universitetin e Prishtinës në Kosovë, dhe Vjosa Osmani, në atë kohë këshilltare e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe aktualisht mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës në Kosovë.

Gjykatës Kushtetuese, kualifikimet e tjera përkatëse për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje të tjera organizative.“.

Fushëveprimi i ligjit do të komentohet në mënyrë të detajuar në pjesën vijuese të Komentarit, sipas neneve përkatëse të Ligjit.

III. Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese

Në bazë të nenit 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese] është përcaktuar se: "2.Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset vendim-marrëse si dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin". Gjykata, pas themelimit të saj në shtator të vitit 2009, ka përgatitur një sërë rregullash të cilat janë miratuar nga ana e gjyqtarëve më 23 nëntor 2010. Sipas nenit 1 [dispozitat e përgjithshme] të Kapitullit I [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese], "Rregullorja e Punës plotëson dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosova për organizimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ("Gjykata"), të procedurave para Gjykatës dhe të çështjeve të tjera përkitazi me funksionimin e Gjykatës."

Rregulloret e Punës kanë pësuar ndryshime disa herë, dhe ndryshimi i fundit është bërë në vitin 2013. Në mënyrë që lexuesit të kuptojnë më mirë ndërveprimin e Ligjit dhe Rregullores së Punës, vetëm ndryshimet më të fundit në tekstin e Rregullores do të shfaqen në Komentar.

IV. Raporti në mes Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta

Edhe pse Gjykata Kushtetuese është një gjykatë e drejtësisë, ajo nuk është një gjykatë e rëndomtë, po është një nga organet kushtetuese të Republikës së Kosovës së bashku me Presidentin, Kuvendin, Qeverinë, Avokatin e Popullit dhe Gjyqësorin. Siç u theksua më lart, Gjykata Kushtetuese ka mandatin për të shërbyer si interpretues përfundimtar i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për Gjyqësorin dhe tërë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 116 [efekti juridik i vendimeve] të Kushtetutës. Në doktrinën kushtetuese, gjykatat kushtetuese rëndom portretizohen si organe kushtetuese, të cilat qëndrojnë jashtë sistemit klasik të gjyqësorit. Ka disa arsye përse gjykatat kushtetuese trajtohen jashtë konceptit ngushtë të definuar të gjyqësorit të zakonshëm. Së pari, në disa kushtetuta evropiane, "dispozitat kushtetuese për gjykatat kushtetuese nuk shfaqen zakonisht në seksionin për Gjyqësorin... po në një seksion të veçantë".[12] Për shembull, Kushtetuta e Italisë (neni 134), Kushtetuta e Austrisë (neni 137) ose Kushtetuta e Francës (neni 56) kanë trajtuar strukturalisht mbrojtjen e kushtetutës dhe mekanizmat e saj mbrojtës në seksione të veçanta kushtetuese. Mirëpo,, natyrisht, ka edhe përjashtime nga kjo praktikë. Për shembull, Ligji Themelor i Gjermanisë, në seksionin

[12] Schwartz, Herman. "New East European Constitutional Courts, The”. *Mich. J. Int'l L.* 13 (1991): 741.

e quajtur Administrimi i drejtësisë, përcakton një qasje më të unifikuar dhe kohezive të Gjyqësorit, dhe Gjykata Kushtetuese përfshihet brenda këtij koncepti të Gjyqësisë. Neni 92 përcakton se "autoriteti gjyqësor u është dhënë gjyqtarëve; dhe ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese Federale, nga Gjykata Supreme Federale, nga gjykatat federale të përcaktuara më këtë Ligj Themelor dhe nga gjykatat e Landeve".

Elementi i dytë i veçantë është profili dhe përvoja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave kushtetuese nuk vijnë domosdoshmërisht nga gjyqësori, po nga "një popullatë më e gjerë duke përfshirë avokatë dhe studiues të shquar ligjorë".[13] Disa vende lejojnë të bëhen anëtarë të gjykatës kushtetuese edhe individë pa përvojë juridike, sikurse ndodh në Francë dhe Turqi, edhe pse në praktikë "këto gjykata përbëhen zakonisht nga juristët".[14] Së treti, gjyqtarët e gjykatës kushtetuese emërohen në bazë të një formule kushtetuese, e cila është ndonjëherë e ndryshme nga sistemi i emërimit të gjyqtarëve të zakonshëm. Në Kosovë, për shembull, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen në një mënyrë që është e ndryshme nga ajo e emërimit të gjyqtarëve të rregullt. Gjithashtu kohëzgjatja e shërbimit të gjyqtarëve kushtetues është e ndryshme në krahasim me atë të gjyqtarëve të rregullt, gjë që pozitën e tyre kushtetuese e bën paksa të ndryshme në krahasim me të gjyqtarëve të rëndomtë.

Në kryerjen e detyrës së saj si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese shqyrton edhe vendimet (veprimet) e gjykatave të rregullta (krahas legjislativit dhe ekzekutivit), në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, duke gjykuar referimet e palëve ankimore (individëve dhe personave juridikë) mbi pretendimet e tyre se një vendim i një gjykate të rregulltë ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë. Megjithëkëtë, ankesa duhet së pari të jetë sjellur para gjykatës, përfshirë këtu edhe Gjykatën Supreme, para se të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese. Kjo do të thotë që duhet të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, para se Gjykata Kushtetuese të mund të shqyrtojë nëse gjykata e rregullt ka shkelur të drejtat kushtetuese siç pretendohet nga ankuesi.

Është me rëndësi të thuhen edhe disa fjalë në lidhje me interpretimin kushtetues të Kushtetutës. Siç ka theksuar me të drejtë, në Komentarin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 2008, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani: "Gjykata Kushtetuese nuk është interpretuesi ekskluziv i Kushtetutës. Interpretimi kushtetues ndodh në çdo sekondë të jetës institucionale për aq kohë sa institucionet kryejnë detyrat e tyre kushtetuese, që burojnë nga kjo Kushtetutë".[15] Por Gjykata Kushtetuese mbetet interpretuesi përfundimtar i kuptimit të normave kushtetuese, kur institucionet shtetërore nuk janë të sigurta ose kanë pikëpamje të kundërta në lidhje me kuptimin e normave ose parimeve kushtetuese. Këto lloje të vendimeve interpretative të Gjykatës

[13] Ferejohn, John, and Pasquale Pasquino. "Constitutional adjudication: lessons from Europe". *Tex. L. Rev*. 82 (2003): 1671.
[14] Raport nga Komisioni i Venecias (Këshilli i Evropës) për përbërjen e gjykatave kushtetuese, datë 17 shkurt 1997 http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-STD(1997)020.aspx.
[15] Shih Hasani, Enver dhe Cukalovic, Ivan. *Komentari i Kushtetutës së Kosovës*. GIZ, 2013. f. 566.

Kushtetuese konsiderohen përgjithësisht si burime të së drejtës kushtetuese dhe juridikisht janë të detyrueshme për institucionet shtetërore.

Kur Gjykata konstaton se vendimi (veprimi) i kundërshtuar i gjykatës së rregullt ka cenuar Kushtetutën, ajo vetëm do të lërë mënjanë vendimin, dhe nuk do ta zëvendësojë me aktgjykimin e saj. Në vend të kësaj, Gjykata do të referojë rastin në gjykatën e rregullt, e cila duhet të ri-konsiderojë çështjen në kontekst të vendimit dhe arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese. Në disa raste Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës Supreme. Në rastin *Ibrahimi et.al k. Gjykatës Supreme të Kosovës*, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese "për të vepruar si një gjykatë e apelit, apo si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme".[16] Detyra e Gjykatës Kushtetuese në këto lloj procedurash të shqyrtimit kushtetues është vetëm për të vlerësuar nëse është shkelur ndonjë nga të drejtat kushtetuese të garantuara me Kushtetutë gjatë procedurës gjyqësore, dhe nëse gjykatat kanë respektuar garancitë kushtetuese në lidhje me mënyrën si janë zhvilluar procedurat gjyqësore. Duhet theksuar se, në aspektin e lidhjes procedurore, "gjykatat e rregullta nuk kanë një pozitë të veçantë në krahasim me personat apo organet e tjera të interesuara në rastet para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e rregullta fitojnë statusin e një pale në procedurë: në rastin e referimit paraqitet në cilësinë e propozuesit (paditësit), dhe në rastin e një ankese kushtetuese, ajo paraqet palën e paditur (ang. defending party)".[17]

Legjislacioni aktual nuk ofron një pasqyrë të qartë në lidhje me përmasat e rishikimit kushtetues të vendimeve të gjykatave nga Gjykata Kushtetuese. Sidoqoftë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat i deklarojnë si jokushtetuese aktgjykimet e Gjykatës Supreme, duhet të respektohen dhe të ekzekutohen nga Gjykata Supreme. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë personat fizikë dhe për autoritetet publike, përfshirë këtu gjykatat. Kjo dispozitë gjithashtu mund të interpretohet se "vendimet e Gjykatës Kushtetuese përbëjnë një precedent të detyrueshëm. Fillimisht, ka mbizotëruar një interpretim i ngushtë i kësaj dispozite, por gradualisht një interpretim më i gjerë dhe efektet e së drejtës së precedentit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, janë duke u njohur gjithnjë e më shumë".[18]

Një lidhje e mëtejshme në mes Gjykatës dhe gjykatave të rregullta është përcaktuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, sipas të cilit: "g*jykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën, dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në*

[16] Imer Ibrahimi k. 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 23 qershor 2010. Http:/ / gjk-ks.org /. Qasja në web. 2 dhjetor 2011.
[17] Raporti i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke.'The relations between the Constitutional Courts and the other national courts, including the interference in this area of the action of the European courts' (http://www.confeuconstco.org) <http://confeuconstco.org/reports/rep-xii/Tsjechie-EN.pdf> qasur më 15 Maj 2014.
[18] Ibid.

fjalë". Kushtetuta përdor shprehjen të gjitha gjykatat, që do të thotë se çdo gjykatë, pavarësisht nga hierarkia e saj në sistemin e drejtësisë në Kosovë, ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, në qoftë se zgjidhja e rastit konkret varet nga përputhshmëria e ligjit të referuar me Kushtetutën. Ky mekanizëm i kontrollit kushtetues, në teorinë e rishikimit kushtetues njihet si referim i rastit ose referim incidental. Gjyqtarët e rregullt sigurisht që nuk mund të vendosin vetë për kushtetutshmërinë e një ligji, i cili është i nevojshëm për vendimin e tyre. Gjykata vetëm mund të ndërpresë procedurat gjyqësore dhe t'ia kalojë çështjen Gjykatës Kushtetuese, e cila më pas do të vendosë nëse ligji i kontestuar është kushtetues. Një kompetencë të ngjashme e hasim edhe në Gjykatën Kushtetuese Federale Gjermane, siç përcaktohet në Ligjin Themelor dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese Federale.[19]

Kontrolli konkret i kushtetutshmërisë do të komentohet më tej në bazë të nenit 51 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit.

[19] Shih për detaje të tjera Ligjin Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, të shpallur nga Këshilli Parlamentar më 23 maj 1949. Ligji mund të gjendet në https://www.btg-bestellservice.de/pdf/80201000.pdf.

Ligji (nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kreu I: Organizimi i Gjykatës Kushtetuese

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 [Fushëveprimi i Ligjit]

> **Ky ligj rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kualifikimet tjera përkatëse për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje tjera organizative.**

Arkitektura ligjore mbështetet përgjithësisht në parimin e supremacisë së kushtetutës, që do të thotë se kushtetuta përfaqëson një *lex fundamentalis* në një demokraci kushtetuese. Ky parim nënkupton se çdo ligj ose akt juridik në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, konsiderohet i pavlefshëm dhe nul. Parimi i supremacisë kushtetuese gjithashtu nënkupton që duhet të respektojnë "jo vetëm të gjitha organet dhe institucionet politike, po edhe të gjitha burimet e tjera të së drejtës apo autoritetet juridike, të cilat janë të ranguara më ulët se kushtetuta në hierarkinë juridike të shtetit".[20] Epërsinë kushtetuese mbi ligjin e kishte evokuar gjyqtari Marshall në jurisprudencën amerikane në rastin e quajtur Marbury k. Madison (1810), në të cilin ai deklaroi se kushtetuta është ligj suprem i vendit dhe, kur ligjet e zakonshme bien në konflikt me kushtetutën, ato duhet të shfuqizohen ose të bëhen të pavlefshme.[21]
Përparësia e kushtetutës ndaj akteve të tjera normative, duke i përfshirë, po duke mos u kufizuar në ligjet e miratuara parlamentare, përbën boshtin e doktrinës së hierarkisë së akteve ligjore. Ky parim është vendosur edhe në Kushtetutën e Kosovës, e cila në nenin 16 përcakton: "Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë". Tipar tjetër i normave kushtetuese, përveç supremacisë së tyre, është ekskluziviteti dhe gjerësia e gjuhës në tekstet kushtetuese. Kjo veçori nënkupton se disa nga normat kushtetuese mund të zbatohen drejtpërsëdrejti për funksionimin e organeve kushtetuese dhe mund të zbatohen drejtpërdrejt nga individët, dhe, së dyti, disa nga normat kushtetuese mund të kërkojnë shtjellim të mëtejshëm në ligj, në mënyrë që të mund të zbatohen në praktikë. E njëjta gjë vlen edhe për dispozita të caktuara të Kushtetutës së Kosovës në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, të cilat kërkojnë rregullim të mëtejshëm në formë të miratimit të ligjit për të përmbushur funksionin e tyre. Për këtë arsye një analizë e

[20] Hirschl, Ran. *Constitutional theocracy*. Harvard University Press, 2011. f. 72.
[21] Shih Van Alstyne, William W., and John Marshall. "A Critical Guide to Marbury v. Madison". *Duke Law Journal* (1969): 1-47; Marshall, Chief Justice John. "Marbury v. Madison". *2013-6-19]. http://laws. flndlaw, corn/US/5/137, html* (1803)

bazës kushtetuese të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, është e rëndësishme për t'u diskutuar.

Baza juridike e Ligjit mbështetet në kapitullin e tetë të Kushtetutës, i cili përcakton parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Kosovës (tash e tutje: "Kuvendi") ka miratuar Ligjin nr. 03/L-121 për të rregulluar më tej këto parime.[22] Kjo teknikë e normimit juridik është zbatuar për rregullimin e organizimit dhe funksionimit edhe të organeve të tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës. Për shembull, Kuvendi i Kosovës, në dhjetor të vitit 2008, ka miratuar Ligjin nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës. Ky ligj përmban një kornizë të detajuar normative lidhur me organizimin, funksionet dhe të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës, të cilat burojnë nga parimet themelore kushtetuese të përcaktuara në kapitullin 5 të Kushtetutës (Presidenti i Republikës së Kosovës).

Rregullimi me ligj i detajeve të organizimit dhe funksionimit të organeve kushtetuese të Kosovës krijon, në këtë mënyrë, një kornizë të ligjeve, të cilat, përmes ngjashmërive të tyre, ofrojnë më tepër siguri dhe stabilitet ligjor dhe sigurojnë funksionimin e tyre në mënyrë më harmonike. Janë dy karakteristika themelore që duhet të trajtohen në këtë drejtim. Së pari, ky Ligj vlefshmërinë e tij juridike e ka fituar nga Kushtetuta (nenet 113, 114 dhe 115), e cila ka autorizuar Kuvendin për të rregulluar më tej kategori të caktuara të Gjykatës Kushtetuese, siç janë çështja e kompetencave shtesë të Gjykatës Kushtetuese, përcaktimi i kualifikimeve të tjera shtesë për kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese si dhe përcaktimi i strukturës organizative dhe i Rregullores së Punës së Gjykatës. Duke evokuar fjalët e Kelzenit në reflektimet e tij rreth shtetit dhe së drejtës, kompetencat e dhëna kushtetuese të Kuvendit nënkuptojnë normat kushtetuese, si norma më të larta, përcaktojnë jo vetëm organin dhe procedurën për miratimin e ligjit që rregullon kategoritë e sipërpërmendura të Gjykatës Kushtetuese, por këto norma përcaktojnë edhe përmbajtjen e normave ligjore.[23] E dyta, Ligji jo vetëm që fiton validitetin e tij nga Kushtetuta, por Ligji duhet të mbetet brenda parametrave të përcaktuar kushtetues duke rregulluar vetëm ato çështje të Gjykatës, për të cilat janë dhënë autorizime shprehimore kushtetuese. Nga perspektiva Kelzeniane e hierarkisë së akteve juridike kjo do thotë se "një normë i përket një rendi të caktuar juridik vetëm për shkak dhe derisa është në përputhje me një normë më të lartë juridike, e cila përcakton krijimin e saj".[24]

---

[22] Shih nenin 113 të Kushtetutës. Kushtetuta u miratua më 9 prill 2008 dhe është e arritshme në http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Default.aspx. Më tepër, për Kushtetutën e Kosovës, shih: Tunheim, John. "Rule of law and the Kosovo constitution". *Minn. J. Int'l L.* 18 (2009): 371; Marko, Joseph. "The new Kosovo constitution in a regional comparative perspective". *Review of Central and East European Law* 33.4 (2008): 437-450.Weller, Marc. "The Vienna negotiations on the final status for Kosovo".*International Affairs* 84.4 (2008): 659-681.

[23] Kelsen, Hans, Pure Theory of Law (Law Book Exchange, 2003) f.267.

[24] Ibid f. 267. Për më tepër rreth punimeve të Hans Kelsen dhe toeirsë së tij rreth kontrollit kushtetues shih Kelsen, Hans. *General theory of law and state*. Vol. 1. The Lawbook Exchange, Ltd., 1945; Ferejohn, John E. "Constitutional review in the global context". *NYUJ Legis. & Pub. Pol'y* 6 (2002): 49.Stone Sweet, Alec. "Constitutional Courts and Parliamentary Democracy (Special Issue on Delegation)". *West European Politics* 25 (2002): 77-100.Jabloner, Clemens. "Kelsen and his circle: The Viennese years". *European Journal of International Law* 9.2 (1998): 368-385.Pasquino, Pasquale. "Constitutional adjudication and democracy. Comparative perspectives: USA, France, Italy". *Ratio Juris* 11.1 (1998): 38-50.

Për sa i takon Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Punës[25], e cila është miratuar nga vetë gjyqtarët e saj, plotëson dispozitat përkatëse të Ligjit dhe rregullon më tej organizimin e Gjykatës, procedurat dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e saj. Siç u përmend më lart, Kushtetuta përcakton vetëm parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës për çështjet që lidhen me: (a) juridiksionin dhe palët e autorizuara; (b) përbërjen dhe mandatin e Gjykatës; (c) organizimin e Gjykatës; (d) efektin juridik të vendimeve të Gjykatës; dhe (e) imunitetin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Në fakt, përcaktimi i kufirit në mes të asaj që duhet të mbetet në Kushtetutë dhe çfarë duhet të rregullohen më tej me ligj apo me akt nënligjor, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të bëhet në mënyrë të qartë. Në të vërtetë, kjo ishte një nga dilemat e anëtarëve të Grupit Punues për hartimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtutjeshëm: "Grupi Punues"), që u shfaq gjatë procesit të hartimit të Ligjit. Grupi Punues vendosi të mos përsëriste dispozitat kushtetuese në tekstin e Ligjit, duke u pajtuar që ligji duhet të trajtojë vetëm ato çështje të cilat kërkojnë rregullim të mëtejmë ligjor, ose kur një dispozitë kushtetuese, për shkak të gjuhës së përgjithësuar, shtron nevojën e rregullimit të mëtejmë përmes legjislacionit primar. Kjo hetohet qartë në tekstin e nenit 1.1 të Ligjit dhe nga struktura e vetë ligjit me të cilin janë rregulluar vetëm çështjet për të cilat është dhënë një autorizim shprehimor kushtetues, siç përcaktohet me Kushtetutë.[26]

Nga çështjet, me të cilat u përballën anëtarët e Grupit Punues gjatë hartimit të këtij Ligji, ishte çështja e fushëveprimit të ligjit. Me fjalë të tjera, parë nga një këndvështrim rregullues ligjor, nuk duket të ketë ndonjë standard ose parametër të qartë për të përcaktuar nëse ligji duhet të jetë një ligj minimalist apo gjithëpërfshirës. Kjo fiton rëndësinë e saj për shkak të faktit se, nëse ligji do të synojë rregullimin e kategorive të lartpërmendura me hollësi të madhe, kjo do të mund të siguronte një shkallë më të lartë të sigurisë juridike lidhur me aspektet organizative dhe funksionale të Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo, nga ana tjetër, një qasje e tillë mund të mos jetë zgjidhja më pragmatike për shkak të faktit se ajo mund të pengojë Gjykatën Kushtetuese për të përshtatur rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj në bazë të rrethanave specifike të saj. Grupi Punues hodhi poshtë idenë për të pajisur Gjykatën Kushtetuese me juridiksionin shtesë për atë që tashmë është dhënë në nenin 113 të Kushtetutës, për të shmangur një situatë në të cilën Gjykata Kushtetuese, e themeluar rishtazi, do të përballej me një numër shpërthyes të rasteve në periudhën fillestare të veprimit të saj.

Neni 1 i Ligjit nuk vendos shprehimisht një rregull thelbësor, po thjesht adreson qëllimin e ligjit. Gjuha e nenit 1 është e gjerë, duke mos u kufizuar në kategoritë që janë objekt i rregullimit ligjor nga ana e Ligjit. Kjo konfirmon supozimin se hartuesit nuk kanë pasur qëllim për të kufizuar fushën e veprimit të ligjit duke numëruar kategoritë që do të rregullohen më tej me Ligj. Megjithatë, një qasje më koherente në kuptim të hartimit juridik, do të ishte nëse në nenin 1 do të numëroheshin të gjitha

[25] Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese 126-3/2013 është miratuar nga Gjykata Kushtetuese më 21 qershor 2013 dhe mund të shkarkohet nga: http://www.gjk-ks.org.

[26] Grupi Punues për themelimin e Gjykatës Kushtetuese ishte përgjegjës për të përgatitur kuadrin ligjor të nevojshëm për funksionimin e Gjykatës; buxhetin e Gjykatës për periudhën 2009-2011; për të përcaktuar strukturën fillestare organizative të Gjykatës Kushtetuese. Më shumë mbi përbërjen e Grupit Punues për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të parë, shih: http://www.gjk-ks.org/?cid=2, 2.

kategoritë, të cilat do të ishin objekt i rregullimit ligjor nga ana e ligjit, për shembull, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e tyre ligjore. Një qasje e tillë do të kishte siguruar më shumë konsistencë në zbatimin e ligjit dhe do ta kishte udhëzuar lexuesin më lehtë nëpër të gjitha çështjet që i rregullon Ligji.
Rregullimi i mëtejmë i organizimit të brendshëm dhe kompetencave të gjykatave kushtetuese përmes ligjit, është tipik për vendet evropiane dhe më gjerë. Për shembull, Ligji për Organizimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në nenin 1 të tij, përcakton: "Ky ligj parashikon rregulla për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, statusin e anëtarëve të saj, paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave, parimet dhe rregullat e shqyrtimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre ".[27]
Ngjashëm me të, Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë përcakton: "Ligji rregullon kushtet dhe procedurat për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë dhe mbarimin e mandatit të tyre, kushtet dhe afatet për vënien në lëvizje të procedurave për shqyrtimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, procedurat dhe efektet juridike të vendimeve të saj, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe çështje të tjera të rëndësishme për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të Gjykatës Kushtetuese".[28]
Megjithëkëtë, ka shembuj të tjerë, të cilët tregojnë se ligjet e gjykatave kushtetuese mund të mos përmbajnë një dispozitë ligjore për të caktuar kufijtë, qëllimin dhe/ose qëllimin e ligjit duke proceduar drejtpërdrejt me rregullimin ligjor. Të tilla janë, për shembull, Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës Federale të Gjermanisë,[29] Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë. Prandaj, në aspektin e hartimit ligjor, është çështje e zgjedhjes për sa i përket fushëveprimit të ligjit dhe përmasës në të cilën dispozitat e ligjit përcaktojnë kategoritë që janë objekt i rregullimit ligjor.

Neni 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese]

2.1 Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës se Kosovës ("Kushtetutën") dhe me ligj.
2.2 Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.

1 Parimi i pavarësisë organizative të Gjykatës është një parim kushtetues. Në bazë të nenit 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese], paragrafit 1 të Kushtetutës

[27] Shih Ligjin nr 8577, datë 10 shkurt 2000 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
[28] Teksti i konsoliduar i Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë përfshin Ligjin Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, botuar në "Narodne novine", Nr. 99/99 në shtator 29, 1999, dhe Ligjin Kushtetues për Rishikimin dhe Amendamentimin e Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, publikuar në "Narodne novine", No. 29/2002 mars 22, 2002.
[29] Shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese Federale të Gjermanisë, datë 12 mars 1951 (Ligji Federal Gazeta I f. 243), botuar më 11 gusht 1993 (Ligji Federal Gazeta I p. 1473), ndryshuar me Ligjin e datës 16 korrik 1998 (Ligji Federal Gazeta I p.1823).

"Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin". Neni 2.1 përcakton dy standarde të rëndësishme për të siguruar pavarësinë kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese: a)pavarësinë organizative e administrative dhe b) pavarësinë financiare. Për sa i takon pavarësisë organizative, neni 2.1 thekson në mënyrë të qartë se institucioni i Gjykatës Kushtetuese është autonom për sa i takon organizimit të brendshëm. Detajet e pavarësisë organizative dhe administrative të Gjykatës janë trajtuar në nenin 2.2, përmbajtja e të cilit ka derivuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 115.1 i Kushtetutës dhe nga Rregulla 15 paragr. 2 [Sekretariati] i Rregullores së Punës së Gjykatës.

Neni 2.1 i Ligjit përcakton standardin se Gjykata duhet të kryejë shërbimet e saj administrative në mënyrën më të pavarur të mundshme, në lidhje me personelin, marrjen e pajisjeve dhe furnizimeve për të mirëmbajtur ndërtesën e Gjykatës, dhe vendin në të cilin edhe ofrohet drejtësia kushtetuese. Rregullorja e punës, e miratuar nga gjyqtarët,[30] ofron detaje të mëtejme, duke u dhënë efekt konkret kërkesave të këtij parimi, i cili është thelbësor për pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese.

Siç ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në Vendimin e saj nr. 19, datë 3.5.2007: *"...pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre (organeve kushtetuese) që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, e*tj.".[31]

2 Pavarësia organizative dhe administrative është përcaktuar fuqishëm në Kushtetutë dhe në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, që synon të sigurojë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në lidhje me aspektet e brendshme administrative e organizative dhe respekton standardet e përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj.[32] Kjo nënkupton se asnjë organ a institucion tjetër shtetëror nuk mund të ndërhyjë në trajtimin e çështjeve që përbëjnë objektin e organizimit dhe veprimtarisë së Gjykatës. Pavarësia organizative konsiston së pari në miratimin e strukturës së brendshme të Gjykatës Kushtetuese (në formë të një organogrami) në mënyrë të pavarur. Siç thekson Steinberger, duke komentuar në librin e tij në lidhje me modelet e juridiksionit kushtetues, "detajet teknike dhe administrative të punës së Gjykatës duhet t'i nënshtrohen një përcaktimi të pavarur nga Gjykata Kushtetuese, duke mos

[30] Gjykata miratoi Rregulloren e punës më 12 dhjetor 2012, tashmë e ndryshuar më 17 qershor 2013. Rregullorja e punës mund të gjendet në http://gjk-ks.org/?cid=2, 37.

[31] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 19/2007, datë 03.05.2007. Http://www.gjk.gov.al. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. 3 maj 2007.

[32] Shih Mark Miller, Judicial independence and judicial accountability: searching for the right balance: when congress attacks the federal courts. 56 Case Western Reserve Law Review, 1015 (2006); Vicki C. Jackson Fair and Independent Courts: A Conference on the State of the Judiciary: Packages of Judicial Independence: The Selection and Tenure of Article III Judges 95 Georgetown Law Journal. 965 (2007).

lejuar udhëzime të jashtme".[33] Për të forcuar pavarësinë administrative në gjykata kushtetuese, Steinberger argumenton se stafi administrativ, që kryen detyra administrative, duhet të jetë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht të kryetarit të Gjykatës.[34]
Neni 2 i Ligjit plotësohet me Rregullat 14 [Seancat Administrative], 15 [Sekretariati], paragrafi 2, 16 [Sekretari i Përgjithshëm] dhe 17 [Personeli i Sekretariatit] të Rregullores së Punës.

Rregulli 1 [Dispozitat e përgjithshme]

Kjo Rregullore e punës plotëson dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për organizimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të procedurave para Gjykatës dhe të çështjeve të tjera përkitazi me funksionimin e Gjykatës.

Qëllimi i Rregullores së Punës është për të plotësuar dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese për çështje organizative. Është e rëndësishme të theksohet se Kushtetuta i ka dhënë asaj bazën kushtetuese për miratimin e Rregullores së Punës në pajtim me nenin 115 të Kushtetutës, i cili thotë: "Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative, në pajtim me ligjin". Janë dy aspekte që meritojnë koment në këtë drejtim. Së pari, Kushtetuta e ka autorizuar Gjykatën Kushtetuese për të përcaktuar organizimin e saj të brendshëm dhe rregullat e procedurës në pajtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Së dyti, neni 115 i Kushtetutës, siç thuhet qartë në Rregullën 1 të Rregullores së Punës, nënkupton se Gjykata Kushtetuese mund të rregullojë funksionimin e saj të brendshëm dhe zhvillimin e procedurave vetëm në kuadër të çështjeve që kanë mbetur për t'u rregulluar nga Gjykata dhe, përderisa një rregullim i tillë është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Ligji për Gjykatën Kushtetuese ka përcaktuar zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me aspektet organizative të Gjykatës Kushtetuese tek një numër i neneve, si për shembull në nenin 3 (Selia dhe simbolet), neni 10 (detyrat e gjyqtarit), neni 12, paragrafi 3 (Sekretariati), neni 13 (Këshilltarët Ligjorë).

Rregulli 14 [Seancat administrative]

14.1 Gjyqtarët takohen në seanca administrative për të diskutuar dhe për të vendosur për çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës. Kur është e nevojshme, nën udhëheqjen e Kryetarit, Sekretariati harton propozimet e politikave për shqyrtim dhe për miratim nga Gjykata.

14.2 Seancat administrative të Gjykatës thirren nga Kryetari, i cili kryeson takimet. Gjykata takohet në seanca administrative së paku dy herë në vit,

[33] Helmut Steinberger, "Models of Constitutional Jurisdiction", Science and Technique of Democracy, No. 2, Strasbourg (1993). f. 44.
[34] Ibid. p. 44

ose në bazë të kërkesës me shkrim të bërë nga ndonjëri gjyqtar ose nga Sekretariati.

14.3 Çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës, përfshijnë, por nuk janë të kufizuara:

(a) buxhetin e Gjykatës;
(b) personelin;
(c) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objektit;
(d) bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
(e) gjobat për shkeljet e bëra gjatë procedurës;
(f) organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Gjykatës;
(g) statusin dhe çështjet kontraktuese që përfshijnë Sekretariatin dhe këshilltarët juridikë;
(h) kushtet e punësimit, orarin e punës, kompensimin dhe Kodin e etikës për stafin administrativ të Sekretariatit; dhe
(i) miratimin e raportit vjetor.

14.4 Në seanca administrative vendimet merren me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që të jenë të pranishëm të paktën pesë (5) gjyqtarë.

Ky rregull u mundëson gjyqtarëve që të trajtojnë dhe të vendosin për çështje të politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës në seancë administrative, ku, ndryshe nga në një seancë gjyqësore, gjyqtarët vendosin për çështje thjesht administrative, shembuj të të cilave janë përmendur në Rregullën 14.3, 15 [Sekretariati], 16 [Sekretari i Përgjithshëm], 17 [Personeli i Sekretariatit], 18 [Këshilltarët Ligjorë] dhe 20 [Buxheti dhe tarifat], të cilat do të komentohen më poshtë. Duhet theksuar se edhe gjykatat e rregullta mbajnë seanca administrative për çështje të ngjashme, siç është përmendur në Rregullin e mësipërm. Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës përcakton ngritjen e komisionit administrativ në çdo gjykatë themelore (të përbërë nga Kryetari i Gjykatës Themelore dhe Gjyqtari mbikëqyrës të secilës prej degëve të saj) për të vlerësuar punën e gjykatës, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve administrative dhe të punëve në gjykatë.[35] Administratori i Gjykatës Themelore në takimet e Komisionit Menaxhues merr rolin e sekretarit.

As Rregulla 14.1 dhe as ndonjë rregull tjetër nuk përcakton mënyrën në të cilën do të regjistrohen, të përmblidhen ose të raportohen diskutimet dhe vendimet e gjyqtarëve në seancat administrative, prandaj, në mungesë të ndonjë dispozite të veçantë për këtë qëllim, pa dyshim, mund të respektohen rregullat përkatëse të ndjekura nga gjykatat e rregullta. Rregullorja, më tutje, specifikon se Sekretariati është gjithashtu kompetent për të ofruar shërbime administrative, teknike dhe shërbime të tjera mbështetëse për Gjykatën, të cilat mund të përfshijnë shërbime lidhur me regjistrimin e procesverbaleve të mbledhjes. Mbledhjet administrative janë formale dhe, për këtë arsye, të dhënat me shkrim rreth diskutimeve që janë zhvilluar në mbledhje, duhet të mbahen me kujdes. Procesverbali i mbledhjeve administrative nuk është vetëm një mjet efektiv për të regjistruar diskutimet ose vendimet e marra në takim, por edhe për të shqyrtuar procesverbalin e regjistruar në mbledhjen e ardhshme administrative për saktësinë e tij dhe për të përcjellë çështjet administrative që diskutohen. Procesverbalet e mbledhjeve

[35] Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 32. Ligji është i arritshëm në http://gzk.rks-gov.net/.

mund të nënshkruhen nga Kryetari i Gjykatës dhe Sekretari i Gjykatës brenda një kohe të arsyeshme, dhe ato mund të mbahen në formë të shkruar dhe elektronike.

Sipas Rregullit, në seancat administrative, gjyqtarët diskutojnë çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës dhe vendosin nëse do të ngarkojnë Sekretariatin për hartimin e disa propozimeve të politikave. Kur shihet e nevojshme nga ana e gjyqtarëve, Sekretariati do ta bëjë këtë "nën drejtimin e Kryetarit", në mënyrë që të sigurohet që Sekretariati përgatit një projektpropozim i cili pasqyron vendimin e gjyqtarëve. Më pas, projekti shqyrtohet dhe miratohet nga ana e gjyqtarëve. Paragrafi 3 i këtij Rregulli, që do të komentohet më pas, përmban një numër të caktuar çështjesh të politikave, të cilat duhet të adresohen nga ana e gjyqtarëve, edhe pse lista nuk është përfundimtare.

Nuk është ndonjë befasi fakti se që nga themelimi i Gjykatës në shtator të vitit 2009, Kryetari i Gjykatës ka thirrur mbledhje administrative në intervale të rregullta, me nismën e tij, me iniciativën e gjyqtarit ose të Sekretariatit. Shumë çështje të politikave në lidhje me administrimin e Gjykatës është dashur të diskutohen e të zhvillohen, veçanërisht, për shkak se Gjykata dhe Sekretariati i saj duhej të ndërtoheshin nga e para. Ishte vetëm një Sekretariat i Përkohshëm para se Gjykata dhe Sekretariati të bëheshin funksional, funksioni i të cilit ishte vetëm për të regjistruar referime dhe për të mbikëqyrë renovimin e objektit të ardhshëm të Gjykatës.[36]

Që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese, Sekretariati ka hartuar propozime të politikave, duke filluar nga buxheti vjetor i Gjykatës deri tek çështje të tjera për funksionimin e duhur dhe organizimin e brendshëm. Gjykata ka miratuar edhe Kodin e Sjelljes për stafin e Gjykatës[37], ndërsa propozimet për zhvillimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar kanë prodhuar një bashkëpunim të shkëlqyer me Gjykatën Supreme të Kosovës, si dhe me Gjykatat Kushtetuese dhe me institucionet e larta gjyqësore, ndër të tjera, të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Estonisë, Francës, Gjermanisë, Hungarisë, Irlandës, Izraelit, Italisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Holandës, Portugalisë, Sllovenisë, Suedisë dhe Turqisë.

Për më tepër, Gjykata ka miratuar një rregullore për njësinë e saj ligjore për të siguruar një bashkëpunim më të mirë ndërmjet gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë, në njërën anë, dhe në mes Departamentit të Regjistrimit të Rasteve, Statistikave dhe Arkivit (DRRSA) dhe këshilltarëve ligjorë, nga ana tjetër. Për sa i takon buxhetit dhe godinës së Gjykatës, është interesante të theksohet se në vitin 2010 Gjykata ka përdorur një pjesë të buxhetit të saj për ndërtimin e një ashensori për t'u mundësuarur personave me handikap fizik që të kenë qasje të lehtë në sallën e seancave gjyqësore në raste të dëgjimeve publike. [38]

Duke filluar me raportin e parë vjetor për vitin 2009, raportet vjetore tashmë janë botuar edhe për vitet 2010, 2011 dhe 2012.[39] Këto raporte botohen në të tri gjuhët që përdoren në Gjykatë (shqipe, serbe dhe angleze) dhe theksojnë jo vetëm vizionin dhe misionin e Gjykatës, por theksojnë edhe aktivitetet dhe të arriturat gjatë vitit në fjalë, si

[36] Shih nenin 57 të ligjit [Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese], që diskutohet në tekstin e mëposhtëm.

[37] Kodi i Sjelljes dhe çështje të tjera të politikës në lidhje me administrimin e gjykatës mund të gjenden në faqen e internetit të Gjykatës në http://gjk-ks.org.

[38] Mobiliet në sallën e gjyqit dhe pajisjet u dhuruar nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë.

[39] Raportet vjetore mund të shkarkohen në faqen e internetit të Gjykatës ose mund të merren si kopje fizike në Gjykatën Kushtetuese.

dhe ndihmën dhe mbështetjen dhënë Gjykatës nga organizata dhe donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë.[40] Qëllimi i raporteve vjetore është për të reflektuar transparencën dhe hapjen e Gjykatës për publikun e gjerë në lidhje me organizimin, funksionimin dhe shpenzimet e Gjykatës.

Me një kuorum prej shtatë gjyqtarëve, votat e katër gjyqtarëve mund të përcaktojnë nëse një propozim miratohet apo refuzohet. Se çfarë procesi të vendimmarrjes do të kemi në rast të votave të barabarta, kur tetë gjyqtarë janë të pranishëm dhe votojnë, nuk është e qartë. Të paktën, ky Rregull nuk parasheh ndonjë zgjidhje.

Kërkesa e pavarësisë organizative dhe administrative të Gjykatës është përforcuar me Rregullën 15.2, që zbërthen të drejtën e gjyqtarëve sipas Rregullit të mësipërm 14.3 (f) për të përcaktuar strukturën organizative të Sekretariatit duke miratuar, në seancë administrative, një propozim me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm për këtë qëllim.[41] Ky Rregull më tej parasheh që Sekretari i Përgjithshëm, me miratimin e gjyqtarëve, mund "të krijojë apo të shuajë departamente, seksione ose njësi si të nevojshme për ushtrimin efektiv dhe efikas të funksioneve dhe përgjegjësive të Sekretariatit".[42] Është logjike se miratimi i gjyqtarëve duhet të kërkohet edhe një herë në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm dëshiron të ndryshojë strukturën organizative të Sekretariatit të miratuar më parë nga ana e gjyqtarëve. Ndryshimet e propozuara mund të diktohen nga nevoja për krijimin ose shuarjen e departamenteve administrative, seksioneve ose njësive, në mënyrë të veçantë kur këto ndryshime janë të rëndësishme për përmirësimin e ushtrimin efikas dhe efektiv të funksioneve të Sekretariatit. Supozohet se, kur Sekretariati i Gjykatës harton propozimet e politikave sipas udhëzimeve të Kryetarit, ky i fundit mund të këshillohet fillimisht me gjyqtarët në lidhje me orientimet që duhen dhënë. Për më tepër, gjyqtarët mund të hartojnë edhe vetë, në qoftë se i konsiderojnë të arsyeshme, propozime politikëbërëse, të cilat më pas i nënshtrohen miratimit nga të gjithë gjyqtarët në seancë administrative, që kryesohet nga Kryetari.

Siç përcaktohet me këtë Rregull, lista e çështjeve të politikave (policy matters) të përmendura nuk është përfundimtare. Në përgjithësi, përveç çështjeve të listuara, çdo çështje në lidhje me Gjykatën, pa përjashtim, mund të diskutohet nga gjyqtarët në seancë administrative, kur një çështje e tillë përfshihet në rendin e ditës me kërkesën e një ose më shumë gjyqtarëve, të Sekretarit të Përgjithshëm ose me urdhër të Kryetarit. Për të lehtësuar diskutimin mbi çdo çështje të politikave të propozuara, Sekretariati, apo ndoshta një ose më shumë gjyqtarë, do të përgatisin një propozim të politikave për seancën në fjalë.

Siç është përcaktuar me Rregullën 14.3, lista e çështjeve të politikave të përmendura nuk është përfundimtare. Në përgjithësi, përveç çështjeve të listuara, çdo çështje në lidhje me Gjykatën, pa përjashtim, do të mund të diskutohet nga gjyqtarët në seancë administrative, kur të përfshihet në rendin e ditës me kërkesën e një ose më shumë gjyqtarëve, të Sekretarit të Përgjithshëm ose me urdhër të Kryetarit. Për të lehtësuar diskutimin mbi çdo çështje të politikës, si të drejtuara nga Kryetari, Sekretariati, apo

[40] East-West Management Institute (EWMI), Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID), Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO), Projekti i Reformës Juridike (GIZ) të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Fondacioni gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (Fondacioni IRZ).

[41] Rregulli 15.2. Rregullorja e Punës.

[42] Rregulli 15.2. Rregullorja e Punës.

ndoshta një ose më shumë gjyqtarë, do të përgatisin një propozim të politikës për seancën në fjalë.

Kërkesa ligjore për pavarësinë organizative dhe administrative të Gjykatës Kushtetuese është marrë parasysh edhe nga vetë Ligji për Administratën Shtetërore, i cili ndër, të tjera, përcakton se rregullat në lidhje me organizimin, bashkëpunimin dhe menaxhimin e organeve shtetërore [të cilat ushtrojnë pushtet ekzekutiv] nuk janë të zbatueshme për administrimin e Gjykatës Kushtetuese.[43] Ligji për Administratën Shtetërore thekson qartë se menaxhimi i brendshëm i administrimit të Gjykatës Kushtetuese është një çështje për të cilën vendos vetë Gjykata, një standard juridik që nuk mund të pakësohet.

Çdo formë e varësisë administrative në ekzekutivin apo legjislativin lidhur me funksionimin e Gjykatës, mund të ketë një ndikim të dëmshëm në aftësinë e Gjykatës për të siguruar një standard të lartë të drejtësisë kushtetuese. Legjislacioni horizontal i kushton vëmendje të veçantë edhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Gjykatën Kushtetuese. Ligji për Shërbimin Civil në Kosovë në nenin 3.7 parashikon se "zbatimi i këtij ligji do të respektojë pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese nga dega ekzekutive".[44]

Metoda kushtetuese me të cilën miratohet buxheti i Gjykatës Kushtetuese, është një barometër i rëndësishëm për të matur shkallën e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese. Siç thekson raporti i Komisionit të Venecias[45] [për Buxhetin e Gjykatës Kushtetuese: Kontrolli dhe Menaxhimi], "nëse... Konventa Evropiane, për shembull, u siguron të gjithëve të drejtën e mbrojtjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, atëherë pa një personel administrativ të mjaftueshëm dhe të kualifikuar asnjë gjyqtar nuk mund të plotësojë këto kërkesa".[46]

Sa më tepër pronësi të ketë Gjykata Kushtetuese në përcaktimin e buxhetit dhe menaxhimin e tij, aq më i pavarur do të jetë ky mekanizëm në procesin e mbrojtjes kushtetuese. Pavarësia financiare e Gjykatës Kushtetuese është një standard i njohur evropian, i cili mundëson që Gjykata të ushtrojë funksionin e mbrojtjes së kushtetutshmërisë në mënyrë të pavarur dhe, për këtë arsye, është përcaktuar në ligjet nacionale në lidhje me organizimin e gjykatave kushtetuese. Siç përmend Steinberger në studimin e tij rreth modeleve të juridiksionit kushtetues, "është Gjykata Kushtetuese e cila duhet të ndërtojë planin e buxhetit të saj, së bashku me parlamentin që vendos zyrtarisht për miratimin e tij, por mbi një detyrim të përgjithshëm që të pajtohet me vlerësimin e Gjykatës rreth shpenzimeve". Gjykata Kushtetuese duhet të ketë të drejtë për të administruar buxhetin e vet në mënyrë të pavarur nga legjislativi.[47]

Për shembull, sipas nenit 1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë, të datës 12 mars 1951, Gjykata Kushtetuese gëzon një autonomi dhe pozicion më të pavarur kushtetues në krahasim me organet tjera kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk i nënshtrohet financiarisht asnjë ministrie, por konsiderohet një organ i pavarur dhe

---

[43] Shih Ligji nr 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës. Ligji është botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës në http://www.gazetazyrtare.com/.

[44] Ligji nr 03/L-149 për Shërbimin Civil. Ligji është botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës në http://www.gazetazyrtare.com/

[45] Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit të Këshillit të Evropës.

[46] Varvarovsky, Pavel.The Budget of the Constitutional Court: Control and Management". Prezantimi në punëtorinë e Komisionit të Venecias të mbajtur në Kiev, Ukrainë, 19-21 janar 1998.

[47] Steinberger Helmut. Models of constitutional jurisdiction. No. 2. Council of Europe, 1993. f.44.

menaxhues buxhetor. Buxheti i Gjykatës mund të miratohet vetëm si një plan i veçantë autonom për t'u përfshirë në buxhetin shtetëror, sa kohë që Gjykata mund të menaxhojë fondet buxhetore në mënyrë të pavarur. Buxheti diskutohet dhe miratohet në seancën plenare të Gjykatës (neni 1.2 i Rregullores se Punës së Gjykatës Kushtetuese Gjermane, datë 2 shtator 1975, e ndryshuar), me përfshirjen e një Këshilli të veçantë buxhetor (neni 3.1.c i Rregullores së Punës).

Në Kroaci Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton se Gjykata Kushtetuese ka buxhetin e saj, i cili miratohet si pjesë e veçantë e buxhetit shtetëror nga përfaqësuesit e Parlamentit, sipas propozimit të Gjykatës Kushtetuese.[48]

Së këndejmi, mënyra në të cilën buxheti i gjykatës kushtetuese miratohet, ka një ndikim të qartë për pavarësinë e saj. Siç argumenton Profesor Steinberger, "duhet të ketë sa më pak ndikim në gjykatë nga pushtetet buxhetore të parlamentit, e edhe më pak nga ekzekutivi", në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë në gjendje të gjykojë në mënyrë të pavarur.[49]. Gjykatat e kushtetuese duhet të kenë të drejtë jo vetëm për të hartuar planet buxhetore dhe për ta dorëzuar atë në mënyrë të drejtpërdrejtë në parlament, por duhet të kenë të drejtë edhe për ta administruar buxhetin e caktuar në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi apo legjislativi. Administrimi i buxhetit të Gjykatës duhet të rregullohet në mënyrë të pavarur nga Gjykata, në pajtim me Ligjin për Buxhet, dhe t'u nënshtrohet procedurave të nevojshme të auditimit. Ky aspekt është marrë në konsideratë nga hartuesit e Ligjit, për të siguruar që standardet e Komisionit të Venecias për pavarësinë e gjyqësorit, të respektohen në mënyrë të plotë. Ky është një faktor i nevojshëm jo vetëm për ruajtjen e fuqisë së Gjykatës Kushtetuese në strukturat e reja të shtetit të Kosovës, por edhe për të siguruar që organet shtetërore në të gjitha nivelet të qeverisen nga sundimi i së drejtës. Sipas kornizës ligjore, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gëzon pronësi të madhe në procesin e hartimit të buxhetit dhe në miratimin e buxhetit të saj nga ana e Kuvendit. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ka përcaktuar se Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe propozimin e tillë ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë ta ndryshojë ose, në çfarëdo mënyre tjetër, ta modifikojë apo të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Buxheti i propozuar nga Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.[50] Një pamje më e gjerë lidhur me rëndësinë e administrimit të pavarur të buxhetit, si pjesë e buxhetit shtetëror të Gjykatës Kushtetuese, do të ofrohet në pjesën e Komentarit lidhur me nenin 14 të Ligjit.

[48] Narodne novine, No. 13/1991, me amendamente.

[49] Steinberger Helmut. Models of constitutional jurisdiction. No. 2. Council of Europe, 1993. f.44.

[50] Shih Mavcic, Arne. *The budget of the constitutional court, control and management with respect to the independence and autonomy of the court*. Një studim i prezantuar në seminarin e organizuar nga Komisioni i Venecias në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës, Sarajevë, 14-15 tetor 2004, në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL- JU (2004) 066prog-e.asp.

Neni 3 [Selia dhe simbolet]

3.1 Selia e Gjykatës Kushtetuese është në Prishtinë.
3.2 Gjykata Kushtetuese zhvillon seancat në selinë e saj, por përjashtimisht, me vendimin e saj mund të zhvillojë seanca edhe në vendet tjera të Republikës së Kosovës.
3.3 Gjykata Kushtetuese ka simbolin dhe vulën e vet, të cilat përcaktohen me rregullore të punës.

Ligji përcakton se selia e Gjykatës Kushtetuese ndodhet në Prishtinë, e cila, në kuptim të Nenit 13 të Kushtetutës, është kryeqyteti i Republikës së Kosovës. Mund të thuhet se në shumë shtete evropiane selitë e gjykatave kushtetuese ndodhen në kryeqytete, me disa përjashtime, siç është rasti me selinë e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, që ndodhet në Karlsruhe.[51] Duhet të theksohet gjithashtu se Prishtina është edhe selia zyrtare e Gjykatës Supreme të Kosovës, si instancë e fundit në kuadër të sistemit të rregullt gjyqësor të Kosovës.[52]
Përjashtimi i mbajtjes së seancave gjyqësore kushtetuese jashtë selisë zyrtare është dhënë në mënyrë të qartë në Nenin 3 (2) të Ligjit, që pasqyron qëllimin e legjislaturës, për t'i mundësuar Gjykatës Kushtetuese të mbajë seanca gjyqësore jashtë selisë së Gjykatës në rrethana të veçanta. Megjithatë, as Ligji dhe as Rregullorja e Punës nuk specifikojnë situatat në të cilat mund të bëhet një shmangje nga rregulli i përgjithshëm, me përjashtim të faktit që mbajtja e seancave jashtë selisë së Gjykatës mund të bëhet vetëm për arsye të veçanta, siç vendoset nga gjyqtarët e Gjykatës.
Meqenëse Ligji nuk përfshin përkufizimet e disa prej fjalëve kyçe, pa dyshim, do të ketë raste dhe shprehje të tilla si "arsye të veçanta", të cilat mund të kërkojnë interpretim ligjor. Në këtë kontekst, gjyqtarët e Gjykatës do të ndjekin me siguri rregullat e përgjithshme të interpretimit, të tilla se interpretimi do të ofrohet në "mirëbesim" në pajtim me kuptimin e zakonshëm që jepet sipas frymës së ligjit dhe në kontekst të objektit dhe qëllimit të tij. Gjykata Kushtetuese mund të përdorë edhe instrumente plotësuese të interpretimit, të tilla si *travaux préparatoires* të Ligjit, duke përfshirë procesverbalin e seancave formale dhe draftet e mëparshme të tekstit.
Mbajtja e seancave dëgjimore të Gjykatës në gjykatoren e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës më 2009, paraqet një shembull të tillë. Duhet theksuar se praktika na sjell edhe shembuj të tjerë të ligjeve për gjykatat kushtetuese, të cilat lejojnë mundësinë e mbajtjes së seancave të gjykatës kushtetuese jashtë selisë së saj. Kështu, për shembull, sipas Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë "edhe pse selia e Gjykatës Kushtetuese do të jetë në Zagreb..., Gjykata Kushtetuese mund të mbajë sesione të saj në vende të tjera të Republikës së Kroacisë, nëse për këtë vendosin shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese".[53] Sipas Rregullores së Punës

[51] Për më shumë mbi Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë, shih Kommers, Donald P., and Russell A. Miller. The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany: Revised and Expanded. Duke University Press, 2012; Landfried, Christine. "Judicial policy-making in Germany: The federal constitutional court". West European Politics 15.3 (1992): 50-67; Kommers, Donald P. "The federal constitutional court in the German political system". Comparative Political Studies 26.4 (1994): 470-491.
[52] Shih Ligjin për Gjykatat Nr. 03/L-199, neni 21. Ligji mund të kërkohet në http://gzk.rks-gov.net/.
[53] Shih Rregullat e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë,mund të kërkohen në http://www.usud.hr/default.aspx?Show=poslovnik_ustavnog_suda&m1=27&m2=53&Lang=en

së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës "seancat e Gjykatës Kushtetuese duhet, si rregull, të mbahen në selinë e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të mbajë sesione të saj jashtë selisë".[54]

Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar simbolin e saj më 10 tetor 2010. Simboli i Gjykatës përbëhet nga Zonja e Drejtësisë (Latinisht: Justitia) perëndesha romake e drejtësisë, si një personifikim i forcës morale të sistemit gjyqësor, në kombinim me ngjyrat bardhë, blu dhe e artë. Për më tepër, Zonja e Drejtësisë paraqitet me sy të lidhur, që do të thotë që gjykimi dhe paanshmëria e saj nuk mund të ndikohen, dhe gjithashtu ajo mban një shpatë, e cila në traditën romake është simbol i pushtetit dhe autoritetit.[55]

Janë me rëndësi të përmenden gjithashtu edhe shembuj të tjerë të simboleve të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo në çdo situatë simboli i gjykatës përcjell një mesazh të fortë për rëndësinë e ruajtjes së supremacisë së Kushtetutës dhe shpreh domosdoshmërinë për të siguruar parimin e "sundimit të ligjit", si një atribut thelbësor i demokracisë kushtetuese.

Është interesant të përmendim simbolin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut. Si një Gjykatë e themeluar në vitin 1994, pas miratimit të Kushtetutës demokratike, logoja e kësaj Gjykate bart disa porosi shumë të fuqishme kushtetuese. Për shembull, pema përfaqëson sistemin e drejtësisë, e cila, historikisht, në traditën afrikane, është zhvilluar në ambient të hapur nën një pemë. Për më tepër, kjo simbolizon transparencën dhe nënvizon faktin që çdo njeri që kalon pranë pemës mund të bashkohet në seancë dhe të marrë pjesë në procedurë duke shënuar në mënyrë simbolike parimin e qasjes për të gjithë. Porosia kushtetuese vazhdon me pjesën e vendosur në mes të pemës të fragmenteve të flamurit të Afrikës së Jugut, e cila simbolizon pronësisë qytetare mbi kushtetutën, të mbrojtur nga Gjykata Kushtetuese[56]

Praktikat e vendeve të tjera lidhur me përcaktimin juridik të simbolit të gjykatës kushtetuese janë të ndryshme. Për shembull, në Kroaci Gjykata Kushtetues është autoriteti që vendos për simbolin "forma, përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të të cilit" përcaktohet në mbledhje të veçantë të Gjykatës Kushtetuese.[57] Por në Shqipëri simboli i Gjykatës Kushtetuese është vendosur nga Kuvendi, mbështetur në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, ku në nenin 5 është përcaktuar që "në sallën e Gjykatës Kushtetuese vendosen Stema e Republikës së Shqipërisë, Flamuri Kombëtar dhe një pamje e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë". Duhet të theksohet, megjithatë, se në qoftë se parlamentet vendosin për përmbajtjen dhe formën e logos së Gjykatës Kushtetuese, atëherë mund të ndikohet në pavarësinë organizative të gjykatës kushtetuese, prandaj rezulton që vendimi për logon e Gjykatës Kushtetuese duhet të lihet të merret tërësisht nga vetë gjyqtarët, pasi një standard i tillë pasqyron me të vërtetë autonominë e Gjykatës, se çfarë mesazhi dëshiron Gjykata të përcjellë tek qytetarët dhe publiku në përgjithësi.

Simboli i Gjykatës duhet të reflektojë pronësinë e qytetarëve të Kosovës ndaj Kushtetutës dhe qasjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, në Gjykatën

[54] Shih Rregullat e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës, neni 50. http://www.ustavnisud.ba/.

[55] Për më tepër rreth definicionit "Justitia" shih http://www.lexexakt.de/glossar/justitia.php

[56] Për më shumë informacion në lidhje me krijimin e logos së Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut, shih http://www.constitutionalcourt.org.za/site/thecourt/thelogo.htm.

[57] Neni 3 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë në http://www.usud.hr.

Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka vendosur tashmë një standard kushtetues rreth simboleve për autoritetet e caktuara publike në Kosovë. Duke vendosur mbi një ankesë në lidhje me emblemën e Komunës së Prizrenit, Gjykata Kushtetuese, në vendimin që mori më datën 18 mars 2010 vinte në dukje që "*simbolet janë të lidhura ngushtë me nxitjen dhe ruajtjen e traditës, kulturës, karakteristikave dalluese të çdo populli dhe ato kanë ndikim në grumbullimin dhe bashkimin rreth një ideje dhe një besimi*".[58] Gjykata më tej shprehej se "*nuk ka kurrfarë dyshimi që simbolet përcjellin disa emocione dhe kuptime, të cilat përjetohen në mënyra të veçanta nga ata që gjejnë historinë, traditën dhe kulturën e tyre në atë simbol. Simbolet nuk janë fotografi apo dekorime të pastra, por secili përmban një kuptim të caktuar më të thellë dhe të fshehtë. Emblema përfaqëson në shumë mënyra arritjet, shpresën dhe idealet e të gjithë qytetarëve të një vendi apo të një rajoni të një vendi. Si e tillë, emblema duhet të ketë respekt për të gjithë qytetarët, siç është në rastin konkret për qytetarët e Komunës së Prizrenit si "një njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Për ta bërë të mundur që qytetarët e Prizrenit ta shohin dhe ta ndjejnë atë në këtë mënyrë, emblema e Komunës do te duhej të ishte simbol i gjithë qytetarëve*".[59]

Neni 3.3 i Ligjit plotësohet nga Rregulla 3 [Simboli dhe Vula e Gjykatës] të Rregullores së Punës (shih më poshtë).

Çështja e mbajtjes së seancave jashtë selisë zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shpjeguar në detaje më tej në Rregullën 2 [Selia e Gjykatës] të Rregullores së Punës.

Rregulli 2 [Selia e Gjykatës]

2.1 Selia e Gjykatës është në Prishtinë, ku Gjykata mban seancat dhe dëgjimet e veta. Gjykata mund të mbajë seanca dhe dëgjime edhe në vende të tjera të përshtatshme brenda Republikës së Kosovës.

2.2 Me kërkesë të Gjykatës, Sekretariati përgatit dhe i paraqet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Kryetari) listën e vendeve që janë të përshtatshme për mbajtjen e seancave dhe të dëgjimeve të Gjykatës.

2.3 Vendimi për mbajtjen e seancave jashtë selisë së Gjykatës merret me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: gjyqtarët), që janë të pranishëm dhe që votojnë. Gjykata merr parasysh pikëpamjet e palëve, para marrjes së vendimit.

Vendet e tilla të përshtatshme duhet të sigurojnë hapësira adekuate, që kanë infrastrukturë të përshtatshme teknike e fizike për të mundësuar mbajtjen e duhur të seancës gjyqësore në përputhje me standardet e gjykimit të drejtë, duke përfshirë qasjen për mediet, duke rezervuar një numër të mjaftueshëm vendesh për gazetarë, të cilët do të jepnin raporte prej seancave gjyqësore, që do të viheshin në dispozicion të publikut, të cilët nuk kanë mundësi të jenë të pranishëm.

Këto kushte janë theksuar edhe nga Rregulli 22 [Qasja në punën e Gjykatës] e Rregullores së Punës, e cila kërkon që puna e Gjykatës të jetë "e hapur për publikun

[58] Qemailj Kurtisi k. Kuvendi Komunal i Prizrenit KO 01/09. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 18 mars 2010. Http://gjk-ks.org /. Vizituar më 6 qershor 2014. para. 44.

[59] Ibid, para. 45

dhe me qasje në të deri në shkallën më të lartë të mundshme, në pajtim me Kushtetutën, në pajtim me Ligjin dhe me kriteret për ruajtjen e konfidencialitetit", duke përfshirë informimin e publikut në lidhje me datën dhe kohën e seancave dëgjimore dhe ofrimin e informacioneve lidhur me procedurat në fjalë.
Një listë e tillë e lokacioneve duhet të përmbajë informacionin e duhur rreth objekteve të parapara dhe një përshkrim mbi përshtatshmërinë e tyre për kryerjen e takimeve dhe seancave dëgjimore të Gjykatës. Lista duhet të përmbajë patjetër hollësi në lidhje me logjistikën e nevojshme për të akomoduar si duhet Gjykatën në këto mjedise, duke përfshirë marrjen e masave të përshtatshme të sigurisë, të cilat duhet të merren nga autoritetet kompetente lokale. Një aspekt i rëndësishëm i përshtatshmërisë së lokacioneve duhet të jetë siguria se paanshmëria e Gjykatës dhe pavarësia gjyqësore nuk do të cenohen dhe se e drejta për një proces të rregullt para Gjykatës Kushtetuese të palëve në procedurë, nuk do të zvogëlohet.
Termi "palët" me siguri do të thotë palët në procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën kohë, ato (palët) duhet të sigurohen se as të drejtat e tyre për një proces të drejtë dhe as paanshmëria e Gjykatës dhe pavarësia e gjyqësorit nuk do të ndikohen nga vendimi i gjyqtarëve që një procedurë të zhvillohet diku tjetër. Në rast se njëra palë ose të dy palët kanë vërejtje serioze ndaj synimit të Gjykatës për të zhvilluar takimin ose dëgjimin jashtë selisë së saj, supozohet se gjyqtarët do të marrin në konsideratë kundërshtimet e tilla me rastin e votimit për propozim.

Rregulla 3 [Simboli dhe vula e Gjykatës]

3.1 Simboli i Gjykatës vendoset nëpërmjet votimit nga shumica, e përbërë nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve.

3.2 Vula e Gjykatës përmban emblemën e Republikës së Kosovës, të rrethuar me mbishkrimin: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës - Ustavni sud Republike Kosova.

Sipas kësaj Rregulle, simboli i Gjykatës do të përcaktohet me vendim të 2/3 të të gjithë gjyqtarëve. Përderisa gjatë hartimit të nenit 3 (3) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk ka pasur mosmarrëveshje rreth së drejtës së Gjykatës për të disenjuar simbolin e saj, nuk ishte e qartë se me çfarë shumice duhej të merrej një vendim i Gjykatës Kushtetuese për të caktuar simbolin e Gjykatës. Edhe pse në atë kohë diskutohej propozimi se Gjykata duhej të vendoste me konsensus bazuar në idenë se simboli i Gjykatës duhet të reflektojë marrëveshje të gjerë në mes të gjykatësve kushtetues, zgjidhja e përcaktuar nga Rregullorja e Punës pasqyron marrëveshjen midis anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për të nxitur një dialog pozitiv midis tyre në hartimin simbolit të Gjykatës.
Vula e Gjykatës nënkupton autoritetin e Gjykatës dhe është detyrë e Sekretariatit për të siguruar se vula e Gjykatës mbahet në mënyrë të sigurt, kur nuk është në përdorim. Rregulla nuk jep detaje të tjera si, për shembull, për formatin e vulës ose për mënyrën si duhet të përdoret vula. Megjithatë, procedura lidhur me mënyrën si përdoret dhe mbahet një vulë e një institucioni publik, është e rregulluar me Ligjin për Vula në

Institucionet e Republikës së Kosovës.[60] Prandaj, mund të thuhet se vula e Gjykatës do të përdoret në përputhje me dispozitat e këtij ligji, respektivisht për të vërtetuar ose certifikuar aktet zyrtare dhe dokumentet e tjera të lëshuara nga Gjykata.

2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese

Neni 4 [Kushtet shtesë për emërimin e Gjyqtarëve]

4.1 Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë:

1.1. shtetas të Republikës së Kosovës;

1.2. juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale, veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, mes tjerash, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës univ ersitarë dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike;

1.3. individë me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale.

Duhet të përmendet se, në mungesë të një paragrafit të dytë, të ishte e mjaftueshme të përmendej neni si Neni 4 dhe jo si Neni 4.1.

Neni 114.1 i Kushtetutës përcakton kualifikimet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Aty theksohet se ata duhet të përmbushin tri kushte për të qenë kandidatë për pozitën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Së pari, kandidatët duhet të jenë shtetas të Kosovës. Së dyti, ata duhet të jenë juristë të dalluar dhe persona me karakterin më të lartë moral. Dhe, së treti, kandidatët duhet të kenë së paku dhjetë (10) vjet përvojë juridike përkatëse. Duke u mbështetur në nenin 114.1 të Kushtetutës, kualifikimet e tjera përkatëse për gjyqtarët e Gjykatës janë lënë të përcaktohen me ligj. Kualifikimet e tilla shtesë për emërimin e gjyqtarëve janë përcaktuar nga Kuvendi në nenin 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Kriteri i shtetësisë, që përmbahet në paragr. 1 të nenit 4 të Ligjit, përbën kusht të rëndësishëm juridik për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.[61] Rëndësia që i është dhënë këtij kriteri juridik, është reflektim i statusit të Gjykatës Kushtetuese në arkitekturën kushtetuese. Prandaj disa përgjegjësi juridike i atribuohen "shtetësisë" duke qenë një relacion juridik në mes individit dhe shtetit, së bashku me të drejtat dhe detyrimet. "Shtetësia" është kusht juridik edhe për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Neni 85 i Kushtetutës përcakton që "President i Republikës së Kosovës mund të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës...mbi moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare". Kjo vlen edhe për Avokatin e Popullit; në nenin 134 paragr. 2 përcaktohet se të drejtë zgjedhjeje gëzon secili "shtetas i Republikës së Kosovës..".

Për sa i përket përzgjedhjes së gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese, hartuesit e Kushtetutës u morën përsëri me çështjen e shtetësisë në nenin 152 [Përbërja e

[60] Ligji për Vula i Institucioneve të Republikës së Kosovës nr 03/L-054, i cili është në dispozicion në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

[61] Shih Ligjin për shtetësinë e Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008.

Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, që përcakton përbërjen e përkohshme të Gjykatës (ky nen është fshirë nga amendamenti kushtetues nr. 13 në vitin 2012).[62] Në bazë të nenit 152.4, "Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar [...]. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj". Në përputhje me këtë dispozitë, të tre gjyqtarët e zgjedhur janë me kombësi amerikane, bullgare dhe portugeze.[63]

Shumë shtete evropiane kanë vënë elementin "shtetësi" si kriter themelor për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Sipas nenit 5 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të zgjidhen nga shtetas kroatë. Për me tepër, neni 9 i Ligjit Slloven për Gjykatën Kushtetuese përcakton: "Secili shtetas i Republikës së Sllovenisë, i cili është ekspert juridik dhe ka arritur moshën 40 vjeç, mund të zgjidhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese".[64]

Edhe pse ky kriter ekziston në shumicën e shteteve, praktika kushtetuese në këtë drejtim njeh disa përjashtime, siç janë Andorra dhe Lihtenshtajni, ku gjyqtarë mund të caktohen edhe nga shtetet fqinje, ose nga shtetet që kanë qenë nën administrim ndërkombëtar, siç është rasti i Bosnjë e Hercegovinës.

Për shembull në monarkinë kushtetuese të Lihtenshtajnit, "praktika është që një gjyqtar vjen nga Austria dhe një nga Zvicra".[65] Shtetet që ndodhen në situata të pasluftës sikurse në Bosnjë e Hercegovinë, kanë zgjedhur një sistem të ngjashëm me atë të Kosovës, duke përzgjedhur tre gjyqtarë ndërkombëtarë për një periudhë të kufizuar kohore.[66] Në Bosnjë e Hercegovinë katër anëtarë të Gjykatës Kushtetuese janë të zgjedhur nga Dhoma e Përfaqësuesve të Federatës, dy anëtarë nga Kuvendi i Republikës Serbe, kurse tre anëtarë e tjerë të Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pas konsultimit me Kryesinë e Federatës.[67]

Për sa i takon kualifikimit juridik të gjyqtarëve kushtetues si "juristë të dalluar", mund të theksohet se, vështruar nga perspektiva krahasimore. përvoja juridike përbën një preferencë të përgjithshme në disa gjykata kushtetuese në Evropë (p.sh. Shqipëria, Bullgaria, Gjermania, Letonia, Lituania, Portugalia, Rumania, Rusia, Sllovakia; ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë).[68] Ekzistojnë disa gjykata kushtetuese, të cilat nuk kërkojnë shprehimisht që anëtarët e tyre të kenë kualifikimin e juristit dhe

---

[62] Shih Amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Nr. 04/436, 07 shtator 2012, Gazeta Zyrtare 25/2012.

[63] Duhet vënë re se dispozitat kalimtare të Kushtetutës janë amendamentuar dhe nuk janë të zbatueshme më tutje, Shih: http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3293.

[64] Shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, botuar në "Narodne novine", nr 99/99, datë 29 shtator 1999, dhe Ligjin mbi rishikimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, botuar në "Narodne novine", nr 29/2002, datë 22 mars 2002, që mund të kërkohet në http://www.usud.hr/default.aspx.

[65] Shih Raportin e Komisionit të Venecias (Këshilli i Evropës) për përbërjen e gjykatave kushtetuese, datë 17 shkurt 1997. Mund ta kërkoni në http://www.venice.coe.int/docs/1997/CDL-JU(1997)010prov-e.asp.

[66] Shih Morrison, Fred L. "Constitution of Bosnia-Herzegovina, The". Const. Comment.13 (1996): 145; Yee, Sienho. "New Constitution of Bosnia and Herzegovina, The". Eur. J. Int'l L.7 (1996): 176; Szasz, Paul C. "The protection of human rights through the Dayton/Paris peace agreement on Bosnia". American Journal of International Law (1996): 301-316.

[67] Shih Nenin VI të Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila është në dispozicion në http://www.ccbh.ba/eng/article.php?pid=835&kat=518&pkat=500.

[68] Shih raportin e Komisionit të Venecias (Këshilli I Evropës) për përbërjen e gjykatave kushtetuese, date 17 shkurt 1997, të arritshëm në http://www.venice.coe.int/docs/1997/CDL-JU(1997)010prov-e.asp.

"shprehimisht lejojnë që, edhe ata që nuk janë juristë, të bëhen anëtarë të gjykatës, në mënyrë që të sjellin një gamë të gjerë të përvojave njerëzore dhe për të shmangur një specializim të tepërt të gjykatës" sikur janë, për shembull, Armenia, Austria, Franca, Lihtenshtajni dhe Turqia, edhe pse "praktika ka treguar që këto gjykata janë kryesisht të përbëra nga juristët".[69]

Megjithatë duhet përmendur se, gjatë hartimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ka pasur një unanimitet në mesin e anëtarëve të Grupit Punues që të bëhej një konkretizim i dispozitave kushtetuese bazuar në ligj lidhur me natyrën e përvojës juridike, e cila është e domosdoshme për ndërtimin e një gjykate të specializuar kushtetuese. Në këtë aspekt ka mbizotëruar tërësisht me arsyes botëkuptimi që autoritetet emëruese (ang.apppointing authorities) duhet të rekrutojnë kandidatë me një përvojë të demonstruar juridike, veçanërisht në fushën e së drejtës kushtetuese. Kjo nënkuptonte një përvojë të shquar në fushën e gjyqësisë kushtetuese ose një përvojë të dëshmuar shkencore dhe akademike në lëmin e së drejtës kushtetuese.

Sipas anëtarëve të Grupit Punues, gjykata kushtetuese kërkon juristë specialistë për të gjykuar konteste kushtetuese, dhe këtu është kërkuar që aftësitë e tyre profesionale të shprehen përmes njohjes së mirë të së drejtës publike, të së drejtës kushtetuese dhe nga një punë e dëshmuar profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë. Ideja e hartueseve të Ligjit ishte që të sigurohej një profilizim i juristëve me kompetencë të specializuar, po jo me kompetencë juridike të përgjithësuar. Nisur nga praktika se jo çdo jurist posedon këto kualitete, qëllimi hartuesve të Ligjit për gjykatën kushtetuese ka qenë që të vendosen kritere të larta për kandidatët potencialë, të cilët dëshirojnë të kandidohen për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Përcaktimi i Ligjit se anëtarët e gjykatës kushtetuese duhet të jenë juristë me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale[70] veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, në mes të tjerash, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë dhe punësh të tjera të rëndësishme të natyrës juridike, është bazuar në premisën e përzgjedhjes së juristëve më të shquar, për të shërbyer në Gjykatën Kushtetuese.

Mirëpo, nuk është vetëm gjatësia e përvojës për t'u cilësuar si "jurist i shquar". Ka faktorë të tjerë, si niveli i përvojës ligjore ose gjyqësore, numri i cilësisë së botimeve akademike, që janë të rëndësishme për të vlerësuar cilësinë e përvojës ligjore. Edhe pse disa vende, si Sllovenia[71] kanë një limit moshe minimale prej 40 vjet, vende të tjera si Shqipëria[72] dhe Kroacia[73] vënë nivelin e përvojës në një nivel më të lartë, duke kërkuar nga kandidatët që të kenë të paktën 15 vjet përvojë si një jurist shumë të kualifikuar dhe me përvojë.

Po aq e rëndësishme është të theksohet njohja me kategorinë e rëndësishme të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Shkalla në të cilën kufizimet mbi të drejtat dhe liritë themelore janë të lejueshme me Kushtetutë, kërkon një analizë të

[69] Ibid.

[70] Neni 7 [Përbërja e Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 2, i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë përcakton "Gjyqtarët emërohen për nëntë (9) vjet pa të drejtë rizgjedhjeje, në mesin e juristëve me kualifikim të lartë dhe përvojë pune jo më pak se 15 vjet".

[71] Neni 9 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

[72] Neni 7.2 i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë.

[73] Neni 5 i Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë.

thellë kushtetuese, në mënyrë të veçantë në bazë të neneve 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Neni 53 parashikon: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Kjo kërkesë do të thotë jo vetëm njohje e kuadrit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ), por, në veçanti, edhe e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GjEDNj) në Strasburg, për të rritur nivelin e respektimit të vendimeve të kësaj gjykate. Duhet të theksohet se, gjatë disa dekadave të fundit, jurisprudenca e GJEDNJ-së është bërë shumë e gjerë dhe, për këtë arsye, një njohje e duhur e kësaj jurisprudence do të ishte shumë e dobishme për zgjidhjen e çështjeve kushtetuese, që përfshijnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me KEDNJ dhe Kushtetutë.

Duhet theksuar fakti se është detyrim kushtetues i të dy autoriteteve emëruese në Kosovë, i Kuvendit të Kosovës dhe i Presidentit të Republikës, që të sigurojnë se procesi i përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese reflekton rregullsinë formale dhe substanciale të procesit të zgjedhjes. Me fjalë të tjera, autoritetet për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të kujdesen që, përgjatë procesit të emërimit, të jenë plotësuar jo vetëm kushtet formale, po edhe ato materiale në lidhje me emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Detyra për të siguruar rregullsinë procedurore të emërimeve gjyqësore buron nga Kushtetuta, e cila ka vendosur mekanizma të kontrolleve dhe balancave reciproke në emërimin e gjyqtarëve kushtetues.[74]

Dyshimet për rregullsitë në emërimin e gjyqtarëve nga autoritetet kompetente tërhoqën vëmendjen e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri, kështu që në vitin 2005 Presidenti i Republikës së Shqipërisë i kishte kërkuar Gjykatës Kushtetuese interpretimin e neneve 125/1 e 136/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë lidhur me procedurën që duhet të aplikojë Kuvendi i Shqipërisë për shqyrtimin e dekreteve për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, dhe çështjen nëse ky organ ka të drejtë të mos japë pëlqimin për këto emërime, tej kritereve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjet përkatëse.[75]

Në vendimin e saj interpretues, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë kishte përcaktuar se "...kompetenca e Kuvendit të Shqipërisë për një shqyrtim të plotë, pra edhe në këndvështrimin e meritës, të zgjedhjes së bërë nga ana e Presidentit të Republikës, është në pajtim edhe me formën e regjimit politik të përcaktuar në Kushtetutë (neni 1) si republikë parlamentare. Në këtë vështrim, pjesëmarrja e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e emërimit të gjyqtarëve, që shkon tej një kontrolli juridik të procesit, është në harmoni të plotë me natyrën politike të këtij organi".[76] Sipas Gjykatës Kushtetuese,

[74] Për më shumë mbi kontrollin dhe balancën në rrjedhën e emërimit të gjyqtarëve, shih Epstein, Lee, and Jeffrey A. Segal. Advice and consent: The politics of judicial appointments. Oxford University Press, 2005; Gauch, James E. "Intended Role of the Senate in Supreme Court Appointments, The". U. Chi. L. Rev. 56 (1989): 337. Lively, Donald E. "Supreme Court Appointment Process: In Search of Constitutional Roles and Responsibilities, The". S. Cal. L. Rev. 59 (1985): 551.

[75] Neni 125 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton se "Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit".

[76] Presidenti i Republikës k.????? Kuvendit të Shqipërisë nr 02/2005. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. 19 janar 2005. Vizituar më 12 korrik 2012. Ky vendim është i arritshëm në http://www.gjk.gov.al/.

"përfshirja e Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces ka të bëjë jo vetëm me shqyrtimin e *rregullshmërisë juridike*, por edhe të *meritës* së zgjedhjes së bërë nga ana e Presidentit të Republikës me qëllim të sigurimit të një përbërjeje cilësore dhe të përshtatshme të gjykatave".[77] Për rrjedhojë, Kuvendi i Shqipërisë ka kompetencë të japë ose jo pëlqimin për emërimet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, deklaroi Gjykata Kushtetuese.

Sipas kësaj dispozite, gjyqtarët e Gjykatës duhet të jenë individë me reputacion të shkëlqyer moral. Është e qartë që kjo kërkesë morale është relativisht abstrakte dhe është vështirë të matet nëpërmjet intervistave apo me metoda të tjera të tilla si testet ose vlerësimet e bëra në bazë të mendimeve të personave që kanë pasur marrëdhënie zyrtare me kandidatin gjatë gjithë karrierës së tij/saj profesionale.[78] Edhe pse, pra, është vështirë të përcaktohet në terma abstraktë, ky parim nënkupton që gjyqtarët e Gjykatës duhet të jenë shumë të respektuar, të ndershëm, dinjitozë dhe të motivuar në zgjidhjen e kontesteve kushtetuese.

Zotësia e plotë e veprimit nënkupton kapacitetin e personit për të vepruar duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe efektet që prodhohen. Në drejtësi ekziston gjithmonë supozimi se secili duhet të trajtohet të jetë në gjendje te ndërmarrë veprime të tij/saj derisa të mos provohet e kundërta. Ky supozim juridik u mundëson individëve që të ndërrojnë veprime të tyre për aq kohë sa janë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë. Mungesa e aftësisë së veprimit mund të jetë rezultat i një paaftësie të rëndë mendore, lëndimi të trurit, problemesh të shëndetit mendor apo mungese të vetëdijes për shkak të anestetikut ose nga ndonjë aksident. Heqja e zotësisë për veprim bëhet përmes vendimit të gjykatës kompetente, sipas kërkesës së palës së autorizuar.

Çështja e dytë, së cilës neni 4 paragr. 1.3 i referohet, është mosdënimi për vepër penale, dhe kjo paraqet një situatë pak më komplekse nga pikëpamja juridike. Në rrethanat e ekzistimit të kërkesave për një shkallë të lartë të integritetit moral, është fare normale që e kaluara e kandidatëve për gjyqtarë të gjykatës kushtetuese të jetë e pastër në pikëpamje penale. Me fjalë të tjera, kandidatët për gjyqtarë të gjykatës kushtetuese nuk duhet të kenë pasur një të kaluar me prapavijë penale, siç përcaktohet me dispozitën e sipërpërmendur. Një kusht i tillë është i arsyeshëm në pikëpamje legale, për faktin që bëhet fjalë për një institucion me autoritet të lartë kushtetues. Gjatë punës në hartimin e dispozitës në fjalë, diskutimet kanë qenë të polarizuara në vështrim të efekteve që mund të prodhojë një dispozitë e tillë dhe për shkak të paqartësive eventuale që mund të shfaqen me rastin e zbatimit të dispozitës në fjalë.

Së pari, një lexim i kujdesshëm i dispozitës në fjalë nuk ofron qartësi të plotë nëse është fjala për vendime gjyqësore të formës së prerë. Kjo është shumë e rëndësishme në pikëpamje legale dhe në kontekst të çështjes së paraqitjes së aplikacioneve për pozitën e gjyqtarit të gjykatës kushtetuese. Sigurisht që varianti më i dëshiruar në kontekst të dispozitës do të ishte që kandidatët për gjyqtarë të gjykatës kushtetuese të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Ky formulim do të ofronte më tepër qartësi legale dhe do të siguronte më tepër besueshmëri lidhur me fatin e aktgjykimit penal në raste procedure apelimi ndaj tij – me fjalë të tjera, nëse vendimi gjyqësor nuk ka marrë ende formë të prerë. Sipas së

[77] Ibid.

[78] Për më shumë informacion, shih Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve të miratuar në Strasburg më 8 - 10 korrik, 1998. Kjo Kartë është në dispozicion në http://www.coe.int.

drejtës pozitive penale të Republikës së Kosovës, një vendim gjyqësor është i formës së prerë nëse "nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë".[79] Në çështjen nëse ndaj kandidatit për gjyqtar të gjykatës kushtetuese zhvillohet procedurë penale, zbatohet parimi "secili i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin". Ky parim përcaktohet në nenin 31 paragr. 5 të Kushtetutës, i cili është huazuar *ad verbatim* nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (art. 6.2).[80]

Një tjetër çështje e ngritur gjatë hartimit të dispozitës në fjalë, ka qenë çështja e dënimeve politike gjatë së kaluarës komuniste. Me fjalë të tjera, anëtarët e Grupit Punues kanë tërhequr vëmendjen për rrezikun që mund të paraqesë formulimi "dënim penal" për rastet e dënimeve politike për agjitim dhe propagandë politike, të cilat në të kaluarën komuniste kanë qenë vepra penalisht të inkriminueshme. Një variant i ngushtë interpretimi i "dënimit penal" mund të jetë një pengesë formale juridike për aplikantët potencialë, të cilët në të kaluarën komuniste kanë qenë viktimë e sistemit të drejtësisë, të gjykimeve të montuara politike për vepra penale politikisht të motivuara. Prandaj, në lidhje me këtë çështje, duhet theksuar se qëllimi i hartuesve nuk ka qenë përfshirja e situatave të këtilla të dënimeve politike dhe kjo evidentohet qartë edhe nga procesverbalet e takimeve të mbajtura lidhur me hartimin e projektligjit për gjykatën kushtetuese.

Grupi punues është përballur gjithashtu me çështjen nëse do të ishte e përshtatshme ose jo të hidheshin poshtë kërkesat e kandidatëve që në tri vitet e fundit kanë mbajtur poste të larta politike a shtetërore. Refuzimi i kërkesave të tilla pretendohej të ishte i nevojshëm si një masë mbrojtëse për të ruajtur pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese dhe për të shmangur politizimin e Gjykatës në periudhën fillestare të punës së saj. Kjo çështje meriton një shqyrtim të mëtejshëm. Një nga ato vende që kanë përfshirë kufizime të tilla ligjore, duke futur periudhën e "ftohjes" (cooling-off period) për ata kandidatë që kanë mbajtur më parë pozita të larta të qeverisë ose në politikë para anëtarësimit në Gjykatën Kushtetuese, është Hungaria. Në bazë të nenit 6.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese "anëtarët e Qeverisë ose të punësuarit e partive politike, si edhe zyrtarë të lartë të administratës shtetërore, të cilët kanë shërbyer në cilësinë e tillë gjatë katër viteve para zgjedhjes, nuk mund të bëhen anëtarë të Gjykatës Kushtetuese".[81]

---

[79] Shih nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nr 04/L-123. Ligji është në dispozicion në http://gazetazyrtare.rks-gov.net.

[80] Neni 31.5 i Kushtetutës përcakton: Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

[81] Ligji i ri i vitit 2011 për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë në nenin 6 (1) parashikon "çdo qytetar hungarez, i cili nuk ka të kaluar kriminale dhe ka të drejtë për të dalë si kandidat në zgjedhjet parlamentare, ka të drejtë të bëhet një anëtar i Gjykatës Kushtetuese, nëse:

a) ka të kryer fakultetin juridik;

b) ka arritur 45 vjeç; dhe

c) është jurist teorik me njohuri të shquara (profesor universiteti apo anëtar i Akademisë Hungareze të Shkencave) ose të ketë të paktën njëzet vjet përvojë pune profesionale në fushën e ligjit.

(2) Përvoja profesionale në fushën e së drejtës, e përmendur në paragrafin (1) do të jetë që të kërkohet diplomë universitare në drejtësi..

(3) Mandati i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese është dymbëdhjetë vjet, e anëtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të rizgjidhen

Është e vërtetë se hartuesit e Kushtetutës, duke u mbështetur në nenin 114.1, synuan që t'i mundësonin legjislaturës që të caktonte kualifikime shtesë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese. Mirëpo, një lexim i kujdesshëm i kësaj dispozite tregon se nuk ishte i domosdoshëm qëllimi i hartuesve që t'u ndalonin të gjithë kandidatëve që kanë mbajtur poste të larta politike ose publike në Kosovë, të bëheshin anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. E dyta, neni 114 i Kushtetutës i referohet termit "kriter plotësues" (në ang. additional condition), i cili jo domosdoshmërisht nënkupton vënien e masave kufizuese në tekstin e Ligjit.
Së fundi, një çështje e tretë e cila është marr në konsideratë ishte parimi i barazisë dhe shanseve të barabarta në kontekstin e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës i cili parasheh se " rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e [...], barazisë, [...], mosdiskriminimit, [...] ". Parë në këtë kontekst, çdo kufizim i së drejtës për të kandiduar për poste publike duhet të bazohet në parimin e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Kjo ishte arsyeja që kufizimi i propozuar për kandidatët për Gjykatën Kushtetuese të mos përfshihej në tekstin e ligjit.

Neni 5 [Papajtueshmëria e funksionit]

5.1 Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:
1.1. anëtar i një partie, lëvizjeje ose çfarëdo organizate tjetër politike;
1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrjeje publike, shoqërie tregtare ose organizate joqeveritare;
1.3. anëtar i një sindikate.

5.2 Përveç ndalesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale, për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akredituar. Për qëllime të këtij ligji, nuk konsiderohet detyrë publike apo profesionale nëse gjyqtari pa pagesë merret me veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata të tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike.

---

(4) Anëtarët e Qeverisë ose të punësuarit e partive politike, si edhe zyrtarë të lartë të administratës shtetërore, të cilët kanë shërbyer në cilësinë e tillë gjatë katër viteve para zgjedhjes, nuk mund të bëhen anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
Është e vërtetë se hartuesit e Kushtetutës, duke u mbështetur në nenin 114.1, me qëllim që t'i mundësonin legjislaturës për të kërkuar kualifikime shtesë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese. Por një lexim i kujdesshëm i këtij neni, nuk ka treguar se ai kishte qenë qëllimi i hartuesve të Kushtetutës për të mos i lejuar kandidatët, të cilët kanë qenë më parë zyrtarë të lartë politikë a publikë, për të marrë pozicionin e gjyqtarit kushtetues. Së dyti, gjuha e nenit 114 që ligji mund të ofrojnë kualifikime të tjera të rëndësishme, nuk do të thotë se klauzola kufizuese duhet të futet në tekstin e ligjit.
Së fundi, një çështje e tretë që merrej në konsideratë, ishte parimi i barazisë së mundësive në kontekstin e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, i cili parasheh se " Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e [...], barazia, [...], mosdiskriminimi, [...] ". Parë në këtë kontekst, çdo kufizim i së drejtës për të kandiduar për poste publike duhet të bazohet në parimin e mosdiskriminimit dhe të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Kjo ishte për arsyet e mësipërme që kufizimi i propozuar për kandidatët e tillë për Gjykatën Kushtetuese, të mos jetë përfshirë në tekstin e ligjit.

5.3 Gjyqtari i propozuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës nëse nuk paraqet dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga funksionet e përcaktuara në paragrafët 1 e 2 të këtij neni.

5.4 Secili gjyqtar ka për detyrë të njoftojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim për çdo aktivitet që kryen jashtë funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin kompensohet me mëditje ose çfarëdo forme tjetër të kompensimit. Në rast se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese shpreh kundërshtimin e vet, gjyqtari ka të drejtë të kërkojë që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të rishqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë mund të hidhet poshtë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Se gjyqtarët kushtetues nuk mund të mbajnë poste konkurrente përgjatë ushtrimit të funksionit të tyre, është fare normale për praktikat e gjykatave kushtetuese. Qëllimi i kësaj ndalese kushtetuese është që të garantohet dhe të sigurohet një zhvillim i paanshëm dhe i pavarur i një procesi kushtetues dhe mbrojtja e gjyqtarëve nga ndërhyrje eventuale në procesin e zgjidhjes së kontesteve kushtetuese. Kushtetuta ka përcaktuar në nenin 113/2 se "Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj". Legjislatori e konkretizon këtë pavarësi përmes instrumentit të kufizimit juridik të dhënë në formë të papajtueshmërisë së funksionit për të siguruar një pavarësi të plotë të gjyqtarëve kushtetues.

Për sa i përket ndalimit të anëtarësimit në parti politike, në lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike, duhet qartësuar se, për dallim nga partia politike, lëvizja politike nuk organizohet me qëllim të zgjedhjes së anëtareve të lëvizjes për organe shtetërore, por synon të bindë qytetarët për të ndërmarrë veprime mbi çështjet dhe shqetësimet që janë në fokus të lëvizjes. Ndalimi i përcaktuar në nenin 5.1.1 të Ligjit nënkupton gjithashtu se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese e kanë të ndaluar të mbajnë fjalime në mbështetje të një organizate apo kandidati politik; ose të rekomandojnë publikisht një kandidat për një pozitë publike, apo të marrin ndonjë funksion që ka të ngjarë të konsiderohet si i natyrës politike.

Arsyeja për këtë ndalesë është e qartë: gjyqtarët e rregullt/gjyqtarët kushtetuese duhet të jenë në gjendje të gjykojnë në mënyrë të lirë nga çdo lloj ndikimi i jashtëm, politik apo i ngjashëm. Prandaj, çdo lloj përkatësie, pjesëmarrjeje ose përfshirjeje në parti, ë lëvizje apo organizatë politike, do të kufizonte fushën e pavarësisë gjyqësore dhe të gjyqtarëve kushtetues dhe do të dëmtonte aftësinë e tyre për të gjykuar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.[82]

Shembuj të ndalimit të anëtarësimit në parti apo organizata politike janë të njohur për praktikën kushtetuese. Për shembull, anëtarësimi në parti politike i gjyqtarëve kushtetues nuk lejohet në shumë shtete (Shqipëria, Azerbajxhani, Kanadaja, Kroacia,

[82] Më tepër për pavarësinë e gjyqtarëve shih: Kane Jr, John L. "Public Perceptions of Justice: Judicial Independence and Accountability". Journal of the National Association of Administrative Law Judiciary 17.2 (2013): 2; Geyh, Charles Gardner. "Judicial Selection Reconsidered: A Plea for Radical Moderation". Harv. JL & Pub. Pol'y 35 (2012): 623; Kelemen, R. Daniel. "The political foundations of judicial independence in the European Union". Journal of European Public Policy 19.1 (2012): 43-58; Seibert-Fohr, Anja. Judicial Independence in Transition. Vol. 233. Springer, 2012.

Republika Çeke, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Italia, Letonia, Rumania, Rusia, Sllovakia, Sllovenia, Turqia, Ukraina), ose të paktën pjesëmarrja aktive në parti politike a shoqata publike nuk është e lejuar (në Argjentinë, Armeni, Finlandë, Francë, Irlandë, Japoni, Letoni, Lituani).[83]

Ligji ua ndalon gjyqtarëve të anëtarësohen në borde të ndërmarrjeve publike gjatë mandatit të tyre. Ligji për Ndërmarrjet Publike siguron kornizën ligjore për pronësinë e ndërmarrjeve publike dhe për qeverisjen e tyre korporative në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike në Kosovë.[84] Qëllimi i normës është për të parandaluar gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të kenë ndonjë marrëdhënie, duke përfshirë pa kufizim interesa pronësorë në ndërmarrje publike, dhe për të mundësuar që një gjyqtar të kryejë me zell përgjegjësitë gjyqësore pa paragjykim apo anshmëri dhe për të ruajtur kompetencën profesionale në kuadër të procedurës kushtetuese. Duhet të theksohet se kjo normë nuk e ndalon gjyqtarin që të mos marrë pjesë në një procedurë ku gjyqtari vetë është palë ndërgjyqëse në cilësi personale kundër një ndërmarrjeje në pronësi publike.

Kushtetuta garanton lirinë për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar me qëllim që të mbrohen interesat e të punësuarve.[85] Për më tepër, Ligji për organizimin e organizatave sindikale rregullon më tej të drejtat dhe lirinë e të punësuarve për të themeluar organizata sindikale në sektorin publik e privat, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomikë, punonjës socialë dhe profesionistë nga puna dhe në kuadër të marrëdhënies së punës. Sipas Ligjit, sindikatat janë organizata të pavarura, që janë krijuar si një bashkim vullnetar i të punësuarve, qëllimi i të cilëve është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave ligjore dhe interesave ekonomikë, socialë dhe profesionalë të anëtarëve të tyre.[86] Megjithatë, Kushtetuta e Kosovës parasheh që ushtrimi i kësaj lirie kushtetuese, siç parashihet me nenin 44 të Kushtetutës, mund t'u nënshtrohet kufizimeve për disa kategori të të punësuarve. Ligji për Gjykatën Kushtetuese ka vendosur kufizime të tilla për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duke u ndaluar gjyqtarëve të anëtarësohen në organizata sindikale. Kjo masë ndalimi mund të jetë vënë me qëllim të sigurimit të një shkalle më të lartë të pavarësisë në Gjykatën Kushtetuese. Anëtarët sindikalist shpesh mund të paraqesin referime kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, p.sh., shkelje të supozuara të të drejtave ose të lirive kushtetuese. Çdo anëtarësim i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ose lidhjet e tyre me organizatat sindikale, mund të kompromet ojnë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese në rrjedhën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kushtetuese që përfshijnë sindikatat, dhe Gjykata Kushtetuese, vendimmarrja e së cilës varet nga kuorumi, nuk do të jetë në gjendje për të vepruar e vendosur për çështjet përkatëse. Për më tepër, në disa vende kushtetutshmëria e veprimtarisë së organizatave sindikale mund të kontestohet po ashtu para gjykatës kushtetuese, e cila është edhe një arsye që mund të ketë ndikuar për të ndaluar anëtarësimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në organizata sindikale.

Megjithatë, Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen e gjyqtarëve profesionistë, në veçanti etikën, sjelljen e

[83] Shih: Raporti i Komisionit të Venecias për përbërjen e gjykatave kushtetuese (supra note 14).
[84] Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 mund të kërkohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
[85] Kushtetuta e Kosovës, Neni 44.
[86] Ligji për organizimin sindikal në Kosovë, nr. 04/L-011.

papajtueshme dhe paanësinë, jep disa mundësi për sa u përket të drejtave të gjyqtarëve të zakonshëm për të marrë pjesë në organizatat sindikale, duke siguruar se "në bazë të lirisë së shprehjes dhe mendimit, gjyqtarët mund të ushtrojnë të drejtën për t'u bashkuar me sindikatat (liria e shoqërimit), megjithëse kufizimet mund të vendosen për të drejtën për grevë".[87]

Standardi i njëjtë vlen edhe në lidhje me ndalimin e anëtarësisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në komitete drejtuese apo në borde të OJQ-ve. Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare rregullon themelimin, regjistrimin, menaxhimin e brendshëm, aktivitetin, shpërbërjen dhe largimin nga regjistri i personave juridikë të organizuar si OJQ në Kosovë. Sipas ligjit, organi më i lartë drejtues i një fondacioni është Bordi i Drejtorëve, i cili ka përgjegjësi të plotë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës, shqyrton dhe miraton asetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës.[88] Duke pasur parasysh tërësinë e përgjegjësive të bordit të OJQ-ve ose të një komiteti drejtues, objektivat e nenit 5 paragr. 1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, janë të vetë-kuptueshme.

Kategoria e dytë e ndalimeve, të cilat janë të përcaktuara në paragraf. 2 të nenit 5, kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave publike a profesionale për të cilat ofrohet kompensim, me përjashtim të të qenit ligjërues i shkencave juridike në një universitet të akredituar. Një lexim i kujdesshëm i këtij paragrafi tregon se legjislatura vetëm i referohet ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike, që duket se përjashton angazhimin e mundshëm të gjyqtarëve në mësimdhënie në universitete të akredituara në lëndët e tjera, që nuk janë domosdoshmërisht juridike. Megjithatë, është interesante të përmendet se në shumë vende parashikohet një përjashtim më i gjerë duke bërë referencë në "mësimdhënie" për lëndë të tjera në institucionet e akredituara.[89] Në këto rrethana, një gjyqtari të gjykatës kushtetuese mund t'i lejohet të japë mësime/ligjërata në shkenca politike ose në ekonomi apo lëndë të tjera, të cilat nuk kanë lidhje me punën e tij si gjyqtar në gjykatën kushtetuese.

Ligji përcakton gjithashtu se angazhimi i një gjyqtari të gjykatës kushtetuese, pa kompensim, në një institut shkencor apo shoqatë të avokatëve, organizatë humanitare, kulturore, sportive dhe në organizata të tjera, nuk duhet të konsiderohet si detyrë publike a profesionale për aq kohë sa këto aktivitete nuk kanë të bëjnë me punën e një partie politike. Kështu, një gjyqtar ka të drejtë të jetë anëtar i bordit të klubit lokal të futbollit ose trajner pa pagesë në një klub të zhytjes.

Për më tepër, një anëtar i Gjykatës Kushtetuese është në një pozitë unike të jetë në gjendje për të kontribuar në përmirësimin e ligjeve, duke u përfshirë në rishikimin e ligjeve materiale e procedurore dhe të sistemit ligjor në përgjithësi. Sa herë që lejon koha, gjyqtari duhet të inkurajohet për ta bërë këtë duke mbajtur fjalime në oda të avokatisë, konferenca gjyqësore ose organizata të tjera të dedikuara për avancimin e së

---

[87] Opinioni nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (CCJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen e gjyqtarëve profesionistë, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanësinë. 19 nëntor 2002. Dokumenti mund të kërkohet në http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/CCJE% 20Opinion% 203_EN.pdf

[88] Law no.04/l –057 on Freedom of Association in Non-Governmental Organisations is available at the Official Gazette of Kosovo at http://gazetazyrtare.rks-gov.net.

[89] Shih, për shembull, Neni 98 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës dhe Neni 10 (2) i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë.

drejtës. Në çdo situatë, një gjyqtar këto aktivitete jashtëgjyqësore duhet t'i kryejë në një mënyrë që nuk hedh asnjë dyshim të arsyeshëm në kapacitetin e tij/saj për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme si gjyqtar dhe për të kryer si duhet detyrat e tij/saj gjyqësore.

Ky nen vendos një detyrim ligjor për gjyqtarët e propozuar nga Kuvendi i Kosovës, që, para se të emërohen nga Presidenti i Republikës dhe para se të japin betimin, të ofrojnë dëshmi për dorëheqjen e tyre nga të gjitha funksionet e përcaktuara në nenet 5.1 dhe 5.2. Nëse kandidatët e propozuar janë anëtarë të Kuvendit, Qeverisë ose të organeve të tjera publike në nivel qendror ose lokal, ata duhet të ndërprejnë të jenë anëtarë të organeve të tilla, para emërimit të tyre nga Presidenti. Është detyrë e kandidatit të propozuar të deklarojë se ekzistojnë pengesa të tilla ligjore dhe të ofrojë dorëheqje të menjëhershme nga pozicioni i papajtueshmërisë. Për sa i përket interpretimit të fjalës "provë", kjo nënkupton çdo të dhënë që qëndron si dëshmi e dorëheqjes, të tilla si një deklaratë e bërë nën betim ose një letër e nënshkruar në mënyrë të rregullt nga ana e kandidatit të propozuar.

Kjo dispozitë përcakton në mënyrë të qartë se është e detyrueshme për gjyqtarët që dëshirojnë të angazhohen si mësimdhënës të shkencave juridike në një universitet të akredituar, që ta informojnë Kryetarin e Gjykatës me shkrim për këtë aktivitet. Meqenëse Kryetari ka për detyrë të sigurojë funksionimin efikas dhe efektiv të Gjykatës në bazë të Rregullës 12 [Funksionet e Kryetarit] të Rregullores së Punës, ai/ajo mund të konsiderojë se veprimtaria e paguar jashtë zyrës së gjyqtarit do të ishte në dëm të funksionimit të duhur të Gjykatës, për shembull, për shkak të numrit të ligjëratave që do të zhvillohen nga gjyqtari në fjalë, dhe për këtë mund të shprehë kundërshtimin e tij. Në këtë rast, gjyqtari mund të kërkojë nga kolegët e tij që të rishqyrtojnë kundërshtimin e vënë nga Kryetari. Shumica e të gjithë gjyqtarëve mund të hedhin poshtë një kundërshtim të tillë ose, edhe pse nuk është cekur në dispozitë, mund të propozojnë një kompromis të pranueshëm për Kryetarin dhe gjyqtarin në fjalë.

Neni 5 i ligjit nuk është i plotësuar nga ndonjë rregull specifike, sipas Rregullores së Punës.

Neni 6 [Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese]

6.1 Me këtë ligj themelohet Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë "Komisioni"). Ky Komision i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me procedurën e përcaktuar në këtë nen.

6.2 Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

1. **Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo një anëtar i Kuvendit përfaqësues i deleguar i tij/saj;**
2. **Udhëheqësit e secilit grup parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtarët e Kuvendit përfaqësues të deleguar të tyre;**
3. **Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;**
4. **Avokati i Popullit;**
5. **Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete;**

6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.

6.3 Komisionin e thërret dhe e kryeson Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesi i deleguar i tij/saj. Komisioni ka dy zëvendëskryesues të cilët zgjidhen në mesin e anëtarëve të tij, do të jetë nga radhët e deputetëve të komunitetit tjetër nga komuniteti i kryesuesit.

6.4 Komisioni vendos me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesit të tij/saj të deleguar është vendimtare.

6.5 Në rast se ndonjëri nga anëtarët e Komisionit ka konflikt të interesit në lidhje me rastin, atëherë ai/ajo nuk merr pjesë në punën e Komisionit për atë rast.

6.6 Procedurën për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e fillon Komisioni. Komisioni publikon thirrjen/ftesën në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe ato të cilat kryesisht lexohen nga komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, të Kuvendit, institucioneve gjyqësore, fakulteteve juridike, Odës së Avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, partive politike, personave të tjerë relevant juridik dhe individëve që të propozojnë kandidat për zgjedhjen e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë ftesa/thirrja). Një person mund të propozojë veten për kandidat.

6.7 Në thirrje/ftesë ceken kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, afati për paraqitjen e propozimit për kandidatin Komisionit, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtër se 15 apo më i gjatë se 20 ditë, dhe dokumentet përcjellëse të cilat dorëzohen me propozim.

6.8 Pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e mëparshëm, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, shqyrton nëse kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedhë poshtë kandidaturat që nuk plotësojnë këto kushte. Në zbatimin e kësaj përgjegjësie, Komisioni aplikon përvojat e krijuara për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve tjerë të gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

6.9 Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për tu zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidateve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

6.10 Lista e ngushtë përmban më shumë kandidatë sesa numri i gjyqtarëve të cilët do të zgjedhën, por jo më tepër se pesë (5) kandidatë për një post të lirë.

6.11 Komisioni, bashkangjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

6.12 Propozimi i Komisioni përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.

Arsyet që kanë determinuar këtë përshkrim të detajuar të procedurës së propozimit të kandidatëve për gjyqtarë të gjykatës kushtetuese nga ana e Kuvendit të Kosovës, kanë qenë të shumëfishta.

E para, gjuha e përgjithësuar kushtetuese ka imponuar një detajim normativ në kuptim të Nenit 6 të Ligjit, i cili ofron qartësi procedurore në kuptimin e vënies në lëvizje të procedurës për propozimin e kandidatëve nga ana e Kuvendit të Kosovës. Dispozita kushtetuese në kuptim të nenit 114 të Kushtetutës (Përbërja dhe mandati i Gjykatës Kushtetuese), e cila flet për rolin e Kuvendit në procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, është mjaft e përgjithësuar. Ajo nuk jep hollësi për masat që duhet të marrë Kuvendi për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. [90]

Së dyti, në lidhje me procesin e emërimit, Ligji përcakton një numër të afateve për përfundimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin prej saj. Këto afate ligjore parandalojnë vonesa të paarsyeshme dhe sigurojnë që procedura e nominimit për emërimin e gjyqtarëve të realizohet brenda afatit kohor të paraparë me ligj.[91]

Dhe çështja e tretë, me të cilën u ballafaquan anëtarët e Grupit Punues, ishte se si të sigurohet një sistem i hartimit të listës së ngushtë të kandidatëve për gjyqtarë, e cila do t'i dërgohej Kuvendit të Kosovës për votim. Me fjalë të tjera, ekzistonte dilema se cili organ, në kuadër të Kuvendit të Kosovës, do të ishte kompetent për të vënë në lëvizje procedurën e kandidimit për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Natyrisht, Neni 6 i Ligjit përcakton një aranzhman me të cilin themelohet një Komisioni i veçantë për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: "Komisioni i Veçantë"). Komisioni i veçantë menaxhon procesin e emërimit të kandidatëve, pas ftesës publike për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni i veçantë është kompetent edhe për të shqyrtuar profilin e kandidatëve dhe për të përpiluar një listë të ngushtë të kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni e dërgon listën e ngushtë në Kuvend për shqyrtim dhe votim. Kjo nënkupton se përgjegjësia e Komisionit është kryesisht për të administruar procedurën për propozimin e kandidatëve të përshtatshëm, kurse ata do të votohen përfundimisht nga Kuvendi.

Duhet theksuar se koncepti i Komisionit të Veçantë bart ngjashmëri të theksuara me Komisionin e parlamentit të Republikës së Kroacisë. Sipas nenit 6.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë "*procedura për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues fillon nga Komisioni i Parlamentit të Kroacisë kompetent për çështje kushtetuese, i cili publikon ftesën publike në Gazetën Zyrtare, në institucione gjyqësore, fakultete juridike, oda të avokatëve, asociacione juridike, parti politike dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë për të propozuar kandidatë për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese*".[92]

---

[90] Paragrafët relevantë të nenit 114 të Kushtetutës përcaktojnë: Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi. 3. Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

[91] Shih Nenin 6 të Ligjit Nr 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

[92] Ligji për Gjykatën Kushtetuese i Kroacisë nr. 49/02, datë 3 maj 2002. Ligji mund të kërkohet në http://www.usud.hr/default.aspx?Show=ustavni_zakon_o_ustavnom_sudu&m1=27&m2=49&Lang=en.

Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e kandidaturave, Komisioni shqyrton nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet në ftesën publike, dhe refuzon kandidaturat e parregullta sipas nenit 6 paragr. 2 të Ligjit. Komisioni më pas zhvillon intervista publike me secilin kandidat që plotëson kushtet për t'u bërë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe, në bazë të të dhënave të prezantuara dhe intervistave të zhvilluara, harton listën e ngushtë të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këto janë arsyet pse sistemi aktual i vënies në lëvizje të procedurës së nominimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përmban ngjashmëri të theksuara me modelin kroat të nominimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Përbërja e Komisionit të veçantë reflekton përfaqësim të gjerë politik në Kuvend dhe përfshin mekanizmat kryesorë të gjyqësisë në Kosovë, siç janë Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Komisioni kryesohet nga Kryetari i Kuvendit (Neni 6.2.1), që reflekton qëllimin e legjislatorit për të evituar një mazhorancë parlamentare gjatë procesit të emërimit. Për më tepër, hartuesit e Ligjit konsideruan se mënyra më e mirë për të siguruar përfaqësim të drejtë parlamentar në Komision e veçantë, ishte krijimi i një mekanizmi, i cili të reflektonte përfaqësimin politik në Kuvend, duke përfshirë edhe përfaqësimin e minoriteteve. Dispozita në fjalë përmend udhëheqësit e secilit grup parlamentar në Kuvend ose të përfaqësuesve të tyre, të përcaktuara si subjekte të autorizuara për të marrë pjesë në Komision (neni 6.2.2). Përbërja e tillë e Komisionit të veçantë është gjithashtu e rëndësishme duke pasur parasysh se kërkohet shumica e kualifikuar parlamentare prej dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të Kosovës që janë të pranishëm, një proces që kërkon pashmangshmërisht një konsensus të gjerë politik, në mënyrë që të sigurohet miratimi parlamentar për kandidaturat e paraqitura. Është e vështirë të imagjinohet një miratim i tillë parlamentar në mungesë të një unanimiteti të gjerë politik.

Për të siguruar një përfaqësim adekuat nga ana e gjyqësorit gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Ligji përcakton pjesëmarrjen e Kryetarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i cili në bazë të nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës, ka për detyrë të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. KGJK-ja si institucion i pavarur kushtetues, luan një rol kyç në rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërime në poste gjyqësore, dhe një përvojë e tillë në fushën e emërimit të gjyqtarëve është e dobishme për punën e Komisionit, dhe siguron gjithashtu një proces të hapur e të bazuar në merita, kur shqyrton kandidatët për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Rëndësia e pjesëmarrjes së Kryetarit të KGJK-së në Komisionin e veçantë shpjegohet edhe nga fakti që Këshilli vepron si një autoritet propozues në procesin e emërimit të gjyqtarëve në Kosovë, dhe për këtë arsye mund të sjellë një përvojë të gjerë në trajtimin e procesit të emërimit të kandidaturave për postin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.[93]

[93] Kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë përcaktuar me nenin 108 të Kushtetutës dhe përfshijnë këto institucione: 1.Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. 2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe

Një tjetër institucion i pavarur që merr pjesë në punimet e Komisionit të Veçantë, është Avokati i Popullit, i cili, në bazë të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit) të Kushtetutës, "*mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*". Avokati i Popullit është në një pozitë të mirë për të testuar kandidatët lidhur me njohuritë e tyre për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, mbrojtja e të cilave është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës.[94]

Një tjetër element i rëndësishëm, i cili buron nga neni 6.2, është çështja e përfaqësimit të komuniteteve në Komision (neni 6.2.5). Për të siguruar përfaqësimin e komuniteteve në këtë mekanizëm, hartuesit e ligjit kanë përcaktuar nevojën e pjesëmarrjes së përfaqësuesit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, organ kushtetues i cili, në bazë të nenit 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete] të Kushtetutës[95], vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës. Çështja e komuniteteve është e rëndësishme, pasi, në bazë të nenit 114.3 të Kushtetutës, vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e Gjykatës merret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, por vetëm me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Së fundi, një përfaqësues i Gjykatës Kushtetuese është anëtar i Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për listën e kandidatëve të kualifikuar, që do t'i paraqiten Kuvendit (neni 6.2.6). Duhet theksuar se, me rastin e themelimit të Gjykatës, kur janë zgjedhur gjashtë (6) gjyqtarë kosovarë për herë të parë në pajtim me nenin 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese], ky vend ka qenë vakant. Por, në kuadër të procesit për përzgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve të Gjykatës për të zëvendësuar gjyqtarët që kanë shërbyer për një periudhë 3-vjeçare pa mundësi të rizgjedhjes, në punimet e Komisionit të veçantë mori pjesë Kryetari i Gjykatës.

Për sa i përket nenit 6.3, hartuesit e kanë zgjedhur Kryetarin e Kuvendit që të thërrasë dhe të kryesojë Komisionin si Kryetar i saj dhe, nëse mungon, të përfaqësohet nga përfaqësuesi i tij/saj. Formulimi i nenit 6.3, fjalia e dytë, është bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, e cila, në nenin 69 [Komisionet kryesore dhe komisionet funksionale], paragrafi 8, siguron që "secili komision do të ketë dy nënkryetarë, kryesuesin e parë dhe kryesuesin e dytë, të cilët u përkasin grupeve të ndryshme parlamentare. Të paktën një nga zëvendëskryetarët duhet të jetë i një komuniteti tjetër

---

propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve. 4. Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për

emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. 5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe jep rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj.

[94] Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton se "individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[95] Neni 60 para. 1 i Kushtetutës përcakton "Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet".

nga kryesuesi". Megjithatë, neni 6.3 i Ligjit nuk jep asnjë detaj në lidhje me sistemin e emërimit të zëvendëskryetarit, mirëpo, lidhur me këtë çështje mund të zbatohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, në qoftë se bëhet i nevojshëm emërimi i zëvendëskryetarit të Komisionit të veçantë

Nuk është e qartë nga teksti në nenin 6.4 nëse shumica e thjeshtë e votave do të thotë një shumicë e thjeshtë e votave të të gjithë anëtarëve ose një shumicë e thjeshtë e votave të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë. Meqë zgjedhja e kandidatit për listën e ngushtë të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ishte aktuale, do të ishte e pritshme që hartuesit të kishin qenë më të saktë në këtë drejtim. Për të njëjtën arsye, mund të ngrihet çështja nëse do të ishte e përshtatshme që, në rast të një barazimi, vota e Kryetarit të Kuvendit do të konsiderohej vendimtare. Në një situatë të tillë, kur çështja ka të bëjë me kandidaturën për një pozitë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, do të ishte më e përshtatshme për të konsideruar se kandidati në fjalë nuk ka kaluar testin dhe nuk duhet të vihet në listën e ngushtë.

Me sa duket, neni 6.5 i lë anëtarit në fjalë për të vendosur nëse do të diskualifikonte veten nga pjesëmarrja në Komision kur ai/ajo pretendon se ka një konflikt interesi në lidhje me një kandidaturë të veçantë. Për shembull, kryetari ose anëtari tjetër i Komisionit mund të jetë vëllai i njërit prej kandidatëve. Kështu, për të shmangur çfarëdo dyshimi se mendimi i një anëtari në fjalë mund të ketë qenë i ndikuar nga ndonjë marrëdhënie ose ndonjë interes i veçantë për një kandidat të caktuar, anëtari i Komisionit nuk duhet të marrë pjesë në asnjë procedurë lidhur me atë kandidat.

Dispozita është e ngjashme me nenin 18 [Përjashtimi i gjyqtarit], paragrafi 5 i ligjit, i cili përcakton se: "Çdo gjyqtar që është i vetëdijshëm se plotëson të paktën një nga kushtet për përjashtim nga procedurat, duhet të informojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim dhe duhet të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga punimet. [...]. Nenit 6.5, megjithatë, i mungon mundësia që anëtari, në raste konflikti të interesit, të hiqet nga Komisioni.[96] Megjithatë, vetë ekzistenca e dispozitës e bën vështirë të kontestuar ndershmërinë e procesit. Gjithashtu, Kodi i Etikës dhe i Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë përmban një nen të ngjashëm. Sipas këtij Kodi, “nëse, për ndonjë arsye, gjyqtari e ndien se nuk është në gjendje të veprojë në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mësipërmetë këtij seksioni, ai/ajo duhet të ndërmarrë veprim të menjëhershëm duke përfshirë edhe heqjen dorë nga rasti, dhe t’i kërkojë Kryetarit të Gjykatës ku ai/ajo shërben, ta përjashtojë nga rasti. Nëse gjyqtari gjendet në një situatë të tillë, që të vërë në pikëpyetje pavarësinë e tij/saj, atëherë ai/ajo është i/e detyruar që palëve të përfshira t’ua bëjë të ditura faktet në lidhje me situatën dhe t’i informojë ata për përjashtimin e tij/të saj të mundshëm”.[97]

Neni 6.6 përcakton mënyrën se si do të zhvillohet procedura për përcaktimin e listës së kandidatëve për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni është i detyruar të publikojë dhe të shpërndajë thirrjen/ftesën sa më gjerë të jetë e mundur, në veçanti, në institucionet e përmendura, edhe pse lista nuk mund të jetë shteruese. Kjo jep më shumë besueshmëri në drejtim të procedurës së përzgjedhjes dhe rrit besueshmërinë e

[96] Neni 18, i cili do të komentohet në tekstin vijues, rregullon gjithashtu procedurën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës nga procedura (shih Komentet lidhur me nenin 18).

[97] Kodi i Sjelljes dhe i Etikës Profesionale për Gjyqtarë u miratua në vitin 2006 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe është në dispozicion në: http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/kodi%20i%20etikes%20dhe%20sjelljes%20profesionale%20per%20gjyqtar.pdf

zgjedhjes, që nga organizatat përkatëse pritet të emërojnë kandidatët e tyre më të mirë për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo formë e shpërndarjes së ftesës publike ofron gjithashtu më shumë konkurrencë të bazuar në merita e profesionalizëm dhe mundëson përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm për këtë post të rëndësishëm.

Legjislatura ka përcaktuar gjithashtu se edhe një individ mund ta propozojë veten si kandidat. Megjithatë, në mënyrë që aplikantit individual t'i ofrohet një shans i mirë dhe i barabartë, është e pritshme që Komisioni të trajtojë kërkesën e tij/saj në të njëjtën mënyrë, njësoj me kandidatët e propozuar nga një ose më shumë institucione të mësipërme.[98]

Për sa i përket afatit për t'i propozuar Komisionit të veçantë një kandidat, neni nuk është i saktë lidhur me çështjen nëse kandidaturat duhet të pranohen nga Komisioni më së voni në ditën e 20-të pasi të jetë publikuar ftesa/thirrja publike, apo nëse kandidatura do të konsiderohet e pranuar në mënyrë të vlefshme, edhe pasi të ketë skaduar afati, nëse ajo do të mbante vulën e ditës së 20-të. Zgjidhja e fundit duket të jetë më e drejtë, pasi teksti i nenit përmend afatin e fundit për propozimin e një kandidati dhe jo afatin për marrjen e propozimit. Në lidhje me këtë, mund të shfrytëzohet Rregulla 27 [Llogaritja e afateve] e Rregullores së Punës, e cila përcakton se në cilën mënyrë do të llogaritet një periudhë kohore e përcaktuar me Kushtetutë, Ligj apo Rregullore të Punës nga ana e Gjykatës.[99]

Meqë, sipas nenit, kriteret e përmendura në Kushtetutë dhe Ligj përcaktojnë gjithashtu natyrën e dokumenteve përcjellëse, të cilat dorëzohen së bashku me propozimin, Komisioni nuk duket të jetë i autorizuar të kërkojë më shumë dokumente përcjellëse ose dokumente përcjellëse të tjera.

Pasi të ketë kaluar afati, kandidaturat e kandidatëve që nuk i kanë plotësuar kushtet për t'u zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të përmendura në nenin 6.7, për shembull, për shkak se nuk i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet përcjellëse të kërkuara, apo kandidatura e tij/saj nuk i është propozuar Komisionit brenda afateve të përmendura në nenin 6.7 (siç interpretohet më lart), mund të refuzohet vetëm nga Komisioni si e pavlefshme. Në raste dyshimi, Komisioni nuk duket të ketë kompetenca për t'i kërkuar secilit kandidat informacione ose dokumentacione shtesë.

Neni më tej parashikon që Komisioni, kur është duke vlerësuar nëse një kandidat i plotëson kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj, duhet të zbatojë edhe praktika të ngjashme, të cilat zhvillohen për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta. Praktika të tilla janë zhvilluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe përcaktohen në Rregulloren për procedurën e për emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK-ja. Praktikat e zhvilluara për gjyqtarët e rëndomtë mund të shërbejnë si shembull edhe për rekrutimin e gjyqtarëve kushtetues. Neni 7 i Rregullores së KGJK-së për emërimin e gjyqtarëve, për shembull, përcakton që nga "kandidatët mund të kërkohet të shkruajnë një ese si pjesë e procesit të intervistës, ku natyra e pyetjeve, të cilat mund të përdoren gjatë intervistës, dhe punimi me shkrim duhet të disenjohen për të nxjerrë informacione që janë relevante me kriteret për

[98] Shih Ligjin Nr. 03/L-121. Neni 6 para. 6.
[99] Shih komentet në Rregullin 27.

emërim”.[100] Shkrimi i eseve nga kandidatët që pretendojnë të bëhen anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, në këtë mënyrë mund të bazohet në praktika të KGJK-së dhe në Rregulloren përkatëse për emërimin e gjyqtarëve.

Pasi të konstatojë Komisioni se një kandidat përmbush kushtet e parapara, do të vazhdojë procesin e intervistimit të kandidatit. Intervista është një instrument i rëndësishëm, që i mundëson Komisionit të njihet me profilin e kandidatëve, të cilëve, në këtë mënyrë, u është dhënë mundësia për të dhënë më tepër detaje lidhur me përvojën e tyre profesionale e arsimore dhe për të sqaruar arsyet pse konsiderojnë se janë të kualifikuar për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni mund të kërkojë nga kandidatët që të paraqesin dokumente shtesë ose mund të kërkojë sqarime shtesë, të cilat konsiderohet se mund të jenë të rëndësishme për procesin e vendimmarrjes, nëse një kandidat kualifikohet ose jo për ta përfshirë në listën e ngushtë, në veçanti, në lidhje me detyrimin e Komisionit sipas nenit 6 (12) të Ligjit (shih më poshtë), përkitazi me detyrimin për të arsyetuar vendimin e tij.

Edhe pse neni vë në dukje vetëm që Komisioni do të zhvillojë intervista me kandidatët, me siguri mund të zbatojë edhe instrumente të tjera për të testuar njohuritë dhe përvojën e kandidatëve në tërësi, për shembull, teste shtesë me shkrim apo ndonjë intervistë të mëtejshme. Nuk ka dyshim se autoriteti i Komisionit për ta ushtruar këtë funksion buron nga neni 6.6, duke përcaktuar se "procedura për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve", siç është komentuar më sipër. Intervista është gjithashtu pjesë e procesit të emërimit të gjyqtarëve të rregullt sipas Rregullores së KGJK-së për emërimin e gjyqtarëve. Për shembull, Rregullorja mandaton KGJK-në për të zhvilluar një qasje të qëndrueshme metodologjike për intervistimin e kandidatëve. Rregullorja parasheh që "pyetjet e bëra gjatë intervistës do të jenë standarde për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të njëjtën pozitë”.[101]

Kur Komisioni paraqet listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar, duhet të sigurojë që lista përfshin të paktën më shumë kandidatë sesa numri i vendeve të lira, po jo më shumë se pesë (5) për çdo vend të lirë. Kjo do të thotë që, në qoftë se, për shembull, duhet të emërohen dy gjyqtarë të rinj, Komisioni duhet që të përfshijë së paku më shumë se dy (2) apo (4) kandidatë në listë, po jo më shumë se dhjetë (10). Arsyeja pse numri i kandidatëve tejkalon numrin e vendeve të lira të shpallura për pozitën e gjyqtarit kushtetues, është thjesht për t’i mundësuar Kuvendit që të ketë një zgjedhje më të gjerë në kuadër të listës së kandidatëve të kualifikuar, të paraqitur nga Komisioni. Nëse Kuvendi pamundësohet për të zgjedhur në mes kandidatëve të propozuar në mënyrën që është parashtruar në nenin 6, paragr. 10 të Ligjit, kjo mund të çojë në një situatë ku Kuvendi potencialisht do të refuzojë kandidatët që i ka propozuar Komision, një situatë kjo që privon Kuvendin nga mundësia për të shkarkuar kompetencat kushtetuese. Praktika aktuale në Kuvend deri tani ka qenë që, në raste kur vetëm dy kandidatë në raundin e parë kanë vazhduar në raundin e dytë (ballotage) dhe nuk arrihet shumica e kërkuar e dy të tretave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, Kuvendi i Kosovës ka urdhëruar përsëritjen e konkursit për atë pozitë. Megjithatë, neni 6.10 i Ligjit nuk duket të jetë një pengesë në mënyrë që anëtarët e

[100] Rregullorja për procedurën lidhur me propozimin për emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, Neni 7 paragrafi 5. Kjo Rregullore mund të kërkohet në ueb faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës http://www.kgjk-ks.org.

[101] Ibid. Neni 7.

Kuvendit të vazhdojnë me kandidatin që ka marrë numrin më të madh të votave pas një votimi të dytë jopërcaktues, për të vendosur në mes të dy kandidatëve. Në këtë mënyrë, Kuvendi do të jetë në gjendje për të shmangur vonesa të gjata në procesin e emërimit të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.

Me sa duket, hartuesit kanë kërkuar që Komisioni të jetë plotësisht transparent për zgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar, që përfshihen në listën e ngushtë, duke kërkuar që së bashku me listën të paraqitet edhe lista e të gjithë kandidatëve që kanë plotësuar kushtet për t'u zgjedhur gjyqtarë të Gjykatës. Megjithatë, do të ishte më transparente në rast se Komisioni do të kishte qenë i detyruar që në listën e ngushtë të paraqiste jo vetëm të dhënat e paraqitura dhe rezultatet e intervistimit të kandidatëve të kualifikuar, por edhe të dhënat dhe rezultatet e intervistimit të kandidatëve, të cilët ishin në përputhje me kushtet e që nuk kanë arritur të përfshihen në listën e ngushtë. Komisioni do ta bënte këtë me siguri, nëse do të ishte kërkuar nga Kuvendi, por do të ishte më e preferueshme nëse Ligji të kishte përcaktuar një zgjidhje të tillë.

Për ta bërë procedurën e përzgjedhjes për listën e ngushtë edhe më transparente, hartuesit kërkuan që Komisioni të arsyetonte përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar duke detyruar Komisionin për të treguar për secilin kandidat të kualifikuar, arsyet pse i kanë dhënë përparësi një kandidati ndaj kandidatit tjetër. Nuk është e mjaftueshme për qëllime të vlerësimit që vetëm për të poentuar kandidatët dhe mbështetur në poentim të hartohet listë e ngushtë e cila më pas i paraqitet Kuvendit për votim. Ligji kërkon që Komisioni të ofrojë arsyet në formë të shkruar, për të elaboruar për se kandidatët e propozuara janë kandidatë të preferuar për votim në Kuvend. Arsyet që duhet të ofrohen, përfshijnë kritere të arsimit, kualifikimit profesional, reputacionit moral dhe kualifikimeve të tjera relevante që janë të rëndësishme të merren parasysh gjatë votimit nga anëtarët e Kuvendit, po nuk kufizohen vetëm në këto.

Kandidatët që kanë përmbushur kushtet, po nuk janë përfshirë si kandidatë të kualifikuar në listë të ngushtë, mund të njihen me arsyet për mospërfshirjen e tyre. Natyrisht, kjo paraqet një lloj mundësie për t’u njohur me vlerësimin se pse, në mungesë të ndonjë mekanizmi të ankimimit, ata nuk do të jenë në gjendje të bëjnë më tepër lidhur me vlerësimin e dhënë.

Neni 7 [Emërimi dhe fillimi i mandatit]

7.1 Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri, sipas këtij ligji, fillon të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak.

7.2 Mandati i gjyqtarit të ri fillon në ditën kur përfundon mandati i gjyqtarit paraprak. Gjyqtari i ri emërohet nga Presidenti dhe e jep betimin para Presidentit para fillimit të mandatit të tij. Në rast se mandati i gjyqtarit përfundon sipas nenit 8 të këtij ligji mandati i gjyqtarit zëvendësues fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.

7.3 Përjashtimisht prej paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, mandati i gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.

7.4 Teksti i betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është si vijon:
“Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës do t'i qëndroj besnik Kushtetutës së

Republikës së Kosovës dhe do të ushtroj funksionin e gjyqtarit me nder, përgjegjësi dhe paanshmëri, duke e respektuar rregullat e etikës profesionale".

Mund të supozohet se ky nen merret vetëm me emërimin e gjyqtarit të ri nga Presidenti, i cili tashmë është zgjedhur nga Kuvendi. Dispozita trajton dy aspekte të ndryshme, të cilat janë shumë të rëndësishme për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese: (1) fillimin e procedurës së emërimit të gjyqtarit të ri nga Presidenti; dhe (2) fillimin e mandatit të gjyqtarit të ri të emëruar. Parë nga ky këndvështrim, është e qartë se fillimi i procedurës së emërimit nuk mund të korrespondojë me fillimin e mandatit të gjyqtarit të ri.

Sipas nenit 7 paragr. 1 të Ligjit, procedura për emërimin e gjyqtarit të ri duhet të fillojë të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak. Në pajtim me këtë, tre (3) muaj para mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës duhet të informojë Kuvendin e Kosovës që të fillojë procedurën për zgjedhjen e gjyqtarit të ri. Pa dyshim se qëllimi i legjislatorit për sa i takon paragrafit 1 të këtij neni, është parandalimi i situatës kur Gjykata Kushtetuese të mos jetë në gjendje të funksionojë me staf të plotë. Është e qartë se neni 7 ka për qëllim vazhdimësinë e punës së Gjykatës Kushtetuese në rastin e mbarimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit të paraparë me nenin 8.1.1.

Neni 7.1 nuk zbatohet me rastin e përfundimit paraprak të mandatit të gjyqtarit, të përcaktuar në nenin 9 [mbarimi i mandatit para kohe], i cili do të komentohet më poshtë, për arsye se ndërprerja e parakohshme e mandatit të gjyqtarit të përmendur në këtë nen, nuk mund të parashikohet ndryshe nga skadimi i rregullt i mandatit.

Edhe pse Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar një sistem të ndarjes së pushteteve midis Parlamentit dhe Presidentit për sa i takon zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, ky sistem i zgjedhjes nuk bën të devijojë deri në atë masë sa të rrezikojë funksionimin e duhur të Gjykatës Kushtetuese, një organ gjyqësor, roli i të cilit është mjaft i dobishëm për të siguruar sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Në kohën e shkrimit të këtij Komentari janë bërë dy vite që kur Gjykata Kushtetuese është duke funksionuar me vetëm tetë gjyqtarë. Problemi që mund të lindë në këtë situatë (kjo ka ndodhur në vende të tjera me një sistem të ngjashëm emërimi të tillë si Shqipëria) është kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë gjyqtarët kushtetues duke përfunduar në situata ku zgjedhjet e gjyqtarëve kushtetuese të mos bëhen me kohë. Por funksionimi i Gjykatës Kushtetuese me vetëm tetë gjyqtarë "mund të përbëjë një sfidë për të siguruar kuorumin prej shtatë gjyqtarëve".[102] Ka pasur tri përpjekje të përsëritura nga ana e Kuvendit për të emëruar gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por asnjëri prej tyre nuk qenë të suksesshme. Natyrisht që nuk ekziston ndonjë instrument kushtetues për të detyruar Kuvendin që të vendosë për kandidatin apo kandidatët e propozuar "pasi nuk ka ndonjë sanksion të tillë në panoramën evropiane".[103] Është po ashtu e qartë se dy të tretat e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, nuk janë lehtë të arritshme në mungesë të një konsensusi politik, i cili shumë herë nuk është siguruar. Një zgjidhje për këtë

[102] Shih raportin e progresit të BE-së për Kosovën (2013). Ky dokument mund të kërkohet në http://ec.europa.eu/ enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf.

[103] Kelemen, Katalin. "Appointment of constitutional judges in a comparative perspective—with a proposal for a new model for Hungary". *Acta Juridica Hungarica* 54.1 (2013): 5-23

problem do të ishte, siç sugjeron Kemelen, të zbatohet institucioni i shtyrjes (*prorogation*) – që paraqet një rregull që gjykatësit do të mbeten në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tyre. Megjithatë, ky institucion mund të zbatohet në Kosovë vetëm me ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili përcakton që mandati i gjyqtarit përfundon kur mbaron mandati i rregullt për të cilin ai/ajo është zgjedhur.

Për sa i përket fillimit të mandatit të gjyqtarit të ri, gjuha e përdorur në këtë nen është e qartë: mandati fillon në datë të caktuar, d.m.th. në ditën kur skadon mandati i gjyqtarit të mëparshëm, pasi gjyqtari i ri të jetë emëruar dhe të ketë dhënë betimin para Presidentit. Kjo është ajo që ndodh në situata normale, që do të thotë, kur nuk ndodh asgjë e jashtëzakonshme që do të mund të shkurtonte periudhën e rregullt për të cilën është zgjedhur gjyqtari. Megjithatë, nëse mandati i gjyqtarit përfundon para kohe, sipas nenit 8.1.2 (shih komentet për këtë në pjesën vijuese të komentarit), mandati i gjyqtarit të zëvendësuar nuk do të fillojë në ditën e mbarimit të parakohshëm të mandatit të gjyqtarit të zëvendësuar, por vetëm në ditën që gjyqtari i ri është emëruar nga Presidenti dhe ka dhënën betimin para tij / saj.

Në mungesë të dispozitave të veçanta, që kanë të bëjnë me procedurën e zëvendësimit të gjyqtarit, mandati i të cilit përfundon para kohe, në pajtim me nenin 8.1.2, duhet të kuptohet se duhet të ndiqet procedura normale për emërimin e gjyqtarëve të përcaktuar në nenin 6. Gjyqtari i zëvendësuar, në këtë rast, do të fillojë mandatin e tij dhe nuk do të përfundojë mandatin e gjyqtarit të larguar. Ky nuk është rasti në Shqipëri, ku në nenin 9 [mbarimi i mandatit], paragr. 3 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, është përcaktuar që "në qoftë se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, brenda një muaji emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar".[104] Kështu gjyqtari i ri vazhdon mandatin e gjyqtarit të larguar derisa të përfundojë. Nuk është e qartë nëse, në këto rrethana, gjyqtari i ri mund të rizgjidhet për një mandat të plotë pasi të ketë përfunduar mandatin e gjyqtarit të larguar.

Ky nen është menduar të aplikohet vetëm me rastin e emërimit të gjashtë (6) gjyqtarëve të parë kosovarë të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse krijon përshtypjen se ka të bëjë me "të gjithë" gjyqtarët e parë. Në fakt, kjo dispozitë kalimtare ka zbatuar ish-nenin 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kapitullit XIV Dispozitat kalimtare të Kushtetutës, e cila, në paragrafin 1 përcaktonte se "gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët, do të jenë të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozim të Kuvendit".[105]

Kështu, procedura e përcaktuar në nenin 6 të Ligjit është ndjekur në mënyrë që të zgjedhën gjashtë (6) gjyqtarët mandati i të cilëve filloi në ditën, kur u emëruan dhe dhanë betimin para Presidentit të Kosovës. Megjithatë, edhe pse mandati i gjyqtarëve të Kosovës filloi të njëjtën ditë, ai nuk mbaroi të njëjtën ditë, siç do të diskutohet më tutje, në bazë të nenit 8 [Ndërprerja e mandatit].

Përveç gjashtë (6) gjyqtarëve kosovarë, në bazë të ish-nenit 152.4 të Kushtetutës, "tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj". Për më

[104] Shih nenin 9 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, No.8577 të 2000/10/02.

[105] Shiko për hollësi të mëtejshme në lidhje me mandatin e gjashtë gjyqtarëve ish-nenin 152 të Kushtetutës.

tepër, neni 154.5 i Kushtetutës rregullonte edhe kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, duke përcaktuar: "Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikurse është parashikuar me Kushtetutën".

Pas procesit të përzgjedhjes, detajet e të cilit janë botuar në një konkurs nga Zyra Civile Ndërkombëtare, tre gjyqtarë ndërkombëtarë, të nacionalitetit amerikan, bullgar dhe portugez, janë emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe kanë dhënë betimin para Presidentit të Kosovës. Arsyet për të pasur gjyqtarë ndërkombëtarë në Gjykatë, kanë qenë të dyfishta. Së pari, kjo paraqet refleksion të "modelit të sundimit të ligjit të promovuar në Kosovë që nga fillimi i misionit të OKB-së në vitin 1999, përmes tranzicionit në EULEX", që është "natyrshëm një model ndërkombëtar".[106] Së dyti, përbërja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës reflektonte edhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Ky dokument i dha një konfigurim të tillë Gjykatës, duke përcaktuar praninë e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë për tu vendosur në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Edhe pse as Kushtetuta dhe as Ligji nuk përcaktojnë në mënyrë shprehimore që gjyqtarët ndërkombëtarë duhet të japin betimin para Presidentit, pasi Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar të ketë bërë emërimin e tyre, gjyqtarët ndërkombëtarë kanë vepruar kështu, megjithëse në data të ndryshme.[107] Anëtarët kosovarë të Gjykatës Kushtetuese kishin dhënë betimin para Presidentit të Kosovës në një datë më të hershme. Dhënia e betimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese para autoritetit emërues (në këtë rast Presidenti) është një praktikë e përhapur në vendet fqinje. Për shembull, në Shqipëri[108] dhe Kroaci[109], Presidenti i emëron gjyqtarët e gjykatës kushtetuese, të cilët japin betimin para tij/saj, ndërsa në Slloveni[110] gjyqtarët zgjidhen nga Kuvendi dhe japin betimin para Kuvendit.

Një shembull interesant në hapësirën kushtetuese evropiane gjejmë në Tribunalin Kushtetues të Polonisë, ku Ligji për juridiksionin dhe organizimin e Tribunalit kushtetues të vitit 1997 jo vetëm përcakton dhënien e betimit para fillimit të mandatit duke deklaruar se, me rastin e ushtrimit të detyrave, ai/ajo do ti shërbejë me sinqeritet popullit polak, do të mbrojë Kushtetutën dhe do te ushtrojë të gjitha detyrat në mënyrë të pavarur, por refuzimi për të dhënë betimin, është ekuivalent me ofrimin e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit të Tribunalit.[111]

Duhet thënë pak fjalë në lidhje me kuptimin e termit shprehjes "duke respektuar rregullat e etikës profesionale", në fund të betimit. Pasi këto fjalë nuk gjenden askund në Kushtetutë, në Ligj apo në Rregulloren e Punës, shtrohet pyetja: Cili është kuptimi i tyre? A i referohen ato etikës profesionale në përgjithësi, apo i referohen etikës

---

[106] Zurn, Michael, Nollkaemper, Andre and Peerenboom, Randy. *Rule of Law Dynamics: In an Era of International and Transnational Governance.* Cambridge University Press: 2012, f.276.

[107] Gjyqtarët janë të detyruar gjithashtu që të ruajnë fshehtësinë e diskutimeve në Gjykatë, edhe pse kjo kërkesë nuk përcaktohet shprehimisht në nenin 7 (4). Në bazë të Rregullës 44 të Rregullores së Punës, këshillimet e Gjykatës nuk janë të hapura për publikun dhe mbeten konfidenciale.

[108] Neni 8 [Fillimi i mandatit], paragrafi 1, i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

[109] Neni 8 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë.

[110] Nenet 14 e 15 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr 64/07.

[111] Neni 5 i Ligjit për Juridiksionin dhe Organizimin e Tribunalit Kushtetues të Republikës së Polonisë, miratuar më 1997.

profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për të cilët shkalla e etikës profesionale duhet të jetë akoma më e lartë?
Çfarëdo që mund të kenë patur për qëllim hartuesit, Neni 12 [Funksionet e Presidentit] përmend në paragrafin 1 të tij (g), se [Presidenti] "do të sigurojë pajtueshmërinë me Kodin e Sjelljes dhe do të mbajë rendin në mjediset dhe gjatë procedurës së Gjykatës". Kjo mund të interpretohet vetëm për të treguar nevojën për miratimin e një Kodi të Sjelljes, të cilin Gjykata Kushtetuese e bëri më 19 qershor 2013, në mënyrë që të plotësonte nevojën për një shpjegim të fjalëve të mësipërme "duke respektuar rregullat e etikës profesionale". Kodi i Sjelljes përmban parimet themelore në mënyrë që të "mbrojë dhe të ngrejë besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e Gjykatës, dhe për t'u ofruar udhëzime gjyqtarëve në ushtrimin e përgjegjësive të tyre".[112]

Neni 8 [Përfundimi i mandatit]

8.1 Mandati i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përfundon me:
1.1 skadimin e kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur;
1.2 ndërprerjen e mandatit para kohe sipas nenit 9 të këtij ligji.
8.2 Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës me qëllim që të filloj procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri.

Skadimi i mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të shihet nga dy këndvështrime: skadimi i rregullt i mandatit të gjyqtarit dhe (2) skadimi i mandatit para periudhës së rregullt për të cilën është zgjedhur një gjyqtar. Për sa i përket mbarimit të rregullt të mandatit të gjyqtarit, nuk është e nevojshme asnjë ndërhyrje nga asnjë organ apo autoritet publik, pasi skadimi është i vetëzbatueshëm. Pra, as edhe një deklaratë apo vendim i Gjykatës nuk është i nevojshëm. Megjithatë, në raste të mbarimit të parakohshëm të mandatit të një gjyqtari për arsyet e parashikuara në nenin 9 të Ligjit [Përfundimi i mandatit para kohe], mbarimi i mandatit shkaktohet në rast vdekjeje (neni 9.1.1) ose dorëheqjeje (neni 9.1.2), ose (2) nëse kërkohet nga organi publik: gjykata e rregullt (neni 9.1.3), vetë Gjykata (neni 9.1.4) ose Presidenti i Kosovës (neni 9.1.5) (Shih për detaje të mëtejshme komentet për nenin 9).
Siç u përmend më parë, as Ligji dhe as Rregullorja e Punës nuk përmendin periudhën e rregullt për të cilën zgjedhen gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Vetëm Neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 2 i Kushtetutës përcakton: "*Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi*". Megjithatë, situata në Shqipëri është e ndryshme nga ajo në Kosovë, sepse, në bazë të nenit 7 [Përbërja e Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 2 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese: "gjyqtarët emërohen për nëntë vjet pa të drejtë riemërimi [...]. Në Slloveni dhe Kroaci, ngjashëm si në Kosovë gjithashtu mandati i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk është përcaktuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese po në

[112] Kodi i Mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese mund të kërkohet në http://gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_kodi_i_miresjelljes_per_gjyqtare_ang.pdf.

Kushtetutë[113] dhe, në këtë mënyrë, mund të ndryshohet vetëm me 2/3 e votave të Kuvendit. Është me rëndësi që kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarëve kushtetues të përcaktohet me Kushtetutë. Një përcaktim i tillë kushtetues siguron një mbrojtje dhe pavarësi më të lartë për gjyqtarët, sepse normat kushtetuese është shumë më e vështirë të ndryshohen. Në këtë mënyrë Kuvendi do ta ketë më të vështirë për të zvogëluar kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarëve kushtetues nëpërmjet masave legjislative.

Megjithatë, për gjyqtarët e parë kosovarë të Gjykatës Kushtetuese (gjyqtarët e periudhës fillestare) periudha e rregullt e mandatit nuk është e njëjtë për të gjithë, siç përcaktohet në nenin 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] që përcaktonte se "*Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet si në vijim: 1. Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit. 2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre".*

Siç argumenton Steinberger "nëse Gjykata Kushtetuese themelohet për herë të parë, për të njëjtën arsye mandati i gjyqtarëve të parë nuk duhet të jetë i barabartë, në kuptim të kohëzgjatjes; gjyqtarët duhen ndarë në disa grupe, një grup që shërben për një mandat të plotë, një grup për një mandat prej 2/3 të mandatit të plotë dhe një grup për një mandat prej 1/3 të mandatit të plotë, me qëllim të ripërtëritjes së gjykatës pas periudhave të caktuara".[114]

Për sa i përket mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, neni 152.5 i Kushtetutës ka specifikuar: "Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikurse është parashikuar me Kushtetutë.". Në shtator 2009, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) ka emëruar tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë për një periudhë prej 3 vjetësh dhe ka vazhduar mandatin e tyre për dy vjet të tjerë, pra deri në vitin 2014, kur mandati i gjyqtarëve ndërkombëtar pritej të mbaronte.[115] Megjithatë, mandati i gjyqtarëve ndërkombëtar u vazhdua nga Presidentja në bazë të nenit 84 para. 4 të Kushtetutes, të nenit 2 të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e BE për Sundim të Ligjit në Kosovë (04/L-274)

[113] Neni 165 i Kushtetutës sllovene përcakton: (1) Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen për një mandat prej nëntë vjetësh. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të rizgjidhen. (2) Pas skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ai vazhdon të kryejë detyrën e tij deri në zgjedhjen e një gjyqtari të ri. Kushtetuta e Kroacisë, në nenin 125, përcakton: (1) Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë do të përbëhet nga trembëdhjetë gjyqtarë të zgjedhur nga Parlamenti Kroat për një mandat prej tetë vjetësh nga radhët e juristëve të shquar, veçanërisht gjyqtarëve, prokurorëve publikë, avokatëve dhe profesorëve universitarë të së drejtës. (2) Procedura e kandidimit dhe propozimit për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë në Parlamentin Kroat do të zhvillohet nga komisioni i Parlamentit të Kroacisë i autorizuar për çështje kushtetuese. (3) Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë do të zgjedhë Kryetarin e saj për një mandat katërvjeçar.

[114] Steinberger (supra note 33).

[115] Shih më shumë lidhur me shtyrjen e mundshme të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës https://www.gazetaexpress.com/lajme/gjyqtaret-e-huaj-ne-pako-per-sundim-ligji-792/

dhe, në përputhje me përmbajtjen e Letrës nr. 693, të 25 gushtit 2014, nga Shefi i Misionit EULEX drejtuar Presidentes. Dekreti presidencial për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar u kontestua nga Avokati i Popullit me pretendimin se dekreti i Presidentes është në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese pasi për vazhdimin e mandatit nuk ishte siguruar propozimi nga Kuvendi i Kosovës. Në vendimin e saj nr. KO155-14 Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën si të pabazuar duke pretenduar se dekreti i referohej vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, tashmë të emëruar dhe jo gjyqtarëve të rinjë vendor. Ndonëse nevoja për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar mund të konsiderohet akoma e justifikuar, përzgjedhja e procedurës për zgjatjen e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar duhet të mbështetet tërësisht në norma të zbatueshme kushtetuese të cilat në secilin rast, sipas Kushtetutës së Kosovës, prevalojnë ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Mund të thuhet se pas shfuqizimit të nenit 152 të Kushtetutës së Kosovës, si një dispozitë kalimtare, vazhdimi i mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar do të mund të ishte bërë vetëm në bazë të nje aprovimi parlamentar të amendamenteve kushtetuese në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë.

Është e rëndësishme që veprimet për plotësimin e vendit të zbrazët të fillojnë paraprakisht, në mënyrë që përzgjedhja e kandidatit të finalizohet në kohën e paraqitjes së nevojës për vendin vakant. Legjislatura, pra, ka caktuar dy momente për marrjen e masave procedurale në lidhje me procesin e përzgjedhjes: (1) fillimin e procedurës për propozimin e gjyqtarit të ri sipas nenit 8.2 dhe (2) fillimin e procedurës për emërimin e gjyqtarit të ri (neni 7.1). Këto dispozita ligjore janë një ilustrim i shkëlqyer i qëllimit të legjislativit për të bërë emërimet gjyqësore në kohën e duhur dhe për të shmangur vonesat e panevojshme kur skadon mandati i rregullt i gjyqtarit kushtetues.

Në Rumani, për shembull, gjyqtari i ri duhet të caktohet të paktën një muaj para mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraprak.[116] Në Hungari, sipas nenit 8.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjyqtari i ri duhet të zgjidhet të paktën tre muaj para mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraprak. Kroacia ka të njëjtën procedurë si në Kosovë, ndërsa në Shqipëri gjyqtari, mandati i të cilit ka ardhur në fund, mund të qëndrojë në detyrë derisa të caktohet gjyqtari i ri.[117] Ndoshta për këtë arsye, ligji shqiptar nuk përmend ndonjë datë për fillimin e procedurës së zëvendësimit, për shkak se gjyqtari që do të zëvendësohet, mund të vazhdojë të shërbejë derisa të emërohet gjyqtari i ri. Duhet të theksohet se gjyqtari të cilit i ka skaduar mandati i tij/saj, duhet të ndërprejë menjëherë shërbimin në Gjykatë dhe atij/asaj nuk i lejohet të presë derisa të bëhet zëvendësimi me një gjyqtar të ri. Në Kosovë gjyqtarët kushtetues emërohen me dekret presidencial, i cili përcakton mandatin brenda të cilit gjyqtari duhet të shërbejë në Gjykatën Kushtetuese. Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton po ashtu që mandati i gjyqtarit kushtetues përfundon me skadimin e kohës së rregullt, për të cilën është zgjedhur gjyqtari.

[116] Në mbështetje të nenit 68 "tre muaj para skadimit të mandatit të ndonjë prej gjyqtarëve, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese do të njoftojë Presidentin e Dhomës së Parlamentit të cilin e ka caktuar gjykatësin përkatës ose, siç mund të jetë rasti, Presidenti i Rumanisë, duke bërë thirrje për emërimin e një tjetri; Emërimi duhet të bëhet të paktën një muaj para përfundimit të mandatit të mbajtur nga gjyqtari i mëparshëm".

[117] Neni 9 (2) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë.

Neni 9 [Përfundimi i mandatit para kohe]

9.1 Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të:
1.1 dorëheqjes;
1.2 vdekjes;
1.3 humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
1.4 sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
1.5 shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës.

9.2 Përfundimi i mandatit sipas pikës 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni duhet të bazohet në vendimin e marrë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese pas shqyrtimit të të gjitha analizave dhe konstatimeve relevante mjekësore. Miratimi i vendimi sipas nenit në fjalë kërkon 2/3 e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të gjyqtarit mandati i të cilit është nën shqyrtim.

Neni rendit një listë të gjerë të situatave, në të cilat mandati i gjyqtarit përfundon para skadimit të periudhës së rregullt, për të cilën është zgjedhur gjyqtari përkatës. Këto situata janë si më poshtë:
Dorëheqja është një akt formal i heqjes dorë nga pozita. Kështu, kur, për shembull, një gjyqtarë i gjykatës kushtetuese jep dorëheqjen, ai/ajo zgjedh të largohet nga posti i tij/saj në gjykatë, vullnetarisht. Neni, megjithatë, nuk jep ndonjë detaj lidhur me formalitetet e mundshme të aktit të dorëheqjes nga ana e një gjyqtari të Gjykatës. Detaje të tilla gjenden në Rregullën 5 [dorëheqja] të Rregullores së Punës, që plotëson nenin 9.1.1 të Ligjit[118]. Implikimet ligjore të dorëheqjes kanë qenë objekt shqyrtimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në referimin e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur juridiksionin rreth rastit të Kryetarit të komunës së Rahovecit, z Qazim Qeska. Pyetja ishte: "Cili institucion i Republikës së Kosovës është përgjegjës për të vlerësuar efektshmerinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe për të konstatuar përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune në bazë të një komunikate drejtuar qytetarëve, paqartësia e së cilës ia bën të pamundur Presidentit veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta?"[119]. Gjykata Kushtetuese deklaroi se as Kushtetuta e Kosovës dhe as Ligji për Vetëqeverisje Lokale nuk u jep kompetencë organeve qeveritare të nivelit qendror për të kryer ndonjë veprim për pranimin e dorëheqjes së kryetarit, që çon në përfundimin e mandatit. Prandaj, sipas Gjykatës Kushtetuese, "çdo dorëheqje e cilitdo kryetar komune është përfundimtare dhe definitive dhe i jep fund mandatit të kryetarit të komunës".[120] Në vlerësimin për pasojat kushtetuese të dorëheqjes së kryetarit të komunës Gjykata deklaroi se dorëheqja e kryetarit të çon në "shpalljen e zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, për të siguruar

[118] Shih komentet më poshtë lidhur me Rregullën 5.
[119] Rasti Nr 80/10 lidhur me kërkesën e Presidentit të Republikës për interpretimin e kushtetutshmërisë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 7 tetor 2010. Http://gjk-ks.org/. qasur më 6 qershor 2012.
[120] Ibid. paragrafi 35.

të drejtën e qytetarëve për të gëzuar të drejtën e votës së lirë dhe të barabartë në themelimin e vetëqeverisjes së tyre lokale".

Një situatë tjetër në të cilën mandati i gjyqtarit përfundon para skadimit të periudhës së rregullt, është kur ai/ajo papritmas vdes. Në rast se gjyqtari vdes pas një sëmundjeje të gjatë, ai / ajo me siguri do të kishte dhënë dorëheqjen nga Gjykata. Në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për të zëvendësuar gjyqtarin, i cili ndahet nga jeta papritmas, as ligji dhe as Rregullorja e Punës nuk kanë përcaktuar detaje për një procedurë të tillë. Supozohet se Kryetari i Gjykatës njofton Presidentin e Kosovës, sikundër edhe Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, për vdekjen e papritur të gjyqtarit, në mënyrë që Kuvendi të iniciojë pa vonesë procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri.

Mund të konsiderohet se, në rast vdekjeje të papritur të Kryetarit të Gjykatës, Zëvendëskryetari do të marrë përsipër menjëherë detyrat e Kryetarit të ndjerë (shih komentet në nenin 11 [Kryetari dhe Zëvendës Kryetari] dhe do të informojë Presidentin e Kosovës si dhe Kryetarin e Kuvendit dhe atë të Qeverisë. Edhe pse neni hesht për këtë çështje, gjyqtarët e Gjykatës do të zgjedhin me siguri pa vonesë Kryetarin e ri. Në të njëjtën kohë, Kuvendi do të fillojë procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri, siç u përmend më lart.

Një bazë tjetër e mëtejshme për përfundimin e parakohshëm të mandatit të gjyqtarit në zbatim të kësaj dispozite, është humbja e përhershme e aftësisë së gjyqtarit për të vepruar ligjërisht, d.m.th. humbja e kapacitetit ligjor të shqiptuar nga gjykata kompetente. Sipas Nenit 31 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore[121], një i rritur mund të shpallet "ligjërisht i paaftë" nga një gjykatë e juridiksionit të rregullt, nëse konstaton se personi i moshës madhore, për shkak të paaftësisë së plotë a të pjesshme për të gjykuar, nuk është në gjendje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e veta, dhe, në pajtim me këtë, atij/asaj ia merr plotësisht a pjesërisht zotësinë për të vepruar.[122] Një veprim i tillë i gjykatës mund të iniciohet nga një palë e autorizuar, në rast se personi vuan nga sëmundje mendore a emocionale ose në rast aftësish të kufizuara fizike. Kur ka arsye të forta ligjore për heqjen e zotësisë juridike të personit të interesuar, gjykata mund të vendosë ta bëjë këtë plotësisht ose pjesërisht.

Për sa i përket përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në rast të humbjes së aftësisë të tij/saj për të vepruar, neni 9.1.3 përcakton se një humbje e tillë duhet të jetë e përhershme. Kështu, në qoftë se gjykata kompetente vendos se gjyqtari në fjalë vuan nga një humbje e përkohshme e aftësisë për të vepruar, e cila pengon aftësinë e tij për të vepruar vetëm përkohësisht, situata mund të zgjidhet nga rasti në rast.

Një arsye tjetër që mund të shkaktojë ndërprerjen para kohe të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, është sëmundja apo ndonjë problem tjetër shëndetësor, që ia bën të pamundur gjyqtarit për të ushtruar detyrat e tij/saj. Ka dy kushte që duhet të plotësohen në këtë drejtim: së pari, një vendim i tillë duhet të jetë i bazuar në një ekzaminim mjekësor, i cili duhet të sigurojë dëshmi që konfirmon se, për shkak të gjendjes shëndetësore të gjyqtarit, ai / ajo nuk është në gjendje të vazhdojë të ushtrojë funksionin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe, së dyti, ndërprerja e mandatit në kuptim të nenit 9.1.4 duhet të vendoset me shumicën e 2/3 të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (shih edhe komentet në nenin 9 (2) në tekstin e mëtejmë).

---

[121] Neni 31 i Ligjit nr 03/L-007 për procedurën jokontestimore, datë 20 nëntor 2008.
[122] Ibid.

Një arsye tjetër për përfundimin e parakohshëm të mandatit të gjyqtarit në pajtim me nenin 9.1.5, është shkarkimi i tij/saj i paraparë me Nenin 118 [Shkarkimi] të Kushtetutës, që përcakton: "Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave".

Vlen të theksohet, së pari, se në parim arsyet për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë të kufizuara. Rrethanat, në të cilat mund të bëhet shkarkimi i një gjyqtari, janë dhënë shprehimisht në nenin 118 të Kushtetutës, prandaj, thjesht, nuk mund të zgjaten më tej me ligj. Qëllimi i hartuesve të Kushtetutës duhet të ketë qenë për të siguruar pavarësinë e Gjykatës dhe për mbrojtur gjyqtarët e saj kundër manovrimeve politike dhe rreziqeve për t'u shkarkuar për arsye të tjera nga ato që janë përcaktuar në nenin 118 të Kushtetutës. Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të qartë nënkupton se gjyqtarët nuk janë të përgjegjshëm ndaj askujt. Kjo është arsyeja pse në shumicën e vendeve rregullat për shkarkim janë të dhëna në kushtetutat e tyre dhe se autoritetet emëruese mund të shkarkojnë një gjyqtar kushtetues vetëm në përputhje me dispozitat kushtetuese.

Për shembull, në Republikën Federale të Gjermanisë, gjyqtarët kushtetues mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës, pas një vendimi të 2/3 të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në rast të një sjelljeje që diskrediton rëndë pozitën e gjyqtarit ose në rast se gjyqtari është dënuar me burgim me një kohëzgjatje më shumë se 6 muaj. Në Shqipëri, sipas nenit 128 të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Një vendim i tillë i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Bazat mbi të cilat një shkarkim mund të konsiderohet kushtetushmërisht i justifikuar në bazë të nenit 118 të Kushtetutës së Kosovës, nuk janë plotësisht të qarta nga pikëpamja ligjore. Për shembull, përkufizimi "krim i rëndë" nuk është elaboruar më tej në këtë nen. Gjithashtu ligji i aplikueshëm në Kosovë nuk ofron qartësi të mjaftueshme ligjore lidhur me kuptimin e fjalëve "krim i rëndë". Pyetja që mund të ngrihet në këtë kontekst, është nëse, për shkarkim, koncepti i "krimeve të rënda" duhet të interpretohet në një kuptim më të gjerë, në mënyrë që të nënkuptojë çdo vepër penale, e cila ndiqet nga një aktakuzë. Ligji i aplikueshëm penal në Kosovë nuk përcakton krime të rënda ose më pak të rënda.[123] Duhet të jetë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese për të caktuar kufijtë e termit "krimi i rëndë", për qëllime të nenit 118 të Kushtetutës.

Megjithatë, është po aq e rëndësishme të bëhet edhe interpretimi i formulimit "kryerja e një krimi të rëndë". Duke marrë parasysh seriozitetin e një situate në të cilën një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese rrezikon të shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, kjo mund të nënkuptojë vetëm që, para shkarkimit, gjykata kompetente për çështje penale duhet ta ketë shpallur gjyqtarin përkatës fajtor për kryerjen e një krimi, i

[123] Kodi Penal i Kosovës parashikon vetëm këtë seksion në lidhje me krimet e rënda: "Ligji mund të parashohë dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda", shih nenin 44 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/l-082 (botuar 13.07.2012).

cili duhet të konsiderohet si “serioz”. Prandaj, procedura për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës, në parim, duhet të fillojë vetëm pas vendimit përfundimtar në çështjen penale ndaj gjyqtarit përkatës. Kjo është e lidhur me parimin e pafajësisë duke qenë një nga të drejtat e parashikuara me Kushtetutë. Neni 31 para. 5 i Kushtetutës thotë: "Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia në bazë të ligjit".[124]

Megjithatë, meqë procedura penale kundër një gjyqtari të Gjykatës do të ndikojë drejtpërdrejt në dinjitetin dhe qetësinë e Gjykatës në tërësi, do të ishte e preferueshme që Gjykata të pezullojë gjyqtarin përkatës nga funksionet e tij/saj për aq kohë sa të jetë në vijim procedura penale. Vetëm pas vendimit përfundimtar, Gjykata duhet të vendosë për të hequr pezullimin ose për të propozuar masën e shkarkimit të gjyqtarit përkatës. As Kushtetuta dhe as ligji, me sa duket, nuk parashikojnë mundësinë për të pezulluar një gjyqtar nga funksionet e tij / saj në situatën e mësipërme (shih edhe komentet për Rregullën 6 [Procedura e shkarkimit] në tekstin e mëtejmë).

Për sa i takon bazës së dytë kushtetuese për përfundimin e parakohshëm të mandatit të gjyqtarit, përkatësisht për mosrespektimin e rëndë të detyrave, mund të parashtrohet një pyetje e ngjashme: Si të bëjnë dallimin në mes të një neglizhence "të thjeshtë" të detyrave dhe një neglizhence të "rëndë" të detyrave? Përsëri, do të duhet që vetë Gjykata Kushtetuese, përmes interpretimit të këtyre termave, të tregojë kufijtë e këtij koncepti, megjithëse rast pas rasti. Në lidhje me këtë, do të mund të ishte e dobishme të ofrojmë një shembull nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë lidhur me interpretimin kushtetues mbi kushtet që kanë të bëjnë me shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në vendimin nr. 75, të datës 19.04.2002 me anë të të cilit Gjykata Kushtetuese kishte dhënë vendim interpretativ lidhur me atë se çfarë nënkuptojnë për qëllime kushtetuese shprehjet “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën…” dhe “shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve” të Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese kishte përcaktuar se nga të gjitha shkaqet për shkarkim të këtyre funksionarëve të lartë që parashikohen në këto nene kushtetuese, dy prej tyre dhe konkretisht “kryerja e një krimi” dhe “paaftësia mendore a fizike”, janë të tilla, që nuk mund të vërtetohen drejtpërdrejt nga Kuvendi, pasi ato kërkojnë që paraprakisht të konstatohen dhe të vërtetohen nga organe kompetente.

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese e kishte distancuar veten nga çfarëdo forme e ligjbërjes duke theksuar, në mes të tjerash: “për interpretimin e këtyre normave, Gjykata Kushtetuese nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit pozitiv, duke parashikuar një për një të gjitha rastet që mund të përfshihen në këto shkaqe kushtetuese, sepse do të ishte e pamundur një gjë e tillë, ndërkohë që Kushtetuta, ligjet, apo edhe vendimet gjyqësore nuk mund të kodifikojnë me saktësi aktet e sjelljet që

[124] Për më tepër lidhur me prezumimin e pafajsisë shih Tadros, Victor. "The Ideal of the Presumption of Innocence”. *Criminal Law and Philosophy* (2013): 1-19; Duff, R. A. "Pre-trial detention and the presumption of innocence”. *Oxford University Press, Forthcoming* (2012): 12-31; Gray, Anthony. "Constitutionally protecting the presumption of innocence”. *U. Tas. L. Rev.* 31 (2012): 132; Weiß, Wolfgang. "Human rights in the EU: rethinking the role of the European convention on human rights after Lisbon”. *European Constitutional Law Review*7.1 (2011): 64-95.

diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit a prokurorit, apo rastet se kur ligji është shkelur rëndë”.[125]

Gjithnjë sipas Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë “*veprimet apo mosveprimet e këtyre funksionarëve të lartë të shtetit, të cilat mund të përfshihen në shkaqet kushtetuese që shërbejnë për shkarkimin e tyre, janë të tilla, që mund të vlerësohen rast pas rasti nga vetë organi që kryen këtë procedurë shkarkimi. Megjithatë, në çdo rast, ato janë të lidhura me sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës, me abuzimin apo dhunimin që ata i bëjnë besimit publik dhe që lidhen kryesisht me dëmet që ata i sjellin shoqërisë dhe shtetit. Aktet dhe sjelljet e padenja që ata kryejnë, duhet të jenë aq serioze, të kenë diskredituar aq rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit apo prokurorit dhe të kenë ulur dinjitetin e organit që përfaqësojnë, sa të detyrojnë organin kompetent për të marrë masën e largimit nga detyra*”.[126]

Sipas shumicës së gjyqtarëve kushtetuese, kuptimi i saktë dhe i drejtë i “shkeljes së rëndë të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit” duhet të analizohet dhe vlerësohet çdoherë në tërësi nga disa faktorë që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, me kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre si dhe me vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur. Gjithashtu, cilësimi “rëndë”, i përdorur si për rastin e diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit e të prokurorit, ashtu dhe të shkeljes së ligjit, i shërben njëkohësisht organit kompetent që fillon procedurat e shkarkimit, për të dalluar këto veprime nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të motivuar shkakun e shkarkimit”.[127]

Ky vendim interpretativ i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mund të shërbejë si udhërrëfyes për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, nëse kjo Gjykatë do të përballet eventualisht me një kërkesë të ngjashme kushtetuese.

Neni 9.1.5 i Ligjit është plotësuar me Rregullën 6 [Procedura e shkarkimit] të Rregullores së Punës.

Fjalia e parë e nenit përmban një gabim të vogël tekstual: "pika 1.4 e paragrafit 1 të këtij neni," duhet të jetë "pika 4 e paragrafit 1 të këtij neni". Është e qartë se, përpara se të vendosë për përfundimin e mandatit të gjyqtarit, i cili është i sëmurë ose ka ndonjë problem tjetër shëndetësor që e ndalon atë për të ushtruar funksionet e tij/saj si gjyqtar i Gjykatës, gjyqtarët e tjerë duhet të shqyrtojnë në mënyrë të plotë të gjitha ekzaminimet mjekësore përkatëse, në mënyrë që të mund të përcaktojnë seriozitetin e gjendjes shëndetësore të kolegut të tyre. Nuk duket të jetë me rëndësi nëse gjendja shëndetësore është shkaktuar nga një sëmundje serioze ose nga ndonjë lëndim i rëndë.

Çfarë ka rëndësi është se dosja mjekësore duhet të përmbajë një diagnozë të saktë mjekësore, të mbështetur me dokumentacionin e nevojshëm mjekësor, dhe një opinion mjekësor të nënshkruar nga më shumë se një specialist, për të konstatuar nëse gjyqtari do të jetë në gjendje të rifillojë funksionin e tij/saj pas shërimit brenda një kohe të caktuar, ose, në rast të një sëmundjeje a lëndimi të rëndë, do të ketë shumë të ngjarë të

[125] Shih rastin Nr. 75/2002 lidhur me kërkesën e Kuvendit të Shqipërisë për interpretimin e neneve 128, 140, 149 të Kushtetutës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. 19 prill 2002. Http://www.gjk.gov.al. Qasur më 1 mars 2014.
[126] Ibid.
[127] Ibid.

mos jetë në gjendje të kthehet në Gjykatë për të ushtruar funksionin e tij. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës në këtë mënyrë do kenë mundësi të vendosin nëse do të vazhdojnë pa gjyqtarin përkatës derisa ai/ajo do të shërohet plotësisht, ose, në qoftë se shanset e shërimit janë shumë të pakta, nëse do të ishte më e këshillueshme, të ndërprejnë mandatin e gjyqtarit në pajtim me nenet 9.1.4 dhe 9.2, në mënyrë që të mund të fillojnë procedurat për propozimin e gjyqtarit të ri.
Neni 9.4 hesht lidhur me procedurën që duhet ndjekur kur një shumicë prej 2/3[128] e gjyqtarëve vendos që mandati i gjyqtarit përkatës duhet të ndërpritet. Megjithatë, supozohet se Kryetari i Gjykatës do të mundësojë që gjyqtarët, para se të vënë në votim propozimin për ndërprerjen e mandatit të gjyqtarit në fjalë, të marrin njoftim të duhur lidhur me shqyrtimet dhe provat e gjetura mjekësore. Pasi të miratohet propozimi, Kryetari i Gjykatës duhet të përcjellë vendimin e gjyqtarëve tek Presidenti i Republikës, i cili, në cilësinë e autoritetit të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, do të përfundojë mandatin e gjyqtarit të sëmurë. Supozohet që më tej, menjëherë pas kësaj, Kryetari i Gjykatës do të informojë Kuvendin për përfundimin e mandatit të gjyqtarit përkatës me qëllim që Kuvendi të fillojë procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri.
Neni 9 plotësohet me Rregullën 5 dhe Rregullën 11 të Rregullores së Punës.

Rregulli 5 [Dorëheqja e gjyqtarëve]

5.1 Gjyqtari i dorëzon dorëheqjen me shkrim Presidentit të Republikës së Kosovës, duke njoftuar me nga një kopje Kryetarin e Gjykatës dhe Sekretariatin.
5.2 Sekretariati njofton menjëherë me nga një kopje të dorëheqjes të gjithë gjyqtarët e tjerë dhe palët përkatëse.
5.3 Për të qenë efektive, dorëheqja e gjyqtarit nuk varet nga pranimi i saj.
5.4 Përveç nëse në dorëheqje me shkrim përcaktohet ndonjë datë tjetër, dorëheqja hyn në fuqi në ditën e dorëzimit të saj te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Letërdorëheqja që dorëzohet nga gjyqtari i Gjykatës, është dokument zyrtar që konfirmon se ai/ajo ka zgjedhur në mënyrë të lirë të largohet nga Gjykata. Letërdorëheqja mund të paraqitet në forma të ndryshme, në varësi të rrethanave, por, në përgjithësi, duhet të përmbajë informacion në lidhje me ditën kur do të bëhet efektive dorëheqja (për shembull, me efekt të menjëhershëm ose në një datë të caktuar) dhe, nëse gjyqtari dëshiron të nënvizojë këtë fakt duke ofruar arsyet e dorëheqjes. Me këtë njoftim do të krijohet një vend i lirë për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, dhe shpallja do të bëhet sipas datës të indikuar në letërdorëheqje.
Letërdorëheqja i dërgohet autoritetit emërues, në këtë rast Presidentit të Kosovës, ndërsa kopjet i paraqiten Kryetarit të Gjykatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm si shef i Sekretariatit. Njoftimi është i vetëzbatueshëm, prandaj, për t'u bërë efektiv, nuk ka nevojë për ndonjë veprim të veçantë nga ndonjë prej palëve të interesuara (shih rregullën 5.3).

[128] Për një shumicë prej 2/3 të tetë (8) gjyqtarëve, prapë duhet votuar për gjashtë (6) gjyqtarë.

Letërdorëheqja u komunikohet jo vetëm të gjithë gjyqtarëve të tjerë, palëve të tjera - sikurse Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Njoftimi i Presidentit të Republikës është i nënkuptuar duke pasur parasysh faktin që Presidenti vepron si një autoritet emërues për gjyqtarin që jep dorëheqjen. Prandaj, dërgimi i letërdorëheqjes Presidentit të Republikës është në përputhje me normat kushtetuese.
Është interesante të vërehet se Rregulla 5.3 nuk kërkon që dorëheqja e gjyqtarit të shqyrtohet dhe të votohet nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatës për të hyrë në fuqi. E drejta e mosrevokimit të vendimit për të dhënë dorëheqje është favorizuar nga hartuesit, të cilët ishin të mendimit se dorëheqja nga një gjyqtar duhet të respektohet dhe, për këtë arsye, nuk duhet të shqyrtohet dhe të votohet. Gjyqtari që jep dorëheqjen, mund të zbulojë arsyet për dorëheqjen e tij / saj, nëse ai / ajo dëshiron, por në asnjë rrethanë ai/ajo nuk mund të detyrohet të bëjë të ditur arsyen e dorëheqjes.
Në vende të tjera, si Shqipëria, dorëheqja e gjyqtarit shqyrtohet dhe votohet në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese. Në Slloveni, Kuvendi si autoriteti i emërimit, do të shkarkojë gjyqtarin në ditën që ai/ajo ka ofruar dorëheqjen,[129] ndërsa në Kroaci Kuvendi vendos për kërkesën e gjyqtarit për t'u liruar nga detyra e tij / saj dhe, nëse Kuvendi nuk vepron brenda tre muajve pasi të jjetë bërë kërkesa, mandati i gjyqtarit do të marrë fund në bazë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.[130]
Gjyqtari që ofron dorëheqjen, mund të caktojë datën kur do të bëhet efektive dorëheqja e tij/saj, por kjo nuk është e detyrueshme. Nëse gjyqtari nuk përcakton shprehimisht datën, sipas Rregullës, datë efektive e dorëheqjes do të jetë dita kur i është dorëzuar letërdorëheqja autoritetit emërues, d.m.th. Presidentit të Kosovës. Në rast se letërdorëheqja është dërguar me postë të regjistruar, datë efektive duhet të konsiderohet dita kur është marrë letra në Zyrën e Presidentit. Në qoftë se letërdorëheqja i është dorëzuar Zyrës së Presidentit me dorë, si datë efektive duhet të konsiderohet. data e dorëzimit.

Rregulli 6 [Procedurat për shkarkim]

6.1 Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:
(a) në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë,
(b) në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës,
(c) në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose
(d) në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit.

6.2 Shkarkimi mund të propozohet nëpërmjet një dokumenti të shkruar, ku përshkruhet baza për shkarkim, dhe i cili nënshkruhet nga një ose më shumë gjyqtarë dhe i dorëzohet Kryetarit. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim. Propozimi për shkarkim duhet të jetë konfidencial dhe të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen me të sa më shpejt që të jetë e mundur.

6.3 Kryetari njofton me shkrim gjyqtarin e propozuar për shkarkim mbi bazën e propozimit për shkarkim dhe i jep gjyqtarit përkatës propozimin e shkruar dhe të gjitha faktet relevante të bashkëngjitura. Në rast se Kryetari

[129] Neni 19. 3 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë.
[130] Neni 12 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë.

propozohet për shkarkim, Zëvendëskryetari i bën njoftimin e njëjtë Kryetarit.

6.4 Gjyqtarët mbajnë takim konfidencial, për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Gjyqtari i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takimin konfidencial dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të gjyqtarëve.

6.5 Gjyqtarët mbajnë një takim tjetër konfidencial nga i cili përjashtohet gjyqtari i propozuar për shkarkim. Në këtë takim, gjyqtarët përcaktojnë nëse do t'ia propozojnë këtë shkarkim Presidentit të Republikës së Kosovës. Kryetari i Gjykatës e kryeson këtë takim dhe diskutimet e gjyqtarëve mbesin konfidenciale. Për t'i propozuar shkarkimin Presidentit të Republikës së Kosovës, propozimi për shkarkim duhet të votohet nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës. Gjyqtarët duhet të kenë të drejtë, po ashtu nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë.

Rregulla, me sa duket, merret jo vetëm me "shkarkimin" e një gjyqtari në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës (pikat a) dhe b) të Rregullës), por përmend gjithashtu arsye të tjera për shkarkim, përkatësisht (c) humbje të përhershme të aftësisë për të vepruar dhe (d) sëmundje apo probleme të tjera shëndetësore që e bëjnë të pamundur për të ushtruar përgjegjësitë dhe funksionet e gjyqtarit. Megjithatë, është e qartë se procedura e shkarkimit, sipas Rregullës 6, nuk zbatohet për pikën (c) "humbje e përhershme e aftësisë së veprimit e konstatuar nga gjykata kompetente" (siç përmendet në nenin 9.1.3 të Ligjit) dhe as për të pikën (d) "(të) sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore " (siç përmendet në nenin 9.1.4 të Ligjit), për arsye se ato nuk përbëjnë "bazën për shkarkim", siç përcaktohet në nenin 118 [Shkarkimi] të Kushtetutës, por përbëjnë "arsye për ndërprerje të mandatit" të gjyqtarit përkatës. Siç është komentuar në nenin 9.1.3, është detyrë e gjykatave të rregullta për të shqiptuar humbjen e përhershme të aftësisë për të vepruar, ndërsa neni 9.2 përmban detajet e procedurës së veçantë për përfundimin e mandatit të gjyqtarit, i cili vuan nga një sëmundje ose problem tjetër shëndetësor. Prandaj është e këshillueshme të korrigjohet Rregulla 6 (1) përshtatshmërisht duke fshirë pikat c) e d) nga teksti.

Propozimi për shkarkimin e gjyqtarit duhet të përmbajë dy elemente të rëndësishme, në mënyrë që Kryetari i Gjykatës të vërë në lëvizje procedurën për shkarkimin e gjyqtarit. Së pari, propozimi duhet të përmbajë një bazë të vlefshme juridike për të justifikuar shkarkimin e propozuar, që do të thotë arsyet e treguara në nenin 118 të Kushtetutës: kryerje e një krimi të rëndë ose mospërfillje e rëndë e detyrave. Këto arsye tashmë janë komentuar gjerësisht më sipër, në bazë të nenit 9.1.5 të Ligjit.

Së dyti, propozimi për shkarkim duhet të përmbajë nënshkrimin e një ose më shumë gjyqtarëve. Mund të parashtrohet pyetja nëse nënshkrimi i vetëm një ose dy gjyqtarëve do të jetë i mjaftueshëm për t'i mundësuar Presidentit që të iniciojë procedurën e shkarkimit? Shkarkimi i gjyqtarit është një çështje shumë serioze dhe një propozim për shkarkim nuk duhet të dorëzohet lehtë tek Presidenti, por ai duhet të përmbajë akuza të rënda të bazuara në fakte relevante. Përndryshe, kjo procedurë mund të abuzohet

lehtësisht nga një gjyqtar që akuzon gjyqtarin tjetër për mospërfillje të rëndë të detyrave, pa qenë në gjendje të paraqesë arsye të mjaftueshme për akuzat e tij/saj. Për shembull, neni 10 [Shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese] i Ligjit shqiptar për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese përcakton: " [...] 2. Procedura në Kuvend për shkarkimin e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese për një nga arsyet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni,[131] fillon me kërkesë të arsyetuar [bërë] nga jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit". Ky kriter, sipas Ligjit shqiptar, duket të jetë më e vështirë të përmbushet se ai i Rregullës 6.2.

Rregulli më tej parashikon që dokumentet që përmbajnë fakte relevante, d.m.th. dëshmi prioritare, mbi të cilat bazohen arsyet për shkarkim, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim, i cili është konfidencial dhe duhet t'u ofrohet sa më shpejt të jetë e mundur (nga Kryetari apo Sekretari i Përgjithshëm) të gjithë gjyqtarëve. Mund të thuhet se gjyqtari i cili është propozuar për t'u shkarkuar, nuk përfshihet në mesin e "të gjithë gjyqtarëve", mirëpo do të informohet në mënyrë të ndarë "me shkrim" nga Kryetari, për propozimin për shkarkim sipas Rregullës 6.3, siç komentohet më vonë.

Rregulli hesht për sa i takon afatit kohor brenda të cilit Presidenti duhet të informojë gjyqtarin përkatës lidhur me propozimin për shkarkimin e tij/saj, por, për hir të transparencës dhe në mënyrë që gjyqtari përkatës të jetë në gjendje të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur përgatitjen e tij / saj të mbrojtjes, Kryetari duhet ta njoftojë atë menjëherë pasi "të gjithë gjyqtarët" në të njëjtën kohë do të kenë marrë propozimin dhe faktet relevante të bashkëngjitura.

Rregulla 6.3 gjithashtu është e heshtur lidhur me çështjen nëse gjyqtari përkatës mund të pezullohet nga Kryetari gjatë procedurës në lidhje me propozimin e shkarkimit. Për shembull, neni 13 i Ligjit kroat për Gjykatën Kushtetuese konstaton se një gjyqtar mund të pezullohet (në të gjitha rastet e përfundimit paraprak të mandatit të tij / saj) me propozimin e bërë nga tre gjyqtarë dhe me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve (kjo mund të nënkuptojë që mund të votojë edhe gjyqtari perkates). Edhe pse Kushtetuta dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk theksojnë në mënyrë specifike rrethanat mbi të cilat një gjyqtar mund të pezullohet para shkarkimit të tij, do të ishte e dobishme në qoftë se Rregullorja do të autorizonte gjyqtarët që të shqiptojnë masën e pezullimit, sidomos në ato situata kur niveli dhe ashpërsia e shkeljes është tërësisht e qartë. Ngjashëm me shembullin kroat, procedura e shpalljes së masës së shkarkimit mund të kërkohet fillimisht sipas propozimit të bërë nga tre gjyqtarë, dhe vendimi mund të merret me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve.

Rregulla në fund përcakton se, në qoftë se propozimi për shkarkim i drejtohet Kryetarit të Gjykatës, dokumenti me shkrim, i cili parashtron arsyet e shkarkimit të tij / saj si gjyqtar, duhet t'i dorëzohet Zëvendëskryetarit i cili do të "sigurojë të njëjtin njoftim për Kryetarin". Rregulli hesht edhe për sa i takon çështjes nëse gjyqtarët do të mund të vendosin për të pezulluar funksionin e Kryetarit jo për të kryer detyrat e tij / saj si gjyqtar, por si Kryetar.

Hapi i ardhshëm proceduror, që mund të ndërmerret kur të bëhet kërkesa për shkarkim, është se Kryetari (ose, si në rastin e Rregullës 6.3, fjalia e fundit:Zëvendës Kryetari) do të thërrasë një takim konfidencial për të diskutuar shkarkimin e propozuar, por nuk do të bëjë këtë pa i dhënë së pari gjyqtarit të propozuar për shkarkimin një kohë të

[131] për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë integritetin dhe reputacionin".

mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij/saj. Rregulla përmban më shumë elemente të "paanshmërisë", duke i mundësuar gjyqtarit përkatës që të jetë i pranishëm në mbledhjen konfidenciale, të ofrojë dëshmi gojore dhe me shkrim në përgjigje të shkarkimit të propozuar dhe t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga gjyqtarët. Supozohet gjithashtu se të gjitha letrat, dokumentet dhe shkresat e lëndës në lidhje me hetimet e mundshme të kryera lidhur me procedurën e shkarkimit, do të mbeten konfidenciale dhe nuk do të zbulohen nga asnjë person, në asnjë kohë dhe në asnjë procedurë, përveç në raste të parashikuara me Ligj.

Mund të rezultojë gjithashtu që edhe në rrethanat e Rregullës 6.5, Kryetari i Gjykatës do të thërrasë një mbledhje të mëpasme konfidenciale dhe që, në qoftë se Kryetari propozohet për shkarkim, mbledhjen do ta konvokojë dhe do ta kryesojë Zëvendëskryetari. Duke marrë parasysh se gjyqtari i propozuar për shkarkim duhet të përjashtohet nga kjo mbledhje dhe se, për pasojë, në mbledhje do të mbesin vetëm 8 gjyqtarë të pranishëm, do të jetë disi e vështirë, edhe pse jo e pamundur, të zbatohet koncepti i "dy të tretave (2/3) të shumicës së votave të të gjithë gjyqtarëve të mbetur në Gjykatë". Pasi një shumicë prej 2/3 të gjyqtarëve do të thotë më shumë se 5 gjyqtarë, shumica prej 6 gjyqtarëve është e nevojshme të votojnë pozitivisht për shkarkimin.[132]

Është gjithashtu me rëndësi të theksohet se Rregulla u mundëson anëtarëve të Gjykatës që të shqiptojnë masa më të lehta se shkarkimi "nëse rrethanat e arsyetojnë këtë", edhe pse as Kushtetuta dhe as Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk ofrojnë ndonjë bazë për shqiptimin e këtyre masave. Prandaj nuk është tërësisht e qartë për çfarë lloji të sanksioneve ose shkeljeje të disiplinës "më pak të rënda se shkarkimi" janë menduar. Megjithatë, edhe pse qëllimi i një Rregulle të tillë mund të jetë i pranuar, mund të parashtrohet pyetja nëse votimi afirmativ për shkarkimin e një gjyqtari mund të lihet mënjanë përmes Rregullorës së Punës për vendosjen e sanksioneve më të buta disiplinore.

Sigurisht se mund të ketë rrethana, për shembull, në të cilat një gjyqtar, sjellja e të cilit është përcaktuar nga propozimi fillestar për shkarkim si për "mospërfillje të rëndë të detyrave", arrin të bindë gjyqtarët e tjerë në mbledhjen e parë konfidenciale të gjyqtarëve, se neglizhimi i tij/saj i detyrave nuk mund të kualifikohet si "i rëndë". Në një rast të tillë, mund të justifikohet një sanksion më pak i rëndë. Mirëpo, pasi gjyqtarët të kenë vendosur që gjyqtari i propozuar për shkarkim, ka kryer një krim të rëndë ose ka neglizhuar rëndë detyrat e tij / saj ", i vetmi sanksion që do t'i propozohet Presidentit të Republikës, është shkarkimi në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës.

Siç është cekur më herët në këtë Komentar, Gjykata Kushtetuese ka miratuar Kodin e Mirësjelljes për Gjyqtarë (të ngjashëm me atë të hartuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës[133]), dispozitat përkatëse të të cilit mund të merren parasysh nga ana e gjyqtarëve kur të trajtohet një propozim për shkarkim. Kod i Mirësjelljes ofron udhëzime për gjyqtarët për një sërë çështjesh të tjera, nga integriteti, pavarësia e gjyqësorit, integriteti dhe paanshmëria deri tek aktivitetet e lejuara jashtëgjyqësore dhe shmangia e sjelljeve të pahijshme ose e paraqitjes së tyre. Duhet shtuar se shkarkimi i një gjyqtari nuk do të zhvlerësojë aktet dhe vendimet në të cilat ka marrë pjesë ai/ajo. Për më tepër, vendimi prej dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve duhet të konsiderohet

[132] Shih komentet më lartë lidhur me nenin 9.4.
[133] Ky Kod i Mirësjelljes është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 25 prill 2006.

përfundimtar e i prerë dhe nuk mund t'i nënshtrohet ndonjë procesi të rishikimit gjyqësor.
Së fundi, duhet përmendur se Rregulla hesht në lidhje me çështjen nëse Presidenti i Republikës, të cilit i është propozuar shkarkimi i gjyqtarit përkatës, është i detyruar të ndjekë këtë propozim në të gjitha rrethanat. Në këtë drejtim, duhet t'i referohemi nenit 118 të Kushtetutës, i cili përcakton qartë që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese "mund" të shkarkohen nga Presidenti. Kjo duket se i ofron Presidentit një kufi të caktuar të vlerësimit, megjithëse nuk është e qartë nëse Presidenti do të jetë i autorizuar në bazë të nenit 118, që të vendosë një sanksion alternativ. Një alternativë mund të jetë, për shembull, që, në vend se të shkarkohet nga Presidenti, ky i fundit do ta ftojë gjyqtarin përkatës të japë dorëheqjen nga funksionet e tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Rregulli 11 [Dorëheqja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit]

11.1 Kryetari ia dorëzon dorëheqjen e vet, si Kryetar, Zëvendëskryetarit dhe Sekretariatit. Zëvendëskryetari ia dorëzon dorëheqjen e vet, si Zëvendëskryetar, Kryetarit dhe Sekretariatit.
11.2 Në secilin rast, Sekretariati njofton menjëherë të gjithë gjyqtarët dhe palët e tjera përkatëse me nga një kopje të dorëheqjes.
11.3 Dorëheqja hyn në fuqi nga data e përcaktuar me shkrim, ose, në rast se nuk është përcaktuar asnjë datë, atëherë ajo hyn në fuqi menjëherë. Dorëheqja nuk varet nga pranimi i saj.
11.4 Administrimi i përkohshëm i Gjykatës dhe zgjedhja e Kryetarit ose e Zëvendëskryetarit bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullit 10.

Është e paqartë pse zgjedhja dhe dorëheqja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës nuk është trajtuar me Ligj, po, në nenin 11 [Kryetari dhe zëvendës Kryetari] përmenden vetëm detyrat e tyre. Në fakt, është,neni 114.5 i Kushtetutës, që merret me detajet e zgjedhjes në këto funksione: "*Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës për një mandat prej tre (3) vjetësh. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit*".
Rregullorja e punës bën dallim në mes dorëheqjes së një gjyqtari dhe dorëheqje së Kryetarit ose Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse procedura për paraqitjen e dorëheqjes siç parashihet në Rregullën 11 të Rregullores së Punës, bart ngjashmëri të theksuara me procesin e dorëheqjes së gjyqtarëve të përcaktuar në Rregullin 5 të Rregullores së Punës. Për të siguruar vazhdimësinë në administratën e Gjykatës, Rregulla 10.2 e Rregullores së Punës përcakton se "Kryetari i Gjykatës, nëse është ende gjyqtar dhe kurdo të jetë e mundshme, vazhdon të ushtrojë funksionet e Kryetarit deri në zgjedhjen dhe deri në marrjen e funksionit nga Kryetari i ri".[134]
Rregullorja më tej thekson se "në rast se posti i Kryetarit mbetet menjëherë i zbrazët, zgjedhja për Kryetar duhet të mbahet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe Zëvendëskryetari ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të mandatit të Kryetarit të ri. Në rast se nuk ka Zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën më të gjatë në Gjykatë ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm. Nëse një ose më shumë

[134] Shih komentet lidhur me Rregullin 10.

gjyqtarë në Gjykatë kanë kaluar kohë të njëjtë në Gjykatë, atëherë gjyqtari më i vjetër për nga mosha konsiderohet gjyqtari me përvojë më të gjatë për qëllim të këtij rregulli”.[135]
Shih më lart komentet për Rregullën 5.2.
Shih më lart komentet për Rregullën 5.4.

Neni 10 [Detyrat e gjyqtarëve]

10.1 Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyre të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
10.2 Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
10.3 Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryej punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës.

Përmbajtje substanciale e konceptit të pavarësisë gjyqësore është parimi i paanshmërisë. Ky parim nuk është prerogativë apo privilegj në interes të gjyqtarit, por në interes të sundimit të së drejtës dhe të atyre që kërkojnë dhe presin drejtësi.[136] Siç ka theksuar Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, në mendimin e tjj në vitin 2001 duke reflektuar mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe kërkesat për paanshmërinë e tyre:
"Pavarësia e gjyqësorit nënkupton paanësinë e përgjithshme të gjyqtarëve. Kur gjykojnë në mes çdo pale, gjyqtarët duhet të jenë të paanshëm, në mënyrë të lirë nga çdo lidhje, prirje apo paragjykim, që ndikon - ose mund të shihet se ndikon – në aftësinë e tyre për të gjykuar në mënyrë të pavarur. Në këtë drejtim, pavarësia e gjyqësorit është një përpunim i parimit themelor se "askush nuk mund të gjykojë në çështjen e vet". Ky parim gjithashtu ka domethënie përtej ndikimit në palët e veçanta të çdo mosmarrëveshjeje. Jo thjesht palët në ndonjë kontest të veçantë, po shoqëria në tërësi duhet të jetë në gjendje t’i besoj gjyqësorit. Një gjyqtar në këtë mënyrë nuk duhet vetëm të jetë i lirë nga çdo lidhje e papërshtatshme, paragjykim a ndikim, por ai ose ajo duhet tërësisht i pavarur. Sepse përndryshe, mund të minohet besimi në pavarësinë e gjyqësorit”.[137]
Duhet të theksohet se, në nivel evropian, çështja e pavarësisë së gjykatave është e lidhur me të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, i cili përcakton se "në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. [...] ".
Ndër tekstet më autoritative (përveç Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) lidhur me pavarësinë e gjyqësorit në nivel evropian, është Rekomandimi nr. (94) 12 i

[135] Neni 11, Rregullorja e Punës.
[136] Shih raportin e Komisionit të Venecias dhe komentet lidhur me amendamentet kushtetuese për reformimin e sistemit gjyqësor në Bullgari në http://www.venice.coe.int/docs/2003/CDL (2003) 060-e.asp.
[137] Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, Këshilli i Evropës, "mbi standardet lidhur me pavarësinë e gjyqësorit dhe parevokueshmërinë e gjyqtarëve" (2001), CCJE 200.123 nëntor 2001. Dokumenti mund të gjendet në http://coe.int/t/ dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/CCJE% 20Opinion% 201_EN.pdf.

Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë, efiçencën dhe rolin e gjyqtarëve. Ky Rekomandim përcakton *inter alia* se "*në procesin e vendimmarrjes, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të jenë në gjendje për të vepruar pa ndonjë kufizim, ndikim të pavend, nxitje, presion, kërcënim ose ndërhyrje, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për çfarëdo arsye. Ligji duhet të parashikojë sanksione kundër personave që kërkojnë të influencojnë mbi gjyqtarët në një mënyrë të tillë. Gjyqtarët duhet të kenë lirinë e papenguar për të vendosur rastet në mënyrë të paanshme, në përputhje me ndërgjegjen e tyre dhe me interpretimin e tyre të fakteve dhe në bazë të rregullave të përcaktuar me ligj. Gjyqtarët nuk duhet të jenë të detyruar që për zgjidhjen e rasteve t'i raportojnë askujt jashtë gjyqësorit".*[138]

Megjithatë, jo më pak të rëndësishme janë Opinioni nr. 1 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) mbi standardet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve[139] dhe Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve,[140] e cila është miratuar në një takim shumëpalësh organizuar nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore të Këshillit të Evropës në Strasburg, në korrik të vitit 1998. Këto instrumente ligjore evropiane sigurojnë një pako të garancive ligjore për të siguruar që gjyqtarët të mbeten të lirë nga ndikimet e jashtme të panevojshme, duke pasur të drejtën që të vendosin të lirë mbi rastet, në mënyrë të paanshme, në përputhje me ndërgjegjen e tyre dhe me interpretimin e fakteve e ne bazë të rregullave ligjore.

Lidhur me nenin 10.1 të Ligjit, duhet theksuar se ai përmban elemente të rëndësishme për zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit kushtetues. Kontrolli kushtetues është shumë i rëndësishëm, pasi trajton aspektet themelore të administrimit të drejtësisë dhe, në të njëjtën kohë paraqet fazën e fundit në administrimin e drejtësisë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që, gjatë procesit të kontrollit kushtetues dhe zgjidhjes së kontesteve kushtetuese, faktorëve si paanësia dhe bindja e lirë e gjykatës t'u jepet kujdesi i duhur.

Sigurisht, një kërkesë praktike, po në të njëjtën kohë mjaft e rëndësishme, është kriteri i paanshmërisë së jashtme. Kjo do të thotë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të ndikohen nga interesat personalç ose privatë, politikë apo nga ndonjë faktor tjetër i jashtëm. Për më tepër, gjyqtarët kushtetuese duhet të shmangin çdo situatë të jashtme që mund të pakësojë ose që duket se zvogëlon paanshmërinë e tyre, apo mund të rrezikojë objektivitetin e tyre me rastin e zgjidhjes së një çështjeje kushtetuese. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të theksohet fraza juridike në lidhje me testin e paanshmërisë: "Drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet: ajo duhet të shihet që të bëhet" (*justice must not only be done: it must be seen to be done")*. Teoria dhe praktika ligjore njohin dy teste për të matur paanshmërinë e gjyqtarit: të ashtuquajturin testi subjektiv dhe atë objektiv të paanshmërisë në një proces gjyqësor.[141]

---

[138] Rekomandimi nr (94) 12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve.Rekomandimi është miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 tetor 1994 në takimin e 518 të zëvendës ministrave.

[139] Opinioni nr 1 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian gjendet në CCEJ) http://venice.coe.int/site/main/texts/JD_docs/CCJE_Opinion_1_E.htm.

[140] Karta mund të kërkohet në http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/ European-Charter-on-Statute-of-Judges_EN.pdf.

[141] Shih më tepër për pavarësinë e gjyqësorit, Thomas, Clarence. "Judging". U. Kan. L. Rev. 45 (1996): 1; Voeten, Erik. "The impartiality of international judges: Evidence from the European Court of Human Rights". American Political Science Review 102.04 (2008): 417-433; Kaufman, Irving R. "The Essence of Judicial Independence". Columbia Law Review (1980): 671-701;

Testi subjektiv konsiston në përpjekjet për të konstatuar bindjen personale të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar. Kjo është, natyrisht, tejet e vështirë për të provuar akuzat për mungesë të paanshmërisë së gjyqtarit në një çështje të caktuar, dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të qartë se paanshmëria personale prezumohet derisa të provohet e kundërta.[142] Edhe pse natyra e kontrollit kushtetues është disi i veçantë dhe dallon nga gjykimet e zakonshme, respektimi i këtyre standardeve është mjaft i rëndësishëm për Gjykatën Evropiane, e cila ka trajtuar parimin e paanshmërisë në një numër të rasteve. Në rastin *Saraiva de Carvalho k. të Portugalisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte elaboruar testin e paanësisë përmes këtij formulimi: "Ekzistimi i paanësisë në kuptim të nenit 6 paragr. 1, duhet parë sipas testit subjektiv, dhe kjo nënkupton mbështetur në bindjen personale të gjyqtarit përkatës në një rast të caktuar dhe, sipas testit objektiv, sipas të cilit gjyqtari ka ofruar të gjitha garancitë që janë të mjaftueshme për të evituar çfarëdo dyshimi legjitim në lidhje me këtë çështje".[143]

Shmangia e situatave që mund të përbëjnë konflikt të interesit në çështjen që shtrohet për trajtim dhe votim, përbën një aspekt tepër të rëndësishëm të paanshmërisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Qëllimi i kësaj ndalese juridike është të parandalojë gjyqtarët që të mos marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve, kur ka shkaqe ligjore që komprometojnë paanësinë e tyre, si dhe të mënjanojnë çdo sjellje që vë në dyshim real drejtësinë ose ul dinjitetin e saj.

Neni 18 [Përjashtimi i gjyqtarit] i Ligjit ka të bëjë, në veçanti, me përjashtimin e gjyqtarit nga procedura para Gjykatës, sipas detyrës zyrtare, me kërkesën e një pale apo të gjyqtarit përkatës, kur ai/ajo ka përfshirje në një rast që është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Ky nen do të komentohet në detaje në tekstin e mëtejmë të Komentarit.

Me këtë dispozitë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, legjislativi ka pasur për qëllim të tregojë rëndësinë e ruajtjes së reputacionit dhe dinjitetit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese gjatë procesit të kontrollit kushtetues. Ruajtja e dinjitetit, reputacionit dhe integritetit të tyre është një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së tyre. Në kryerjen e funksioneve të tyre, gjyqtarët duhet të udhëhiqen nga parimi se reputacioni dhe dinjiteti i Gjykatës duhet të ruhen në të gjitha kohët. Një sjellje e tillë vlen jo vetëm gjatë orarit të punës, po edhe gjatë aktiviteteve private, dhe ajo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që konfliktet e mundshme me detyrat e tij ose të saj gjyqësore, të shmangen ose, të paktën, të reduktohen në minimum. Me fjalë të tjera, imazhi i një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë imazh i një personi që rrezaton besim, respekton ligjin e Kushtetutën dhe rrit sundimin e ligjit.

Siç përcakton edhe vetë Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, "gjyqtarët, në kryerjen e detyrave të tyre, në dispozicion, duhet të tregojnë respekt për individët, dhe vigjilencë në ruajtjen e nivelit të lartë të kompetencës që vendimet e rasteve - vendimet mbi të cilat varet garantimi i të drejtave individuale dhe ruajtja e fshehtësisë së informacioneve, të cilat u janë besuar gjatë procedurës".[144] Karta Evropiane më tej

[142] Luzius Wildhaber "Judicial Impartiality under the European Convention on Human Rights", një punim që mund të kërkohet në http://www.concourt.am/hr/ccl/vestnik/2.12-2001/wildhaber-eng.htm. (qasur më 03 qershor 2014).

[143] Shih Saraiva de Carvalho v Portugal (Aplikacioni Nr. 15651/89 vendosur më 23 mars 1994).

[144] Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve (supra note 78).

parasheh që "gjyqtarët duhet të përmbahen nga çdo sjellje, veprim apo shprehje e një lloj mënyre efektive për të ndikuar në besimin mbi paanësinë dhe pavarësinë e tyre".[145]
Siç u përmend më sipër, Gjykata Kushtetuese ka miratuar Kodin e saj të Mirësjelljes, ekzistenca e të cilit është përmendur në Rregullën 12 [Funksionet e Kryetarit], (1) (g) të Rregullores së Punës, duke theksuar: "[Kryetari duhet] të sigurojë pajtueshmërinë me Kodin e Mirësjelljes dhe të mbajë rendin në mjediset dhe gjatë procedurës të Gjykatës". Rregulla 12 do të komentohtet hollësisht në tekstin e mëtejmë, kur do të diskutohet Neni 11 i Ligjit [Kryetari dhe Zëvendës Kryetari].
Neni duket se u referohet së pari detyrave të çdo gjyqtari në gjykimin kushtetues lidhur me kërkesat e paraqitura në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, si për shembull, duke vepruar si gjyqtar raportues ose anëtar i një paneli shqyrtues; pjesëmarrja në dëgjime publike; votimi për ose kundër pranueshmërisë dhe themelësisë së ankesave kushtetuese; ruajtja e konfidencialitetit të diskutimeve.
Për më tepër, gjyqtarët e Gjykatës kryejnë detyra të tjera, si: në zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit; emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Këshilltarit Kryesor Ligjor; pjesëmarrja në bazë të Rregullës 14 të Rregullores së punës (që plotëson nenin 10.3 të Ligjit), në seancat administrative (shih komentet e mëtejme); përfaqësimi i Gjykatës në ngjarjet zyrtare brenda dhe jashtë Kosovës; pjesëmarrja në programe për afrim; mësime në universitet dhe në institucione të tjera të arsimit publik dhe privat.

Neni 11 [Kryetari dhe Zëvendëskryetari]

11.1 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese:
- **1.1 koordinon aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese dhe punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;**
- **1.2 thërret dhe drejton seancat verbale të Gjykatës Kushtetuese;**
- **1.3 përfaqëson Gjykatën Kushtetuese;**
- **1.4 nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese;**
- **1.5 kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.**

11.2 Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese ushtron detyrat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese kur ky i fundit mungon ose për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e tij. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund t'ia delegojë Zëvendëskryetarit disa detyra të caktuara për të mbështetur Kryetarin në ushtrimin e detyrave të tij.

Duhet të theksohet se Ligji, në vend të asaj që mund të pritej, nuk rregullon zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Gjykatës. Vetëm Neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 5 i Kushtetutës përcakton se "Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë për një mandat tre (3) -vjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit". Neni nuk cakton se kush do të zhvillojë procesin e zgjedhjes së Kryetarit të parë dhe të Zëvendëskryetarit të Gjykatës. Për më tepër, pasi të gjithë gjyqtarët e parë në Gjykatë kanë një senioritet të barabartë, e vetmja zgjidhje e

[145] Ibid, neni 4.3.

arsyeshme për zgjedhjen e Kryetarit është që zgjedhjet t'I zhvillojë gjyqtari më i moshuar. Sa më shpejt të zgjidhet Kryetari, ai/ajo mund të zhvillojë procedurën për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit.

Është interesante të theksohet se, kur hartuesit e Kushtetutës tentuan të qartësojnë dilemën nëse zgjedhja e një gjyqtari në pozitën e Kryetarit ose Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese do të lërë të kuptojë fillimin e një mandati të ri gjyqësor, ata zgjodhën rregullën e përcaktuar në nenin 114.5 të Kushtetutës, i cili përcakton në mënyrë të qartë se zgjedhja në pozitën e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit nuk zgjat mandatin e gjyqtarit.

Për sa i përket pyetjes nëse emërimi i Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit nënkupton zgjatjen e mandatit gjyqësor të gjyqtarit përkatës, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në vendimin e saj interpretues nr. 51/99, datë 30 korrik 1999, arriti në përfundimin se "dispozita konkrete kushtetuese nuk e ndan mandatin e gjyqtarit nga mandati i Kryetarit të kësaj gjykate, në vend të kësaj ajo i bashkon ato". Sipas kësaj dispozite kushtetuese, mandati i anëtarit, Zëvendëskryetarit dhe Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit janë të unifikuara në mandatin e gjyqtarit. Është pikërisht kjo bazë e gjyqtarit të Gjykatës së Kasacionit, nga e cila buron funksioni i Zëvendëskryetarit dhe Kyetarit të kësaj gjykate".[146] Sipas të njëjtit parim, zgjedhjet për pozitën e Kryetarit/ZëvendësKryetarit të Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të interpretohen si fillim i një mandati të ri për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 114.5 të Kushtetutës.

Procedura e zgjedhjes sipas nenit 114.5 të Kushtetutës, zbatohet edhe në Bullgari, Kroaci, Hungari, Maqedoni, Slloveni dhe në Turqi.[147] Në Shqipëri, megjithatë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit për një mandat tre-vjeçar.[148]

Më shumë detaje në lidhje me zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të Gjykatës gjenden në Rregullin 10 [Zgjedhja e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit] të Rregullores së Punës.[149]

Çfarë është "pozita" e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në mesin e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës? Nëse i lexoni dispozitat përkatëse të Ligjit dhe të Rregullores së Punës, rezulton se statusi ligjor i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mbështetet në parim e barazisë. Siç thuhet në një raport të Komisionit të Venecias për Demokraci nëpërmjet Ligjit,[150] Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zakonisht konsiderohet i pari ndër të barabartët, i cili drejton institucionin e Gjykatës Kushtetuese, por që, në parim, nuk ushtron funksione juridiksionale më të larta sesa të gjyqtarëve të tjerë.

Për më tepër, Rregulla 4 paragr. 2 i Rregullores ka përcaktuar që "në ushtrimin e funksioneve të tyre...gjyqtarët kanë status të barabartë, pavarësisht moshës së tyre, rendit të emërimit ose kohës së shërbimit. Kjo barazi e statusit është pa paragjykim ndaj autorizimeve të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, të përcaktuara në këtë Rregullore

[146] Shehu k. Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr 51/99. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. 30 korrik 1999. Http://www.gjk.gov.al/. Qasja në web. 2 tetor 2013.

[147] Shih Raportin e Komisionit të Venecias (supra note 14).

[148] Shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, Art. 7 paragr. 4. Ligjimund të kërkohet në http://www.gjk.gov.al/web/ligji_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_kshtetuese_82.pdf.

[149] Shih komentet lidhur me Rregullën 10 më lart.

[150] Shih Raportin e Komisionit të Venecias (supra note 14).

të punës".[151] Statusi i barazisë është, megjithatë, pa paragjykuar kompetencat e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës, të rregulluara me Ligjin dhe Rregulloren e Punës.

Sipas nenit 11.1.1 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ushtron funksionin e koordinimit të aktiviteteve dhe organizimit të Gjykatësm siç janë, për shembull, kryesimi i mbjedhjeve të Gjykatës, koordinimi i punës së gjyqtarëve kushtetues, caktimi i gjyqtarëve raportues, i anëtarëve të kolegjeve shqyrtuese, caktimi i orarit të seancave dëgjimore për kërkesat e pranueshme. Aktivitetet e tilla të Kryetarit janë menduar për të siguruar funksionimin efektiv të Gjykatës.

Sipas dispozitës së nenit 11.1.2, Kryetari ka për detyrë të thërrasë dhe të kryesojë seancat gjyqësore (dëgjimi i palëve dhe diskutimet) dhe seancat administrative të Gjykatës. Për sa u takon seancave dëgjimore, Kryetari siguron saktësinë e procedurës dhe mban rendin në seancë. Për më tepër, ai/ajo hap dhe mbyll seancën dhe është përgjegjës për sjellje të duhur të palëve në kuadër të Gjykatës. Kryetari gjithashtu konstaton praninë e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre dhe masat që ai/ajo mund t'i marrë nëse ata nuk shfaqen në seancë. Në diskutimet e Gjykatës, gjyqtarët diskutojnë rezultatet e dëgjimeve gojore dhe të raporteve paraprake të gjyqtarëve raportues e të paneleve shqyrtuese dhe marrin vendime.

Duhet shtuar se, me kërkesë të cilësdo palë, Kryetari mund të shtyjë seancën dëgjimore, nëse pala dëshmon se nuk ka mundësi të vijë në seancë për ndonjë arsye të rëndësishme, ose nëse nuk ka kuorum.[152] Megjithatë, kur Kryetari shpall kërkesën për shtyrjen e seancës, ai mund të urdhërojë që pala kërkuese të paguajë shpenzimet që i ka shkaktuar palës ose palëve të tjera me rastin e shtyrjes së seancës. [153]

Përveç seancave dëgjimore, Kryetari ka të drejtë të thërrasë dhe të kryesojë seancat administrative të Gjykatës, të cilat thirren në bazë të Rregullës 14 nga Kryetari, të paktën dy herë në vit, ose me kërkesë me shkrim të ndonjë gjyqtari apo të Sekretariatit (për komente të hollësishme, shih Rregullën 14 [Seancat administrative] të Rregullores së Punës.[154]

Për të përfaqësuar Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet në Nenin 11.1.3, është sigurisht detyrë tipike për Kryetarin e Gjykatës. Në lidhje me këtë, Rregulla 21 [Bashkëpunimi i Brendshëm dhe Ndërkombëtar], paragrafi 1 i Rregullores së Punës, përcakton një numër të rrethanave të veçanta, ku Kryetari përfaqëson dhe drejton Gjykatën, domethënë, kur krijon dhe mban bashkëpunim me institucionet e Kosovës (Presidenca, Kuvendi, Qeveria, Gjykata Supreme dhe gjykatat e tjera, Avokati i Popullit, institucionet e vetëqeverisjes lokale dhe subjektet e tjera publike), gjykatat e huaja kushtetuese,[155] dhe organizatat vendore e ndërkombëtare aktive në fushën e sundimit të ligjit.[156]

Për më tepër, Kryetari përfaqëson Gjykatën në marrëdhëniet e saj të përditshme me institucionet e mësipërme, si dhe me mediet. Megjithatë, Kryetari është po ashtu

[151] Shih Rregulloren, neni 4 (5).
[152] Rregulli 42.2 i Rregullores së Punës.
[153] Rregulli 42.2 i Rregullores së Punës.
[154] Rregulli 14.2 i Rregullores së Punës.
[155] Shih për detaje raportet vjetore të Gjykatës Kushtetuese.
[156] East West Management Institute (EWMI); United Kingdom Department for International Development (DIFID; International Civilian Office (ICO); Deutesch Gesellschaft fuer internationale Zusammenarbeit (GIZ); and the German Foundation for International Legal Cooperation (IRZ Foundation).

përgjegjës për ruajtjen e pavarësisë së Gjykatës, të përcaktuar me Kushtetutë dhe në Ligj, në të gjitha rrethanat. Në fushën e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, Rregulla 21.2 parasheh në mënyrë të qartë që "*Bashkëpunimi duhet të zbatohet në atë mënyrë që ruan pavarësinë e Gjykatës, siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës*".

Së fundi, duhet përmendur se Kryetari përfaqëson Gjykatën në përurimin solemn të çdo viti gjyqësor, në prani të kryetarëve të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të autoriteteve të nivelit të lartë nga Kosova dhe ndërkombëtare, dhe në programe të organizuara nga Gjykata.

Një detyrë tjetër e Kryetarit është të nënshkruajë aktet e Gjykatës Kushtetuese (Neni 11.1.4), për shembull, aktvendime mbi papranueshmërinë, aktgjykime, vendime për masat e përkohshme, sqarime si dhe vendimet e tjera të Gjykatës, por edhe vendimet e marra në seanca administrative për politikat e gjykatës, emërimin e këshilltarëve ligjorë dhe të Sekretarit të Përgjithshëm, për buxhetin vjetor (në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike) dhe raportin vjetor, procesverbalet e seancave gjyqësore pas miratimit nga ana e gjyqtarëve, dhe çështje të tjera të përmendura në Rregullën 14 [Seancat administrative], të komentuar më sipër.

Së fundi, Kryetari kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo me Rregulloren e Punës (neni 11.1.5). Në lidhje me këtë, një referencë e veçantë i është bërë Rregullës 12 të Rregullores së Punës [Funksionet e Kryetarit], e cila së bashku me Rregullën 14 plotësojnë nenin 11 të Ligjit në aspekte të caktuara.

Neni 11.2, me sa duket, i referohet përgjegjësisë kryesore të Zëvendëskryetarit, roli i të cilit është të shërbejë si Kryetar i përkohshëm në të gjitha rastet kur Kryetari nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij/saj, në pajtim me dispozitat e nenit 9 si më lart. Zëvendëskryetari do të marrë përsipër të gjitha funksionet dhe kompetencat e Kryetarit të diskutuara e të komentuara si më lart, pa përjashtim.

Kryetari mund të delegojë ushtrimin e një detyre të caktuar ose një pjesë një detyre të caktuar, e cila i është dhënë sipas Ligjit dhe Rregullores së Punës, Zëvendëskryetarit, në varësi të kushteve dhe kufizimeve që mund të specifikohen në aktin e delegimit. Megjithatë, një delegim i një detyre të tillë tek Zëvendëskryetari nuk i heq përgjegjësinë Kryetarit lidhur me atë detyrë. Meqë Ligji nuk parashikon asnjë kufizim nga natyra e detyrave që mund të delegohen, Kryetari ka të drejtë të delegojë çdo funksion të cilin ai/ajo e sheh të arsyeshëm. Për shembull Zëvendëskryetari mund të marrë përsipër detyra të tilla të Kryetarit, si, për shembull, duke qenë i pranishëm në ngjarjet zyrtare, kur Kryetari mund të jetë shumë i zënë për të marrë pjesë, por edhe për të kryesuar seancat e këshillimore të Gjykatës, sa herë që Kryetari ka për dalë jashtë për një kohë të caktuar. Kryetari mund të rifillojë detyrat e tij duke njoftuar Zëvendëskryetarin dhe gjyqtarët e tjerë të Gjykatës, se arsyet që e kishë penguar atë të ushtrote detyrat e tilla, kanë pushuar së ekzistuari.

Neni 11 plotësohet nga Rregullat 10 e 12 të Rregullores së Punës.

Rregulla 10 [Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit]

10.1 Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës dhe mandatet e tyre fillojnë nga data e cekur në vendimin e Gjykatës për zgjedhjen e tyre.

10.2 Zgjedhja për Kryetar dhe për Zëvendëskryetar mbahet një muaj para skadimit të mandatit të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit në detyrë. Kryetari i Gjykatës, nëse është ende gjyqtar dhe kurdo të jetë e mundshme, vazhdon të ushtrojë funksionet e Kryetarit deri në zgjedhjen dhe deri në marrjen e funksionit nga Kryetari i ri. Në rast se posti i Kryetarit mbetet menjëherë i zbrazët, zgjedhja për Kryetar duhet të mbahet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe Zëvendëskryetari ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të mandatit të Kryetarit të ri. Në rast se nuk ka Zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën më të gjatë në Gjykatë ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm. Nëse një ose më shumë gjyqtarë në Gjykatë kanë kaluar kohë të njëjtë në Gjykatë, atëherë gjyqtari më i vjetër për nga mosha konsiderohet gjyqtari me përvojë më të gjatë për qëllim të këtij rregulli.

10.3 Kryetari udhëheq zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit. Nëse Kryetari nuk është më gjyqtar, ose nuk është në gjendje të ushtrojë detyrën e tij/saj, zgjedhjet udhëhiqen nga Zëvendëskryetari. Nëse Zëvendëskryetari nuk është më gjyqtar, ose nuk është në gjendje të ushtrojë detyrën e tij/saj, zgjedhjet udhëhiqen nga gjyqtari më i vjetër.

10.4 Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit bëhet ndaras, në mënyrë të njëjtë dhe nëpërmjet votimit të fshehtë. Të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen brenda një kohe të mjaftueshme për të marrë pjesë në zgjedhje. Të paktën shtatë gjyqtarë duhet të jenë të pranishëm në takimin në të cilin do të mbahen zgjedhjet. Gjyqtari, i cili merr votat e shumicës së të gjithë gjyqtarëve që marrin pjesë në zgjedhje dhe që votojnë, shpallet i zgjedhur dhe Gjykata përcakton datën kur gjyqtari merr përsipër përgjegjësinë e atij posti.

10.5 Në rast se, pas tri radhëve të votimit, asnjë gjyqtar nuk merr shumicën e votave, gjyqtarët zgjedhin në mes të dy gjyqtarëve që kanë marrë numrin më të madh të votave dhe zgjidhet gjyqtari që merr shumicën e votave në radhën e katërt të votimit. Për të përcaktuar nëse një gjyqtar ka marrë shumicën e votave, numërohen vetëm votat për dy kandidatët e fundit. Nëse, në radhën e tretë të votimit, tre gjyqtarë marrin nga tri vota, dy kandidatët e fundit përcaktohen me short. Nëse, në radhën e katërt të votimit, asnjëri gjyqtar nuk merr shumicën e votave, zgjedhja përcaktohet me short.

Kjo Rregull nuk specifikon kohëzgjatjen e mandatit të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit, që, në bazë të nenit 114.5 të Kushtetutës, është tre (3) vjet, por mund të jetë më i shkurtër nëse mandati i tyre si gjyqtarë përfundon në një datë më të hershme. Zgjedhja e Kryetarit aktual, Prof. Dr. Enver Hasani u mbajt më 14 qershor 2009 dhe mandati i tij ka filluar të njëjtën ditë. Më 14 maj 2012, një muaj para skadimit të mandatit të tij si Kryetar (shih rregullën 11.2), ai u rizgjodh për një mandat tjetër prej 3 vjetësh.

Disa skenarë për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit janë trajtuar në këtë Rregull:

1. Zgjedhja për Kryetar dhe për Zëvendëskryetar mbahet një muaj para skadimit të mandatit të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit në detyrë;
2. Nëse mandati i Kryetarit skadon, por jo mandati i tij/saj si gjyqtar, ai/ajo do të vazhdojë si Kryetar derisa të zgjidhet dhe të marrë funksionin Kryetari i ri. Vlen të theksohet se Rregulla nuk e ndalon ripërtëritjen e mandatit të Kryetarit për një mandat tjetër. Për më tepër, është e paqartë se për ç'arsye nuk është përmendur e njëjta procedurë për Zëvendëskryetar. Të dy procedurat mund të nënkuptohet se duhet të trajtohen në kuadër të Rregullës 10.2;
3. Nëse mandati i Kryetarit/Zëvendëskryetarit si gjyqtar skadon, zgjedhja e Kryetarit të ri/ Zëvendëskryetarit duhet të mbahet një muaj para skadimit të mandatit të tyre si gjyqtarë. Procedura mund të nënkuptohet që përfshihet në Rregullë 10.2;
4. Në qoftë se ka një vend vakant të menjëhershëm për pozitën e Kryetarit, në bazë të nenit 9 [Përfundimi i parakohshëm i mandati]: në rast të dorëheqjes apo vdekjes, ose kur Kryetari mungon për shkak të paaftësisë së përhershme ose për çështje të shëndetit, Zëvendëskryetari do të veprojë si Kryetar i përkohshëm, derisa të zgjidhet një Kryetar i ri, i cili do të marrë detyrën ("deri në datën efektive të mandatit të Kryetarit të ri"). Nëse aftësia për të vepruar dhe çështja e shëndetit janë të një natyre të përkohshme, supozohet se Zëvendëskryetari do të veprojë si Kryetar i përkohshëm derisa të kthehet Kryetari;
5. Nëse mandati i Zëvendëskryetarit skadon gjatë shërbimit si Kryetar i përkohshëm, zgjedhja e Zëvendëskryetarit duhet të mbahet një muaj para skadimit të mandatit të tij/saj. Nëse nuk rizgjedhet, Zëvendëskryetari do të vazhdojë si kryetar i përkohshëm deri në skadimin e mandatit të tij/saj të rregullt si Zëvendëskryetar, ose deri në një datë më të hershme, në qoftë se zgjedhet Kryetari i ri. Nëse rizgjedhet, ai/ajo do të vazhdojë të veprojë si Kryetar i përkohshëm derisa të zgjidhet dhe të marrë detyrën Kryetari i ri;
6. Në qoftë se mandati i Zëvendëskryetarit, i cili është duke vepruar si Kryetar i përkohshëm, skadon si gjyqtar, zgjedhja e Zëvendëskryetarit të ri duhet të bëhet një muaj para skadimit të mandatit të tij/saj si gjyqtar. Zëvendëskryetarit i ri do të shërbejë si Kryetar i përkohshëm derisa të zgjidhet dhe të marrë detyrën Kryetari i ri;
7. Në rast se nuk ka Zëvendëskryetar, në Gjykatë rolin e Kryetarit të përkohshëm e ushtron gjyqtari me përvojën më të gjatë. Nëse mandati i gjyqtarit me përvojën më të gjatë mbaron, si Kryetar i përkohshëm do të shërbejë gjyqtari pasues me përvojën më të gjatë, derisa të zgjidhet një Kryetar i ri.
8. Nëse një ose më shumë gjyqtarë në Gjykatë kanë kaluar kohë të njëjtë në Gjykatë, atëherë gjyqtari me moshë më të madhe konsiderohet gjyqtari me përvojë më të gjatë për të realizuar dispozitën sipas rregullës 10.

Rregulli thjesht përcakton që zgjedhjet për Kryetar dhe Zëvendëskryetar do t'i zhvillojë Kryetari. Natyrisht, këto zgjedhje nuk do të zhvillohen në të njëjtën kohë. Në bazë të Rregullës 10 (4) (shih komentet më lart), theksohet se "Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit bëhet ndaras, në mënyrë të njëjtë" Kryetari së pari do të zhvillojë zgjedhjet për Kryetar dhe më pastaj për Zëvendëskryetar.

Rregulla më tej parasheh që, në rast se Kryetari nuk është më gjyqtar ose është i paaftë për të vepruar, zgjedhjet do t'i zhvillojë Zëvendëskryetari. Megjithatë, është më e logjikshme që, posa të dihet data e skadimit të mandatit si gjyqtar, zgjedhjet për

Kryetar të bëhen një muaj para skadimit të mandatit si gjyqtar. Skenari i Rregullës 10.3 kur që Kryetari nuk është më tej gjyqtar dhe ZëvendëskKryetari do të zhvillojë zgjedhjet për Kryetar, pra mund të mos ndodhin.
Edhe pse nuk përmendet shprehimisht nga Rregulla, mund të thuhet se, meqë zgjedhjet e Kryetarit të ri dhe të Zëvendëskryetarit do të mbahen ndaras, së pari do të bëhet zgjedhja e Kryetari. Sapo të ketë marrë detyrën Kryetari, ai/ajo do të zhvillojë zgjedhjet për Zëvendëskryetar. Për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit është i nevojshëm kuorumi prej 7 gjyqtarëve. Votimi i fshehtë do t'u mundësojë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të bëjnë një zgjedhje të sinqertë duke parandaluar çdo përpjekje për të ndikuar në procedurën e votimit.
Sipas Rregullës, gjyqtari që merr shumicën e votave të shtatë ose më shumë gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, do të fillojë mandatin e tij/saj të Kryetarit ose Zëvendëskryetarit të përcaktuar nga Gjykata. Një rregull e ngjashme është paraparë në Rregullën 10.1, siç është komentuar më sipër. Data e fillimit normalisht do të jetë dita pas mbarimit të mandatit të Kryetarit në detyrë ose te Zëvendëskryetarit. Në rast të rizgjedhjes së Kryetarit në detyrë ose të Zëvendës Kryetarit, mandati i ri do të fillojë natyrisht pas skadimit të mandatit të tanishëm.
Nëse së paku shtatë gjyqtarë janë të pranishëm dhe votojnë, rezultati përfundimtar do të arrihet më lehtë dhe tërheqja e shortit nuk do të jetë e nevojshme, pasi do të jenë të nevojshme më së shumti tre raunde. Në rast se 8 gjyqtarë janë të pranishëm dhe votojnë, dhe dy gjyqtarë do të përfundojnë deri në raundin e katërt me 4 vota secili, atëherë do të jetë e nevojshme tërheqja e shortit.

Rregulli 12 [Funksionet e Kryetarit]

12.1 Përveç funksioneve të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në dispozitat e tjera në këtë Rregullore, Kryetari:
- **(a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Gjykatës;**
- **(b) koordinon punën e gjyqtarëve dhe thërret seancat gjyqësore dhe administrative të Gjykatës;**
- **(c) koordinon dhe mbikëqyr administrimin e të gjitha aktiviteteve të Gjykatës;**
- **(d) përfaqëson Gjykatën, themelon dhe siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe me autoritetet publike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;**
- **(e) krijon grupe punuese, për të diskutuar dhe për të bërë rekomandime për çështjet që meritojnë shqyrtim të gjerë ose interdisiplinar;**
- **(f) kryeson të gjitha takimet gjyqësore dhe administrative të Gjykatës;**
- **(g) siguron respektimin e Kodit të mirësjelljes dhe mban rendin brenda objektit dhe gjatë seancave të Gjykatës; dhe**
- **(h) informon të gjithë gjyqtarët për të gjitha çështjet në zhvillim e sipër dhe për ato të ardhshme, për proceset dhe për veprimet që kanë të bëjnë me Gjykatën.**

12.2 Zëvendëskryetari kryen detyrat e Kryetarit, kur Kryetari mungon ose kur për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të kryejë detyrat e Kryetarit.

12.3 Kryetari mund t'u delegojë detyra dhe përgjegjësi Zëvendëskryetarit ose gjyqtarëve të tjerë.

Rregulla përputhet pjesërisht me dispozitat e Nenit 11 të Ligjit. Në raste të kundërshtimit, dispozita përkatëse e Rregullës nuk do të komentohet; me këtë rast vetëm do të bëhet referencë tek dispozitat përkatëse të Nenit 11.
Rregulla 12.1 (a) kryesisht përsërit përmbajtjen e Nenit 11.1.1 dhe nuk do të komentohet më tej.
Sa i përket Rregullës 12.1 (b), shih komentet për nenet 11.1.1 dhe 11.1.2 të Ligjit si më lart.
Këto detyra, sipas Rregullës 12.1 (c) i përkasin në mënyrë të qartë punës së përditshme të Kryetarit dhe mund të konsistojnë kryesisht në udhëheqjen e Gjykatës nga pikëpamja administrative me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës, i cili i raporton drejtpërdrejt atij/asaj në pajtim me nenit 12 [Sekretariati] të Ligjit dhe Rregullën 16 [Sekretari i Përgjithshëm) të Rregullores së punës.
Lidhur me Rregullën 12.1 (d), shih komentet në për Nenin 11.1.3 të Ligjit të mësipërm.
Nuk është krejtësisht e qartë se si duhet interpretuar "shqyrtimi i gjerë ose interdisiplinar" sipas Rregullës 12.1 (e). Ideja mund të jetë për të hartuar grupe pune të përbëra nga gjykatësit dhe ndoshta Sekretari i Përgjithshëm dhe një ose më shumë këshilltarë ligjorë, për të këshilluar Gjykatën për çështje të caktuara të natyrë ndërdisiplinore. Që nga themelimi i Gjykatës janë krijuar disa grupe punuese të përbëra nga një ose më shumë gjyqtarë dhe një ose më shumë këshilltarë ligjorë, njëri prej të cilëve ka hartuar propozimin për një njësi ligjore në kuadër të Gjykatës dhe një tjetër që ka rishikuar Formularin Referues dhe ka hartuar udhëzime për mënyrën se si të ofrohen përgjigje për pyetje të ndryshme të përfshira në Formularin e Referimit.
Për si i përket Rregullës 12.1 (f) shih komentet në Nenin 11.1 (2) të Ligjit si më lartë.
Në vitin 2011, Sekretariati ka hartuar Kodin e Etikës për stafin e Gjykatës. Kodi i Etikës bazohet në Kodin e Mirësjelljes për Shërbyesit Civilë të institucioneve të Kosovës, pasi, në bazë të Rregullës 17 [Personeli i Sekretariatit], paragrafi 2, stafi i Sekretariatit janë nëpunës civilë. Për më tepër, kërkesa që Sekretariati të ketë një Kod të tillë buron nga neni 17.4, që përcakton se " i gjithë personeli i punësuar nga Sekretariati duhet të betohet në përputhje me Kodin e Etikës".
Për më tepër, në vitin 2013 gjyqtarët miratuan "Kodin e Sjelljes Gjyqësore" duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e rëndësishme që i janë besuar Gjykatës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, në këtë mënyrë, miratuan këto parime për të udhëhequr dhe rregulluar sjelljen e tyre gjyqësore. Siç përcaktohet në këtë Kod, qëllimi i këtyre parimeve është që të mbrojnë dhe të rritin besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë **e** Gjykatës, dhe për të udhëzuar gjyqtarët në ushtrimin e përgjegjësive të tyre.
Lidhur me detyrat e mëtejshme të Kryetarit, është e rëndësishme të përmendet ajo e mbajtjes së rendit në mjediset e Gjykatës, që nuk mund të jetë aq e lehtë sa duket, meqë Gjykata nuk ka ndonjë personel të sigurisë/polici të Gjykatës. Gjykata vërtet ka policë të veçantë përgjegjës për ruajtjen e hyrjes në kompleksin e Gjykatës, mirëpo nuk ka polici gjyqësore të ngarkuar për ruajtjen e rendit në ndërtesën e Gjykatës në mënyrë të veçantë gjatë seancave dëgjimore të Gjykatës, që mbahen në sallën e gjykimeve në katin e dytë të ndërtesës. Në këtë aspekt mund të bëhet një referencë tek Rregulla 41

[Pjesëmarrja në dëgjimet publike] duke përcaktuar se Kryetari mund të paralajmërojë ndonjë palë, përfaqësues, dëshmitar ose pjesëmarrës tjetër, që sjellja e tij/saj është e papranueshme dhe të urdhërojë mbajtjen e disiplinës duke përfshirë gjobë ose përjashtim nga seanca. Pa një polici të duhur gjyqësore, do të jetë e vështirë për Kryetarin të "urdhërojë disiplinë" në seancë.
Bazuar në parimet e kolegjialitetit, statusit të barabartë dhe transparencës (Rregulla 12.1 (h)), është e qartë se Kryetari duhet të informojë gjyqtarët e tjerë në seanca administrative për çështje, proces, veprime dhe aktivitete çfarëdo, të cilat kanë të bëjnë me Gjykatën, në mënyrë që të sigurohet që ata (gjyqtarët) të mund të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në njohje të plotë të të gjitha çështjeve gjyqësore relevante.
Formulimi i Rregullës 12.2 është identik me formulimin e Nenit 11.2 dhe, për këtë arsye, nuk ka nevojë të komentohet veçan.
Kryetari është i autorizuar, me sa duket, nga Rregulla 12.3, që të delegojë ndonjë detyrë a përgjegjësi jo vetëm tek Zëvendëskryetari, por edhe tek ndonjë gjyqtarë tjetër i Gjykatës Kushtetuese.

3. Administrimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 12 [Sekretaria]

12.1 Gjykata Kushtetuese ka Sekretarinë e vet e cila kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese.

12.2 Sekretaria kryen punët administrative dhe ka për detyrë të mbështesë punën e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria:

- **1.1 pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet tjera zyrtare;**
- **1.2 mban regjistrin e Gjykatës;**
- **1.3 siguron incizimet e përcaktuara me ligj;**
- **1.4 përgatitë transkriptet dhe procesverbalet;**
- **1.5 kryen punët e informimit publik dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese;**
- **1.6 mban vulën e Gjykatës Kushtetuese; dhe 8**
- **1.7 kryen punët tjera të përcaktuara me ligj dhe me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.**

12.3 Organizimi dhe mënyra e punës së Sekretarisë rregullohen me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese

12.4 Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Sekretari përzgjidhet dhe emërohet nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicë të votave. Hollësitë lidhur me përzgjedhjen, emërimin, kushtet e punës dhe pagën e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Sekretari I Përgjithshëm i raporton Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për punën e tij i'u përgjigjet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

12.5 Sekretari i Përgjithshëm emëron dhe shkarkon të punësuarit e Sekretarisë në pajtim me ligjin në fuqi për shërbimin civil. Ndaj të punësuarve të Sekretarisë zbatohen dispozitat ligjore për shërbyesit civil.

Sekretariati përbën një zyrë themelore administrative dhe ekzekutive të Gjykatës Kushtetuese dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Duhet theksuar se, kur diskutohej statusi dhe qëllimi i Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese, në mesin e anëtarëve të grupit punues ka pasur një dilemë si për emrin, ashtu edhe për kompetencat e Sekretariatit. Në veçanti, opinionet ishin të ndara nëse Sekretariati do të jetë kompetent për të shqyrtuar ose jo pranueshmërinë e kërkesës. Duke pasur parasysh modelet, mbi të cilat janë të disenjuara administratat e gjykatave kushtetuese evropiane, dhe duke marrë parasysh këshillat nga ekspertët ndërkombëtarë, hartuesit e Ligjit vendosën të krijonin institucionin e Sekretariatit të Përkohshëm për një periudhë fillestare, për të procedurar krijimin e një Sekretariati të Përhershëm kryesuar nga Sekretari i Gjykatës Kushtetuese, që do të emërohej nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave. Themelimi i Sekretariatit të Përkohshëm është përcaktuar në nenin 57 [Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese] të Kapitullit IV [Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare] të Ligjit (shih komentet për Nenin 57 në tekstin e mëtejmë).

Sekretariati është motori dhe mbështetja administrative e Gjykatës. Në mungesë të Sekretariatit, Gjykata nuk do të ishte në gjendje të funksiononte dhe, nëse do të bënte një punë të dobët, Gjykata nuk do të ishte në gjendje të funksiononte siç duhet. Andaj është me rëndësi të madhe për Gjykatën, që ajo të mund të mbështetet në një Sekretariat që përmbush detyrat e veta nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

Fushëveprimi i pranimit dhe dërgimit të të gjitha komunikimeve zyrtare është shumë i gjerë: kjo përfshin shkresat dalëse të Gjykatës (raportet për pranueshmëri, aktgjykimet dhe vendimet e tjera) për publikim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, deri tek dërgimi i ftesave për seancat dëgjimore, dhe shpërndarjen e postës dhe korrespondencës për palët e tjera në procedurën para Gjykatës, si dhe qarkullimin e komunikimeve zyrtare brenda Gjykatës.

Megjithatë, roli i Sekretariatit nuk është vetëm administrativ dhe teknik. Duke marrë parasysh udhëtimin e një kërkese kushtetuese, duket se Sekretariati luan një rol të rëndësishëm në procedimet e kërkesës kushtetuese, që paraqiten para Gjykatës. Sipas nenit 22 të Ligjit, Sekretaria e Gjykatës është një hallkë ndërlidhëse dhe funksionale shumë e rëndësishme, e cila vihet dhe ndërvepron në mes aplikantit (personit që dorëzon kërkesën kushtetuese), në një anë, dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në anën tjetër. Së këndejmi është Sekretaria ajo që vë në lëvizje një proces të kontrollit kushtetues me aktin e regjistrimit të kërkesës kushtetuese. Rrjedhimisht, fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës kushtetuese në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese, e cila regjistron kërkesën në regjistrin e Gjykatës (sipas radhës së parashtrimit të tyre) dhe më pastaj atë (nga një kopje të kërkesës) ia dërgon palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Por roli i Sekretariatit nuk përfundon në këtë fazë të procedurës, sepse Neni 22 i Ligjit i ka rezervuar palës kundërshtare a pjesëmarrësit në procedurë, të drejtën për përgjigje ndaj kërkesës brenda dyzet e pesë (45) ditësh nga marrja e kërkesës, Sekretaria i dërgon gjyqtarit raportues, i cili caktohet nga Kryetari i Gjykatës për të përgatitur një raport paraprak (mbi faktet, lejueshmërinë dhe bazat e referimit), një kopje të kërkesës dhe, pas kësaj, përgjigjen e kërkesës, sa më shpejt që është e mundur (shih komentet e detajuara në nenin 22 të Ligjit, në tekstin e mëtejmë).

Sidoqoftë, duhet theksuar fakti se as Ligji dhe as Rregullorja nuk i kanë dhënë të drejtën Sekretarisë, respektivisht Sekretarit, të drejtën për të vlerësuar paraprakisht pranueshmërinë e kërkesës kushtetuese, siç është rasti me Këshillin e Shtetit në Greqi, me Gjykatën Supreme në Irlandë ose me Gjykatën e Luksemburgut, në të cilat nuk ekzistojnë mekanizma të filtrimit të kërkesave kushtetuese.[157] Kur është fjala për vlerësimin paraprak të pranueshmërisë së kërkesës, në kontekstin e Kosovës, Rregullorja e Punës përcakton që Sekretariati do të regjistrojë kërkesën vetëm atëherë kur të jenë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme. Sekretariati, pra, mund të këshillojë aplikantin që të heqë dorë nga paraqitja e kërkesës, në rast se kërkesa nuk është e plotë apo nëse është e qartë që është e palejueshme, dhe t'u shpjegojë palëve arsyet për këtë.[158] Kjo detyrë kryhet normalisht nga anëtarët (këshilltarë juridikë dhe hulumtues juridikë) të Njësisë Juridike të Gjykatës (shih komentet për nenin 13 [Këshilltarët Juridikë] të Ligjit. Por, pavarësisht nga kjo rregull, Sekretaria do të bëjë regjistrimin e kërkesës në rast se pala, pavafrësisht nga këshillimi, insiston që kërkesa e saj të regjistrohet.

Për më tepër, Sekretariati do të procesojë komunikimet zyrtare drejtuar institucioneve publike në Kosovë dhe, kur është e nevojshme, harton draft letra të nënshkruara nga Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm ose nga gjyqtari. Komunikimet zyrtare nga dhe tek adresat e huaja, kanë të bëjnë me korrespondencën në mes Kryetarit të Gjykatës dhe kolegëve të tij të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera.[159]

Edhe pse Neni 12.2.2 hesht për këtë çështje, supozohet se regjistri, siç përmendet këtu, do të thotë regjistri për referime. Përveç këtij regjistri, Sekretariati mban sigurisht një regjistër shtesë, ku janë të regjistruara të gjitha komunikimet e tjera hyrëse dhe dalëse. Në regjistrin për referime, Sekretariati paraqet të gjitha referimet sipas datës dhe kohës së dosjeve, emrin e aplikantit (palët e autorizuara neni 113 [Palët e Autorizuara] të Kushtetutës), që bëjnë dorëzimin e kërkesës, të paditurin ose palën e interesuar, numrin e regjistrit, Gjyqtarin raportues si dhe anëtarët e Panelit Shqyrtues të emëruar nga Kryetari, në bazë të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit (shih komentet për nenin 29).[160] Sekretariati është gjithashtu përgjegjës për mbajtjen e të gjitha akteve, fotografive, shënimeve dhe arkivave të Gjykatës, ndërsa Departamenti i tij për Menaxhimin e Lëndëve, cakton një numër të regjistrimit për çdo kërkesë dhe krijon një lëndë për secilin rast që përfshin të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me kërkesën, duke përfshirë të gjitha komunikimet me palët dhe materiale të krijuara gjatë procedurës.[161]

Për sa i përket kuptimit të fjalës "incizim" neni 12.2.3 nuk ofron hollësi të mëtejshme, me përjashtim të referencës tek "Ligji". Megjithatë, Ligji për Gjykatën Kushtetuese hesht për këtë çështje. Çfarë nënkuptohet, me siguri është audio-incizimi i seancave gojore të Gjykatës nga Sekretariati dhe trajtimi i incizimeve të tilla pas kësaj. Ndërsa Rregullorja e Punës në Rregullën 15 [Sekretariati], paragrafi 1 (a) përmend vetëm se Sekretariati ofron "shërbime mbështetëse për seancat e Gjykatës", Neni 28 [Regjistrimi

[157] Analizë e Komisionit të Venecias: "Statusi dhe funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm të gjykatave kushtetuese dhe organeve ekuivalente". Punimi është në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-JU (2004) 034-e.asp. (shikuar më 3 qershor 2014).
[158] Rregulli 30.1 i Rregullores së Punës.
[159] Rregulli 15 i Rregullores së Punës.
[160] Rregulli 30 i Rregullores së Punës.
[161] Rregulli 30.3 i Rregullores së Punës.

i dëgjimeve publike], paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë është shumë më i qartë, duke përcaktuar: "Incizimi i dëgjimeve publike bëhet dhe ruhet si audio-incizim". Andaj mund të thuhet se neni 12.2.3 i Ligjit mund të interpretohet në mënyrë të ngjashme.

Dispozita e nenit 12.2.4 i ka dhënë Sekretariatit autoritetin për të përgatitur transkriptet dhe procesverbalet, por nuk ofron detaje të mëtejshme. Sipas Rregullës 43 [Procedura e Dëgjimit], paragrafi 9, me sa duket, fjala është për transkripte dhe procesverbale "të seancave",[162] të cilat duhet të nënshkruhet nga Kryetari. Transkriptet janë zakonisht kopje të procesverbalit të seancës dëgjimore, të cilat përgatiten nga një raportues i gjykatës (shtypja e çdo gjëje që është thënë gjatë gjykimit fjalë për fjalë), por mund të jetë edhe një dokument i shtypur i një audio-incizimi. Nuk është e qartë nëse transkriptet janë të hapura për publikun, në mënyrë që të sigurohet ndonjë kopje e informacionit. Sipas Rregullës 22, vetëm palët kanë të drejtë të kenë qasje në dokumente zyrtare në rastet në të cilat ato janë palë, përveç nëse dokumenti ose lënda është konfidenciale, siç përcaktohet nga Gjykata.

Procesverbali, megjithatë, përmban vetëm atë çfarë ndodh gjatë seancës dëgjimore të gjykatës, ose, për shembull: informacione në lidhje me datën dhe orën e seancës, vendin e seancës; emrat e gjyqtarëve të pranishëm dhe kapacitetin e tyre zyrtar (Kryetari, Zëvendëskryetari, gjyqtarët, gjyqtarët raportues, anëtari i Panelit Shqyrtues, Kryetari i kolegjit); informacione në lidhje me palët, përfaqësuesit dhe pjesëmarrësit e tjerë në seancë si dëshmitarë, ekspertë dhe *amicus curiae*; përmbledhje të prezantimeve nga ana e gjyqtarit raportues, e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë; pyetje e përgjigje dhe përmbledhje të deklaratave përfundimtare. Megjithatë, Sekretariati siguron po ashtu hartimin e procesverbaleve për seanca administrative dhe për seancën e këshillimeve në Gjykatë.

Kryerja e veprimtarive të informimit publik nga Sekretariati, është pjesë e programit të Gjykatës në terren për të sjellë Gjykatën dhe përgjegjësitë e saj më afër publikut. Për shembull, Sekretariati mirëmban faqen zyrtare të Gjykatës, tekste të plota të gjitha aktvendimeve, aktgjykimeve dhe vendimeve të tjera në gjuhën shqipe, serbe, angleze e turke dhe jep informacion të përgjithshëm për Gjykatën dhe aktivitetet e saj.

Detajet rreth seancave të caktuara të Gjykatës paraqesin po ashtu atë që e bën të gjithë procesin e gjykimit kushtetues më transparent. Faqja e internetit më tej përfshin tekstet integrale të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregulloren e Punës. Aktivitetet e informimit publik, si publikime dhe aktivitete në terren, nuk ndërmerren vetëm nga Sekretariati po edhe nga ana e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë, të cilët marin pjesë në seminare e punëtori për këshilltarë ligjorë, dhe palë të tjera të interesuara në lidhje me Gjykatën dhe aktivitetet e tij/e saj si dhe se si të paraqitet një kërkesë në Gjykatë.

Sekretariati u përgjigjet po ashtu kërkesat për informacion në lidhje me punën e Gjykatës. Për këtë qëllim, Sekretariati ka rekrutuar një zëdhënës, puna e të cilit është për t'iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve a të personave të tjerë, të cilët kontaktojnë Gjykatën duke kërkuar informacione në lidhje me punën e Gjykatës në përgjithësi, ose në lidhje me raste të veçanta, të cilat janë në pritje në Gjykatë, ose me rastet që tashmë janë gjykuar.

[162] Rregulla 43 (9) parashikon: "Sekretari i Përgjithshëm do të sigurojë që transkriptet dhe procesverbalet e seancës janë përgatitur dhe nënshkruar nga Kryetari".

Vula e Gjykatës mbahet nga Sekretariati, për të vërtetuar të gjitha komunikimet dhe dokumentet zyrtare të Gjykatës. Edhe pse nuk parashikohet shprehimisht, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm mund të kenë një vulë të Gjykatës për ushtrimin e funksioneve të tyre

Detyra të tjera, të përcaktuara me Ligjin dhe Rregulloren e Punës, që t i kryen Sekretariati, përfshijnë, për shembull, veprimet e përcaktuara në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, ku Sekretariati është ngarkuar me regjistrimin e menjëhershëm të çdo kërkese kushtetuese sipas radhës së paraqitjes, dhe me dërgimin e kopjeve të kërkesës palës kundërshtare dhe palë(ve) ose pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Detyra të tjera që i janë besuar Sekretariatit nga Gjykata sipas Rregullores së brendshme, janë të shumta. Ato variojnë nga përgatitja e një liste të hapësirave, të cilat do të ishin të përshtatshme për të zhvilluar takime dhe seanca të Gjykatës jashtë selisë në Prishtinë (Rregulla 2) dhe komunikimi i një kopjeje të letërdorëheqjes së gjyqtarit për të gjithë gjyqtarët e tjerë dhe palët e tjera (Rregulla 5 [Dorëheqja e gjyqtarëve]) deri tek hartimi, sipas sugjerimit të Kryetarit, i propozimeve për politika për shqyrtim dhe miratim nga Gjykata në seancë administrative (Rregulla 14 [seancat administrative], paragr. 1, dhe njoftimi i regjistrimit dhe numrit të regjistrimit të personit që ka paraqitur kërkesën dhe të çdo pale kundërshtare ose pale tjetër të interesuar, si dhe i thirrjeve për dëgjimin e palëve (Rregulla 42 [njoftim dëgjimi]) dhe paradhënie për dëshmitarët dhe ekspertët për shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit (Rregulla 50 [Kompensimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve]). Këto detyra do të komentohen në tekstin e mëtejmë të komentarit.

Me anë të kësaj dispozite (neni 12.3), ligjvënësi ka autorizuar Gjykatën Kushtetuese, me anë të Rregullores së Punës, për të përcaktuar më tej përgjegjësitë e Sekretariatit për shërbimet mbështetëse në Gjykatë, përfshirë strukturën organizative dhe detyrat shtesë të Sekretariatit. Gjykata e ka bërë këtë në mënyrë të veçantë duke miratuar Rregullën 15 [Sekretariati] të Rregullores së Punës, që plotëson nenin 12.3 të Ligjit. Si detyrë shtesë, që i është dhënë Sekretariatit nga Gjykata, prej atyre që përmenden në Rregullën 15, tashmë janë përmendur në komentet në Nenin 12.2.7 më lart, të cilat nuk përputhen plotësisht me nenin 12.3.

Edhe pse Ligji dhe Rregullorja janë të heshtin për këtë çështje, është lënë të nënkuptohet se statusi ligjor i Sekretarit të Përgjithshëm është i statusi nëpunësit civil dhe, si i tillë, ai/ajo i nënshtrohet Ligjit për shërbyes civilë.[163] Referenca për zbatimin e dispozitave të Shërbimit Civil është përmendur në Nenin 12 paragr. 5 të Ligjit, që i mundësojnë Sekretarit të Përgjithshëm për të vepruar në pajtim me Ligjin në fuqi mbi Shërbimin Civil me rastin e emërimit dhe shkarkimit të punonjësve të Sekretariatit. Si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv i Sekretariatit, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e saj tij si dhe për funksionimin e saj tij të duhur. Ai/ajo zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash të gjyqtarëve, mirëpo neni nuk specifikon nëse është e nevojshme një shumicë e thjeshtë e gjyqtarëve të pranishëm e që votojnë (në një kuorum prej shtatë gjyqtarëve të pranishëm), ose shumica prej të gjithë gjyqtarëve. Megjithatë, neni ka deleguar përcaktimin e detajeve në lidhje me zgjedhjen, emërimin, kushtet e punës dhe të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm, në Rregulloren e Punës së Gjykatës, e cila përmban detaje të tilla në Rregullën 16 (shih për hollësi të mëtejshme komentet lidhur me Rregullën 16). Prandaj rregullat e

[163] Ligji Nr. 03 / L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

procedurës në Rregullën 16 përcaktojnë që "Sekretari i Përgjithshëm emërohet në seancë administrative, me shumicë të thjeshtë votash të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Emërimi duhet të jetë i bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues, të përzgjedhjes".

Edhe pse sipas nenit 12.4 Sekretari i Përgjithshëm i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Gjykatës, ai/ajo është përgjegjës/e ndaj të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës. Kjo vetëm mund të nënkuptojë se, në qoftë se gjyqtarët konsiderojnë që Sekretari i Përgjithshëm nuk menaxhon Sekretariatin në mënyrë efektive dhe efikase dhe/ose nuk i kryen funksionet dhe përgjegjësitë e tjera të tij/saj në mënyrë të kënaqshme, ai/ajo mund të shkarkohet ose të pezullohet përkohësisht me shumicë të votave të gjyqtarëve të përcaktuar me Rregullën 16 (5).

Për më tepër, Sekretari i Përgjithshëm duhet të ndjekë udhëzimet e Kryetarit, për shembull, për të organizuar seanca verbale, në përurimin solemn të vitit të ri gjyqësor dhe për vizita zyrtare në gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera.

Në bazë të nenit 12.5, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për rekrutimin dhe shkarkimin e stafit të Sekretariatit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil. Kështu, punonjësit e Sekretariatit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet sipas këtij Ligji, dhe kanë të drejtë të përdorin të gjitha mjetet juridike të përcaktuara nga ky Ligj, nëse mendojnë se janë trajtuar në kundërshtim me këtë ligj, për shembull, në rast të ndonjë shkarkimi të padrejtë. Është interesant të theksohet se Rregullorja e Punës (Rregulla 17) thekson se "në mënyrë që të ruhet pavarësia kushtetuese dhe juridike e Gjykatës dhe duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Gjykatës në interpretimin kushtetues, rregullat e përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil për rekrutimin e personelit, për pagat, për shtesat, për orarin e punës dhe për pushimet, nuk zbatohen". Mund të thuhet se, edhe pse qëllimet për mbrojtjen e pavarësisë kushtetuese të Gjykatës janë të arsyeshme, duhet të merret parasysh fakti se Rregullorja e punës autoritetin e tyre e fitojnë nga një akt më i lartë juridik, si Ligji për Gjykatën Kushtetuese, i cili nuk e ka mandatuar Gjykatën Kushtetuese për të rregulluar emërimin dhe shkarkimin e personelit administrativ në bazë të Rregullores së Punës. Ligji vetëm i bën thirrje Sekretarit të Përgjithshëm që të veprojë në pajtim me Ligjin në fuqi mbi Shërbimin Civil në çështjet lidhur me caktimin dhe shkarkimin e stafit administrativ. E njëjta gjë vlen edhe për festat zyrtare, të cilave u referohet Rregullorja e Punës. Kuvendi i Kosovës ka miratuar një ligj mbi festat zyrtare, të cilit duhet t'i nënshtrohen të gjitha organet kushtetuese, përfshirë Gjykatën Kushtetuese.[164]

Për më tepër, me rastin e themelimit të Sekretariatit, Sekretari i Përgjithshëm është i detyruar të ndjekë politika të rekrutimit, në bazë të nenit 11 (3) të Ligjit për Shërbimin Civil, që përcakton: "Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror, të paktën 10% të pozitave, duhet të jenë të rezervuara për personat që u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit".[165]

Si rezultat, gjatë vitit 2010 janë ndjekur procedurat e rekrutimit, përmes të cilave janë zbatuar politika jodiskriminuese në mënyrë të veçantë lidhur me barazinë gjinore dhe përfaqësimin shumetnik. Pas vlerësimit të planit strategjik të Gjykatës për vitet 2010 -

[164] Ligji nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

[165] Shih Raportin Vjetor të Gjykatës Kushtetuese, Departamenti i Administratës dhe Personelit, faqe 132. Raporti vjetor mund të gjenden në faqen e internetit të Gjykatës në http://gjk-ks.org/.

2013 si dhe planit të rekrutimit për stafin për vitin 2010, është arritur përqindja e dhënë me Ligjin për rekrutimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe pjesëmarrja e kënaqshme e personelit femra.[166]
Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, Sekretari i Përgjithshëm është i autorizuar edhe për të pezulluar dhe disiplinuar anëtarë të stafit të përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil. Në të njëjtën kohë, stafi i Gjykatës duhet të përmbushë kërkesat e Ligjit në lidhje me ecurinë e punës, besnikërinë, konfidencialitetin, efikasitetin dhe detyrimet e tjera të lidhura me punën. Në të njëjtën kohë, stafi civil duhet të japë betimin në përputhje me Kodin e Etikësë të hartuar nga Sekretariati në vitin 2011.[167]
Neni 12 i Ligjit është plotësuar me Rregullën 15 [Sekretariati], 16 [Sekretari i Përgjithshëm] dhe 17 [Personeli i Sekretariatit] të Rregullores së punës.

Rregulli 15 [Sekretariati]

15.1 Përveç funksioneve dhe përgjegjësive të caktuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Sekretariati) ka përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve administrative e teknike dhe të shërbimeve të tjera mbështetëse për Gjykatën, përfshirë, por jo kufizuar, në:
(a) shërbimet mbështetëse për seancat dëgjimore të Gjykatës;
(b) shtypjen e dokumenteve dhe të materialeve të tjera;
(c) shërbimet e përkthimit;
(d) shërbimet e ndërlidhura me buxhetin, me pagesat, me auditimin e brendshëm, me prokurimin dhe me personelin;
(e) shërbimet e menaxhimit të objektit, shërbimet teknike, pajisjet e zyrave, shërbimet për automjete, shërbimet postare, kujdesin kundër zjarrit dhe shërbimet e tjera të sigurisë;
(f) shërbimet mbështetëse për hartimin dhe për botimin e raportit vjetor; dhe
(g) shërbime të tjera mbështetëse, që mund të përcaktohen nga Gjykata.

15.2 Struktura organizative e Sekretariatit përcaktohet nga gjyqtarët në seancë administrative, pas propozimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm. Me miratimin e gjyqtarëve, Sekretari i Përgjithshëm mund të themelojë ose të mbyllë sektorë apo njësi, kur kjo është e nevojshme për zbatimin efikas të funksioneve dhe të përgjegjësive të Sekretariatit.

Rregulla 15.1 parasheh një listë jo të plotë të shërbimeve administrative, teknike dhe të shërbimeve të tjera të mbështetjes nga ana e Sekretariatit të Gjykatës, të cilat nuk shtrojnë nevojën për komente të mëtejshme. Sipas nënparagrafit (g), Gjykata mund t'i kërkojë Sekretariatit që të sigurojë shërbime të tjera të mbështetjes, të cilat nuk janë përmendur në Ligj ose në Rregulloren e Punës.
Është detyrë e Sekretarit të Përgjithshëm[168] për të përgatitur një projektpropozim, mbi bazën e të cilit gjyqtarët do të jenë në gjendje të përcaktojnë strukturën organizative të

[166] Ibid.
[167] Kodi i Etikës mund të gjendet në faqen e internetit të Gjykatës së http://gjk-ks.org/.
[168] Shih për detaje të mëtejme nenin 12.4 dhe Rregullin 16 më poshtë.

Sekretariatit. Pasi të themelohet Sekretariati, Sekretari i Përgjithshëm mund të bëjë ndryshime në strukturën organizative të Sekretariatit për të përmirësuar funksionimin e tij dhe efikasitetin gjithnjë me miratimin e gjyqtarëve. Përmirësime të tilla mund të përfshijnë, siç përmendet në nenin respektiv, me themelimin ose heqjen e departamenteve, seksioneve ose njësive, në mënyrë që Sekretariati të mund të kryejë funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë më efektive dhe efikase.
Mirëpo, Sekretari i Përgjithshëm nuk është i autorizuar të bëjë ndonjë ndryshim në strukturën organizative të Sekretariatit sipas vendimit të tij/saj, por vetëm me miratimin e gjyqtarëve. Aktualisht, struktura organizative e Gjykatës Kushtetuese përfshin katër departamente nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm: (1) Departamenti i Administratës dhe Personelit, (2) Departamenti për Regjistrimin e Lëndëve, Statistika dhe Arkivi; (3) Departamenti i Mbështetjes Profesionale; dhe (4) Departamenti i Buxhetit dhe Financave. Për më tepër, janë themeluar njësitë organizative për prokurim, marrëdhënie të jashtme, kontroll të brendshëm, informacion publik dhe për certifikim, të cilat i raportojnë drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm.

Rregulli 16 [Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm]

16.1 Sekretari i Përgjithshëm është kryeshef ekzekutiv i Sekretariatit. Ai i raporton Kryetarit dhe është përgjegjës për:

(a) administrimin e përgjithshëm dhe për menaxhimin e Sekretariatit, si dhe për të siguruar se funksionet e caktuara të tij përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase;

(b) nxjerrjen e rregulloreve dhe të udhëzimeve për çfarëdo çështjesh që kanë të bëjnë me funksionimin e Sekretariatit dhe të çështjeve të ndërlidhura administrative;

(c) të siguruar se vendimet e Gjykatës përkitazi me çështjet administrative zbatohen brenda afateve kohore dhe në mënyrë efikase;

(d) menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve;

(e) organizimin dhe për plotësimin me personel të Sekretariatit, për të siguruar se rekrutimi i personelit për Sekretariat është i bazuar në kualifikime profesionale, në aftësi dhe në merita dhe se ai bëhet me konkurs të drejtë e të hapur; dhe

(f) zbatimin e politikave jodiskriminuese, sa i përket personelit brenda Sekretariatit, përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjithë lëmenjtë dhe nivelet, dhe për të siguruar se përbërja e personelit pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës.

16.2 Sekretari i Përgjithshëm emërohet në seancë administrative, me shumicë të thjeshtë votash të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Emërimi duhet të jetë i bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues, të përzgjedhjes.

16.3 Kushtet e punësimit dhe paga:

(a) Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është 3 vjet me mundësi vazhdimi.

(b) Vlerësimi i performancës bëhet në fund të çdo viti në bazë të planit vjetor që paraqet Sekretari i Përgjithshëm.

(c) Paga e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohet me vendim të Gjykatës.

16.4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë, së paku, kualifikimet minimale të përcaktuara më poshtë:

(a) përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, në ato ekonomike, në menaxhim ose në administratë;

(b) pesë vjet përvojë pune, nga të cilat së paku dy vjet përvojë profesionale në administratë dhe në menaxhim; dhe

(c) të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

16.5 Konkursi për postin e Sekretarit të Përgjithshëm shpallet së paku në tri (3) gazeta që shpërndahen gjerësisht në Kosovë. Aplikacionet do të shqyrtohen nga komisioni përzgjedhës, i përbërë nga tre gjyqtarë të emëruar nga Kryetari. Komisioni përzgjedhës ua paraqet gjyqtarëve listën e personave që kanë konkurruar dhe që i përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafin (3).

16.6 Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet, ose të suspendohet përkohësisht, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në seancë administrative të Gjykatës.

16.7 Kryetari emëron Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm, i cili do të jetë përgjegjës posaçërisht për logjistikën, për prokurimin dhe për financat e Gjykatës. Zëvendëssekretar i Përgjithshëm do të jetë njëri nga drejtorët e Sekretariatit, i cili njëkohësisht do të ushtrojë funksionin e tij/saj të drejtorit. Mandati i Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm do të jetë tri (3) vjet dhe paga e tij/saj do të jetë për 15% më e ulët se paga e Sekretarit të Përgjithshëm.

Komisioni i Venecias në Buletinin e tij special ofron një analizë të detajuar të statusit dhe funksioneve të Sekretarit të Përgjithshëm të gjykatave kushtetuese.[169] Sa i përket Rregullës 16, është menduar që përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm, të përmendura në paragrafin (1), nuk janë të plota dhe mund të shtohen edhe kompetenca të tjera, nëse një gjë e tillë shihet e arsyeshme nga ana e gjyqtarëve. Në këtë drejtim, do të sugjerohej që në fund të Rregullës 16 (1) të shtohej një nënparagraf (g), që do të përcaktonte "përgjegjësitë tjera siç kërkohet nga ana e gjyqtarëve".

Rregulla 16.1 (a) thekson se Sekretari i Përgjithshëm duhet të drejtojë Sekretariatin në mënyrë të tillë, që të gjitha funksionet të kryhen në mënyrë efektive dhe efikase nga departamentet e ndryshme dhe nga personeli i tyre, dhe të ndërhyjë pa vonesë, sa herë që kjo është bërë në mënyrë të kënaqshme. Sekretari i Përgjithshëm është, pra, përgjegjës për "vendosjen e cilësisë" dhe për "kontrollin e cilësisë ".

Shembuj të udhëzimeve që lidhen me çështje administrative dhe të nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm, janë, për shembull, udhëzimet administrative për përdorimin e automjeteve zyrtare të Gjykatës Kushtetuese; përdorimi i telefonave fiks dhe celularë në Gjykatë; dhe ndarja e shpenzimeve të reprezentacionit. Për më tepër, siç u përmend më lart, Sekretariati ka hartuar gjithashtu Kodin e Etikës së bashku me deklaratën e betimit për stafin e shërbimit civil të Gjykatës, siç kërkohet në rregullën 14 [Seancat Administrative], paragrafi 3 (h), që u miratua nga ana e gjyqtarëve në një seancë administrative të Gjykatës.

[169] Buletini mund të gjenden në http://venice.coe.int/files/Bulletin/SpecBull-Secretaries-General-e.pdf.

Vendimet e përmendura janë ato të marra nga gjyqtarët në seanca administrative. Është detyra e Sekretarit të Përgjithshëm për të kryer vendime të tilla, sa më shpejt të jetë e mundur dhe për të mbajtur Kryetarin dhe gjyqtarët të informuar përfshirë problemet eventuale në zbatimin e tyre. Si pjesë e aktiviteteve me publikun, Gjykata publikon vendime të tilla në *ueb faqen* e saj zyrtare.

Sekretarit të Përgjithshëm i është besuar po ashtu edhe detyra për të menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive burimet financiare, të cilat i atribuohen Gjykatës nga Kuvendi për një vit të caktuar buxhetor. Ai/ajo ndihmohet në këtë detyrë nga Drejtori Financiar dhe Auditori i Brendshëm i Gjykatës. Për më tepër, në fund të çdo viti auditohen shpenzimet e Gjykatës nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, i cili, në bazë të nenit 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës, është kompetent, ndër të tjera, për të bërë auditimin rreth përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve publike nga autoritetet qendrore dhe lokale.[170]

Për sa i përket punësimit të personelit të Sekretariatit, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar që të jenë respektuar plotësisht kriteret e Rregullës. Kriteret e ngjashme janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil dhe duhet të përmbushen plotësisht. Mbi këtë bazë, procedurat e rekrutimit duhet të jenë të drejta e transparente dhe sa më shumë të jetë e mundur të monitorohen nga një ose më shumë gjyqtarë. Për më tepër, në rast se një kandidat i pasuksesshëm ka ndonjë dyshim rreth zhvillimit të drejtë të procedurës së rekrutimit, së pari duhet të bëhet një hetim i duhur nga Sekretari i Përgjithshëm, para se personi në fjalë të fillojë të përdorë ndonjë prej mjeteve juridike në bazë të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, nëse janë të përcaktuara.

Mund të thuhet se politikat e personelit, të përmendura nga Rregulla, burojnë nga Ligji për Shërbimin Civil dhe janë të bazuara në parimet e të drejtave të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutë. Mosrespektimi i këtyre politikave të personelit mund të çojë në pezullimin e përkohshëm ose shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës (shih komentet për Rregullën 16.5, në tekstin e mëtejmë).

Kërkesat e procesit të përzgjedhjes siç përcaktohet në këtë Rregull, janë të ngjashme me ato të përcaktuara në nenin 12.4, përveç kërkesës që emërimi duhet të bazohet në një proces transparent dhe të hapur. Kjo kërkesë është hedhur edhe në nenin 11 të Ligjit për Shërbimin Civil.[171] Është e kuptueshme që procesi transparent, i hapur dhe konkurrues i përzgjedhjes është përcaktuar në Rregullin 16.4 (shih komente të detajuara mbi rregullin 16.4, në tekstin e mëtejmë).

Duke se Rregullorja e Punës nuk ka përcaktuar që Sekretari i Përgjithshëm të betohet pas emërimit para fillimit të mandatit të tij/saj, edhe pse në bazë të Rregullës 17 i gjithë personeli i punësuar nga Sekretariati duhet të japë betimin në përputhje me Kodin e Etikës, prandaj sugjerohet që kjo Rregull të ndryshohet në përputhje me rrethanat.

Kualifikimet minimale të përcaktuara në Rregull, janë kumulative, kështu që çdo kandidat të cilit i mungon ndonjë nga këto kualifikime, duhet të diskualifikohet. Supozohet se kërkesa minimale për shkollim të avancuar universitar nënkupton jo një *baçelor*, po një diplomë *masteri*. Përvoja profesionale prej të paktën pesë vjetësh duket

[170] Shih për detaje të përgjegjësive dhe kompetencave të auditorit të përgjithshëm, nenet 136-138 të Kushtetutës.

[171] Ligji 03 / L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ligji gjendet në http://gazetazyrtare.rks-gov.net/SearchResults.aspx.

të jetë mjaft e shkurtër për një pozicion të tillë të rëndësishëm të kryeshefit ekzekutiv të Sekretariatit të Gjykatës, por do të jetë në të mirë të kandidatëve që kanë më tepër vite të përvojës së punës.

Edhe pse nuk përmendet shprehimisht në Rregull, konkursi në lidhje me vendin e lirë për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të publikohet në gjuhët zyrtare në Kosovë, në pajtim me Ligjin në fuqi mbi Shërbimin Civil. Për më tepër, Rregulla duket të jetë disi e paplotë. Paneli i përzgjedhjes mund t'u paraqesë gjyqtarëve listën e personave që kanë përmbushur kërkesat e Rregullës 16.3, por Rregulla nuk përcakton se çfarë do të ndodhë më pastaj. Me sa duket, kandidatët në listë do të intervistohen nga gjyqtarët, të cilët pas një ose më shumë raundesh, do të zgjedhin kandidatin e suksesshëm me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në seancë administrative, sipas Rregullës 16.2. Megjithatë, kjo pjesë vendimtare e procedurës së përzgjedhjes duhet të përcaktohet si duhet me Rregulloren e Punës, prandaj rekomandohet që kjo Rregull duhet të plotësohet përshtatëshmërisht.

Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet ose të pezullohet përkohësisht në të njëjtën mënyrë si është zgjedhur, domethënë me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në një seancë administrative. Rregulla nuk jep asnjë detaj për sa u përket rrethanave në të cilat mund të mbështeten gjyqtarët për të shkarkuar ose pezulluar Sekretarin e Përgjithshëm. Baza për masa të tilla duhet të gjendet në Ligjin për Shërbimin Civil dhe në Rregulloren nr. 01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e punësimit në shërbimin civil në Kosovë, e cila ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shqiptimin e masave disiplinore dhe sanksionet kundër nëpunësve civilë në Kosovë.[172]

Supozohet se shkarkimi ose pezullimi i Sekretarit të Përgjithshëm mund të fillohet në mënyrë të ngjashme sikurse shkarkimi i gjyqtarit (shih Rregullën 6 më lart). Në bazë të kësaj Rregulle shkarkimi ose suspendimi i Sekretarit të Përgjithshëm mund të propozohet me shkrim, duke parashtruar arsyet e shkarkimit ose të pezullimit, të nënshkruar nga Kryetari, të cilit i raporton Sekretari i Përgjithshëm. Dokumentet që përmbajnë fakte relevante, duhet t'i bashkëngjiten propozimit dhe do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

Detaje të tjera në lidhje me procedurën që duhet ndjekur, burojnë nga Ligji i mësipërm për Shërbimin Civil. Kur Sekretari i Përgjithshëm shkarkohet me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, procedura për të rekrutuar pasuesin sipas neneve 16.2 dhe 16.4 të Rregullores, duhet të vihet në lëvizje pa vonesë. Në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm është pezulluar përkohësisht nga ana e gjyqtarëve, Kryetari i Gjykatës duhet të emërojë një zyrtar të rangut të lartë për administratë të përgjithshme, në të njëjtën mënyrë siç është paraparë në Rregullën 16.4 si më poshtë.

Kohët e fundit gjyqtarët kanë vendosur të themelojnë funksionin e Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, i cili do të jetë një nga drejtorët e Sekretariatit dhe, në të njëjtën kohë, do të vazhdojë të ushtrojë funksionin e tij/saj si Drejtor. Rregullorja e punës ka theksuar qartë se Zëvendëssekretari i Përgjithshëm do të mbështesë Sekretarin e Përgjithshëm për çështjet që kanë të bëjnë me prokurimin, logjistikën dhe financat. Duhet të theksohet se Rregullorja e Punës nuk ka përcaktuar në mënyrë të qartë që Zëvendëssekretari i Përgjithshëm do të zëvendësojë Sekretarin e Përgjithshëm në raste

[172] Rregullorja Nr 01/2011 mbi ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e punësimit në shërbimin civil gjendet në http://map.rks-gov.net/userfiles/file/document_page/Rreg_Nr_01_2011.pdf.

të mungesës ose të pamundësisë për të ushtruar funksionet e tij/saj, kurdo që të jetë e nevojshme. Megjithatë, roli i tillë i Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm është i qartë, nëse lindin rrethanat e mësipërme. Sa herë që Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të ushtrojë funksionin e tij/saj, mund të supozohet se detyrat mund të ushtrohen përkohësisht nga Zëvendëssekretari i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Rregulli 17 [Personeli i Sekretariatit]

17.1 Sekretariati do të ketë personel të nevojshëm për t'i mundësuar atij të përmbushë funksionet në mënyrë efektive dhe efikase, brenda resurseve buxhetore të ndara për Gjykatën.

17.2 Pas punësimit nga Gjykata, punëtorët e Sekretariatit janë personel administrativ. Sekretari i Përgjithshëm siguron që rekrutimi i personelit bazohet në kualifikime profesionale, në aftësi dhe në merita, dhe bëhet me konkurs të drejtë dhe të hapur, në pajtim me Ligjin.

17.3 Statusi i stafit administrativ të parashikuar në nenin 12 të Ligjit zbatohet deri në atë masë sa ai status të mos ketë ndikim në pavarësinë e Gjykatës, të garantuar me nenin 112.2 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

17.4 Në mënyrë që të ruhet pavarësia kushtetuese dhe juridike e Gjykatës dhe duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Gjykatës në interpretimin kushtetues, rregullat e përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil për rekrutimin e personelit, për pagat, për shtesat, për orarin e punës dhe për pushimet, nuk zbatohen.

17.5 Me miratimin e gjyqtarëve, Sekretari i Përgjithshëm mund të kontraktojë ekspertë dhe profesionistë të tjerë për të kryer shërbime të caktuara për Gjykatën.

17.6 Të gjithë të punësuarit në Sekretariat duhet të japin betimin dhe të veprojnë në pajtim me Kodin e etikës.

Në mënyrë që Sekretariati të përmbushë funksionet e veta në mënyrë efikase dhe efektive, është e nevojshme të rekrutohet një numër adekuat i nëpunësve civilë, të cilët do të jenë në gjendje dhe të gatshëm për të arritur këto qëllime. Me rastin e rekrutimit të personelit, Sekretariati duhet të veprojë në kuadër të kufijve buxhetorë të miratuar për vitin përkatës. Kjo do të thotë se Sekretarit të Përgjithshëm nuk i lejohet të tejkalojë numrin maksimal të personelit të përcaktuar në buxhetin e miratuar në një vit të caktuar. Megjithatë, mund të supozohet që, në qoftë se kërkohet nga rrethanat, mund të rekrutohet stafi shtesë, duke përdorur mjete financiare nga një linjë buxhetore e buxhetit të Gjykatës, me miratimin e gjyqtarëve. Edhe pse Rregulla hesht për këtë çështje, supozohet që, në qoftë se nëpunësit civilë nuk përmbushin funksionet e tyre në mënyrë efikase dhe efektive, siç kërkohet me Rregullën, ata mund të shkarkohen ose që ndaj tyre mund të merren masa disiplinore, në përputhje me rregullat që zbatohen për nëpunësit civilë.

Në lidhje me qëllimin e përcaktuar në Rregullën 17.1 i referohemi raportit vjetor të vitit 2010 të Gjykatës Kushtetuese, ku theksohet se gjatë atij viti Sekretariati është

përqendruar në mënyrë të vendosur për arritjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare, që janë identifikuar në Planin Zhvillimor Strategjik të Gjykatës për periudhën 2010 - 2013:

- Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme njerëzore përmes rekrutimit të stafit të merituar, të kualifikuar dhe profesional, në mënyrë që të plotësohet numri i personelit në përputhje me numrin e miratuar dhe buxhetin;....”.[173]

Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se personeli është i nevojshëm për të mundësuar përmbushjen e funksioneve të veta në mënyrë efikase dhe efektive sipas Rregullës 17.1, por kjo përfshin gjithashtu detyrimin e Sekretariatit për t’i mundësuar stafit vijimin e trajnimeve adekuate që të përmirësohen kapacitetet e tyre për të përmbushur këtë funksion. Gjatë vitit 2010, Departamenti i Administratës dhe Personelit (në tekstin e mëtejmë: DAP) ka hartuar një kornizë të programit të trajnimeve për nëpunësit civilë të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2011-2013 si dhe një program orientues për trajnime për punonjësit e rinj në Gjykatë, të realizuar nga fillimi i vitit 2011.

Sipas raportit vjetor të vitit 2010, DAP ka "implementuar një rritje të vazhdueshme të aftësive për burimet njerëzore dhe çështjet operative", ndërsa, në të njëjtën kohë, "zyrtarët përkatës të Gjykatës kanë ndjekur me sukses edhe trajnime të detyrueshme të organizuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Instituti i Administratës Publike dhe programe të tjera të trajnimit nga Institute të tjera të specializuara". Për më tepër, "nëpunësit janë certifikuar në çështje të prokurimit publik, financave e auditimit të brendshëm dhe kanë marrë pjesë në vizita studimore brenda dhe jashtë vendit".[174]

Një referencë e tillë mund të gjendet edhe në raportet vjetore për vitin 2011 dhe 2012.

Procesi i punësimit të anëtarëve të stafit të Sekretariatit bazohet në tërësinë e tij në dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil. Në veçanti, neni 11 i këtij Ligji duhet të ketë frymëzuar hartimin e këtij Rregulli.

Mund të ketë rrethana kur gjyqtarët mund të konsiderojnë që, në mungesë të ekspertizës adekuate, në kuadër të Sekretariatit të huazohen shërbime të caktuara, d.m.th. shërbime që kryhen nga ekspertë dhe profesionistë të tjerë jashtë Gjykatës. Se cilat janë arsyet për të cilat Sekretari i Përgjithshëm duhet “të"kërkojë nga gjyqtarët" për të hyrë në kontrata me personat e përmendur, nuk është e qartë. Natyrisht, në bazë të nenit 12.4 të Ligjit, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për punën e tij/saj për të gjithë gjyqtarët, por kjo nuk do të thotë se ai/ajo duhet të kërkojë miratimin e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës për secilin dhe për çdo shërbim të huazuar nga jashtë ose se ai/ajo duhet të presë derisa për huazimin e shërbimeve të marrë “një kërkesë të gjyqtarëve", siç e përcakton Rregulla.

Në raste të tilla, Sekretari i Përgjithshëm duhet të ndjekë gjithashtu rregullat përkatëse të prokurimit, të zbatueshme për të gjitha institucionet publike. Në të kundërtën, Sekretari i Përgjithshëm rrezikon të kritikohet nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës në raportin vjetor të auditimit të jashtëm dhe/ose të pezullohet a të shkarkohet nga gjyqtarët. Një shembull i një kontrate të lidhur me ekspertë të jashtëm për të kryer shërbime për Gjykatën, është ai në lidhje me përkthimin e referimeve dhe dokumenteve jo të ndjeshme nga një kompani e jashtme për përkthime, në bazë të tenderit publik të

[173] Shih raportin vjetor të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, faqe 125. Ky raport është në dispozicion online në http://gjk-ks.org/. Raporti është shikuar më 7 prill 2014.

[174] Raporti Vjetor i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2010, 2011 dhe 2012 mund të gjenden në faqen e internetit të Gjykatës http://gjk-ks.org/. Raportet janë shikuar më 7 prill 2014.

shpallur nga Sekretariati. Duhet të theksohet se kompania dhe përkthyesit në fjalë do të obligohen të nënshkruajnë klauzolën e konfidencialitetit për kryerjen e shërbimeve të përkthimit.[175]
Siç është përmendur në Raportin vjetor të Gjykatës për vitin 2011, Sekretariati ka hartuar dhe botuar Kodin e Etikës dedikuar personelit, përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm. Raporti vjetor nuk tregon nëse personeli i pranishëm ka dhënë betimin në përputhje me Kodin e Etikës, siç kërkohet nga Rregulli.

Neni 13 [Këshilltarët Juridikë]

> **Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kushtet për emërimin, shkarkimin, dhe statusin e këshilltarëve juridikë caktohen me Rrregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Pagat e këshilltarëve juridikë caktohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.**

Në praktikën e Gjykatës është treguar që roli i këshilltarëve juridikë në gjykimin e çështjeve kushtetuese është themelor. Ata luajnë një rol thelbësor në sigurimin e analizave juridike, draftraporteve, aktvendimeve mbi papranueshmërinë, vendimeve dhe aktgjykimeve e këshillave të tjera ligjore, që mund të jenë relevante për zgjidhjen e çështjeve kushtetuese. Roli i tyre konsiston në hulumtime ligjore lidhur me jurisprudencën e gjykatave të tjera kushtetuese dhe, në mënyrë të veçantë, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, vendimet e së cilës janë të detyrueshme në pikëpamje kushtetuese për Gjykatën në interpretimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të garantuara me Kushtetutë.[176]
Pra, është shumë e rëndësishme që një numër i mjaftueshëm i këshilltarëve juridikë të kualifikuar të ndihmojnë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, duke marrë parasysh juridiksionin e saj të gjerë dhe, në këtë mënyrë, numrin e madh të referimeve kushtetuese, të cilat mund të dorëzohen në Gjykatë, sidomos, referime individuale sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
Sipas nenit, kushtet për emërimin, shkarkimin dhe statusin e këshilltarëve juridikë përcaktohen në Rregulloren e Punës. Rregulla 18 [Këshilltarët Juridikë] e Rregullores së Punës përmban të dhënat e nevojshme (shih komentet lidhur me Rregullën 18, në tekstin e mëtejmë). Një nga karakteristikat kryesore të Rregullës është se dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil nuk janë të zbatueshme për këshilltarët juridikë, pasi ata nuk konsiderohen nëpunës civilë. Këshilltarët juridikë, në këtë mënyrë, nuk i nënshtrohen fushëveprimit të këtij Ligji. Si pasojë, lind pyetja, nëse një kontratë në mes të Sekretariatit dhe një këshilltari juridik përmban dispozita të ngjashme mbrojtëse në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij/saj në raport me punëdhënësin (Sekretariatin),të cilat ai/ajo do të kishte gëzuar sipas Ligjit për Shërbimin Civil.
Gjatë hartimit të ligjit janë konsideruar dy modele për emërimin e këshilltarëve juridikë. Modeli i parë ka pasur për qëllim lidhjen e një kontrate të përhershme me këshilltarin juridik, të rekrutuar pas një procesi të hapur dhe konkurrues të

[175] Në rast të shkeljes të dispozitivit, kontrata mund të ndërpritet menjëherë dhe pala e dëmtuar mund të kërkojë kompensim të dëmit.
[176] Shih nenin 53 të Kushtetutës.

përzgjedhjes, ndërsa modeli i dytë preferonte një proces ku këshilltari juridik “të vinte" dhe "të largohej" në të njëjtën kohë si gjyqtari për të cilin ai/ajo kishte punuar gjatë asaj kohe. Disa gjykata kushtetuese kanë zgjedhur opsionin e parë, të tjerat modelin e dytë, ndërkohë që ka edhe shembuj në rajon, sikurse janë gjykata kushtetuese e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe ajo e Shqipërisë, të cilat kanë paraparë një angazhim më të përhershëm të këshilltarëve ligjorë, në mënyrë që të mos humbasë "kujtesa institucionale" e tyre. Kështu, emërimi i këshilltarëve ligjorë në baza më afatgjata mund të sigurojë më shumë qëndrueshmëri në procesin e shqyrtimit kushtetues dhe një shkallë më të lartë të memories institucionale, të cilat janë instrumente të rëndësishme për krijimin e një jurisprudence kushtetuese të qëndrueshme.

Neni 13 është mjaft i paqartë duke përcaktuar se pagat e këshilltarëve juridikë caktohen në pajtim me ligjin në fuqi. Kjo, megjithatë, nuk është krejtësisht e qartë se çfarë nënkuptohet me "ligjin në fuqi". Ligji i Punës mund të japë referenca të dobishme në lidhje me emërimin, shkarkimin dhe statusin e këshilltarëve juridikë, por lartësia e pagave nuk trajtohet me atë Ligj (siç është rasti në Ligjin për Shërbimin Civil), pasi palët në një kontratë pune mund të bien dakord për një pagë të veçantë. Në mungesë të ndonjë treguesi të qartë për sa i takon çështjes së pagave, mund të zbatohet përshtatshmërisht neni 15 [Paga e Gjyqtarëve] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (i cili siguron që Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës), si udhëzues për ngritjen e pagave të këshilltarëve juridikë të Gjykatës me përcaktimin se, për shembull, pagat e tyre duhet të jenë 1.3 herë më të larta se pagat e këshilltarëve juridikë përkatësisht të bashkëpunëtorëve profesionalë të Gjykatës Supreme.

Duhet të theksohet gjithashtu se Sekretariati i Gjykatës ka rekrutuar disa zyrtarë të rinj ligjorë, të cilët janë të ngarkuar për të ndihmuar këshilltarët juridikë si dhe gjyqtarët, për të bërë kërkime në çështje të veçanta ligjore dhe instrumente vendore e ndërkombëtare ligjore, në veçanti të atyre që janë pjesë e Kushtetutës, si KEDNJ dhe jurisprudenca përkatëse e saj. Këta zyrtarë mund të ndihmojnë gjithashtu në hartimin e raporteve dhe vendimeve të Gjykatës nën mbikëqyrjen e këshilltarit juridik. Hulumtuesit juridikë janë nëpunës të Sekretariatit dhe, në këtë mënyrë, ndryshe nga këshilltarët juridikë, janë nëpunës civilë. Megjithatë, së bashku me këshilltarët juridikë, ata janë pjesë e Njësisë Ligjore, e cila është themeluar në vitin 2010, me miratimin e gjyqtarëve.

Neni 13 plotësohet me Rregullën 18 [Këshilltarët Juridikë] të Rregullores së Punës.

Rregulli 18 [Këshilltarët juridikë]

18.1 Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza. Këshilltarët juridikë ndihmojnë në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike, të krijuara nga Gjykata. Gjyqtarët përcaktojnë numrin e këshilltarëve juridikë që duhet punësuar, duke marrë parasysh nevojat e Gjykatës dhe resurset buxhetore në dispozicion.

18.2 Këshilltarët juridikë nuk janë shërbyes civilë. Kushtet e kontratës së këshilltarëve juridikë përcaktohen nga Gjykata, në pajtim me ligjin përkatës.

18.3 Për qëllime të këtij rregulli, me termin "ligj" nënkuptohen: Ligji për Gjykatën Kushtetuese (Nr. 03/L-121), Ligji i Punës (Nr. 03/L-212) dhe vendimet e Gjykatës.

18.4 Niveli i pagës së këshilltarëve juridikë caktohet me vendim të Gjykatës në seancë administrative.

18.5 Këshilltarët juridikë emërohen me shumicën e thjeshtë të votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, duke u bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues të përzgjedhjes. Këshilltarët juridikë kanë statusin e këshilltarëve profesionalë. Një këshilltar juridik mund të punësohet vetëm nëse përmbush këto kushte:

(a) të ketë përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, preferohen trajnime apo specializime në të drejtën kushtetuese, në të drejtat e njeriut, në të drejtën ndërkombëtare publike, ose ndonjë drejtim tjetër i së drejtës publike;

(b) të ketë së paku dy (2) vjet përvojë përkatëse profesionale në çështje juridike; dhe

(c) të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

18.6 Konkurset për postet e këshilltarëve juridikë shpallen së paku në tri (3) gazeta që shpërndahen gjerësisht në Kosovë. Aplikacionet për postet e këshilltarëve juridikë shqyrtohen nga kolegji përzgjedhës i përbërë nga tre gjyqtarë, të emëruar nga Kryetari. Komisioni përzgjedhës ua paraqet gjyqtarëve listën e personave që përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafin (3).

18.7 Këshilltari juridik mund të shkarkohet, ose të suspendohet përkohësisht, me vendimin e shumicës së gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, në pajtim me legjislacionin përkatës.

18.8 Këshilltarët juridikë mbikëqyren nga Këshilltari i parë juridik, të cilin e zgjedhin gjyqtarët nga radhët e këshilltarëve juridikë të punësuar në Gjykatë. Atij/asaj do t'i ndihmojnë dy Zëvendës të Këshilltarit të parë juridik, të cilët i emëron Kryetari i Gjykatës.

18.9 Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik emërohen në bazë të rotacionit nga këshilltarët juridikë, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Gjykata.

18.10 Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik i raportojnë Kryetarit. Pas konsultimit me Kryetarin dhe me gjyqtarët, Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik mund të shkarkohen nga funksioni, kurdoherë, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në seancë administrative.

18.11 Mandati i Këshilltarit të parë juridik dhe zëvendësve të Këshilltarit të parë juridik është një (1) vit.

18.12 Paga e Këshilltarit të parë juridik do të ketë rritje për 10 % gjatë kohës sa ai/ajo ushtron atë funksion; ndërsa paga e Zëvendës këshilltarëve do të jetë 5% më e ulët se sa ajo e Këshilltarit të parë juridik.

18.13 Gjykata ka themeluar Njësinë Ligjore. Struktura dhe organizimi i Njësisë Ligjore, që përfshin pozitën e këshilltarëve juridikë dhe personelin tjetër ligjor, rregullohet më tutje me Udhëzimin për praktikat, të miratuar nga Gjykata.

Siç është përmendur tashmë në bazë të nenit 13 të Ligjit, këshilltarët juridik luajnë një rol të rëndësishëm për t'u ofruar gjyqtarëve ndihmë dhe mbështetje juridike, duke hartuar analiza, raporte, aktvendime për papranueshmëri, aktgjykime dhe vendime të tjera të rëndësishme për gjykimin e referimeve të bëra sipas nenit 113 [Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Në praktikë, këshilltarët juridikë tashmë luajnë një rol të caktuar në dorëzimin e kërkesave, kur pranojnë aplikantë të mundshëm ose përfaqësues të tyre, të cilët vijnë në lokalet e Gjykatës për të paraqitur kërkesat kushtetuese personalisht. Është praktikë që këshilltarët juridikë (sikurse dhe hulumtuesit ligjorë) i presin aplikantët në Gjykatë, në mënyrë që të kontrollojnë nëse kërkesa është e plotë dhe përmban të gjitha dokumentet e nevojshme. Nëse nuk i kanë në rregull, aplikantëve u kërkohet të kompletkojnë kërkesën, e cila nuk është e regjistruar (shih komentet në Rregullën 30).[177] Vetëm pas kompletimit të dosjes, kërkesa kushtetuese do të regjistrohet dhe do t'i jepet një numër i regjistrimit.
Për më tepër, këshilltari juridik i ndihmon gjyqtarit raportues, të cilit i është caktuar lënda nga Kryetari,[178] në hartimin e raportit paraprak, që i dorëzohet Panelit Shqyrtues.[179] Pasi kërkesa të jetë konsideruar në mënyrë unanime si e papranueshme nga Paneli Shqyrtues, këshilltari juridik i ndihmon Kryetarit të kolegjit në hartimin e aktvendimit për papranueshmëri. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë kërkesa/referimi i përcillet Gjykatës në përbërjen e saj të plotë. Më pas, këshilltari juridik ndihmon Gjykatën që të hartojë vendimin përfundimtar për kërkesën.[180]
Vlen të përmendet se në Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë këshilltarët juridikë ushtrojnë funksione të ngjashme.[181] Sipas nenit 16 [Departamenti i Këshilltarëve Juridikë] i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë, këshilltarët në mënyrë të barabartë "përgatisin raportet, projektvendimet, urdhrat dhe opinionet në kuadër të rasteve që janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe ofrojnë ekspertizë sipas nevojës për të ndihmuar Gjykatën në shqyrtimin dhe vendimmarrjen e saj". Në të njëjtën kohë, gjyqtarët mund të shtojnë ose të korrigjojnë pjesë të arsyetimit të projektvendimeve, mirëpo hartimi mbetet kryesisht detyrë e këshilltarëve juridikë.

---

[177] Rregulla 30 [Regjistrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], paragrafi 1 i Rregullores së punës përcakton: Sekretari i Përgjithshëm e regjistron kërkesën menjëherë pasi të jetë dorëzuar ajo, apo çfarëdo dokumenti, madje edhe në rastet kur kërkesa nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme. Sekretariati mban një listë kontrolluese të dokumenteve të nevojshme dhe mund të ndihmojë palët duke shpjeguar se çfarë mungon në kërkesë".
[178] Shih komentet e mëtejshme lidhur me Rregullën 7 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues] të Rregullores së Punës.
[179] Shih komentet e mëtejshme lidhur me Rregullën 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues] të Rregullores së Punës.
[180] Shih komentet e mëtejshme lidhur me Rregullin 56 [llojet e vendimeve] të Rregullores së Punës
[181] Shih Raportin e Komisionit te Venecias hartuar nga Jadranka Sovdat lidhur me organizimin e punës së këshilltarëve ligjor në mbështetje të vendimmarrjes së gjykatës kushtetuese: prezantimi dhe përvoja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë. Raporti është në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2005/CDL-JU (2005) 041-e.asp.

Për të maksimizuar mbështetjen dhe shërbimet e këshilltarëve juridikë përmes rritjes së cilësisë së hartimit të analizave dhe vendimeve të Gjykatës, vazhdojnë të organizohen trajnime për këshilltarë juridikë për tema të veçanta, të cilat organizohen nga organizatat donatore me përvojë në ndërtimin e kapaciteteve dhe programeve të arsimimit ligjor. Kjo ka të bëjë me programet për ndërtimin e kapaciteteve dhe të programeve të arsimimit të vazhdueshëm ligjor. Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese në Slloveni në konferencën e sekretarëve të përgjithshëm ka theksuar: "në qoftë se ne do të dëshironim këshilltarë juridikë për të siguruar mbështetje të përshtatshme të ekspertëve për gjyqësorin, ne duhet së pari të sigurojmë kushte të përshtatshme për punën e tyre. Në këtë drejtim duhet siguruar një mjedis i këndshëm pune dhe qasje në të gjitha të dhënat, në literaturë të ekspertëve, në teknologji të informacionit, si dhe çdo gjë të nevojshme për të siguruar kryerjen e mirë dhe efikase të punëve. Për më tepër, këshilltarëve juridikë duhet t'u sigurohet mundësia për të ndjekur shkollimin e mëtejshëm, jo vetëm në fushën e së drejtës, po edhe në fusha të tjera, sidomos në avancimin e njohjes së gjuhëve të huaja. Kjo e fundit u lejon atyre të studiojnë të drejtën dhe literaturën juridike të huaj, si dhe të sigurojnë informacione të tjera relevante në fushën e drejtësisë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese jep grante për studime pasuniversitare në fusha të ndryshme juridike, inkurajon pjesëmarrjen në seminare përkatëse ligjore në Slloveni, si dhe jashtë vendit, dhe organizon kurse të gjuhëve të huaja (anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht) në Gjykatën Kushtetuese.[182] Shembulli slloven i forcimit të aftësive të hartimi juridik dhe avancimit të njohurive të gjuhëve të huaja, është nje nga janë shembuj të mirë për Gjykatën Kushtetuese.

Aktivitete të ngjashme janë organizuara ose janë duke u organizuar për këshilltarë juridikë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Aktualisht, Gjykata ka 12 këshilltarë juridikë kosovarë dhe tre ndërkombëtarë, të cilët janë rekrutuar dhe janë vënë në dispozicion të Gjykatës nga ana e ish-Zyrës Civile Ndërkombëtare, ndër të tjera, në mënyrë që të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të kolegëve të tyre kosovarë, si dhetë tre zyrtarëve ligjorë vendorë.[183]

Rregullorja në nenin 18.2 ka përcaktuar se këshilltarët ligjorë nuk janë shërbyes civilë. Siç është përmendur tashmë në komentet lidhur me nenin 13 të Ligjit të mësipërm, kontratat e këshilltarëve ligjorë, të lidhura me Gjykatën, mund të mos përmbajnë klauzola mbrojtëse të ngjashme me ato të përfshira në kontratat e anëtarëve të stafit të Sekretariatit, të lidhura me Sekretariatin sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Do të ishte interesante të krahasohen kushtet e llojeve të ndryshme të kontratave. Neni 2 i Ligjit për Shërbimin Civil nëpunësit civilë i definon si persona të punësuar" personi i punësuar për ushtrimin e autoritetit administrativ publik në bazë të aftësisë dhe kapacitetit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre".

---

[182] Ibid.

[183] Në bazë të nenit 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ICR), i cili ishte emëruar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar, pas konsultimeve me BE-në dhe i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit), kishte emëruar tre gjykatës ndërkombëtarë të Gjykatës dhe, nën autoritetin e tij, Zyra e tij ka rekrutuar edhe tre këshilltarë ligjorë ndërkombëtarë për të mbështetur punën e Gjykatës. Këshilltarët juridikë ndërkombëtarë nuk janë përmendur në Ligj ose në Rregulloren e Punës.

Edhe pse është e vërtetë që puna e këshilltarëve juridikë nuk mund të përshtatet krejtësisht në këtë përkufizim, duket se këshilltarët juridikë të gjykatave të tjera kushtetuese në rajonë kanë me të vërtetë statusin e nëpunësit civil.[184] Andaj nuk është krejt e qartë se për çfarë arsyeje specifike Gjykata ka zgjedhur të mos u akordojë këshilltarëve juridikë një status të tillë. Në mungesë të mbrojtjes së dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, këshilltarët ligjorë duhet të mbështeten më tepër në dispozitat relevante të Ligjit të Punës, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në mes të punëdhënësit e punëmarrësit, dhe klauzolat mbrojtëse për këtë të fundit.[185]

Procedura sipas së cilës emërohen këshilltarët juridikë nga ana e gjyqtarëve, është shumë e ngjashme me procedurën sipas së cilës emërohet Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës (Rregulla 16 si më lart). Me përjashtim të numrit minimal të kërkuar të viteve të përvojës (që në rastin e Sekretarit të përgjithshëm kërkohen pesë vjet, kurse për këshilltarët juridikë kërkohen dy vjet), kërkesa për integritetin dhe mënyra në të cilën shpallen vendet e lira, janë mjaft identike. Megjithatë, një kusht i mëtejmë si pjesë e përvojës përkatëse profesionale duket se mungon, fjala është për përvojën në hartime juridike. Pa një përvojë të tillë, këshilltarit juridik të sapoemëruar do t'i marrë një periudhë të konsideruar për të mësuar se si hartohen raporte dhe vendime në mënyrë të duhur. Si rregull, këshilltarët e rinj juridikë duhet të mbikëqyren dhe të monitorohen nga kolegët e tyre më me përvojë derisa të konsiderohen të aftë për t'u inkuadruar në procesin e hartimit pa mbikëqyrje të tillë. Mendimi i gjyqtarëve duhet të jetë një faktor i rëndësishëm në këtë proces.

Për sa u përket kualifikimeve të nevojshme të përmendura në Rregull, duket se nuk kërkohet një nivel i avancuar i gjuhës angleze, edhe pse njohja e gjuhës angleze duhet të jetë një kusht i domosdoshëm për këshilltarët juridikë të Gjykatës. Për shembull, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës përcakton: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Për të qenë në gjendje për të kuptuar dhe analizuar këto vendime, të cilat Gjykata Evropiane i publikon në anglisht dhe frëngjisht, këshilltarët juridikë duhet të kenë të paktën njohuri të avancuara (ligjore) të gjuhës angleze. Në të kundërtën, këshilltarët mund të mos jenë në gjendje të këshillojnë gjyqtarët për jurisprudencën e Strasburgut, e cila mund të jenë e rëndësishme për gjykimin e ankesave kushtetuese të paraqitura sipas nenit 113 të Kushtetutës.

Për më tepër, zotërimi i gjuhës angleze është bërë edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh praninë në Gjykatën Kushtetuese të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe të tre këshilltarëve juridikë ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, për të mbështetur punën e Gjykatës. Është absolutisht e nevojshme që këshilltarët juridikë të jenë në gjendje të komunikojnë me gjyqtarët ndërkombëtarë dhe me këshilltarë juridikë pa ndihmën e përkthyesit. Megjithatë, në praktikë, mungesa e kësaj kërkese si dhe e kërkesës sugjeruar të lartpërmendur lidhur me aftësitë e hartimit, mund të jenë bërë të parëndësishme pasi kandidatët duhet të kalojnë testin me shkrim dhe me gojë në gjuhën angleze.

Komentet lidhur me Rregullën 16.4 në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm, vlejnë edhe për këtë Rregull. Rregulla megjithatë hesht për

[184] Për shembull, Gjykatat Kushtetuese në Shqipëri, Slloveni dhe Maqedoni.

[185] Ligji nr.03 / L -212 për marrëdhënie të punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Viti V / Nr. 90/01 dhjetor 2010.

mënyrën se si do t'i zgjedhin gjyqtarët këshilltarët juridikë nga radhët e kandidatëve që janë paraqitur në listë nga paneli përzgjedhës. Me sa duket, gjyqtarët do të vlerësojnë kandidatët në listë përmes një testimi me shkrim dhe me gojë, në bazë të të cilit do të zgjedhin kandidatin e suksesshëm me shumicë votash, sipas Rregullës 18.3. Megjithatë procedurën që duhet ndjekur nga gjyqtarët, duhet të rregullojë Rregulla.
Për këtë arsye sugjerohet plotësimi i Rregullës 18.4 me një procedurë të tillë.
Ngjashmëria e Rregullës 18.5 me Rregullën 16.5 dallohet, me përjashtim të ndonjë reference për "ligjin e aplikueshëm", siç që përmendet në rregullën 18.5. Megjithatë, është e qartë se shkarkimi dhe suspendimi i përkohshëm i Sekretarit të Përgjithshëm është rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil, por jo edhe shkarkimi dhe suspendimi i këshilltarit juridik. Prandaj referenca për "ligjin" mund të mos jetë e tepërt, pavarësisht nga fakti se nuk është krejt e qartë se cili ligj do të jetë relevant. Siç u përmend më lart, në mungesë të ndonjë procedure të detajuar, të përcaktuar në Ligj ose në Rregulloren e Punës, mund të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës[186] me qëllim të rregullimit të të drejtave dhe obligimeve nga marrëdhëniet e punës. Kështu, nëse gjyqtarët dëshirojnë të shkarkojnë ose të suspendojnë një këshilltar juridik, këtë do të jenë në gjendje ta bëjnë vetëm në përputhje me kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet Sekretariatit dhe këshilltarit juridik, dhe me dispozita përkatëse të Ligjit të Punës. Për shembull, këshilltarit juridik duhet t'i jepet çdo mundësi për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj (me ndihmën e avokatit, nëse është e nevojshme) si dhe e drejta për t'u dëgjuar nga gjyqtarët, para se të merret ndonjë vendim sipas kësaj Rregulle.
Roli kryesor i Këshilltarit të Parë Juridik është të mbikëqyrë punën e njësisë ligjore, e cila përbëhet nga këshilltarët juridikë dhe hulumtuesit ligjorë. Për të organizuar si duhet punën e Njësisë Ligjore në konsultim me Kryetarin si dhe me këshilltarët ligjorë, kërkohet vëmendja e plotë dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e Këshilltarit të parë Juridik, në veçanti për të siguruar një gjykim efikas dhe efektiv të ankesave kushtetuese nga ana e Gjykatës brenda një kohe të arsyeshme. Këshilltarit i Parë Juridik ushtron gjithashtu një rol koordinues në përgatitjen e listës së referimeve për t'u diskutuar në seancat e Gjykatës, në konsultim me Kryetarin dhe Departamentin e Menaxhimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivave.
Edhe pse fillimisht Këshilltari i Parë Juridik ishte zgjedhur nga gjyqtarët nga radhët e këshilltarëve juridikë ndërkombëtarë, gjyqtarët, për shkak se, rotacioni i pozicioneve të këshilltarëve juridikë ndërkombëtarë kishte ardhur në fund, kanë vendosur për të emëruar një prej këshilltarëve juridikë të Kosovës si Këshilltar Juridik për një kohë të caktuar. Këshilltarit i Parë Juridik kosovar ndihmohet nga dy zëvendës kosovarë.
Për sa i përket shkarkimit të Këshilltarit të Parë Juridik dhe zëvendësve të tij/saj nga ana e gjyqtarëve, procedura duket të jetë e thjeshtë, pasi ajo mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo arsyeje, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, për shembull, për arsyen e thjeshtë se gjyqtarët dëshirojnë një tjetër Këshilltar të Parë Juridik ose zëvendës. Pas shkarkimit, ai/ajo normalisht do të vazhdojë punën e tij/saj si këshilltar ligjor.

[186] Ligji nr.03 / L -212 për marrëdhënie të punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Viti V / Nr. 90/01 dhjetor 2010.

Neni 14 [Buxheti]

14.1 Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
14.2 Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe i'a dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Buxheti i propozuar nga Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
14.3 Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Siç është komentuar më lartë në rregullën 15.2, e drejta për të pasur buxhetin e saj është mjaft e rëndësishme për Gjykatën Kushtetuese pasi qe i siguron pavarësinë. Pavarësia e një organi kushtetues nuk mund të paramendohet pa një shkallë të mjaftueshme të pavarësisë financiare, pasi që buxheti i tyre si pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës të miratohet nga legjislativi, mbrohen nga ndërhyrjet e mundshme për sa i takon mënyrës së shpenzimit të buxhetit të tyre. Me një fjalë, pavarësia buxhetore siguron pavarësinë institucionale.
Gjykata Kushtetuese gjermane ka nënvizuar nevojën që gjykata kushtetuese duhet të ketë buxhetin e vet: " E drejta që Gjykata Kushtetuese të ketë buxhetin e saj buron nga kompetencat e saj dhe pavarësia e saj që në mënyrë të pandarë lidhet me të, dhe në të njëjtën kohë, Gjykata absolutisht ka nevojë për të pasur buxhetin e vet për të qenë e pavarur, dhe ky buxhet i pavarur i garanton një pjesë të pavarësisë strukturore të Gjykatës."[187]
Gjersa neni 14.1 përcakton se Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i shtetit, neni 14.2 përcakton një variant të një propozimi buxhetor, i cili me siguri se mbron Gjykatën Kushtetuese nga ndërhyrjet e mundshme të organizatave të tjera buxhetore ekzekutive dhe ofron një komunikim të drejtpërdrejtë të Gjykatës me Kuvendin në lidhje me përmbajtjen e propozimit të buxhetit. Fjalët hyrëse të nenit 14.2 duke përcaktuar se "pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera" shprehin qartë synimin e legjislativit për të evituar çdo prevalencë të dispozitave të tjera ligjore në fuqi në fushën e përgatitjes së propozimeve buxhetore të organeve kushtetuese (sidomos të Ligjit mbi Menaxhimin dhe Përgjegjësitë e Financave Publike)[188] në lidhje me mënyrën në të cilën procedohet propozim buxheti i Gjykatës Kushtetuese.
Ndonëse Kushtetuta nuk ka përcaktuar në kuadër të kapitullit 8 ndonjë dispozit kushtetuese për të garantuar një formë të pavarësisë buxhetore për Gjykatën

[187] Shih raportin "Buxheti i Gjykatës Kushtetuese si një nga garancitë e pavarësisë së drejtësisë kushtetuese", të hartuara nga znj. Elke Luise Barnstedt, Drejtoreshë në Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë në kuadër të Komisionit të Venecias /Seminar për "Buxheti i Gjykatës Kushtetuese: një faktor përcaktues i pavarësisë së saj, Sarajevë, 14-15 tetor 2004.
[188] Ligji Nr 2008/03- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kushtetuese, legjislatori duke vepruar mbi rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendor i ka dhënë pavarësisë buxhetore te Gjykatës Kushtetuese një dimension të fuqishëm duke përcaktuar në mënyrë të qartë se "Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese". Qëllimi i legjislatorit lidhur me dispozitën ne fjale është i qartë.[189] Propozimin për buxhetin i hartuar fillimisht nga Sekretari dhe i miratuar në seancë administrative nga Gjykata Kushtetuese i përcillet drejtpërsëdrejti Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe aprovim duke evituar në këtë mënyrë rrugën e zakonshme të procedimit të projekt-buxheteve të organizatave buxhetore tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shqyrtim dhe aprovim. [190]

Ky sistem i procedimit të buxhetit ka ngjashmëri të theksuar me versionin polak ku buxheti i Gjykatës Kushtetuese të Polonisë miratohet nga Plenumi i Gjyqtarëve i cili pas nënshkrimit nga Kryetari i Gjykatës dërgohet për miratim në Sejm. Ngjashëm me këtë është edhe modeli hungarez ku Gjykata Kushtetuese e Hungarisë propozon buxhetin e saj dhe e dërgon për aprovim në mënyrë direkte në Parlament.[191] Sa i përket modelit gjerman, (të përcaktuar me nenin 1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, 12 mars 1951 me ndryshime), Gjykata Kushtetuese gëzon një "status më të pavarur dhe autonom në krahasim me organet e tjera kushtetuese."[192] Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese nuk është e varur financiarisht për asnjë ministri, "por ajo është një organ i pavarur buxhetor ", buxheti i së cilës miratohet si një plan i veçantë autonom i përfshirë në buxhetin e shtetit në tërësi.[193] Në Kroaci, buxheti vjetor i Gjykatës Kushtetuese miratohet si pjesë e veçantë e buxhetit të shtetit nga Dhoma përfaqësuese e Parlamentit me propozim të Gjykatës Kushtetuese (Ligji për Gjykatën Kushtetuese - Nezavisne Narodne, nr. 13/1991, me ndryshime).

Neni 14.2 plotësohet me Rregullën 20 [Buxheti dhe Taksat] e Rregullores së Punës.

Pavarësia buxhetore e Gjykatës Kushtetuese nënkupton poashtu të drejtën e menaxhimit të pavarur të buxhetit të saj. Sipas legjislacionit në fuqi, buxheti i një organizate buxhetore ndahet në paga dhe mëditje, shërbime dhe mallra, shërbime të kontraktuara (komunali), subvencione, transfere dhe shpenzime kapitale. Rrjedhimisht për kategoritë respektive Gjykata Kushtetuese gëzon autonomi të plotë në menaxhimin e këtyre fondeve publike siç përcaktohet me kornizën ligjore. Rrjedhimisht në lidhje

---

[189] Megjithatë, siç duket nga raporti vjetor për vitin 2010, për shembull, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në dy raste gjatë atij viti buxhetor ka reduktuar buxhetin e Gjykatës në kategorinë e shërbimeve, si dhe pagave dhe shtesave.

[190] Duhet theksuar se kompetent për shqyrtimin e buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës është Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës. Për më tepër, Komisioni shqyrton shpenzimet e mundshme që mund t'i bartë një projektligj dhe të bëjë rekomandime në komisionin përkatës funksional të Kuvendit.

[191] Neni 2 i Ligjit Nr. XXXII (1989) lidhur me Gjykatën Kushtetuese*;* Shih punimet e punëtorisë lidhur me "Buxhetin e Gjykatës Kushtetuese: Kontrolli dhe Menaxhmenti", Botim i Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias për Demokraci përmes Ligjit), 1 tetor 2004, http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-JU(2004)056-e.asp.. Kyiv, Ukraine, 19-21 January 1998. Shih poaashtu Arne Mavcic, "Buxheti i Gjykatës Kushtetuese, Kontrolli dhe Menaxhimi për sa i takon pavarësisë dhe autonomisë së gjykatës", Strasbourg, Janar 2008.

[192] Shih materialet e përgatitura nga Komisioni i Venecias (Dokumentet CDL-Ju (2004) 056 dhe CDL-Ju (2004) 059, të paraqitura në seminarin "Buxheti i gjykatave kushtetuese: një faktor përcaktues i pavarësisë së saj") http: / / www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-JU (2004) 056-e.asp

[193] Ibid.

me kategoritë përkatëse, Gjykata Kushtetuese gëzon autonomi të plotë në menaxhimin e këtyre fondeve publike, siç përcaktohet nga kuadri ligjor. Gjykata Kushtetuese është për shembull tërësisht autonome për të hyrë në kontrata, ose për të vendosur për rekrutimin e stafit.
Për më tepër, Gjykata është e lirë në një masë të caktuar për t'i rialokuar fondet nga një kategori buxhetore në tjetrën në përputhje me dispozitat e ligjit të mësipërm për Menaxhimin e Financave Publike. Megjithatë, administrimi i buxhetit nga ana e Gjykatës i nënshtrohet mbikëqyrjes së auditorit të brendshëm dhe Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, i cili në bazë të nenit 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës është institucioni më i lartë i ekonomisë dhe kontrollit financiar i mandatuar për të kryer auditimin e organizatave buxhetore të Kosovës.
Auditime të brendshme të cilat janë kryer në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në departamente të ndryshme të Gjykatës kanë për qëllim për të realizuar objektivat e auditimit lidhur me kontrollin e brendshëm dhe përmirësimin e efikasitetit të punës në mënyrë që të shmangen gabimet e mundshme. Departamenteve të cilave u janë gjetur gabime, pranojnë vizita pasuese nga auditori i brendshëm në mënyrë që të kontrollohet nëse rekomandimet janë zbatuar siç duhet.
Sa i përket auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të Gjykatës nga Auditori Gjeneral, Gjykata ka adresuar çështjet e përfshira në Memorandumin e Auditorit të Përgjithshëm duke marrë masat e duhura për zbatimin e tyre. Për shembull, memo e vitit 2011 arriti në përfundimin se Gjykata, me zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar në përputhje me dispozitat ligjore ka arritur që me sukses të menaxhojë buxhetin e caktuar për vitin 2011.[194]

Rregulli 20 [Buxheti dhe taksat]

20.1 Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Kryetarin, përgatit propozimin për buxhet dhe ia paraqet atë gjyqtarëve për shqyrtim dhe për miratim.
20.2 Në seancë administrative, gjyqtarët shqyrtojnë, dhe, nëse është e nevojshme, e ndryshojnë dhe e miratojnë propozimin përfundimtar të buxhetit. Kryetari nënshkruan propozimin e miratuar të buxhetit, i cili dorëzohet nga Sekretari i Përgjithshëm në procedurë të mëtejshme, në pajtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
20.3 Sekretari i Përgjithshëm ua propozon gjyqtarëve listën e tarifave për shërbimet administrative.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor të Gjykatës në përputhje me udhëzimet e dhëna nga kryetari i Gjykatës. Propozimi i buxhetit, pasi të përgatitet, i paraqitet nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm gjyqtarëve të cilët e diskutojnë atë në seancë administrative si një nga çështjet e politikave të Gjykatës ("buxheti i Gjykatës") që përcaktohet me Rregullën 14 [Seancat Administrative], paragrafi 3 (a) (shih komentet më lartë).
Në seancë administrative gjyqtarët diskutojnë, shqyrtojnë dhe nëse është e nevojshme ndryshojnë pika individuale të projekt-buxhetit të Sekretariatit për atë vit të caktuar

[194] Memorandumet dhe Raportet e Auditorit të Përgjithshëm janë të publikuara në faqen e internetit në fjalë.

para se ta miratojnë atë. Buxheti miratohet me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë me kusht që së paku shtatë gjyqtarë të jenë të pranishëm siç është përcaktuar me Rregullën 14.4. Pasi Kryetari të ketë nënshkruar projekt-buxhetin e miratuar, Sekretari i Përgjithshëm duhet t'ia paraqesë atë Komisionit për Buxhet të Kuvendit, i cili është një forum i rëndësishëm për të paraqitur arsyeshmërinë e fondeve të nevojshme për zbatimin e mandatit të Gjykatës për një vit të caktuar. Pas miratimit nga Komisioni, buxheti i Gjykatës do të përfshihet si një kategori në vete, në buxhetin përkatës vjetor të Kosovës për t'u miratuar nga Kuvendi. Pas miratimit, fondet e ndara i barten Gjykatës përmes Ministrisë së Financave.
Shërbimet administrative të përcaktuara nga Rregulla përcaktohen në Rregullën 23 [Qasja në dosje dhe dokumente], paragrafi 2 ku theksohet: "*Palët kanë të drejtë të marrin kopjet e dosjeve dhe të dokumenteve për lëndën në të cilën ata janë palë në procedurë, përveç nëse ajo dosje ose ai dokument është përcaktuar nga Gjykata të jetë konfidencial. Gjykata mund të caktojë taksë administrative për kopje të tilla.*"[195] Me sa duket deri tani nuk është bërë asnjë propozim i tillë sepse pasi që taksat e tilla do të ishin caktuar, ato do të duhej të paraqiteshin në faqen e Gjykatës si informacion publik.
Është interesante të përmendet se disa sisteme të gjykatës kushtetuese kanë vendosur pagesën e një tarife kur aplikantët dorëzojnë kërkesën e tyre edhe pse gjykata mund të vendosë t'i përjashtojë ata nga një pagese e tillë, ose për të zvogëluar atë në varësi të situatës së tyre financiare. Megjithatë, shumica e sistemeve nuk kanë vendosur një sistem të tillë. Nga njëra anë, detyrimi për të paguar një pagesë mund ta ulë numrin e referimeve të dorëzuara në një gjykatë kushtetuese, por nga ana tjetër ajo mund ta kufizojë qasjen në të që mund të jetë rrethanë rënduese në bazë të ligjit dhe KEDNj-së kur është e zbatueshme. Në disa vende pagesa e shpenzimeve procedurale është e përcaktuar shprehimisht në rastet e aplikimeve joserioze (për shembull, Austria, Gjeorgjia, Gjermania, Malta, Portugalia, Spanja dhe Zvicra).[196]

Neni 15 [Pagat e Gjyqtarëve]

15.1 Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

15.2 Gjykatësit ndërkombëtarë, të emëruar në pajtim me Kushtetutën dhe me këtë ligj, vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas vendimit për emërim. Qeveria e Kosovës merr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë, në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë.

Legjislatura ka fiksuar pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duke i lidhur ato me pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Natyrisht, qëllimi i legjislaturës duhet të ketë qenë për të krijuar një sistem të thjeshtë të pagave të bazuar në një sistem ekzistues pa qenë i detyruar për të krijuar një sistem të ri ose tjetër të pagave e cila "duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e profesionit [të gjyqtarëve kushtetues] dhe

[195] Shih komentet në Rregullën 23 më pas.
[196] Mavcic, Arne. *Constitutional Court of the Republic of Slovenia*. Sarajevo: Venice Commission for European Democracy through Law, 2004.

barrës së përgjegjësisë së tyre".[197] Megjithatë, ajo çfarë legjislativi nuk duket të ketë parashikuar është që skema e pagës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme mund të mos jetë krejt transparente dhe e lehtë për të kuptuar. Për shembull, legjislativi nuk e ka rregulluar nëse me "shpërblim" siç theksohet në nenin 15 nënkuptohet "paga bazë" apo një sistem i shpërblimit i bazuar në gjatësinë e përvojës në profesione të tjera, duke përfshirë ato të kaluara në Gjykatë, ose mbështetur në norma tjera. Është e paqartë nëse gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të lejuar për të rregulluar detajet e pagesës së kompensimit të tyre përmes Rregullores së Punës. Në secilin rast, për momentin nuk ka ndonjë Rregull që trajton këtë problematik.

Neni është gjithashtu i heshtur sa i takon garancioneve sociale shtesë, të tilla si festat, shpërblimet, ndihmat, dhe pensionet, të cilat gjyqtarët duhet të gëzojnë në kuadër të shpërblimit që ata marrin. Mund të supozohet se në mungesë të ndonjë reference tjetër, përfitimet sociale të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme mund të përdoren si referencë në të njëjtën mënyrë siç është rasti me pagat. Legjislativi duhet të rregullojë pagesën e pagave dhe garancive sociale në mënyrë më transparente "pasi që ato (pagat) janë të lidhura ngushtë me pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve në njërën anë dhe pranimin e privilegjeve në shoqëri në anën tjetër".[198]

Garantimi i pagave të gjyqtarëve me ligj është edhe një standard ndërkombëtar. Rekomandimi Nr. (94) 12 i Komitetit të Ministrave të 13 Tetorit 1994 mbi pavarësinë, efiçencën dhe rolin e gjyqtarëve ka përcaktuar se pagat e gjyqtarëve duhet të rregullohen me ligj dhe duhet të jenë “proporcionale me dinjitetin e profesionit të tyre dhe me vëllimin e detyrave të tyre të përgjegjësive”.[199] Në Republikën e Shqipërisë pagat e gjyqtarëve kushtetues përcaktohen me Ligj, i cili përcakton se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë ndërsa paga e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.[200] Për më tepër Ligji ka përcaktuar se “pagat dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ulen dhe as të preken” duke garantuar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë dhe paprekshmërinë e pagave të gjyqtarëve kushtetues që është shumë e rëndësishme për demokracitë e reja kushtetuese. Në Republikën Federale Gjermane pagat e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese Federale përcaktohen me ligj të veçantë. Ligji për Pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë (GjKFGJ) rregullon në mënyrë të detajuar pagat e anëtarëve të GjKFGJ.

Por ka edhe shembuj të tjerë që tregojnë mënyra të ndryshme për shpërblimin e gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese. Shembulli i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Bjellorusisë është adekuat për t’u përmendur në këtë drejtim. Ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon se "pagat e Kryetarit, Zv. kryetarit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese do të përcaktohet në të njëjtin nivel me atë që rregullojnë pagat e Kryetarit, Zv. kryetarit të Parë dhe Zëvendëskryetarët e Këshillit të Lartë respektivisht".[201] Ligji më

[197] Shih Rekomandimin (94) 12 të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve (supra note 138).

[198] Opinion mbi Projekt-amendamentet e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Letonisë, të miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 80-të të saj /Venecia 2009.

[199] Shih Rekomandimin Nr. (94)12 (supra note 138).

[200] Shih Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, neni 17.

[201] Neni 25(2), Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Belarusisë.

tej parasheh që "gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që nuk posedojnë hapësirë të jetesës, kanë banesë me qira ose që kanë nevojë për strehim më të mirë për arsye të tjera, do t'i mundësohet qëndrim adekuat në qytetin e Minskut me shpenzimet e buxhetit të Republikës, jo më vonë se gjashtë muaj pas zgjedhjes së tyre për postin e gjyqtarit apo pas shfaqjes së shkaqeve të përmendura".[202] Edhe në qoftë se mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron para se ai/ajo të arrijë moshën e daljes në pension ose në raste të veçanta të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, "ai mund, me kërkesën e tij, të kthehet në funksionin e tij të mëparshëm ose t'i ofrohet punë ekuivalente në qoftë se ky post nuk është në dispozicion".[203]

Në Slloveni, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore në përputhje me rregullat e sigurimit social për personat në punësim të përhershëm.[204] Gjyqtarët kushtetues në Slloveni gëzojnë gjithashtu të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për dhe nga puna, kompensimin-e shpenzimeve për udhëtime biznesi (kompensim të udhëtimit, kompensim të përditshëm, shpenzimet hoteliere), kompensimi për ushqim gjatë punës, kompensimi i pushimit vjetor, kompensim zhvendosje, rimbursimin e shpenzimeve të bëra gjatë ditëve që udhëtojnë nga vendi i punës në vendin e banimit të përhershëm dhe mbrapa, kompensimin e shpenzimeve të lëvizjes nga vendbanimi përhershëm në vendin e punës dhe mbrapa, rimbursimin e kostove të trajnimit dhe bonus për dalje në pension.[205]

Neni 15.2 [për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji)] i është shtuar neni 15 në bazë të nenit 2 të Ligjit, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës miratuar nga Kuvendi më 7 shtator 2012. Sipas nenit 5.2, Qeveria e Kosovës do të kontribuojë në pagimin e pagave të gjyqtarëve ndërkombëtarë të përcaktuar me vendimin e emërimit nga ana e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN). Deri më tani, këto paga janë mbuluar vetëm nga bashkësia ndërkombëtare. Kështu, me hyrjen në fuqi të Ligjit të miratuar më 7 shtator 2012 deri në fund të afatit të përcaktuar d.m.th. periudhës së mandatit të tyre, Qeveria e Kosovës do të marr pjesë në pagesën e gjykatësve ndërkombëtarë në periudhën e përcaktuar në vlerë të pagave të gjyqtarëve vendorë të përcaktuar në nenin 5.1.

[202] Neni 25(3), Ligji për Gjykatën Kushtetuese.
[203] Neni 25(4), Ligji për Gjykatën Kushtetuese.
[204] Neni 73, Ligji për Gjykatën Kushtetuese.
[205] Neni 74 (1), Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Kreu II: Procedurat

1. Dispozitat e përgjithshme procedurale

Neni 16 [Rregulli i përgjithshëm]

16.1 Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

16.2 Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese.

1 Neni 16.1 përcakton parimin se dispozitat e përgjithshme procedurale (lex generalis) të përcaktuara në Kreun II të Ligjit do jenë të zbatueshme për të gjitha procedurat gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, palët janë në dijeni për të drejtat e tyre procedurale gjatë procedurave para Gjykatës, duke krijuar sigurinë juridike dhe mbrojtjen e barabartë para ligjit, të cilat janë dy parimet themelore të sundimit të ligjit, të garantuara me Kushtetutë. Megjithatë, nëse një dispozitë procedurale diku tjetër në Ligj shmanget nga dispozitat e përgjithshme procedurale të Kreut II, kjo dispozitë e veçantë procedurale (lex specialis) duhet të zbatohet në vend të rregullës së përgjithshme.

Në fakt, është Kreu III (Procedurat e Veçanta) i Ligjit që përcakton procedurat e veçanta që Gjykata duhet të aplikojë në çështjet e ngritura para saj në formën ligjore nga pala e autorizuar e përcaktuar sipas nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës.

Nga Nënkreu 1 [Procedurat për rastet nga neni 113.2, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës][206] e deri tek Nënkreu 12 [Procedurat për rastet e përcaktuara në nenin 113.9 të Kushtetutës][207] i Kreut III, përcaktojnë se deri në çfarë mase këto procedura të veçanta ndryshojnë nga dispozitat e përgjithshme procedurale të përcaktuara në Kapitullin II dhe mënyrën se si ato duhet të aplikohen nga Gjykata. Këto përjashtime nga dispozitat e përgjithshme procedurale të Kapitullit II, tash e tutje në mënyrë më të detajuar do të komentohen në Nënkapitullin III të Ligjit, së bashku me Rregulloren përkatëse të punës.

Ligjet mbi gjykatat kushtetuese në shumicën e vendeve evropiane përmbajnë dispozita të veçanta procedurale për çështje të ngjashme.[208]

---

[206] Neni 113.2 i Kushtetutës parashikon: "Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim në Gjykatën Kushtetuese: (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

[207] Neni 113.9 i Kushtetutës parashikon: "Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".

[208] Kapitulli VII [Procedurat e veçanta] i Ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; Kapitulli VI [Zgjidhja e mosmarrëveshjeve juridiksionale ndërmjet pushtetit

2 Neni 16.2 duket së lë të nënkuptojë që Gjykata Kushtetuese në raste të veçanta, kur ligji nuk parashikon dispozitat e duhura procedurale, duhet të përdorë dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale *"në mënyrë të arsyeshme dhe analoge"*. Megjithëse, neni 16.2 nuk specifikon se cilat *"janë ligjet tjera procedurale"* në të cilat Gjykata duhet të ketë mbështetje dhe poashtu ka një margjinë të konsiderueshme të vlerësimit, në vendimin e saj për dispozitat e tilla, ajo kufizohet nga tri kritere: (1) dispozitat procedurale përkatëse do të zbatohen në mënyrë të arsyeshme dhe analoge; (2) natyra e rastit duhet të lejojë zbatimin e dispozitave të tilla procedurale dhe (3) dispozitat që do të aplikohen duhet që të përshtaten me specifikat procedurale, pra procedurat e Gjykatës Kushtetuese. Nëse ballafaqohet me një situatë të tillë, Gjykata me shkathtësi do të vendosë për përdorimin e këtyre kritereve.

Legjislativi duhet t'ia ketë dhënë këtë mjet Gjykatës Kushtetuese, vetëm për shkak se ajo është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të veta[209] dhe do ta përdorë atë me vetëpërmbajtje të nevojshme dhe, siç përcaktohet me nenin, *"në mënyrë të arsyeshme dhe analoge"*. Ndonëse, siç u tha më lartë, kjo dispozitë nuk i referohet në veçanti ndonjë prej "ligjeve të tjera procedurale", por mendohet se legjislatura mund të ketë paraparë procedura të tilla si ato të përcaktuara në, *inter alia*, Ligjin mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006 të datës 30 qershor 2008), Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26 të datës 6 korrik 2003), si dhe Ligjin mbi Procedurën Administrative (Ligji Nr. 02/L-28 të datës 22 korrik 2005).

Si vërejtje e fundit duhet të përmendet që, është e paqartë se pse neni 16.2 i referohet vetëm dispozitave përkatëse të ligjeve të tjera procedurale, në vend që së pari të përmendë Rregulloren e Punës së Gjykatës, e cila tashmë përmban rregulla procedurale shtesë, disa prej të cilave mund ta kompensojnë mungesën e dispozitave procedurale në Kreun II dhe Kreun III të Ligjit. Për shembull, neni 25 [Provat] i Ligjit përcakton se *"Procedura për administrimin dhe shqyrtimin e provave do të përcaktohet në Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese."* Pra, në vend që të sigurohet që procedura për administrimin dhe shqyrtimin e provave të jetë e ngjashme me dispozitat përkatëse, për shembull, të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, neni e fuqizon Gjykatën që vetë të përcaktojë një procedurë të tillë. Sigurisht, gjatë përgatitjes së rregullave të tilla, Gjykata vërtetë mund të ketë përdorur procedurën për administrimin e provave të atij Ligji si një shembull, por po ashtu mund të ketë pasur opsion për procedurë të ngjashme të ligjeve të tjera. Edhe pse kjo do të ishte shumë e logjikshme, sistemi ligjor menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe miratimit të Kushtetutës ndodhej në gjendje fluide. Disa ligje ishin në proces të hartimit, me qëllim të harmonizimit të sistemit ligjor me

legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor]; Kapitullin X [Procedurat e Apelit të Gjykatës Kushtetuese] të Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë; Kapitulli VII [Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës, Kryetarit të Qeverisë ose të Ministrave]; Kapitulli X [Opinion mbi pajtueshmërinë e Traktateve me Kushtetutën] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë.

[209] Shih Nenin 112.2 të Kushtetutës: Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saja.

Kushtetutën e re.[210] Prandaj, është e kuptueshme që zgjidhja optimale në bazë të rrethanave ishte fuqizimi i Gjykatës që vetë të përcaktojë procedura të tilla. Komente të mëtejshme mbi nenin 25 dhe Rregulloren përkatëse të punës do të trajtohen nga këtu e tutje.

Në të njëjtën kohë, Gjykata duhet të ketë të drejtë, që kurdo që e kërkojnë rrethanat, për shembull, në qoftë se në një situatë të caktuar nuk do të mund të zbatohet asnjë rregull përkatëse e Rregullores së Punës ose asnjë dispozitë përkatëse e ndonjë ligji tjetër procedural, për të miratuar vetë një dispozitë të duhur procedurale, në pajtim me nenin 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 1, i Kushtetutës dhe nenin 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 2, i Ligjit, ku që të dyja sigurojnë se: "Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin." Në qoftë se ndodh një situatë e tillë, Gjykata duhet të obligohet që në vendimin përkatës të përmend këtë shprehimisht. Sipas praktikës së deritanishme gjyqësore të Gjykatës, si duket ende nuk ka ndodhur asnjë situatë e tillë.

Sa i përket rregulloreve të ngjashme të vendeve fqinje, mund të referohet, për shembull, neni 34 i Aktit Kushtetues mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, që parashikon një rregull pothuajse identike, duke deklaruar se: *"Nëse nuk parashikohet ndryshe me Aktin Kushtetues, Gjykata Kushtetuese në mënyrë suplementare kuptimplotë do të zbatojë dispozitat e legjislacionit procedural përkatës të Republikës së Kroacisë."*[211]

Neni 17 [Parimi i Publicitetit]

17.1 Seancat, përfshirë edhe shpallja e aktgjykimeve janë të hapura për publikun.

17.2 Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun kur vlerëson që është e nevojshme për ruajtjen e:

1.1. sekretit shtetëror, rendit ose moralit publik;

1.2. informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi publik;

1.3. jetës private ose sekretit afarist të palës në procedurë.

17.3 Procedura për përjashtimi e publikut nga paragrafi 2 mund të iniciohet me kërkesën e palës.

17.4 Gjatë procesit të këshillimit dhe votimit në kuadër të marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, marrin pjesë vetëm gjyqtarët.

Duke pasur parasysh titullin e dhënë, mund të pritej që neni 17 do të ofrojë një deklaratë të përgjithshme mbi karakterin publik të aspekteve të ndryshme të punës së Gjykatës. Megjithatë, neni jep vetëm shembuj të parimit të publicitetit, siç (1) seancat

[210] Shih listën e ligjeve të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në dispozicion tek: http://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=1&InstID=1&CatID=6 (vizituar me datën 28 prill 2014).

[211] (2002) Ligji Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Koacisë / Ustavni Zakon o Ustavnom sudu Republike Hrvatske / Constitutional Act on the Constitutional Court of the Republic of Croatia, http://www.usud.hr/default.aspx?Show=ustavni_zakon_o_ustavnom_sudu&m1=27&m2=49&Lang=en, (vizituar me datën 28 prill 2014).

janë të hapura për publikun, (2) duke përfshirë seancat ku nxirren aktgjykimet, si dhe (3) përjashtimet e parimit, por nuk e konfirmon, në përgjithësi, karakterin publik të punës së Gjykatës.

Në fakt, është Rregulla 22.1 e cila përcakton publicitetin e punës së Gjykatës në përgjithësi: *"Puna e Gjykatës do të jetë transparente, e hapur dhe e qasshme për publikun për aq sa është e mundur, në përputhje me Kushtetutën, ligjin dhe kërkesat e konfidencialitetit të Gjykatës [...].* Rregulla 22 parasheh aspektet shtesë të parimit të publicitetit të nenit 17 për të cilin do të komentohet këtej e tutje. Nga pikëpamja ligjore, do të kishte qenë më e përshtatshme, nëse parimi i përgjithshëm i publicitetit të punës së Gjykatës do të kishte qenë i përcaktuar në ligj, dhe i miratuar nga Kuvendi, në vend se të lihet në varësi të Gjykatës për të përcaktuar një parim të tillë të përgjithshëm në Rregulloren e vet të Punës.

Aktet e Gjykatave Kushtetuese të Sllovenisë dhe Kroacisë përmbajnë parimin e përgjithshëm të publicitetit, Akti i Gjykatës Kushtetuese sllovene, në nenin e tij 3 (1), që përcakton: *"Puna e Gjykatës Kushtetuese është publike kur parashikohet me këtë ligj"*, ndërsa neni 3 i Aktit kroat për Gjykatën Kushtetuese parashikon se: *"Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese është publike."*

Një pjesë integrale e parimit të publicitetit, të përshkruar në nenin 17, përpos të drejtës për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore, është e drejta e qasjes në informacion dhe në shpërndarjen e informacionit, e cila është e lidhur ngushtë me të drejtën e lirisë së shprehjes. Si kushtetutat e të gjitha vendeve demokratike, ashtu edhe Kushtetuta e Kosovës e përkufizon këtë të drejtë duke e përcaktuar në nenin 40 [Liria e Shprehjes], paragrafi 1:. *"Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për t'u shprehur, për të shpërndarë dhe marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush."* Prandaj Kushtetuta në këtë mënyrë, njeh faktin se e drejta për të pranuar dhe shpërndarë informacione është elementi kryesor (qendror) i lirisë së shprehjes dhe një pjesë integrale e parimit të publicitetit.[212]

Gjithashtu GjEDNj-ja në praktikën e saj vazhdimisht thekson se neni 10 [Liria e Shprehjes] i KEDNj-së jo vetëm që garanton të drejtën për të shpërndarë informacion dhe ide, por gjithashtu përfshin të drejtën e publikut për t'u informuar si duhet. Informacioni i tillë është, inter alia, i përcaktuar në dokumentet publike, duke përfshirë dokumentet e gjykatës, të cilat duhet të jenë të disponueshme për publikun sa më shumë të jetë e mundur.

Në lidhje me këtë këtu duhet të ceket një gjykim i rëndësishëm i GjEDNj-së i muajit prill 2009 në të cilën është njohur e drejta për qasje në dokumente zyrtare. Në këtë Aktgjykim, GjEDNj-ja e bëri të qartë se, kur organet publike zotërojnë informacion që nevojitet për debat publik, refuzimi për të ofruar dokumentet përkatëse për ata që janë duke kërkuar qasje në to, përbën shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, që garantohet me nenin 10 të KEDNj-së. Rasti kishte të bënte me një kërkesë nga Társaság a Szabadságjogokért (Unioni Hungarez i Lirive Civile - TASZ), drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë, për të shpalosur ankesën e një deputeti që e vinte në dyshim ligjshmërinë e legjislacionit të ri penal mbi veprat penale të lidhura me drogën. Gjykata Kushtetuese refuzoi të bëjë publik informacionin. GjEDNj-ja konstatoi se kërkuesi ishte i përfshirë në mbledhjen e ligjshme të informacioneve për

[212] Társaság a Szabadságjogokért v. Hungary, nr. 37374/05, § 38, 14 pril 2009, http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-92171 (vizituar me datën 9 qershor 2014).

një çështje me rëndësi publike dhe se monopoli i Gjykatës Kushtetuese mbi informacionin përbënte një formë të censurës. Për këtë arsye, u arrit në përfundim se ndërhyrja nga Gjykata Kushtetuese me të drejtat e ankuesit përbënte shkelje të nenit 10 të KEDNj-së.[213].

E drejta kushtetuese e qasjes në dokumente publike që posedojnë institucionet e Kosovës është e parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] që përcakton se 1. *"Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike"* dhe 2. *"Dokumentet e institucioneve publike dhe organeve të pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve afariste ose të klasifikimit të sigurisë."* Neni 41 i Kushtetutës zbatohet me Ligjin Nr. 03/L-215 [Qasja në Dokumentet Publike].

Sipas nenit 1 të tij, qëllimi i Ligjit është "*që të garantojë të drejtën e* secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike." Neni 3 e përkufizon një dokument publik si një *"dokument zyrtar, përfshirë por pa u kufizuar në,* të gjitha informatat e regjistruara në çfarëdo forme, të hartuara apo pranuara dhe mbajtura nga institucionet publike. Dokument zyrtar është çdo shkresë zyrtare që shërben për të dëshmuar ose për të vërtetuar diçka, pa marrë parasysh formën e saj fizike apo karakteristikat, tekstin e shkruar apo të shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet punuese, si dhe incizimet tingullore, të zëshme, magnetike apo elektronike, incizimet optike apo video incizimet në çfarëdolloj forme, si dhe pajisje bartëse për përpunim automatik të të dhënave me memorie të instaluara apo bartëse për arkivimin e të dhënave në formë digjitale."

Pasi që dokumentet e gjykatave janë të mbrojtura me ligj, Gjykata është e detyruar të ndjekë procedurat dhe rregullat e tjera për procedimin e aplikacioneve për qasje në dokumente publike. Gjykata e ka plotësuar Ligjin, duke miratuar Rregullat 22 [Qasja në punën e Gjykatës] dhe 23 [Qasja në dosje dhe dokumente] të Rregullores së Punës së Gjykatës, të cilat ofrojnë detaje në lidhje me transparencën, hapjen dhe qasjen në punën e Gjykatës për publikun, duke përfshirë shikimin e dosjeve dhe dokumenteve.

Përveç rregullës së përgjithshme që *"[] Puna e Gjykatës do të jetë transparente, e hapur dhe e qasshme për publikun"*, Rregulla 22 gjithashtu ofron aspekte të veçanta të parimit të publicitetit, së bashku me, inter alia, nenin 20 [Vendimet] dhe 24 [Shyrtimi verbal] të Ligjit si dhe Rregullën 23 [Qasja në Dosje dhe Dokumente] të Rregullores së Punës, të cilat rëndisin aspekte të mëtejshme të parimit të publicitetit të përmendur në nenin 17. Këto do të komentohen në detaje këtej e tutje.

1 Siç është e përshkruar në këtë dispozitë, kërkesa e publicitetit përfshin dy elemente: natyra publike e seancave të Gjykatës dhe natyra publike e aktgjykimit të Gjykatës. Neni përdor termin"seancat" (në versionin anglisht), edhe pse do të ishte më i saktë përdorimi i termit "seancat plenare". Sipas Fjalorit Juridik nga Black, seanca e gjykatës është *"koha gjatë së cilës në fakt ajo qëndron për transaksionin e punës gjyqësore, dhe në këtë mënyrë përfundon çdo ditë me ngritje të gjykatës."*[214] Kështu, "seancat", mund të nënkuptojë: dëgjime të mbyllura ose

[213] Ibid.

[214] "Black's Law Dictionary 1078 (2nd ed. 1995), Featuring Black's Law Dictionary Free Online Legal Dictionary 2nd Ed..". http://thelawdictionary.org/session (vizituar me datën 9 qershor 2014).

publike, shqyrtimet si dhe votimi nga ana e gjyqtarëve, nxjerrja e aktgjykimeve dhe veprimtarive të tjera të gjykatës.

Megjithatë, në kontekstin e nenit 17.1, termi "seanca" në mënyrë të qartë nuk përfshin këshillimin dhe votimin, i cili, në bazë të Rregullës 17.4 *("Vetëm gjyqtarët marrin pjesë në punën e Gjykatës Kushtetuese gjatë këshillimit dhe votimit kur të merren vendimet"*) dhe Rregullës 44.1 *("Këshillimet e Gjykatës nuk do të jenë të hapura për publikun dhe do të mbeten konfidenciale.")* janë të mbyllura për publikun. Gjithashtu seanca administrative, e përmendur në Rregullën 14 [Seanca administrative], ku gjyqtarët diskutojnë dhe vendosin për çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës, janë zakonisht të mbyllura për publikun, edhe pse të dyja, Ligji dhe Rregulla heshtin lidhur me këtë çështje.

Fushëveprimi i "seancave " në nenin 17.1 me sa duket, është arsyeja, e kufizimit në (1) seancat dëgjimore; (2) seancat ku shpallen vendimet dhe (3) në ato ku kryhen punët e tjera të gjykatës (për shembull, ceremonitë zyrtare në një seancë të Gjykatës në të cilën mund të marrë pjesë publiku, etj). Sa i përket nxjerrjes së aktgjykimeve, Gjykata ka miratuar një procedurë tjetër, domethënë, ajo publikon gjykimet e saj në faqen e saj dhe në Gazetën Zyrtare (shih për detaje të mëtejshme nenin 20 [Vendimet], paragrafi 4, këtej e tutje), në vend që të nxjerrë këto së pari në seancën publike të Gjykatës. Sipas nenit 11.1 Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të BeH, seancat dhe dëgjimet publike nuk janë identike. Përveç dispozitës së përgjithshme që: "Puna e Gjykatës do të jetë publike", neni përcakton se: *"Procedurat para Gjykatës do të bëhen publike:. 1. duke e informuar publikun për përgatitjet dhe mbajtjen e [e] seancave të Gjykatës si dhe dëgjimeve publike para Gjykatës; [...]. "*

Në këtë mënyrë, neni 11.1 Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të BeH bën dallim të qartë midis "seancave " dhe "dëgjimeve publike", pasi që ajo siguron se publiku do të informohet për përgatitjet dhe mbajtjen e "*seancave të Gjykatës si dhe dëgjimeve publike para Gjykatës.* " Kjo duket të jetë konfirmuar nga neni 11.3 që përcakton se pjesëmarrësit në procedurë dhe personat e tjerë të interesuar janë të lejuar *"të jenë të pranishëm në seancat e Gjykatës, përveç nëse Kryetari i Gjykatës, në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare shoqërinë demokratike, vendos ndryshe; [...].*"

Në rastin e dëgjimeve publike, megjithatë, sipas nenit 46 të Kreut 4 [Dëgjimet Publike] të Rregullave të Gjykatës Kushtetuese të BeH, nuk është Kryetari, por vetë Gjykata ajo e cila vendos për përjashtimin e publikut. Edhe pse Rregullorja e Punës nuk e specifikon se çfarë është menduar pikërisht me *"seancat e Gjykatës*", të paktën është e qartë se ata nuk përqafojnë "sesione pune" të cilat, së bashku me seancat ku zhvillohen këshillimet dhe votimi, janë të mbyllura për publikun në bazë të nenit 12 të Rregullave të Gjykatës Kushtetuese të BeH.

Cilido që të jetë kuptimi i saktë i termit "seancat", rregulla e përgjithshme duket të jetë se publiku ka të drejtë të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore dhe dëgjimet publike

Megjithatë, neni 17.1 nuk i jep një pale "të drejtën" për një seancë dëgjimore sikur që neni 20 [Vendimet] i Ligjit mund të kuptohet të ketë bërë, por gjoja trajton situatën ku Gjykata ka marrë vendim, në bazë të Rregullës 39 [Seancat dëgjimore dhe Shqyrtimet], të mbajë seancë dëgjimore gojore e cila, në bazë të parimit të

publicitetit, është e hapur për publikun. Në këtë mënyrë, (1.) palët kanë të drejtë të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në seancën dëgjimore; (2) publiku dhe mediet kanë të drejtë të jenë të pranishëm; dhe (3) aktgjykimi duhet të bëhet publik, që tregon se parimi i publicitetit nuk është vetëm një e drejtë subjektive e palëve në procedurë, por edhe një parim kushtetues, qëllimi i së cilës është vendosja e Gjykatës nën mbikëqyrjen e publikut[215].

Parimi i karakterit publik të një seancë dëgjimore është i mishëruar në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 3, i Kushtetutës, duke përcaktuar se:

"3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj".

Neni 31.3 i Kushtetutës dhe neni 17.1 i Ligjit plotësohen me Rregullën 22 [**Qasja në punën e Gjykatës**], paragrafi 1, dhe Rregullën 39.3 të Rregullores së Punës. Rregulla 22.1 parasheh:

Puna e Gjykatës është transparente, e hapur për publikun dhe me qasje në të deri në shkallën më të lartë të mundshme, në pajtim me Kushtetutën, në pajtim me Ligjin dhe me kriteret për ruajtjen e konfidencialitetit, përfshirë, por jo të kufizuar në:

(a) informimin e publikut për datën dhe për kohën e mbajtjes së dëgjimeve;

(b) ofrimin e informacioneve për rrjedhën e procedurës; […].

Edhe pse Rregulla nuk e përmend shprehimisht se dëgjimet e Gjykatës do të jenë të hapura për publikun, ai përcakton të paktën që publiku duhet të informohet për datën dhe kohën e dëgjimeve si dhe për rrjedhën e procedurës. Kjo vetëm mund të kuptohet të thotë se dëgjimet janë, në parim publike, përveç nëse kërkesat e konfidencialitetit, siç u diskutua më lartë, do të shpien Gjykatën të vendosë ndryshe. (shih komentet e mëtejshme mbi Rregullën 22)

Rregulla 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] në Kreun IV. Seancat dëgjimore dhe shqyrtimet, edhe pse është më e qartë në këtë drejtim, duke përcaktuar, në paragrafin 3, se: *" Seanca dëgjimore është publike, përveç nëse Gjykata urdhëron ndryshe, kur ka arsyetim të mirë sipas Ligjit ose sipas kësaj Rregulloreje."*

Një e drejtë e ngjashme është e përcaktuar në nenin 6 [E drejta për Gjykim të Drejtë] të KEDNj-së që së bashku me shtatë (7) instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut [216], është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë në bazë të nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve

[215] Shih Open Society Justice Initiative (OSJI). "Report on Access to Judicial Information", March 2009 http://www.right2info.org/resources/publications (vizituar me datën 9 qershor 2014). Raporti shqyrton ligjet dhe praktikat e mbi 15 shteteve për qasje në dokumente gjyqësore dhe informacione mbi gjyqësorin.

[216] Këto instrumente të drejtave të njeriut janë: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Ndërkombëtare] të Kushtetutës dhe në rast të konfliktit ka prioritet ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të autoriteteve publike në Kosovë. KEDNj-ja mban një vend të veçantë në mesin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare, sepse Kushtetuta parashikon, në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] se *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) "*. Kjo nënkupton se, në rastet kur gjykon një kërkesë sipas të cilës shkelja e një të drejte ose lirie kushtetuese është e pretenduar, Gjykata Kushtetuese duhet të ndjekë praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut lidhur me interpretimin e kësaj të drejte kushtetuese (Neni 53 do të komentohet në detaje këtu e tutje).[217]

Neni 6 KEDNj-ja parashikon, në mënyrë të ngjashme si neni 31 i Kushtetutës, që, inter alia, "*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i caktuar me ligj [...]*". Parimi i publicitetit mbron palët në mosmarrëveshje jo vetëm kundër administrimit të drejtësisë pas kontrollit publik, por gjithashtu e mban besimin e publikut në administratën e drejtësisë dhe në vetë gjykatat. Dukshmëria (vizibiliteti) e administrimit të drejtësisë kontribuon në sigurimin e korrektësisë së gjykimit, e që është qëllimi i nenit 6 dhe që konsiderohet me një rëndësi thelbësore në një shoqëri demokratike. Dëgjimi publik gjithashtu i lejon shtypit (medieve) që të ushtrojnë rolin e tyre kryesor si kontrollues (vigjilentët) publik, funksion ky i mbrojtur edhe me nenin 10 të Konventës. [218]

Respektimi i parimit të publicitetit është thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe, siç theksohet në GjEDNj, një nga shtyllat e shoqërisë demokratike brenda kuptimit të Konventës[219]. Ky interpretim, i cili, siç u përmend më lart, ka fuqi detyruese në Kosovë sipas nenit 53 të Kushtetutës, kërkon që çdo përjashtim nga e drejta për një proces i cili është i hapur për publikun, duhet të interpretohet në mënyrë të kufizuar, në përfundim se përjashtimi duhet të ketë një qëllim legjitim dhe të zbatohen në mënyrë proporcionale me qëllimin që kërkohet të arrihet.

Sa i përket parimit të publicitetit të nenit 17 që dëgjimi para Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë i hapur për publikun, Gjykata e Strasburgut ka vendosur të zbatojë të gjitha kërkesat e nenit 6 gjithashtu edhe për gjykatat kushtetuese. Këtë e bëri në Aktgjykimin e saj të datës 3 mars 2000, Krcmar kundër Republikës Çeke, duke deklaruar në mënyrë dërrmuese se "*Për më tepër, sipas jurisprudencës së Gjykatës,*

---

[217] Shih Rastin Nr. KI.41/09, Universiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë, Aktvendimi i 27 janarit 2010, pika 11. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2009-2010*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2011, faqe 50.

[218] "INTERIGHTS Manual for Lawyers – Right to A Fair Trial under the ECHR (Article 6)". http://www.inte rights.org/files/107/INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014). Neni 10 i KEDNj-së parasheh: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë […]".

[219] Shih Öllinger v. Austria, no. 76900/01, ECHR 2006-IX; Werner v. Austria, 24 November 1997, Reports of Judgments and Decisions 1997-VII; Diennet v. France, 26 September 1995, Series A no. 325-A; Pretto and Others v. Italy, 8 December 1983, Series A no. 71; Axen v. Germany, 8 December 1983, Series A no. 72.

neni 6.1 vlen për procedurat para gjykatave kushtetuese".[220] Deri atëherë, GjEDNj-ja kishte vendosur tek një numër i rasteve që vetëm disa aspekte të të drejtave të garantuara nga neni 6 i KEDNj-së ishin të zbatueshme për procedura të tilla.

Sidoqoftë, sipas GjEDNj-së, gjykatat kushtetuese gëzojnë një status të veçantë dhe luajnë një rol të veçantë në gjykimin e ankesave kushtetuese. Prandaj, edhe pse ato bien në parim në kuadër të zbatimit të kërkesave të nenit 6 të KEDNj-së, gjykatat kushtetuese ende gëzojnë një liri të caktuar të vlerësimit, për shembull, si të drejtën për dëgjim publik.[221] Edhe pse kjo e drejtë është e një rëndësie parësore për gjykatat e rëndomta, nuk është e rëndësisë së njëjtë për procedurën para Gjykatës Kushtetuese, pasi që, në parim, procedurat kushtetuese janë të kufizuara në shqyrtimin e çështjeve të kushtetutshmërisë dhe, për këtë arsye, zakonisht nuk sjellin një vlerësim të çështjeve të faktit ose të çështjeve të ligjit.

Megjithatë, pasi Gjykata ka vendosur të mbajë seancë dëgjimore, palët kanë të drejtë të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në seancën e dëgjimit, e cila, në të njëjtën kohë, duhet të jetë e hapur për publikun dhe media, përveç nëse Gjykata vendos të përjashtojë ata nga dëgjimi për arsye të parashtruara në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, neni 17.2 të Ligjit dhe Rregullat 39 [e Drejta e Dëgjimit dhe Heqjes Dore) dhe 41 [Pjesëmarrja në dëgjimet] të Rregullores së Punës.

2 Pavarësisht nga natyra publike e dëgjimeve gojore, Gjykata mund të përjashtojë publikun dhe mediet për njërën nga arsyet e dhëna në nen. Përjashtime të tilla nga rregulla janë të paraparë edhe me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNj-së dhe Rregullat 39.3 dhe 41.1 të Rregullores së Punës. Në interes të drejtësisë përjashtimi i *"publikut apo medieve"* do të justifikohet vetëm, siç përcaktohet në nenin 31 të Kushtetutës, nëse prania e tyre do të rrezikonte: *"rendin publik, sigurinë kombëtare, interesat e të miturve ose intimitetin e palëve në proces në përputhje me ligjin. "*

Lista e arsyeve të përcaktuara në nenin 17.2 është, në disa aspekte, e ndryshme nga ajo e parashikuar në nenin 31 të Kushtetutës, pasi që neni 17.2 gjithashtu lejon Gjykatën që të përjashtojë publikun dhe mediet nga seanca e dëgjimit: *"për mbrojtjen e sekretit kombëtar, moralit, informacionit sekret dhe sekretit të punës të palës në procedura."* Rregulla 39.3 në të vërtetë nuk shton ndonjë arsye më shumë, pasi që vetëm thekson se Gjykata mund të urdhërojë përjashtimin e publikut,*"kur paraqitet shkaku i mirë në bazë të ligjit ose këtyre Rregullave."* Prandaj, i referohet vetëm arsyeve të përmendura më lart dhe atyre të përcaktuara në Rregullën 41 që i lejojnë Gjykatës të përjashtojë publikun nga dëgjimi,*" nëse përjashtimi i tillë është i nevojshme për të mbrojtur sigurinë e palëve apo përfaqësuesve të tyre ose përjashtimi i tillë kërkohet nga marrja në konsideratë e sigurisë dhe rendit publik."* Përveç dispozitave ligjore të mësipërme, edhe neni 6 i KEDNj-së përmban një numër arsyesh për përjashtimin e publikut dhe medies nga dëgjimi *"në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur*

[220] Shih Krčmář and Others v. the Czech Republic, no. 35376/97, § 36, 3 March 2000

[221] Shih, për më shumë detaje Kuijer, Martin. *The Blindfold of Lady Justice: Judicial Independence and Impartiality in Light of the Requirements of Article 6 ECHR.* Wolf Legal Productions, 2004.

interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkojnë këtë ose deri në atë masë që është rreptësisht e domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta ku publiciteti do të cenoj interesat e drejtësisë."
Arsyeja e fundit (përjashtimi në rrethana të veçanta ku publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë) duket se i lënë gjykatës një hapësirë të madhe për vlerësim dhe kjo mund të çojë në abuzim, nëse termi *"interes të drejtësisë"*, nuk është i definuar në mënyrë të qartë nga KEDNj-së dhe / ose GjEDNj-së. Neni 31 i Kushtetutës duket se është kopjuar nga neni 6 i KEDNj-së, me përjashtim të referencës së "moralit". Referimi në *"interes të drejtësisë"*, gjithashtu është marrë dhe, në rast se një interpretim kërkohet nga Gjykata, duhet të interpretohet në përputhje me interpretimin e GjEDNj-së.
Gjykata me siguri se nuk do të vendosë të përjashtojë publikun dhe mediet me lehtësi, pasi që, në qoftë se ajo do të përjashtojë ato, Gjykata do t'i deprimonte ato (1) nge e drejta e tyre themelore për të qenë në gjendje të kontrollojë administrimin e duhur të drejtësisë së Gjykatës Kushtetuese[222] dhe (2) nga e drejta e tyre shtesë për të marrë dhe dhënë informacion si pjesë e lirisë së tyre të shprehjes, të garantuar me nenin 40 [Liria e shprehjes] të Kushtetutës dhe nenin 10 [Liria e shprehjes] KEDNj-së (shih për detaje në tekstin e mëtejmë).
N.B. Nenet 17.1 dhe 17.2 janë plotësuar më tej nga Rregula 41 [Pjesëmarrja në dëgjimet] e Rregullores së Punës.

3 Kjo dispozitë (Neni 17.3) u mundëson palëve në procedurë që të kërkojnë nga Gjykata që të nisin procedurën për të përjashtuar publikun (dhe medien) nga seancat gojore në rastin e tij / saj për të njëjtat arsye si të renditura në nenin 17.2 të Ligjit. Në një rast të tillë, Gjykata me siguri se do të pres nga pala që të bindet për domosdoshmërinë e masës duke e bazuar mjaftueshëm kërkesën e tij / saj. Neni është i heshtur në çështjen nëse Gjykata duhet të dëgjojë palën tjetër para se të marrë një vendim lidhur me kërkesën. Megjithatë, duket se është e përshtatshme që, në funksion të parimit të "barazisë së armëve", Gjykata duhet t'i japë palës tjetër mundësi për komente lidhur me kërkesën.
Deri më tani, asnjë palë në procedurë gjyqësore nuk ka kërkuar që publiku dhe media të përjashtohet nga një seancë dëgjimore para Gjykatës.

4 Supozohet se termi "konsultim", në nenin 17.4 qëndron për "shqyrtimet" siç është rasti në Rregullën 44 [këshillimet si dhe votimi]. Siç u përmend më lart, këshillimet dhe votimi bëhet vetëm në seanca të mbyllura *(në kamera)* të cilat nuk janë të hapura për publikun. Gjykata, për këtë arsye, nuk ka nevojë që të merr një vendim mbi përjashtimin e publikut.
Edhe pse neni jep përshtypjen se "Vetëm gjyqtarët marrin pjesë në punën e Gjykatës gjatë konsultimit dhe votimit gjatë marrjes së vendimit", Rregulla 44.2 e ka zgjeruar rrethin e personave të lejuar që mund të jenë të pranishëm duke iu lejuar edhe Sekretarit të Përgjithshëm, Këshilltarit Ligjor Kryesor, si dhe punonjësve të tjerë të Sekretariatit apo këshilltarëve ligjor. Neni 17.4 nuk ofron

[222] Në përputhje me Adagio e famshëm: "Drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, ajo duhet të shihet të jetë bërë". Më shumë lidhur me këtë parim shih Aall, Jørgen. "Waiver of Human Rights: Waiver of Procedural Rights According to ECHR Article 6." *Nordic Journal of Human Rights 2011 29*: 206–278.

vetë detajet e mënyrës në të cilën gjykatësit marrin vendime. Kjo bëhet nga neni 19 [marrja e vendimeve], që komentohet këtu në tekstin e mëtejmë.
Duket se nuk ekziston përkufizim i duhur ligjor i fshehtësisë së shqyrtimeve (në kamera), por mund të merret nga literatura juridike se fshehtësia e shqyrtimeve përfshin aktivitetet që ndodhin në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, si p.sh. diskutimit midis gjyqtarëve me qëllim që të arrihet një vendim dhe votimi pasues.[223] Fshehtësia e shqyrtimeve lejon që të përmenden emrat e gjyqtarëve në gjykimin. Ruajtja e fshehtësisë së shqyrtimeve është e justifikuar, pasi që garanton autoritetin e gjykatës dhe kolegjialitetin, unitetin dhe pavarësinë e gjyqtarëve.
Ligji i ri për gjykatat, në nenin e vet 34 [Obligimet e Gjyqtarëve], paragrafët 3 dhe 4, edhe pse nuk janë të zbatueshme për Gjykatën Kushtetuese, përmban rregullat e mëposhtme: *"Gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore, gjyqtarët duhet të ruajnë fshehtësinë e gjithë informacionit jo -publik; "dhe" Gjyqtarët nuk do të komentojnë për mediat mbi përbërjen, evidencat dhe vendimet e ndonjë rastit ".*
Në përgjithësi, fshehtësia e shqyrtimeve është konsideruar si një çështje e shenjtë e cila garanton pavarësinë gjyqësore. Prandaj, përgatitjet për aktgjykim duhet të mbahen në mënyrë të pavarur dhe në mënyrë të fshehtë pa ndikimet e jashtme, kurse aktgjykimi në vetvete do të jetë publik. Gjyqtarët duhet të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve madje edhe pasi të ketë përfunduar mandati i tyre[224]
Neni 17.4 i Ligjit plotësohet nga Rregulla 44 [Këshillimet dhe Votimi] i Rregullores së Punës që parashikon konfidencialitetin e shqyrtimeve, personat që mund të jenë të pranishëm, përgatitjen e procesverbalit dhe përgatitjen e tekstit final për gjykimin e Gjykatës. Megjithatë, pasi që, sipas nenit 24 [Dëgjimi oral], "[...] *procedura e seancës dëgjimore orale do të përcaktohet në Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese,"* Rregulla 44 do të komentohet në ndërthurrje me Rregullat 39 [E Drejta e Dëgjimit dhe Heqjes Dore] deri tek 43 [Orari i seancave dëgjimore]. Këto rregulla merren me procedurën e seancës dëgjimore gojore në detaje dhe do të komentohen pas komenteve për nenin 24.

Rregulli 22 [Qasja në punën e Gjykatës] e Rregullores së punës

22.1 Puna e Gjykatës është transparente, e hapur për publikun dhe me qasje në të deri në shkallën më të lartë të mundshme, në pajtim me Kushtetutën, në pajtim me Ligjin dhe me kriteret për ruajtjen e konfidencialitetit, përfshirë, por jo të kufizuar në:
(a) informimin e publikut për datën dhe për kohën e mbajtjes së dëgjimeve;
(b) ofrimin e informacioneve për rrjedhën e procedurës;

[223] Laffranque, J. (2003). Dissenting opinion and judicial independence. *Juridica International, 8*, 162-166., http://www.juridicainternational.eu/public/pdf/ji_2003_1_162.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014), Kelemen, K. (2013)
Dissenting opinions in constitutional courts. German Law Journal, 14(8): 1345-1371 http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:662804/FULLTEXT01.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).
[224] Hambro, E. Dissenting and individual opinions in the International Court of Justice. Zeitschrift für ausländisches und öffentliches Recht und Völkerrecht (ZaöRV), 1956, Bd. 17/2, p. 229 - 48. http://www.hjpp.de/17_1956_57/17_1956_2_a_229_248.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).

(c) lejimin e shikimit të dosjeve dhe të dokumenteve;
(d) botimin e aktgjykimeve dhe të vendimeve; dhe
(e) çfarëdo forme tjetër të komunikimit të përcaktuar nga Gjykata.

22.2 Sekretari i Përgjithshëm boton aktgjykimet dhe vendimet në ueb-faqen e Gjykatës, menjëherë pas miratimit të tekstit përfundimtar të tyre dhe siguron botimin e rregullt të versioneve të shtypura të aktgjykimeve dhe të vendimeve.

22.3 Sipas nevojës, Gjykata mund të lëshojë komunikata ose mund të mbajë konferenca për medie. Komunikatat për medie të Gjykatës lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm vetëm pas miratimit të përmbajtjes nga Kryetari. Gjyqtarët marrin kopjet e të gjitha komunikatave për medie sa më shpejt që të jetë e mundur.

I. Rregulla 22.1 ka të bëjë jo vetëm me qasjen në dokumente, por përcakton një sërë të aspekteve të tjera të qasjes, hapjes dhe transparencës së punës së Gjykatës. Qasja e tillë është e domosdoshme për të mundësuar publikun, mediet dhe palët e tjera të treta që të monitorojnë drejtpërdrejt punën e Gjykatës dhe zhvillimin dhe administrimin e drejtësisë kushtetuese. Në të njëjtën kohë, qasja në informacionin e përmendur në Rregullën 22.1 është qendrore për të ndërtuar dhe për të ruajtur besimin e publikut në drejtësi kushtetuese dhe sundimin e ligjit.

Sa i përket Rregullës 22.1 (a) dhe (b), njëherit që Gjykata të ketë vendosur që të mbajë seancën dëgjimore gojore, duhet të njoftojë, shumë kohë përpara seancës, për datën dhe kohën, dhe palët e përfshira si dhe informacione të tjera në lidhje me rrjedhën e procedurës në ueb-faqen e vet dhe në tabelën e informimit publik jashtë objekteve të gjykatave dhe në gazetat kryesore. Nuk do të mund të jetë e paarsyeshme për publikun dhe medien që të jenë në gjendje të marrin një informacion të tillë me telefon, në qoftë se kanë nevojë për të. Për më tepër, Gjykata gjithashtu duhet t'i ofrojë publikut dhe medies informata mbi rrjedhën e procedurës, si shtyrjen, pezullimin ose përfundimin e procedurës.

Rregulla 22.1 (c) përmban të drejtën e qasjes në dosjet dhe dokumentet pa dhënë detaje të mëtejshme. Edhe pse Rregulla 22.1 (c) nuk shprehet, supozohet se kjo do të ndodhë, kur opinioni dëshiron t'i shoh dosjet dhe dokumentet.

Detaje të tilla gjenden në Rregullën 23 [Qasja në Dosjet dhe Dokumentet] në tekstin e mëtejmë.

Që puna e Gjykatës duhet të jetë e hapur dhe transparente me anë të publikimit të aktgjykimeve dhe vendimeve të Gjykatës, siç kërkohet me Rregullën 22.1 (d), është në përputhje me nenin 20 [vendimet], paragrafi 4, i Ligjit që përcakton se *"vendimi i dërgohet secilës palë sipas ex officio dhe botohet në Gazetën Zyrtare*." Gjykata gjithashtu publikon gjykimet e veta dhe vendimet në ueb-faqen e vet.

Qëllimi i Rregullës 22.1 (e) për ta bërë punën e Gjykatës transparente dhe të hapur nëpërmjet *"çfarëdo forme tjetër të komunikimit si të autorizuar nga Gjykata"*, mund t'i referohet krijimit të programeve në terren pasi që Gjykata është zhvilluar që nga themelimi i vet[225]

[225] Shih Raportin Vjetor të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2010, 170. Gjendet në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI_2010.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

II. Rregulla 22.2 përcakton se Gjykata, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të jetë pro-aktive në sigurimin e transparencës së punës së saj nëpërmjet publikimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe vendimeve në ueb-faqen e Gjykatës. Gjykimet dhe vendimet në faqen e internetit mund të jenë të pajisura me treguesit, për të lehtësuar kërkimin për ndonjë aktgjykim apo vendim të veçantë. Kjo rregull nuk është as zëvendësim për kërkesën, e përcaktuar në nenin 20.4 të Ligjit, për të publikuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare, dhe as zëvendësim për kërkesat e nenit 20.3 që vendimet e Gjykatës Kushtetuese do të shpallen publikisht. Kjo vetëm tregon për Sekretarin e Përgjithshëm se si të publikojë aktgjykimin dhe vendimet e Gjykatës.

III. Është bërë praktikë e Gjykatës të informojë publikun, përmes komunikatave për shtyp, organizimit të konferencave për shtyp apo në mënyrë elektronike (nuk është e përmendur në Rregullën), rreth aktiviteteve të veta (për shembull, vizitave në gjykata të tjera kushtetuese ose trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë), çështjet e natyrës administrative (për shembull, informacionit në lidhje me pozitat e lira të punës) ose informacion mbi gjyqtarët (për shembull, emërimin e gjyqtarëve të rinj, biografitë e tyre, etj). Mjetet e tilla të shpërndarjes së informacionit do të mund të përdoren gjithashtu për shpalljen publike të datës në të cilën do të mbahet seanca ose të dorëzimit të aktgjykimit. Për më tepër, Gjykata mund të lëshojë një përmbledhje të gjykimit që sapo është miratuar, por teksti i të cilit nuk është finalizuar ende[226]

Rregulli 23 [Qasja në dosje dhe dokumente] i Rregullores së punës

23.1 Palët kanë të drejtë të shikojnë dosjet dhe dokumentet zyrtare për lëndën në të cilën ata janë palë në procedurë, përveç nëse ajo dosje ose ai dokument është përcaktuar nga Gjykata të jetë konfidencial. Palët kërkojnë shikimin e dokumentit së paku 24 orë më parë. Shikimi kryhet brenda objektit të Gjykatës, gjatë orarit të punës dhe në prani të personelit të Sekretariatit.

23.2 Palët kanë të drejtë të marrin kopjet e dosjeve dhe të dokumenteve për lëndën në të cilën ata janë palë në procedurë, përveç nëse ajo dosje ose ai dokument është përcaktuar nga Gjykata të jetë konfidencial. Gjykata mund të caktojë taksë administrative për kopje të tilla.

23.3 Raporti i Gjyqtarit raportues, projektvendimi i Kolegjit shqyrtues, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e gjyqtarëve, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të gjyqtarëve gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit

---

Raporti Vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2011, 53-54. Gjendet në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Raporti%20Vjetor%202011%20Versioni%20Final.pdf,, (vizituar për herë të fundit më 28 prill, 2014).

Raporti Vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2012, 59. Gjendet në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/RAPORTI%20VJETOR%202012.pdf,, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Raporti Vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 2013, 61 -. 62 Gjendet në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_raporti_vjetor_2013.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[226] Shih për shembull Komunikatën për media të datës 3 shtator 2013, në lidhje me Rastin KO 108/13, http://www.gjk-ks.org/?cid=2,28,347, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

të rastit, si dhe materiali tjetër i përcaktuar nga Gjykata, duhet të jetë konfidencial dhe në të nuk do të kenë qasje as palët, e as publiku. Gjykata mund të autorizojë lëshimin e dokumentit konfidencial, në rast se përcakton që një gjë e tillë është e domosdoshme për interesin publik.

I. Rregulla 23.1 ka të bëjë me të drejtën e palëve për të parë dosjet dhe dokumentet zyrtare, por vetëm në rastin e tyre. Për më tepër, edhe pse palët mund t'i shohin vetëm "dosjet dhe dokumentet zyrtare ", supozohet se ata mund t'i shohin dosjet dhe dokumentet "jo-zyrtare", nëse ka ndonjë dokument të tillë në rastin kur ata janë palë. E drejta e palëve për të parë dosjet dhe dokumentet (zyrtare) në rastin e tyre është një nga aspektet e parimit të barazisë së armëve (palët në procedurë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime), i cili është një tipar i së drejtës për gjykim të drejtë.

E drejta e palëve për të parë dosjet dhe dokumentet zyrtare vetëm në rastin e tyre duket të jetë mjaft e kufizuar dhe shtron pyetjen, se pse palët nuk duhet të kenë të drejtë t'i shohin dosjet dhe dokumentet në rastet e tjera, për shembull, në rastet e ndonjë natyre të ngjashme, që mund të sigurojë argumente të rëndësishme për rastin e tyre. E drejta e publikut t'i shoh dosjet dhe dokumentet e gjykatës është një rrjedhim logjik i rëndësishëm i së drejtës për të pasur drejtësi që jepet në publik.

Siç u përmend më lart, publiku ka të drejtë të ngjashme sipas Rregullës 22.1 (c), sfera e veprimit e të cilit duket të jetë më e gjerë, pasi që lejon *"për të parë dosjet dhe dokumentet"*, pa Rregullën që e kufizon qasjen në ndonjë rast të veçantë, ashtu siç Rregulla 23.1 me sa duket e bënë.

Rregulla 23.1 parasheh se palët nuk kanë të drejtë për të parë dosjet dhe dokumentet të cilat Gjykata i ka caktuar si konfidenciale. Rregulla, megjithatë, nuk i përmend kriteret e konfidencialitetit në bazë të të cilit qasja në dosjet dhe dokumentet mund të kufizohet për palët. Kriteret e tilla mund të renditen nga sigurimi ose siguria kombëtare deri tek interesat e biznesit dhe të përmenden nga Gjykata, gjatë përcaktimit të konfidencialitetit të dosjeve dhe dokumenteve përkatëse. Kufizimi i qasjes në dosjet dhe dokumentet konfidenciale i aplikuar nga Gjykata për palët në ndonjë rast të veçantë, duhet gjithashtu të zbatohet, *mutatis mutandis*, tek kërkesat e anëtarëve të publikut për të pasur qasje në të njëjtat dokumente. Dosjet ose dokumentet konfidenciale janë të përcaktuara në komentet në Rregullën 23.3

Mund të jetë ashtu, që një palë, kur i shikon shkresat e lëndës, konstaton se një dokument (zyrtar ose jo) nuk është i pranishëm, por është në posedim të palës tjetër. Në këtë rast pala e interesuar në përmbajtjen e këtij dokumenti, mund ta shfrytëzojë procedurën e përcaktuar në Rregullën 51 [Dokumentet], paragrafi 3, i Rregullores së Punës.

Rregulla 23.1 më tej rregullon mënyrën në të cilën dosjet dhe dokumentet zyrtare mund të shihen nga palët, duke siguruar se kërkesa duhet të jetë e parashtruar 24 orë më parë dhe se shikimi mund të bëhet vetëm në praninë e stafit të Sekretariatit gjatë orarit të rregullt të punës. Prania e anëtarit të stafit është e nevojshme për të siguruar se shikimi i dosjeve dhe dokumenteve të ndodhë në mënyrë të rregullt dhe që dokumentet të cilat janë konfidenciale nuk shihen pa qëllim.

II. Rregulli 23.2 i lejon palët të marrin kopje të dosjeve dhe dokumentet që ata kanë të drejtë t'i shohin në bazë të Rregullës 23.1, por vetëm *"në rastin në të cilat ata janë palë"* (Rregulli 23.2 nuk e përmend që dosjet dhe dokumentet duhet të jenë "zyrtare ", siç është rasti me Rregullën 23.1). Kjo e drejtë mund të kufizohet për të njëjtën arsye siç është përmendur në Rregullën 23.1, domethënë, kur Gjykata konstaton se dosjet ose dokumentet që duhet shikuar janë konfidenciale. Rregulla më tutje parashikon që Gjykata mund të ngarkojë një pagesë administrative për çdo kopje.

Supozohet që gjithashtu një anëtar i publikut ka të drejtë të marrë kopje të cilado dosjeve dhe dokumenteve kundrejt taksës administrative, nëse ka, përveç nëse dosja ose dokumenti është konfidencial siç përcaktohet nga Gjykata.

III. Dokumentet e Gjykatës të përmendura shprehimisht në Rregull janë sipas *ex officio* konfidenciale, por Gjykata mund të vendosë ta heqë karakterin konfidencial në ndonjë prej dokumenteve të tilla "në interes të publikut". Shtrohet pyetja nëse Rregulla gjithashtu do të lejojë palë ose anëtar të publikut për të kërkuar dhënien e një dokumenti konfidencial "në interes të asaj pale apo atij anëtari të publikut". Rregulli nuk jep një përgjigje kësaj pyetjeje, por nuk rezulton të ketë një pengesë për Gjykatën për të pranuar një kërkesë të tillë në raste të veçanta dhe vetëm nëse kërkesa është e justifikuar siç duhet.

Përveç dokumenteve të Gjykatës të përmendura, Gjykata mund përcaktojë që çdo material tjetër të konsiderohet konfidencial. Ashtu si në Rregullën 23.1, nuk ka arsye për konfidencialitet të tillë që përmendet veçanërisht, por supozohet se kjo mund të ndodhë, kur, sipas mendimit të Gjykatës, materialet e tilla shtesë përmbajnë informacion zbulimi i të cilave mund të jetë i dëmshëm për interesa të caktuara, për shembull, për interesat kombëtare ose të sigurisë, moralit publik dhe interesave private dhe të biznesit, etj. Dosjet dhe dokumentet e tilla konfidenciale nuk mund të shihen nga palët dhe publiku, por, si në rastin e dokumenteve të Gjykatës, nëse Gjykata e konsideron dhënien e tërë ose një pjesë të materialit konfidencial shtesë të nevojshëm për interesin publik (ose, ndoshta, tjetër), mund të bëjë një përjashtim nga rregulla e konfidencialitetit dhe të lëshojë ndonjë dokument të veçantë konfidencial.

Për sa i përket qasjes në dosjet dhe dokumentet e lejuara nga gjykatat e tjera kushtetuese, për shembull, Akti i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane u mundëson palëve të treta, që nga viti 1999 të marrin informacion përmbledhës të Dosjeve të Gjykatës Kushtetuese, me kusht që të tregohet "interes i arsyeshëm", përveç nëse "pala e përfshirë" në rastin ka një interes të arsyetuar në informacion që nuk është shpalos.[227]

Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës përcakton, në nenin 11.3, që, përveç pjesëmarrësve në procedurë, gjithashtu *"personat e tjerë të interesuar kanë të drejtë të inspektojnë dosjet e lëndëve në lidhje me rastet të cilat janë duke u vendosur nga Gjykata"* (supozohet se inspektimi i dosjeve-të lëndëve të cilat janë gjykuar, janë njësoj të qasshme). [228]Për

[227] Neni 35B mund të gjendet në: http://www.iuscomp.org/gla/statutes/BVerfGG.htm#35b,, (vizituar me datën 9 qershor 2014).
[228] Shih uebfaqen e Gjykatës: www.ccbh.ba.

më tepër, Gjykata Kushtetuese ka miratuar Udhëzim që parimisht mundëson qasjen publike në të gjitha informatat dhe të dhënat që janë në posedim të Gjykatës.[229]

Sa i përket zbatimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese kroate të parimit të publicitetit për dokumentet e Gjykatës Kushtetuese, qasja e Gjykatës Kushtetuese duket se është e ngjashme me gjykatat e tjera kushtetuese, kur një anëtar i publikut do të donte të marrë një kopje të vendimeve, aktvendimeve dhe raporteve të Gjykatës të papublikuara. Personi i interesuar duhet vetëm të paraqesë një kërkesë me shkrim në Gjykatë, në përputhje me nenin 57 [Disponueshmëria e Vendimeve, Vendimeve Gjyqësore dhe Raporteve të Papublikuara] të Rregullores së Punës për të marrë kopje të këtyre vendimeve, aktvendimeve dhe raporteve të pabotuara (të paktën një kopje të secilës pa pagesë).

Sidoqoftë, në rast se ka kërkesë për të marrë dokumentet nga një dosje e veçantë e rastit, situata është me sa duket e ndryshme. Në bazë të nenit 62 [Dosjet e Lëndëve të Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 1 të Rregullave të Punës së Gjykatës: "Një dosje e rastit të Gjykatës Kushtetuese do të përfshijë skedar fillestar me të cilat një rast i Gjykatës Kushtetues ishte krijuar ose që e ka propozuar fillimin e procedimit të Gjykatës Kushtetuese, përmbledhjet e shkurtra, memorandumet, punimet e ekspertëve dhe mendimet e dhëna ndaras të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese që bashkëpunuan në përpunimin e rastit, mendimet me shkrim nga këshilltarët ligjorë shkencor të Gjykatës Kushtetuese, vërejtjet me shkrim nga organet shtetërore të marra gjatë kryerjes së procedurave të Gjykatës Kushtetuese, mendimet kundërshtuese nga gjyqtarët dhe deklaratat me shkrim mbi arsyet lidhur me votën e disidencës, tekstin origjinal dhe transkriptimet e vërtetuara të vendimit, aktgjykimin dhe raportin. Sipas nenit 62.2, "dokumentet që gjenden në dosjen e rastit të Gjykatës Kushtetuese do t'i shërbejnë nevojave të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese në procedurën për rastet identike ose të ngjashme të Gjykatës Kushtetuese." Vetëm personave të autorizuar u lejohet të rishikojnë pjesë të dokumentacionit të përfshira në dosjen e çështjes së Gjykatës Kushtetuese para përfundimit të procedurës, në rrethanat e përshkruara në nenin 94 [Rishikimi i Dosjeve të Rasteve të Gjykatës Kushtetuese gjatë kohëzgjatjes së procedurës] të Rregullores së Punës: "(1) Pjesëmarrësit në procedurë të Gjykatës Kushtetuese, agjentët e tyre dhe personat e tjerë të ngarkuar me interes juridik mund të kërkojnë që të shqyrtojnë dokumentacionin e mëposhtëm nga dosja korresponduese e rastit të Gjykatës Kushtetuese deri në përfundim të procedurës:

1. regjistrat ku procedurat e Gjykatës Kushtetuese ishin propozuar ose institucionalizuar;
2. vërejtjet me shkrim të palëve kundërshtare (në qoftë se kërkohen dhe parashtrohen);
3. mendimet me shkrim të këshilltarëve ligjorë shkencore të Gjykatës Kushtetuese (në qoftë se kërkohen dhe parashtrohen);
4. vërejtjet me shkrim të organeve shtetërore që u shfaqën ose janë pranuar gjatë përpunimit të rastit (në qoftë se kërkohen dhe parashtrohen).

[…].”

[229] Udhëzuesi për Qasje në Informata të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës mund të gjendet në http://www.ccbh.ba/eng/p_stream.php?kat=90, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Neni 63 [Dokumentacioni Konfidencial i Gjykatës Kushtetuese, Dosjet e Gjykatave dhe Organeve të Tjera Shtetërore] i Rregullave të Punës së Gjykatës kufizon edhe më tej qasjen në dokumentacionin e dosjes së lëndës duke përcaktuar që:

(1) *"Dokumentacioni konfidencial i Gjykatës Kushtetuese përfshin rezultatet e votimit dhe procesverbalin mbi votimin, projektvendimet, aktvendimet dhe raportet, ndryshimet e propozuara për nxjerrjen e termeve dhe deklaratat e arsyeve të projekt-vendimeve dhe aktvendimeve, ndryshimet e propozuara për frazat e projekt-vendimeve, aktvendimeve dhe raportet, komentet me shkrim dore ose të nënshkruara nga raportuesi i gjyqtarëve dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese që kanë marrë pjesë në përpunimin e një çështje të caktuar, dhe të dhënat e bazuara në dokumentacionin e gjykatave dhe të organeve tjera shtetërore të klasifikuara si shtetërore, ushtarake, të sekreteve zyrtare ose afariste të cilat ende janë nuk janë klasifikuar.*

(2) *Dokumentacioni konfidencial i Gjykatës Kushtetuese nuk do të konsiderohet një komponent e dosjes së rastit të Gjykatës Kushtetuese dhe do të ruhet në mënyrë të përshtatshme së bashku me dosjen e rastit të Gjykatës Kushtetuese. Qasja në dokumentacion të tillë nuk do t'i lejohet askujt përveç gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetuese*

(3) *Dosjet nga gjykatat që kanë të bëjnë me temën e ankesave kushtetuese, dosjeve të lëndëve dhe dokumentacionin nga organet e tjera shtetërore të kërkuara nga një gjyqtar-raportues gjatë zhvillimit të procedurave të Gjykatës Kushtetuese (Neni 69 i Aktit Kushtetues) dhe dokumentet dhe njoftimet e marra gjatë rrjedhës së procedurave të Gjykatës Kushtetuese (Neni 25 i Aktit Kushtetuese) nuk do të konsiderohet _ pjesë e dosjes së rastit të Gjykatës Kushtetuese.*

(4) *Kopjet e dosjeve të marra nga gjykatat dhe organet e tjera shtetërore nga paragrafi 3 i këtij neni, do të ruhen në mënyrë të përshtatshme me dosjen korresponduese të rastit të Gjykatës Kushtetuese. Qasja në këto dosje nuk i lejohet askujt jashtë gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të Gjykatës Kushtetues."*

Edhe e drejta për qasje në një dosje të lëndës, pasi të ketë përfunduar, mund të jetë e vështirë për t'u marrë nga pjesëmarrësit në ato procedura, pasi që, sipas nenit 64 [Rishikimi i Dosjeve të Lëndës së Gjykatës Kushtetues pas mbylljes së procedimeve], ai / ajo do të duhet ta njoftojë Kryetarin e Gjykatës ", me shkrim se ai ose ajo është duke përgatitur një kërkesë për mbrojtjen e të drejtave para Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, dhe deklaron arsyet se përse një përmbledhje e shkresave të lëndës e konsideron të nevojshme."

Vetëm për arsye shumë specifike kryetari i Gjykatës mundet të miratojë një rishikim të dosjes së lëndës sipas nenit 62.1 për një person fizik i cili nuk ka qenë pjesëmarrës në procedurat, pasi të kenë përfunduar procedurat e Gjykatës Kushtetuese dhe rasti është caktuar si "a.a ", në qoftë se personi pa mëdyshje dëshmon se i ka interesat e justifikuara profesionale shkencore, kërkimore ose të ngjashme, dhe paraqet një garanci me shkrim dhe të nënshkruar që asnjë emër personal, emër të personave juridikë dhe emrat e vendeve dhe të shteteve të huaja të përfshira në lëndë [...] do të zbulohen"

Neni 93 [Të dhënat për Rrjedhën e Procedurave të Gjykatës Kushtetuese] i Rregullores se Punës përcakton se vetëm:

"(1) Pjesëmarrësit në procedurat e Gjykatës Kushtetuese dhe agjentët e tyre mund të kërkojnë informata për rrjedhën e saj deri në konkludimet e këtyre procedurave.

(2) Informacioni nga Paragrafi 1 i këtij neni do të ofrohet nga Sekretari për operacione të Gjykatës Kushtetuese në bazë të të dhënave nga Regjistri dhe dosjeve të lëndës së Gjykatës Kushtetuese."

Për më tepër, dokumentacioni që mund të kërkohet është disi i kufizuar, siç tregohet në nenin 94 [Rishikimi i Dosjeve të Lëndëve të Gjykatës Kushtetuese gjatë Kohëzgjatjes së Procedimeve], edhe pse, përveç pjesëmarrësve në procedurë të Gjykatës Kushtetuese dhe agjentëve të tyre, gjithashtu "persona të tjerë të ngarkuar me interes juridik mund të kërkojnë që të shqyrtojnë dokumentacionin e caktuar nga dosja përkatëse e rastit. Neni 94 parashikon si në vijim:

"…

(1) Pjesëmarrësit në procedurë të Gjykatës Kushtetuese, agjentët e tyre dhe personat e tjerë të ngarkuar me interes juridik mund të kërkojnë që të shqyrtojnë dokumentacionin e mëposhtëm nga dosja korresponduese e rastit të Gjykatës Kushtetuese deri në përfundim të procedurës:

1. *regjistrimet ku procedurat e Gjykatës Kushtetuese janë propozuar ose institucionalizuar;*
2. *vërejtjet me shkrim të palëve kundërshtare (nëse kërkohen dhe të parashtrohen);*
3. *mendimet me shkrim të këshilltarëve ligjor shkencor të Gjykatës Kushtetuese (nëse kërkohen dhe të parashtrohen);*
4. *vërejtjet me shkrim të organeve shtetërore që u shfaqën ose janë pranuar gjatë përpunimit të rastit (nëse kërkohen dhe të parashtrohen).*

(2) Kërkesa për shqyrtimin e dokumentacionit nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të dorëzohet me shkrim tek Sekretari për Operacionet e Gjykatës Kushtetuese.

(3) Shqyrtimi do të bëhet në Zyrën e Pritjes së Sekretariatit për Operacionet e Gjykatës Kushtetuese në kohën e përcaktuar nga Sekretari për Operacionet e Gjykatës Kushtetuese.

(4) Shqyrtimi i dokumentacionit të Gjykatës Kushtetuese do të nënkuptojë të drejtën për transkriptet e mbarë dokumentacionit nga paragrafi 1 i këtij neni ose pjesëve tyre ose të drejtën për kopjet e dokumentacionit me shpenzimet e palës së autorizuar që e kërkon rishikimin bazuar në normat e postuara në tabelën e buletinit të Gjykatës Kushtetuese.

…"

Shembulli i mësipërm i qasjes së kufizuar në dosjen e lëndës së Gjykatës Kushtetuese sipas Aktit Kushtetuese kroat dhe Rregullores së Punës tregon se qasja në dosjet dhe dokumentet sipas Rregullës 23 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është shumë më liberale.

Parimi i qasjes në informata për statusin e procedurës para Gjykatës Kushtetuese është i përcaktuar në Rregullën 24 [Informacionet mbi Statusin e Procedimeve] të Rregullores së Punës.

Rregulli 24 [Informacionet për statusin e procedurës] i Rregullores së punës

Në bazë të kërkesës me shkrim nga cilido person, Sekretari i Përgjithshëm ofron informacione për statusin e procedurës para Gjykatës.

Rregulli 24, i cili është pjesë e parimit të publicitetit, ka rëndësi të veçantë për Gjykatën, pasi që i kërkon asaj të mbajë një sistem funksional të menaxhimit të rasteve në mënyrë që të jetë në gjendje të respektojë këtë Rregull, duke i dhënë çdo personi, përfshirë edhe palëve ose një pjesëtari të publikut, informacion mbi statusin e procedurave, sipas kërkesës:

1. duke dhënë informacion në lidhje me rrjedhën e procedurave;
2. duke i lejuar pjesëmarrësve në procedurë dhe personave të tjerë të interesuar për të inspektuar dosjet e lëndëve lidhur me rastet të cilat janë duke u vendosur nga Gjykata; duke i lejuar ata të jenë të pranishëm në seancat e Gjykatës, përveç nëse Kryetari i Gjykatës, në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, vendos ndryshe; dhe të jenë të pranishëm në ngjarje të tjera nga të cilat publiku nuk është i përjashtuar në bazë të Rregullores së Punës;
3. duke publikuar vendimet e miratuara;
4. duke botuar Buletinin e Gjykatës në të cilin vendimet, aktgjykimet dhe aktet e tjera më të rëndësishme janë publikuar;
5. në çfarëdo mënyre tjetër të lejuar nga Gjykata.

Neni 17 i Ligjit plotësohet gjithashtu me Rregullën 41 të Rregullores së Punës. Veç kësaj, Rregulla 39.3 që parasheh që: "seanca dëgjimore është publike, përveç nëse Gjykata urdhëron ndryshe, kur ka arsyetim të mirë sipas Ligjit ose sipas kësaj Rregulloreje." e plotëson neni 17 e që do të komentohet më pas, në lidhje me nenin 20 [Vendimet] të Ligjit.

Rregulli 41 [Pjesëmarrja në seancë dëgjimore] i Rregullores së punës

41.1 Të gjitha seancat dëgjimore do të jenë të hapura për qytetarët, përveç kur Gjykata urdhëron përjashtimin e qytetarëve nga seanca, nëse një përjashtim i tillë kërkohet për sigurinë e ndonjërës nga palët ose të përfaqësuesve të tyre, apo për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike..

41.2 Çdo pale, përfaqësuesi, dëshmitari ose pjesëmarrësi tjetër në seancë dëgjimore, sjellja e të cilit ndaj gjyqtarit ose Sekretarit të Përgjithshëm nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës, ose i cili sillet në mënyrë fyese ndaj palës tjetër apo të ndonjë përfaqësuesi të palës tjetër, mund t'i shqiptohet vërejtje nga Kryetari dhe t'i jepet mundësia të mbrojë veten. Kryetari, në konsultim me gjyqtarët, mund të urdhërojë shqiptimin e masave disiplinore, përfshirë shqiptimin e gjobës, në pajtim me normat e vendosura nga Gjykata, ose, në raste të jashtëzakonshme, përjashtimin nga seanca dëgjimore.

41.3 Kryetari mund ta përjashtojë një vëzhgues nga seanca, nëse sjellja e tij, ose e saj, nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës apo nëse ai ose ajo shkakton shqetësim në Gjykatë.

I. Rregulli 41.1 e bën të qartë se, nëse Gjykata vendos të përjashtojë publikun, ajo ka për të nxjerrë një urdhër, të bazuar në ligj dhe të arsyetuar siç duhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17 (2) të Ligjit dhe vetë Rregullës. Rregulla 41.1 prezanton disa arsye shtesë për përjashtimin e publikut nga seancat dëgjimore, të cilat nuk janë të përmendura në nenin 17 të Ligjit[230], përkatësisht, "*për sigurinë e ndonjërës nga palët ose të përfaqësuesve të tyre, apo për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike* …". Këto arsye tjera shtesë kanë të bëjnë me "*sigurinë*" e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre të cilët mund të jenë në rrezik, nëse publiku (dhe mediet) marrin pjesë në seancë dëgjimore.[231] Me fjalë të tjera, arsyeja e Gjykatës për të përjashtuar publikun dhe të tjerët nga seanca dëgjimore, gjithashtu mund të justifikohet në interesin e tyre në mënyrë që të shmanget ndonjë dëm që mund t'iu shkaktohet, përderisa marrin pjesë në seancë dëgjimore.

Për shembull, Gjykata mund të ketë marrë kërcënime serioze ose informacion të besueshëm se një pjesëtar i publikut mund të përpiqet të pengojë punimet dhe të përdorë dhunën. Në një rast të tillë, Gjykata mund ta konsiderojë të këshillueshme[232] që të mos e lejojë publikun (dhe mediet) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore në mënyrë që të mos rrezikojë sigurinë e gjyqtarëve, palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, si dhe pjesëtarëve të pranishëm të publikut në sallën e gjykimit. Edhe në mungesë të ndonjë kërcënimi, Gjykata nuk duhet të ngurrojë, në mungesë të një policie të duhur të Gjykatës, të kërkojë mbrojtje të veçantë në sallën e Gjykatës nga ana e policisë, sigurimin e objektit, ose ndonjë organizatë të specializuar të sigurisë, sa herë që planifikon të mbajë seancë dëgjimore.

Për shembull, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka të drejtë të posedojë policinë e saj të gjykatës, në bazë të nenit 15 [Siguria] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar se: "*1. Për të ruajtur sigurinë e saj, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të ketë policinë në shërbimin e saj "; dhe "2. Numri dhe detyrat e policisë janë miratuar nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. "*

Rregulli 41.1 nuk shprehet për metodat alternative që mundësojnë publikun (dhe mediat) të ndjekin procedurat gjyqësore, për shembull, në rast të një çështjeje të sigurisë, Kryetari mund të vendosë që të akomodojë publikun dhe gazetarët në vende të tjera në hapësirat e Gjykatës, ku procedimet do të mund të ndiqen në një ekran televiziv. Në këtë mënyrë, natyra publike dhe seanca dëgjimore gojore mund të ruhet, si dhe të drejtat e mësipërme të publikut dhe të mediave të shkruara për të marrë pjesë në seancë dëgjimore në fjalë.

Gjithashtu neni 445 i Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore parashikon baza të ngjashme, në bazë të të cilave publiku mund të përjashtohet nga seanca dëgjimore:

---

[230] Shih komentet lidhur me Nenin 17.2 të Ligjit, duke siguruar se: Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun, kur e shikon të nevojshme për të mbrojtur: 17.2.1 sekretin kombëtar, rendin dhe moralin publik; 17.2.2 Informacionin sekret i cili do të vihet në rrezik nga seancë publike; 17.2.3 jeta private apo sekreti i biznesit të palës në procedurë.

[231] Mund të ketë raste të tjera, të cilat do të kërkojnë një vendim të ngjashëm të Gjykatës, për shembull, ku siguria e "pjesëmarrësve të tjerë të seancës dëgjimore" (shih Neni 41 (2)), sikurse e dëshmitarëve dhe ekspertëve, është në rrezik.

[232] Gjykata Kushtetuese nuk disponon me polici të gjykatës, siç është rregull në procedurat para gjykatave penale.

"Gjykata lejon, me vendim të arsyetuar, që gjykimi i çështjes tërësisht apo pjesërisht, të bëhet në seancë me dyer të mbyllura/jo publike/, vetëm kur:
(a) është e nevojshme të ruhet një sekret zyrtar dhe rendi publik;
(b) përmendën sekrete tregtare, apo shpikjesh, nga publikimi i të cilave do të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj;
(c) përmenden rrethana nga jeta intime private e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në proces."

II. Rregulla 41.2 mundëson Gjykatën të përjashtojë ndonjë nga pjesëmarrësit e seancës dëgjimore për (1) "mospërfillje të gjykatës" dhe (2) sjellje fyese ndaj palës tjetër ose përfaqësuesit nga ajo palë. Në përgjithësi, mospërfillja e gjykatës ndodh, kur personi përçmues nuk respekton autoritetin dhe dinjitetin e gjykatës, apo nuk i bindet një urdhrit të gjykatës, duke penguar ose ndërhyrë në administrimin e drejtësisë dhe duke nënvlerësuar autoritetin e gjykatës. Duke e ndëshkuar personin përbuzës, gjykata mbron autoritetin dhe legjitimitetin.
Sipas praktikës gjyqësore të Strasburgut, masat e urdhëruara nga gjykata për shkak të sjelljes së çrregullt gjatë procedimeve (mospërfillje të gjykatës) konsiderohen se bien jashtë sferës së nenit 6 të KEDNj-së, sepse ato janë të ngjashme me ushtrimin e kompetencave disiplinore (shih Ravnsborg kundër Suedia, Aktgjykimi i GjEDNj-së 23 mars 1994[233]). Megjithatë, natyra dhe pesha e dënimit mund ta bëjnë nenin 6 të zbatueshëm me një dënim për mosbindje ndaj gjykatës të klasifikuar në ligjin vendor, si penal (shih Kyprianun kundër Qipros, nr. 73797/01 e datës 15 dhjetor 2005).
Rregulla 41.2 duket të jetë e paplotë, pasi që vetëm përmend sjelljen fyese të *"cilësdo pale, përfaqësuesit, dëshmitarit apo pjesëmarrësit tjetër të seancës dëgjimore"* ndaj *"një palë tjetër ose të përfaqësuesit të asaj pale"*, por nuk i referohet sjelljes fyese ndaj një dëshmitari tjetër apo pjesëmarrësve të tjerë në seancën dëgjimore. Gjithashtu nuk e përmend sjelljen e papranueshme ndaj një anëtari të stafit të Gjykatës, përveç Sekretarit të Përgjithshëm, ose pjesëtarëve të publikut, personelit të dhomës së gjykatës, gazetarëve apo çdo personi tjetër të pranishëm në sallën e gjyqit. Është sugjeruar që të ndryshohet Rregullorja e Punës në përputhje me rrethanat.
Nëse një paralajmërim nga Kryetari i Gjykatës nuk e ka efektin e dëshiruar, apo paraqitja e një mbrojtjeje ishte plotësisht e pakënaqshme, ai / ajo mund të vendosë sanksione, në konsultim me gjyqtarët, që ndryshojnë nga pagesa e një gjobe deri në përjashtim nga seanca dëgjimore. Nëse Gjykata parasheh të përjashtojë një palë nga seanca dëgjimore, do të duhet që seriozisht të balancojë të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNj-së kundër masës së përjashtimit, dhe të sigurohet që masa duhet të ketë një qëllim legjitim dhe të aplikohet në një mënyrë që nuk është jo proporcionale, dhe me qëllimin që kërkohet të arrihet.

III. Supozohet se me "vëzhgues", nënkuptohet një pjesëtar i publikut. Personi në fjalë vetëm rrezikon që të përjashtohet nga seanca dëgjimore pa ju imponuar më tej

[233] See Ravnsborg v. Sweden, Judgment of 23 March 1994, Series A, No. 283 – B; (1994) 18 EHRR 38

ndonjë sanksion. Sigurisht, në qoftë se personi ka shkaktuar dëme në hapësirat ose ka sulmuar një pjesëmarrës në seancën dëgjimore ose një tjetër pjesëtar të publikut, ai / ajo mund të paditet në gjykata të zakonshme për dëme ose të ndiqet penalisht ngaqë ka shkaktuar dëm trupor apo edhe më keq.

Neni 18 [Përjashtimi i gjyqtarit]

18.1 Gjyqtari përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës kur gjyqtari
- **1.1 është i përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese;**
- **1.2 është në lidhje martesore ose jashtëmartesorë ose në lidhje familjare më një palë në procedurë, në pajtim me ligjin në fuqi; ose**
- **1.3 sipas detyrës zyrtare është marrë më herët me çështjen para se ajo t'i jetë referuar Gjykatës Kushtetuese.**

18.2 Gjykatësi nuk është i përfshirë në çështje në kuptimin e paragrafit 1, pika 1.1. vetëm pse I takon një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni ose një partie politike interesat e së cilës mund të preken nga rezultati i procesit para Gjykatës Kushtetuese.

18.3 Paragrafi 1, pika 1.3. nuk përfshin pjesëmarrjen në procedurë legjislative si dhe shprehjen e mendimit profesional ose akademik për një çështje juridike, e cila mund të jetë me rëndësi për procesin para Gjykatës Kushtetuese.

18.4 Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar.

18.5 Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërish.

Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit nga pjesëmarrja në një rast para Gjykatës Kushtetuese është një çështje serioze dhe për këtë arsye, duhetvetëm të merret, kur, për arsyet e përcaktuara në nen, gjyqtari në fjalë rezulton të mos jetë në gjendje "të kryejë funksionet e tij / saj me ndërgjegje dhe paanshmëri, për të vendosur me vullnetin e tyre të lirë në pajtim me Kushtetutën", siç kërkohet nga neni 10 [Detyrat e gjyqtarëve], paragrafi 1, i Ligjit.

1 Kur një gjyqtar i plotëson kushtet për përjashtimin nga pjesëmarrja në një procedurë të përcaktuar në nenin 18.1, formulimi i nenit nuk duket se i lenë Gjykatës ndonjë zgjedhje tjetër përveç se të përjashtojë - ex officio, ose me kërkesë të ndonjërës prej cilësdo palë - gjyqtarin nga pjesëmarrja në procedurat në fjalë. Lista e arsyeve për përjashtimin e gjyqtarit, të përmendura në nenin 18.1, është qartësisht enumerative, që do të thotë se Ligji nuk do ta lejojë Gjykatën të përdorë ndonjë arsye tjetër për përjashtim të gjyqtarit. Në qoftëse nuk do të ishte ky rast, neni 18 do të përmbante një dispozitë të veçantë për këtë qëllim, gjë që nuk e ka.
Shtrirja e nenit 18.1.1 duket të jetë mjaft e gjerë, pasi që gjyqtari duhet të përjashtohet, kur ai / ajo është "përfshirë" në rastin në pritje para Gjykatës.

Formulimi duket se nënkupton që përfshirja (me sa duket do të thotë: "ndonjë lidhje e mundshme me rastin") duhet të jetë e vazhdueshme. Edhe pse kjo mund të jetë logjike për të përfshirë gjithashtu çdo përfshirje e cila ka ndodhur në të kaluarën e largët apo më pak të largët, kjo çështje duket të jetë e mbuluar me nenin 18.1.3 i cili do të komentohet më pas

Pra, pyetja e parashtruar nga neni 18.1.1 nuk është nëse ka anësi atypëraty nga ana e gjyqtarit (mungesa e paanshmërisë subjektive [234]), por nëse fakti i thjeshtë i të qenit të përfshirë në rastin mund të ngrejë dyshime për paanshmërinë e tij / saj (mungesa e paanshmërisë objektive)[235]. Në rast të paanshmërisë subjektive, Gjykata, ex officio, ose pala që sfidon gjyqtarin, do të duhet të tregojë prova për anësi të atypëratyshme nga ana e gjyqtarit, që do të thotë se presupozohet paanshmëria personale e gjyqtarit, përveç nëse ka prova për të kundërtën. Ky është një presupozim shumë i fortë dhe, në praktikë, është shumë e vështirë për të provuar anshmëri personale. Megjithatë, neni 18.1.1 merret me paanshmërinë objektive të gjyqtarit, që do të thotë se kjo duhet të dëshmohet se ka fakte bindëse (për shembull, përfshirja e tij / saj në rastin), të cilat ngrejnë dyshime lidhur me paanshmërinë e tij / saj, duke çuar tek përjashtimi i tij / saj. Kështu që, edhe një shfaqje e përfshirjes mund të jetë e mjaftueshme të përjashtojë një gjyqtar.[236]

Kriteret për përjashtimin e gjyqtarit, të përmendura në nenin 18.1.2 duket të jenë të qarta: *marrëdhënia martesore ose jashtëmartesore* me ndonjë palë në procedimet automatikisht s'kualifikon një gjykatës nga pjesëmarrja në rast. Megjithatë, nëse *marrëdhëniet* e tij / saj *familjare* me ndonjë palë në procedurë do të diskualifikonte një gjyqtar duket se është më pak e qartë. Dispozita, përkatësisht, nuk tregon ndonjë shkallë specifike të marrëdhënies familjare. Në një vend të vogël si Kosova, me rreth 2.000.000 banorë, ekziston një mundësi reale që një gjyqtar mund të jetë anëtar i largët i familjes së cilësdo palë.

Në lidhje me këtë, do të mund të jetë interesante për t'ju referuar nenit 67.1 (b) të Kreut III [Përjashtimi i Gjyqtarit nga Gjykimi] të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore [237], duke siguruar: *"[*Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike*], [...] b)) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo."*

[234] Për të vlerësuar paanësinë e gjyqtarit, GjEDNj-ja përdor një test subjektiv dhe objektiv, ashtu siç bëri në Piersack kundër Belgjikës, ku vendosi që, *"ndërsa paanshmëria normalisht tregon mungesë paragjykimi, apo anshmërie, ekzistenca e saj ose në rastin e kundërt mundet, veçanërisht sipas nenit 6 (1) i KEDNj-së, të testohet në mënyra të ndryshme. Dallimi mund të nxirret në këtë kontekst midis një qasjeje subjektive, që është përpjekur të konstatojë bindjen personale të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar, dhe një qasjeje objektive, që është përcaktuese nëse ai ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë respekt* " (*Piersack v. Belgium, Judgment* of *1 October 1982, Series A* No. 53, para 30).

[235] Shih Idem

[236] Fey v. Austria, 24 February 1993, § 30, Series A no. 255-A.

[237] Ligji nr. 03/L-006 i datës 30 qershor 2008.

"Neni 67.1 (b) përcakton qartësisht shkallën e lidhjes së gjakut që duhet të merret parasysh për përjashtimin e gjyqtarit nga një rast i veçantë. Neni 39.1.1.2 i Kodit të Procedurës Penale përmban një dispozitë të ngjashme.[238]
Shtrirja e nenit 18.1.2 të Ligjit, për sa i përket marrëdhënieve familjare, duket, pra, që është tepër e gjerë. Kur thirren për të interpretuar dispozitën, Gjykata mund t'i zbatojë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Kodin e Procedurës Penale, sipas nenit 16.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, duke parashikuar: *" Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese*. Prandaj, në qoftë se përjashtimi i një gjyqtari kërkohet nga një palë, Gjykata mund t'i zbatojë kriteret e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.
Neni 18.1.3 përfshin përsëri një shembull tipik të paanshmërisë objektive të gjyqtarit. Është e qartë se në një çështje, kur një person, i cili është tani një gjyqtar i Gjykatës, ka luajtur një rol në një cilësi zyrtare para se rasti t'i jetë dorëzuar Gjykatës, ai / ajo duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në shqyrtimin kushtetues të këtij rasti, përveç nëse kushtet e nenit 18.3 që ofrojnë një përjashtim nga ky rregull (shih komentet në nenin 18.3 këtej pas), do të zbatohen. Në lidhje me këtë, i bëhet referencë Rastit nr. 17/11, ku një gjyqtar i Gjykatës ka njoftuar kryetarin se ai kishte qenë i përfshirë në rastin në një cilësi zyrtare, para se të ishte referuar në Gjykatë.[239] Gjykata vendosi të përjashtojë gjyqtarin nga procedimet për arsyet që u thanë prej tij.

2 Versioni anglisht i nenit nuk duket se është hartuar qartësisht, pasi që është i vështirë për t'u kuptuar. Ajo që mund të kuptohet është që teksti donë të thotë se, një gjyqtar nuk mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në një rast që është duke u shqyrtuar nga Gjykata vetëm për arsye se ai / ajo i përket një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni apo entiteti politik që ka paraqitur rastin në Gjykatë. Për shembull, nëse një gjyqtar është një grua, ndërsa referimi i dorëzohet Gjykatës nga një grup i grave, anshmëria e atij gjyqtarit në rastin e tillë nuk mund të prezumohet, thjesht sepse ajo është një grua. Gjyqtari merr pjesë në cilësinë e tij / saj personale dhe, pra, nuk përfaqëson asnjë nga grupet apo subjektet e tilla[240]
Megjithatë, në qoftë se ndonjë palë do të jetë në gjendje të provojë njëanshmërinë personale nga ana e gjyqtarit (mungesa e paanshmërisë subjektive) në rastin në fjalë, gjyqtari duhet me të vërtetë të përjashtohet nga Gjykata. Neni gjithashtu përmend aderimin e gjyqtarit në një "subjekt politik". Duke marrë parasysh që ligji në mënyrë eksplicite ndalon një gjyqtar që të jetë anëtar i një partie politike, lëvizje apo ndonjë organizatë tjetër politike (shih komentet për nenin 5 [Papajtueshmëria e

[238] Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 37 / 28 DHJETOR 2012, PRISHTINË
[239] Shih Rastin KI 17-2011, Shefkat Perdibuka dhe Suhejla Morina, Prishtinë, AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI i datës 12 dhjetor 2011, para. 16. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2011*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2012.
[240] Neni 25.2 i Ligjit të Shqipërisë për Gjykatën Kushtetuese në të njëjtën mënyrë përcakton: "Në veprimtarinë e tij, një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë në cilësinë e tij personale dhe nuk përfaqëson ndonjë autoritet shtetëror, organizatë shoqërore, parti apo shoqatë politike, ose grup etnik apo social."

funksionit] të Ligjit), nuk është e qartë se çfarë lloj "entiteti politik" kishin në mendje hartuesit, që nuk do të mbulohet me këtë ndalim.
Së fundi, nuk është e qartë nga teksti i nenit, se si "*rezultati i procesit në Gjykatën Kushtetuese"*, mund të ndikojë në interesat e grupeve, profesioneve apo subjekteve të tilla, kur në momentin që Gjykatat do të duhet të vendosin nëse janë apo jo për të përjashtuar gjyqtarin në fjalë, rezultati i çështjes para Gjykatës nuk mund të jetë i njohur. Prandaj është sugjeruar ndryshimi i nenit 18.2 në përputhje me rrethanat.

3 Ashtu si teksti i nenit 18.2, gjithashtu edhe teksti i nenit 18.3 duket të jetë disi i paqartë. Sa i përket formulimit *"pjesëmarrje në procedurat legjislative"*, supozohet se dispozita i referohet pjesëmarrjes "së mëparshme" të gjyqtarit në fjalë, në procedura të tilla legjislative (për shembull, si një ish-anëtar i Kuvendit, ose si një ish-ekspert juridik i konsultuar nga Kuvendi), pasi që është e vështirë të imagjinohet që një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese do të mund të marrë pjesë në procedurat legjislative, pasi kjo do të përbënte shkelje të qartë të parimit të ndarjes së pushteteve nga ai gjyqtar
Megjithatë, për sa i përket *"shprehjes së mendimit profesional ose akademik për një çështje juridike që mund të jetë me rëndësie për procesin para Gjykatës Kushtetuese"*, nuk duhet të ketë rëndësi, nëse shprehjet e tilla të opinionit janë bërë para ose pasi që autori i shprehjeve të tilla u emërua si gjyqtar në Gjykatë, duke pasur parasysh se një gjyqtar i Gjykatës lejohet, sipas nenit 5 [Papajtueshmëria e funksionit] të Ligjit, ndër të tjera, të performojë, për shembull, si një ligjërues i shkencave juridike në një universitet të akredituar, siç u përmend më lart, dhe, në këtë mënyrë, të ketë mendime të veta profesionale ose akademike për çështjet juridike", të cilat mund të jenë të rëndësishme për procesin në Gjykatën Kushtetuese”.
Në një situatë të tillë, një gjyqtar nuk mund të konsiderohet si i njëanshëm, thjesht sepse palët në rastin dhe publiku tashmë do e dinin mendimin e tij / saj për një çështje të veçantë juridike që është ngritur në procedurën para Gjykatës. Natyrisht, një palë gjithmonë mund të përpiqet të sfidojë gjyqtarin, edhe pse pala do të ketë vështirësi për të dëshmuar njëanshmërinë nga ana e gjyqtarit, thjesht sepse ky i fundit mban një opinion profesional ose akademik të mbuluar nga neni 18.3.

4 Si një nga parimet e procesit të rregullt ligjor, një vendim i një organi zyrtar duhet të arsyetohet. Për më tepër, siç u cek më lartë, përjashtimi i një gjyqtari nga pjesëmarrja në një rast para Gjykatës, është një çështje serioze kështu gjyqtari, palët dhe publiku kanë të drejtë të dinë arsyen për këtë përjashtim. Për këtë arsye, një përjashtim i tillë, *ex officio* ose me kërkesë të një pale, duhet të jetë "i bazuar mirë dhe i themeluar me arsye", siç është përcaktuar me Rregullën 7.5 të Rregullores së Punës (shih këtej pas), bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 18 të Ligjit.
Nëse vendimi për përjashtim është bazuar në një kërkesë të palës ose u soll *ex officio*, nuk ka rëndësi për zbatimin e nenit 18.4. Në të dyja rastet një vendim i arsyetuar nga Gjykata është i detyrueshëm.

5 Përveç përjashtimit *ex officio* të një gjyqtari ose një pale që kërkon përjashtimin e

një gjyqtari, ky gjykatës është i detyruar që të ngrejë çështjen e përjashtimit me Kryetarin e Gjykatës dhe për të kërkuar përjashtim e tij / saj, nëse ai / ajo ndjen se paanshmëria e tij / saj në një rast të caktuar është në rrezik në bazë të një ose më shumë kritereve të cekura në nenin 18. Në një rast të tillë, në përputhje me fjalinë e fundit të nenit, paragrafët 3 dhe 4 do të zbatohen sipas rastit. Referenca për paragrafin 4, megjithatë, nuk duket të jep shumë kuptim, pasi që do të ishte më e saktë për të bërë referencë në paragrafët 2 dhe 3, që të dyja ofrojnë përjashtime nga kriteret për përjashtim të përcaktuara në nenin 18.1.

Përveç detyrimit për një gjyqtar për të "informuar Kryetarin me shkrim *"se ai i plotëson një ose më shumë kushte për përjashtimin dhe për të kërkuar që të përjashtohen nga procedimet"*, neni nuk duket që përcakton se çfarë veprimi Gjykata duhet të ndërmarrë, kur gjyqtari në fjalë qëllimisht nuk e informon Kryetarin. Një lëshim i tillë i qëllimshëm nga ana e gjyqtarit duhet të çojë në pasoja më të rënda që janë diskutuar më lartë sipas Rregullës 6 [procedura e shkarkimit] të Rregullores së Punës.

Neni 18.5 i Ligjit plotësohet nga Rregulla 7 [Procedurat për Përjashtim] të Rregullores se Punës.

Rregulli 7 [Procedurat për Përjashtim] të Rregullores se Punës

7.1 Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim tëarsyeshëm përkitazi me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës. Një kopje e atij informacioni do t'u dërgohet të gjithë gjyqtarëve.

7.2 Cilado palë në procedurë mund të paraqesë kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari sapo t'I kuptojë arsyet për përjashtim dhe jo më vonë se një javë para fillimit të seancës dëgjimore, nëse ka, ose para se të merret vendimi nga Gjykata.

7.3 Në informacion ose në kërkesë, gjyqtari ose pala duhet t'i prezantojë faktet dhe rrethanat me të cilat e arsyeton përjashtimin. Arsyet e cekura në peticionin paraprak për përjashtimin që ishte refuzuar nuk mund të përfshihen në kërkesën për përjashtim. Kopje të asaj kërkese do t'u dërgohen të gjithë gjyqtarëve.

7.4 Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar nga cilado palë, një deklaratë do të merret nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk mund marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit.

7.5 Gjykata, me shumicë votash të gjyqtarëve, do të vendosë përkitazi me përjashtimin, nëse vendos që përjashtimi është i bazuar mirë dhe i mbështetur.

I. Rregulla 7.1 i Rregullores së Punës jo vetëm që përmend kriteret për përjashtim të renditura në nenin 18.5 të Ligjit, por gjithashtu paraqet kritere të reja jo të specifikuara në këtë nen, përkatësisht, situatën në të cilën gjykatësi është ai/ajo që

vet beson se "rrethanat e tjera " ekzistojnë që ngrejnë dyshimin e arsyeshëm për sa i përket paanësisë së tij ose të saj. Do të ishte e logjikshme, nëse ky kriter shtesë do të ishte gjithashtu i përmendur në nenin 18.5 të Ligjit, në vend se në Rregullën 7.1 të Rregullores se Punës.

Me fjalë të tjera, nëse një gjyqtar beson se ekziston një mundësi e arsyeshme që paanshmëria e tij / saj të mund të vihet në dyshim, ai / ajo duhet ta bëjë këtë të njohur tek Kryetari i Gjykatës me shkrim (me një kopje të dërguar të gjithë gjyqtarëve). Kjo, pastaj do të varet nga Gjykata për të vendosur, me vendim të arsyetuar, nëse gjyqtari është apo nuk është i drejtë në ngritjen e kësaj çështjeje, dhe nëse do të apo nuk do të justifikohet që ai/ajo të përjashtohet nga seancat në fjalë. Kur merret një vendim nga Gjykata, supozohet se palët do të marrin një kopje të atij vendimi, që, në çdo rast, duhet të publikohet në të njëjtën mënyrë si çdo vendim tjetër i Gjykatës.

Pyetja mund të shtrohet nëse palët nuk duhet të kenë të drejtë të marrin një kopje të informacionit të dorëzuar të gjithë gjykatësve, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të paraqesin komentet e tyre mbi informacionin, e veçanërisht, në qoftë se ata nuk ishin në dijeni për rrethanat e kërkuara nga gjyqtari, i cili, nëse paraprakisht është i njohur për palët, mund t'i ketë shpënë ata të paraqesin vetë një kërkesë pranë Gjykatës, në pajtim me nenin 18.1 të Ligjit dhe rregullën 7.2 të Rregullores së Punës. Në rast të tillë, komentet e palëve dhe / apo kërkesa për përjashtimin mund të ndihmojnë Gjykatën në dhënien e vendimit të arsyetuar mirë dhe të balancuar për përjashtimin e gjyqtarit në fjalë.

II. Rregulli 7.2, që plotëson kriteret sipas të cilave një palë mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit sipas nenit 18.1 të Ligjit, duket të jetë shumë më e gjerë në shtrirje, pasi që i referohet vetëm "një" arsyeje për përjashtimin. Kjo do t'i japë një pale mundësinë për të shkuar përtej kritereve të rënditura në nenin 18.1 dhe që të përmendë në kërkesë çfarëdo rrethana, të cilat, sipas mendimit të tij / saj, do të kompromotojnë paanësinë e gjyqtarit. Gjykata do të marrë në konsideratë rrethana të tilla dhe do të vendosë nëse këto janë mjaft serioze për të justifikuar apo jo përjashtimin e gjyqtarit, në qoftë se pohimit "qartazi i mungon merita".[241]

Për më tepër, Rregulla i jep të drejtë palës të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit sa herë që ai / ajo mëson lidhur me një arsye për përjashtimin, por jo më vonë se vetëm një javë para seancës gojore, ose para se Gjykata të ketë marrë një vendim mbi rastin. Në këtë mënyrë, sipas rregullës, një palë që sapo mëson mbi arsyen për përjashtimin e gjyqtarit në më pak se një javë para seancës gojore nuk do të ketë të drejtë të paraqesë një kërkesë të tillë. Në rast se ai / ajo megjithatë do ta bëjë këtë, Gjykata do të duhet të refuzojë kërkesën si jashtë afatit.

Siç u përmend më lart në komentet e nenit 18, e drejta e një pale për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit është pjesë e së drejtës së tij / saj për qasje në një gjykim të pavarur dhe të paanshëm, për sa i përket mbrojtjes me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Të kufizohet kjo e drejtë siç përkufizohet në rregullën 7.2 do të rrezikonte të konsiderohej si një shkelje e këtyre neneve.

[241] Remli v France judgement of 23 April 1996 Reports 1996-II, 559 (1996) 22 EHRR 253, Para. 48.

Në rast se seanca dëgjimore gojore nuk mbahet, pala kërkuese është e detyruar të paraqesë kërkesën për përjashtim një javë *"para se të merret një vendim nga Gjykata"*. Prandaj në mënyrë që të jetë në gjendje për ta bërë këtë, pala duhet ta di datën në të cilën Gjykata do të marrë vendimin e saj. Megjithatë, kjo do të thotë që Gjykata duhet shprehimisht ta njoftojë palën për atë datë, një praktikë që Gjykata, deri më tani, nuk duket që e ka zhvilluar. Për më tepër, çfarë do të ndodhë, nëse ndonjë palë mëson një arsye për përjashtimin e një gjyqtari pas skadimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesës, ose edhe pasi që Gjykata ka dhënë një vendim në lidhje me kërkesën? Pala mundet, të paktën, të paraqesë një ankesë tek Kryetari i Gjykatës, duke argumentuar se e drejta e saj për qasje në një gjykim të pavarur dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 KEDNj-ja do të shkelet, nëse Gjykata do ta injorojë lutjen e tij.

As neni 18, e as Rregulla 7 që përmend një situatë të tillë e cila mund të ketë pasoja të rënda për një gjyqtar, aq më tepër, nëse ai / ajo me dashje ka heshtur gjatë gjithë procedimeve dhe pala nuk ishte në dijeni për atë në atë kohë. Një lëshim i tillë nga gjyqtari mund të konsiderohet si një neglizhencë e rëndë e detyrave dhe të çojë në shkarkimin e tij / saj, në pajtim me nenin 118 [Shkarkimi] të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit dhe procedurës për shkarkimin e gjyqtarit, të përcaktuar në Rregullën 6 [Procedurat e shkarkimit] të Rregullores së Punës, mund të iniciohet (Shih gjithashtu më lartë komentet për nenin 18.5).

Për më tepër, një situatë e tillë mund ta çojë gjithashtu Gjykatën në anulimin e vendimit dhe të gjykojë rastin edhe një herë, edhe pse nuk ka dispozitë të shprehur për këtë qëllim që duket se ekziston.

Sipas Rregullës 6 (2) të Rregullores së Punës, një ose më shumë gjyqtarë mund t'i propozojnë Kryetarit të Gjykatës shkarkimin e një gjyqtari me një dokument me shkrim, duke parashtruar arsyet e shkarkimit (shih komentet për Rregullën 6 (2) më sipër, paragrafi 1.) ose mund, "nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë." (shih Rregullën 6.5).[242] Si rrjedhim, sugjerohet të merret në konsideratë amandamentimi i nenit 18, si dhe Rregullës 6.

III. Në informacionin që duhet drejtuar Kryetarit, gjyqtari duhet t'i tregojë faktet dhe rrethanat që justifikojnë kërkesën e tij / saj për përjashtimin në bazë të kritereve të nenit 18 të ligjit ose në "rrethana të tjera" të përmendura në Rregullën 7.1. Gjithashtu çdo palë duhet të mbështes kërkesën e tij / saj të paraqitur në Gjykatë dhe të tregojë shkakun e përjashtimit të gjyqtarit. Është logjike që me një kërkesë të re për përjashtimin një palë nuk mund të përsërisë të njëjtat arsye, të cilat Gjykata i kishte refuzuar tashmë në një peticion të mëhershëm. Supozohet që Sekretari i Përgjithshëm është i ngarkuar me dorëzimin e kërkesës për diskualifikimin e të gjithë gjyqtarëve.

IV. Kur një palë e sfidon paanësinë e gjyqtarit dhe kërkon përjashtimin e tij / saj nga procedimet, Gjykata duhet të hetojë një kërkesë të tillë, përveç nëse kërkesa është

[242] Në këto rrethana, pa pritur rezultatin e vendimit të Gjykatës, gjyqtari në fjalë mund të vendosë të japë dorëheqjen, në bazë të nenit 9 [Përfundimi i mandatit para kohës] të Ligjit dhe të Rregullës 5 [Dorëheqja e gjyqtarëve] të Rregullores së Punës.

qartazi e pabazuar.[243] Në një situatë të tillë, parimi i barazisë së armëve kërkon që gjyqtari në fjalë duhet të jetë në gjendje ta mbrojë veten. Sipas rregullës, do të merret një deklaratë nga gjyqtari, por kjo nuk tregon nëse gjyqtari do të dëgjohet nga Gjykata, përpara se ta marrë vendimin për përjashtimin e gjyqtarit. Gjykata mund të kërkojë mbështetje për çfarëdo mjetesh tjera që i vlerëson të përshtatshme, për të marrë sqarime të mëtejshme lidhur me anshmërinë e mundshme të gjyqtarit. Kërkesa që një gjykatësit të sfiduar nuk duhet t'i lejohet të marrë pjesë në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës për përjashtimin e tij / saj, është e ngjashme me atë të parashikuar në nenin 9 [Përfundimi i mandatit para kohës], paragrafi 2, i Ligjit, ku gjyqtari "mandati i të cilit është në shqyrtim e sipër" përjashtohet nga vendimi i Gjykatës mbi përfundimin e mandatit të tij / saj.

V. Ndryshe nga vendimi sipas nenit 9 (2) të Ligjit, që ka të bëjë me shkarkimin e gjyqtarit, dhe, pra, kërkon një shumicë prej 2/3 e gjyqtarëve, përjashtimi i gjyqtarit nga një rast i dhënë në bazë të nenit 18 dhe Rregullës 7 (5) ka nevojë vetëm për votën e shumicës së gjyqtarëve. Vetëm atëherë kur Gjykata arrin në përfundim se përjashtimi i gjyqtarit nga rasti është "i bazuar mirë dhe themeluar në mënyrë të arsyeshme", do të vendosë që të përjashtojë gjyqtarin, ndonëse nuk është e qartë, se pse përjashtimi duhet të jetë "*i bazuar mirë*", por jo vetëm *"i mbështetur në mënyrë të arsyeshme*".

Praktika Gjyqësore e GJEDNj-së:

Përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18.1 të Ligjit, të cilat formojnë bazën për përjashtimin e gjyqtarit nga procedura, vlerësimi i paanshmërisë së gjyqtarit dhe ndikimi i saj mbi të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm duhet gjithashtu të merren parasysh në përputhje me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Në fakt, për të vlerësuar paanësinë e gjyqtarit, GjEDNj-ja përdor një test subjektiv dhe objektiv [244](të përmendura më lart në komentet mbi nenin 18.1), ashtu siç e bëri në rastin *Piersack* kundër Belgjikës, ku vendosi që, *përderisa paanshmëria normalisht tregon mungesën e paragjykimit apo anshmërisë, ekzistencën e saj ose ndryshe, sidomos në bazë të nenit 6 (1) KEDNj-së, mund të testohet në mënyra të ndryshme. Në këtë kontekst mund të nxirret një dallim ndërmjet një qasjeje subjektive, që po bënë përpjekje për të konstatuar bindjen personale të një gjyqtari të dhënë në rastin e dhënë, dhe një qasje objektive, që po përcakton nëse ai ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt*.[245] Në Doracakun për të Drejtat e Njeriut nr. 3 [E Drejta për Gjykim të Drejtë], të botuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Këshillit të Evropës [246], në lidhje me këtë deklaron se, *për t'u treguar paanshmëria subjektive, GjEDNj-ja kërkon prova të anshmërisë aktuale. Paanshmëria personale e gjyqtarit të emëruar në mënyrë të rregullt presupozohet, deri sa nuk ka prova për të dëshmuar të kundërtën*[247].

[243] Shih, Remli v. France
[244] De Cubber v. Belgium, 26 October 1984, § 26, Series A no. 86..
[245] Piersack v. Belgium, 1 October 1982, § 30, Series A no. 53, para. 30.
[246] Council of Europe, *The right to a fair trial: A guide to the implementation of Article 6 of the European Convention on Human Rights*, August 2006, Human rights handbooks, No. 3, available at: http://www.refworld.org/docid/49f180362.html [vizituar me datën 9 qershor 2014]
[247] Hauschildt v. Denmark, 24 May 1989, § 47, Series A no. 154, para. 47.

Ky është një supozim shumë i fortë dhe në praktikë është shumë e vështirë për të provuar anshmërinë personale.

Për sa i përket testit objektiv, Doracaku i referohet deklaratës së GjEDNj-së në *Fey kundër Austrisë* [248]*, ku duhet të përcaktohet, në mënyrë mjaft të pavarur prej sjelljes personale të gjyqtarit, nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e tij. Në këtë drejtim edhe dukja e jashtme mund të jetë me rëndësi. Ajo çfarë është në rrezik është siguria të cilën gjykatat në një shoqëri demokratike duhet ta frymëzojnë tek publiku dhe mbi të gjitha për sa i përket procedimeve penale kur bëhet fjalë për të akuzuarit,, […]* tek palët në procedura. *Kjo nënkupton që kur te merret vendimi në rastin konkret mbi atë nëse ka një arsye legjitime për frikë se një gjyqtar i caktuar nuk ka paanshmëri, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Ajo çfarë është përcaktuese, është, nëse kjo frikë mund të konsiderohet si e justifikuar në mënyrë objektive.* Sipas GjEDNj-së në Piersack kundër Belgjikës, çdo gjykatës në lidhje me të cilin ka një arsye legjitime për frikë të mungesës së paanshmërinë duhet të tërhiqet.

Për sa i përket procedurës para Gjykatës Kushtetuese, kjo do të thotë se, me anë të testit subjektiv, vlerësohet nëse një gjyqtar me të vërtetë nuk është i paanshëm në rastin që është objekt i shqyrtimit nga Gjykata, por që, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, paanshmëria personale e gjyqtarit gjithmonë duhet të presupozohet, derisa të paraqiten prova për të kundërtën. Siç konsideron GjEDNj-ja, ky test është thuajse pak i dobishëm, për shkak se është shume i vështirë për një palë në procedurë për t'i ofruar Gjykatës dëshmi mjaft të forta që tregojnë se gjyqtari në fjalë nuk është i paanshëm..

Testi objektiv për të përcaktuar nëse një gjyqtar i Gjykatës nuk është i paanshëm, duket të jetë më i lehtë, pasi që prania e fakteve të caktuara ose një paraqitje e caktuar tashmë mund të ngrejë dyshime për paanshmërinë e tij / saj. Prandaj, siç është përcaktuar nga GjEDNj-ja, në qoftë se ka një arsye legjitime për frikë se një gjykatësi i mungon paanshmëria, ai / ajo duhet të tërhiqet nga procedura[249]. Ky parim është përcaktuar në Rregullën 7 (1) të Rregullores së Punës.

Për më tepër, për sa i përket "paraqitjes së njëanshmërisë" të gjyqtarit, GjEDNj-ja theksoi, në rastin Buscemi [250], se komunikatat për shtyp të gjyqtarit mbi çështjen për t'u vendosur nga Gjykata, si reagim ndaj deklaratave të bëra nga ankuesi, ishin veprimet që ngritën shqetësimin për paanshmërinë e gjykatësit." Sipas mendimit të GjEDNj-së, "autoritetet gjyqësore duhet të ushtrojnë kujdes maksimal në lidhje me rastet të cilat ata i trajtojnë në mënyrë që të ruajnë imazhin e tyre si gjyqtarë të paanshëm. Ky paralajmërim nevojitet për t'i dekurajuar ata nga përdorimi i medieve të shkruara, edhe në qoftë se provokohen. Ky obligim është imponuar nga kërkesa më e lartë për drejtësinë.

Për sa i përket këndvështrimit të GjEDNj-së që çdo gjykatës në lidhje me të cilin ka një arsye legjitime për frikë mungese të paanshmërisë duhet të tërhiqet [251], ky parim u përsërit në rastin e Sigurdsson kundër Islandës[252], ku burri i njërit prej gjyqtarëve që vendosnin për parashtruesit e kërkesës në rastin kundër një banke kishte lidhje

[248] Fey v. Austria, 24 February 1993, § 30, Series A no. 255-A,.
[249] De Cubber vs Belgium - 9186/80 [1984] ECtHR 14 (26 October 1984), para. 26.
[250] Buscemi v. Italy, Application 29569/95, EctHr judgment of 16 September 1999, para 67.
[251] Persack v. Belgium, ECtHR judgment of 1 October 1982, para 33.
[252] Sigurdsson v. Iceland, ECtHR judgment of 10 July 2003.

financiare me atë bankë. Këto marrëveshje të favorshme bënë që GjEDNj-ja të arrijë në përfundimin se, përderisa nuk kishte asnjë sugjerim për anshmëri aktuale, ankesat e parashtruesit për mungesë të paanshmërisë objektive ishin të justifikuara dhe për këtë arsye, kishte pasur një shkelje të nenit 6 të KEDNj-së[253].

Neni 19 [Marrja e vendimeve]

19.1 Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.
19.2 Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
19.3 Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
19.4 Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit.

1 Në parim, Gjykata ushtron pushtetin e vet të vendimmarrjes me panelin gjyqësor të plotë të gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese, domethënë, nëntë (9) gjyqtarëve, sipas nenit 114.1 të Kushtetutës [254]. Megjithatë, edhe në qoftë se nuk janë të pranishëm të gjithë gjyqtarët, Gjykata mund të vendosë akoma në mënyrë të ligjshme si një panel, nëse të paktën një numër i caktuar minimal i gjyqtarëve është i pranishëm, siç përcaktohet me nenin 19.2

2 Kur kuorumi (numri minimal) prej shtatë (7) gjyqtarëve është i pranishëm, Gjykata akoma mund të veprojë si trup gjykues dhe të marrë vendime të cilat janë të vlefshme ligjërisht. Kjo do të thotë se vendimet mund të merren nga një shumicë prej katër (4) gjyqtarëve. Numri i gjyqtarëve të nevojshëm për të marrë vendime të vlefshme ligjërisht ndryshon nga vendi në vend. Për shembull, neni 27.1 i Aktit kroat për Gjykatën Kushtetuese përcakton se: *"Gjykata Kushtetuese jep vendime dhe vendime gjyqësore me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj, përveç kur parashikohet ndryshe nga Kushtetuta ose nga ky Akt kushtetues."* Kjo do të thotë se për shumicë votash prej të gjithë gjyqtarëve të saj (Gjykata përbëhet nga një total prej nëntë gjyqtarëve) janë të nevojshme votat e 5 gjyqtarëve. Pra, edhe me vetëm 5 gjyqtarë të pranishëm, Gjykata Kushtetuese kroate do të mund të kalojë vendimet apo vendimet gjyqësore, për aq kohë sa të gjithë të 5 gjyqtarët të votojnë në favor. Ky numër minimal i gjyqtarëve që nevojiten për marrjen e vendimeve do të mund, pra, të konsiderohet si kuorum, edhe pse është e qartë se, me një kuorum prej 5 gjyqtarëve, vendimmarrja me shumicë votash nga 5 gjyqtarë është e mundur vetëm nëse votimi është unanim.
Gjithashtu neni 8 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës parasheh në mënyrë të ngjashme: *"Gjykata plenare vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Gjykatës."* Për më tepër, neni 72 [Nxjerrja e vendimit dhe publikimi], paragrafi 2, i Kapitullit VIII [Vendimet e Gjykatës Kushtetuese] të Ligjit të Shqipërisë për organizimin dhe funksionimin e

[253] The right to a fair trial. A guide to the implementation of Article 6 of the European Convention on Human Rights. Nuala Mole and Catharina Harby (2001, updated 2006). Human rights handbooks. Practical guides to the implementation of the European Convention on Human Rights, Handbook No. 3.
[254] Neni 114.1 i Kushtetutës përcakton: *Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë [....].*

Gjykatës Kushtetuese përcakton se: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet. "* Pra, me një total prej 9 gjyqtarëve, vendimmarrja mund të bëhet me një shumicë prej 5 gjyqtarëve të pranishëm.

Neni 41 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese sllovene përcakton në mënyrë të ngjashme: *"Gjykata Kushtetuese vendos për meritat lidhur me çështjet e përmendura në nenin 21 të këtij ligji me shumicën e votave e të gjithë gjyqtarëve, me kusht qe ky Akt nuk e përcakton ndryshe. Gjykata Kushtetuese vendos për çështje të tjera me një urdhër të miratuar me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm. [...]. "*[255] Gjithashtu këtu Gjykata Kushtetuese ka nevojë vetëm për praninë e 5 gjyqtarëve (nga një total prej 9 gjyqtarëve) që ligjërisht të marrë vendime.

Kështu, pra, duket se metoda për të pasur një kuorum e miratuar për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, nuk është rregull e përgjithshme për një numër të vendeve fqinje të cilat kanë zgjedhur një sistem ku gjykata kushtetuese vendos me shumicë votash prej të gjithë gjyqtarëve të tyre.

3 Si një institucion vendimmarrës kolegjial, Gjykata udhëhiqet domosdoshmërisht nga parimi i kolegjialitetit, që nënkupton se në procesin e vendimmarrjes gjyqtarët kanë status të barabartë, edhe pse nuk përmendet shprehimisht me nenin. Fakti që Gjykata përbëhet nga gjyqtarë të cilët janë zgjedhur në bazë të procedurave të ndryshme për (1) të pasqyruar përfaqësimin etnik, sipas nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 3, i Kushtetutës; (2) për të respektuar parimin e barazisë gjinore për arsye të paragrafit 1 të të njëjtit nen; si dhe (3) për të respektuar përbërjen e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] te Kushtetutës[256], nuk prek statusin e barabartë të gjyqtarëve. Prandaj, që nga fillimi i mandatit të tyre, gjyqtarët kanë status të barabartë dhe votë të barabartë në procesin e vendimmarrjes së Gjykatës.[257] Kjo konfirmohet nga Rregulla 4 [Përparësia e Gjyqtarëve] i Rregullores së Punës (shih tekstin e mëtejmë), i cili plotëson nenin 19.3 të Ligjit.

Shumica e votave është thelbi i parimit të kolegjialitetit të Gjykatës. Natyrisht, vendimet e Gjykatës mund të jenë konsensuale, por gjyqtarët si anëtarë të panelit të gjykatës (dhe sikurse gjykatësit e gjykatave të rregullta[258]) janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe prandaj, mund të, mos e ndjekin shumicën për të arritur konsensus në frymën kolegjiale.

---

[255] Shih nenin 42, Akti i Gjykatës Kushtetuese, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr 64/07- tekst zyrtr i konsoliduar.

[256] Shih komentet në nenin 152 të Kushtetutës.

[257] Për më shumë informacion, shih CDL-AD(2005)039 Opinion on proposed voting rules for the Constitutional Court of Bosnia and Herzegovina adopted by the Commission at its 64th plenary session (Venice, 21-22 October 2005) accessible at: http://www.coe.ba/web2/en/dokumenti/_cat_view/202-coe-documents-on-bosnia-and-herzegovina--coe-dokumenti-vezani-za-bih/61-european-commission-for-democracy-through-law-venice-commission--venecijanska-komisija/92-published-in-2005--objavljeno-2005.html, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[258] Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, paragrafi 4: "Gjyqtarët do të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre".

Sidoqoftë, mund të duket konfuze që, sipas tekstit, Gjykata vendos me shumicën e gjyqtarëve "të pranishëm dhe që votojnë", pasi që paragrafi 4 i të njëjtit nen, shprehimisht parasheh se "Secili gjyqtar është i detyruar të votojë pro ose kundër vendimit". Termat *"... të pranishëm dhe që votojnë"*, në organet e tjera vendimmarrëse, siç janë parlamentet, kuvendet, bordet dhe organet e tjera të ngjashme, ku vendimet merren gjithashtu me shumicën e votave, nënkupton që lejohet abstenimi nga votimi. Mirëpo, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të tjera, ndonëse janë organe vendimmarrëse kolektive,[259] nuk u lejohet të abstenojnë nga votimi, kur janë të pranishëm. Prandaj, sugjerohet që fjalët *"që votojnë"* të fshihen.

4 Siç u përmend më lart, çdo gjyqtar duhet të votojë pro ose kundër një vendimi, pasi që abstenimi nuk lejohet. Nëse një gjyqtar nuk pajtohet me vendimin e shumicës, mospajtimi i tij / saj me vendimin e shumicës nuk mund të vë në dyshim legjitimitetin e vendimit dhe forcën e tijj të detyrueshëm, të përcaktuar me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 1, i Kushtetutës, duke parashikuar: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës."* Gjithashtu, neni 20 [Vendimet] i Ligjit në mënyrë të qartë përcakton legjitimitetin e vendimeve të Gjykatës, duke saktësuar: *"Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përcaktojnë vendimin e Gjykatës" (shih komentet në tekstin e mëtejmë).*

Edhe pse Ligji nuk shprehet, Rregullorja e Punës së Gjykatës (Rregulli 58 [Mendimet mospajtuese] dhe 59 [Mendimi konkurrues] shprehimisht parashikojnë të drejtën e gjyqtarëve për të përgatitur një opinion të veçantë në formën e një mendimi mospajtues ose atë konkurues, si rezultat i vendosmërisë së Gjykatës për të rregulluar çështjen. Kjo vendosmëri jo vetëm që ishte e bazuar në praktikën e gjykatave kushtetuese të themeluara pas rënies së diktaturave komuniste në Evropë, por gjithashtu e bazuar në mendimin e Komisionit të Venedikut,[260] dhe praktikën e GjEDNj-së, praktika gjyqësore e të cilit, siç u përmend më sipër, është duke u zbatuar nga Gjykata Kushtetuese për të interpretuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.[261]

Është e njohur gjerësisht, që tipar i rëndësishëm i vendimeve të GjEDNj-së janë mendimet e ndara (mospajtuese dhe konkurruese) të gjykatësve, të cilat formojnë pjesë integrale të këtyre vendimeve, dhe, si të tilla, publikohen së bashku me vendimin bazë. Për shkak të nivelit të lartë të kolegjialitetit të kësaj gjykate të

[259] Kushtetuta e vendos Gjykatën Kushtetuese jashtë kapitullit VII të saj [Sistemi i Drejtësisë], duke e rregulluar Gjykatën në një kapitull të veçantë, Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese]. Kjo ndarje në mes të kontrollit kushtetues dhe gjyqësorit është një tipar i rëndësishëm i Kushtetutës, duke e demonstruar qartazi, se për kontroll kushtetues, preferohet modeli Kelsenian i ngjashëm me modelin gjerman.

[260] Shih një prej shumë opinioneve të Komisionit të Venedikut që adresojnë çështjet e mendimit mospajtues: Opinion on Draft Amendments to the Law on the Constitutional Court of Latvia, adopted by the Venice Commission at its 80th Plenary Session (Venice, 9-10 October 2009) në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2009/CDL-AD%282009%29042-e.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[261] Neni 53 i Kushtetutës përcakton: *Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

rëndësishme, mendimet e ndara kurrë nuk e kanë tronditur rëndësinë e vendimeve të saja dhe nuk e kanë lënduar besueshmërinë e saj, por kanë kontribuar më tepër në transparencën e procesit të vendimmarrjes.[262]

Sot, mendimet mospajtuese dhe ato konkurruese njihen në, inter alia, Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Estoni, Gjeorgji, Gjermani, Greqi, Hungari, Maqedoni, Moldavi, Mal të Zi, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Serbi, Slloveni, Spanjë, Turqi dhe Ukrainë[263], dhe kanë kontribuar në zhvillimin e parimit të sundimit të ligjit dhe mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Të gjitha vendet që kanë vuajtur nga totalitarizmi dhe diktatura u referuan, kur Justice Douglas i Gjykatës së Lartë të SHBA në mënyrë dramatike argumentoi në lidhje me zhvillimin e drejtësisë kushtetuese:"… *siguria dhe unanimiteti në ligj janë të mundshme në që të dy sistemet si fashiste ashtu dhe komuniste. Ato nuk janë vetëm të mundshme; janë të detyrueshme….*"[264]

Mendimet e ndara të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese demonstrojnë se vendimet e shumicës janë të bazuara mbi arsye të mira dhe gjithashtu janë me rëndësi etike si për gjykatësit ashtu dhe për vetë Gjykatën për të bindur palët në procedurë dhe publikun e gjerë se një pjesë e rëndësishme e procesit të vendimmarrjes është shkëmbimi i mendimeve ndërmjet gjykatësve si dhe shqyrtimet e bazuara në argumente. Publikimi i mendimeve të veçanta është një tipar i rëndësishëm që siguron se gjyqtarët e Gjykatës, *"kryejnë funksionet e tyre me ndërgjegje dhe paanshmëri, për të vendosur me vullnetin e tyre të lirë në pajtim me Kushtetutën"*, sipas nenit 10.1 të Ligjit të mësipërm.

Rëndësia e mendimeve të veçanta gjithashtu është shprehur edhe nga Profesori i të drejtës kushtetuese Stack:

"Publikimi i një mendimi të vetëm mund të jetë i mjaftueshëm për të dëshmuar se vendimi i Gjykatës është i bazuar në arsye, por praktika e dhënies së një mendimit të vetëm nuk do të demonstronte që vendimi i Gjykatës është produkt i dialogut të arsyetuar midis Gjyqtarëve. Publiciteti i opinioneve kundërshtuese si dhe treguesi i mbështetjeve individuale të opinioneve të veçanta të gjyqtarëve tregojnë se Gjyqtarët u kundërvihen njëri tjetrit me mospajtimet e tyre në lidhje me çështjet parimore duke i shkëmbyer mendimet dhe me bisedën që i rrethon ata, nëse jo edhe në konferencat e tyre formale. Në këtë mënyrë, praktika e mospajtimit manifeston shkëmbimin e arsyeve midis Gjyqtarëve që e karakterizon procesin e tyre të vendimmarrjes; pa këtë praktikë, ne që gjendemi përjashta Gjykatës nuk do të kishim asnjë mundësi të shohim Gjykatën që e personifikon një proces të gjykimit deliberativ."[265]

[262.] White, Robin CA, and Iris Boussiakou. "Separate opinions in the European court of human rights." *Human Rights Law Review* 9, no. 1 (2009): 37-60.

[263] MAVČIČ, Mr Arne Marjan. "THE IMPORTANCE OF DISSENTING AND CONCURRING OPINIONS IN THE DEVELOPMENT OF JUDICIAL REVIEW WITH SPECIAL REFERENCE TO SLOVENIAN PRACTICE", http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-JU%282010%29016-e.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[264]Sir Anthony Mason, 'The Centenary of the High Court of Australia' (2003) 5 Constitutional Law and Policy Review 41, 43.

[265] Stack, Kevin M. "The Practice of Dissent in the Supreme Court." *Yale Law Journal* (1996): 2235-2259

Mendimet e ndara janë me të vërtetë të rëndësishme për zhvillimin e drejtësisë kushtetuese. Sa për zhvillimet në SHBA, mund të vërehet se opinionet e kundërta të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, siç ishte rasti me Gjyqtarët Curtis dhe McLean në lëndën Scott kundër Samford, të cilët kanë prezantuar zgjidhjet për gabimet serioze të doktrinës kushtetuese të shfaqura në vendimin e shumicës. Mendimi i tyre mospajtues ishte udhërrëfyes për korrigjimin e vendimit të shumicës, atëherë kur ditët më të mira për korrigjim nuk kishin ardhur ende.[266]

Sot nuk mund ta mohojmë rëndësinë pedagogjike të publikimit të opinioneve të ndara të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shkencës juridike në përgjithësi. Si rezultat i përdorimit të gjerë të internetit nga të gjithë juristët, avokatët, studentët e drejtësisë, profesorët e drejtësisë dhe praktikuesit e tjerë juridikë, si dhe gazetarët dhe grupet e tjera të interesit, opinionet e ndara ndihmojnë në vlerësimin e argumenteve të vendimit të shumicës.

Së fundi, është e rëndësishme të theksohet se pavarësia institucionale e Gjykatës është thuajse vështirë e ndarë nga pavarësia individuale e gjyqtarëve si anëtarë të Gjykatës. Publikimi i opinioneve të ndara publikisht tregon pavarësinë e tyre, duke i mundësuar secilit dhe çdonjërit prej tyre të shprehin opinionin që dallon nga vendimi i shumicës.

Kur reflekton mbi rëndësinë e publikimit të opinioneve mospajtuese, siç është argumentuar më lart, Rregullat në vijim 58 dhe 59 të Rregullores së Punës përmbajnë rregulla të hollësishme për botimin e mendimeve të ndara.

Rregulli 4 [Përparësia e gjyqtarëve] i Rregullores së punës

(1) Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të emëruar në pajtim me nenin 114 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 6 e me nenin 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

(2) Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore të punës, gjyqtarët kanë status të barabartë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre, pavarësisht moshës, rendit të emërimit, kohëzgjatjes së shërbimit, ose kohëzgjatjes së mandatit.

(3) Me rastin e përcaktimit të rendit të votimit, gjyqtarët votojnë me përparësi, sipas datës dhe sipas kohës së fillimit të mandatit të tyre: ata që janë emëruar më së voni, votojnë së pari. Nëse gjyqtarët janë emëruar në të njëjtën kohë, atëherë ata votojnë me radhë sipas alfabetit.

(4) Me rastin e përcaktimit ose të zëvendësimit të gjyqtarëve raportues dhe të kryesuesve të kolegjeve shqyrtuese, përparësia e gjyqtarëve përcaktohet nëpërmjet sistemit të tërheqjes së shortit dhe të emërimit të gjyqtarit përkatës nga Kryetari.

I. Ndryshe nga neni 19.3, Rregulla 4.2 shprehimisht parasheh që, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Gjykatës, të gjithë gjyqtarët kenë një status të barabartë. Mosha, përparësia e emërimit, kohëzgjatja e shërbimit apo kohëzgjatja e mandatit nuk kanë rëndësi, përveç nëse parashihet ndryshe me Rregullat. Për

[266] Graber, Mark A. *Dred Scott and the problem of constitutional evil*. Cambridge University Press, 2006.

shembull, një përjashtim është bërë në rastet e përmendura në tekstin e mëtejmë në Rregullën 4.3 (rendi i votimit) dhe Rregullën 4.4 (përcaktimi ose zëvendësimi i kryesuesit ose gjyqtarit raportues ose të trupit gjykues të kolegjit shqyrtues [267]).

II. Sipas Rregullës 4.3, rendi i votimit përcaktohet ose në bazë të moshës së gjyqtarëve ose në bazë të datës dhe kohës së fillimit të mandatit të secilit prej gjyqtarëve. Në Rregullën 4.3 Gjykata ka zgjedhur metodën e mandatit, në kuptimin që data dhe koha e fillimit të mandatit të gjyqtarit e përcakton rendin e votimit, me gjyqtarin e emëruar të fundit që voton i pari. Vetëm në rast se mandati i gjyqtarëve filloi në të njëjtën kohë, radha e votimit duhet të përcaktohet në bazë të moshës, me votimin e gjyqtarit më të ri që voton i pari. Megjithatë, duke marrë parasysh se mandati i një gjyqtari fillon me dhënien e tij / saj të betimit para Presidentit të Republikës, asnjëherë nuk mund të jetë çështje e "[...] *Gjyqtarëve [që kanë] qenë të emëruar në të njëjtën kohë*, [...] ", sepse koha e dhënies së betimit asnjëherë nuk mund të jetë e njëjtë. Rendi i dhënies së betimit, pra, duhet të jetë parametri.
Rregulli 4.3 gjithashtu mbështet statusin e barabartë të gjyqtarëve dhe parimin e kolegjialitetit të Gjykatës si një trup kolektiv. Kryetari i Gjykatës nuk ka pozitë të veçantë për sa i përket rendit të votimit, për dallim nga disa gjykata të tjera kushtetuese. Në Rumani, për shembull, kryetari i Gjykatës Kushtetuese voton i fundit, si e përcaktuar me Ligjin Rumun për Gjykatën Kushtetuese[268]
Është interesante të theksohet që as Ligji i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese, e as Rregullorja e Punës nuk e rregullojnë shprehimisht mundësinë e dështimit për të arritur shumicën e votave. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse një panel i përbërë nga tetë (8) gjyqtarë merr një vendim dhe votimi përfundon me një barazim.[269] Një mënyrë për të kapërcyer këtë problem është që të rishqyrtojnë rastin kur trupi gjykues përbëhet me numër tek gjyqtarësh. Një tjetër zgjidhje për votim të barabartë në çështjet që përfshijnë shkeljen e supozuar të Kushtetutës është supozimi se nuk ka pasur asnjë shkelje kushtetuese, siç parashikon paragrafi i tretë i nenit 15 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Federale.[270]

Rregulli 58 [Mendimet mospajtuese] i Rregullores së punës

58.1 Gjyqtari i Gjykatës ka të drejtë të përgatisë një mendim mospajtues me aktgjykimin e Gjykatës, mbi bazë të ligjshmërisë së kërkesës. Gjyqtarët e tjerë mund t'i bashkëngjiten mendimit mospajtues, i cili duhet të shpjegojë arsyet përse gjyqtari nuk pajtohet me mendimin e shumicës së Gjykatës. Për aq sa është e mundur, mendimi mospajtues ndaj një aktgjykimi të

[267] Shih komentet mbi nenin 22.4 dhe 22.5 të Ligjit
[268] Ligji nr. 47/1992, neni 58 paragrafët 1 dhe 2 ribotuar, në dispozicion në http://www.ccr.ro/en/Legea-nr-471992, (vizituar me datën 9 qershor 2014).
[269] Për shembull, paragrafi 1 nga Rregulla 23 i Rregullores së Punës të GjEDNj-së përcakton se në rast të një barazimi në votim, do të merret një votë e re, dhe në qoftë se ka ende barazim, Kryetari do të hedhë votën, nëse kjo Rregullore nuk e parasheh ndryshe.
[270] Fjalia e tretë e nenit 15.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Federale Gjermane parashikon: "Nëse votat janë të barabarta, Ligji themelor ose një ligj tjetër Federal nuk mund të deklarohet të jetë shkelur."
"Law on the Federal Constitutional Court (Gesetz über das Bundesverfassungsgericht)." http://www.iuscomp.org/gla/statutes/BVerfGG.htm (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Gjykatës paraqitet së bashku me aktgjykimin, bëhet pjesë e dosjes së lëndës, botohet së bashku me aktgjykimin dhe u dërgohet palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin.

58.2 Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim mospajtues për vendimin e Gjykatës sa i përket masës së përkohshme. Çdo gjyqtar ka të drejtë të cekë në vendim se ka votuar kundër masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata.

58.3 Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim mospajtues për aktvendimin e Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës. Secili gjyqtar ka të drejtë të cekë në aktvendim se nuk është pajtuar me aktvendimin për pranueshmërinë e kërkesës.

I. Rregulli 58.1 përcakton qartë të drejtën e një gjyqtari i cili nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës, individualisht ose së bashku me gjyqtarët e tjerë, për të përgatitur një opinion mospajtues, në të cilin ai / ajo shpjegon arsyet e mospajtimit me mendimin e shumicës. Mendimi mospajtues bëhet pjesë e dosjes së lëndës dhe botohet së bashku me aktgjykimin. Së bashku me aktgjykimin, i dërgohet palëve dhe publikohet me aktgjykimin e Gjykatës në faqen e saj dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë, duke botuar mendime të tilla së bashku me vendimin e Gjykatës në faqen e saj dhe në Gazetën Zyrtare, publiku i gjerë ka qasje në mendimet mospajtuese dhe konkurruese njëherësh siç ka qasje në mendimin e shumicës.

Megjithatë, formulimi *"... për aq sa është e mundur për ta bërë këtë..."*, do t'i mundësonte Gjykatës, për arsye të ndryshme, që të mos i publikojë mendimet mospajtuese të gjyqtarëve në të njëjtën kohë me mendimin e shumicës. Për shembull, në qoftë se, për arsye të caktuara, një gjykim ka nevojë që të publikohet sa më shpejt të jetë e mundur, por gjyqtari (ët) në fjalë ka nevojë për më shumë kohë se sa e parashikuar për të finalizuar mendimin mospajtues ose nëse Gjykata përballet me ndonjë pengesë tjetër, Rregulla i lejon që Gjykata t'i komunikojë mendimet mospajtuese me një vonesë të caktuar

Mirëpo, gjykatat e tjera kushtetuese mund të kenë procedura më të rrepta që përmbajnë dispozita të detajuara mbi përgatitjen dhe publikimin e mendimeve të veçanta, afatet për përgatitjen e tyre dhe referencën për këto në tekstin e aktgjykimit përkatës, në të cilin ato duhet të jenë të bashkëngjitura, dhe pa të cilat aktgjykimi nuk mund të shpallet ose publikohet në botimet e këtyre gjykatave kushtetuese, përfshirë publikimet elektronike, Gazetën Zyrtare ose Buletinet e tyre[271]

II. Një nga përjashtimet e rregullës së përgjithshme për publikimin e opinioneve mospajtuese është bërë për vendimet për masat e përkohshme, për shkak të natyrës

[271] Shih, për shembull, Kapitulli 8 [Mendimet e Ndara, nenet 71 [Lloji dhe qëllimi], 72 [Afati Kohor për Paraqitjen e Opinioneve Individuale] dhe 73 [Të Shërbyerit dhe Publikimi] i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë. Official Gazette of the Republic of Slovenia, No. 86/07, 54/10 and 56/11, available at: http://www.us-rs.si/media/the.rules.of.procedure-2012.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).

së tyre specifike.[272] Në bazë të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, i Kushtetutës, vendimet për masat e përkohshme merren nga Gjykata pa e paragjykuar vendimin e saj përfundimtar dhe mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, deri sa Gjykata të e merr një vendim përfundimtar, në qoftë se *"konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të paripërueshme."*[273]

Arsyeshmëria prapa Rregullës është që, pasi që këto vendime duhet të merren urgjentisht dhe nuk e paragjykojnë vendimin përfundimtar për rastin, një gjyqtarit i cili nuk pajtohet me vendimin e shumicës mbi masë të përkohshme, nuk i lejohet që të publikojë një mendim të arsyetuar mospajtues. Mirëpo, nëse kjo kërkohet nga një gjyqtar mospajtues, vendimi i Gjykatës mbi masë të përkohshme mund të përfshijë informacion të thjeshtë se ai / ajo e ka kundërshtuar vendimin mbi masat e përkohshme, pa ndonjë elaborim të mëtejshëm. Para se të miratohej Rregullorja aktuale e Punës nga Gjykata, opinionet mospajtuese të gjyqtarëve në lidhje me procedurën e ndjekur rreth zbatimit të papërshtatshëm të saj [274] ose për sa i përket përmbajtjes së vendimit [275] vërtetë kanë qenë të bashkangjitura në disa vendime të hershme të Gjykatës mbi masat e përkohshme.

III. Rregulla 58.3 përmban një përjashtim të mëtejshëm të rregullës së përgjithshme në publikimin e mendimeve mospajtuese, duke siguruar se gjyqtarëve nuk u lejohet të bashkëngjisin një mendim mospajtues në një rezolutë të Gjykatës mbi pranueshmërinë e kërkesës. Gjyqtarët mospajtues kanë të drejtë vetëm të sugjerojnë në rezolutë që ai / ajo nuk pajtohet me rezolutën. Në praktikë, vendimet Gjykatës, ku referimi është deklaruar i papranueshëm, titullohen "Rezolutat mbi Papranueshmërinë". Mund të jetë për keqardhje që rezolutat e tilla përmbajnë vetëm arsyet e shumicës për vendimin mbi papranueshmërinë, pasi që palët në procedurë dhe publiku në përgjithësi do të jenë të privuar nga e drejta për të ditur arsyet e gjyqtarëve mospajtues që kundërshtojnë vendimin e shumicës për të deklaruar referimin e papranueshëm. Ata vetëm mund të e dinë se një gjyqtar nuk u pajtua me Rezolutën për Papranueshmërinë, në qoftë se ai gjykatës e ka përdorur të drejtën e tij / saj për ta treguar këtë në Rezolutë. I njëjti arsyetim mund të përdoret në lidhje me Rregullën 58.2 më lartë.

Ndryshe nga kjo Rregull, qëllimi i nenit 71 [Lloji dhe Qëllimi], paragrafi 1, i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë duket të jetë më i gjerë, duke siguruar se një gjyqtar i cili nuk pajtohet me "*një vendim"* (supozuar: çdo vendim) të miratuar në një sesion të Gjykatës Kushtetuese mund të paraqesë

[272] Për më shumë informata, shiko komentet mbi masat e përkohëshme.

[273] Shih gjithashtu komentin në lidhje me nenin 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit.

[274] GjEDNj-ja adopton masa të përkohshme vetëm, nëse kërkuesi është në rrezik të menjëhershëm që të pësojë një dëm të dëshmuar të parevokueshëm. Tipike për masat e përkohshme janë kërkesat për ekspozim ndaj keqtrajtimit në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së, ndërsa shembulli më i zakonshëm është, kur një kërkues përballet me një ekstradim / deportim në një vend, ku ai do të ishte në rrezik të keqtrajtimit të tillë apo ku jeta e tij do të jetë me të vërtetë në rrezik. Shih Komunikatën e GjEDNj-së mbi përdorimin e pavend të masave të përkohshme të komunikuar më 21.12. 2007: http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=827272&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[275] Shih faqen e internetit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

një mendim të veçantë, i cili mund të jetë ose një opinion mospajtues, nëse ai nuk pajtohet me dispozitat vepruese, apo një mendim pajtues, në qoftë se ai nuk pajtohet me deklaratën e arsyeve.[276] Dispozita të ngjashme janë të përfshira në Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës (neni 41), duke përcaktuar se gjyqtari duhet të dorëzojë (1) arsyet për mendimin e veçantë të tij / saj brenda pesëmbëdhjetë ditëve, ose (2) një deklaratë të vetme mbi mospajtimin.[277] Me sa duket, vetëm gjyqtari mospajtues ka të drejtën sipas nenit 72.8 të Ligjit Shqiptar të Gjykatës Kushtetuese *"të arsyetojë mendimin e tij / saj, i cili i bashkëngjitet dhe botohet së bashku me vendimin."* Edhe Ligji Gjerman për Gjykatën Kushtetuese, përcakton në nenin 30 (2), që *"Gjykatësi që mban një opinion mospajtues mbi vendimin ose arsyet gjatë shqyrtimeve mund ta ketë të regjistruar me votë të veçantë;Votimi i veçantë do t'i bashkëngjitet vendimit.* [...]."[278] Opinionet konkurruese janë relativisht të rralla, sepse në shumicën e rasteve, në qoftë se Gjyqtarët bien dakord për rezultatin, ata do të gjejnë një mënyrë për të akomoduar në formulimin për meritat, linjat e ndryshme të argumentit të cilat çojnë në këtë përfundim.

Rregulli 59 [Mendimi konkurrues] i Rregullores së punës

59.1 Gjyqtari i Gjykatës ka të drejtë të përgatisë një mendim konkurrues me aktgjykimin e Gjykatës, mbi bazë të ligjshmërisë së kërkesës. Mendimi konkurrues nënkupton pajtimin me aktgjykimin e Gjykatës, por jo edhe me arsyetimin e dhënë. Prandaj, një mendim konkurrues mund të shkruhet nga një gjyqtar, i cili voton njëjtë me shumicën, duke mbështetur vendimin e Gjykatës. Gjyqtarët e tjerë mund t'i bashkohen mendimit konkurrues dhe në mënyrë specifike duhet t'i shpjegojnë arsyet pse gjyqtari pajtohet me rezultatin, por nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë nga shumica e Gjykatës. Për aq sa është e mundur, një mendim konkurrues me aktgjykimin e Gjykatës paraqitet së bashku me aktgjykimin, bëhet pjesë e dosjes së lëndës, botohet me aktgjykimin dhe u dërgohet palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin.

59.2 Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim konkurrues ndaj vendimeve ose ndaj aktvendimeve të Gjykatës, por mund të tregojë se ka mendim konkurrues vendimin ose për aktvendimin.

I. Përveç të drejtës për të bashkëngjitur një mendim mospajtues në vendimet e Gjykatës mbi bazueshmërinë e kërkesës, gjyqtarët kanë të drejtë që të përgatisin mendime të ndara edhe në qoftë se ata pajtohen me rezultatin e aktgjykimit. Siç është shkruar në Rregull, të ashtuquajturat "mendimet konkurruese" janë të përgatitura, nëse gjyqtarët pajtohen me rezultatin e aktgjykimit, por besojnë që

[276] Shih për hollësi të mëtejshme tekstin e plotë të nenit 71 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr 86/07, 54/10 dhe 56/11

[277] Shih tekstin e plotë të nenit 41 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, të korrigjuar (Gazeta Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës, nr 26/01, 6/02, 04/01.

[278] Bundesverfassungsgesetz, Procedura Kushtetuese Pjesa II, Seksioni I Rregullat e përgjithshme procedural, në dispozicion tek:: http://www.iuscomp.org/gla/statutes/BVerfGG.htm, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

shumica ka dështuar të zhvillojë arsyetimin e duhur për atë apo i ka injoruar ose refuzuar argumentet përkatëse, ose thjesht nuk pajtohen me arsyetimin. Ndryshe nga mendimi mospajtues, mendimi konkurrues përdor një ton më të qetë, dhe gjyqtari apo gjyqtarët që e përgatisin atë mund të bëjnë përpjekje për të forcuar vendimin nëpërmjet një arsyetimi të ndryshëm dhe / ose më të mirë.

Në të njëjtën kohë, mendimet konkurruese mund të japin më shumë informacion, të cilat, sipas gjyqtarit apo gjyqtarëve që i kanë përgatitur ato, do të kontribuojnë në të kuptuarit më të mirë të vendimit të shumicës. Mendimet konkurruese u tregojnë palëve dhe publikut të gjerë se ekziston një mosmarrëveshje brenda shumicës së gjyqtarëve në lidhje me arsyet e aktgjykimit. Siç është rasti me mendimet mospajtuese, Gjykata duhet t'i paraqesë mendimet konkurruese, *"për aq sa është e mundur ta bëjnë këtë"*, me aktgjykimin dhe të publikojë ato bashkërisht. Të njëjtat komente të dhëna më lartë në lidhje me mundësinë e Gjykatës për të publikuar mendimet mospajtuese në një fazë të mëvonshme, janë njëlloj të vlefshme për mendimet konkurruese.

Dispozitat ligjore të Sllovenisë dhe të Bosnjës të referuara më lartë kanë të bëjnë me mendime të ndara, që të dyja, ato mospajtuese dhe konkurruese.

II. Ngjashëm me ndalimin e përgatitjes së mendimeve mospajtuese mbi rezolutat e Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës, gjyqtarëve gjithashtu u ndalohet të përgatisin mendime konkurruese për vendimet (mbi masat e përkohshme) dhe Aktvendimet për Papranueshmëri të Gjykatës. Edhe pse Gjykata është e obliguar të arsyetojë vendimet dhe Aktvendimet e veta[279], palët në procedurë dhe publiku në përgjithësi nuk e ka asnjë mundësi për të mësuar nëse gjyqtarët, të cilët pajtohen me vendimin përfundimtar, kanë pasur argumente të detajuara për t'u mos-pajtuar me arsyetimin e vendimit ose të Aktvendimit. Gjyqtarët mund të, natyrisht, në qoftë se ata dëshirojnë, të tregojnë që ata pajtohen me vendim apo me Aktvendim. Ndryshe nga Rregulla 58.3, e cila i referohet vetëm rezolutave për pranueshmërinë e kërkesës, Rregulla 59.2 përmend dy vendimet dhe Aktvendimet e Gjykatës në të cilat gjyqtari mund të tregojë se ai / ajo pajtohet me atë vendim apo Aktvendim. Kjo mund të ketë qenë qëllimi i Gjykatës, kur e miratoi Rregulloren e Punës, që në mënyrë të barabartë t'i japë të drejtën një gjyqtari për të treguar në një vendim që ai / ajo nuk pajtohet me këtë vendim.

Ngjashëm, siç është rasti me mendimet mospajtuese, në Slloveni dhe Bosnjë e Hercegovinë palët dhe publiku kanë mundësi të mësojnë për argumentet e gjyqtarëve konkurrues, duke ua mundësuar atyre që të përgatisin një opinion konkurrues që mbështet një vendim - jo vetëm një aktgjykim - të Gjykatës, por për shkaqe të ndryshme. Dispozitat shqiptare dhe gjermanë vetëm përmendin mundësitë e mendimeve mospajtuese, jo konkurruese.

[279] Shih, Rregullën 57 (1), duke siguruar: *Aktgjykimet, Aktvendimet, Vendimet apo Urdhërat e tjerë të Gjykatës Kushtetuese do të përmbajnë minimumin e të dhënave, si në vijim: emrat e gjyqtarëve të Gjykatës, një hyrje, një deklaratë për bazën juridke për vendosje të rastit, një deklaratë që përmban arsyetimin e Gjykatës dhe dispozitat operative.*

Neni 20 [Vendimet]

20.1 Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

20.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.

20.3 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruara, nga kryetari i gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari raportues. Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtareve përcaktojnë vendimin e gjykatës. Vendimet shpallen publikisht.

20.4 Vendimi i dërgohet secilës palë sipas detyrës zyrtare dhe shpallet në gazetën zyrtare.

20.5 Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes së gazetën zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe.

1 Kjo dispozitë parashikon pa mëdyshje që palët (që do të thotë: parashtruesin e kërkesës si dhe palën në përgjigje) kanë të drejtë për seancë të shqyrtimit verbal, përveç nëse ata heqin dorë nga kjo e drejtë. Vetëm në qoftë se palët nuk e bëjnë këtë, rrjedh që Gjykata mund të vendosë për një rast vetëm *" pas përfundimit të* seancës së shqyrtimit verbal *"*.

Por çfarë mund të ndodhë, nëse njëra nga palët nuk heq dorë nga e drejta e tij / saj për seancë të shqyrtimit verbal? Në një situatë të tillë, duke marrë parasysh parimin e barazisë së armëve, zgjidhja mund të jetë që e drejta e palës që nuk heq dorë nga e drejta për seancë të shqyrtimit verbal, të peshojë më shumë se sa e drejta e palës tjetër që të mos heq dorë nga ajo e drejtë. Në fund, duhet të jetë Gjykata ajo që merr vendimin nëse do të mbajë apo jo një seancë të shqyrtimit verbal, duke peshuar me kujdes të drejtat e të dy palëve. Përndryshe, procedura para Gjykatës do të ndërmerrte rrezikun për t'u bllokuar shume lehtë çdo herë që palët nuk pajtohen lidhur me mbajtjen e një seance.

Dikush mund të mos pajtohet me interpretimin e mësipërm të nenit 20.1 se mbajtja e seancës së shqyrtimit verbal është rregull kur të dyja palët nuk heqin dorë nga e drejta për seancë verbale, aq më tepër që, nga pikëpamja tekstuale, kjo dispozitë nuk është e paqartë dhe, për këtë arsye, nuk duket se jep një interpretim të ndryshëm. Hartuesit / Legjislatura mund të mos ketë pasur qëllimin që në mënyrë të pakushtëzuar të japë një të drejtë të tillë të rëndësishme për palët, për shkak se mbajtja e seancës së shqyrtimit verbal, si rregull shumë lehtë do të stër-ngarkonte Gjykatën dhe administratën e saj dhe të çojë në krijimin e akumulimit të madh të rasteve.

Megjithatë, për aq kohë sa neni 20.1 të mos ndryshohet, Gjykata do të duhet të vendosë se si do të zgjidhë këtë çështje, në veçanti, pasi që neni 20.2 duket të jetë në kundërshtim të qartë me nenin 20.1, që përcakton se Gjykata është ajo e cila mund të vendosë "të mos mbajë seancë të shqyrtimit verbal". Nuk mund të jetë që, në bazë të njërit paragraf të nenit, palëve u është dhënë një e drejtë e tillë e rëndësishme, ndërkohë që, sipas paragrafit të ardhshëm të të njëjtit nen, Gjykata

thjesht mund të bëjë vet pa këtë të drejtë, “në diskrecionin e saj". (Shih gjithashtu komentet mbi Rregullën 3g të Rregulloren e Punës).
Neni 20.1 është elaboruar më tej me Rregullën 39 [E Drejta për dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së Punës.

2 Duke përdorur fjalët: "Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni", neni 20.2 në mënyrë eksplicite e pranon që palët kanë me të vërtetë të drejtën e një gjykimi në bazë të nenit 20.1. Megjithatë, edhe pse e pranon që palët e zotërojnë këtë të drejtë, neni 20.2 i mundëson Gjykatës, në të njëjtën kohë, të ndërhyjë në këtë të drejtë pa qenë e detyruar të jep ndonjë arsye për këtë. Si rezultat i kësaj, Gjykata do të mund thjesht të vendosë që të mos e mbajë një seancë të shqyrtimit verbal dhe ta gjykojë kërkesën në bazë të shkresave të lëndës. Në çdo rast, neni 20.2 e kërkon një vendim nga Gjykata për të "mos" mbajtur një seancë të shqyrtimit verbal. Për sa i përket praktikës së Gjykatës në këtë çështje, deri më tani, asnjë vendim i tillë nuk është marrë ndonjëherë nga Gjykata. Në vend të kësaj, Gjykata më tepër ka ndjekur procedurën e parashtruar në Rregullën 39.2 të Rregullores së Punës, që përcakton: “ Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore, në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar provat.”
Nëse e drejta për një seancë të shqyrtimit verbal është e drejtë e palëve (nenet 20.1) dhe 20.2 të Ligjit) ose një obligim për Gjykatën para ose pas vendimit për pranueshmërinë (neni 22.9 i Ligjit) ose një privilegj i Gjykatës (Rregulla 39.1 dhe 39.2 e Rregullores së Punës), nuk mund të mohohet se kërkesat për një seancë të shqyrtimit verbal duhet të jenë të qarta dhe koncize në interes të transparencës, efikasitetit, sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë. Prandaj, i vetmi përfundim që mund të nxirret është se dispozitat e ndryshme juridike të Ligjit dhe Rregullores së Punës në lidhje me mbajtjen e një seance të shqyrtimit verbal, të cilat janë kontradiktore dhe konfuze, duhet të amendohen sa më shpejtë të jetë e mundur për të shmangur më tej konfuzionin për palët dhe Gjykatën.
Për sa i përket rëndësisë së dëgjimeve verbale, nëse e shikon në praktikën e gjykatave të tjera kushtetuese në Evropë [280],disa vende ofrojnë seanca të shqyrtimit verbal (Itali), të tjerët procedura të shkruara (Hungari, Portugali), dhe përsëri të tjerët një kombinim të të dyjave procedurave gojore dhe me shkrim (Gjermani, Austri). Është e vërtetë që seancat e shqyrtimit verbal, në përgjithësi, kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e procesit të vendimmarrjes. Seancat e shqyrtimit verbal ebëjnë të mundur për gjyqtarët që të fitojnë një përshtypje më të drejtpërdrejtë të fakteve dhe qëndrimeve të palëve në një rast. Prandaj, në bazë të nenit 20 të Ligjit, ligjvënësi në Kosovë ka vendosur që seancat e shqyrtimit verbal duhet të jenë parim i procesit të vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese, bazuar në transparencë si një ndër vlerat thelbësore demokratike. Seancat e shqyrtimit verbal i shërbejnë publikut të gjerë për të ushtruar kontroll demokratik mbi punën e Gjykatës Kushtetuese.

[280] Shih tabelën 1.1.9 e cila paraqet dispozitat më të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore për seancat gojoree dhe përjashtimet, në studimin e miratuar nga Komisioni i Venedikut **CDL-AD(2010)039rev** Study on individual access to constitutional justice - Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010), në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD%282010%29039rev-e.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Në të njëjtën kohë, seancat e shqyrtimit verbal i japin Gjykatës një mekanizëm të rëndësishëm për të fituar besimin e publikut. Nëpërmjet seancave të shqyrtimit verbal, Gjykatës Kushtetuese i është dhënë mundësia për ta bërë të qartë për publikun se vendimet e saj janë marrë në mënyrë të pavarur, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Në këtë aspekt, seancat e shqyrtimit verbal janë veçanërisht të rëndësishme për Gjykatën Kushtetuese si një institucion i ri i një vendi të ri që ka vuajtur gjatë gjithë historisë së saj nga mungesa e sundimit të ligjit dhe nga perceptimi i qytetarëve që vendimet merren në fshehtësi dhe jo në mënyrë të pavarur dhe në mënyrë të paanshme..

Përkundër rëndësisë së madhe të seancave të shqyrtimit verbal, megjithatë, siç është thënë në mënyrë të qartë nga Komisioni i Venedikut, "*Gjykatat kushtetuese duhet të mbeten të afta për të interpretuar vendime të rëndësishme brenda një kohe të arsyeshme.*". Seancat e shqyrtimit verbal mund të marrin shumë kohë dhe nuk i shërbejnë në të gjitha rastet shpejtësisë së nevojshme të procedurës."[281] Është e vërtetë që seancat e shqyrtimit verbal mund të organizohen shpejt dhe mund të marrin vetëm një kohë të shkurtër, duke rrezikuar të bëhen një formalitet i thjeshtë, gjë që nuk i shërben qëllimit të vet origjinal. Kjo është arsyeja pse shumë gjykata kushtetuese në Evropë kanë zgjedhur një procedurë të shkruar. Komisioni i Venedikut ashtu siç është deklaruar ka qëndrimin e vet të qartë për këtë çështje, duke vënë në dukje se edhe procedura e shkruar e përdorur nga gjykatat kushtetuese është në përputhje me standardet evropiane.[282] Për shembull, Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë rrallëherë organizon seancë dëgjimore gojore.

Në veçanti, për sa i përket referimeve të paraqitura nga individët për organizimin e një seancë dëgjimore varet nga rëndësia që Gjykata i jep rastit. Në mënyrë tipike, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane heq dorë nga seanca e shqyrtimit verbal, kur parashikon që seanca nuk do të çojë në ndonjë progres në procedurë. Seancat gojore janë, megjithatë, të detyrueshme për kontestet ndërmjet organeve kushtetuese në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre të përcaktuara me Kushtetutë (*Rastet Organstreit)*, nxjerrjen para gjyqit të Presidentit të Gjermanisë, si dhe për shqyrtimin abstrakt të kushtetutshmërisë, përveç nëse palët që sollën rastin dhe janë organe të rëndësishme shtetërore, të heqin dorë nga mbajtja e një seance të shqyrtimit gojor.[283]

3 Vendimet e shkruara përbëjnë mjete të rëndësishme për të gjitha institucionet publike për të komunikuar në mënyrë efektive me palët dhe publikun e gjerë. Gjykatat në përgjithësi, sidomos gjykatat kushtetuese, ndryshe nga institucionet e tjera publike, thjesht nuk i publikojnë vendimet e tyre. Ato janë nën një detyrim ligjor që të publikojnë vendimet e arsyetuara. Për shkak se gjykatat kushtetuese janë institucione kolegjiale, arsyetimi i vendimeve të tyre arrihet nëpërmjet një procesi të diskutimeve të brendshme dhe shkëmbimit të mendimeve ndërmjet

[281] Shih Opinionin mbi Projektligjin Kushtetues Federal "On Modifications And Amendments to the Federal Constitutional Law on the Constitutional Court of the Russian Federation" në dispozicion në http://www.venice.coe.int/docs/2004/CDL-AD%282004%29035-e.asp, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[282] Ibid.

[283] Donald Kommers, Russell A. Miller, dhe Ruth Bader Ginsburg. Jurisprudenca Kushtetuese e Republikës Federale të Gjermanisë. Edicioni i 3-të, rishikuar dhe dhe zgjeruar. Durham [N.C.]: Duke University Press, 2012, fq. 27

gjykatësve. Një vendim duhet të ofrojë një shpjegim mbi atë se si gjykata e ka arritur/marrë atë, në veçanti, duhet të përmbajë një elaborim të analizës kushtetuese të fakteve dhe ligjit dhe arsyet për rezultatin e rastit[284]

Në botimin e famshëm "Liberalizmi Politik", John Rawls konsideron se gjykatat, veçanërisht gjykatat kushtetuese, si forume ku arsyet dhe shpjegimet nuk janë vetëm të pritshme, por për këtë arsye duhet të sigurohen. Në këtë kuptim, fuqia e gjykatave mbështetet në masë të madhe në cilësinë e arsyetimit gjyqësor, që do të thotë, arsyet që i lidhin vendimet gjyqësore me burimet juridike, e në veçanti, fakti që gjykatat si institucione nuk kanë kredencialet demokratike dhe po ashtu edhe mjetet për të zbatuar vendimet e tyre[285]. Arsyetimi i vendimeve është pjesë e demokracisë së vendimmarrjes. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të arsyetojnë pushtetin e tyre nga Kushtetuta dhe detyrimi i tyre për të justifikuar vendimet duhet të parandalojë ndonjë arbitraritet në vendimmarrje.

Gjithashtu, arsyetimi i vendimeve të gjykatës kushtetuese i mundëson zyrtarëve shtetërorë, gjyqtarëve të tjerë, juristëve, avokatëve, dhe publikut të gjerë të parashikojnë implikimet e vendimeve të tilla për rastet pasuese. Në këtë kuptim, arsyetimi i vendimeve mund të rris efikasitetin në trajtimin e çështjeve të ngjashme dhe të ndihmojë të tjerët të zgjedhin veprimet e tyre në mënyrë më inteligjente, duke i marrë parasysh pasojat që veprimet e tilla mund të sjellin. Pra, me pak fjalë, arsyetimi i vendimeve ndihmon për të përmirësuar sundimin e ligjit.

Detyrimi sipas nenit 20.3 të Ligjit për të justifikuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese është i bazuar në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të KEDNj-së. Vetëm vendimet e arsyetuara e bëjnë të qartë për të dyja palët dhe publikun e gjerë që Gjykata i ka dhënë palëve të drejtën për t'u dëgjuar dhe që argumentet e tyre të trajtohen në mënyrë të drejtë[286].

Kërkesa e nenit 20.3, që vendimet e Gjykatës do të nënshkruhen nga Kryetari i Gjykatës dhe Gjyqtari raportues tregon që gjyqtarët e tjerë të Gjykatës nuk nënshkruajnë vendimet. Nënshkrimi i Kryetarit është i rëndësishëm, sepse e bënë të vlefshëm vendimin, ndërsa nënshkrimi i gjyqtarit raportues është i rëndësishëm, sepse tregon transparencën e procesit të vendimmarrjes së Gjykatës, e cila fillon me raportin paraprak autor i të cilit është Gjyqtari raportues. Raporti Paraprak përmban faktet, pretendimet e palëve, si dhe aspektet ligjore të rastit konkret, në mënyrë të detajuar dhe prandaj, është i një rëndësie të madhe gjatë procedurave para Gjykatës[287]

Edhe pse përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtarëve do përcaktojnë vendimin e Gjykatës, vendimi i shumicës si i tillë, nuk është shkruar nga shumica por nga ana e gjyqtarit raportues, sipas Rregullës 60 [Teksti Përfundimtar i Gjykimit dhe Arkivimi] i Rregullores së Punës. Neni 20.3 megjithatë, nuk përmendë që gjyqtarët të cilët nuk pajtohen me aktgjykimin apo pajtohen me të për arsye të ndryshme nga

[284] John Ferejohn and Pasquale Pasquino, "Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Toward an Institutional Theory of Constitutional Justice," in *Constitutional Justice, East and West (*Wojciech Sadurski, ed.), The Hague: Kluwer Law International, 2002, 21-36.

[285] John Rawls, Political Liberalism, New York: Columbia University Press, 1993, fq. 237.

[286] Shih komentet në Rregullën 57 të Rregullave të Punës.

[287] Shih, nenin 22 të Ligjit, i cili përmban procedurën e hollësishme para Gjykatës.

ato të shumicës, kanë të drejtë të bashkëngjisin mendimin e tyre mospajtues ose konkurrues në aktgjykimin. Siç u përmend më lart, duket që hartuesit e ligjit nuk arritën të bien dakord për këtë çështje dhe thjesht e lënë atë jashtë. Gjykata, megjithatë, ka pranuar, rëndësinë e mendimeve të tilla, dhe, prandaj, e rregulloi këtë të drejtë, siç u përmend më lart në Rregullat 58 [Mendimet Mospajtuese] dhe 59 [Mendimet Konkurruese] të Rregullores së Punës

Fjalia e tretë e nenit 20.3 përcakton se vendimet e Gjykatës, do të shpallen publikisht. Megjithatë, as Ligji, dhe as Rregullorja e Punës nuk e parashikon ndonjë procedurë të veçantë për shpalljen e tillë publike. Në praktikën e Gjykatës, vendimet nuk shpallen paraprakisht, por, siç përcaktohet në nenin 20.4, i dërgohen palëve dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.

Ndonëse mund të shtrohet pyetja, nëse kjo mënyrë e shpalljes publike e vendimeve dhe aktgjykimeve është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së, i cili parashikon se gjykimi do të "shqiptohet publikisht". Pasi që KEDNj-ja është drejtpërdrejti e zbatueshme në Kosovë dhe, në pajtim me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara prej saj kanë, në rastin e konfliktit, prioritet mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike në Kosovë, pasoja do të ishte se detyrimi i "shqiptimit publik" të një vendimi, siç kërkohet nga neni 6 i KEDNj-së, do të ketë prioritet mbi detyrimin e "shpalljes publike" të një aktgjykimi në bazë të nenit 20.3 të Ligjit.

Në lidhje me këtë, i referohemi rastit Moser kundër Austrisë[288], të cilin GjEDNj-ja ka deklaruar se kishte zbatuar kërkesën e shpalljes publike të vendimeve me një shkallë të fleksibilitetit. Pra, bëri që përkundër formulimit që duket se sugjerojnë që leximi në gjyq të hapur është i detyruar, mënyrat e tjera të marrjes së aktgjykimit publik mund të jenë në përputhje me nenin 6 § 1. Në rastin e Sutter kundër Zvicrës, GjEDNj-ja gjeti që_ kushti i publicitetit ishte përmbushur nga fakti që kushdo që kishte një interes mund të konsultohej apo të merrte një kopje të tekstit të plotë të Gjykatës Ushtarake të Kasacionit, së bashku me faktin që gjykimet më të rëndësishme të gjykatës ishin botuar në koleksionin zyrtar.

Duke marrë parasysh praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, tani duhet t'i epet përgjigje çështjes nëse mënyra në të cilën vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë bërë publike në pajtim me nenin 20.4 i përmbushë kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së.

Pa dyshim, mënyra në të cilat vendimet e Gjykatës janë bërë publike në Kosovë, domethënë, duke botuar ato në Gazetën Zyrtare pasi u është komunikuar palëve, është në përputhje me praktikën gjyqësore të mësipërme të GjEDNj-së mbi nenin 6 të KEDNj-së, më tepër aq, pasi që, përveç publikimit në Gazetën Zyrtare, vendimet janë publikuar gjithashtu, menjëherë pasi u nënshkruan nga Kryetari i Gjykatës dhe Gjyqtari Raportues, në faqen e internetit të Gjykatës, në bazë të Rregullës 22 [Qasja], paragrafi 2, të Rregullores së Punës, duke përcaktuar: *"Sekretari i Përgjithshëm boton aktgjykimet dhe vendimet në ueb-faqen e Gjykatës, menjëherë pas miratimit të tekstit përfundimtar të tyre dhe siguron botimin e rregullt të versioneve të shtypura të aktgjykimeve dhe të vendimeve".*

[288] *Moser v. Austria, no. 12643/02, § 101,*.21 Shtator 2006.

4 Gjykata Kushtetuese gjermane ndjek një procedurë tjetër, Kryetari i Gjykatës shqipton aktgjykimin duke e lexuar një përmbledhje të saj në qoftë se janë mbajtur parashtresat verbale.[289] Në mënyrë që ta bëjë gjykimin më të arritshëm për publikun, përmbledhja bëhet lehtësisht e kuptueshme. Gjykata Kushtetuese Shqiptare shpall datat në të cilat gjykimet do të bëhen publike në një tabelë lajmërimesh jashtë gjykatës, por, zakonisht, nuk shqiptohen gojarisht, ndonëse kjo kërkohet nga Akti i Gjykatës Kushtetuese.[290]

5 Pasi që publikimi i vendimeve të Gjykatës në Gazetën Zyrtare mund të vonohet, e cila, nga pikëpamja juridike e aspektit të të qenit të sigurt mund të shihet nga palët dhe publiku si një gjë që e pengon efektivitetin dhe shpejtësinë e administrimit të drejtësisë, ligjvënësi i ka dhënë të drejtën Gjykatës, nëse e sheh të arsyeshme, që të shmanget prej atij rregull dhe të specifikojë në vendimet e saj një datë tjetër për hyrjen në fuqi të vendimeve të saj. Deri tani, praktika e Gjykatës ka qenë e tillë që përcakton në gjykimet dhe vendimet e veta se ato janë "në fuqi menjëherë", në vend se "në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare" të parashikuar me nenin. Me formulimin "në fuqi menjëherë", është e kuptueshme që vendimi në fjalë hyn në fuqi në ditën, në të cilën Gjykata mori vendimin, edhe pse, për shkak të ndërlikueshmërisë së rastit ose për arsye të tjera, teksti përfundimtar i vendimit mund të marrë ca kohë për t'u finalizuar dhe nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës dhe Gjyqtarit Raportues (ose gjykatësi tjetër që ka hartuar aktgjykimin apo vendimin).
Komentet mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës mund të gjenden në nenin 26 [Bashkëpunimi me organet tjera publike] në tekstin e mëtejmë.
Duke marrë parasysh, rëndësinë që Gjykata i jep arsyetimit të vendimeve, Rregullat 56 [Llojet e vendimeve] dhe 57 [Përmbajtja e Vendimeve] të Rregullores së Punës përcaktojnë, respektivisht, llojet e ndryshme të vendimeve dhe anatominë e një vendimi të arsyetuar të Gjykatës Kushtetuese në më shumë detaje.

Rregulli 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] i Rregullores së punës

39.1 Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsyetimi të mirë.
39.2 Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore, në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar provat.
39.3 Seanca dëgjimore është publike, përveç nëse Gjykata urdhëron ndryshe, kur ka arsyetim të mirë sipas Ligjit ose sipas kësaj Rregulloreje.

1. Titulli i Rregullës 39 duket që e plotëson nenin 20.1 të Ligjit, duke konfirmuar që palët kanë të drejtën e një gjykimi, por mund të heqin dorë nga e drejta e tyre. Megjithatë, teksti i Rregullës 39.1 duket të jetë mjaft hutues, pasi që pjesa e parë e fjalisë me sa duket ia lë këtë Gjykatës për të vendosur nëse do të mundësojë seancë dëgjimore, por vetëm në një situatë ku kërkesa është përcaktuar e pranueshme. Për

[289] Shih nenin 30 (1) të Aktit të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë.
[290] Shih nenin 72.6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë.

më tepër, pjesa e dytë e fjalisë duket që sugjeron se me të vërtetë të gjitha kërkesave të pranueshme do t'u jepet një seancë dëgjimore, "përveç nëse Gjykata me shumicë votash vendos ndryshe për shkaqe të arsyeshme të paraqitura." Pra, sipas asaj pjese të fjalisë, shumica e gjyqtarëve nuk munden thjesht t'i shmangen të drejtës së palëve për një proces gjyqësor, por duhet të tregojë arsye të mjaftueshme që justifikojnë vendimin e saj për të mos mbajtur një seancë dëgjimore.

2. Ndryshe nga Rregulla 39.1, që duket se e pranon të drejtën e palëve për seancë dëgjimore, pika e nisjes e paragrafit 2 të Rregullës duket të jetë që palëve nuk u jep të drejtën e tillë, por që Gjykata, me iniciativën e vet, mund të vendosë të mbajë një seancë dëgjimore *"në qoftë se beson që një seancë dëgjimore është e nevojshme për të sqaruar provat"*. Pra Rregulla 39.2 duket se i lënë Gjykatës të mbajë një seancë edhe para se të shpallet kërkesa e pranueshme, vetëm me kusht që ajo duhet të besojë se është e nevojshme një seancë dëgjimore.

Për më tepër, për të shtuar hutinë, neni 20.2 i Ligjit përcakton se është vetëm në diskrecionin e Gjykatës për të mos mbajtur seancë dëgjimore, por për të vendosur çështjen në bazë të shkresave të lëndës.

E drejta procedurale për të urdhëruar një seancë dëgjimore, që kjo Rregull i atribuon Gjykatës, krejtësisht devijon nga parimi i neneve 20.1 dhe 20.2 të Ligjit që në mënyrë eksplicite i atribuojnë të drejtën për seancë dëgjimore palëve. Kjo nënkupton që kjo rregull nuk është me sa duket në përputhje me ligjin dhe duhet që të amendohet, përveç nëse nenet 20.1 dhe 20.2 të Ligjit janë amenduar në mënyrë të përmendur më lartë.

Për t'i shtuar tutje këtij konfuzioni, neni 22.9 i Ligjit, që do të komentohet në tekstin e mëtejmë, përcakton se, kur çështja i referohet Gjykatës (në qoftë se Kolegji Shqyrtues konkludon që kërkesa është e pranueshme ose në qoftë se një apo më shumë gjyqtarë që nuk janë në Kolegjin Shqyrtues e kundërshtojnë propozim-vendimin për refuzimin e kërkesës), do të merr parasysh *"* lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës *në seancën verbale"*. Kështu, neni sugjeron që, kur çështja t'i referohet Gjykatës për arsyet e treguara, Gjykata automatikisht do të organizojë një seancë dëgjimore, ku konsideron lejueshmërinë dhe meritat e kërkesës dhe vetëm vendos për to", pas përfundimit të seancës dëgjimore", siç është përcaktuar me nenin 20.1 të Ligjit. Rregulla 39.1, megjithatë, mundëson që *"Vetëm kërkesave të përcaktuara si të pranueshme"* mund t'u jepet një seancë dëgjimore, domethënë që Gjykata se pari duhet të përcaktojë që një kërkesë është e pranueshme, para se të mundësojë seancë dëgjimore.

Në fakt, praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës tregon se dëgjimet gojore nuk janë rregull, por më tepër përjashtim. Madje, edhe në rastin ku Gjykata duhej të vendoste mbi çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës kishte kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës (neni 113.6 i Kushtetutës), procedura është kryer vetëm në bazë të shkresave të lëndës.[291] Megjithatë, duhet cekur që Presidenti nuk ka kërkuar një përjashtim. Në kontekstin gjerman në rast të një

[291] Shih Pikën 33 dhe 34 të KI 47/10 Mendimi mospajtues Gjyqtare Snezhana Botusharova dhe Gjyqtar Almiro Rodrigues, në dispozicion në: http://www.gjkks.org/repository/docs/ki_47_10_mendimi_mospajtues_gjyqtarja_snezhana_botusharova_dhe_gjyqtari_almiro_rodrigues.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

procedure të impeachment-it të Presidentit të Gjermanisë, dëgjimi publik është i detyrueshëm, siç është përcaktuar me nenin 55 (1) të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese Gjermane.

Rregulli 56 [Llojet e vendimeve] i Rregullores së punës

Gjykata miraton këto lloje të vendimeve:

(1) Aktgjykimet, kur Gjykata vendos në bazë të meritave të një kërkese;
(2) Aktvendimet, kur vendos për pranueshmërinë e një kërkese;
(3) Vendimet, kur Gjykata vendos përkitazi me kërkesat për masë të përkohshme;
(4) Vendimet administrative, sa herë që Gjykata vendos në séance administrative për çështje administrative; dhe
(5) Urdhra të tjerë të atillë që kohë pas kohe konsideron si të duhur.

I. Vetëm pasi parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kërkesat procedurale për pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata do të deklarojë kërkesën të papranueshme dhe do ti gjykojë meritat e kërkesës në formën e aktgjykimit. Kriteret e pranueshmërisë janë të përcaktuara në Rregullën 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së Punës.

II. Shumica e kërkesave nuk e kalojnë fazën e pranueshmërisë, sepse parashtruesit e kërkesave nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për të mundësuar që Gjykata të marrë parasysh meritat e kërkesës. Në ato raste, Gjykata do të lëshojë një Aktvendim për Papranueshmëri, duke përcaktuar arsyet e papranueshmërisë. Kur një kërkesë të shpallet e pranueshme, Gjykata, normalisht, nuk lëshon një Vendim të veçantë mbi Pranueshmërinë, pasi që vendimi për shpalljen e pranueshme të kërkesës është i inkorporuar në aktgjykim[292]

III. Rregulla 55 [Vendimi për masa të përkohshme] parashtron detajet e kësaj procedure për t'u ndjekur nga Gjykata, kur vendoset mbi një kërkesë për masa të përkohshme. Duket se në disa raste [293] Gjykata ka trajtuar kërkesën për masa të përkohshme jo në një vendim të veçantë siç kërkohet në rregullën 56.3, por vetëm në Vendimin mbi Papranueshmërinë e Kërkesës, që do të thotë shumë më vonë se brenda afatit të kërkuar nga Rregulla 55.

IV. Rregulla duhet të shihet në kuadrin e Rregullës 14 [Seancat Administrative] të Rregullores së Punës. Vendimet administrative janë vendimet e marra me shumicën e votave të gjyqtarëve në seancat administrative ku diskutojnë dhe vendosin për çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës.

---

[292] Shih Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në dispozicion në http://www.gjk-ks.org/?cid=2,57, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[293] Shih, për shembull, Rastin nr. KI 124/13, NLB Prishtina (sh.a) me seli në Prishtinë, Aktvendimi i 11 tetorit 2013. BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2013. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2014.

V. Si një shembull i Urdhrit tjetër të tillë, i bëhet referencë Rregullës 51 [Dokumentet], paragrafi 4, ku pala mund të paraqesë një kërkesë në Gjykatë duke kërkuar një Urdhër të adresuar palës tjetër për të prodhuar një dokument të caktuar; ose Rregullës 52 [Inspektimi i vendit të ngjarjes ose i objektit], paragrafi 3, sipas të cilit pala mund të parashtrojë kërkesë në gjykatë për një Urdhër me të cilin kërkon që një personi, që nuk është palë në procedurë, t'i lejohet qasje në vendngjarjen ose objektin që do të ekzaminohet.

Rregulli 57 [Përmbajtja e vendimeve] i Rregullores së punës

57.1 Aktgjykimet, aktvendimet, vendimet ose urdhrat e tjerë të Gjykatës Kushtetuese do të përmbajnë minimumin e të dhënave, si në vijim: emrat e gjyqtarëve të Gjykatës; një hyrje, një deklaratë për bazën juridike për vendosje të rastit; një deklaratë që përmban arsyetimin e Gjykatës; dhe dispozitat operative.

57.2 Deklarata e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, që miraton aktgjykimin, aktvendimin, vendimin ose urdhër tjetër, do të theksojë rezultatin e votimit dhe emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që kanë paraqitur mendime të tjera.

57.3 Pjesa hyrëse do të theksojë emrat e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë ose të personave të autorizuar nga palët, nëse ka, datën e seancës publike, nëse është mbajtur, dhe datën e seancës kur është miratuar vendimi.

57.4 Deklarata që përmban arsyetimin e Gjykatës do të ketë një përmbledhje të fakteve dhe të pretendimeve të pjesëmarrësve në procedurë dhe arsyet për vendimin e Gjykatës.

57.5 Dispozitat operative do të theksojnë mënyrën e zbatimit të aktgjykimit, të aktvendimit, të vendimit ose të urdhrit tjetër, datën e hyrjes në fuqi të vendimit dhe palën të cilës i dorëzohet vendimi.

I. Vendimet mbi masat e përkohshme, të përmendura në Rregullën 56.3, janë përjashtuar nga Rregulla 57, domethënë që vendimet e tilla nuk kanë nevojë të përmbushin kërkesat e paraqitura aty. Sa i përket "detajeve minimale", që një Aktgjykim, Vendim apo Urdhrat e tjerë të Gjykatës do të përmbajnë, janë të specifikuara në paragrafët 2 deri në 5 të Rregullës. Kështu, detajet e "*emrave të Gjyqtarëve të Gjykatës"* janë të përcaktuara në Rregullën 57.2, ndërsa detajet e *"hyrjes"* gjenden në Rregullën 57.3. Për më tepër, detajet e *"deklaratës që përmban arsyetimin e Gjykatës"* janë dhënë në Rregullën 57.4 dhe ato të *"dispozitave operative"* në Rregullën 57.5. Nuk ka asnjë paragraf të veçantë të Rregullës që merret me detajet e *"deklaratës për bazën juridike për vendosje të rastit"*, e cila është përmendur gjithashtu në Rregullën 57.1.

II. Për sa i përket rezultatit të votave, kur nuk ka unanimitet në mesin e gjyqtarëve, praktika e Gjykatës duket të jetë që rezultati i saktë i numrit të gjyqtarëve që votuan pro dhe numrit të gjyqtarëve që votuan kundër nuk tregohet gjithmonë, por në vend të kësaj përdoret vetëm fjala "me shumicën". Pra, në këto raste, palët dhe publiku nuk informohen për numrin e saktë të gjyqtarëve që votuan pro dhe atyre

që votuan kundër vendimit. Në çdo rast, emrat e gjyqtarëve që votuan pro ose kundër, deri më tani, nuk janë përmendur asnjëherë në asnjërin nga vendimet.
Mirëpo, vetëm kur gjyqtari e bën përdorimin e të drejtës së tij / saj që të ketë emrin e tij / saj të treguar (1) në një vendim për masë të përkohshme që ai / ajo votoi kundër masës së përkohshme të rënë dakord nga ana e Gjykatës (shih Rregullën 58.2 më lartë), ose (2) në aktvendimin e Gjykatës mbi pranueshmërinë e kërkesës (shih Rregullën 58.3 më lartë) që ai / ajo nuk pajtohet me vendimin, dhe (3) në një aktgjykim (nëse ai / ajo nuk dëshiron të shkruaj një mendim të ndarë), palët dhe publiku do të mësojnë emrat e gjyqtarëve, të cilët votuan kundër vendimeve në fjalë.

III. Në praktikë, vendimet e gjykatave, në paraqitjen e tyre, përmbajnë titujt e ndryshmëm nën të cilët janë përmendur çështjet e Rregullës 57.3. Për shembull, emri i parashtruesit të kërkesës dhe personit të autorizuar, nëse ka, janë përmendur nën "Aplikuesi", ndërsa pala reaguese shfaqet nën "Pala Reaguese". Data e dëgjimit publik, nëse është mbajtur, emrat e palëve që u shfaqën si dhe data e shqyrtimeve dhe e miratimit të vendimit, së bashku me informacione të tjera në lidhje me emërimin nga Kryetari i Gjyqtarit Raportues dhe anëtarëve të kolegjit shqyrtues, si dhe informacioni për komunikimet me palët do të paraqitet nën titullin "Procedura para Gjykatës". Në rast se palët e interesuara, dëshmitarët dhe ekspertët, si dhe amicus curiae, nëse ndonjë është i pranishëm në seance dëgjimore, emrat e tyre do të ceken nën titullin "Procedura para Gjykatës"[294].

IV. Një përmbledhje e qartë dhe koncize e fakteve dhe pohimeve të palëve është e një rëndësie të madhe për të kuptuar mirë kërkesën dhe ngjarjet të cilat kanë çuar që çështjet të ngriten në bazë të Kushtetutës. Këto janë përmendur nën tituj të ndryshëm, "Përmbledhja e fakteve" dhe, "Pretendimet e Parashtruesit (ose Palëve sipas rastit)", respektivisht. Pra, përmbledhjet e tilla jo vetëm që e shërbejnë Gjykatën në gjykimin kushtetues të kërkesave, por gjithashtu publikun, për të kuptuar lehtë historikun e rastit dhe të argumenteve më të rëndësishme të paraqitura nga palët
Është njëlloj e rëndësishme që vendimi i Gjykatës të jetë i arsyetuar mirë për të siguruar palët dhe publikun që gjyqtarët e Gjykatës kanë kryer funksionin e tyre "me ndërgjegje dhe paanshmëri," në pajtim me detyrimin e tyre sipas nenit 10 [Detyrat e gjykatësit] të Ligjit (shih komentet më lartë). Nëse arsyetimit i mungon qartësia dhe bindja, Gjykata rrezikon të humb kredibilitetin e saj.

V. Për sa i përket dispozitave operative të Aktgjykimit, Vendimit apo Urdhrit tjetër, ato të një Aktgjykimi nuk janë të njëjta si ato të një Vendimi apo Urdhri. Në fakt, pjesa operative e Aktgjykimeve që kanë fuqi obliguese për palët në kërkesë, thekson mënyrën e zbatimit të tyre nga ana e palës ose palëve, ndërsa pjesa operative e Vendimit apo Urdhrit tjetër nuk kërkon ndonjë zbatim të veçantë nga një palë apo palët, por përmend veprimet të cilat gjykata do të ndërmarrë vetë, duke deklaruar, për shembull, që do të njoftojë palët për vendimin, dhe e publikon këtë në Gazetën Zyrtare.

[294] Shih, për shembull, Rastin nr. KO 01/09, Qemajl Kurtishi kundër Kuvendi Komunal i Prizrenit, Aktgjykimi i 18 marsit 2010, *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2009 – 2010*,. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2011.

Deri tani, Gjykata me sa duket nuk ka dhënë ndonjë Urdhër, por më tepër Vendime, në veçanti, me kërkesë të një pale për masa të përkohshme. Vendimet e tilla vërtetë mund të përmbajnë një Urdhër, si, për shembull, në Rastin KI 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundrejt Kuvendit Komunal të Prizrenit, ku Gjykata, pasi kishte pranuar kërkesën për masë të përkohshme për një kohëzgjatje jo më shumë se 3 muaj nga data e vendimit, menjëherë e pezulloi ekzekutimin e "Vendimit për Amendimin dhe Plotësimin e Vendimit të Planit të Detajuar Urban (PZHU) të Zonës Jaglenica në Prizren, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 30 prill 2009 [...], për të njëjtën kohëzgjatje dhe "urdhëroi" Kuvendin Komunal të Prizrenit që të pezullojë çdo ndërtim në lokacionin e mësipërm për të njëjtën kohëzgjatje[295]

Në pjesën operative të vendimit, Gjykata gjithashtu tregon kur Aktgjykimi, Vendimi ose Urdhri do të hyjë në fuqi. Në bazë të nenit 20.5 të Ligjit (shikoni komentet më lartë), një vendim botohet në Gazetën Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë, përveç nëse Gjykata vendos ndryshe.

Përveç që iu dorëzon vendimin palëve, gjykata mund të vendosë ti njoftojë për vendimin e saj pjesëmarrësit e tjerë në procedurë përveç palëve, për shembull, ata që ishin ftuar nga Gjykata për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore me palët.

Në lidhje me komentet e mësipërme mbi nenin 20 të Ligjit dhe Rregullat 56 dhe 57 të Rregullores së Punës, do jetë gjithashtu e duhur të komentohet këtu për Rregullën 60 [Teksti Përfundimtar i Aktgjykimit dhe Arkivimi] të Rregullores së Punës.

Rregulli 60 [Teksti përfundimtar i aktgjykimit dhe arkivimi] i Rregullores së punës

60.1 Teksti përfundimtar i një vendimi të miratuar nga Gjykata përgatitet nga Gjyqtari raportues. Nëse Gjyqtari raportues nuk pajtohet me aktgjykimin, ose me kryesuesin e Kolegjit shqyrtues, dhe voton kundër masës së përkohshme, Kryetari përcakton një gjyqtar tjetër i cili ka votuar me shumicën për të përgatitur aktgjykimin ose vendimin e Gjykatës.

60.2 Gjyqtari, i cili përgatit aktgjykimin, aktvendimin ose vendimin e Gjykatës, përfshirë edhe vendimin për masë të përkohshme, duhet të finalizojë tekstin e aktgjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është përcaktuar nga Gjykata, nga data e miratimit nga Gjykata. Teksti përfundimtar u dorëzohet gjyqtarëve për rishikim dhe secili gjyqtar mund t'i japë komentet e veta brenda pesë (5) ditësh. Pasi të shqyrtohet nëse do të bëhen ose nuk do të bëhen ndryshimet e sugjeruara nga gjyqtarët e tjerë, gjyqtari, i cili e përgatit aktgjykimin e Gjykatës, i bën ndryshimet e nevojshme. Teksti përfundimtar u dorëzohet gjyqtarëve, të cilët mund të takohen për të miratuar versionin përfundimtar, ose ndryshe mund të përcaktohen për miratimin e versionit përfundimtar të tekstit. Pas miratimit përfundimtar nga gjyqtarët, teksti përfundimtar dorëzohet për nënshkrim, për arkivim dhe për dorëzim te palët.

[295] Vendimi mbi Kërkesën për Masa të Përkohshme të 25 nëntor 2009.

60.3 Gjyqtarët, që përgatisin mendim mospajtues ose konkurrues, duhet ta finalizojnë tekstin e mendimeve të tyre brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i tekstit përfundimtar te Kryetari. Për aq sa është e mundur, mendimet e tilla do të arkivohen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe do t'u dërgohen palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin e Gjykatës.

I. Titulli i Rregullës është, me sa duket, i pasaktë, pasi Rregulla merret jo vetëm me tekstin përfundimtar dhe paraqitjen e një vendimi, por edhe me një vendim mbi kërkesën për masa të përkohshme. Fjalia e parë e Rregullës 60.1 merret ekskluzivisht me përgatitjen e tekstit përfundimtar të aktgjykimit e cila konfirmohet duke iu referuar Rregullës 44 (Këshillim dhe Votim) që rregullon rrjedhojën e një seancë dëgjimore dhe siguron, në paragrafin 4 të saj, se *"Pas votimit, nëse Gjyqtari raportues është në mesin e shumicës së Gjykatës, Kryetari do ti caktojë Gjyqtarit Raportues detyrën e përgatitjes së tekstit përfundimtar të Vendimit të Gjykatës."* Pra, në këtë aspekt Rregulla 60.1 dhe Rregulla 44.4 janë të ngjashme.

Megjithatë, në qoftë se gjyqtari raportues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë cilindo gjyqtar në mesin e shumicës në Kolegjin Shqyrtues (që e deklaroi rastin të pranueshëm) për të përgatitur propozim-vendimin, dhe që, në qoftë se asnjë anëtar i Kolegjit Shqyrtues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë *"cilindo gjyqtar i cili është në mesin e shumicës"* për të përgatitur një propozim-vendim të Gjykatës. Rregulla 60.1 ka një zgjidhje më të drejtpërdrejtë, thjesht duke siguruar se nëse gjyqtari raportues është mospajtues me Aktgjykimin, Kryetari do të caktojë "cilindo gjyqtar i cili është në mesin e shumicës" të përgatisë aktgjykimin e Gjykatës

Rregulli 60.1, megjithatë, gjithashtu përmend gjendjen në të cilën kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues voton kundër kërkesës për masa të përkohshme. Gjithashtu në këtë rast, Rregulla 60.1 parasheh që Kryetari i Gjykatës do të caktojë një Gjyqtar tjetër, që votoi me shumicën, të përgatisë vendimin e Gjykatës. Në lidhje me këtë, mund të ketë nevojë të shpjegohet, se çfarë Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues duhet të bëjë me një kërkesë për masa të përkohshme. Siç përcaktohet në Rregullën 55 [Vendimi mbi masa të përkohshme], paragrafi 2,[296] Kryetari do të caktojë kërkesën për masë të përkohshme për Kolegjin Shqyrtues në referimin. Nëse Kolegji Shqyrtues i rekomandon Gjykatës së plotë që kërkesa për masa të përkohshme duhet të epet, qoftë në tërësi apo pjesërisht, vendimi i Kolegjit Shqyrtues do të deklarojë arsyet që mbështesin rekomandimin (Rregulli 55.5, fjalia e parë[297]) dhe se si është përmbushur standardi juridik, dhe duhet të deklarojnë kohën e kufizuar në të cilën masat e përkohshme do të jenë efektive.

Në bazë të Rregullës 35 [Kolegjet shqyrtuese], paragrafi 5, është kryesuesi i trupit gjykues të Kolegjit Shqyrtues, që do të përgatisë atë propozim- rekomandim

[296] Rregulla 55 (2) i Rregullores së Punës parasheh si më poshtë*: Kryetari do të caktojë kërkesën për masë të përkohshme tek Kolegji Shqyrtues të caktuar për referimin [...].*

[297] Rregulla 55 (5), fjalia e parë ofron*: Nëse pranohet kërkesa për masa të përkohshme (*Rregulli duhet të ketë përdorur termin "rekomanduar" si në nën-paragrafin e mëparshëm*), ose në tërësi ose pjesërisht, vendimi i Kolegjit të Shqyrtimit do të deklarojë arsyet që mbështesin vendimin (*përsëri është dashur të përdoret termi "rekomandimi*") [...]*

Gjykatës. Pra, nëse ai / ajo voton kundër masave të përkohshme, Kryetari duhet të shoh për ndonjë alternative tjetër. Në këtë rast, zgjidhja e Rregullës 44.4 është që Kryetari të përcaktojë ndonjë gjyqtar në mesin e shumicës së Kolegjit Shqyrtues për të përgatitur një propozim-vendim. Sidoqoftë, mund të ndodhë, që asnjë anëtar i Kolegjit Shqyrtues të mos jetë në mesin e shumicës së Gjykatës. Në këtë rast, sipas Rregullës 44.4, Kryetari cakton çdo gjykatës që është në mesin e shumicës së Gjykatës për hartimin e vendimit të Gjykatës.

Megjithatë, Rregulla 60.1 duket se nuk është në harmoni me Rregullën 44.4 mbi këtë çështje, pasi që vetëm siguron se, nëse Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues voton kundër masave të përkohshme, Kryetari i Gjykatës përcakton një tjetër gjyqtar nga shumica e Gjykatës për të përgatitur vendimin e Gjykatës. Sugjerohet që rregullat të sillen në përputhje me njëra-tjetrën me një amendament të ardhshëm të Rregullores.

II. Edhe pse Rregulla nuk vendos një afat kohor për përgatitjen e propozim-tekstit të një aktgjykimi, aktvendimi apo vendimi (pasi kjo do të varet në masë të madhe nga kompleksiteti i rastit) nga ana e gjykatësit hartues, kërkon që Gjykata, sapo të ketë miratuar aktgjykimin, të përcaktojë një periudhë të arsyeshme kohore për t'i mundësuar gjyqtarit ta finalizojë tekstin e aktgjykimit. Pasi që teksti përfundimtar t'i jetë dorëzuar gjyqtarëve të tjerë, ata kanë një periudhë prej 5 ditësh, brenda të cilit ata mund të dorëzojnë komente për të.

Afati kohor prej pesë (5) ditësh mund të konsiderohet mjaft i shkurtër, veçanërisht, kur krahasohet me atë të përmendur në nenin 22 [Procedimi i kërkesës], paragrafi 8, i ligjit, ku, në rast të një propozim-rekomandimit të Kolegjit Shqyrtues,[298] afati kohor për gjyqtarët, të cilët nuk janë anëtarë të Kolegjit Shqyrtues, t'i paraqesin komentet mbi propozim-rekomandimin me afat kohor prej (10) ditësh nga marrja e propozim-vendimit. Duket se është e padrejtë t'i lihet gjyqtarëve dy herë më shumë kohë për të komentuar një propozim- rekomandim të Kolegjit Shqyrtues se sa për të komentuar mbi një propozim-aktgjykim që mund të jetë shumë më i komplikuar dhe i shtjelluar.

Rregulli 60.2, fjalia e tretë, më tej ngarkon me detyrë gjyqtarin që e bënë përgatitjen e aktgjykimit, aktvendimit apo vendimit të Gjykatës që të bëjë ndryshimet e nevojshme në draft në bazë të komenteve të gjyqtarëve të tjerë dhe të paraqesë draftin edhe një herë tek gjyqtarët për miratim në një takim, siç është, për shembull, rregulla për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, që me sa duket e përshkojnë vetë draftin e tekstit fjalë për fjalë para miratimit të aktgjykimit. Rregulla më tej përcakton që në qoftë se nuk mbahet mbledhja për të miratuar versionin përfundimtar, gjyqtarët mund që "përndryshe" ta miratojnë atë, me sa duket me thirrje telefonike, e-mail ose mesazh në tekst.

Fjalia e fundit e Rregullës duket se nuk është precize, pasi që teksti final i miratuar do të nënshkruhet jo vetëm nga Kryetari, por, në bazë të nenit 20.3 më lartë, edhe

[298] Neni 22.8 përcakton: "Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve prej pranimit të propozim-vendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozim-vendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë."

nga gjyqtari raportues. Teksti është i heshtur në pyetjen nëse,/ në rast se një tjetër gjyqtar caktohet nga Kryetari për të përgatitur aktgjykimin, aktvendimin apo vendimin, nëse gjyqtari do të nënshkruajë tekstin përfundimtar në vend të gjyqtarit raportues origjinal. Megjithatë, në atë rast do të ishte e logjishkme që të shmanget nga ky kusht, pasi përndryshe Gjyqtari raportues do të duhet të nënshkruajë një aktgjykim me të cilin ai / ajo nuk pajtohen në radhë të parë.
Për më tepër, Sekretari i Përgjithshëm jo vetëm që do të paraqesë vendimin e nënshkruar dhe t'ia servojë atë palëve siç e parasheh Rregulla, por gjithashtu e vendos atë menjëherë në faqen e Gjykatës dhe e dërgon atë në Gazetën Zyrtare për botim zyrtar.

III. Ndryshe nga rekomandimet e Komisionit të Venedikut të përmendura më lart që mendimet e ndara të gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese duhet të botohen së bashku me aktgjykimin, Rregulla 60.3 është fleksibile në lidhje me këtë në të njëjtën mënyrë si Rregulla 58 [Mendimet mospajtuese] dhe 59 [Mendimet konkurruese]. Kjo tregohet nga fakti i thjeshtë që Rregulla thotë se " *mendimet e tilla do të arkivohen, për aq sa është e mundur, nga Sekretari i Përgjithshëm në të njëjtën kohë dhe do t'u dërgohen palëve me aktgjykimin e Gjykatës*." Pra, mund të ndodh që mendimet e ndara nuk mund të arkivohen në të njëjtën kohë ", *si dhe me aktgjykimin"* dhe, për këtë arsye, mund të mos i dërgohet palëve me aktgjykimin. Kjo do t'i mundësonte Gjykatës t'i trajtojë mendimet e tilla si pjesë integrale të aktgjykimeve dhe t'i publikojë ato në një fazë të mëvonshme. Në raste të tilla, mendimet e ndara mund të mos marrin të njëjtën vëmendje të publikut siç do të kishin marrë po të ishin botuar së bashku me aktgjykimin. Shikuar ato në kontekstin e drejtpërdrejtë të aktgjykimit, veçanërisht pasi të lexohet, së pari teksti integral i aktgjykimit, mund të të çojë në të kuptuarit më të mirë të mendimeve mospajtuese dhe konkurruese të gjyqtarit (ve) në fjalë.

Neni 21 [Përfaqësimi]

Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.

Si versioni shqip, ashtu edhe anglisht i nenit është disi i paqartë. Me "procesin në Gjykatën Kushtetuese" është menduar ndoshta: "procedurat para Gjykatës Kushtetuese". Dispozita nuk i detyron palët në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të përfaqësohen nga një përfaqësues i autorizuar sipas rregullës, jo domosdoshmërisht një avokat, pasi që mund të jetë pengesë për shumë aplikantë për të paguar shpenzimet e një avokati. Në anën tjetër, përfaqësimi i detyrueshëm nga një avokat mund të konsiderohet si një mohim i të drejtës për qasje në gjykatë kushtetuese, në veçanti, në qoftë se një palë nuk disponon me fonde të nevojshme për një përfaqësim të tillë. Në çdo rast, përfaqësimi nga një avokat mund të ndihmojë në masë të madhe një palë para Gjykatës me atë që cilësia e kërkesës të mund të përmirësohet duke bërë të mundur që Gjykata të kuptojë më mirë rastin (shih edhe komentet në nenin 22.1 të Ligjit këtej pas).

Vendet e ndryshme kanë preferuar për zgjidhje të ndryshme.[299] Për shembull, në procedurën para Gjykatës Federale Kushtetuese në Gjermani, përfaqësimi nga një avokat, në parim, nuk është i detyrueshëm.[300] Megjithatë, në rrethana të veçanta, të tilla si në një seancë të shqyrtimit verbal, nga pala kërkohet që të përfaqësohet me një avokat, apo një profesor i drejtësisë nga një institucion arsimit të lartë.[301] Sistemi i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane mund të jetë i dobishëm për procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, sidomos, pasi që Kosova duket të jetë një vend i favorshëm për të pasur qasje efektive në drejtësi, në bazë të legjislacionit progresiv për ndihmë juridike falas. Megjithatë, Ligji për Ndihmë Juridike Falas (Ligji Nr. 04/L-017 i 2 shkurt 2012) parashikon në nenin e tij 4 [Shtrirja dhe llojet e ndihmës juridike falas], paragrafi 2, se *"Ndihma juridike falas do të ofrohet në procedurë civile, administrative, kundërvajtje dhe procedurë penale"* dhe, për këtë arsye, nuk i mundëson aplikuesit perspektivë të kërkojnë ndihmën falas të një avokati për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Duke e amendamenduar Ligjin, ndihma juridike falas mund të përjashtohet në procedurat para Gjykatës, në veçanti, tek rastet komplekse. Përndryshe, vet Gjykata mund të miratojë një Rregull për këtë qëllim.

I. Rregulli 35.1 përcakton vetëm se caktimi i gjykatësit kryesues, i cili do të kryesojë Kolegjin Shqyrtues, do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores 9.2 komentuar më sipër).

[299] Më shumë rreth dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore për përfaqësim ligjor në Gjykatat Kushtetuese, shih: Study on Individual Access to Constitutional Justice. Adopted by the Venice Commission at its 85th Plenary Session (Venice, 17-18 December 2010). On the basis of comments by Mr Gagik Harutyunyan (Member, Armenia), Ms Angelika Nussberger (Substitute Member, Germany), Mr Peter Paczolay (Member, Hungary). Published by the Center of the Constitutional Law RA, 2012, p. 268.h http://www.venice.coe.int/WebForms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2010)039rev-e (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[300] Shih nenin 22 të Ligjit pnin 22 të Kushtetuese tt□憶jermanistue (Gesetz über das Bundesverfassungsgericht). http://www.iuscomp.org/gla/statutes/BVerfGG.htm, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[301] Idem.

Neni 22 [Procedimi i kërkesës]

22.1 Fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kërkesat dorëzohen me shkrim në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria regjistron menjëherë të gjitha kërkesat në regjistrin e Gjykatës Kushtetuese sipas radhës në të cilën janë parashtruar. Kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet të ju bashkëngjiten provat e nevojshme.

22.2 Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Pala kundërshtare ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të dorëzuar në Sekretari përgjigjen e saj në kërkesë së bashku me arsyetimin dhe provat e nevojshme.

22.3 Sekretari ia dërgon kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë gjyqtarit raportues i cili përgatit raportin paraprak lidhur me faktet, lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës. Gjyqtari raportues caktohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

22.4 Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

22.5 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë gjyqtari raportues ia dërgon kolegjit shqyrtues raportin paraprak. Në rast se përgjigja në kërkesë nuk dorëzohet brenda afatit të paraparë ose sipas natyrës së procedurës së veçantë nuk kërkohet një përgjigje në kërkesë, gjyqtari raportues përgatit raportin paraprak vetëm në bazë të kërkesës.

22.6 Kolegji shqyrtues vlerëson lejueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues përbëhet nga tre gjyqtarë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës.

22.7 Nëse kolegji shqyrtues unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e lejueshme, kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë. Kolegji shqyrtues merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të siguroj se kopja e propozim-vendimit u është dërguar gjyqtarëve që mund të mos jenë në territorin e Republikës së Kosovës.

22.8 Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve prej pranimit të propozim-vendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozim-vendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë.

22.9 Në rast se kolegji shqyrtues vjen në përfundim se kërkesa është e lejueshme apo nëse të paktën njëri prej gjyqtarëve që nuk ka qenë anëtar i kolegjit shqyrtues kundërshton propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa, lënda i dërgohet trupit gjykues. Trupi gjykues gjatë shqyrtimit verbal shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 22 i Ligjit zbaton nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, duke përcaktuar në detaje procedurën në bazë të së cilës Gjykata Kushtetuese do t'i gjykojë rastet të cilat i paraqiten asaj në mënyrë ligjore nga palët e autorizuara të përmendura në nenin 113.[302] Paragrafët e këtij neni plotësohen me Rregulloren e Punës të Gjykatës, e cila do të komentohet në mënyrë të detajuar pas komenteve të dhëna për nenin 22.9.

1 Sipas fjalisë së parë të nenit 22.1, procedura para Gjykatës mund të iniciohet vetëm përmes kërkesës, pa hyrë në detaje lidhur me atë se çka nënkupton kërkesa por se kush mund të parashtrojë kërkesë pranë Gjykatës. Përgjigjet në këto pyetje mund të gjenden në nenin 113 të Kushtetutës [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 1 i cili përcakton se "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar." Nenet 113.2 deri 113.9 të Kushtetutës përcaktojnë më tej se cilat janë palët e autorizuara të cilat mund të ngrejnë çështje para Gjykatës Kushtetuese, si dhe rrethanat në të cilat mund ta bëjnë këtë[303]. Palë të tilla të autorizuara, sipas renditjes në nenin 113, janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, individët (dhe personat juridikë[304]), gjykatat dhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Disa prej palëve të tilla të autorizuara gjithashtu kanë të drejtë të parashtrojnë në Gjykatë kërkesa në bazë të neneve tjera të Kushtetutës, siç është për shembull Presidenti i Republikës së Kosovës, i cili, në bazë të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 9, të Kushtetutës "mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese." Për më tepër, Qeveria e Kosovës, sipas nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafi 10, të Kushtetutës ka kompetenca identike me ato të përshkruara për Presidentin në nenin 84.9, duke qenë se e njëjta "mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese," si dhe Avokati i Popullit, i cili sipas nenit 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], paragrafi 4, të Kushtetutës "ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute." Autorizimet shtesë të këtyre palëve të autorizuara për të referuar çështje para Gjykatës sipas neneve të lartpërmendura të Kushtetutës trajtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë pas komenteve mbi nenin 54 të Ligjit, nën titullin: "Shembuj tjerë të qasjes së drejtpërdrejtë të autoriteteve publike në Gjykatën

[302] Neni 113.1 i Kushtetutës përcakton: "*Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*"

[303] Për më tepër detaje, shih në vijim komentet mbi Kapitullin III [Procedurat e Veçanta], nenet 29 deri 54 të Ligjit. Shih gjithashtu Komentin e Kushtetutës së Kosovës, nga Prof. Dr. Enver Hasani dhe Ivan Çukalloviq.

[304] Personat juridikë nuk përmenden në këtë nen si palë të autorizuara përkrah personave fizikë, por përmenden në nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili përcakton: "*Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*"

Kushtetuese, të cilët nuk përmenden në Kapitullin III [Procedurat e Veçanta] të Ligjit."

Një palë tjetër e autorizuar përmendet në nenin 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal] të Kushtetutës - Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete, i cili mund të parashtrojë një çështje në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të drejtpërdrejtë. Komentet mbi këtë janë dhënë nën titullin e përmendur në alinenë paraprake.

Rrjedhimisht, rregullat e përgjithshme procedurale të përcaktuara në nenin 22 (*lex generalis*) janë të zbatueshme për të gjitha procedurat e iniciuara nga "palët e autorizuara" të përmendura në nenin 113 dhe pjesët tjera të Kushtetutës. Devijimet nga këto rregulla të përgjithshme procedurale përcaktohen në nenet 29 deri 54 të Kapitullit III [Procedurat e Veçanta] të Ligjit (*lex specialis*) dhe do të komentohen në vijim.

Sipas fjalisë së dytë të nenit 22.1 kërkesat duhet të dorëzohen në formë të shkruar në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se parashtruesit e kërkesave duhet ta bëjnë këtë në ndërtesën e Gjykatës në Prishtinë. Nga Rregulla 29 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] kuptohet se parashtruesit lejohen që kërkesat t'i parashtrojnë personalisht (apo përmes përfaqësuesit të tyre ligjorë) në Sekretariatin e Gjykatës, por edhe përmes postës apo mjeteve tjera të komunikimit elektronik (shih për shembull, komentet për Rregullën 29 (5) më poshtë).

Fjalia e tretë e nenit 22.1 kërkon nga Sekretariati që menjëherë ta regjistrojë kërkesën në regjistrin e Gjykatës, sipas rendit të parashtrimit. Siç do të sqarohet në mënyrë më të detajuar më poshtë, Rregulla 28 [Fillimi i Procedurës] përcakton ngjashëm se *"Procedura para Gjykatës fillon me dorëzimin e kërkesës në Sekretariat. Pasi të jetë dorëzuar kërkesa, apo çfarëdo dokumenti fillestar, kërkesës i caktohet numri i regjistrimit të saj nga Sekretariati."* Kjo konfirmohet me Rregullën 30 [Regjistrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve" në të cilin thuhet se *"Sekretari i Përgjithshëm e regjistron kërkesën menjëherë pasi të jetë dorëzuar ajo, apo çfarëdo dokumenti, madje edhe në rastet kur kërkesa nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme. Sekretariati mban një listë kontrolluese të dokumenteve të nevojshme dhe mund të ndihmojë palët duke shpjeguar se çfarë mungon në kërkesë."* Kjo do të thotë se edhe një kërkesë me gjysmë faqeje do t'i mjaftonte Sekretariatit për ta regjistruar atë si kërkesë pranë Gjykatës, duke e hapur lëndën dhe duke i vënë asaj numrin regjistrues. Siç do të shihet më vonë, Sekretariati, Gjyqtari Raportues, Kolegji Shqyrtues dhe vetë Gjykata mund të kërkojnë nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësojë lëndën.

Fjalia e katërt e nenit 22.1 nënkupton se për të përkrahur ankesat e tyre kushtetuese, parashtruesit e kërkesës duhet të japin një përshkrim të qartë të fakteve, të parashtrojnë të gjitha dokumentet e domosdoshme përkrahëse dhe informatat tjera, si dhe të dëshmojnë se i kanë plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë (shih posaçërisht komentet mbi Rregullën 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] më poshtë). Nëse një parashtrues i kërkesës nuk u përmbahet këtyre kërkesave, Gjykata mund ta shpallë kërkesën të papranueshme apo, edhe nëse e konsideron kërkesën të pranueshme, mund t'i konsiderojë informatat e

parashtruara si të pamjaftueshme për të gjetur shkelje të Kushtetutës që pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.

Rrjedhimisht, pasi që të jetë tejkaluar pengesa e pajtueshmërisë, duhet të justifikohen pretendimet për shkeljet e mundshme të Kushtetutës. Sa më të mirë të jenë të paraqitura sqarimet dhe dëshmitë përkrahëse, aq më të lehtë do ta ketë Gjykata që t'i kuptojë faktet dhe të vendosë mbi ankesën kushtetuese në fjalë. Nëse faktet nuk janë të qarta apo të plota, apo janë të përmbledhura asisoj që Gjykata ta ketë të vështirë të kuptuarit e meritave të lëndës, gjasat e kërkesës për të rezultuar e suksesshme zvogëlohen dukshëm. Faktet që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me rastin, edhe pse parashtruesit të kërkesës mund t'i duken të rëndësishme, nuk do duhej përmendur pasi që të njëjtat mund të shkaktojnë konfuzion dhe t'ia vështirësojnë Gjyqtarit Raportues punën në hartimin e një Raporti Preliminar të qartë për Kolegjin Shqyrtues.

Për më tepër, dokumentet dhe informatat përkrahëse, të cilat i janë bashkëngjitur kërkesës, do duhej të përmbajnë të gjitha dëshmitë e domosdoshme, në bazë të së cilave Gjykata do duhej të bazojë gjetjen e vet mbi shkeljen e mundshme të Kushtetutës. Për shembull, nëse një individ në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës paraqet pretendim ankimor se Gjykata Supreme ia ka shkelur të drejtat kushtetuese të tij/saj duke refuzuar kërkesën e tij/saj për revizion të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (apo tani Gjykatës së Apelit në Prishtinë), ai/ajo duhet ta parashtrojë jo vetëm aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme por edhe vendimet paraprake të instancave më të ulëta.

Në parashtresat e tij/saj, parashtruesit e tillë gjithashtu do duhej t'u referohen rasteve të ngjashme të cilat janë trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese apo praktikave gjyqësore të GjEDNj-së, të cilat ai veç mund t'i ketë paraqitur para instancave më të ulëta gjatë procesit të shterjes së mjeteve juridike. Në raste të tilla, parashtruesi i kërkesës duhet t’i paraqesë si dokumente përkrahëse të gjitha vendimet gjyqësore relevante. Një shembull tjetër do të mund të ishte një komunë e cila e konteston kushtetutshmërinë e një akti të Qeverisë që ia zvogëlon të ardhurat, në bazë të nenit 113.4 të Kushtetutës. Në rast të tillë, komuna do duhej të parashtrojë jo vetëm tekstin e aktit të Qeverisë, por edhe ligjet apo aktet nënligjore në të cilat bazohet akti në fjalë, si dhe dëshmi bindëse se si e njëjta preket drejtpërdrejt nga akti dhe se si të hyrat e saj janë zvogëluar (apo do të zvogëlohen).

Sa i përket kushtit që kërkesa të jetë e arsyetuar, do të thotë që shkeljet e pretenduara të Kushtetutës të jenë të dëshmuara në parashtresat e parashtruesve të kërkesës, nga praktika ligjore e Gjykatës duket se kur kemi të bëjmë me ankesa kushtetuese individuale, nga parashtruesit e kërkesës nuk kërkohet medoemos të caktojnë nenin (nenet) e saktë të Kushtetutës apo Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) apo instrumenteve tjera ndërkombëtare juridike të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë (shih edhe komentet në nenin 48 më poshtë). Për shembull, do të mjaftojë të përmendet shkelja e pretenduar e të drejtës për gjykim të drejtë në substancë, pa e përmendur nenin përkatës të Kushtetutës dhe/ose të KEDNj-së ose instrumenteve tjera ndërkombëtare juridike. Megjithatë,

parashtruesit e kërkesës duhet të japin detaje mbi bazën sipas të cilës një akt konkret i një autoriteti publik ua ka mohuar ndonjë të drejtë.[305]
Neni 22.1 plotësohet me Rregullën 28 [Fillimi i Procedurës], Rregullën 29 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] dhe Rregulla 30 [Regjistrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve], të cilët komentohen në vijim.

2 Teksti i fjalisë së parë të nenit 22.2 specifikon se Sekretariati duhet t'i dërgojë kopje të kërkesës palës apo palëve kundërshtare ose pjesëmarrësve, pa përmendur ndonjë afat kohor të caktuar për këtë. Për arsye transparence dhe konsistence, hartuesit kanë mundur të përmendin një periudhë prej një jave apo jo më shumë se 15 ditësh, për t'u siguruar se Sekretariati nuk do të shkaktojë vonesa të paarsyeshme gjatë komunikimit të kërkesës tek palët kundërshtare dhe palëve dhe pjesëmarrësve tjerë të mundshëm.
Për më tepër, siç u përmend edhe më sipër, mund të ndodhë që të ketë raste kur nuk ekziston pala e kundërt, siç është rasti kur pretendimi kushtetues është i drejtuar kundër një vendimi gjyqësor, siç është aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendimi i parashtruesit të kërkuesit është refuzuar në shkallë të fundit. Fillimisht, Gjykata Supreme si autore e aktgjykimit të kontestuar, u konsiderua si palë kundërshtare në procedurat para Gjykata Kushtetuese, prandaj nga e njëjta u kërkua që t'i përgjigjet kërkesës në fjalë brenda afatit të caktuar ligjor. Megjithatë, Gjykata Supreme si duket kurrë nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë, por vetëm i është referuar aktgjykimit të sfiduar të saj, pa shtuar komente shtesë në arsyetimin e dhënë në të.[306]
Gjithashtu, në procedurat para gjykatave të rregullta do të ishte e vështirë që të imagjinohet, për shembull, se një gjykatë e shkallës së parë do të mund të obligohej nga gjykata e apelit që të sqarojë arsyet e saj për një aktgjykim të caktuar, për t'iu përgjigjur pyetjeve të gjyqtarëve të apelit. Kjo sigurisht se do të ishte në kundërshtim me parimin e "pavarësisë së gjyqtarëve" dhe "fshehtësisë së vendimeve gjyqësore", të cilave u janë përmbajtur gjyqtarët gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të kontestuar.
I njëjti parim do duhej zbatuar edhe lidhur me procedurat para Gjykatës Kushtetuese, asisoj që nga gjykatat e rregullta aktgjykimet e së cilave janë temë shtjellimi në kërkesa të mund të kërkohet nga Gjykata që të japin komentet e tyre dhe/ose të ftohen për të marrë pjesë në seanca para Gjykatës, por ato të lejohen të injorojnë këtë ftesë dhe t'i përmbahen parimit të "pavarësisë së gjyqtarit", sipas së cilit ata nuk duhet të japin llogari publike për gjykimet e tyre. Rrjedhimisht, në mungesë të komenteve nga gjykatat relevante të rregullta, i mbetet Gjykatës që të interpretojë vendimet e kontestuara gjyqësore sipas vlerësimit të saj.
Mund të jetë interesante që t'iu referohemi praktikave të vendeve tjera ku Gjykatat Kushtetuese kanë qasje të ngjashme apo të ndryshme ndaj kësaj çështjeje. Për shembull Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës i konsideron gjykatat e rregullta të cilat i kanë nxjerrë vendimet e kontestuara si palë kundërshtare në

[305] Shih, për shembull, Lëndën Nr. KI 20/09, Petrit Morina kundër Aktgjykimit Nr. 495/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 7 prill 2004, në të cilën Parashtruesi i Kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë.
[306] Po aty.

procedurat para saj.[307] Megjithatë, gjatë një seminari të organizuar nga Komisioni i Venedikut në Armeni, Prof. Luis Lopez Guerra, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese Spanjolle, deklaroi se nëse vendimi gjyqësor sfidohet para Gjykatës, palë kundërshtare në procedurën ankimore kushtetuese është pala kundërshtare në procedurën në të cilën është nxjerrë akti individual i kontestuar.[308]

Siç u përmend më sipër, gjykatat e rregullta kanë për obligim, në bazë të nenit 26 të Ligjit [Bashkëpunimi me Organet tjera Publike], që *"tç u përmend më sipër, gjykatat e rregullta kanë për obligim, në bazë të nenit 26 të Ligjit [Bashkëpunimi me O* njëjtë sikur autoritetet publike të Republikës së Kosovës. Megjithatë, siç thuhet edhe më sipër, kjo nuk duhet të interpretohet si obligim për gjykatat e rregullta që t'i dorëzojnë komentet e tyre dhe të marrin pjesë në seanca dëgjimore, nëse ftohen nga Gjykata për të bërë një gjë të tillë.

Është e vërtetë se një gjykatë e rregullt mund të pranojë ftesën e Gjykatës për të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Për shembull. Në Lëndën 06/10[309], Gjykata ftoi Gjykatën Komunale të Prishtinës në një seancë dëgjimore mbi lëndën në fjalë. Në këtë rast, Gjykata Komunale pranoi ftesën dhe u paraqit në seancë dëgjimore ku iu përgjigj pyetjeve të parashtruara nga gjyqtarët dhe dha një deklaratë. Në rrethana të tilla, do të ishte më e rrugës që gjykata e rregullt të konsiderohet pjesëmarrës në procedurë.

Në çfarëdo rasti, për arsye të transparencës, do të ishte gjithsesi e rrugës që Sekretariati t'ia dërgojë një kopje gjykatave që kanë nxjerrë vendimin e kontestuar, vetëm sa për ta informuar mbi pranimin e kërkesës dhe/ose kërkuar nga to që t'u përgjigjen pyetjeve teknike/administrative apo të parashtrojnë dokumente të caktuara dhe konfirmojnë data apo numra të caktuar të lëndëve. Për shembull, nga gjykata në fjalë do të mund të kërkohet të konfirmojë datën kur një parashtrues i kërkesës e ka nënshkruar pranimin e aktgjykimit të tij/saj. Kjo datë është e rëndësi për kalkulimin e kufirit kohor katërmujor brenda të cilit parashtruesi i kërkesës është dashur ta dorëzojë kërkesën në Gjykatë (për detaje të mëtejme, shih komentet për nenin 49 [Afatet] më poshtë).

Gjykata gjithashtu e ka ndryshuar qasjen e vet, duke mos e përmendur më në titullin e Kërkesës, për shembull: "X kundër Vendimit Nr. Y të Gjykatës Supreme" ose "X kundër Gjykatës Komunale të Podujevës".[310] Në vend të kësaj, titulli përmend vetëm vendimin (vendimet) e sfiduara të gjykatës (gjykatave) përkatëse, për shembull: "Parashtruesi i kërkesës X, shqyrtimi kushtetues i Vendimit Nr. Y të Gjykatës Supreme të datës..."[311].

---

[307] Shih nenin 15 (1) (b) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

[308] Ngjashëm me procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë (shih, Guide of the Constitutional Court of Slovenia, http://www.us-rs.si/en).

[309] Lënda KI 06/10, Parashtruesi i Kërkesës Valon Bislimi, Aktgjykimi i datës 30 tetor 2010.

[310] Shih, për shembull, Lëndën Nr. KI 27/09, Rafet Hoxha kundër Vendimit Nr. Pn. 168/2005 të Gjykatës Supreme, Vendimi i datës 15 dhjetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 30; dhe Lënda Nr. KI 34/10, Bislim Kosumi kundër Gjykatës Komunale të Podujevës, Vendimi për Papranueshmëri i datës 25 shkurt 201, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 32.

[311] Shih, për shembull, Lëndën Nr. 61/09, Adler Com Sh.p.k nga Gjakova, Shqyrtimi Kushtetues i Urdhrit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, Vendimi për Papranueshmëri i datës 16 dhjetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 400.

Gjithashtu mund të ketë situata kur pala (palët) apo pjesëmarrësit tjerë, përveç palës kundërshtare, marrin pjesë në procedurën para Gjykatës, për shembull, në një seancë dëgjimore lidhur me një pretendim kushtetues, një autoritet publik i përfshirë në rast mund të ftohet nga Gjykata për të marrë pjesë në procedura dhe për të bërë parashtresat e veta dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të mundshme. Për shembull, në Aktgjykimin e datës 17 dhjetor 2010 mbi *Lëndën KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Tubave IMK në Ferizaj, Shqyrtimi Kushtetues i Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt,Vendimi Nr. 340/2001, të datës 11 janar 2012*,[312] Gjykata ka ftuar në seancë dëgjimore Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe NewCo IMK, si dhe Gjykatën Komunale të Ferizajt. Përfaqësuesit e AKP dhe NewCo IMK morën pjesë në seancë, por jo edhe Gjykata Komunale, gjë që edhe është pritur.

Është gjithashtu e mundshme që Gjykata të ftojë një palë të tretë për të marrë pjesë në procedurë në kapacitet të "*amicus curiae*". Intervenimet e tilla mund të përbëjnë përkrahje për parashtruesin e kërkesës apo palën kundërshtare dhe të ofrojnë këshilla lidhur me rastin në fjalë. Varësisht nga natyra e lëndës, Gjykata mund të ftojë madje edhe nga disa "amicus curiae" për të marrë qëndrime të ndryshme mbi të njëjtën çështje. Palët e treta gjithashtu mund të kërkojnë nga Gjykata që të ftohen në procedura si "amicus curiae" (për detaje të mëtejme, shih komentet mbi Rregullën 53 [Amicus Curiae] më poshtë).

Për më tepër, Sekretariati gjithashtu mund t'i dërgojë kopje të kërkesës për komente një pale (apo disa palëve) apo pjesëmarrësve tjerë në procedurë, e jo vetëm palës kundërshtare, në rast se një gjë e tillë shprehimisht i është kërkuar nga Gjyqtari Raportues. Është e rëndësisë kyçe që Gjyqtari raportues të grumbullojë sa më shumë fakte, qëndrime dhe informata që është e mundur lidhur me kërkesën para përgatitjes së Raportit Preliminar që duhet t'i prezantohet Kolegjit Shqyrtues në mënyrën më të mirë të mundshme.

Dërgimi i kërkesës nga Sekretariati tek pala kundërshtare dhe/ose palët apo pjesëmarrësit tjerë rrjedh nga "parimi i barazisë së armëve" që përbën pjesë të konceptit të gjykimit të drejtë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [Gjykimi i Drejtë] të KEDNj-së. Pala kundërshtare, e mundësisht edhe palët dhe pjesëmarrësit tjerë, veprimet e të cilëve mund të kenë shkaktuar shqyrtimin kushtetues para Gjykatës, duhet të gëzojnë mundësi të barabartë për të mbrojtur veprimet e tyre të cilat, sipas parashtruesit të kërkesës, kanë shkelur Kushtetutën.

Sipas fjalisë së dytë të 22.2, pala kundërshtare apo pjesëmarrësit do duhej t'i paraqesin përgjigjet e tyre së bashku me justifikimin përkatës dhe të gjitha informatat e domosdoshme dhe dokumentacionin përkrahës për përgjigjen e tyre brenda 45 ditësh nga pranimi i kërkesës së dërguar nga Sekretariati. Hartuesit e këtij neni kanë qenë mjaft bujarë në këtë drejtim, sepse kjo periudhë mund të zgjatet nga Gjyqtari raportues për një periudhë tjetër shtesë prej (maksimumi) 15 ditësh. Neni nuk i përgjigjet pyetjes nëse pala kundërshtare apo pjesëmarrësit tjerë rrezikojnë të sanksionohen nëse afati prej 45 ditësh nuk respektohet. Sido që të jetë Gjyqtari raportues mundet, për arsye të justifikuara, në pajtim me nenin 22.4, që të zgjasë afatin për një periudhë shtesë prej 15 ditësh (apo më pak). E nëse edhe ky

[312] Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 417; dhe faqja e Gjykatës në internet.

afat nuk respektohet, fjalia e dytë e nenit 22.5 përcakton se *"Në rast se përgjigja në kërkesë nuk dorëzohet brenda afatit të paraparë […]gjyqtari raportues përgatit raportin paraprak"* (shih komentet e mëtejme nën nenin 22.5).
Neni 22.2 plotësohet me Rregullën 29 [Paraqitja e Kërkesave dhe Përgjigjeve] i cili është komentuar më poshtë.

3 Sa i përket fjalisë së parë të nenit 22.3, supozohet se termi "Sekretar" është vënë gabim në vend të "Sekretariat", sikur në paragrafin 2 të nenit 22, në fjalinë e parë dhe të dytë, apo të "Sekretar i Përgjithshëm" (si udhëheqës i Sekretariatit të Gjykatës), i cili përmendet në nenin 12 më sipër, duke qenë se Ligji nuk e shfrytëzon këtë term askund gjetiu. As Rregullorja e Punës nuk e përmend këtë term, kështu që duket se kemi të bëjmë thjeshtë me një lëshim nga hartuesit. Për të mos shkaktuar më shumë konfuzion me përdorimin e termit "Sekretar" edhe këtu, në vijim to të shfrytëzojmë termin "Sekretariat".
Neni nuk përcakton ndonjë limit kohor brenda së cilit Sekretariati do duhej t'ia dërgojë kërkesën Gjyqtarit Raportues të emëruar nga Kryetari i Gjykatës në pajtim me Rregullën 8 të Rregullores së Punës.[313] As Rregulla 33 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues] nuk përcakton ndonjë limit kohor (shih komentet më poshtë).
Për më tepër, edhe pse formulimi i këtij neni mund të japë bindjen se Sekretariati do t'ia dërgojë Gjyqtarit Raportues edhe kërkesën edhe përgjigjen njëkohësisht, praktika e ka dëshmuar të kundërtën. Siç përcaktohet në fjalinë e dytë të nenit 22.2, pala kundërshtare ka 45 ditë nga pranimi i kopjes së kërkesës për t'ia dërguar përgjigjen Sekretariatit. Rrjedhimisht, në parim, Gjyqtari raportues do duhej të ketë në dispozicion përgjigjen, nëse pala kundërshtuese ka paraqitur përgjigje, më së voni 45 ditë pas pranimit të kërkesës nga Sekretariati. Nëse për arsye të justifikueshme pala kundërshtare dhe palët e pjesëmarrësit tjerë nuk kanë qenë në gjendje ta parashtrojnë përgjigjen ndaj kërkesës brenda 45 ditësh, ata do duhej ta informojnë Gjyqtarin Raportues i cili mund të lejojë shtyrjen e afatit për 15 ditë tjera, në bazë të nenit 22.4, duke arsyetuar këtë me faktin se përgjigja nuk është (ende) e qartë apo e plotë.
Megjithatë, ky nen nuk përcakton nëse përgjigja do duhej t'i dorëzohet parashtruesit të kërkesës për komente. Do të ishte logjike dhe në përputhje me parimin e "barazisë së armëve" që parashtruesi i kërkesës të ketë të drejtë të komentojë përgjigjen, por hartuesve duket se iu ka ikur kjo çështje. Sidoqoftë, nuk ka arsye përse Gjyqtari Raportues, *me iniciativë të tij*, të mos i lejojë parashtruesit të kërkesës një gjë të tillë, pasi që komentet e parashtruesit të kërkesës mund t'i ndihmojnë atij/asaj në mënyrë të konsiderueshme në përgatitjen e raportit preliminar. Nëse mbahet ndonjë seancë dëgjimore, ky lëshim nuk do të luante ndonjë rol të rëndësishëm, pasi që palët do të ftoheshin nga Kryetari i Gjykatës që të komentojnë parashtresat e njëri-tjetrit (për më shumë detaje shih komentet për Rregullën 43 më poshtë).
Neni 22.3 më tej rregullon se pas pranimit të kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë, Gjyqtari raportues përgatit[raportin preliminar lidhur me faktet, pranueshmërinë dhe arsyeshmërinë e kërkesës. Pasi që raporti preliminar i Gjyqtarit Raportues

[313] Shih komentet për Rregullën 8 më poshtë.

përbën bazën për vendimin e Gjykatës, është me rëndësi që i njëjti të hartohet me kujdes dhe syçeltësi, në pajtim me parimet e përcaktuara në Rregullën 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues]. Është posaçërisht e rëndësishme që faktet të jenë precize dhe të qarta dhe të mos lënë hapësirë për interpretime të ndryshme.
Natyrisht, vlerësimi nëse kërkesa është pranueshme dhe përmban baza të mjaftueshme për të gjetur shkeljen e pretenduar nga parashtruesi i kërkesës duhet të bëhet nga gjyqtarët. Kolegji Shqyrtues mund të pajtohet apo jo me raportin preliminar, ndërsa Gjykata mund të pajtohet apo jo me rekomandimin e Kolegjit Shqyrtues. Sidoqoftë, një raport bindës dhe i thuktë preliminar, i cili bazohet edhe në praktikat relevante gjyqësore, mund të ketë më shumë gjasa që të përcillet me një rekomandim adekuat nga Kolegji Shqyrtues për Gjykatën. E nëse ndodh kjo, atëherë do të jetë i lehtë konvertimi i raportit preliminar në vendim përfundimtar të Gjykatës. Kjo sqaron përse sipas Rregullës 60 [Teksti Përfundimtar i Aktgjykimit dhe Arkivimi], paragrafi 1, Gjyqtari raportues ka për detyrë hartimin e vendimit të Gjykatës (për më shumë detaje, shih komentet për Rregullën 60(1) më poshtë).
Neni 22.3 plotësohet me Rregullat 8 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues], 29 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve], 30 [Regjistrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve], 33 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues] dhe 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues].

4 Sipas nenit 22.4, nëse një kërkesë apo përgjigje nuk është e qartë apo e plotë, Gjyqtari raportues mund të konsiderojë se për hartimin e propozim-raportit preliminar nevojiten më shumë informata nga parashtruesi i kërkesës dhe/ose pala kundërshtare ose pjesëmarrësit tjerë. Për shembull, mund të jetë e domosdoshme që disa çështje të qartësohen dhe të parashtrohen dokumente shtesë. Afati maksimal prej 15 ditësh që caktohet nga Gjyqtari raportues duhet të kuptohet se fillon të rrjedh nga data në të cilën parashtruesi i kërkesës, pala kundërshtare dhe/ose pjesëmarrësit tjerë e kanë pranuar kërkesën në fjalë. Fjalia e dytë e nenit 22.4 thekson se edhe nëse kërkesa është e qartë dhe e plotë, Gjyqtari raportues mund të konsiderojë se ai/ajo ende ka informata dhe dokumente përkrahëse të pamjaftueshme për të përcaktuar pranueshmërinë dhe meritat e pretendimit, dhe se i nevojiten më shumë informata. Megjithëse nuk ka afat brenda së cilit do duhej dorëzuar informatat shtesë, siç përmendet edhe këtu, do të mund të shfrytëzohej afati i njëjtë prej jo më shumë se 15 ditësh, i cili përcaktohet në fjalinë e parë të nenit 22.4. Natyrisht, nëse Gjyqtari raportues e konsideron këtë të domosdoshme, ai/ajo mund t'i dërgojë kërkesa shtesë palëve relevante duke iu dhënë në dispozicion afate të ngjashme kohore.

5 Fjalia e parë e nenit 22.5 nuk duket se merr parasysh mundësinë që pas pranimit të kërkesës dhe përgjigjeve ndaj kërkesës, Gjyqtari raportues të ketë nevojë të kërkojë nga cilado palë informata shtesë në rrethanat e përshkruara në nenin 22.4.
Në rast të tillë, palëve apo pjesëmarrësve relevantë duhet t'u jepet afat prej jo më shumë se 15 ditësh për të dorëzuar informatat shtesë në fjalë, gjë që do ta zgjatë për 15 ditë shtesë periudhën prej 30 ditësh brenda së cilës Gjyqtari raportues do

duhej t'ia dorëzojë Raportin Preliminar Kolegjit Shqyrtues.[314] Përveç kësaj, informatat shtesë duhet të përkthehen edhe në dy gjuhë tjera, gjë që gjithashtu merr kohë. Prandaj, nuk do të ishte e paarsyeshme që kjo dispozitë të interpretohet në frymën e asaj që afati 30-ditor të fillojë të numërohet vetëm pasi që Gjyqtari raportues të ketë pranuar të gjitha informatat shtesë të dorëzuara nga palët dhe pjesëmarrësit dhe, kurdo që është e domosdoshme, versionet e përkthyera të tyre.

Sipas fjalisë së dytë të nenit 22.5, Raportuesi mund të përgatisë Raportin Preliminar, mes tjerash, nëse përgjigja ndaj kërkesës nuk është dorëzuar brenda afatit. Megjithatë, Rregulla nuk trajton fare se a mund të marrë parasysh Gjyqtari raportues përmbajtjen e përgjigjes së dorëzuar brenda afatit 30-ditor brenda së cilit ai duhet të dorëzojë raportin preliminar tek Kolegji Shqyrtues. Duket se ky qëndrim është i arsyeshëm pasi që në rast se Gjyqtari raportues nuk bën një gjë të tillë, ai/ajo do të rrezikonte që të bazohet në fakte të pasakta dhe të nxjerr përfundime të gabuara, për shembull Gjyqtari raportues do të propozonte që një kërkesë të shpallet e papranueshme ndërsa në bazë të informatave të vonuara kërkesa është qartë e pranueshme.

Për më tepër, sipas fjalisë së dytë të nenit 22.5 Gjyqtari raportues mund të përgatisë Raportin Preliminar edhe vetëm në bazë të kërkesës, "nëse sipas natyrës së procedurës së veçantë nuk kërkohet një përgjigje në kërkesë." Në këtë kontekst, referencë i bëhet dispozitave të Procedurave të Veçanta, të përcaktuara në nenin 113 të Kushtetutës, Kapitullin III [Procedurat e Veçanta] të Ligjit dhe Kapitullit VIII [Dispozitat e veçanta për procedura, të caktuara sipas nenit 113 të Kushtetutës] të Rregullores së Punës, për të përcaktuar nëse një përgjigje është e domosdoshme në rast se kërkesat paraqiten në bazë të Procedurave të Veçanta.

Edhe pse në rastet kur kërkesa parashtrohet në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës (pretendime kushtetuese nga individët), Sekretariati si rregull ia komunikon kërkesën palëve kundërshtare, nuk është gjithaq e qartë nëse kjo duhet bërë për kërkesa të parashtruara në bazë të Procedurave të Veçanta tjera. Në rast të çfarëdo dyshimi, Sekretariati do duhej të konsultojë Gjyqtarin Raportues, në kapacitetin e tij si 'zot' i Raportit Preliminar, lidhur me pyetjen se kujt t'i komunikohen kërkesat për komente. Kësisoj, në mungesë të ndonjë dispozite specifike ligjore që trajton këtë çështje do duhej ta vendosë Gjyqtarit Raportues, nëse procedura e veçantë në fjalë është e natyrës së tillë që kërkesa t'i komunikohet të gjitha palëve, apo palëve të caktuara të interesuara qëndrimi i të cilëve mbi çështjen në fjalë mund të jetë në interes të përgatitjes së Raportit Preliminar, për shembull, nëse Gjykata do të ishte e interesuar që të ftojë në procedurë *amicus curiae* (për komente të detajuara, shih Rregullën 53 [Amicus Curiae] më poshtë).

Neni 22.5 plotësohet me Rregullat 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues] dhe 35 [Kolegji Shqyrtues], të cilat janë komentuar më poshtë.

6 Fjalia e parë e nenit 22.6 nënkupton se Kolegji Shqyrtues së pari shqyrton Raportin e Preliminar, pas paraqitjes së tij nga Gjyqtari Raportues, para se të vlerësojë pranueshmërinë e tij. Kriteret e pranueshmërisë janë përcaktuar në Rregullën 36 [Kriteret e Pranueshmërisë].

[314] Neni nuk elaboron më tej çështjen e Kolegjit Shqyrtues. Detajet lidhur me Kolegjin mund të gjenden në nenin 22.6 dhe Rregullat 8 dhe 34 të Rregullores së Punës (shih më poshtë).

Përveç përbërjes dhe emërimit të Kolegjit Shqyrtues nga Kryetari, neni nuk ofron detaje lidhur me qëllimin e tij apo mënyrën se si do të vlerësojë pranueshmërinë apo mospranueshmërinë e një kërkese. Detajet në fjalë jepen në Rregullën 9 [Emërimi i Kolegjeve Shqyrtuese] dhe Rregullën 35 [Kolegji Shqyrtues] të Rregullores së Punës, të cilët shtjellohen më poshtë.

7 Sipas nenit 22.7, vetëm në rast të vlerësimit të njëzëshëm të Kolegjit Shqyrtues se kërkesa është e papranueshme në bazë të kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullën 36 propozim-vendimi u dërgohet të gjithë gjyqtarëve. Kjo nuk do të bëhet nga Kolegji, siç përcaktohet në këtë nen, por nga Sekretari i Përgjithshëm, në pajtim me Rregullën 35(4). Megjithatë, neni 22.7 nuk tregon se cila procedurë zbatohet në rast se Kolegji Shqyrtues vendosë 'me shumicë votash' se kërkesa është e papranueshme. Gjithashtu, Rregullën 35 [Kolegjet Shqyrtuese] nuk duket se mbulon këtë çështje. Megjithatë, në praktikë nuk ka dallim në procedurë, pasi që siç bëhet e qartë nga vendimet e Gjykatës në çdo rast Kolegji Shqyrtues, përmes Kryesuesit të Kolegjit, ia dërgon rekomandimet e veta tërë Gjykatës, shpesh gjatë të njëjtës seancë.

Edhe pse fjalia e dytë e nenit 22.7 rrjedhimisht e ka humbur rëndësinë, nuk është e qartë përse hartuesit e kanë konsideruar të domosdoshme që Kolegjin Shqyrtues ta ngarkojnë me detyrën për të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'ia dërguar një kopje të propozim-vendimit gjyqtarëve të cilët mund të mos jenë brenda territorit të Republikës së Kosovës. Siç rregullohet edhe me fjalinë e parë të këtij neni, dërgimi në fjalë do duhej të jetë detyrë e Sekretarit të Përgjithshëm (sigurisht, sipas udhëzimit të Kryesuesit të Kolegjit Shqyrtues), mundësisht me mjete elektronike apo mjete tjera efektive të komunikimit (në këtë nen shfrytëzohet termi 'efektivisht'), si dhe sigurimi i konfirmimit të pranimit nga gjyqtarët përkatës.

Edhe pse kjo nuk thuhet në mënyrë shprehimore, dispozitat duket se i referohen në veçanti gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës, të cilët mund të jenë në pushim në vendet e tyre të origjinës apo në misione tjera. Megjithatë, mund të ndodhë gjithashtu që gjyqtarët kosovarë të jenë në udhëtime jashtë vendit dhe të njëjtit të duhet të pranojnë kopjet e propozim-vendimeve (si dhe të konfirmojnë pranimin e tyre), në mënyrë që të shprehin qëndrimet e tyre lidhur me to brenda 10 ditësh. Nëse gjyqtarët nuk mund të kontaktohen gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit, e vetmja zgjidhje do të ishte që propozim-vendimi të diskutohet në seancë nga të gjithë gjykatësit në datën e parë të mundshme pas kthimit të tyre.

Neni 22.7 plotësohet me Rregullën 35 [Kolegjet Shqyrtuese], i cili është komentuar më poshtë.

8 Sa i përket nenit 22.8, pasi që "propozim-vendimi" i miratuar njëzëri nga Kolegji shqyrtues t'u jetë dërguar gjyqtarëve tjerë, këta të fundit nuk kanë nevojë ta miratojnë atë në mënyrë të shprehur. Ata thjeshtë mund të lënë të skadojë afati prej 10 ditësh që nënkupton se ata do të konsiderohet se e kanë miratuar atë në heshtje.

Megjithatë, bazuar në praktikën e lartpërmendur sipas së cilës rekomandimi i dërgohet tërë përbërjes së Gjykatës, kryesisht gjatë të njëjtës seancë, gjyqtarët të cilët nuk janë në Kolegj mund të shprehin qëndrimin e tyre menjëherë, në vend se

të presin për ta bërë këtë punë brenda 10 ditësh siç përcaktohet në nen. Kur Gjykata të pajtohet njëzëri apo me shumicë votash me rekomandimin se kërkesa është e papranueshme, ajo mund të procedohet menjëherë dhe pa vonesë, edhe pse gjyqtarët ende i kanë në dispozicion 10 ditë pas pranimit të propozim-vendimit për t'u pajtuar apo jo me formulimin përfundimtar të vendimit të Gjykatës. Pas kësaj, në pajtim me nenin 22.8, Kryetari e nënshkruan dhe nxjerr vendimin se kërkesa refuzohet për shkak të papranueshmërisë së saj.

Për më tepër, lidhur me nënshkrimin e "Vendimeve për Papranueshmëri", neni 22.8 jep bindjen e gabuar se ato i nënshkruan vetëm Kryetari, ndërsa neni 20.3 i Ligjit qartë rregullon se "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese... do të nënshkruhen nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjyqtari Raportues." Fakti se Kryetari dhe Gjyqtari raportues i nënshkruajnë vendimet nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata duhet të pajtohen me to. Ata mund të mos pajtohen me ndonjë vendim të caktuar dhe të kenë votuar kundër miratimit të tij. Nënshkrimi i vendimit për papranueshmëri është, rrjedhimisht, vetëm formalitet. Kjo dallon nga hartimi dhe nënshkrimi i aktgjykimeve në të cilat Gjyqtari raportues nuk pajtohet me shumicën e Gjykatës (shih komentet mbi Rregullën 60 [Teksti përfundimtar i aktgjykimit dhe arkivimi] më poshtë).

Në fund, sa i përket nënshkrimit dhe publikimit të vendimeve nga Kryetari, ky nen nuk përcakton ndonjë procedurë të veçantë. Vetëm neni 20 [Vendimet], paragrafi 4, i Ligjit përmban ca detaje të cilat thonë se *" Vetëm neni 20 [Vendimet], paragrafi 4, i Liare dhe publikohet në Gazetën Zyrtare."* Në fakt, është Sekretari i Përgjithshëm ai/ajo që i kryen të gjitha këto detyra në emër të Kryetarit. Për më tepër, në praktikë, vendimet nuk publikohen vetëm në Gazetë Zyrtare por edhe në faqen zyrtare të Gjykatës në internet.

Neni 22.8 plotësohet me Rregullën 35 [Kolegjet Shqyrtuese], i cili komentohet më poshtë.

9 Neni 22.9 parasheh dy mundësi për paraqitje të lëndëve para përbërjes së plotë të Gjykatës: (1) nëse Kolegji Shqyrtues vendosë njëzëri apo me shumicë votash se kërkesa është e pranueshme; dhe (2) nëse Kolegji Shqyrtues vendosë njëzëri se kërkesa është e papranueshme, por një apo më shumë gjyqtarë që nuk kanë qenë në kolegj e kundërshtojnë këtë vendim. Në praktikë, kjo nuk ka shumë rëndësi sepse sipas procedurës që aktualisht ndiqet nga Gjykata lëndët gjithmonë i referohen nga Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues përbërjes së plotë të Gjykatës për vendim të mëtejmë.

Sa i përket fjalisë së dytë të nenit 22.9, është e paqartë përse ligjvënësit nuk kanë paraparë opsione tjera të cilat nuk do ta obligonin Gjykatën që të mbajë seancën e cila përcaktohet në fjalinë e dytë të këtij neni, në veçanti duke qenë se neni 20.2 i Ligjit ia mundëson Gjykatës që të vendosë sipas vlerësimit të saj mbi pretendimet në bazë të dosjes së lëndës (shih komentet e detajuara mbi nenin 20.2 më sipër)[315].

[315] Neni 20(2), i cili përcakton: "*Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.*", është problem në vete sepse mohon të drejtën në seancë dëgjimore e cila në mënyrë shprehimore sigurohet me nenin 20(1), i cili përcakton: "*Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së*

Cilido të ketë qenë qëllimi i hartuesve gjatë vendosjes së referencës mbi "seancën dëgjimore" në nenin 22.9, Gjykata ka rregulluar çështjen në Rregullore të Punës, në pajtim me nenin 20.2 (shih Rregullat 45 deri 53, të komentuara në vijim). Rrjedhimisht, hartuesit kanë mundur t'ia lënë Gjykatës vendimin nëse do të mbajë seancë dëgjimore apo jo, ashtu siç ka gjasa të kenë menduar fillimisht kur është hartuar neni 20.2. Në rrethana të tilla Gjykata do të kishte katër opsione:

(1) Gjykata e shpallë pretendimin të papranueshëm dhe rrjedhimisht nuk merret me meritat e tij;
(2) Ajo e shpallë lëndën të pranueshme dhe vendosë mbi meritat e pretendimit pa seancë dëgjimore;
(3) Ajo e shpallë lëndën të pranueshme dhe mban seancë dëgjimore mbi meritat e lëndës;
(4) Ajo vendosë mbi lëndën pas seancës në të cilën trajtohen edhe pranueshmëria edhe meritat e lëndës.

Opsioni 4 do të mund të shfrytëzohej kur Gjykata të vlerësojë se seanca dëgjimore është e domosdoshme për të qartësuar çështjet faktike dhe ligjore që ndërlidhen me pranueshmërinë dhe meritat e pretendimit, për shembull, nëse parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk kanë mbetur mjete juridike pa u shterur apo se mjetet juridike në dispozicion janë joefektive. Situata e tillë mund të shfaqet, për shembull, kur një parashtrues i kërkesës gjendet pranë deportimit apo ekstradimit në një vend tjetër, ku ai/ajo pretendon se do të mund t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor apo poshtërues, që është në kundërshtim me nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues] dhe nenin 3 [Ndalimi i Torturës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut[316] dhe se ende nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të ofruara me ligjin e zbatueshëm. Normalisht, në raste të tilla, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata edhe shqiptimin e masave të përkohshme mbi autoritetet deportuese/të ekstradimit për të ndalur deportimin e tij/saj në vende të tilla para përfundimit të procedurës para Gjykatës (për më shumë detaje, shih komentet mbi nenin 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit më poshtë).

Gjykata mund ta konsiderojë mbajtjen e seancës dëgjimore të domosdoshme për të trajtuar pyetjen nëse parashtruesi i kërkesës duhet t'i shtjerrë të gjitha mjetet juridike apo jo, pasi që sipas parashtruesit të kërkesës ato janë joefektive, si dhe vetë meritat e lëndës.

Neni 22.9 plotësohet me Rregullat 45 [Paraqitja e dëshmive nga palët] deri 53 [Amicus Curiae], të cilët do të shtjellohen nën nenin 25 [Dëshmitë].

Siç u përmend edhe më lartë tek komentet mbi të gjithë paragrafët e nenit 22, Rregullat 8, 9, 28, 29, 30, 33, 34, 35, 36, 37 dhe 38, të cilat plotësojnë këta paragrafë do të trajtohen në fund të këtij neni. Prandaj, komentet mbi këto Rregulla do të jepen në vijim, së bashku me komentet mbi Rregullat 37 [Bashkimi dhe Ndarja e Kërkesave] dhe 38 [Aktgjykimet Testuese], të cilat ngjashëm sikur neni 22 përcaktojnë procedurat për procedimin e kërkesave, më specifikisht në rastet

shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal". Shih më lartë komentet e detajuara mbi nenin 20.

[316] Neni 3 i KEDNJ-së rregullon se: "*Askush nuk do t'i nënshtrohet trajtimit apo ndëshkimeve çnjerëzore apo poshtëruese*."

kur temat janë të ndërlidhura apo çështjet janë të ndryshme dhe preferohet shqyrtimi i ndarë i tyre.

Rregulli 8 [Emërimi i Gjyqtarit raportues] i Rregullores së Punës

1. **Gjyqtari, të cilit i caktohet një kërkesë, zgjidhet nëpërmjet sistemit të tërheqjes së shortit dhe emërohet nga Kryetari.**
2. **Në rast se është e domosdoshme të zëvendësohet Gjyqtari raportues, lënda i caktohet një gjyqtari tjetër nëpërmjet tërheqjes së shortit dhe pastaj, ai gjyqtar, emërohet nga Kryetari.**
3. **Me kalimin e kohës, të gjithë gjyqtarëve do t'u caktohet numër i barabartë i lëndëve në të cilat ata janë gjyqtarë raportues.**

I. As neni 22.3 i Ligjit, e as Rregullat 8 dhe 33 të Rregullores së Punës, nuk përmendin kornizën kohore brenda së cilës Kryetari do duhej të emërojë Gjyqtarin Raportues pas regjistrimit të kërkesës nga Sekretariati. Në vend se të përcaktohet afati kohor brenda së cilit Sekretariati do duhej ta përzgjedhë Gjyqtarin Raportues përmes një sistemi të tërheqjes së rastësishme të shortit dhe t'ia paraqesë atë Kryetarit për emërim, hartuesit duket se e kanë lënë këtë vendimin për këtë në diskrecion të Sekretariatit.

Ajo që Gjykatës i mungonte më së shumti në fillim ishte një sistem i zbatueshëm për menaxhimin e lëndëve, që përbën një vegël shumë të dobishme për regjistrimin e kërkesave me kohë, për komunikim me palët, për detaje të procedurës, për dorëzim të dokumenteve dhe çështje tjera të rëndësishme për trajtimin adekuat të kërkesave si dhe për emërimin e Gjyqtarit raportues dhe anëtarëve të Kolegjit Shqyrtues. Fatmirësisht, falë veprimtarisë së Njësisë për Teknologji Informative dhe Multimediale të Gjykatës (NJTIM), e cila është përgjegjëse për funksionimin e infrastrukturës multimediale dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me teknologji informative dhe multimediale, në vitin 2011 në bashkëpunim me donatorët nga East-West Management Institute (EWMI) është krijuar Sistemi për Menaxhimin e të Dhënave të Lëndëve (CDMS) dhe i njëjti është instaluar në kompjuterët e gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë dhe punonjëseve të Gjykatës, duke u mundësuar të njëjtëve përcjelljen e lëndëve nga dita e regjistrimit deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

II. Kur është i domosdoshëm zëvendësimi i ndonjë gjyqtari që është emëruar Gjyqtar raportues për ndonjë kërkesë, edhe gjyqtari zëvendësues përzgjidhet në mënyrë të rastësishme me short dhe më pas emërohet nga Kryetari për pozitën në fjalë. Arsyet për një zëvendësim të tillë mund të jenë të ndryshme dhe gjenden në nenet 8 [Skadimi i Mandatit], 9 [Përfundimi i Mandatit Para Kohe] dhe 18 [Përjashtimi i një Gjyqtari] të Ligjit dhe Rregullat 5 [Dorëheqja e Gjyqtarëve], 6 [Procedurat për Shkarkim] dhe 7 [Procedurat për Përjashtim] të Rregullores së Punës, të cilat plotësojnë nenet në fjalë. Në të gjitha situatat e rregulluara me dispozitat e lartpërmendura zëvendësimi i gjyqtarëve duhet të përcillet edhe me zëvendësimin e tij/saj si Gjyqtar raportues dhe anëtar i Kolegjeve Shqyrtuese përkatëse. Varësisht

nga rrethanat, gjyqtari zëvendësues mund të jetë gjyqtar aktual i Gjykatës apo gjyqtar i sapoemëruar.

III. Edhe pse Rregulla 8 (3) përcakton se të gjithë gjyqtarët do të kenë, me kalimin e kohës, ndarje të barabartë të punëve, vetë përdorimi i sistemit të tërheqjes së shortit të rastësishëm bën të qartë se nuk mund të garantohet një ndarje e barabartë e detyrave të Gjyqtarëve raportues. Prandaj, nuk është e lehtë që të shihet se si ndarja e barabartë e detyrave mund të arrihet 'me kalimin e kohës'. Megjithatë, sistemi aktual i tërheqjes së rastësishme të shortit nuk mund të zëvendësohet lehtësisht me ndonjë sistem tjetër, pasi që kjo do të mund të konsiderohej nga opinioni publik si një përpjekje për të ndikuar mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe mbi ndarjen e paanshme të rasteve. Për më tepër mbajtja e këtij sistemi të delegimit në baza 'të rastësishme' shmang çfarëdo konflikti mes gjyqtarëve.
Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë shfrytëzon një metodë sipas së cilës lëndët ndahen në bazë të përmbajtjes, varësisht se origjina e tyre a ka të bëjë me shkelje të pretenduar të ligjeve themelore apo me ndonjë fushë të caktuar të së drejtës.[317] Një sistem i tillë nuk do të shmangte në tërësi konfliktet mes gjyqtarëve në lidhje me delegimin e lëndëve. Megjithatë, ai do të mund të ndihmonte në delegimin e lëndëve tek gjyqtarët (dhe këshilltarët ligjorë) që kanë specializuar në fushat përkatëse.
Rregulli 8 plotësohet më tej me Rregullën 33 [Caktimi i Gjyqtarit Raportues], i cili komentohet më poshtë.

Rregulli 9 [Përcaktimi i kolegjeve shqyrtuese] i Rregullores së Punës

1. **Për secilën kërkesë të regjistruar në Gjykatë, me short caktohet Kolegji shqyrtues i përbërë nga tre gjyqtarë, i cili pastaj emërohet nga Kryetari, për të shqyrtuar pranueshmërinë e kërkesës.**
2. **Kryetari përcakton njërin nga gjyqtarët e caktuar në Kolegjin shqyrtues të shërbejë si kryesues i Kolegjit shqyrtues.**
3. **Me kalimin e kohës, të gjithë gjyqtarëve do t'u caktohet numër i barabartë i lëndëve për të shërbyer si gjyqtarë në kolegje shqyrtuese dhe si kryesues të kolegjeve shqyrtuese.**
4. **Gjyqtari raportues, i caktuar për të përgatitur raportin për kërkesën që shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues, nuk mund të jetë anëtar i atij Kolegji shqyrtues.**

I. Përzgjedhja e gjyqtarëve për Kolegj Shqyrtues me short të rastësishëm është e ngjashme me atë të shfrytëzuar për delegimin e gjyqtarëve si Gjyqtarë raportues për çdo kërkesë, siç përcaktohet në Rregullën 8 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues]. Megjithatë, mund të ketë raste kur si rezultat i tërheqjes së rastësishme në një Kolegj Shqyrtues mund të caktohen edhe tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Shumë rezultate tjera të padëshirueshme të ngjashme mund të parashikohen dhe theksohen në lidhje me këtë lloj të përzgjedhjes së Gjyqtarit raportues. Në raste të tilla Sekretariati mund të përsërisë tërheqjen e shortit, pas konsultimit me Kryetarin.

[317] http://www.bverfg.de/organisation/geschaeftsverteilung_2014.html,

Megjithatë, do të ishte e preferueshme që të përmirësohet sistemi i tërheqjes së shortit për emërimin e Gjyqtarit raportues dhe anëtarëve të Kolegjit Shqyrtues, përmes miratimit nga Gjykata të rregullave shtesë të cilat mund të kenë një rezultat më të balancuar.
Edhe pse Rregulla nuk e trajton këtë çështje, duket e përshtatshme dhe në pajtim me dispozitat e nenit 11.2 të Ligjit që kurdo që Kryetari i Gjykatës të jetë zgjedhur përmes sistemit të tërheqjes së rastësishme të shortit si anëtar i Kolegjit Shqyrtues, emërimin në fjalë ta bëjë Zëvendëskryetari i Gjykatës.

II. Gjykata ka mundur të përzgjedhë të njëjtin sistem të shortit të rastësishëm për nominimin e Kryesuesit të Kolegjit Shqyrtues, por si duket ka preferuar që emërimin e tij t'ia lë në dorë Kryetarit të Gjykatës. Megjithatë, në interes të transparencës, Gjykata gjithashtu si duket ka vendosur që Kryetari ta emërojë si Kryesues të Kolegjit Shqyrtues gjyqtarin më të vjetër për nga mosha nga tre gjyqtarët e emëruar. Por, kjo si rezultat do të ketë që dy gjyqtarët më të rinj për nga mosha të mos kenë gjasa të bëhen Kryesues të Kolegjeve Shqyrtuese, deri sa të emërohen gjyqtarë tjerë më të rinj. Kjo duket se është në kundërshtim me Rregullën 4 [Përparësia e Gjyqtarëve], paragrafi 2, të Rregullores së Punës, i cili përcakton se "[...] gjyqtarët janë të barabartë, pa marrë parasysh moshën, [...]"[318]

III. Ngjashëm me ndarjen e barabartë të delegimeve si Gjyqtar raportues, nuk është e lehtë që përmes aplikimit të sistemit të tërheqjes së rastësishme të shortit të arrihet ndarja e barabartë e emërimeve si Gjyqtarë në Kolegje Shqyrtuese, apo si Kryesues të tyre. Siç u tha edhe më sipër, janë të domosdoshme rregulla të reja shtesë për të evituar ndarjen e pabarabartë të delegimeve të tilla për shkak të sistemit të moshës, i cili aktualisht është duke u zbatuar.

IV. Nënkuptohet se do të ishte në mospërputhje me parimin e "pavarësisë së gjyqtarëve" nëse Gjyqtari raportues do të ishte njëkohësisht edhe anëtar i Kolegjit Shqyrtues i cili trajton raportin e tij/saj preliminar për kërkesën.
Detaje të mëtejme mbi procedurën para Kolegjit Shqyrtues përcaktohen me Rregullën 35 [Kolegjet Shqyrtuese] të Rregullores së Punës.

Rregulli 28 [Fillimi i Procedurës] i Rregullores së Punës

> **Procedura para Gjykatës fillon me dorëzimin e kërkesës në Sekretariat. Pasi të jetë dorëzuar kërkesa, apo çfarëdo dokumenti fillestar, kërkesës i caktohet numri i regjistrimit të saj nga Sekretariati. (e re)**

Rregulli nuk thotë shumë më shumë se neni 22.1. Ai nënkupton se edhe nëse nuk janë pranuar të gjitha dokumentet e nevojshme, kërkesës duhet t'i jepet një numër regjistrimi (shih edhe Rregullën 30 (1)). Prandaj nëse një kërkesë mbetet jo e plotë, ajo do të vazhdojë të konsiderohet si rast i pazgjidhur nga Gjykata dhe do të trajtohet nga

[318] Formulimi i plotë i Rregullës 4.2 është: "Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore të punës, gjyqtarët kanë status të barabartë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre, pavarësisht moshës, rendit të emërimit, kohëzgjatjes së shërbimit, ose kohëzgjatjes së mandatit.".

Gjykata më vonë. Por, ekziston rreziku që Gjykata ta refuzojë lëndën si të papranueshme nëse parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e veta për shkelje të Kushtetutës.

Rregulli 29 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] i Rregullores së Punës

1. Kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim, në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Kërkesa i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të përfshijë datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e parashtron atë.

2. Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
   (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën;
   (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka;
   (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka;
   (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet;
   (e) mbrojtjen juridike të kërkuar;
   (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;
   (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe
   (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

3. Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse etëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla.

4. Dokumentet mund të parashtrohen në cilëndo gjuhë zyrtare të Kosovës, ose në ndonjërën nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë. Kur dokumenti që i është bashkëngjitur kërkesës nuk është në njërën nga gjuhët zyrtare, ose në gjuhët në përdorim zyrtar, atëherë ai duhet të jetë i shoqëruar nga përkthimi i certifikuar në njërën nga këto gjuhë. Përkthimi mund të kufizohet në pjesë përkatëse të dokumentit, por, në këtë rast, përkthimi duhet të shoqërohet me një shpjegim që tregon se cilat pjesë të dokumentit janë përkthyer. Gjykata mund të kërkojë përkthim më të gjerë ose përkthim të plotë të dokumentit.

5. Sekretariati duhet të krijojë procedurë për kontrollimin e saktësisë së përkthimeve të paraqitura.

6. Kërkesa mund të parashtrohet personalisht në zyrën e Sekretariatit të Gjykatës, gjatë orarit të rregullt të punës, ose nëpërmjet postës apo mjeteve të komunikimit elektronik.

7. Gjykata, për të ndihmuar palët në dorëzimin e kërkesës, duhet të përcaktojë formularin e kërkesës dhe duhet ta publikojë atë në ueb-faqen e vet.

8. Përgjigjet në kërkesa duhet të parashtrohen nga palët kundërshtare në mënyrë të njëjtë, si dorëzimi i kërkesës, të përcaktuara në këtë rregull.

Është e qartë se Rregulla 29 është e zbatueshme për të gjitha palët e autorizuara sipas nenit 113 të Kushtetutës, edhe pse komentet mbi këtë Rregull nganjëherë prekin në

mënyrë më të detajuar parashtrimin e kërkesave nga individët (dhe personat juridikë) në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës. Prandaj, komentet në vijim mbi këtë rregull kanë të bëjnë me të gjitha palët e autorizuara.
Në lidhje me këtë, është e rrugës që t'i referohemi shkurtimisht formularit të parashtrimit të kërkesës (formularit të parashtrimit të kërkesës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 46 deri 49 dhe 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës) dhe udhëzimeve të cilat u ndihmojnë palëve në parashtrimin e kërkesave para Gjykatës Kushtetuese të republikës së Kosovës, të cilat janë elaboruar enkas nga Gjykata për individë që mëtojnë të parashtrojnë ankime kushtetuese e të cilat mund të merren në lokalet e Gjykatës apo të shkarkohen nga faqja e Gjykatës në internet.[319] Është evidente se palët e tjera të autorizuara sipas nenit 113 të Kushtetutës mund të shfrytëzojnë formularin e parashtrimit të kërkesës gjatë parashtrimit të tyre pranë Gjykatës, siç edhe ka ndodhur për shumicën e kërkesave të parashtruara nga to. Detaje të mëtejme mbi formularin e kërkesës do të gjenden tek komentet mbi Rregullën 29(6) më poshtë.

I. Rregulli 29(1) përcakton se kërkesa duhet të parashtrohet në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në pajtim me nenin 5 [Gjuhët], paragrafi 1, i Kushtetutës, përcakton se gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe serbe. Megjithatë, as Ligji e as Rregullorja e Punës nuk përcaktojnë se kërkesat mund të parashtrohen edhe në gjuhët turke, boshnjake dhe rome, megjithëse sipas nenit 5.2 të Kushtetutës "kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj". Për më tepër, neni 24 [Barazia Para Ligjit] i Kushtetutës, në paragrafin 2, përcakton se: "Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të […] gjuhës […]." Prandaj, pyetje legjitime do të ishte të dihet nëse do të diskriminohej një person që parashtron kërkesën e tij/saj në gjuhët turke, boshnjake apo rome, e Sekretariati ia refuzon atë për shkak se nuk është parashtruar në gjuhën shqipe apo serbe.
Edhe pse rast të tillë nuk ka pasur ende, nuk është e qartë se sa strikt do të jetë Sekretariati në aplikimin e rregullës 29(1) në rast se një rast i tillë shfaqet. Siç do diskutohet në vijim, fjalia e parë e Rregullës 29(4) bën përjashtim për parashtrimin e dokumenteve në gjuhët turke, boshnjake apo rome. Nëse do të aplikohej në mënyrë të përpiktë, Rregulla 29(1) parasheh që Sekretariati t'i kërkojë parashtruesit të kërkesës parashtrimin e përkthimit të kërkesës së tij/saj në shqip dhe serbisht dhe do ta konsideronte, me gjasë, kërkesën jo të plotë përderisa të mos jetë dorëzuar përkthimi në njërën nga gjuhët zyrtare.
Përveç çështjes së diskriminimit që u shtjellua më sipër, parashtruesi i mundshëm i kërkesës gjithashtu do të mund të mbronte tezën se e drejta e tij për t'iu qasur Gjykatës Kushtetuese, si pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë, do të mohohej nëse ai obligohet që ta përkthejë kërkesën nga një gjuhë 'në përdorim zyrtar' në një 'gjuhë zyrtare në Kosovë', e në veçanti nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka mjete të mjaftueshme për t'i paguar shpenzimet e përkthimit në fjalë. Do t'i mbetej Gjykatës për të vendosur se si të trajtojë ankesat e mundshme lidhur me Rregulloren. Për shembull, Ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të

[319] Faqja e Gjykatës Kushtetuese në internet është: www.gjk-ks.org.

Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë[320], përcakton në nenin 15 se: "*Në procedurë penale në përdorim janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze dhe shkrimi i tyre. Ndonjë gjuhë apo shkrim tjetër gjithashtu mund të përdoret nëse brenda juridiksionit territorial të veçantë të një gjykate është paraparë me ligj*", ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit thotë se "*Deklaratat, ankesat dhe parashtresat tjera mund të dorëzohen në gjykatë në gjuhën angleze, shqipe ose serbe ose në ndonjë gjuhë tjetër, duke pasur parasysh dispozitat e Kornizës Kushtetuese dhe çfarëdo ligji që parasheh përdorimin e një gjuhe tjetër brenda juridiksionit territorial të veçantë të një gjykate […].* Supozohet se pasi që Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë nuk është më në fuqi, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës më 15 qershor 2008, neni 15(1) i Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës[321] duhet të lexohet në frymën e nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila nuk e përmend anglishten si gjuhë zyrtare. Megjithatë, në pajtim me parimin e sigurisë juridike, përderisa Ligji të mos ndryshohet në pajtim me nenin 5 të Kushtetutës, çdo person do duhej të jetë në gjendje të bazohet në dispozitat e të njëjtit ligj dhe rrjedhimisht mund ta konsiderojë ende anglishten si gjuhë të përmendur në nenin 15(1) gjuhë zyrtare në procedurat penale para gjykatave.[322]

Sa u përket gjuhëve turke, boshnjake dhe rome, të cilat sipas nenit 5.2 të Kushtetutës, kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal apo janë në përdorim zyrtar në të gjitha nivelet të cilat përcaktohen me ligj, çdo person do duhej të ketë të drejtë t'i shfrytëzojë këto gjuhë në procedurë penale, në bazë të fjalisë së dytë të nenit 15(1) të Ligjit të lartpërmendur, i cili rregullon se: "*Ndonjë gjuhë apo shkrim tjetër gjithashtu mund të përdoret nëse brenda juridiksionit territorial të veçantë të një gjykate është paraparë me ligj.*" Rrjedhimisht, së paku në nivel të gjykatave komunale penale, çdo person do duhej të jetë në gjendje të shfrytëzojë gjuhët turke, boshnjake apo rome në vend të shqipes dhe serbishtes. Në procedura të apelit para Gjykatave të Qarkut dhe Gjykatës Supreme, i njëjti person do të mund të shfrytëzonte nenin 24 [Barazia Para Ligjit] dhe argumentet e tij për të pretenduar diskriminim në rast se nuk lejohet të përdorë këto gjuhë të cilat ka mundur t'i përdorë në procedurë para gjykatës komunale.

Për sa u përket procedurave civile, neni 6 i Kapitullit I të Pjesës së Parë [Dispozitat Themelore] të Ligjit për Procedurën Kontestimore[323] përcakton: "*6.1 Procedura kontestimore zhvillohet në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë. 6.2 Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, të cilët nuk e kuptojnë apo nuk e flasin gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë kanë të drejtë që të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën që e kuptojnë.*" Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 96 të Kapitullit VI [Gjuha në Procedurë] shtjellon në mënyrë më të detajuar çështjen e gjuhës: "*96.1 Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë. 96.2 Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e*

[320] Ligji Nr. 03/L-003, ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.
[321] Ligji Nr. 03/L-002 i datës 6 nëntor 2008.
[322] Kuvendi do duhej të sigurojë pajtueshmërinë e Ligjit me Kushtetutën.
[323] Shih Ligjin Nr. 03/L-006 të datës 30 qershor 2008.

tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtresave dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrohet në seancë gjyqësore." Për më tepër, neni 98 thotë: *"Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë i dërgojnë gjykatës paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera të tyre në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë."*
Edhe pse neni 6 i Ligjit të Procedurës Kontestimore duket se autorizon të gjitha palët që të flasin në çfarëdo gjuhe që ai/ajo kupton dhe të ketë përkthim sipas nevojës, ai kërkon nga palët që parashtresat t'i dërgojnë në "gjuhët zyrtare të gjykatës". Nenet 96 dhe 98 përcaktojnë të njëjtat kërkesa në mënyrë më të detajuar. Rrjedhimisht, çështja e gjuhëve ngritet vetëm kur palët dhe pjesëmarrësit tjerë duan të dërgojnë pretendime, ankesa dhe parashtresa në gjykatë. Në parim, sipas nenit 5 të Kushtetutës, gjuhët zyrtare janë shqipja dhe serbishtja, por pasi që gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal, palët dhe pjesëmarrësit e tillë do duhej të lejohen që parashtresat t'i bëjnë në gjuhët në fjalë së paku pranë gjykatave komunale. Sa u përket procedurave civile në gjykata, lidhur me përdorimin e gjuhëve do duhej të shfrytëzohen të njëjtat argumente sikur për procedurat penale. Megjithatë, për hir të transparencës dhe sigurisë ligjore, ligjvënësit do duhej të sjellin më shumë sqarime dhe t'i amendamentojnë ligjet në fjalë përkitazi.
Sa i përket kërkesës së parashtruar në Rregull se kërkesa duhet të përmbajë datën e parashtrimit, nuk është e qartë se çka do të thotë kjo. Natyrisht se kërkesa duhet të përmbajë datën në të cilën kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij, por kjo datë nuk është shumë e rëndësishme. Në fakt e vetmja datë e rëndësishme është data e regjistrimit të kërkesës nga Sekretaria, pasi që siç u përmend më sipër kjo datë është e rëndësishme për kalkulimin e afatit katërmujor që përcaktohet në nenin 49 të Ligjit.
Kur kërkesa dërgohet me postë, pritet që Sekretariati të shfrytëzojë datën e vënë në pullë postare si datë të regjistrimit në Gjykatë, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk mund të mbahet përgjegjës për çfarëdo vonese të shërbimit postar. Kur parashtruesi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij/saj parashtron kërkesën në Gjykatë personalisht apo përmes mjeteve të komunikimit elektronik, data e vizitës në Gjykatë apo data e dërgimit të postës elektronike në adresën elektronike të Gjykatës do të jetë data në të cilën kërkesa është dërguar dhe në të cilën asaj i është dhënë numri i regjistrit.
Sa i përket nënshkrimit të kërkesës[324], është paksa befasuese përse Rregulla kërkon vetëm nënshkrimin e personit që parashtron kërkesën, por jo edhe ndonjë dëshmi të identitetit të personit, siç do të ishte letërnjoftimi, pasaporta apo kopjet e certifikuara të tyre. Edhe pse kjo nuk parashihet me Ligj apo Rregullore të Punës, Sekretariati do duhej që të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës që të identifikojë veten në momentin e parashtrimit të kërkesës apo, nëse kërkesa parashtrohet me postë apo elektronikisht, të dorëzojë edhe një fotokopje apo kopje të skanuar të letërnjoftimit apo pasaportës. Në rast se parashtruesi i kërkesës përfaqësohet ligjërisht nga dikush tjetër, përfaqësuesi i tij/saj nuk do duhej të dorëzojë vetëm autorizimin ligjor të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës dhe ai/ajo, por edhe dëshmi të identitetit të tij dhe, nëse personi në fjalë është avokat, dëshmi të

[324] Sa i përket nënshkrimit të kërkesave të parashtruara në formë elektronike, shih komentet për Rregullën 29(5) më poshtë.

anëtarësisë së tij në odën e avokatëve (shih më tej komentet për Rregullën 29(2)(b) dhe 29(2)(c) më poshtë). Sugjerohet që Ligji dhe/ose Rregullorja e Punës të ndryshohen për të siguruar këtë.

II. Sipas Rregullës 29(2), parashtruesi i kërkesës duhet të vendosë në të edhe emrin dhe adresën e tij/saj. Edhe në këtë rast nuk përmendet fare kërkesa për të paraqitur edhe dokumente valide të identitetit të lëshuara nga autoritete kompetente, të cilat do t'i mundësonin Sekretariatit verifikimin nëse të dhënat personale të përmendura në kërkesë korrespondojnë me ato të dokumenteve identifikuese. Natyrisht se në rast dyshimi Gjykata mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës që të paraqesë dëshmi për identitetin e tij/saj kurdo gjatë procedurës, por do duhej të jetë Sekretariati ai i cili në momentin e pranimit të kërkesës duhet të verifikojë nëse emri dhe adresa e parashtruesit të kërkesës janë të sakta.

Sa u përket parashtruesve potencialë të kërkesave që jetojnë jashtë vendit, ata duhet të dorëzojnë kopje (të certifikuara) të dokumenteve të tyre të identifikimit, të lëshuara nga autoritetet në shtetin ku banojnë apo shtetin e origjinës.

Në rast se parashtruesi i kërkesës është i përfaqësuar në bazë të autorizimit, nënparagrafi (b) kërkon që të vendoset vetëm emri dhe adresa e përfaqësuesit, në mënyrë që Sekretariati të jetë në gjendje të komunikojë me të në lidhje me dërgimin e shkresave. Megjithatë, siç u përmend më sipër kur bëhej fjalë për fjalinë e dytë të Rregullës 29(1), as Ligji e as Rregullorja e Punës nuk duket se kërkojnë nga përfaqësuesi që të dorëzojë çfarëdo dëshmie mbi identitetin e tij/saj. Sugjerohet ndryshimi i kësaj Rregulle në mënyrë që nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës të kërkohet dorëzimi i dëshmive për identitetin e tij/saj në momentin e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë. Siç u përmend më sipër, nëse përfaqësuesi është avokat, ai/ajo duhet të paraqesë edhe dëshmi të anëtarësisë në odën e avokatëve.

As Ligji e as Rregullorja e Punës nuk i obligojnë parashtruesit e kërkesës që të përfaqësohen nga ndonjë avokat apo përfaqësues tjetër i kualifikuar ligjor. Edhe pse përfaqësimi nga avokatët sigurisht se nuk përbën garanci për gjasa më të mira të kërkesës për të qenë e suksesshme, ai mund të sigurojë përgatitje më të mirë të arsyetimit të kërkesës dhe bën që parashtruesit të mos i parashtrojnë kërkesa që nuk janë të argumentuara, apo që janë të papranueshme për arsye evidente, në veçanti në kuptim të mosshterrjes së të gjitha mjeteve juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm apo mospërputhjes me kërkesat e afatit katërmujor.

Megjithatë, përfaqësimi i obligueshëm nga avokati nuk është kërkuar nga hartuesit e Ligjit. Në veçanti ka mundur të parashihet përfaqësim i tillë mandator për ankesat kushtetuese të parashtruara sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Mbase pasi që siç u përmend më herët Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është drejtpërsëdrejti e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, nuk kërkon përfaqësim të domosdoshëm nga avokati me rastin e parashtrimit të kërkesës para GjEDNj-së, atëherë edhe hartuesit e ligjit nuk kanë vendosur të imponojnë një obligim të tillë.[325] Sa u përket rregullave të Strasburgut, vetëm kur një rast t'i jetë

[325] Për shembull, në Francë parashtrimi i një kërkese pranë Gjykatës Kushtetuese duhet të bëhet nga avokati që përfaqëson parashtruesin e kërkesës.

komunikuar Palës së Lartë Kontraktuese, GjEDNj-ja[326] kërkon nga parashtruesi i kërkesës që të ketë përfaqësim ligjor dhe do t'ia mundësojë atij/asaj kërkimin e ndihmës juridike pa pagesë, nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar përfaqësimin në fjalë. Është e qartë se, në të kundërtën, do të kishim të bëjmë me shkelje të parimit të barazisë së armëve nëse në procedurat para GjEDNj-së parashtruesi i kërkesës do obligohej të paraqesë rastin e tij/saj pa ndihmë juridike, ndërsa Pala e Lartë Kontraktuese do të mund të shfrytëzonte ekspertët më të kualifikuar juridikë në kundërshtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk kualifikohet për ndihmë juridike pa pagesë, por ka angazhuar një avokat, atëherë GjEDNj-ja mund t'ia mbulojë një pjesë të shumës që ai/ajo duhet të paguajë.[327]

Sa u përket procedurave para Gjykatës, mund të jetë e dobishme dhe legjitime që në të njëjtat baza të vendoset një Rregull i ngjashëm me atë që zbatohet në GjEDNj-në, posaçërisht pasi që Gjykata të ketë vendosur që ta shpallë kërkesën të pranueshme, e edhe më shumë nëse ka vendosur që të mbajë seancë dëgjimore për lëndën në fjalë.

Nëse parashtruesit e kërkesës përfaqësohen nga një avokat apo përfaqësues tjetër, ata duhet të paraqesin edhe autorizimin ligjor, në të cilin thuhet qartë se e autorizojnë përfaqësuesin në fjalë që t'i përfaqësojë në procedurat para Gjykatës. Në fakt, autorizimi do duhej të mbajë emrat dhe nënshkrimet dhe adresat e parashtruesit (parashtruesve) të kërkesës dhe përfaqësuesit (përfaqësuesve), përfshirë kopjet (e certifikuara) të letërnjoftimeve të tyre dhe, në rast të përfaqësimit nga një avokat, të anëtarësimit të përfaqësuesit në odën e avokatëve.

Rregulli kërkon që parashtruesit perspektivë të kërkesave të tregojnë edhe emrin dhe adresën e palës apo palëve kundërshtare, nëse të njëjtat janë të ditura, në mënyrë që Sekretariati të mund t'ia komunikojë kërkesën edhe palës apo palëve përkatëse për komente. Në të shumtën e rasteve, parashtruesit e kërkesës do ta dinë se kush është pala kundërshtare. Megjithatë, kur një parashtrues i kërkesës është në gjendje të përshkruajë padrejtësitë e një procedure të caktuar gjyqësore, ai/ajo do të duhej të jetë në gjendje të japë edhe emrat dhe adresat e palës (palëve) kundërshtare në procedurë pranë gjykatës (gjykatave) përkatëse. Në pajtim me fjalinë e parë të nenit 22.2 të Ligjit, Sekretariati do duhej t'ia dërgojë kopjet e kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë.

Do të ishte më logjike që të vendoset një paragraf i ri (e) në fund të Rregullës 29(2), pasi që pyetja lidhur me mjetet e shfrytëzuara zakonisht vendoset në fund të kërkesës, pas pretendimeve dhe justifikimit të kërkesës. Sa i përket vetë Rregullës, ai kërkon që parashtruesit e kërkesave të deklarojnë detajet e mjeteve juridike të shfrytëzuara. Ata nuk mund të presin që Gjykata të zbulojë me iniciativë të vet se cilat mjete juridike parashtruesit e kërkesave mund t'i kenë shfrytëzuar. Për shembull, në rast se një individ është ankuar lidhur me ekstradimin e vet, duke pretenduar se ekstradimi në fjalë do ta shpinte atë në një shtet që do ta nënshtronte ndaj trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, gjë që shprehimisht ndalohet me nenin 27

[326] Për më shumë detaje, shih Kapitullin X [Ndihma Juridike], Rregullat 91, 92 dhe 93 deri 96 të Rregullores së Gjykatës së GjEDNj-së.
[327] Po aty.

[Parandalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues][328] të Kushtetutës dhe instrumentet tjera ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë (siç është neni 3 [Ndalimi i Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues] i KEDNj-së), ai/ajo me siguri do të deklarojë se kërkesa e tij/saj do të jetë mosekstradimi apo deportimi. Është pothuajse e sigurt se në një shembull të tillë parashtruesi i kërkesës gjithashtu do të kërkojë nga Gjykata që të shqiptojë masë të përkohshme, në mënyrë që qeveria, si palë kundërshtare, të mos lejohet që të ekstradojë parashtruesin e kërkesës gjatë procedurës para Gjykatës apo deri sa parashtruesi i kërkesës të mos ketë shterur të gjitha mjetet juridike të cilat i ka në dispozicion në bazë të ligjit të zbatueshëm (për më shumë komente, shih nenin 27 [Masat e Përkohshme] të Ligjit)[329]

Shembull tjetër është ai i një individi që pretendon se autoritetet publike ia kanë privuar të drejtën e tij/saj në pronë, duke shkelur kësisoj nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, i cili do të thotë se nëse kërkesa e tij ka sukses ai/ajo dëshiron ta kthejë pronën. Në të gjitha parashtrimet e dorëzuara nga palët e autorizuara nën nenin 113 të Kushtetutës, duhet të përcaktohet qartë qëllimi i kërkesës. Megjithatë, ka pasur raste kur Gjykata është dashur të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës që ta elaborojë rregullimin e kërkuar.[330]

Dhënia e një përshkrimi të shkurtër dhe të qartë të fakteve mund të mos jetë aq i lehtë sa mund të duket. Parashtruesit e kërkesave mund të mendojnë se është me rëndësi që të jepen sa më shumë detaje që është e mundshme, pa dalluar qartë mes asaj që faktikisht ka ndodhur dhe vlerësimit të tyre mbi faktet. Parashtruesit e kërkesës duhet të paraqesin faktet dhe të mbrojnë argumentet e tyre në mënyrë të qartë dhe koncize dhe në aspekt kronologjik, duke përfshirë një kopje të parashtresave të tyre gjatë procedurave relevante administrative, gjyqësore apo tjera, nëse kanë të tilla. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të përkrahen nga dokumentacioni i domosdoshëm dhe nga informatat tjera relevante, të cilat do t'i mundësonin Gjykatës që të vërtetojnë autenticitetin e fakteve dhe ngjarjeve të pretenduara. Për të lehtësuar këtë detyrë të formulimit të fakteve në mënyrën më të qartë të mundshme, parashtruesi i kërkesës thjeshtë duhet të shohë si shembull tekstet e vendimeve të Gjykatës që publikohen në faqen e saj në internet, ku faktet ("Përmbledhja e Fakteve") paraqiten në mënyrën e kërkuar, dhe thjeshtë të ndjekin këtë shembull.

Parashtruesit perspektivë të kërkesës duhet të jenë në gjendje të justifikojnë se si në rrethanat e rastit ata i kanë ndjekur të gjitha procedurat e duhura sipas ligjeve të Kosovës (ky kusht duket të jetë i ngjashëm me kërkesën për shterje të mjeteve

[328] *"Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues."*

[329] Shih, për shembull, një rast kur parashtruesit e kërkesës të cilët ishin para largimit nga Kosova, parashtruan kërkesë para Gjykatës, duke kërkuar edhe shqiptimin e masave të përkohshme: Lënda Nr. KI 121/10, Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan dhe Hom Bahadur Battarai, Shqyrtimi kushtetues i Vendimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL Nr. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 161/2010, e datës 22 nëntor 2010, Vendimi për Papranueshmëri i datës 14 dhjetor 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 669; dhe në faqen e Gjykatës në internet.

[330] Shih, për shembull, Lënda Nr. KO 05/12, të parashtruar nga Visar Ymeri dhe 12 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vendimi për Papranueshmëri i datës 19 mars 2012 (për tekstin e plotë, shih faqen e Gjykatës në internet).

juridike që përcaktohet në Rregullën 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së Punës, i cili komentohet më poshtë).
Në anën tjetër, parashtruesi perspektiv i kërkesës duhet të justifikojë se substanca e kërkesës bie nën kompetencat e Gjykatës dhe se faktet e dhëna në kërkesë përbëjnë vërtetë shkelje të Kushtetutës, Siç u theksua më lartë, edhe pse nga parashtruesit individualë të kërkesave nuk kërkohet shprehimisht që të përmendin shkeljen e pretenduar të neneve specifike të Kushtetutës në procedurat para gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës dhe GjEDNj-së, ata së paku duhet të thirren në të drejtat dhe liritë përkatëse në mënyrë substanciale.
Pa dokumente përkrahëse dhe informata tjera të domosdoshme, kërkesa kurrsesi nuk mund të rezultojë e suksesshme. Ato përbëjnë bazamentin e lëndës dhe do t'i mundësojnë Gjykatës që të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është në pajtueshmëri me të gjitha kushtet për pranueshmërinë e kërkesës (apo nuk ka qenë në gjendje që të sigurojë këtë pajtueshmëri për arsye të justifikueshme) dhe të verifikojë nëse faktet që kërkesa i përmban përkrahin pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të Kushtetutës. Kjo qartazi do të thotë se dokumentet dhe informatat të cilat nuk e përkrahin kërkesën përkatëse nuk duhet të parashtrohen fare. Siç u cek edhe më lartë, parashtruesit e kërkesës megjithatë mund të mendojnë se është e dobishme për Gjykatën që të ketë në dispozicion të gjitha dokumentet që ata i posedojnë në lidhje me lëndën, edhe nëse shumë prej tyre janë irelevante. Ata mund t'ia vështirësojnë punën Gjyqtarit Raportues i cili duhet të përgatitë Raportin Preliminar për Kolegjin Shqyrtues, pasi që ai së pari duhet të ndajë dokumentet irelevante e tek më pas të fillojë me procedimin dhe përgatitjen e raportit mbi pranueshmërinë e kërkesës. Natyrisht, vlerësimi i parë i dokumenteve të parashtruara bëhet me rastin e ardhjes së parashtruesit të kërkesës në Gjykatë për të dorëzuar kërkesën dhe pranimin e saj nga punonjësi i Gjykatës, i cili do të mund t'ia bënte parashtruesit të kërkesës me dije se disa dokumente të caktuara janë thjeshtë irelevante për kërkesën. Kësisoj, përzgjedhja e parë e dokumenteve të parashtruara mund të bëhet nga punonjësi, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia që parashtruesi i kërkesës të ngulë këmbë që punonjësi t'i mbajë të gjitha dokumentet, përfshirë edhe ato irelevante, apo që dokumentet e tilla t'i dorëzojë në fazat e mëpasshme. Sërish duhet theksuar se është detyrë e parashtruesit të kërkesës që të mbrojë rastin e vet para Gjykatës dhe një gjë e tillë mund të bëhet me sukses vetëm me ndihmën e dokumenteve dhe informatave relevante.

III. Formulimi i fjalisë së parë dhe të dytë të Rregullës 29(3) është i ngjashëm me ato që veç janë diskutuar në lidhje me fjalinë e katërt të nenit 22.1. I njëjti vetëm shton se kopjet e pjesëve relevante të dokumentit duhet t’i bashkëngjiten kërkesës. Në realitet, parashtruesit e kërkesës mund të preferojnë bashkëngjitjen e tërë dokumentit dhe jo vetëm të disa pjesëve, pasi që sipas tyre do të ishte me rëndësi për Gjykatën që të lexojë edhe pjesët tjera të dokumentit për të kuptuar më mirë kontekstin e ngjarjeve të përshkruara në pjesën relevante të dokumentit.

IV. Jo sikur fjalia e parë e Rregullës 29(1), e cila kërkon që kërkesa të plotësohet në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, fjalia e parë e Rregullës 29(4)

lejon që dokumentet tjera përkrahëse të dorëzohen në gjuhët zyrtare apo në njërën nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë, d.m.th. në gjuhët turke, boshnjake dhe rome, të cilat përmenden në nenin 5.2 të Kushtetutës.[331] Megjithatë, nuk është e kuptueshme se përse vetëm dokumentet mund të dorëzohen në gjuhë zyrtare apo gjuhë në përdorim zyrtar, por pjesa tjetër e kërkesës duhet të plotësohet në njërën nga gjuhët zyrtare. Siç u theksua edhe më sipër, parashtruesit e kërkesës këtë mund ta konsiderojnë diskriminim dhe shkelje të të drejtës së tyre për t'iu qasur Gjykatës.
Edhe pse parashtruesit e kërkesës kanë të drejtë të dorëzojnë dokumentet e tyre në një gjuhë tjetër, përveç gjuhëve të lartpërmendura, ata duhet të ofrojnë përkrah dokumentit edhe përkthimin e certifikuar në njërën nga "gjuhët në përdorim në Kosovë," gjë që nënkupton një nga gjuhët zyrtare (gjuhë shqipe apo serbe), apo gjuhë në përdorim zyrtar (gjuhë turke, boshnjake apo rome). Nëse parashtruesit e kërkesës duan t'i parashtrojnë vetëm pjesët relevante të një dokumenti të tillë, përkthimit duhet t'i bashkëngjitet edhe shpjegimi i pjesëve të dokumentit që janë përkthyer. Në praktikë, parashtruesit e kërkesës më me dëshirë dorëzojnë dokumentet e plota se sa të sqarojnë se cilat pjesë të një dokumenti janë përkthyer e cilat jo. Aq më tepër, Gjykata prapëseprapë mund të kërkojë nga parashtruesit e kërkesës që të dorëzojnë edhe përkthimet e pjesëve tjera të dokumenteve të përkthyera pjesërisht më vonë.
Megjithatë, nëse një parashtrues i kërkesës obligohet që të parashtrojë përkthime të certifikuara të dokumenteve të caktuara para Gjykatës në rrethanat e përshkruara në Rregull, mund të ketë raste kur parashtruesi i kërkesës nuk ka resurse financiare të mjaftueshme për të paguar përkthimin e dokumenteve në fjalë. Kësisoj, e drejta e parashtruesit të kërkesës për t'iu qasur Gjykatës mund të rrezikohet seriozisht, nëse ai/ajo nuk mund t'i parashtrojë dokumentet përkrahëse në njërën nga gjuhët e kërkuara. Si duket ky problem nuk është paraqitur ende, megjithatë, kjo përbën një çështje të rëndësishme e cila duhet trajtuar më tej dhe duhet të rezultojë me amendamentimin e kësaj Rregulle, në veçanti kur kërkesat janë *prima facie* të pranueshme.

V. Nuk është automatikisht e qartë se çfarë procedure Sekretariati do duhej të zhvillojë për të kontrolluar autenticitetin e përkthimeve të parashtruara. Nëse përkthimi bartë vulën certifikuese, të vënë nga një përkthyes i certifikuar apo kompani e përkthimit, autenticiteti i përkthimit duhet të konsiderohet i garantuar, përveç nëse ka dyshime serioze mbi vetë autenticitetin e certifikimit. Po aq e rëndësishme për Sekretariatin mund të jetë kontrollimi i autenticitetit të vetë dokumentit të përkthyer, për t'u siguruar se i njëjti nuk është i falsifikuar.

VI. Kërkesa strikte e fjalisë së dytë të nenit 22.1 të Ligjit që kërkesat të dorëzohen në Sekretariat me shkrim është zbutur nga Rregulla 29(6) i cili u lejon parashtruesve të kërkesës që atë ta parashtrojnë personalisht në zyra të Sekretarisë dhe përmes mjeteve të komunikimit elektronik. Praktika dëshmon se gjatë orarit të punës në Gjykatë, parashtruesit perspektivë të kërkesave dhe/ose përfaqësuesit e tyre

[331] Neni 5.2 i Kushtetutës thotë: "*Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.*"

pranohen nga një punonjës i cili e kontrollon kërkesën për të siguruar pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e përmendura në Rregullën 29(2) të komentuar më lartë.
Nëse formulari i kërkesës i Gjykatës ende nuk është plotësuar apo nuk është plotësuar tërësisht, punonjësi do të sqarojë (1) si të plotësohet formulari në mënyrë adekuate (i njëjti mund të shkarkohet nga faqja e Gjykatës në internet)[332], (2) cilat kritere të pranueshmërisë duhet të plotësohen, (3) se ankesat kushtetuese duhet të argumentohen dhe përkrahen me dëshmi të nevojshme (vendime të autoriteteve publike, vendime të gjykatave dhe dokumente tjera). Punonjësi, megjithatë, nuk do të japë këshilla lidhur me atë se si t'i paraqitet kërkesa Gjykatës më së miri. Pas vizitës së tyre në Gjykatë, parashtruesit perspektivë të kërkesave mund të shkojnë prapa në shtëpi për të përgatitur kërkesën në mënyrën e sqaruar nga punonjësi dhe të kthehen në Gjykatë sa më shpejt që munden me kërkesën e plotësuar dhe dokumentet përkrahëse. Ka të tjerë të cilët si duket vijnë në Gjykatë me kërkesë të plotësuar dhe e lënë aty për t'u regjistruar si rast i pazgjidhur para Gjykatës.
Megjithatë, nëse gjatë vizitës bëhet e qartë se parashtruesi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij/saj nuk do të jenë në gjendje të justifikojnë pretendimet e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe nuk do të mund të dorëzojnë informatat e domosdoshme dhe dokumentet përkrahëse, për shkak se nuk janë shterur të gjitha mjetet juridike të cilat i kanë pasur në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm (për komente të mëtejme në temën e shterjes së mjeteve juridike shih komentet për nenin 47.2 më poshtë), punonjësi mund t'ia tërheqë vëmendjen parashtruesit të kërkesës dhe/ose përfaqësuesit të tij/saj se kërkesa nuk do të ketë shumë gjasa që të jetë e suksesshme dhe, rrjedhimisht do të shpallej e papranueshme nga Gjykata; thënë shkurt, se nuk ka shumë kuptim që të regjistrohet kërkesa dhe të kërkohet nga Gjykata që të merret me këtë lëndë.
Nëse parashtruesi i kërkesës pajtohet dhe nuk insiston që ta regjistrojë ankesën e tij si kërkesë, pasi që ai/ajo ende për shembull mund të ketë mundësi të shterë mjetet juridike në dispozicion, kjo i ndihmon shumë Gjykatës pasi që dukshëm ia zbret numrin e lëndëve të pazgjidhura. Natyrisht, nëse një parashtrues i kërkesës apo përfaqësues i tij/saj ngulë këmbë që ta regjistrojë kërkesën, në bazë të së drejtës së tij/saj kushtetuese për të parashtruar kërkesën në Gjykatë dhe për të kërkuar shqyrtimin e saj, Sekretariati do ta regjistrojë kërkesën.
Dispozita gjithashtu parasheh se parashtruesit e kërkesës mund të parashtrojnë ato edhe përmes mjeteve të komunikimit elektronik. Prandaj, çdo parashtrues perspektiv i kërkesës i cili ka qasje në internet mund ta plotësojnë formularin në formë elektronike, t'i skanojë të gjitha dokumentet përkrahëse të kërkesës dhe t'i dërgojë ato në adresën elektronike të Gjykatës (info@gjk-ks.org). Ky lloj i komunikimit me Sekretariatin sigurisht se do të mbetet përjashtim nga rregulla, pasi që shumë parashtrues të kërkesës nuk kanë qasje në internet, apo thjeshtë preferojnë të shkojnë në Gjykatë për t'i dorëzuar kërkesat e tyre personalisht. Kur një kërkesë pranohet në Gjykatë përmes mjeteve të komunikimit elektronik, ajo kontrollohet ngjashëm me mënyrën e përshkruar më lartë. Parashtruesi i kërkesës do të pranojë konfirmimin e pranimit të kërkesës përmes emailit, por në të njëjtën kohë nga ai do të kërkohet që të dorëzojë formularin e nënshkruar të kërkesës dhe

[332] www.gjk-ks.org

dokumentet shtesë përmes postës së rekomanduar. Nëse është e domosdoshme, Sekretariati do ta dërgojë edhe konfirmimin e njoftimit që përmban numrin regjistrues të lëndës edhe me email edhe me postë të rekomanduar[333].

VII. Në pajtim me Rregullën 29(7) dhe siç u sqarua më sipër, Gjykata ka përpiluar një formular të kërkesës[334] si dhe udhëzimet[335] që përmbajnë instruksione për parashtruesit perspektivë të kërkesës se si të plotësohen të njëjtit (me apo pa ndihmë të një përfaqësuesi) dhe si të parashtrohen në Gjykatë. Formulari i kërkesës përmban një sërë pyetjesh të cilat kryesisht bazohen në Rregullat 29(2)(a) deri në (h) dhe duhet të përgjigjen nga parashtruesit e kërkesës para se të dorëzohen në Sekretariat. Formularët e kërkesës dhe udhëzimet mund të shkarkohen nga faqja e Gjykatës në internet (www.gjk-ks.org), apo tks.orgp://www.gjk-ks.org"rashtruesit perspektivë të kërkesës se si të plotësohen të njëjtit (me apo prkesës përbëjnë bërthamën e dosjes së lëndës të cilën Departamenti për Regjistrimin e Lëndëve, Statistika dhe Arkiv (DRLSA) brenda Sekretariatit e krijon për çdo kërkesë dhe në bazë të së cilës Gjyqtari raportues do tgp://www.gjk-ks.org"rashtruesit perspajtim me nenin 22.3 të Ligjit, i cili u komentua më lartë.

VIII. Sipas Rregullës 29(8), pdo tgp://www.gjk-ks.org"rashtruesit perspajtim me nenin 22.3 të Ligjit, i cili u komentua më lartë.prkesës përbëjnë bërthamën e dosjes së lëndës të cilën Departamashtrimin e kërkesave në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesave sipas nenit 29 vlejnë njëjtë *mutatis mutandis* putatis mutandis /www.gjk-ks.org" rashtruesit perspajtim me nenin 22.3 të Ligjit, i cili u komentua më lartë prkesës përbëjnë bërtham.

Rregulli 30 [Regjistrimi i Kërkesës dhe i Përgjigjes] i Rregullores së Punës

1. **Sekretari i Përgjithshëm e regjistron kërkesën menjëherë pasi të jetë dorëzuar ajo, apo çfarëdo dokumenti, madje edhe në rastet kur kërkesa nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme. Sekretariati mban një listë kontrolluese të dokumenteve të nevojshme dhe mund të ndihmojë palët duke shpjeguar se çfarë mungon në kërkesë.**
2. **Nëse një kërkesë nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme, Sekretariati e njofton parashtruesin e kërkesës se kërkesa duhet të plotësohet me dokumentet e specifikuara në kërkesë dhe e përcakton saktë se këto dokumente duhet të dorëzohen brenda afatit 30-ditësh.**
3. **Sekretariati mban regjistrin në të cilin regjistrohen të gjitha kërkesat dhe përgjigjet, përfshirë këto të dhëna:**

[333] Për shembull, Rregulla 35(2) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë përcakton se "Kërkesat të cilat dorëzohen në formë elektronike, por të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e sigurt në bazë të certifikatës kualifikuese nuk konsiderohen kërkesa të cilat Gjykata Kushtetuese i pranon nën kornizën e funksionimit të zyrës, prandaj kjo e fundit nuk është e obliguar t'u përgjigjet atyre."

[334] Formulari për parashtrimin e kërkesave sipas nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenet 46, 47, 48, 49 dhe 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

[335] Udhëzimet që u ndihmojnë palëve në parashtrimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

(a) datën dhe kohën e parashtrimit;
(b) emrin e personit ose të personave që e kanë parashtruar kërkesën;
(c) numrin e regjistrimit të caktuar të kërkesës;
(d) Gjyqtarin raportues, të caktuar për këtë kërkesë; dhe
(e) Kolegjin shqyrtues, të caktuar për këtë kërkesë.

4. Për secilën kërkesë të regjistruar, Sekretariati krijon nga një dosje, e cila përmban të gjitha dokumentet dhe materialet e ndërlidhura me kërkesën, përgjigjen, nëse ka, dhe dokumentet e materialet e tjera të krijuara gjatë procedurës.

I. Fjalia e parë e Rregullit 30(1), e cila është pothuajse identike me tekstin e Rregullit 28 [Fillimi i Procedurës], qartë tregon se politika e Gjykatës është që të lehtësojë regjistrimin e kërkesave për aq sa është e mundshme, me kusht që parashtruesi të këtë dorëzuar të gjitha dokumentet e domosdoshme sa më shpejtë që është e mundshme. Politika e Gjykatës supozohet se bazohet në presupozimin se shumica e parashtruesve të kërkesave nuk e njohin procedurën e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë, prandaj, atyre duhet tu ndihmohet, kurdo që kjo është e nevojshme, duke ua sqaruar se çka mungon nga kërkesa e tyre.
Fjalia e dytë e Rregullit 30(1) kërkon nga Sekretariati që të mbajë (për çdo kërkesë) listën kontrolluese të dokumenteve të domosdoshme, e cila përbën pjesë të dosjes së lëndës dhe i mundëson Gjykatës verifikim të shpejtë të burimeve, natyrës dhe datës së dokumenteve.
Siç rregullohet më tej në fjalinë e dytë, Sekretariati (e në praktikë kjo bëhet nga këshilltari ligjor i Gjykatës nga i cili parashtruesit perspektivë të kërkesave pranohen në lokale të Gjykatës) mund t'i ndihmojë palëve duke u treguar se çka mungon në kërkesat e tyre. Kjo çështje veç është komentuar gjerësisht nën Rregullin 18 [Këshilltarët Ligjorë] më lartë. Shkurtimisht, këshilltari ligjor do t'i asistojë parashtruesve perspektivë të kërkesave në plotësimin e formularit të kërkesës, do t'u tregojë se cilat dokumente dhe informata janë të domosdoshme dhe do t'ia bëjë me dije kushtet që kërkesat duhet t'i plotësojnë për të qenë të pranueshme dhe të bazuara, para se Gjykata të mund të vendosë mbi meritat e tyre. Parashtruesit perspektivë të kërkesave do duhej t'i dorëzojnë dokumentet që mungojnë dhe parashtresat tjera sa më shpejtë që të jetë e mundur apo brenda afatit prej 30 ditësh që përcaktohet me Rregullin 30(2).

II. Rregulli 30(2) kërkon nga Sekretariati që të njoftojë parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij/saj është jo e plotë dhe se ai/ajo ka në dispozicion 30 ditë për të dorëzuar dokumentet që mungojnë. Rregulli nuk i përgjigjet pyetjes nëse Sekretariati ka të drejtë të caktojë ndonjë afat më të shkurtër, ngjashëm sikur Gjyqtari Raportues sipas fjalisë së parë të nenit 22.4, kur ai/ajo konsideron se kërkesa (apo përgjigja në kërkesë) është e paqartë ose jo e plotë dhe mund të caktojë një afat prej jo më shumë se 15-ditësh për të qartësuar dhe plotësuar kërkesën apo përgjigjen në të (për më shumë detaje shih komentet në nenin 22.4).

III. Rregulli 30.3 kërkon nga Sekretariati që të krijojë dhe mbajë një regjistër në të cilin do të regjistrohen të gjitha informatat e domosdoshme lidhur me kërkesat dhe përgjigjet e të cilat përmenden në Rregullin 30(3)(a) deri (e).

Megjithatë, Rregulli 30(3)(b) përballet me të njëjtën mangësi sikur edhe neni 22 i Ligjit dhe Rregullat 29(2)(a) deri (c) më sipër. Siç sugjerohet edhe për to, nuk do duhej të regjistrohet vetëm emri dhe adresa e parashtruesve perspektivë të kërkesave por edhe dëshmitë e identitetit të tyre, siç janë kopja e letërnjoftimit ose pasaportës, ndërsa Gjykata do të mund të urdhëronte kurdo gjatë procedurës parashtruesit e kërkesave dhe palët tjera që të paraqesin dokumentet origjinale. E njëjta vlen edhe për përfaqësuesit ligjorë, nëse ka të tillë, të cilët në Regjistër do duhej t'i regjistrojnë emrat dhe adresat si dhe autorizimet e nënshkruara (e nëse përfaqësuesit janë avokatë, edhe kopjen e anëtarësisë në odën e avokatëve). Rrjedhimisht, sugjerohet ndryshimi i nenit 22 dhe Rregullit në fjalë.

Për sa u përket Gjyqtarit Raportues dhe anëtarëve të Kolegjit Shqyrtues, në Regjistër do duhej të regjistroheshin jo vetëm emri i tyre dhe data dhe numri i Vendimit për Emërim nga Kryetari i Gjykatës.

IV. Edhe pse Rregulli 30(4) nuk ofron ndonjë detal lidhur me atë se si Sekretariati do duhej të krijojë dosjet e lëndëve, Sekretariati si duket mban komplet dosjet e lëndëve në formë të shtypur dhe në formë elektronike. Të vetëdijshëm mbi faktin se do të ishte tejet e rëndësishme që kjo Gjykatë Kushtetuese e re të krijojë një sistem efikas dhe modern të menaxhimit të lëndëve, dhe se Sekretariati i kësaj Gjykata do të ketë nevojë për asistencë të domosdoshme nga ekspertë të kualifikuar në krijimin e një sistemi të tillë për menaxhim të lëndëve në mënyrë lehtë të qasshme dhe miqësore për gjyqtarët dhe stafin relevant të Gjykatës, *East-West Management* i ka siguruar ekspertët e teknologjisë informative të cilët e kanë krijuar një sistem elektronik për menaxhimin e lëndëve, në të cilin kanë qasje gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë dhe i cili është i lehtë për përdorim.

Ekspertët është dashur të kenë parasysh se kërkesat dhe dokumentet përkrahëse dhe informatat tjera, përfshirë edhe ato që sajohen në fazat e mëvonshme të procedurës duhet të ekzistojnë në dy gjuhët zyrtare, si dhe në anglisht (disa dokumente nganjëherë janë edhe në ndonjërën nga tri gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë - shih komentet për Rregullin 29.4 më lartë) gjë që sigurisht e ka bërë në masë të konsiderueshme më të ndërlikuar krijimin dhe funksionimin e mirëfilltë të sistemit për menaxhimin e lëndëve. Sistemi është duke funksionuar tani një vit dhe përbën një aset të rëndësishëm në punën e gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë.

Ajo që Sekretariati duhet të bëjë me numrin e regjistrimit, pas arkivimit dhe regjistrimit të kërkesës, përcaktohet jo me Rregullin 30, por me paragrafin 1, respektivisht fjalinë e dytë të Rregullit 33 [Caktimi Gjyqtarit Raportues].

Rregulli 33 [Emërimi i Gjyqtarit Raportues] i Rregullores së Punës

1. Pas regjistrimit të kërkesës në Sekretariat, ajo duhet t'i përcillet Kryetarit, i cili emëron Gjyqtarin raportues, në pajtim me mënyrën e përcaktuar në rregullin 8. Sekretariati e njofton personin që ka parashtruar kërkesë dhe cilëndo palë kundërshtare ose cilëndo pale të interesuar për regjistrimin e kërkesës dhe për numrin e regjistrimit.

2. Pas emërimit të Gjyqtarit raportues, Sekretariati menjëherë ia përcjell atij kërkesën, përfshirë edhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura. Pasi

Sekretariati të marrë ndonjë përgjigje në kërkesë, përfshirë edhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura, do t'ia përcjell ato Gjyqtarit raportues.

I. Edhe pse Rregullat 8 dhe 33 mbajnë tituj identikë, përmbajtja e tyre nuk është e tillë. Fjalia e parë e Rregullit 33(1), mbi emërimin e Gjyqtarit Raportues, i referohet prapa Rregullit 8 dhe është e ngjashme me fjalinë e dytë të nenit 22.3 të Ligjit. Të dyja këto dispozita janë komentuar më sipër. Prandaj, në vijim do të komentohet vetëm fjalia e dytë e Rregullit 33(1).
Teksti i Rregullit nuk përcakton ndonjë afat kohor brenda së cilit Sekretariati duhet ta njoftojë parashtruesin e kërkesës dhe palën kundërshtare apo palët tjera mbi regjistrimin dhe numrin regjistrues të kërkesës në fjalë. Mbajtja e këtyre afateve kohore në minimum varet nga sistemi adekuat i menaxhimit të lëndëve, çfarë është sistemi i instaluar i CDMS.
Edhe pse kjo nuk përcaktohet në fjalinë e dytë, duhet të kuptohet se bashkë me regjistrimin e kërkesës dhe caktimin e numrit regjistrues të saj, Sekretariati duhet t'ia dërgojë palës kundërshtare ose palëve tjera të interesuara edhe vetë kërkesën, përfshirë formularin e kërkesës dhe parashtresat tjera, në mënyrë që këto palë të mund t'ia dërgojnë Sekretariatit "përgjigjen e tyre ndaj kërkesës, së bashku me justifikimin dhe dokumentet përkrahëse të domosdoshme", brenda 45 ditësh nga pranimi i kërkesës (siç përcaktohet në fjalinë e dytë të nenit 22.2 të Ligjit).
Formulimi "personi që ka parashtruar kërkesën" mund të nënkuptojë vetë parashtruesin e kërkesës apo parashtruesit e kërkesës si dhe përfaqësuesin e tij/saj/tyre (që jo domosdoshmërisht është avokat). Si rregull, pasi që një palë të ketë emëruar një përfaqësues, Sekretariati do të komunikojë vetëm me të. Do të thotë, vetëm përfaqësuesi do të njoftohet për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit.
Rregulli nuk cakton kurrfarë afati kohor brenda së cilit Sekretariati do duhej të njoftojë palët përkatëse mbi regjistrimin dhe numrin e regjistrimit. Supozohet se Sekretariati do të bëjë këtë në ditën e regjistrimit apo shpejt pas regjistrimit. Njëkohësisht me njoftimin e palës kundërshtare dhe palëve tjera të interesuara për regjistrimin e kërkesës dhe numrin përkatës të saj, Sekretariati do t'ia dërgojë atyre kërkesën dhe dokumentet përcjellëse për informim dhe komentim.

II. Rregulli 33(2) nuk dallon shumë nga fjalia e parë e nenit 22.3, dhe në fakt përsëritë se pas emërimit nga Kryetari i Gjykatës, Gjyqtari Raportues do të marrë nga Sekretariati tërë dosjen e lëndës së parashtruar si dhe të gjitha përgjigjet ndaj kërkesës (përfshirë të gjitha dokumentet e bashkëngjitura) të cilat dorëzohen nga pala kundërshtare apo ndonjë palë a pjesëmarrës tjetër.
Ngjashëm me fjalinë e parë të nenit 22.3 të Ligjit, edhe Rregulli 33(2) nuk ofron afat kohor brenda së cilit Sekretariati do duhej t'ia dërgojë kërkesën Gjyqtarit Raportues të emëruar për ta trajtuar lëndën. E njëjta ndodh edhe sa i përket afatit brenda së cilit Sekretariati do duhej t'ia dërgojë përgjigjet ndaj kërkesës Gjyqtarit Raportues. Kjo mund të sqarohet me faktin se Sekretariati kurrë nuk mund të jetë i sigurt se kur do të kthehen nga përkthimi dosja e lëndës dhe të gjitha përgjigjet në kërkesë, të cilat duhet tu dërgohen gjyqtarëve në shqip, serbisht dhe anglisht, do të thotë të përkthyera në të gjitha gjuhët. Megjithatë, Sekretariati, e në veçanti këshilltari ligjor i emëruar për kërkesën në fjalë, mund ta këshillojë Gjyqtarin

Raportues relevant që ta mos përkthejë tërë lëndën por vetëm pjesët relevante të saj, për shembull kur kemi të bëjmë me një rast që është qartë i papranueshëm, në mënyrë që të kursejë para dhe kohë. Në çdo rast, çështja e përkthimit do të vazhdojë të shkaktojë vonesa në procedurat para Gjykatës, në veçanti kur kemi të bëjmë me kërkesa e dosje të lëndëve komplekse, voluminoze dhe të vështira për tu përkthyer.

Rregulli 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues] i Rregullores së Punës

1. Raporti i Gjyqtarit raportues përmban:
(a) përshkrimin e fakteve të rastit;
(b) paraqitjen e fakteve të kontestuara dhe të pakontestuara;
(c) indikacionin se cila palë bart barrën e të provuarit të fakteve të kontestuara;
(d) argumentet juridike të paraqitura nga të gjitha palët;
(e) vlerësimin fillestar për pranueshmërinë e kërkesës; dhe
(f) vlerësimin fillestar për aspektet kryesore juridike të kërkesës.

2. Periudha kohore tridhjetë (30) ditë për dorëzimin e raportit nga Gjyqtari raportues, e përcaktuar në nenin 22.5 të Ligjit, nuk fillon derisa Gjyqtari raportues të mos ketë marrë nga dosja të gjitha dokumentet, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, përkthimin e të gjitha dokumenteve që duhet përkthyer.

I. Bazën e çdo kërkese dhe raporti preliminar të Gjyqtarit Raportues e përbëjnë përmbledhja e saktë e fakteve të pakontestuara, të nxjerra nga dokumentet origjinale, siç janë aktet administrative të autoriteteve publike dhe aktgjykimet e gjykatave, apo, nëse asnjë palë në procedurë nuk është në gjendje të ofrojë fakte, të nxjerra nga burime tjera. Vetëm në rastet kur faktet kontestohen dhe nuk ka dokumente tjera për të vërtetuar vërtetësinë e tyre, Gjyqtari Raportues duhet të tregojë se cila palë do ta bartë barrën e provave lidhur me faktet e kontestuara, apo të kërkojë që dëshmitë në fjalë të sigurohen nga të dyja palët apo nga palët e treta. Megjithatë, duhet kuptuar se barra fillestare për të ofruar justifikim *prima facie* se lënda duhet shqyrtuar bartet nga parashtruesi i kërkesës.

Është po ashtu e rëndësishme që të gjitha palët t'i paraqesin argumentet e tyre juridike në mënyrë të qartë dhe koncize, në mënyrë që t'i ndihmojnë Gjyqtarit Raportues që t'i kuptojë dhe vlerësojë më mirë ato, duke qenë se ai duhet t'i trajtojë ato në Raportin Preliminar të tij/saj.

Sa i përket vlerësimit tentativ të pranueshmërisë së kërkesës, që përmendet në paragrafin (e), Gjyqtari Raportues do duhej të verifikojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kërkesat procedurale para se që pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese të ekzaminohen nga Kolegji Shqyrtues dhe Gjykata. Në fakt, kushtet e pranueshmërisë gjenden në instrumente të ndryshme ligjore: (1) në Kushtetutë, (2) në Ligj, si dhe (3) në Rregullore të Punës. Për shembull, paragrafët 1 deri 9 të nenit 113 të Kushtetutës [Palët e Autorizuara] përmendin "palët e autorizuara" të cilat kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesa, si

dhe "çështjet të cilat palët e autorizuara ligjërisht mund t'i referojnë për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese".[336]

Për më tepër, neni 113.7 përmend "individët" si palë të autorizuara dhe çështjet për të cilat ata mund të ankohen ("shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë") dhe si kërkesë formale shtesë, faktin se ata mund të ngrenë çështje të tilla para Gjykatës "pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të garantuara me ligj".

Gjithashtu, Kapitulli III [Procedurat e Veçanta] të Ligjit përmbajnë për çdo kategori të palëve të autorizuara të përmendura në nenin 113 të Kushtetutës kushtet e Veçanta të pranueshmërisë. Për shembull, si kritere të pranueshmërisë shtesë, neni 49 [Afatet] i Ligjit kërkon nga parashtruesi i kërkesës sipas nenit 113.7 të Kushtetutës që të parashtrojë kërkesën brenda 4 muajsh nga dita kur paditësit i është shërbyer vendimi gjyqësor. Kërkesat e Veçanta të pranueshmërisë për çdo kategori nuk do të komentohen këtu, por në nenet relevante të Ligjit më poshtë.

Aq më shumë, Rregulli 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së Punës përmban një listë të gjerë të kërkesave të pranueshmërisë për kërkesa të cilat janë valide për të gjitha kategoritë e kërkesave dhe do diskutohen në vijim.

Sa i përket vlerësimit tentativ të aspekteve juridike substanciale të kërkesës, që përmendet në Rregullin 34(1)(f), Raporti Preliminar i Gjyqtarit Raportues do duhej të japë indikacione lidhur me atë nëse parashtruesi i kërkesës e ka arsyetuar sa duhet ankesën e vet kushtetuese dhe nëse ka parashtruar dëshmi dhe argumente të kënaqshme, për të justifikuar vlerësimin e meritave të lëndës në fjalë nga Gjykata.

II. Rregulli 34(2) qartë i referohet periudhës 30-ditore, që specifikohet në nenin 22.5 të Ligjit, por më specifikisht përcakton se kjo periudhë 30-ditore fillon të rrjedhë kur Gjyqtari Raportues të ketë pranuar të gjitha dokumentet nga dosja, përfshirë përkthimet kurdo që të njëjtat janë të domosdoshme. Nuk është e qartë nëse "të gjitha dokumentet në dosje" përfshijnë edhe përgjigjet ndaj pyetjeve të bëra nga Gjyqtari Raportues për palët dhe/ose pjesëmarrësit tjerë në procedurë si dhe përgjigjet ndaj tyre. Megjithatë, Rregulli 34(2) do të ishte më i arsyeshëm nëse periudha 30-ditore për përgatitjen e raportit preliminar do të fillonte të rrjedhuri në ditën kur Gjyqtari Raportues i ka pranuar jo vetëm të gjitha dokumentet që veç gjenden në dosje, por edhe dokumentet dhe përgjigjet tjera shtesë të cilat ai/ajo ua ka kërkuar palëve, përfshirë përkthimet e domosdoshme, aq më shumë nëse dokumentet shtesë të tilla janë më të rëndësishme se sa ato që i përmban dosja fillestare. Ajo që do të ndodhë nëse informatat e domosdoshme nuk arrijnë me kohë, apo nuk arrijnë fare, rregullohet me fjalinë e dytë të nenit 22.5 (shih komentet mbi këtë nen më sipër).

[336] Kushtet tjera formale të cilat me rastin e parashtrimit të kërkesave para Gjykatës duhet të plotësohen nga të gjitha palët e autorizuara sipas nenit 113 të Kushtetutës janë përcaktuar në nenet 29 deri 54 të Kapitullit III [Procedurat e Veçanta] të Ligjit dhe do të diskutohen në mënyrë më të detajuar më poshtë.

Rregulli 35 [Kolegjet Shqyrtuese] i Rregullores së Punës

1. **Në secilin rast, Kolegji shqyrtues kryesohet nga kryesuesi i Kolegjit shqyrtues, në pajtim me dispozitat e rregullit 9.**
2. **Kolegji shqyrtues mund të kërkojë nga pala që e parashtron kërkesën, ose nga pala që e parashtron përgjigjen, të paraqesin fakte, dokumente ose informacione shtesë, nëse kjo është e nevojshme për ta përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës.**
3. **Kolegji shqyrtues e dorëzon vendimin e tij për pranueshmërinë e kërkesës brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së raportit të Gjyqtarit raportues dhe dosjes së lëndës. Nëse kërkohen informacione shtesë nga palët, aktvendimet dorëzohen brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të të gjitha informacioneve shtesë.**
4. **Në rast se Kolegji shqyrtues konstaton që kërkesa është e papranueshme, kryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit projektaktvendimin, i cili përmban arsyet për papranueshmërinë e kërkesës dhe ia dërgon atë projektaktvendim Sekretariatit. Sekretari i Përgjithshëm ua përcjell të gjithë gjyqtarëve për shqyrtim të mëtejmë atë projektaktvendim, në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.**
5. **Nëse Kolegji shqyrtues konkludon se kërkesa është e pranueshme, kryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit projektaktvendimin, i cili përmban arsyet për pranueshmëri, dhe ia dërgon atë aktvendim Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm ua përcjell rekomandimin të gjithë gjyqtarëve.**
6. **Nuk lejohen mendime mospajtuese me shkrim nga gjyqtari në Kolegjin shqyrtues, përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës.**
7. **Gjyqtari, i cili kundërshton përfundimin e Kolegjit shqyrtues se kërkesa është e papranueshme, ia paraqet kundërshtimin e tij Sekretarit të Përgjithshëm brenda afatit kohor të përcaktuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Sekretari i Përgjithshëm i informon menjëherë gjyqtarët për kundërshtimin.**

I. Rregulli 35(1) definon vetëm se delegimi i Kryesuesit të Kolegjit Shqyrtues do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullit 9(2) të komentuar më lartë).

II. Ngjashëm me Gjyqtarin Raportues edhe Kolegji Shqyrtues ka autorizime që të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës dhe/ose pala kundërshtare (e edhe pjesëmarrësit tjerë nëse ka) që të parashtrojnë fakte shtesë, dokumente (për shembull, që dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm) dhe informatat tjera, nëse e konsideron se kërkesa nuk përmban dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pranueshmërinë e saj. Duhet theksuar se autorizimet e Gjyqtarit Raportues lidhur me këtë janë të përcaktuara në nenin 22.4 të Ligjit dhe jo në Rregullore të Punës, ndërsa ato të Kolegjit Shqyrtues janë të përcaktuara në këtë Rregull por jo edhe në Ligj.
Pasi që Rregulli nuk përcakton ndonjë limit kohor brenda së cilit duhet parashtruar informatat shtesë, gjë që nuk ndodh në rastin e Gjyqtarit Raportues, i cili mund të

përcaktojë, sipas nenit 22.4 të komentuar më sipër, këtë afat në jo më shumë se 15 ditë, Kolegji Shqyrtues duket se i ka duart e lira në caktimin e këtij afati.

III. Kur të kërkohen informata shtesë, supozohet se Kolegji Shqyrtues do të caktojë një afat për dorëzimin e tyre, i cili duhet të jetë sa më i shkurtër që ka mundësi dhe në interes të procedurës. Nëse informatat shtesë nuk dorëzohen brenda afatit kohor apo dorëzohen vetëm pjesërisht apo nuk dorëzohen fare, supozohet se Kolegji Shqyrtues do të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës vetëm në bazë të informatave në dispozicion, përfshirë Raportin Preliminar të Gjyqtarit Raportues dhe praktikën gjyqësore (shih, *mutatis mutandis*, fjalinë e dytë të nenit 22.5).

IV. Për dallim nga neni 22.7 i Ligjit, Rregulli 35(4) nuk i përgjigjet pyetjes nëse konkluzioni i Kolegjit Shqyrtues mbi papranueshmërinë e kërkesës miratohet 'njëzëri' apo 'me shumicë votash'. Pasi që Rregulli nuk bën kurrfarë dallimi, supozohet se e njëjta procedurë ndiqet në të dyja rastet, me atë që Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues përgatitë projektaktvendimin për papranueshmëri të kërkesës dhe ia dërgon atë Sekretarit të Përgjithshëm për shpërndarje tek të gjithë gjyqtarët. Pas kësaj, gjyqtarët do të vlerësojnë nëse projektaktvendimi i Kolegjit Shqyrtues është në pajtim me nenet 22.8 dhe 22.9 të Ligjit.

V. Rregulli 35(5) përcakton se Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues i referon të gjitha rekomandimet e Kolegjit Shqyrtues tek Sekretari i Përgjithshëm për shpërndarje tek të gjithë gjyqtarëve për gjykim. Megjithatë, në praktikë, parashtrimi i rekomandimit të Kolegjit për Gjykatën kryhet në mënyrë gojore nga Kryesuesi i Kolegjit, prandaj nuk ekziston ndonjë rekomandim i arsyetuar i Kolegjit Shqyrtues që i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm për shpërndarje tek të gjithë gjyqtarët. Është e vërtetë se projektaktvendimet e arsyetuara mund të përbëjnë vegël të dobishme që iu ndihmon gjyqtarëve që nuk janë në Kolegj Shqyrtues në formulimin e qëndrimit të tyre mbi pranueshmërinë apo papranueshmërinë e lëndës, por kjo procedurë si duket kursen mjaft shumë kohë dhe letër, për më tepër duke qenë se Kolegji Shqyrtues vendimin e merr në prani të gjyqtarëve të tjerë. Kësisoj, këta të fundit njoftohen për diskutimet mes anëtarëve të Kolegjit Shqyrtues të cilat rezultojnë me miratimin e rekomandimit. Megjithatë, vazhdon të mbetet e papërgjigjur pyetja nëse Rregulli duhet të ndryshohet.

VI. Rregulli 35(6) duket se është i arsyeshëm pasi që nuk do të kishte shumë kuptim që një gjyqtar mospajtues në Kolegjin Shqyrtues t'ia bashkëngjisë qëndrimin e tij/saj vendimit të Kolegjit Shqyrtues për pranueshmëri dhe këtë t'ia paraqesë përbërjes së plotë të Gjykatës ku çështja e pranueshmërisë do diskutohet sërish. Në fakt, mund të jetë e mundshme që gjyqtari mospajtues në Kolegj Shqyrtues të ndërrojë qëndrimin e tij/saj gjatë diskutimeve të zhvilluara para përbërjes së plotë dhe të mbrojë një qëndrim të ndryshëm me atë që e ka mbrojtur gjatë punës në Kolegj Shqyrtues. Mendimet mospajtuese lejohen vetëm në bazë të Rregullit 58 [Mendimet Mospajtuese], i cili përcakton se gjyqtari do të ketë të drejtë të shkruajë mendim mospajtues ndaj aktgjykimit të Gjykatës mbi meritat e kërkesës (shih më poshtë).

VII. Rregulli 35(7) plotëson fjalinë e parë të nenit 22.7 dhe nenin 22.8, të cilët flasin për atë se çfarë ndodhë nëse Kolegji Shqyrtues njëzëri ka vlerësuar se kërkesa është e papranueshme ndërsa gjyqtarët të cilët nuk janë anëtarë të Kolegjit Shqyrtues e kundërshtojnë këtë projektaktvendim të hartuar nga Kryesuesi i Kolegjit Shqyrtues, duke parashtruar vërejtjet e veta me shkrim tek Sekretari i Përgjithshëm brenda 10 ditësh pas pranimit të të njëjtit.
Pasi që në praktikë përbërja e plotë e Gjykatës do t'i diskutojë rekomandimet e Kolegjit Shqyrtues menjëherë pas miratimit të tyre, nuk është i domosdoshëm Rregulli që Sekretari i Përgjithshëm, të cilit gjyqtarët mospajtues mund t'ia dërgojnë vërejtjet e tyre, duhet t'i njoftojë të gjithë gjyqtarët mbi kundërshtimin në fjalë. Siç u tha më sipër, kjo praktikë i kursen Gjykatës shumë kohë të çmueshme. U mbetet gjyqtarëve që të diskutojnë mes veti nëse ky Rregull do duhej ndryshuar, për ta sjellë atë në pajtim me praktikën e zhvilluar, apo jo.

Rregulla 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së Punës

1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
- **(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;**
- **(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose**
- **(c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.**

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
- **(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;**
- **(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;**
- **(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose**
- **(d) kur parashtruesi nuk dështon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.**

3. Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:
- **(a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;**
- **(b) kërkesa është anonime;**
- **(c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;**
- **(d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;**
- **(e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;**
- **(f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;**
- **(g) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën; ose**
- **(h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.**

4. Nëse kërkesa është e pakompletuar, ose nuk përmban informacione të domosdoshme për zhvillimin e procedurave, Gjykata mund të kërkojë nga parashtruesi t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda 30 ditësh.

5. Nëse parashtruesi, pa ndonjë arsye objektive, dështon t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar me paragrafin 5 të këtij Rregulla, atëherë kërkesa do të procedohet.

Kushtet e pranueshmërisë përbëjnë pengesën e parë që duhet të kalohet nga parashtruesi i kërkesës, para se Gjykata të jetë në gjendje të merret me meritat e ankesave kushtetuese të tij/saj. Megjithatë, shumë prej kërkesave dështojnë që në këtë fazë të pranueshmërisë, sepse parashtruesi i kërkesës (dhe shpesh përfaqësuesi ligjor i tij/saj) duket se nuk ka njohuri të mjaftueshme mbi mekanizmat e ankesave kushtetuese. Mungesa e informatave adekuate, njohurive dhe të kuptuarit të këtij mekanizmi mund të trajtohen përmes vazhdimit të realizimit të strategjisë së porsa sajuar të Gjykatës për t'iu qasur publikut. Në Planin Strategjik të saj për periudhën 2010-2013, të korrikut të vitit 2010[337], Gjykata e ka kuptuar domosdoshmërinë që të sajohet një strategji komunikimi dhe të krijojë një program të qasjes tek publiku, me të cilin do të mbahen marrëdhëniet e mira me qytetarët dhe do të sigurohet zbatim efektiv i drejtësisë kushtetuese. Sipas mendimit të Gjykatës, publiciteti, transparenca dhe shfrytëzimi i teknologjisë moderne janë kyçe për përmbushjen e mandatit të vet, ndërsa strategjia e komunikimit gjithashtu i konsideron qëndrimet e Gjykatës për rregullimin e komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm si parakushte thelbësore për përmirësimin e ndërveprimit me opinionin publik.
Pasi që arsyet e pranueshmërisë janë caktuar në Rregullën 36, shumica prej tyre korrespondojnë me ato që janë të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe nenin 35 [Kriteret e Pranueshmërisë] të KEDNJ, siç përmendet më poshtë. Në ndërlidhje me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton se "*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*", nga praktika gjyqësore duket qartë se Gjykata në çdo vendim të saj jo vetëm që i ka interpretuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në pajtim me vendimet e GJEDNJ, por edhe u është përmbajtur me kujdes interpretimeve të GJEDNJ lidhur me kriteret e pranueshmërisë. Kurdo që të jetë e domosdoshme do të ofrohen shembuj të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ.

I. Duhet theksuar se nënparagrafët 1(a) deri 1(c) të Rregullës 36 janë kërkesa kumulative, do të thotë se të tri kushtet duhet të plotësohen para se Gjykata të mund të merret me një kërkesë. Nëse jo, Gjykata do të refuzojë kërkesën si të papranueshme. Nënparagrafët 1(a), 1(b) dhe 1(c) rrjedhimisht duhet të përmbajnë fjalët "dhe" në fund të tyre e jo "ose". Sugjerohet ndryshimi përkatës i kësaj rregulle.
Rregulla 36(1) (a) plotëson paragrafin 2 të nenit 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit që rregullon se "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj", ndërsa vetë neni 47 zbaton nenin 113.7 të Kushtetutës i cili ngjashëm i referohet kushtit të shterjes së mjeteve juridike: "[…]vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara

[337] Shih faqen e Gjykatës në internet: www.gjk-ks.org

me ligj"[338]. E neni 113.7 i Kushtetutës është pasqyrim i nenit 35 [Kriteret e Pranueshmërisë], paragrafi 1, të KEDNJ, i cili thotë: "Gjykata mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike vendore, në pajtim me rregulla të njohura përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare [...]".

Megjithatë, ndryshe nga neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47.2 i Ligjit dhe neni 35.1 i KEDNJ, Rregulla 36 (1) (a) përmend shprehimisht se duhet të shteren vetëm mjetet juridike "efektive". Koncepti i mjeteve efektive juridike rrjedh qartë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, sipas së cilës parashtruesit e kërkesës duhet të kenë shterur vetëm mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe efektive, dhe se mjetet juridike diskrecionale apo të jashtëzakonshme nuk ka nevojë të shteren, duke përfshirë këtu për shembull kërkimin e revizionit të vendimeve gjyqësore. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka përdorur ndonjë mjet juridik të cilin Gjykata e konsideron si të papërshtatshëm, koha të cilën parashtruesi i kërkesës e ka shfrytëzuar për ta shterur këtë mjet juridik joefektiv, në kontekst të Kosovës, nuk do të pengojë rrjedhjen e afatit katër mujor të përcaktuar në nenin 49 [Afatet] të Ligjit (shih komentet mbi të më poshtë).[339]

Duhet theksuar se Rregulla për shterjen e mjeteve juridike nënkupton dy gjëra:

(1) Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ai/ajo i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që janë në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, duke përfshirë edhe ankesën pranë gjykatës apo instancës më të lartë kompetente. Për shembull, me rastin e ankimit për shkeljen e ndonjë të drejte kushtetuese nga ndonjë akt administrativ i nxjerrë nga një autoritet administrativ, parashtruesi i kërkesës duhet të dorëzojë dëshmitë që vërtetojnë se ai/ajo është ankuar kundër aktit në fjalë pranë autoritetit më të lartë administrativ, por edhe pranë Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Kushtetuese në rast se ankesa para organeve administrative nuk ka qenë e suksesshme, e më pas edhe pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, në pajtim me Ligjin Nr. 2010/03 L-199 për Gjykatat, të datës 9 gusht 2010. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës,[340] arsyeja për Rregullën e shterjes, sipas interpretimit të GJEDNJ[341], është që autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, t'u jepet mundësia që të parandalojnë apo rregullojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata konsideron se ky Rregull bazohet në prezumimin se rendi juridik i Kosovës do të ofrojë mjet efektiv juridik për të përmirësuar shkeljen e të drejtave kushtetuese, gjë që përbën aspekt të rëndësishëm të karakterit subsidiar të Kushtetutës.

---

[338] Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton se: "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

[339] Shih Lëndën Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi i datës 27 Janar 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 50, si dhe në faqen e Gjykatës në internet; shih gjithashtu *Prystavka, Rezgui kundër Francës*, Kërkesa Nr. 49859/99, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 7 nëntor 2000.

[340] Shih, për shembull Lëndën Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi i datës 27 Janar 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 50, si dhe në faqen e Gjykatës në internet; shih gjithashtu: *Selmouni kundër Francës*, Kërkesa Nr. 25803/94, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 28 Korrik 1999.

[341] Shih *Prystavka, Rezgui kundër Francës*, Kërkesa Nr. 49859/99, Gjykimi i GJEDNJ i datës 7 nëntor 2000.

(2) Parashtrues i kërkesës gjithashtu duhet të tregojë se ai/ajo ka paraqitur ankesën kushtetuese apo së paku substancën[342] e asaj që po parashtron para Gjykatës edhe para autoriteteve apo institucioneve relevante, duke përfshirë edhe ato të instancës së fundit (në shembullin e mësipërm, autoritetet administrative të instancës së fundit, departamenteve administrative të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme) për t'iu dhënë këtyre instancave rast që të shqyrtojnë dhe riparojnë shkeljet kushtetuese, para parashtrimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese[343]. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës do të duhej që në të gjitha procedurat e apelit të përcaktojë qartë të drejtat dhe liritë të cilat, sipas mendimit të tij/saj, janë shkelur nga autoritetet dhe gjykatat relevante. Do të ishte ideale nëse ai/ajo do të mund të bazohej njëkohësisht në të gjitha nenet e Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare që janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë të cilat pretendohet se janë shkelur me veprimin në fjalë. Megjithatë, gjykata tashmë ka vendosur se nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngritën në mënyrë eksplicite në procedurë, porse Rregulla i shterjes së mjeteve juridike konsiderohet i plotësuar nëse çështja e ndërlidhur është trajtuar në mënyrë implicite apo në substancë.[344]

Gjykata si duket zbaton Rregullën e shterjes së mjeteve juridike në mënyrë relativisht strikte dhe përjashton nga ai parashtruesit e kërkesës vetëm nëse ai/ajo ka dëshmuar se mjeti juridik nuk ka qenë në dispozicion, ka qenë joefektiv apo i jashtëzakonshëm, dhe rrjedhimisht nuk është dashur të shteret[345] (për komente të mëtejme, shih më poshtë komentet lidhur me kushtin e shterjes së mjeteve juridike sipas nenit 47 [Kërkesat Individuale], paragrafi 2 i Ligjit).[346]

Kushti i pranueshmërisë sipas Rregullës 36 (1) (b) është më pak i elaboruar se sa në nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe thjeshtë përcakton se kërkesa duhet të parashtrohet në Sekretariat brenda periudhës prej katër muajsh, e cila fillon të numërohet nga data në të cilën është dorëzuar (dhe në fakt është pranuar nga parashtruesi i kërkesës) vendimi mbi mjetin juridik efektiv të fundit. Për dallim nga Rregullës për shterjen e mjeteve juridike të përmendura në nenin 113.7 të Kushtetutës, neni 49 i Ligjit apo neni 35.1 i KEDNJ, vetëm Rregulla 36(1)(b) përcakton se mjeti juridik duhet të jetë efektiv, aspekt ky i rregullës që tashmë është përmendur tek komentet mbi Rregullën 36(1)(a) më sipër.

Rrjedhimisht, kur me datën në të cilën kërkesa është pranuar nga Sekretariati konstatohet se kanë kaluar më shumë se katër muaj nga data kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar realisht vendimi i gjykatës së instancës së fundit, Gjykata

[342] Gjykata mund të mos e konsiderojë të domosdoshme që parashtruesi i kërkesës të bazohet në nenet specifike të Kushtetutës në procedurat para autoriteteve relevante.

[343] Shih për shembull Lëndën Nr. KI 17/10, Vesel Tmava dhe të tjerët kundër Ministrisë së Transportit dhe Komunikimit të Republikës së Kosovës, Vendimi për Papranueshmëri i datës 15 Tetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqja 285; Hydson kundër IRJM, Kërkesa Nr. 67128/01, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 24 mars 2005.

[344] Shih sërish rastin e AAB-RIINVEST; dhe *mutatis mutandis, Azianas kundër Qipros,* Kërkesa Nr. 56679/00, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 28 prill 2004.

[345] Po aty.

[346] Neni 47(2) i ligjit përcakton: "*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

do ta shpallë kërkesën të papranueshme si të parashtruar jashtë afatit. Aspektet tjera të pranueshmërisë do të trajtohen nën nenin 49 [Afatet] të Ligjit.

Nëse kërkesa nuk është në mënyrë të dukshme e pabazë, ajo kualifikohet për trajtim nga Gjykata të meritave të saj, me kusht, megjithatë, që të jenë plotësuar kushtet tjera të pranueshmërisë. Situatat në të cilat Gjykata do të refuzojë kërkesat si dukshëm të pabaza janë të përcaktuara në Rregullën 36(2)(a) deri (d) dhe do të komentohen në mënyrë më të detajuar në vijim**.**

II. Pretendimet që i përmban kërkesa e parashtruesit duhet të shërbejë si dëshmi fillestare (*prima facie*) se shkelja e pretenduar e të drejtave të njeriut dhe lirive të garantuara me Kushtetutë vërtetë ka ngjarë. Prandaj, pa dëshmi *prima facie*, nuk do të ekzistojë as rasti që duhet trajtuar dhe Gjykata do të jetë e shtyrë që ta shpallë kërkesën të papranueshme si dukshëm të pabazë[347].

Parashtruesit perspektivë të kërkesave, të cilët vijnë në Gjykatë për të parashtruar kërkesa, do të dëgjojnë nga punonjësi që i pret ata se atyre mund t'ju nevojitet, mes tjerash, që t'i argumentojnë në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre dhe të tregojnë se lënda e tyre duhet trajtuar. Gjithashtu, Gjyqtari Raportues dhe Kolegji Shqyrtues[348] mund të kërkojnë nga parashtruesit e kërkesës që të sajojnë dëshmi *prima facie* mbi shkeljen e mundshme të të drejtave dhe lirive përkatëse, por përpjekja fillestare për të ndërtuar argumentet *prima facie* mbetet me parashtruesin e kërkesës i cili këtë gjë duhet ta bëjë me rastin e parashtrimit të kërkesës.

Dallimet mes Rregullës 36(2)(b) dhe nënparagrafit paraprak duket se janë minimale. Përderisa Rregulla 36(2)(a) dëshmon se kërkesa do të duhej të jetë e justifikuar së paku *prima facie*, nënparagrafi (b) kërkon që faktet e paraqitura të justifikojnë së paku "pretendimin" mbi shkeljen e të drejtave kushtetuese. Prandaj, parashtruesit e kërkesës duhet të bëjnë të ditur lidhjen mes shkeljes së pretenduar dhe fakteve të paraqitura. Në praktikë, mosplotësimi i këtyre kushteve do të ketë rezultat të njëjtë, d.m.th. Gjykata do ta shpallë kërkesën e tillë si dukshëm të pabazë.[349]

Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se është prekur drejtpërsëdrejti nga një akt apo lëshim i autoritetit publik. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, ky kriter nuk mund të aplikohet në mënyrë mekanike dhe jofleksibile[350]. Për shembull, parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë se një ligj ua shkel të drejtat e tyre edhe nëse ata nuk i nënshtrohen ndonjë mase individuale të ndërmarrë sipas atij ligji, nëse ligji në fjalë i obligon ata që të ndërrojnë mënyrën e sjelljes apo të përballen me përndjekje[351], apo nëse janë anëtarë të një klase

[347] Shih, për shembull, Lëndën Nr. 67/09, Idriz Ratkoceri, Shqyrtimi Kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, Vendimi për Papranueshmëri i datës 14 Dhjetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 295; *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Kërkesa Nr. 53363/99, Vendimi i GJEDNJ për papranueshmëri i datës 10 Korrik 1991.

[348] Shih Rregullin 35.2 të Rregullores së Punës, të komentuar më poshtë.

[349] Shih, për shembull, Lëndën Nr. KI 53/09, Avdi Kastrati kundër Vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, Ac. Nr. 540 të datës 8 Qershor 2009, Vendimi për Papranueshmëri i datës 29 Korrik 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 233, si dhe në faqen e Gjykatës në internet.

[350] Shih, për shembull, *Karner kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafi 25.

[351] Shih, për shembull, *Norris kundër Irlandës*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafi 66.

njerëzish që ka rrezik të preken nga legjislacioni në fjalë[352]. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk mund ta argumentojë këtë, Gjykata do të konsiderojë se parashtruesi i kërkesës është ankuar për legjislacion apo akt të autoritetit publik në mënyrë abstrakte. Pasi që Kushtetuta nuk ofron mundësi për *"actio popularis"*[353], Gjykata do të duhej të refuzonte kërkesën si të pabazë.

Ky sistem i *"actio popularis"* nënkupton që çdo individ të ketë të drejtë të ndërmarrë veprime për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e akteve normative pas hyrjes së tyre në fuqi, pa dashur që të vërtetojë se ai/ajo aktualisht është duke u prekur nga të njëjtat. Në një opinion të Komisionit të Venedikut[354], të hartuar në bazë të kërkesës së autoriteteve hungareze të cilat donin të zëvendësojnë sistemin e tyre ekzistues të *actio popularis* me mjetet tjera, Komisioni vlerëson se disponibiliteti i *actio popularis* në çështje të kushtetutshmërisë nuk mund të konsiderohet standard evropian. Edhe pse Komisioni i Venedikut e pranonte se ky mekanizëm konsiderohet si garancia më e gjerë për një shqyrtim kushtetues gjithëpërfshirës, i cili mundësonte eliminimin e shpejtë të ligjeve jo kushtetuese nga rendi juridik, analiza krahasuese ka dëshmuar se shumica e shteteve nuk e kanë përzgjedhur këtë mekanizëm juridik si mjet për të sfiduar aktet statutare para gjykatës kushtetuese. Sipas autoriteteve hungareze, qëllimi i kësaj reforme ishte të shmang rrezikun nga tej ngarkimi i gjykatës kushtetuese nga një sasi e pa menaxhueshme e kërkesave dhe mjeteve juridike, dhe t'i mundësohet gjykatës përqendrimi në çështje për të cilat ekziston interes i veçantë.

Rregulla 36(2)(c) nuk është dashur të vendoset në kategorinë e "dukshëm të pabaza". Nëse Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk është viktimë e një shkeljeje të pretenduar të të drejtave kushtetuese të tij/saj, ajo nuk do të duhej ta shpallë kërkesën si të pabazë, por ta refuzojë atë si jo në përputhje me *ratione personae* të Kushtetutës, që rregullohet me Rregullën 36(3)(g) (shih më poshtë), ngjashëm me praktikat e GJEDNJ.[355]

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ edhe viktimat indirekte mund të parashtrojnë kërkesa në rast se kanë lidhje personale dhe specifike me viktimën direkte[356]. Pasi që të drejtat dhe liritë në Kushtetutë duhet të interpretohen në pajtim me vendimet e GJEDNJ[357], Gjykata do të duhej të ndjekë të njëjtën logjikë kurdo që përballet me çështjet e ngjashme.

Për më tepër, prapë sipas praktikës së GJEDNJ, edhe familja e një parashtruesi të kërkesës që nuk është më gjallë mund të paraqes kërkesën, me kusht që të kenë interes përkatës për të bërë këtë[358]. Aq më shumë, në disa raste në të cilat parashtruesi i kërkesës ka ndërruar jetë GJEDNJ ka vendosur se do të ishte e rrugës

---

[352] Shih, për shembull, *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafi 34.

[353] Shih, për shembull, Lënda Nr. KI 45/09, Teki Bokshi, Shqyrtimi Kushtetues i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, Vendimi për Papranueshmëri, i datës 30 Nëntor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore, faqe 13.

[354] CDL-AD (2010) 039 rev., paragrafi 74.

[355] Praktika e GJEDNJ: nëse parashtruesi i kërkesës nuk është në gjendje të vërtetojë se ai ose ajo ka qenë viktimë e shkeljes së pretenduar, kërkesa do të shpallet jo në përputhshmëri me parimin "*ratione personae".*

[356] Shih, për shembull, *Yasa kundër Turqisë*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ.

[357] Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës.

[358] Shih, për shembull, *Raimondo kundër Italisë*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafi 2.

që të vazhdohet me ekzaminimin e kërkesës me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për shembull, në një rast kur kërkesa ka të bëjë me legjislacion apo sistem juridik apo praktikë të një shteti të caktuar.[359] Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës mund ta humbë statusin e tij/saj si viktimë nëse atij/asaj i është dhënë mundësia adekuate dhe e mjaftueshme për të zgjidhur problemin e tij, për shembull, nëse ndërkohë shkelja është trajtuar në mënyrë adekuate nga autoriteti publik relevant, përmes një vendimi të favorshëm gjyqësor apo mjeteve tjera adekuate. Në rast të tillë, parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë më tej se është viktimë[360] dhe, rrjedhimisht Gjykata do të duhet të refuzojë kërkesën si jo në pajtim me *ratione personae* (shih komentet për Rregullën 36(3)(g) më poshtë. Si rrjedhojë e kësaj, Gjykata mund të largojë kërkesën nga lista e lëndëve të pazgjidhura.[361]

Rregulla 36(2)(d) është i ngjashëm me Rregullës 36(2)(a) dhe 36(2)(b). Parashtruesit e kërkesave duhet të ndërtojnë argumentet e tyre duke dorëzuar të gjitha dëshmitë e domosdoshme të cilat tregojnë se ka pasur shkelje të mundshme të të drejtave dhe lirive kushtetuese të tyre. Kësisoj, nuk mund të theksohet aq sa duhet se barra e provës në rast të tillë bie mbi parashtruesin e kërkesës. Në veçanti, nëse pretendimet nuk janë mjaftueshëm të përkrahura nga faktet, parashtruesi i kërkesës rrezikon që Gjykata t'ia refuzojë rastin si të pabazuar. Neni 48 [Saktësimi i Kërkesës] përcakton ngjashëm se: "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".* Komentet e bëra për këtë Rregull janë po ashtu të vlefshme për Nenin 48 (shih më poshtë).

Nga praktika gjyqësore bëhet e qartë se Gjykata deri tani një numër të madh të kërkesave i ka refuzuar si të papranueshme për arsye se parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar sa duhet pretendimet e veta dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se pretendimet e tyre lidhur me shkeljet kushtetuese janë të justifikueshme. Parashtruesit e kërkesës dhe shpesh avokatët e tyre, nëse kanë të tillë, nuk janë sa duhet të vetëdijshëm mbi rëndësinë e këtij kushti dhe nuk e kuptojnë se është detyrë e tyre që ta argumentojnë rastin. Nuk duhet që Gjykata të kryejë detyrat e shtëpisë së parashtruesit të kërkesës dhe të kuptojë se çka ka menduar parashtruesi i kërkesës dhe cilat nene të Kushtetutës apo KEDNJ mund të jenë shkelur në rastin e parashtruar. Natyrisht, nëse parashtruesi i kërkesës nuk mund të dorëzojë dëshmitë e domosdoshme, për shkak se të njëjtat janë në posedim të palës kundërshtare dhe palëve të treta, ai/ajo do të duhej të informojë Gjykatën, në mënyrë që Gjykata të mund të kërkojë nga palët në fjalë të paraqesin dëshmitë e duhura (shih Rregullës 45 dhe 51 të Rregullores së Punës).

Siç u theksua më sipër, strategjia e Gjykatës për t'iu qasur publikut si pjesë e procesit të planifikimit strategjik të saj gjithsesi do të rezultojë me të kuptuar më të

[359] Shih, për shembull, *Karner kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafët 26 dhe 28.

[360] Shih, për shembull, *Eckle kundër Gjermanisë*, Kërkesa Nr. 8130/78 Aktgjykim i GJEDNJ i datës 15 Korrik 1982, paragrafi 66.

[361] Shih, për shembull, Lënda Nr. KI. 12/09, Mehdi Krasniqi kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Vendimi për të Larguar Kërkesën, i datës 24 Mars 2010; *Gaefgen kundër Gjermanisë*, Kërkesa Nr. Aktgjykim i GJEDNJ, paragrafi 116.

mirë të mekanizmave për ankesa kushtetuese para Gjykatës nga parashtruesit perspektivë të kërkesës (dhe përfaqësuesve të tyre), të cilët janë të përshkruar në mënyrë të detajuar në Udhëzimet për parashtrimin e kërkesave para Gjykatës, të cilat u përmendën më lartë.[362]

III. Gjykata ka juridiksion vetëm mbi rastet të cilat janë shprehimisht në fushëveprimin e saj sipas Kushtetutës dhe Ligjit. Prandaj, nëse parashtruesit e kërkesës paraqesin kërkesë pranë Gjykatës, duke u thirrur në shkelje të të drejtave dhe lirive të cilat nuk garantohen nga Kushtetuta (për shembull, e drejta për të pasur patentë shoferi), Gjykata nuk ka juridiksion për të trajtuar çështjet e tilla, por do të duhet ta refuzojë kërkesën si jo në përputhje me *ratione materiae*[363] (shih gjithashtu komentet për Rregullën 36(3)(f) më poshtë). Gjithashtu, kur një parashtrues i kërkesës pretendon se të drejtat dhe liritë e tij/saj kushtetuese janë shkelur nga institucione apo persona tjerë për sjelljen e të cilëve nuk janë përgjegjëse "autoritetet publike", Gjykata nuk do të ketë juridiksion për të vendosur mbi kërkesën, por do ta refuzojë atë si jo në përputhje me *ratione personae*[364] (shih gjithashtu komentet për Rregullën 36(3)(g) më poshtë).

Për më tepër, Gjykata nuk ka juridiksion për të trajtuar kërkesa të cilat kanë të bëjnë me faktet që kanë ndodhur para datës 15 qershor 2008, datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, përveç rasteve që përbëjnë ndonjë "situatë të vazhdueshme" (për më shumë detaje, shih komentet për Rregullën 36(3)(h) më poshtë).

Gjykata nuk do të pranojë kërkesa anonime, pasi që procedurat para Gjykatës janë të karakterit publik dhe emrat me të dhënat tjera të parashtruesve të kërkesës janë të domosdoshëm sipas Rregullës 29 [Regjistrimi i Kërkesës dhe Përgjigjes][365] dhe Rregullës 30 [Regjistrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve][366] të Rregullores së Punës. Është çështje tjetër kur parashtruesit e kërkesës në Gjykatë nuk e bëjnë emrin e tyre publik. Por, ata duhet të japin arsye të mjaftueshme që justifikojnë mos zbulimin e emrit dhe të dhënave të tjera të parashtruesit nga Gjykata. Nëse Gjykata miraton këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës në fjalë mund të shënohet me "X" siç edhe ka ndodhur në disa kërkesa të parashtruara në Gjykatë[367].

Megjithatë, nëse kërkesa i komunikohet palës tjetër për komente, identiteti i parashtruesit të kërkesës duhet të zbulohet përndryshe pala në fjalë nuk mund t'u përgjigjet pretendimeve të një personi anonim. Natyrisht se pala kundërshtare duhet të informohet lidhur me miratimin e kërkesës së parashtruesit për anonimitet,

---

[362] Udhëzimet, së bashku me formularin e kërkesës mund të shkarkohen nga faqja e Gjykatës në internet.

[363] Shih, për shembull, *Maaouia kundër Francës*, Kërkesa Nr. 39652/98, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 5 Tetor 2000, paragrafët 40-41.

[364] Shih, për shembull, *Papon kundër Francës*, Kërkesa Nr. 54210/00, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 15 nëntor 2001.

[365] Rregulli 29(2) përcakton: "*Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën…"*

[366] Rregulli 30(2) përcakton: "*Sekretariati mban regjistrin në të cilin regjistrohen të gjitha kërkesat dhe përgjigjet, duke përfshirë këto të dhëna:…(b) emrin e personit ose të personave që e kanë parashtruar kërkesën".*

[367] Shih, për shembull, Lënda Nr. KI 06/09, X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004, Vendimi i datës 17 Qershor 2010.

në mënyrë që të evitojë situatën kur pala kundërshtare do ta përdorte pa dashje emrin e parashtruesit në kontekst publik.

Nëse kërkesa në Gjykatë parashtrohet nga një person i paautorizuar, i cili nuk kualifikohet si palë e autorizuar në kuptimin e nenit 113.2 të Kushtetutës, Gjykata do ta refuzojë kërkesën si të papranueshme. Nëse personi i paautorizuar në fjalë do të vinte në Gjykatë për të parashtruar kërkesë, punonjësi i cili e pranon atë do të duhej ta informonte se regjistrimi i kërkesës nuk do të kishte kurrfarë kuptimi, pasi që Gjykata do të duhej ta refuzonte kërkesën menjëherë si të papranueshme. Vetëm nëse personi do të ngulte këmbë që ankesën e tij ta regjistronte si kërkesë, atëherë Sekretariati do ta bënte një gjë të tillë. Sa i përket procedurës së GJEDNJ në raste të tilla, ankesa nuk do të regjistrohej si kërkesë, por një komision prej 3 gjyqtarëve do ta refuzonte kërkesën përmes një letre.[368]

Deri tani, Gjykata nuk e pasur mundësinë e sajimit të çfarëdo kriteri për të përkufizuar abuzimin e të drejtës për t'i referuar shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive kushtetuese tek ajo. Padyshim se Gjykata do të konsideronte që kërkesat janë abuzive nëse parashtruesit apo përfaqësuesit e tyre do të parashtronin dokumente të falsifikuara, të dhëna jo të sakta apo fakte të pavërteta, apo përpiqeshin ta udhëzojnë Gjykatën gabimisht në çfarëdo mënyre, për shembull, duke fshehur dokumente apo fakte të cilat Gjykata do të duhej t'i kishte parasysh për të kuptuar të vërtetën mbi shkeljen e pretenduar[369]. Gjykata patjetër do ta konsideronte një kërkesë si abuzim të së drejtës nëse parashtruesi i kërkesës do të përdorte në korrespondencën e tij me Gjykatën një gjuhë provokuese apo fyese.

Në anën tjetër, GJEDNJ ka zhvilluar praktikë të pasur gjyqësore lidhur me çështjen që trajtohet në nenin 35(3)(a) të KEDNJ, i cili përcakton se: "*kërkesa [...] është abuzim i të drejtës së një kërkese individuale;"*. Për shembull, GJEDNJ i konsideron ankesat joserioze[370] dhe ankesat e përsëritura nga parashtruesit e bezdisshëm[371], të cilat janë të ngjashme me kërkesat të cilat ata i kanë parashtruar në të kaluarën dhe të njëjtat janë shpallur të papranueshme, abuzim me të drejtën e ankimimit[372]. Por, kur në kërkesë përdoret gjuhë abuzive, GJEDNJ duket se është paksa fleksibile pasi që kërkesat i konsideron abuzive vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, për shembull, kur gjuha e një parashtruesi i tejkalon "kufijtë e kritikës normale, të qytetëruar dhe legjitime"[373]. Rregullorja e Punës së GJEDNJ, në Rregullën 44D [Parashtresat e Papërshtatshme nga Palët], përmbajnë referencë specifike ndaj sjelljes abuzive të përfaqësuesit të palës. E njëjta përcakton se: "Nëse përfaqësuesi i një pale paraqet parashtresa abuzive, joserioze, të bezdisshme, çorientuese apo të stërzgjatura, Kryetari i Odës mund ta përjashtojë përfaqësuesin nga procedurat, ta refuzojë tërë parashtresën apo një pjesë të saj, apo të shqiptojë

[368] Shih Rregullin 52 A të Rregullores së GJEDNJ.

[369] Shih, për shembull, *Varbanov kundër Bullgarisë*, Kërkesa Nr. 31365/96, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 5 Tetor 2000, paragrafi 36.

[370] Parashtruesi i kërkesës nuk mund të paraqesë asnjë argument racional në bazë të dëshmive apo ligjit që do ta përkrahte pretendimin.

[371] Parashtruesit e kërkesës që dorëzojnë kërkesa pa arsye apo dyshim të bazuar.

[372] Shih, për shembull, *Philis kundër Greqisë*, Kërkesa Nr. 28970/95, Vendim i Komisionit i datës 17 Tetor 1996.

[373] Shih, për shembull, *Aleksanyan kundër Rusisë*, Kërkesa Nr. 46468/06, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 22 Dhjetor 2008.

çfarëdo urdhri që ai/ajo e konsideron të rrugës, pa paragjykuar paragrafin 3 të nenit 35 të Konventës" (shih gjithashtu komentet mbi Rregullën 41 [Pjesëmarrja në Seanca], paragrafi 2, të Rregullores së Punës së Gjykatës më poshtë).

Gjykata do t'i refuzojë kërkesat e reja si të papranueshme, nëse të njëjtat kanë të bëjnë me çështje të cilat janë trajtuar më herët në një kërkesë tjetër dhe nëse nuk përmban arsye të mjaftueshme për të nxjerrë një vendim të ri[374]. Vetëm kur një kërkesë e re e parashtruar nga i njëjti parashtrues i kërkesës mbi të njëjtën temë përmban informata të reja, Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën e re. Gjithashtu, mund të ndodhë që parashtruesit e kërkesës të ofrojnë në kërkesat e reja dëshmi që vërtetojnë se tani ata i kanë shterur të gjitha mjetet juridike që i kanë pasur në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm dhe kanë dorëzuar kërkesën e re brenda periudhës prej katër muajsh pas pranimit të vendimit përfundimtar në lidhje me lëndën. Kjo mund t'i lejojë Gjykatës ekzaminimin e meritave të lëndës të cilën më herët e ka refuzuar për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike në dispozicion.

KEDNJ përmban një rregull të ngjashëm, që përcakton (neni 35.2): "*Gjykata nuk do të trajtojë asnjë kërkesë të parashtruar në bazë të nenit 34 e që [...] (b) është në substancë e njëjtë me një çështje që veç është trajtuar nga Gjykata"*. Në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ, kërkesa konsiderohet se është "në substancë e njëjtë" kur palët, ankesat dhe faktet janë identike.[375]

Parashtruesit e kërkesës mund të ankohen vetëm për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë apo ligj. Ankesat që nuk bien brenda fushëveprimit të të drejtave dhe lirive të tilla, apo që kanë të bëjnë me të drejta të cilat nuk janë garantuar nga këto instrumente juridike, duke përfshirë instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të përcaktuara në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Instrumenteve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të cilat janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë, do të refuzohen nga Gjykata si jo në përputhje me *ratione materiae*.[376]

Sa i përket KEDNJ, neni 32.1 [Juridiksioni i Gjykatës] përcakton se: "Juridiksioni i Gjykatës do të shtrihet mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe Protokolleve të saj [...]". Për të qenë një ankesë në përputhje me *ratione materiae* me Konventën, e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur nga Konventa dhe Protokollet e saj që janë në fuqi. Për shembull, kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e vetëvendosjes[377] apo të drejtën e personave të huajë për të hyrë dhe jetuar në një

[374] Shih, për shembull, Lënda KI 130/11, Parashtruesit e Kërkesës Denic Mladen dhe Vitkovic-Denic Milorad, Vendimi për Papranueshmëri i datës 21 Maj 2012.

[375] Shih, për shembull, *Pauger kundër Austrisë*, Kërkesa Nr. 24872/94, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 9 Janar 1995. Për më shumë informata, shih Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ, Këshilli i Evropës, Dhjetor 2010.

[376] Shih, për shembull, Lëndën KI 146/11, Parashtruesi Isak Berisha, Vendimi për Papranueshmëri i datës 21 Maj 2012.

[377] Shih, për shembull, *X kundër Holandës*, Kërkesa Nr. 7230/75, Vendim i Komisionit i datës 4 Tetor 1976, DR 8.

Shtet Kontraktues[378] janë të papranueshme, pasi që këto të drejta si të tilla nuk janë mes të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë.[379]

Siç u përmend edhe më lartë tek Rregulla 36(2)(c), nëse parashtruesit e kërkesës nuk mund të dëshmojnë se janë viktima të shkeljes së pretenduar apo drejtpërsëdrejti të prekur nga masa apo akti i autoritetit publik, që do të përbënte shkelje të të drejtave kushtetuese të tyre, Gjykata nuk mund ta refuzojë kërkesën si të pabazuar, por si jo në përputhje me *ratione personae* sipas Rregullës 36(3)(g), në pajtim me praktikat e GJEDNJ. Për detaje të mëtejme, referohuni tek komentet në Rregullën 36(2)(c) më lartë, i cili trajton të gjitha aspektet e kërkesave për të qenë viktimë.

Përveç çështjes së të qenit viktimë, kërkesa është gjithashtu jo në përputhje me *ratione personae* nëse shkelja e pretenduar nuk është kryer nga autoritet publike, siç përmendet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.1 të Ligjit dhe nëse kërkesa është e drejtuar kundër një personi (apo personave) për të cilët autoritet publike nuk janë përgjegjëse.

KEDNJ përmban një Rregull të ngjashëm (shih nenet 35.3, 32.1 dhe 32.2). Por, sipas interpretimit të Rregullës nga KEDNJ, shtetet mund të konsiderohen përgjegjëse për akte të autoriteteve të tyre, pa marrë parasysh nëse ato janë kryer brenda kufijve shtetërorë apo jo, e të cilat prodhojnë efekte jashtë territorit të tyre[380]. Një shtet mund të konsiderohet përgjegjës për shkelje të të drejtave të përcaktuara në Konventë për persona të cilët gjenden në territorin e një shteti tjetër por të cilët janë nën autoritetin dhe kontrollin e shtetit të parë, përmes agjentëve që operojnë, qoftë ligjërisht qoftë jo ligjërisht, në shtetin e fundit[381]. GJEDNJ gjithashtu ka trajtuar çështjen e përgjegjësisë së një shteti në lidhje me pranimin e administrimit ndërkombëtar civil në territorin e tij[382] dhe ka gjykuar se përgjegjësia e shtetit mund të kërkohet edhe si rezultat i pranimit në heshtje apo pjesëmarrjes në akte të individëve privatë të cilët shkelin të drejtat sipas Konventës ndaj individëve të tjerë që janë brenda juridiksionit të tij[383].

Kërkesa është jo në përputhje me *ratione temporis* me Kushtetutën kur vendimi përfundimtar gjyqësor i marrë në lidhje me lëndën e parashtruesit të kërkesës (do të thotë në instancë të fundit) daton para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, d.m.th. para 15 qershorit 2008. Megjithatë, nëse ngjarjet të cilat përbëjnë bazën e ankesës kushtetuese kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, por vendimi i instancës së fundit për rastin e parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar

[378] Shih, për shembull, *Penafiel Salgado kundër Spanjës*, Kërkesa Nr. 65964/10, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 16 Prill 2002.

[379] Shih, për më shumë informata, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ për Kriteret e Pranueshmërisë, Dhjetor 2010.

[380] Shih, për shembull, *Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës,* Kërkesa Nr. 12747/87, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 26 Qershor 1992, Seria A, Nr. 240.

[381] Shih, për shembull, *Illich Ramirez Sanchez kundër Francës,* Kërkesa Nr. 59450/00, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 27 Janar 2007.

[382] Shih *Beric dhe të tjerët kundër Bosnjës dhe Hercegovinës,* Kërkesa Nr. 36357/04 dhe të tjerat, GJEDNJ 2007.

[383] Shih *Ilascu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë,* Kërkesa Nr. 48787, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 8 Korrik 2014. Për më shumë informata mbi këtë çështje, shih Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ mbi Kriteret e Pranueshmërisë, Dhjetor 2010.

parashtruesit të kërkesës më 15 qershor 2008 apo më vonë, Gjykata mund të ekzaminojë kërkesën.

Ka përjashtime për këtë Rregull (që rrjedhin nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, shih më poshtë), në rast të "situatave të vazhdueshme" të cilat kanë origjinë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës por vazhdojnë të shfaqen edhe pas asaj date. Për shembull, parashtruesi i kërkesës ka fituar pronësinë mbi një parcelë toke përmes një vendimi gjyqësor të plotfuqishëm para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, por ai/ajo ende nuk ka arritur që të gëzojë të drejtat e veta pronësore për shkak se vendimi gjyqësor, i cili është bërë *res judicata* kurrë nuk është zbatuar nga autoritetet kompetente. Përderisa të ekzistojë "situata e vazhdueshme" edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Gjykata mund të shtjellojë pretendimet. Gjykata ka shqyrtuar një pretendim të ngjashëm dhe ka vlerësuar se: "Situata e moszbatimit të aktgjykimit të datës 11 janar 2002 është duke vazhduar deri në ditën e sotme"[384]. Megjithatë, në rast të tillë afati katër mujor brenda të të cilit parashtruesi i kërkesës duhet ta dorëzojë atë në Gjykatë, do të fillojë të numërohet vetëm nga momenti kur "situata e vazhdueshme" pushon së ekzistuari.

Sa i përket praktikës gjyqësore të GJEDNJ në lidhje me këtë çështje, juridiksioni i Gjykatës duhet të përcaktohet në lidhje me faktet që përbëjnë ndërhyrje dhe prandaj është e domosdoshme që të identifikohet në çdo rast të veçantë koha e ndërhyrjes së pretenduar. Kësisoj Gjykata shfaqet e kujdesshme në lidhje me aktgjykimin përfundimtar, i cili si i tillë mund t'ia shkelë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, përkundër ekzistencës së mjeteve juridike të radhës të cilat kanë bërë që ndërhyrja të mund të vazhdojë të ekzistojë.[385] Dështimi i mëpasshëm i mjeteve juridike të cilat kanë pasur për qëllim shmangien e ndërhyrjes nuk mund ta sjellin atë nën juridiksionin temporal të Gjykatës.[386]

Institucionet e Strasburgut kanë pranuar shtrirjen e juridiksionit të tyre *ratione temporis* mbi kërkesat të cilat kanë të bëjnë me situata të vazhdueshme të cilat fillimisht janë shfaqur pra hyrjes në fuqi të Konventës, por të cilat kanë vazhduar edhe pas hyrjes së saj. GJEDNJ e ka ndjekur këtë qasje në disa raste lidhur me të drejtat pronësore.[387] Për shembull, ankesa kishte të bënte me pamundësinë e parashtrueses së kërkesës për të rikthyer posedimin e pronës së saj dhe për të marrë nivel adekuat të qirasë për shtëpinë e saj, në bazë të ligjeve që ishin në fuqi në Poloni para dhe pas ratifikimit të Protokollit 1 nga ajo.[388]

Një tjetër kriter i pranueshmërisë, i cili nuk përmendet në Rregullore të Punës, është kur Gjykata nuk ka juridiksion *ratione loci* për t'u marrë me një kërkesë, do të thotë kur parashtruesit e kërkesës nuk kanë qenë në gjendje të dëshmojnë se çështjet që përbëjnë bazë të ankesës ishin "brenda juridiksionit" të Republikës së Kosovës në momentin kur ka ndodhur shkelja e pretenduar e Kushtetutës. Me fjalë

[384] Shih Lëndën Nr. KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Fabrikës së Tubave IMK në Ferizaj, Shqyrtimi Kushtetues i Vendimit Nr. 340/2001 të Gjykatës Komunale të Ferizajt, i datës 11 Janar 2002.

[385] Për informata të mëtejme shih Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ mbi Kriteret e Pranueshmërisë, të dhjetorit 2010, faqet 45-51.

[386] Shih për shembull, *Blecic kundër Kroacisë*, Kërkesa Nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 29 Korrik 2004.

[387] Për informata të mëtejme shih Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ, faqet 49 – 51.

[388] See *Hutten-Czapska kundër Polonisë*, Kërkesa Nr. 35014/97, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 19 Qershor 2006.

të tjera, kur kërkesat bazohen në ngjarje jashtë territorit të Kosovës dhe kur nuk ka lidhje mes atyre ngjarjeve dhe ndonjë autoriteti nën juridiksionin e Kosovës, Gjykata do të duhet t'i refuzojë ato në bazë të mospajtueshmërisë me *ratione loci* me Kushtetutën.[389] Megjithatë, duhet të jetë e qartë se Kosova do të jetë përgjegjëse për aktet e përfaqësuesve të saj diplomatikë dhe konsularë jashtë vendit, rrjedhimisht, nuk mund të ekzistojë mospërputhja me *ratione loci* në lidhje me përfaqësitë diplomatike[390] (apo aktet e kryera në një fluturake apo mjet lundrues të regjistruar në Kosovë apo që shfrytëzon flamurin e Kosovës[391], nëse shfaqet ndonjë situatë e tillë).

IV. Rasti i përmendur në Rregullën 36(4) mund të shfaqet vetëm kur edhe Gjyqtari Raportues (i cili tashmë mund të ketë kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të japë informata shtesë brenda një afati kohor prej jo më shumë se 15-ditë, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit) e edhe Kolegji Shqyrtues (i cili po ashtu mund të ketë kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të paraqesë fakte, dokumente apo informata shtesë, nëse të njëjtat janë të domosdoshme për ta përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës sipas Rregullës 35(2) të Rregullores së Punës) i kanë konsideruar informatat në dispozicion të mjaftueshëm për të nxjerrë një rekomandim mbi kërkesën, por Gjykata nuk konsideron se informatat në dispozicion janë të plota apo të mjaftueshme. Në rast të tillë, Gjykata mund të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës që të bëjë korrigjimet e domosdoshme duke ofruar informata shtesë të cilat Gjykatës i nevojiten për të nxjerrë vendimin përfundimtar mbi pranueshmërinë dhe/ose meritat e kërkesës. Gjithashtu mund të ndodhë, për shembull, që Gjykata të pajtohet me rekomandimet e Kolegjit Shqyrtues për të shpallur një kërkesë të pranueshme në bazë të informatave në dosje, por që e njëjta të konsiderojë se për të gjykuar mbi meritat e kërkesës informatat janë të pamjaftueshme apo se është i domosdoshëm korrigjimi i tyre. Parashtruesit të kërkesës mund t'i jepen jo më shumë se 30 ditë për të plotësuar kërkesën e Gjykatës.

V. Nëse parashtruesi i kërkesës mund të justifikojë (me qëllim të mirë) vonesën e tij/saj në parashtrimin e korrigjimeve të domosdoshme brenda afatit kohor prej jo më shumë se 30 ditë, Gjykata mund të zgjasë këtë afat. Justifikim mund të jetë, për shembull, se parashtruesi i kërkesës nuk mund t'i dorëzojë korrigjimet në fjalë për shkak se ato janë në posedim të palës kundërshtare apo të një pale të tretë, prandaj nevojitet më shumë kohë për sigurimin e tyre. Por, nëse parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk mund të sigurojë ato, për shkak se ato nuk ekzistojnë më apo për shkak se parashtruesi i kërkesës i ka humbur, Gjykata do të procedojë me shqyrtimin e lëndës në bazë të informatave që i ka dhe mund ta refuzojë kërkesën si jo të plotë.

Në fund, Rregulla gabimisht i referohet paragrafit 5 e jo paragrafit 4 të Rregullës, prandaj, sugjerohet që ai të ndryshohet për të qenë në pajtueshmëri.

---

[389] Po aty.

[390] Shih, për shembull, *W.M. kundër Danimarkës*, Kërkesa Nr. 17392, Vendim i Komisionit i datës 14 Tetor 1992.

[391] Shih, për shembull, *Bankovic dhe të tjerët kundër Belgjikës dhe 16 shteteve tjera kontraktuese*, Kërkesa Nr. 52207/99, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 19 Dhjetor 2001, paragrafi 73.

Rregulli 37 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] i Rregullores së Punës

1. Sekretariati njofton Kryetarin dhe Gjyqtarin raportues se kërkesa mund të jetë e ndërlidhur, për nga çështja e trajtuar në të, me një kërkesë tjetër të parashtruar para Gjykatës, dhe të jetë e drejtuar kundër aktit të njëjtë të një autoriteti publik. Kryetari, me rekomandimin e Gjyqtarit raportues, mund të urdhërojë bashkimin e kërkesave të ndara.

2. Nëse kërkesa trajton dy ose më shumë ligje, ose akte të tjera të autoritetit publik, Gjyqtari raportues e njofton Sekretariatin dhe Kryetarin. Me rekomandimin e Gjyqtarit raportues, Kryetari mund të urdhërojë shqyrtimin e ndarë të elementeve përkatëse të kërkesës, nëse shqyrtimi i tyre së bashku nuk favorizon një shqyrtim të drejtë dhe të shpejtë.

3. Nëse pala nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës për t'i bashkuar ose për t'i ndarë kërkesat, ajo mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit, së bashku me çfarëdo argumenti faktik ose ligjor, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e urdhrit të Kryetarit për t'i bashkuar ose për t'i ndarë disa kërkesa.

I. Sipas Rregullës 37(1), nisma për të sjellë çështjen në vëmendje të Kryetarit të Gjykatës dhe Gjyqtarit raportues buron nga Sekretariati. Pasi Kryetari dhe Gjyqtari raportues të kenë kuptuar për çështjen, është Kryetari ai i cili, pasi t'i ketë pranuar rekomandimet e Gjyqtarit raportues, mund ta urdhërojë bashkimin ose ndarjen e kërkesave. Kjo kompetencë qartë bie në përkufizimin e Rregullës 12 [Funksionet e Kryetarit] të Rregullores së Punës, ku, në paragrafin 1(a) parashihet që Kryetari do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Gjykatës. Në praktikë, kjo mund të jetë që Kryetari, në interes të transparencës, të parashtroj këtë çështje para Gjykatës, e cila pastaj mund të vendosë për bashkimin[392]. Arsyetimi i Rregullës është që të lehtësohet puna e Gjyqtarit raportues, Kolegjit shqyrtues dhe Gjykatës duke u marrë me kërkesa të ndara në procedurë të përbashkët (shqyrtim i përbashkët) që do të mbyllen me një vendim. Pasi është e qartë që për kërkesat e bashkuara nuk do të caktohet një numër i përbashkët referues, referenca në këto procedura në parashtrues individual duhet të bëhet me përmendjen e numrit të tyre individual të regjistrit.

Bashkimi i kërkesave përdoret gjithashtu edhe në gjykatat e rregullta në procedura civile dhe penale. Gjithashtu, GJEDNJ ka përdorur këtë procedurë në disa raste, në bazë të Rregullës 42 të Rregullave të kësaj Gjykate.[393]

II. Sa i përket ndarjes së kërkesave, nisma vjen nga Gjyqtari raportues i cili do të njoftoj Sekretariatin dhe Kryetarin për këtë çështje. Njëjtë si në Rregullën 37(1), në

[392] Shih rastet KI 58/09, 59/09, 60/09, 64/09, 66/09, 70/09, 72/09, 75/09, 76/09, 77/09, 79/09, 3/10, 5/10, 13/10, 78/09, Lënda e Gani Prokshit dhe 15 ish punëtoreve tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 Aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i datës 15 Tetor 2010, Nr. ref.: AGJ 62/10.

[393] Shih për shembull, Kërkesat nr. 48420/10, 59842/10, 51671/10 dhe 36516/10, Eweida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, e datës 15 Janar 2013.

parim është Kryetari ai që merr vendimin për të ndarë kërkesat në fjalë[394]. Për më tej, arsyetimi i Rregullës është i ngjashëm me atë paraprak, respektivisht, të lehtësohet shqyrtimi i kërkesës pasi, siç parasheh Rregulla, shqyrtimi së bashku nuk favorizon një shqyrtim të drejtë dhe të shpejtë dhe madje mund të komplikojë shqyrtimin e tyre.

Për shembull, një parashtrues i kërkesës mund të parashtrojë një kërkesë e cila përmban dy ankesa të ndryshme: një ankesë që ka të bëj me çështje pronësore që përfshin ligjet për pronën dhe veprimet përkatëse të ndërmarra nga autoritetet komunale dhe ankesat administrative, ku përfshihet kërkesa për masë të përkohshme, dhe një ankesë tjetër lidhur me një pohim të komplikuar për shkeljen e supozuar të së drejtës për gjykim të drejtë në procedurë penale dhe vendimet relevante gjyqësore. Në veçanti, nëse për çështjen pronësore nevojitet të vendoset në mënyrë të përshpejtuar, do të ishte e arsyeshme të veçohej nga rasti penal, i cili, për shkak të ndërlikueshmërisë së dukshme mund të merrte shumë kohë për të gjykuar.

Ndarja e rasteve përdoret edhe në gjykatat e rregullta në rastet civile dhe penale, për shembull Nenet 35 [Kompetenca territoriale lidhur me bashkimin e procedurës] dhe 36 [Veçimi i procedurës] të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës[395]. Gjithashtu, Rregullës e Gjykatës së GJEDNJ përmbajnë rregull të ngjashëm për bashkimin e rasteve. Rregulla 42 [Bashkimi dhe shqyrtimi i njëkohshëm i kërkesave] ofron mundësinë e bashkimit të dy ose më shumë kërkesave, me kërkesë të palëve ose me vetë iniciativën e Dhomës[396]. Megjithatë, duket se Rregullës e Gjykatës nuk përmbajnë rregulla për ndarjen e kërkesës.

III. Edhe pse Rregullës 37(1) dhe 37(2) përcaktojnë që është Kryetari ai që urdhëron bashkimin ose ndarjen e kërkesave, duket e padrejtë që në paragrafin 3 të Rregullës të përmendet që për bashkimin dhe ndarjen vendos Gjykata, madje edhe më shumë se kaq, në të njëjtin paragraf, kur përmendet afati që duhet respektuar përsëri i referohet Urdhrit të Kryetarit. Sugjerohet ndryshimi i Rregullës në përputhje me qëndrimin e theksuar më sipër.

Rregulla 38 [Aktgjykimet testuese] i Rregullores së Punës

1. Kur paraqiten kërkesa të ngjashme, ose të njëjta, që janë rrjedhojë e të njëjtit veprim të kontestuar, Gjykata, me shumicë votash të gjyqtarëve, mund të zgjedhë njërën kërkesë ose më shumë kërkesa për t'i trajtuar me prioritet.

2. Kur një kërkesë trajtohet si rast testues për aktgjykim, Gjykata mund ta pezullojë shqyrtimin e të gjitha rasteve të ngjashme, ose identike, për një periudhë të caktuar kohore. Palët në procedurat që janë pezulluar do të informohen për të gjitha zhvillimet në rastet testuese të aktgjykimeve dhe, në çdo kohë, Gjykata mund t'i rihapë kërkesat e pezulluara për shqyrtim të mëtutjeshëm.

[394] Nëse, në praktikë Gjykata, në vend të Kryetarit, do të merrte vendimin për të ndarë kërkesën, ngjashëm si me Rregullin 37.1 nuk është e qartë, pasi gjer më tani kjo çështje nuk është parashtruar.
[395] Shih, Ligji 04/L-123, më 13 Dhjetor 2012.
[396] Shih, për shembull, Kërkesa nr. 30210/96 [2000] GJEDNJ 510 (26 Tetor 2000).

Procedura e aktgjykimeve testuese është zhvilluar dhe zbatuar në mënyrë të suksesshme në GJEDNJ si mjet për trajtimin e grupeve të mëdha të rasteve identike që në themel burojnë nga i njëjti problem. Në një shënim informativ, i lëshuar nga sekretari më 18 Mars 2011, GJEDNJ publikoi tekstin e Rregullës 61 të ri [Procedura e pilot-aktgjykimeve], të cilin e kishte inkorporuar në Rregullën e Gjykatës më 21 shkurt 2011. Rregulla përcakton në detaje mënyrën se si zhvillohet procedura. Ajo që pason është përmbledhja e shënimit informativ, që mund të shërbejë si mjet i dobishëm për Gjykatën Kushtetuese, kur ballafaqohet me procedurën e ngjashme të aktgjykimeve testuese sipas Rregullës 38 të Rregullores së vet të Punës.[397]

Mënyra se si zhvillohet pilot aktgjykimi është se kur GJEDNJ pranon një numër të madh të kërkesave që burojnë në thelb nga e njëjta arsye, ajo mund të përzgjedh një ose disa për trajtim me prioritet. Në trajtimin e rastit ose rasteve të përzgjedhura, GJEDNJ do të kërkoj të arrijë një zgjidhje e cila e tejkalon kërkesën ose kërkesat në fjalë sa për të mbuluar të gjitha rastet e ngjashme që ngrenë çështjen. Aktgjykimi rezultues do të jetë pilot aktgjykimi. Me këtë aktgjykim GJEDNJ do të synojë:

- të përcaktojë nëse kishte shkelje të të drejtave të ngritura në rastin e caktuar;
- të identifikojë mosfunksionimin sipas ligjit të vendit që është thelbi i shkeljes;
- të jap indikacione të qarta për autoritetet përgjegjëse të përfshira se si ato mund të eliminojnë këtë mosfunksionim;
- të sjellë deri të krijimi i mjetit juridik i cili do të jetë në gjendje të merret me rastet e ngjashme (duke përfshirë edhe ato që janë të pazgjidhura në GJEDNJ në pritje të pilot aktgjykimit) ose së paku sjellë zgjidhjen e të gjitha rasteve të pazgjidhura në GJEDNJ.

Prandaj, pilot aktgjykimi ka për qëllim t'i ndihmoj autoriteteve shtetërore në eliminimin e problemit sistematik ose strukturor të theksuar nga GJEDNJ ku përmenden rastet përsëritëse. Një veçori e rëndësishme e procedurës është mundësia e shtyrjes ose e "ngrirjes" së shqyrtimit të të gjitha rasteve të tjera relevante për një kohë të caktuar […]. Kjo është një tjetër masë e nxitjes së autoriteteve shtetërore për të ndërmarrë hapat e nevojshëm. Këto shtyrje, të cilat zakonisht do të jenë për kohë të caktuar, mund të jenë subjekt i kushtit që autoritetet të reagojnë shpejtë dhe në mënyrë efektive ndaj konkluzioneve të nxjerra në pilot aktgjykimin. Kur rastet shtyhen me këtë qellim, rëndësia e informimit të parashtruesve të kërkesave lidhur me çdo zhvillim në procedurë, GJEDNJ e pranon në tërësi. Duhet të theksohet që GJEDNJ në çdo kohë mund të vazhdojë shqyrtimin e cilitdo rast i cili ishte shtyrë nëse këtë e kërkon interesi i drejtësisë, për shembull kur rrethanat e veçanta e parashtruesit të kërkesës e bëjnë të padrejtë ose të paarsyeshme për ata që ta presin për më gjatë mjetin juridik[398]. Ideja qendrore prapa kësaj procedurës së pilot aktgjykimeve është në rastet kur ka numër të madh të kërkesave që kanë të bëjnë me problemin e njëjtë parashtruesit e kërkesave do të marrin dëmshpërblimin më shpejtë nëse mjeti juridik themelohet në nivel shtetëror sesa nëse rastet e tyre procedohen në baza individuale në Strasburg […].

Nuk do të jetë çdo kategori e rasteve të përsëritura që do të jetë e përshtatshme për procedurën e pilot aktgjykimeve dhe çdo procedurë e pilot aktgjykimeve nuk do të qoj

[397] Shih GJEDNJ, Rregulli 61 i Rregullores së Gjykatës: Procedura për pilot-aktgjykimet, shënim informativ i botuar nga sekretari më 18 Mars 2011.

[398] Për shembull, nëse parashtruesi i kërkesës është në gjendje të rëndë shëndetësore, prandaj nuk do të mund të priste më gjatë për mjetin.

në shtyrje të rasteve, posaçërisht kur problemi sistematik prek të drejtat më thelbësore të personit sipas Konventës. Procedura e parë e pilot aktgjykimeve[399] ka sjellë përfundimin e suksesshëm pasi është miratuar legjislacion i ri dhe janë zgjidhur rastet e pazgjidhura[400].
Në pilot aktgjykimin (*Broniowski kundër Polonisë*) GJEDNJ, ndër të tjera, vendosi "…që ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe që shteti i paditur duhet, me përdorimin e masave të duhura ligjore dhe praktikave administrative, të siguroj zbatimin e të drejtës së pronës në fjalë sa i përket paditësve të tjerë në rastin Bug River ose të ju ofroj dëmshpërblim të barasvlershëm për këtë, në pajtim me parimet e mbrojtjes së të drejtave pronësore, sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1…".
Gjer më tani, Gjykata Kushtetuese nuk e ka shfrytëzuar këtë procedurë dhe kur ta bëj këtë për herë të parë, ajo për së afërmi do të shikoj praktikën e zhvilluar në GJEDNJ, siç është përshkruar në shënimin informues të lartpërmendur.

Neni 23 [Tërheqja e palës]

Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.

1 Neni 23 përcakton qartë se Gjykata është ajo që vendos nëse do të vazhdoj me gjykimin e një kërkese, pavarësisht nëse pala e autorizuar ose pala kundërshtare (tërheqja e "palës") tërhiqet nga ajo. Megjithatë, nëse pala e autorizuar ose pala kundërshtare tërhiqet nga procedura, mund të ketë implikime të ndryshme, respektivisht:

(1) nëse pala kundërshtare tërhiqet nga procedura, Gjykata duhet të vendosë për kërkesën në bazë të parashtresave të parashtruesit të kërkesës, dokumenteve ekzistuese dhe informatave tjera të dorëzuara, duke përfshirë edhe parashtresat dhe dokumentet e dorëzuara më herët nga pala që tërhiqet. Edhe po që se pala që tërhiqet dëshiron të tërheq parashtresat dhe dokumentet e dorëzuara në një kohë të mëhershme, Gjykata mund të refuzojë këtë në interesin e çështjes në shqyrtim.

(2) nëse pala e autorizuar informon Gjykatën që dëshiron të tërheqë kërkesën, çështja është më serioze, sepse në këtë rast Gjykata mund të gjendet para fundit të parakohshëm[401]. Megjithatë, neni i lë Gjykatës të vendos nëse do të vazhdoj ose jo me gjykimin e rastit. Për shembull, Gjykata mund të vendos që ekzistojnë arsye bindëse për të vazhduar me shqyrtimin e kërkesës dhe të vendosë përkitazi me kërkesën. Gjykata mund ta bëj këtë në interes të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Për më shumë, Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ishte nën

[399] Shih *Broniowski kundër Polonisë*, Kërkesa nr. 31443/96, Aktgjykim i GJEDNJ, 2002-X; dhe *Broniowski kundër Polonisë* (marrëveshje miqësore), Kërkesa nr. 31443/96, Aktgjykim i GJEDNJ 2004-V.
[400] Shih E.G. v. Poland, nr 50425/99, dhe 175 kërkesa të tjera për Bug River, vendimi i datës 23 Shtator 2008.
[401] Shih rasti nr. KI. 27/09, Rafet Hoxha kundër Gjykatës Supreme nr..Pn.nr. 168/2005, Vendimi për të heqë kërkesën i datës 24 Mars 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore,. faqe 97.

presion të autoriteteve ose palëve të tjera për të tërhequr kërkesën (kontrolli i ngjashëm mund të kërkohet kur pala kundërshtare tërhiqet nga procedura). Gjykata duhet të shqyrtoj këtë çështje në pajtim me Rregullës që ka krijuar GJEDNJ për këtë çështje.

Nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka për qellim të ndjekë kërkesën e parashtruar në GJEDNJ, ai/ajo mund ta bëj këtë në cilëndo etapë të procedurës[402]. GJEDNJ gjithmonë do të shqyrtojë motivin dhe rrethanat e parashtruesit të kërkesës, në veçanti nëse autoritetet kanë përdorur presion ndaj parashtruesit të kërkesës për të tërhequr kërkesën. Nëse GJEDNJ gjen që nuk ka rrethana të veçanta lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të përkufizuara me Konventën dhe Protokollet e saj, ajo vendos të heqë rastin nga lista e rasteve të saj. Për shembull në *Elena Mititelu kundër Rumanisë*, parashtruesja e kërkesës u ankua sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ për pamundësinë e ushtrimit të të drejtave të saj të pranuara me vendimet e plotfuqishme dhe detyruese të gjykatave të rëndomta. Pasi GJEDNJ e kishte njohur Qeverinë me rastin, parashtruesi i kërkesës kishte informuar GJEDNJ që dëshiron të tërheq kërkesën pasi kishte rikthyer pronën e saj përmes procedurës pasuese gjyqësore. GJEDNJ vendosi që, në mungesë të ndonjë rrethane të veçantë lidhur me të drejtat e garantuara me Konventë dhe Protokollet e saj, konsideron që nuk është më e arsyeshme të vazhdohet me shqyrtimin e rastit dhe vendosi ta heqë atë nga lista e rasteve të veta[403].

Megjithatë, në rastet tjera, GJEDNJ kishte vendosur të vazhdonte shqyrtimin e kërkesave sepse me to ngriheshin çështje të rënda të të drejtave të njeriut sipas KEDNJ, të cilat arsyetonin vazhdimin e shqyrtimit të tyre në interes të përgjithshëm[404].

Neni plotësohet me Rregullën 32 [Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes] të Rregullores së punës.

Rregulla 32 [Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes] i Rregullores së Punës

1. **Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.**
2. **Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.**
3. **Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj.**

I. Në Rregullën 32(1) duket se nuk merret parasysh mundësia që, për shembull dy palët, pas seancës dëgjimore për një kërkesë, por para se Gjykata të merr vendimin, mund të pajtohen. Në këtë rast, do të ishte e duhur që Gjykata të pranojë pajtimin

[402] Neni 37.1 KEDNJ

[403] Shih *Elena Mititelu kundër Rumanisë*, Kërkesa 24583/07 e datës 25 Janar 2011.

[404] Shish, për shembull Cicek dhe Oztenelad dhe 6 të tjerët kundër Turqisë, nr. i kërkesave 74069/01, 74703/01, 76380/01, 16809/02, 25710/02, 25714/02, 30383/02, Aktgjykim i datës 3 Gusht 2007.

dhe të heqë kërkesën nga lista e kërkesave të saj, pasi të ketë verifikuar (për aq sa është e mundur) nëse pala ose palët i ishin nënshtruar presionit të panevojshëm për të arritur një pajtim të tillë. Veç kësaj, gjithashtu nuk është e qartë pse Gjykata nuk e ka miratuar Rregullën e ngjashëm me atë të GJEDNJ, ku do të përcaktohej që parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të tërheq kërkesën në çfarëdo kohe gjatë procedurës, gjithashtu edhe gjatë ose pas seancës dëgjimore.

II. Në Rregullën 32(2) thjesht përsëritet përmbajtja e Nenit 23 [Tërheqja e palës] të Ligjit. Prandaj, komentet e dhëna për atë nen kanë të njëjtën vlefshmëri lidhur me këtë rregull (shih komentet për Nenin 23 të Ligjit, të cekur më lartë).

III. Sa i përket Rregullës 32(3), i vetmi koment për të bërë është që fjalët "pa seancë dëgjimore" duket të jenë të tepërta pasi Gjykata do të vendos për kërkesën vetëm në bazë të kërkesës, çfarëdo përgjigje dhe dokumenteve të bashkëngjitura me parashtresat. Për komente të tjera, referenca është dhënë në komentet e paraqitura në Nenin 23 të Ligjit.

Neni 24 [Shqyrtimi verbal]

Shqyrtimi verbal kryesohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Procedura e shqyrtimit verbal përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Ligji nuk e rregullon procedurën e shqyrtimeve verbale, por ia lë Gjykatës për të vendosur Rregullën e nevojshme në Rregulloren e saj të Punës. Në vendet e regjionit, siç janë Shqipëria, Kroacia dhe Sllovenia, veçoritë kryesore të shqyrtimeve verbale janë të përcaktuara në ligjet gjegjëse për gjykatat kushtetuese. Është e vështirë të kuptohet se për cilat arsye ligjvënësi e ka vlerësuar si të mjaftueshme të mbulojë njërën pjesë të shqyrtimeve verbale në Nenin 17 [Parimi i publicitetit], respektivisht që: *"Seancat, duke përfshirë edhe shpalljen e aktgjykimeve janë të hapura për publikun"*. Neni më tej cakton kushtet për përjashtimin e publikut nga shqyrtimet verbale. Për më tej, Neni 20 [Vendimet] ka të bëj me të drejtën e palëve për shqyrtimin verbal dhe kufizimet e kësaj të drejte nga Gjykata. Neni 24 më lart, këtyre vetëm i shton që Kryetari i Gjykatës Kushtetuese kryeson seancën e shqyrtimit verbal.
Shqyrtimet verbale para Gjykatës duhet të jenë në pajtim me parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, të përcaktuar në Nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 6 [E drejta në gjykim të drejtë] të KEDNJ. Në rastin kundër Republikës Çeke[405], GJEDNJ në mënyrë eksplicite vendosi që Neni 6(1) i GJEDNJ[406], i cili ka të bëjë me parimin e gjykimit të drejtë, aplikohet edhe në procedurën para gjykatave kushtetuese. Përveç kësaj, në *Gast dhe*

[405] Shih, *Krcmar dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Kërkesa nr. 35376/97, Aktgjykim i GJEDNJ i datës 3 mars 2000.
[406] Pjesa relevante e nenit 6(1) të KEDNJ thuhet si vijon: "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij..".

Popp kundër Gjermanisë[407], GJEDNJ konkludoi që shteti i cili ka themeluar një gjykatë me model kushtetues kishte për detyrë të siguronte që palët ndërgjyqësore, në procedurën para një gjykatë të tillë, të gëzojnë garancitë themelore të parashtruara në Nenin 6. Kjo vetëm mund të nënkuptojë që ligjvënësi është i detyruar që me një akt normativ të rregullojë të gjitha aspektet e gjykimit të drejtë në procedurat para Gjykatës, duke përfshirë edhe shqyrtimin verbal. Prandaj, mund të parashtrohet pyetja nëse ligjvënësi mund të delegojë rregullimin e zbatimit të parimit për gjykim të drejtë te Gjykata me miratimin e Rregullores së Punës[408]. Çështjet që zakonisht rregullohen me Rregulloren e Punës, siç përkufizohet me Nenin 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese], paragrafin 2 të Ligjit[409], janë të aspektit teknik, administrativ dhe operativ të procedurës së gjykatës, duke përfshirë edhe Rregullën për sjelljen e duhur gjatë shqyrtimeve verbale, për të cilat është përgjegjës Kryetari (shih komentet për Rregullën 43 [Procedura gjatë seancës dëgjimore], paragrafin 1, më poshtë). Gjatë komentimit të rregullave të tjera, me të cilat rregullohen aspektet e gjykimit të drejtë, siç është procedura për administrimin dhe shqyrtimin e provave në Nenin 25, vërejtjet si më lartë janë po ashtu të vlefshme.
Neni 24 plotësohet me Rregullën 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] gjer në 44 [Këshillimet dhe votimi] të Kapitullit IV [Seancat dëgjimore dhe shqyrtimet}, të Rregullores së Punës.

Rregulli 40 [Orari i seancave dëgjimore] i Rregullores së Punës

1. **Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Kryetarin, cakton seanca dëgjimore në mënyrë të duhur.**
2. **Kryetari, me kërkesën e palës, e cila demonstron pse një kërkese duhet t'i jepet përparësi, dhe me miratimin e 2/3 të të gjithë gjyqtarëve, mund të urdhërojë që një kërkese t'i jepet përparësi për dëgjim ndaj të tjerave.**

I. Rregulla 40(1) ka për synim që pasi të ketë vendosur Gjykata për të mbajtur seancën dëgjimore, Sekretari i Përgjithshëm do të caktoj seancën dëgjimore në datën të cilën Kryetari, me siguri pas konsultimeve me gjyqtarët, e konsideron si të përshtatshme dhe do të bëj përgatitjet e nevojshme. Pasi kishte filluar të funksiononte Gjykata në vitin 2009, nuk ekzistonte një gjykatore e duhur në objektin e Gjykatës, por kjo nuk e kishte ndalur Gjykatën për mbajtjen e disa seancave dëgjimore në objektin e Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, derisa nuk përfundoi ndërtimi dhe pajimi i gjykatores (donacion i Gjykatës Kushtetuese të Turqisë) në objektin e Gjykatës, në maj të vitit 2010.

II. Sipas Rregullës 40(2) vetëm kur në kërkesën e palës janë dhënë mjaft arsye me të cilat arsyetohet që kërkesës t'i jepet prioritet dhe me miratimin e 2/3 të shumicës së të gjithë gjyqtarëve, Kryetari do të miratoj dhe urdhëron një seancë dëgjimore me

[407] Shih, Gast kundër Popp kundër Gjermanisë, Kërkesa nr. 29357/95, GJEDNJ 2000-II.
[408] Të dytë, ligji i Shqipërisë dhe i Sllovenisë për gjykatat kushtetuese për shembull përmbajnë parimet e Nenit 6(1), duke përfshirë edhe detajet për procedurën e shqyrtimeve verbale.
[409] "*Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin"*

përparësi. Edhe pse teksti nuk flet për çështjen, mund të supozohet që Kryetari do ta njoftoj palën tjetër për kërkesën me komente, para parashtrimit të kërkesës dhe përgjigjes së mundshme para të gjithë gjyqtarëve për miratim.

Rregulli 41 [Pjesëmarrja në seancë dëgjimore] i Rregullores së Punës

1. **Të gjitha seancat dëgjimore do të jenë të hapura për qytetarët, përveç kur Gjykata urdhëron përjashtimin e qytetarëve nga seanca, nëse një përjashtim i tillë kërkohet për sigurinë e ndonjërës nga palët ose të përfaqësuesve të tyre, apo për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.**
2. **Çdo pale, përfaqësuesi, dëshmitari ose pjesëmarrësi tjetër në seancë dëgjimore, sjellja e të cilit ndaj gjyqtarit ose Sekretarit të Përgjithshëm nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës, ose i cili sillet në mënyrë fyese ndaj palës tjetër apo të ndonjë përfaqësuesi të palës tjetër, mund t'i shqiptohet vërejtje nga Kryetari dhe t'i jepet mundësia të mbrojë veten. Kryetari, në konsultim me gjyqtarët, mund të urdhërojë shqiptimin e masave disiplinore, përfshirë shqiptimin e gjobës, në pajtim me normat e vendosura nga Gjykata, ose, në raste të jashtëzakonshme, përjashtimin nga seanca dëgjimore.**
3. **Kryetari mund ta përjashtojë një vëzhgues nga seanca, nëse sjellja e tij, ose e saj, nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës apo nëse ai ose ajo shkakton shqetësim në Gjykatë.**

I. Siç u tha më herët, përveç Rregullës 39, Rregulla 41 gjithashtu plotëson Nenin 17 [Parimi i publicitetit] të Ligjit dhe vendos disa arsye të reja për përjashtimin e publikut nga seanca dëgjimore, të cilat nuk përmenden në Nenin 17[410], respektivisht: *"për sigurinë e ndonjërës nga palët ose të përfaqësuesve të tyre, apo për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.."*. Është e qartë që këto arsye shtesë kanë të bëjnë me "sigurinë" e palëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe sigurinë e publikut që merr pjesë në seancë dëgjimore[411]. Me fjalë të tjera, arsyeja për përjashtimin e publikut nga seanca dëgjimore duket të jetë parandalimi dhe mbrojtja prej disa ngjarjeve të mundshme (për shembull një sulm kundër Gjykatës ose vonesë) që do të rrezikonte sigurinë e gjyqtarëve, palëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe të publikut dhe do të shkaktonte rrezik të lartë, lëndim/dëmtim ose dëm (për shembull në një rast të ndjeshëm Gjykata mund të pranoj kërcënime serioze kundër ndonjërës palë ose njërit ose të gjithë gjyqtarëve). Në këto raste Gjykata duhet të kërkoj mbrojtje nga organizatat e shërbimeve emergjente, siç janë policia, zjarrfikësit, emergjenca dhe të tjerët.

[410] Shih komentet lidhur me Nenin 17.2 të Ligjit, ku thuhet që: Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun kur vlerëson që është e nevojshme për ruajtjen e: 17.2.1. sekretit shtetëror, rendit ose moralit publik; 17.2.2. informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi publik; 17.2.3. jetës private ose sekretit afarist të palës në procedurë.

[411] Mund të ketë edhe raste të tjera, në të cilat do të nevojitet vendim i ngjashëm të Gjykatës, për shembull kur është në rrezik siguria e "pjesëmarrësve të tjerë në seancën dëgjimore" (shih Rregullin 41.2), siç janë dëshmitarët ose ekspertët.

Rregulla nuk flet për çështjen, nëse në rast të ndonjë teme rreth sigurisë, publiku dhe gazetarët do të mund të uleshin në ndonjë dhomë tjetër e jo në gjykatore, ku do të ishin në gjendje të ndjekin seancë dëgjimore në ekrane televizive.

II. Çështja e ngritur në Rregullën 41(2), në fakt, ka të bëjë me të ashtuquajturën "mospërfillje të gjykatës". Në përgjithësi, mospërfillja e gjykatës ndodh kur kryesi nuk e respekton autoritetin dhe dinjitetin e gjykatës ose nuk e respekton një urdhër të gjykatës, dhe me këtë e pengon ose përzihet ne administrimin e drejtësisë dhe minon autoritetin e gjykatës. Me gjobimin e kryesit, gjykata mbron autoritetin dhe legjitimitetin e vet.

Megjithatë, duket se Rregulla nuk është e plotë, pasi në të përmendet vetëm sjellja fyese e *"çdo pale, përfaqësuesi, dëshmitari ose pjesëmarrësi tjetër në seancën dëgjimore"* ndaj *"palës tjetër apo të ndonjë përfaqësuesi të palës tjetër"*, por jo sjellja fyese ndaj një dëshmitari tjetër ose një pjesëmarrësi tjetër në seancën dëgjimore (për shembull ekspert ose amicus curiae). Gjithashtu, nuk përmendet sjellja e papranueshme ndaj anëtarëve të tjerë të personelit të Gjykatës, përveç Sekretarit të Përgjithshëm, të cilët janë prezent në gjykatore ose anëtarëve të publikut, punonjësve të sigurimit ose gazetarëve. Sugjerohet ndryshimi i Rregullës në përputhje me atë që u theksua më sipër.

Nëse vërejtja e Kryetarit nuk ka efekt të mjaftueshëm, Kryetari mund të shqiptojë sanksione, në konsultim me gjyqtarët, nga pagesa e një gjobe deri te përjashtimi nga seanca dëgjimore. Sa i përket opsionit të dytë, respektimi i të drejtave të garantuara me Nenin 31 të Kushtetutës dhe Nenit 6(1) të KEDNJ duhet të matet shumë seriozisht krahasuar me një masë të tillë dhe të sigurohet që masa e përjashtimit të individit nga seanca dëgjimore nuk është jo proporcionale me qëllimin i cili synohet të arrihet. Për shembull, nëse pala pandërprerë ndërpret gjyqtarët dhe palët e tjera, përkundër vërejtjeve të përsëritura të Kryetarit, ai individ nuk ka nevojë të përjashtohet nga e gjithë seanca dëgjimore. Kështu që kur gjyqtarët të kenë dëshirë t'i parashtrojnë pyetje, pa e përjashtuar, do të mund ta sillnin përsëri brenda, përveç nëse edhe sjellja e tij penguese do ta pamundësonte këtë.

Sa i përket Rregullës me të cilin i lejohet kryetarit që, në konsultim me gjyqtarët, të shqiptoj gjobë ndaj palës penguese, përfaqësuesi, dëshmitari ose ndonjë tjetër pjesëmarrësi në seancë dëgjimore, shqiptimi i një gjobe të tillë me frymën e Rregullores së Punës do të duhej të delegohej me një akt normativ, siç u tha më herët.

Sipas praktikës gjyqësore të Strasburgut, masat e urdhëruara nga gjykatat, sipas rregullave të tyre që kanë të bëjnë me sjelljen penguese në procedurat para tyre (mospërfillja e gjykatës), konsiderohet të jenë jashtë fushëveprimit të Nenit 6 të KEDNJ, pasi ato janë më të ngjashme me ushtrimin e autorizimeve disiplinuese. Megjithatë, natyra dhe ashpërsia e sanksionit mund ta bëjnë Nenin 6 të zbatueshëm ndaj dënimit për mospërfillje të gjykatës, e cila në ligjin e shtetit klasifikohet si penale[412].

[412] Shih *Kyprianou kundër Qipros*, Kërkesa nr. 73797/01, Aktgjykim i GJENDJ i datës 15 Dhjetor 2005.

III. Supozohet që me "vëzhgues" nënkuptohet një anëtar i publikut ose një gazetar, i cili po merr pjesë në seancën dëgjimore. Personi në fjalë rrezikon vetëm të përjashtohet nga seanca dëgjimore pa iu shqiptuar ndonjë sanksion shtesë. Deri më tani Kryetari nuk e ka ushtruar këtë autorizim.

Rregulli 42 [Njoftimi për seancë dëgjimore] i Rregullores së Punës

1. Palët do të ftohen në seancën e parë dëgjimore nëpërmjet një njoftimi me shkrim që u dërgohet nga Sekretariati, sipas mënyrës së përcaktuar në Rregullën 26. Njoftimi përmban datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe u dërgohet palëve jo më vonë se dy javë para datës së mbajtjes së seancës, përveç nëse Gjykata cakton një periudhë më të shkurtër për shkaqe të urgjencës.

2. Pas paraqitjes së kërkesës nga cilado palë, Kryetari mund të shtyjë seancën, nëse pala dështmon se, për ndonjë arsye të rëndësishme, nuk mund të marrë pjesë në seancë. Palës tjetër mund t'i jepet mundësia të bëjë komente për atë kërkesë. Kryetari vendos nëse do të urdhërojë shtyrjen e seancës dëgjimore dhe Sekretariati i njofton palët me një vendim të tillë. Kur urdhëron shtyrjen e seancës, Kryetari mund të urdhërojë që pala, e cila ka bërë kërkesë, të paguajë shpenzimet që ajo palë ia ka shkaktuar palës tjetër ose palëve të tjera, si rezultat i kërkesës për shtyrje.

I. Sipas Rregullës 42(1) palët ftohen në seancë dëgjimore me anë të një ftese nga Sekretariati, në pajtim me kushtet e Rregullës 26 [Zbatimi i dorëzimit] (për komente të hollësishme shih komentet për Rregullën 26 [Zbatimi i dorëzimit]). Ftesa për seancë dëgjimore, fletëpranimi për të cilën duhet të nënshkruhet nga pala gjegjëse në datën e dorëzimit, do të vendoset në dosjen e rastit. Nëse pala në kërkesë ka përfaqësues, ftesa për seancë dëgjimore i dërgohet përfaqësuesit. Gjithashtu, mund të ndodh që një palë e cila ishte e papërfaqësuar në fillim të ketë përfaqësuesin në seancë dëgjimore.

Edhe pse me Rregulla nuk përmendet një situatë e tillë, mund të supozohet që në rast të tillë pala zyrtarisht duhet të informojë Sekretarin e përgjithshëm që ai/ajo do të ketë përfaqësuesin në seancën dëgjimore dhe njëkohësisht të dorëzojë informatat e nevojshme lidhur me përfaqësuesin (kopjen e letërnjoftimit, pasaportës ose kartelës së anëtarësisë në odën e avokatëve). Sekretari i përgjithshëm, pasi të ketë kontrolluar informatat e pranuara, duhet të dërgojë ftesën te përfaqësuesi.

Edhe pse në rast të emergjencës Gjykata mund të përcaktojë një periudhë më të shkurtë, kjo gjithashtu do të mund të shkelte të drejtën e palës për t'i dhënë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur si duhet për seancën dëgjimore (një nga aspektet e parimit të gjykimit të drejtë), për shembull kur pala është në reces të marrjes së dokumenteve shtesë dhe informatave të tjera, të cilat mendon se janë të rëndësishme për seancën dëgjimore. Edhe pse teksti i Rregullave nuk flet për këtë çështje, mund të supozohet që palët mund të ankohen në Gjykatë për kohëzgjatjen e një periudhe të tillë më të shkurtër, duke e bazuar kërkesën e tyre në të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar me Nenin 31 të Kushtetutës dhe Nenin 6 të KEDNJ.

Si rrjedhojë, Gjykata mund të jetë e gatshme të caktojë seancën dëgjimore në datën e cila është më e pranueshme për palën (palët). Gjithashtu, mund të ketë raste (për shembull kur parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon shqiptimin e masës së përkohshme[413]), në të cilat urgjenca është aq e madhe sa që Gjykata nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të caktojë një datë më të hershme për seancën dëgjimore se sa do ta bënte në kushte normale. Në rastet e tilla Kryetari me siguri do të konsultohet me gjyqtarët tjerë.
Mënyrat në të cilën ftohen pjesëmarrësit tjerë në seancën dëgjimore (dëshmitarët dhe ekspertët) përmendet më poshtë në Rregullës 46 [Thirrjet e dëshmitarëve] dhe 48 [Dëshmia e ekspertit], respektivisht.

II. Sipas Rregullës 42(2), pala kërkuese duhet t'i dorëzojë Kryetarit dëshmi bindëse që ai/ajo nuk mund të paraqitet në seancën e caktuar dëgjimore për një arsye të rëndësishme dhe gjithashtu mund të pohojë që nëse Kryetari nuk e miraton kërkesën, e drejta e tij/saj për gjykim të drejtë do të shkelet. Supozohet që Kryetari mund ta konsiderojë vdekjen e një të afërmi ose një sëmundje të rëndë të papritur si arsye të rëndësishme. Por, para se të vendos për një kërkesë të tillë është e obligueshme që Kryetari t'i ofroj mundësi palës(palëve) tjetër të jep komente. Në rastet e ndonjë dyshimi, të themi ashtu, në rastet ku arsyet e parashtruara Kryetarit nuk duken plotësisht bindëse, mund të ndodh që Kryetari së pari të konsultohet me gjyqtarët tjerë para se të marrë vendimin. Gjithashtu, mund të jetë që Kryetari të konsultojë gjyqtarët në të gjitha rastet e tilla.
Edhe nëse Kryetari e miraton këtë kërkesë, kjo mund të mos kalojë pa pasoja, pasi Kryetari ka të drejtë të urdhërojë palën e cila kërkon shtyrjen të paguaj të gjitha shpenzimet e nevojshme të cilat iu kanë shkaktuar palëve të tjera për shkak të shtyrjes. Megjithatë, nëse pala kërkuese dorëzon dëshmi të mjaftueshme me të cilat dëshmohet që "arsyeja e rëndësishme" ishte jashtë fuqive të tij/saj dhe rrjedhimisht do të ishte e paarsyeshme të urdhërohej ai/ajo të paguaj shpenzimet ose nëse ai/ajo është josolvent, sipas Rregullës, Kryetari ka lejen të abstenojë nga shqiptimi i kësaj "gjobe". Por, përsëri mbetet pyetja se kush do t'i bartë shpenzimet e palëve të tjera në këto rrethana.

Rregulli 43 [Procedura gjatë seancës dëgjimore] i Rregullores së Punës

1. **Kryetari hap seancën dëgjimore dhe është përgjegjës për sjelljen e duhur gjatë seancës. Kryetari konstaton pjesëmarrjen e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, nëse ka.**
2. **Gjykata siguron që, gjatë gjithë seancës, të jenë në dispozicion shërbimet e përkthimit, për cilëndo nga palët ose për përfaqësuesit që kërkojnë përkthim.**
3. **Pala që është e përfaqësuar mund t'i drejtohet Gjykatës përmes përfaqësuesit, përveç nëse gjyqtari i bën ndonjë pyetje drejtpërsëdrejti palës.**

[413] Gjithashtu, shih komentet e hollësishme të Nenit 25 të Ligjit.

4. Palëve mund t'u jepet mundësia që shkurtimisht t'i paraqesin argumentet e tyre nëpërmjet prezantimeve verbale, duke i kufizuar ato prezantime vetëm në fakte dhe në çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me kërkesën. Kryetari mund t'ia kufizojë secilës palë periudhën kohore të caktuar për këtë prezantim.

5. Gjatë seancës, gjyqtarët mund t'u parashtrojnë pyetje përfaqësuesve të palëve, ose drejtpërsëdrejti cilësdo palë.

6. Pas deklaratave hyrëse, Gjykata mund të dëgjojë dhe të pranojë prova në pajtim me Rregullës 45 – 53.

7. Pas përfundimit të mbledhjes së provave, palëve do t'u jepet mundësia të paraqesin vërejtjet përmbyllëse përkitazi me faktet dhe me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me kërkesën. Kryetari mund të kufizojë kohën e paracaktuar të prezantimit për secilën palë.

8. Kryetari shtyn seancën dëgjimore dhe cakton seanca shtesë, vetëm nëse të gjitha dëshmitë dhe parashtresat nuk kanë mundur të paraqiten në një seancë.

9. Sekretari i Përgjithshëm siguron përpilimin e transkriptit dhe të procesverbalit, të cilat nënshkruhen nga Kryetari.

I. Në mungesë të rregullave të qarta se si të zhvillohet seanca dëgjimore, Kryetari është relativisht i lirë për të përcaktuar zhvillimin e saj. Përveç detyrimit që të hapë seancën dëgjimore dhe të konstatojë pjesëmarrjen e palëve dhe përfaqësuesve të tyre, nëse ka (edhe pse nuk përmendet me këtë dispozitë, pjesëmarrësve të tjerë në seancën dëgjimore, siç janë dëshmitarët dhe ekspertët si dhe amicus curiae) Kryetari, si udhëheqësi i ceremonisë, pastaj mund të shpjegojë si mendon të zhvillojë seancën dëgjimore në pajtim me Rregullën 43(4), 43(5), 43(7), dhe 43(8) (shih komentet më poshtë).

II. Edhe pse, sipas Rregullës 43(2) Gjykata është e detyrueshme që të sigurojë përkthim për secilën palë ose përfaqësues që kërkon përkthim, mund të supozohet që për shembull pjesëmarrësit e ftuar, siç janë dëshmitarët dhe ekspertët, si dhe amicus curiae, gjithashtu kanë të drejtë të kërkojnë përkthim. Si rrjedhojë, shpenzimet e tilla shtesë të përkthimit do të duhej të barten nga Gjykata. Çfarëdo refuzimi i Gjykatës mund të nxis palën ose përfaqësuesin e prekur të kërkojë, ku është e mundur, të drejtat e tij/saj sipas Nenit 31 të Kushtetutës dhe Nenit 6 të KEDNJ.

III. Sipas Rregullës 43(3), edhe nëse pala preferon që përfaqësuesi i tij/saj t'i drejtohet Gjykatës, një gjyqtar mund të dëshirojë të dëgjojë hollësitë për një çështje drejtpërdrejtë nga pala, madje edhe më shumë se përfaqësuesi e njeh rastin vetëm nga çka u tha- u dëgjua, përderisa pala ka qenë ai personi që ka përjetuar ngjarjet, për të cilat gjyqtari mund të shprehë interesimin.

IV. Siç e shpall Kryetari, Gjyqtari raportues do të paraqes përmbledhjen e fakteve dhe çështjeve më të rëndësishme të kërkesës në një mënyrë të qartë, koncize dhe konkrete, kështu që palët si dhe publiku që është prezent në seancë dëgjimore do të

njihen me faktet e kontestuara në rast dhe çështjet tjera që do të jenë në qendrën e seancës dëgjimore.
Pas hyrjes së Gjyqtarit raportues, Kryetari do të ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës, ose në nëse është i/e papërfaqësuar, vetë parashtruesin e kërkesës, për të dhënë një deklaratë të shkurtë hyrëse dhe shkurtimisht të prezantojë faktet dhe çështjet që janë relevante për kërkesën e tij ose saj dhe shkeljet e supozuara të Kushtetutës si dhe, në rastet ku është e mundur, të KEDNJ ose instrumenteve të tjera juridike të përmendura në Nenin 22 të Kushtetutës. Pastaj, është radha e palës përgjegjëse ose përfaqësuesit të tij/saj që shkurtimisht të shpjegojë pse pohimi i parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit në publik, që janë prezent në gjykatore, do të kenë mundësinë e dytë (pas hyrjes së Gjyqtarit raportues) të njihen me kërkesën.

V. Rregulla 43(5) nuk duket se dallon shumë nga Rregulla 43(3). Gjyqtarët mund të parashtrojnë aq pyetje sa mendojnë që është e nevojshme prej anës së përfaqësuesve ose vetë palëve. Megjithatë, pasi është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës, Kryetari mund të kërkojë nga gjyqtarët të kufizojnë numrin e pyetjeve. Sapo që gjyqtari të mendojë që përgjigja e palës është e mjaftueshme, ai/ajo mund të ndërpres palën dhe parashtron pyetjen vijuese ose të informojë palën që ai/ajo nuk ka pyetje të tjera.

VI. Rregulla 45 [Paraqitja e dëshmive nga palët] – 53 [Amicus Curiae] përbëjnë pjesë të Kapitullit V. [Dëshmitë] dhe do të komentohen në vijim.

VII. Kryetari, si udhëheqës i procedurës, do të vendos nëse mbledhja e provave, siç përshkruhet në Rregullën 43 – 53 ka përfunduar dhe do t'i ndajë secilës palë kohën për vërejtjet përmbyllëse. Argumentet përmbyllëse mund të jenë të rëndësishme, pasi ato ia mundësojnë palës ose përfaqësuesit të përmbledhin aspektet kryesore të rastit dhe përsëri të tërheqin vëmendjen në detajet e fakteve dhe të ligjit, si dhe në argumentet të cilat, sipas mendimit të tij/saj, pala tjetër nuk ishte në gjendje të rrëzonte, si për shembull nëse gjatë seancës dëgjimore janë paraqitur prova të reja, të cilat fuqizojnë pozitën e tij/saj.

VIII. Gjer më tani nuk është paraqitur një situatë e tillë në Gjykatë, por me siguri, është e mundur që në rastet e ndërlikuara me një numër të madh të dëshmitarëve dhe ekspertëve një seancë dëgjimore nuk do të mjaftoj dhe do të nevojitet të pasohet nga një ose më shumë seanca shtesë.

IX. Transkripti i seancës dëgjimore është dokumenti zyrtar i shkruar i të gjithë procesit në seancën dëgjimore, të cilin e përpilon raportuesi i Gjykatës dhe iu jep mundësinë gjyqtarëve të shqyrtojnë tërë procesin e seancës dëgjimore. Procesverbali i seancës dëgjimore është i vetmi dokument i procedurës në gjykatore, siç është fillimi dhe pushimi i seancës dëgjimore, emrat e palëve, përfaqësuesit, dëshmitarët, ekspertët dhe amicus curiae, nëse ka, dhe të vendimeve të Gjykatës, të cilin e mban Sekretari i përgjithshëm i Gjykatës. Nuk është e qartë

nëse, pasi ta nënshkruaj Kryetari, Sekretari i përgjithshëm këtë ia shpërndan palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në seancën dëgjimore.
Transkripti i seancës dëgjimore është një mjet shumë i dobishëm për gjyqtarët për të rifreskuar mendjen e tyre për çështjet e caktuara të cilat u trajtuan në seancë dëgjimore para se të marrin pjesë në këshillimet përfundimtare për kërkesën. Megjithatë, do të marrë kohë përkthimi i transkriptit (i cili supozohet që fillimisht përpilohet vetëm në shqip) në gjuhë të tjera të cilat i flasin gjyqtarët, gjithashtu mund të jetë që gjyqtarët do të donin të konsultoheshin vetëm me pjesët e caktuara të transkriptit, të cilat mbulojnë ndonjë çështje të veçantë, të cilat pastaj do të mund të përktheheshin me prioritet. Shih më poshtë gjithashtu Rregullën 44(3).

Rregulli 44 [Këshillimet dhe votimi] i Rregullores së Punës

1. **Pas përfundimit të seancës dëgjimore, sa më parë që të jetë e mundur, Gjykata do të tërhiqet për këshillim. Këshillimet e Gjykatës nuk janë të hapura për qytetarët dhe do të mbeten konfidenciale.**
2. **Vetëm gjyqtarët mund të marrin pjesë aktive në këshillimet e Gjykatës. Sekretari i Përgjithshëm, Këshilltari i parë juridik dhe anëtarët e tjerë të personelit të Sekretariatit, ose këshilltarët juridikë, mund të jenë të pranishëm nëse një gjë të tillë e kërkon ndonjë gjyqtar dhe nëse kjo nuk kundërshtohet nga asnjë gjyqtar tjetër. Asnjë person që merr pjesë në këshillim, përveç gjyqtarëve, nuk do të marrë pjesë në këshillim ose të flasë nëse nuk i kërkohet nga ndonjë gjyqtar.**
3. **Sekretari i Përgjithshëm përgatit procesverbalin e këshillimeve, ku regjistrohet vetëm titulli ose natyra e temave a e çështjeve të diskutuara dhe rezultatet e ndonjë votimi. Në procesverbal nuk do të regjistrohen as hollësitë e diskutimeve dhe as pikëpamjet e shprehura, mirëpo secili gjyqtar ka të drejtë të kërkojë që deklarata e tij të regjistrohet në procesverbal.**
4. **Pas votimit, nëse Gjyqtari raportues është në mesin e shumicës së Gjykatës, Kryetari do t'ia caktojë Gjyqtarit raportues detyrën e përgatitjes së tekstit përfundimtar të vendimit të Gjykatës. Nëse Gjyqtari raportues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë cilindo gjyqtar nga shumica e Kolegjit shqyrtues për të përgatitur një projektvendim të Gjykatës. Nëse asnjë anëtar i Kolegjit shqyrtues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë cilindo gjyqtar nga shumica për të përgatitur një projektvendim të Gjykatës.**

I. Sa më shpejtë që të këshillohet për një kërkesë, pas përfundimit të rastit pas seancës dëgjimore, derisa hollësitë e seancës dëgjimore janë ende të freskëta në mendjen e gjyqtarëve, aq më mirë. Megjithatë, mund të ndodh që disa nga gjyqtarët do të preferonin të presin kopjen e transkriptit para se të marrin pjesë në këshillime për kërkesën. Pasi, si u tha më lart, përkthimi i transkriptit në gjuhë të ndryshme mund të marrë kohë, përzgjedhja e një date të hershme për këshillime do të ishte e vështirë, përveç nëse rëndësia e rastit është aq e madhe saqë gjyqtarët do të përdornin shënimet e tyre dhe do të përdornin ekstraktet e përthyera urgjentisht të tranksriptit, nëse kërkohet.

Rregulla që këshillimet nuk duhet të jenë të hapura për publikun ("*para* kamerës") dhe duhet të mbesin konfidenciale nuk është asgjë e pazakonshme dhe gjithashtu zbatohet në të gjitha gjykatat e rregullta. Për shembull, sipas Nenit 473 [Seanca e mbyllur për këshillim dhe votim] e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Ligji nr. 04/L-123 i datës 13 dhjetor 2012), *"Seanca e mbyllur për këshillim dhe votim 1. Këshillimi dhe votimi mbahen në seancë të mbyllur. 2. Në sallën ku gjykata mban këshillimin dhe votimin, të pranishëm mund të jenë vetëm anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi"*. Në fshehtësinë e gjykatores, gjyqtarët mund të shprehin lirisht mendimin e tyre dhe të diskutojnë rezultatin përfundimtar të kërkesës. Palët dhe publiku do të kuptojnë vetëm votën e tyre (jo emrin e tyre) për ose kundër vendimit përfundimtar, përveç nëse ndonjëri nga gjyqtarët aktgjykimit ia bashkëngjet mendimin e kundërt ose mospajtues, ku përmendet emri i tij/saj.
Për më tej, Rregulla është në pajtim me Nenin 12 [Përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente], paragrafin 1, të Kapitullit III [Refuzimet e qasjes në dokumente] të Ligjit për qasje në dokumente publike[414], ku thuhet: *"Çdo kërkues ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së: […] 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje"*.

II. Sipas Rregullës 44(2), nëse gjyqtarit i nevojitet të personeli tjetër i Sekretariatit ose këshilltarët juridik të jenë prezent gjatë këshillimeve, një gjyqtar tjetër mund të kundërshtojë prezencën e personave të tillë. Kjo do të thoshte që gjyqtari kundërshtues ka votën më të fuqishme se sa ai që kërkon prezencën e personit në fjalë. Duke marrë parasysh parimin që të gjithë gjyqtarët janë të barabartë, do të ishte më e pranueshme që Gjykata të votojë për çështjen për të mbajtur paqen në gjykatore. Në çdo rast, të gjithë personat prezent në këshillime, duke përfshirë edhe gjyqtarët, do të jenë të lidhur me kushtet e konfidencialitetit në Rregullën 19 [Konfidencialiteti][415], fushëveprimi i të cilëve është përtej gjykatores. Megjithatë, Rregullës nuk flasin për atë se çfarë pasojash do të ketë për atë person i cili ka shkelur Rregullën 19. Supozohet që personi në fjalë së paku rrezikon ndërmarrjen e masave disiplinore ose masave të tjera ndaj tij/saj.

III. Në bazë të nenit 44(3) procesverbali i këshillimeve, të cilin e përgatit Sekretari i përgjithshëm, është i vetmi regjistër i shkruar zyrtar që del nga këshillimet. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë që Këshilltari i parë juridik si dhe personeli tjetër dhe këshilltarët juridik, të cilëve u lejohet të jenë të pranishëm në këshillime, për shembull nuk mund të marrin shënime për çështjet specifike dhe të ndërlikuara juridike të cilat i diskutojnë gjyqtarët sa i përket kërkesës në shqyrtim dhe indikacioneve se si një pjesë e vendimit do të duhet të formulohet.

[414] Ligji nr. 03/L-215 i datës 7 Tetor 2010

[415] Rregulli 19 thotë: *"Të gjithë gjyqtarët, Sekretari i Përgjithshëm, personeli i Sekretariatit dhe këshilltarët juridikë, nuk shprehin në publik kurrfarë komentesh dhe mendimesh përkitazi me çështjet që kanë të bëjnë me lëndët që i janë parashtruar ose që mund t'i parashtrohen Gjykatës, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore"*.

Por, mendimet personale të gjyqtarëve nuk mund të shënohen në procesverbal, përveç, nëse, siç parashihet me Rregullën, një gjyqtar dëshiron të vendoset deklarata e tij në procesverbal. Arsyetimi i Rregullës është që në këtë mënyrë gjyqtari ka mundësinë të informojë publikun për qëndrimin e tij/saj për një çështje të caktuar gjatë këshillimeve, pasi procesverbali, si pjesë e dosjes së rastit, do të bëhet i qasshëm për publikun (sipas Ligjit për qasje në dokumente zyrtare) pasi që aktgjykimi i Gjykatës të jetë publikuar në Gazetën Zyrtare, në bazë të nenit 20 [Vendimet], paragrafit 5, të Ligjit. Megjithatë, sipas Ligjit për qasje në dokumente publike[416], disa materiale të dosjes së rastit, të cilat janë të natyrës personale për palën ose mund të përmbajnë sekrete afariste, do të largohen nga dosja, para se publikut t'i ofrohet qasja në të.

IV. Qëllimi i Rregullës 44(4) është që Gjyqtarit raportues, si gjyqtar i cili ka përgatit Raportin paraprak, dhe rrjedhimisht gjyqtar i cili është më i njoftuar me rastin, t'i jepet detyra e përgatitjes së tekstit përfundimtar të aktgjykimit, por me kusht që ai/ajo është pjesë e shumicës së Gjykatës. Nëse nuk është kështu, është logjike të mos pritet që Gjyqtari raportues të përfshihet në përgatitjen e tekstit përfundimtar të vendimit të Gjykatës, për të cilin ai/ajo ka votuar kundër. Zgjedhja e ardhshme do të ishte një anëtar i Kolegjit shqyrtues, i cili i takon shumicës së Gjykatës, pasi anëtarët e Kolegjit shqyrtues janë marrë me kërkesën në një etapë më të hershme në kuadër të Kolegjit shqyrtues. Rregulla gabimisht i referohet cilitdo gjyqtar nga shumica e Kolegjit shqyrtues. Prandaj, nëse shumica e Kolegjit shqyrtues ishte kundër vendimit të shumicës së Gjykatës, një gjyqtar shumicë në Kolegjin shqyrtues nuk do të duhej të zgjedhet për përgatitjen e aktgjykimit, por gjyqtari i mbetur i Kolegjit shqyrtues, i cili ka votuar me shumicën e Gjykatës. Prandaj, Rregulla do të duhej të thoshte: "cilindo gjyqtar i Kolegjit shqyrtues në mesin e shumicës". Kjo përshtatet mirë në fjalinë vijuese: "Nëse asnjë anëtar i Kolegjit shqyrtues nuk është në mesin e shumicës..".. Prandaj, nëse asnjë anëtar i Kolegjit shqyrtues nuk ishte në mesin e shumicës të Gjykatës, Kryetari është ai që ia cakton detyrën e përgatitjes së tekstit përfundimtar të vendimit cilitdo gjyqtar i cili është në mesin e shumicës.

Shembuj të ndikimit të mundshëm të seancave dëgjimore në vendimmarrjen e Gjykatës

Do të ishte interesante të reflektohej mbi pyetjen nëse seancat dëgjimore, të cilat janë mbajt në Gjykatë në këto vitet e fundit, kishin ndonjë ndikim të dukshëm në vendimmarrjen e Gjykatës. Megjithatë, paraprakisht do të duhej të vendosej një numër parametrash për një veprim të tillë. Së pari, duhet të ekzaminohet nëse mbajtja e seancës dëgjimore do të përshpejtoj rastin, ku do të kursehej koha e çmueshme. Për më shumë, duhet të merret në konsideratë nëse seanca dëgjimore do të sjell deri te kuptimi më i mirë i çështjeve në fjalë te gjyqtarët. Dhe, në fund, nëse seanca dëgjimore do të ndikoj që publiku të njohë më mirë procesin e vendimmarrjes në Gjykatë.
Edhe pse është shumë e vështirë të matet nëse seancat dëgjimore ndikojnë në vendimmarrjen e Gjykatës, nuk mund të mohohet se seancat e tilla, ku palët në kërkesë

[416] Ligji nr. 03/L-172 i datës 29 prill 2010.

do të jenë në gjendje t'i përgjigjen parashtresave të tyre gjegjëse dhe ku pjesëmarrësit tjerë, dëshmitarët, ekspertët dhe mundësisht, amicus curiae, do të mund t'i dëgjonte Gjykata, me siguri do t'i mundësojnë gjyqtarëve të kuptojnë më mirë çështjen në fjalë në një periudhe relativisht të shkurt kohore. Çfarëdo pyetje që ata ndoshta kishin para seancës dëgjimore, ata në seancë dëgjimore mund të parashtrojnë pyetje të tilla dhe çfarëdo pyetje të re e cila mund të paraqitet pas përgjigjes së palëve. Prandaj, gjyqtarët mund të jenë të përgatitur më mirë për të marrë vendimin se sa do të ishin në gjendje ta bënin pa seancë dëgjimore. Por, është e vështirë të dëshmohet që pa seancë dëgjimore gjyqtarët do të votonin ndryshe ose që cilësia e aktgjykimit do të ishte më e dobët. Por, së paku ky supozim mund të jetë real.

Për më tej, nuk mund të mohohet që seancat dëgjimore përshpejtojnë procesin e vendimmarrjes. Kjo mund të ketë një përparësi të veçantë në rastet e ndërlikuara me shumë pjesëmarrës. Për shembull, rasti nr. KO 97/12, *Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, te Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093*[417], pjesëmarrësit, përveç Avokatit të popullit, si parashtrues kërkesës, përbëheshin nga Ministria e financave, Ministria e administratës publike, Departamenti për regjistrimin dhe bashkërendimin me OJQ-të, Banka Qendrore, Komisioni për legjislacion i Kuvendit dhe Amicus Curiae i ftuar nga Gjykata. Kërkesa u regjistrua më 11 Tetor 2012, seanca dëgjimore u mbajt më 5 Mars 2013 dhe Gjykata mori vendimin më 14 mars 2013. Pra, Gjykatës iu deshën pak më shumë se 5 muaj për të gjykuar një kërkesë kaq të vështirë. Pa seancë dëgjimore, me siguri që nuk do të ishte e mundur që Gjykata ta bëj këtë (Shënim: Nuk duhet të harrohet që Gjykata me shqiptimin e masës së përkohshme ndoshta gjithashtu ka kontribuuar me ndikimin përshpejtues në procesin e vendimmarrjes).

Njëkohësisht, ky rast paraqet një shembull shumë të mirë të ndikimit të seancës dëgjimore në kuptimin më të mirë të çështjeve të ndërlikuara në fjalë te gjyqtarët, siç tregohet në tekstin konciz dhe të qartë të Aktgjykimit.

Në fund, është e rëndësishme që duke iu falënderuar mbajtjes së seancave dëgjimore, rastet e rëndësishme i afrohen publikut më shumë. Nuk ka vetëm publiku të drejtën për të marrë pjesë në seancat dëgjimore, sipas dispozitave përkatëse të Ligjit dhe Rregullores së punës[418], por edhe prezenca e medieve është e pazëvendësueshme për t'i treguar publikut rëndësinë e Gjykatës për mbrojtjen e sundimit të ligjit.

Në rastin e parashtruesit individual të kërkesës kundër Radio-televizionit të Kosovës (RTK) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK)[419], seanca dëgjimore (e para për Gjykatën) u mbajt me kërkesë të parashtruesit të kërkesës për të shqiptuar masat e përkohshme. Megjithatë, seanca dëgjimore, në të cilën ishin prezent palët kundërshtare (KEK-u nuk u përgjigj kurrë me shkrim ndaj kërkesës, por i kishte paraqitur pikëpamjet e veta për herë të parë në seancën dëgjimore), nuk u mor vetëm me shqiptimin e masës së përkohshme, por gjithashtu e udhëhoqi Gjykatën për të vendosur

[417] Buletini i praktikës gjyqësore.

[418] Shih, Neni 17 [Parimi i publiciteti] i Ligjit, Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] i Kushtetutës dhe Rregullës 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] dhe 41 [Pjesëmarrja në seancën dëgjimore] e Rregullores së Punës.

[419] Shih, Rasti nr. KI 11/09, Masat e përkohshme, Tomë Krasniqi kundër RTK-së e të tjerëve, Vendim i datës 16 Tetor 2009.

që kjo kërkesë individuale nuk kishte të bënte vetëm me interesin personal të parashtruesit të kërkesës, por edhe me interesin publik. Si rrjedhojë, Gjykata i rekomandoi Kuvendit të rishqyrtojë natyrën e Nenit 20.1 të Ligjit për RTK-në dhe praktikave të bazuara në këto dispozita, siç ishte diskutuar gjatë seancës dëgjimore. Nuk pasuan seanca të tjera dëgjimore e as shkëmbim të parashtresave të palëve para se Gjykata (pasi kishte vazhduar masën e përkohshme dy herë) vendosi të heq rastin. Kjo tregon sa të rëndësishme ishin parashtresat e palëve dhe përgjigjet e tyre në pyetjet e gjyqtarëve gjatë seancës dëgjimore dhe është një shembull i qartë i kërkesës në të cilën seanca dëgjimore kishte ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar.
Sigurisht, ka shumë shembuj të rasteve të tjera në të cilat Gjykata mbajti seancë dëgjimore. Do t'i lihet lexuesit të interesuar t'i kërkojë ato në ueb-faqen e Gjykatës dhe t'i lexojë ato në frymën e vërejtjeve të mësipërme.

Neni 25 [Provat]

> **Procedura e administrimit dhe shqyrtimit të provave përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.**

Ashtu siç është komentuar më lart, në nenin 24 [Seanca dëgjimore], është përgjegjësi e legjislativit për të rregulluar me akt normativ, që ka një efekt të përgjithshëm, të gjitha aspektet e procedurës së gjykimit të drejtë para Gjykatës. Prandaj, mund të argumentohet se legjislaturës nuk i lejohet t'i delegojë Gjykatës rregullimin e aspekteve të parimit të gjykimit të drejtë, të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, përveç procedurave teknike, administrative dhe organizative, si dhe funksioneve të Gjykatës që rregullohen me Rregullën e brendshme të gjykatave, siç është përcaktuar me nenin 2 (2) të Ligjit[420]. Rregullës rreth konsideratës së provave mund të mos jenë rregull e brendshme e gjykatave, në qoftë se ato ndërhyjnë në sferën ligjore të të adresuarit, siç është rasti me aktet e parlamentit.
Për shembull, të gjitha aspektet e të drejtës për të paraqitur prova dhe mënyra e pranimit të provave, duke përfshirë kërkesat për të dëgjuar dëshmitarët dhe ekspertë si dhe nga kundërshtimet kundër kërkesave të tilla, janë tiparet e parimit të "barazisë së armëve" që në vete është pjesë e të drejtës për një gjykim të drejtë [421] dhe duhet, për këtë arsye, të rregullohen me akt normativ, që ka një efekt të përgjithshëm, të miratuar nga legjislativi. Çështje të ngjashme në procedurat civile dhe penale janë, ndryshe nga rregulla e gjykatës, të parashikuara në Ligjin për procedurën kontestimore respektivisht Kodin e Procedurës Penale,. Gjithashtu në vendet fqinje, si Shqipëria dhe Sllovenia, janë këto parimet e gjykimit të drejtë të rregulluara me Ligj[422].
Për më tepër, në lidhje me çështjen e seancës së dëgjimit të dëshmitarëve, si pjesë e të drejtës për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë]

[420] "*Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me Ligjin*".
[421] Shih *Ekbatani v. Suedisë*, Kërkesa nr. Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 26 Maj 1988, Seria A nr. 134, f.14.
[422] Shih, Ligji Nr. 8577 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë të datës 10 Shkurt 2000, dhe Ligji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë 15 Korrik 2007.

të KEDNJ, GJEDNJ ka zhvilluar një jurisprudencë të gjerë. Sipas GJEDNJ, pranueshmëria e provave është kryesisht një çështje për rregullim me ligj kombëtar[423]. Sa i përket të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, kjo përbën një pjesë të të drejtave themelore dhe lirive, të përcaktuara në nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, të cilës e janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Është, pra, e logjikshme që kjo e drejtë dhe të gjitha aspektet e saj, të cilët janë njëlloj të zbatueshme për procedurën para Gjykatës Kushtetuese, duhet, pra, jo të rregullohen me Rregullores së Punës, por me akt normativ të legjislaturës. Komentet në çështjet e administrimit dhe konsideratës së provave, të parashikuara në Rregullës 45-53 të Kapitullit V. [Provat] të Rregullores së Punës, të cilat plotësojnë nenin 25 të Ligjit, do të duhej të lexohen me vëmendje me këtë konsideratë.

Rregulli 45 [Paraqitja e dëshmive nga palët] i Rregullores së Punës

1. Palët mund të paraqesin në Gjykatë dëshmitë e mëposhtme:
   a. emrin dhe adresën e dëshmitarit dhe përmbledhjen e dëshmive që dëshmitari pritet ta japë;
   b. kërkesën për dëshminë dhe përmbledhjen e ekspertit, që paraqesin fakte të cilat duhet të përcaktohen nga raporti i ekspertit;
   c. kopjet e dokumenteve, ose gjësendet e tjera fizike, që përmbajnë informacione të rëndësishme për kërkesën;
   d. përshkrimin e dokumentit, ose të gjësendeve të tjera fizike, që përmbajnë informacione të rëndësishme për kërkesën, por që nuk janë në posedim ose në kontroll të palës, bashkë me identifikimin e personit që besohet të ketë në posedim ose në kontroll këtë dëshmi dhe arsyet pse besohet ashtu; ose
   e. identifikimin e lokacionit që duhet vizituar, ose objektin që duhet inspektuar, bashkë me përshkrimin e dëshmisë që duhet të përcaktohet nga ajo vizitë ose inspektim.

2. Mbledhja e dëshmive të rëndësishme për kërkesën që nuk krijon probleme të mëdha me faktet ose me ligjin, me një vendim të Gjykatës, mund t'i delegohet një gjyqtari të Gjykatës. Mbledhja e dëshmive nga gjyqtari duhet të bëhet në pajtim me këto rregulla.

I. Rregulla 45(1) përcakton parimin që të dyja palët e gëzojnë të njëjtën të drejtë për të dorëzuar dëshmitë, në pajtueshmëri me parimin e "barazisë së armëve", të përmendur më lartë. Sipas praktikës gjyqësore të KEDNJ-së, nënkuptohet që secilës palë duhet t'i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij/saj- duke përfshirë edhe dëshmitë- me kusht që ai/ajo të mos vihet në pozitë të disfavorshme karshi kundërshtarit"[424]. Përkitazi me dorëzimin e dëshmive, palët,

[423] Shih, për shembull, *AlbertandLeCompte v. Belgjikës*, Kërkesa Nr. 7299/75 dhe 7496/76, Aktgjykimi i GJEDN i datës 10 Shkurt 1983.
[424] Shih, për shembull, *DomboBeheer v. Holandës*, Kërkesa nr. 14448/88, Vendimi i KEDNJ më 27 Tetor 1993.

prandaj, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga Gjykata, pos në rast kur kërkohet përjashtim nga rregulla, e që arsyetohet dhe në proporcion me rrethanat.

Pra, në rast të një seance dëgjimore, palët duhet të njihen me Rregullën e mësipërm që përcakton llojet e ndryshme të dëshmive që do të donin të dorëzonin. Këto Rregulla nuk dallojnë shumë nga ato që kanë të bëjnë me seancat dëgjimore të gjykatave të rregullta (shih, Nenin 45(1) (a) që përcakton se palët mund të dorëzojnë para Gjykatës emrin dhe adresën e dëshmitarit/es (dëshmitarëve) si dhe një përmbledhje të dëshmisë se dëshmitarit/es (dëshmitarëve). Nëse palët dëshirojnë, ato duhet së pari të dëshmojnë ose t'i tregojnë Gjykatës se ka në fakt arsye të mjaftueshme për marrje në pyetje, sipas Rregullës 46 [Thirrja e Dëshmitarit] që përcakton (shih, komentet në Rregullën 46 më tutje). Përmbledhja e mësipërme e dëshmisë së dëshmitarit/es (dëshmitarëve) mund të shërbejë si dëshmi e tillë.

Rregulla 45(1)(b) lejon që palët të kërkojnë nga Gjykata një dëshmitar ekspert, me kusht që ata duhet të dorëzojnë një përmbledhje të fakteve që do të mund të vendosnin nga raporti i ekspertit. Për më tepër, një raport eksperti mund të dalë me një rezultat të padëshiruar, meqë, ndryshe nga një dëshmi subjektive e dëshmitarit/es, raporti i ekspertit bazohet në elementet objektive që janë jashtë ndikimit të palës.

Detajet e emërimit, raportimit dhe dëgjimit të ekspertit/es, përcaktohen me Rregullën 48 [Raporti i Ekspertit] që do të komentohet më poshtë.

Rregulla 45(1)(c) lejon palët të dorëzojnë para Gjykatës çfarëdo dokumenti ose gjë tjetër fizike me kusht të vetëm që ato të përmbajnë informata relevante për rastin në fjalë. Meqë parashtruesit mund të konsiderojnë menjëherë që një dokument ose gjësend përmban informata relevante, rreziku është se ata mund të tej ngarkojnë Gjykatën me shumë dokumente ose gjëra që janë jo-relevante për rastin. Neni 22 dhe Rregullës 29, 30 dhe 36, të komentuara më lartë, flasin më qartë për dokumentet "e domosdoshme" ose "mbështetëse".

Rregulla 45(1)(c) nuk e përmend gjuhën në të cilën duhet dorëzuar dokumentet. Kjo çështje rregullohet në mënyrë të detajuar në Rregullën 29(3), e komentuar më sipër. Detajet e përdorimit të dokumenteve dhe gjërave të tjera fizike para Gjykatës rregullohen me Rregullën 51 [Dokumentet] që do të komentohen më poshtë.

Rregulla 45(1)(d) kërkon nga palët, që dëshirojnë të dorëzojnë një dokument ose gjëra të tjera fizike e që nuk janë në posedim ose kontroll të tyre, të paraqesin një përshkrim të saj si dhe identifikim të personit për të cilin besohet që posedon ose ka kontroll mbi gjërat e tilla bashkë me arsyet për një bindje të tillë. Dhe gjatë kësaj procedure, pala përkatëse mund të kërkojë nga personi për të cilin besohet se posedon ose ka kontroll mbi gjërat përkatëse, t'i paraqes ato propiomotu. Ky person mund të jetë pala tjetër ose pala e tretë. Nëse bëhet fjalë për palën tjetër, pala përkatëse mund ta bëjë një gjë të tillë sipas Rregullës 51 51(3). Megjithatë, sipas Rregullës 45(1)(d), pala në fjalë nuk mund të kërkojë nga Gjykata që Gjykata të kërkojë palën tjetër ose personin për të cilin besohet të posedojë ose të ketë nën kontroll gjëra ta tillë, t'i paraqes ato, por duhet ta bëjë këtë sipas Rregullës 51(4) dhe 51(5), të komentuara më poshtë.

Rregulla 45(1)(e) u jep të drejtë palëve t'ia dorëzojnë Gjykatës identifikimin e një lokacioni për t'u vizituar ose të një objekti që duhet inspektuar, bashkë me

përshkrimin e dëshmisë që duhet të paraqitet në rast një vizite ose inspektimi të tillë. Megjithatë, nëse lokacioni ose objekti është në posedim të një personi që nuk është palë në procedurë, pala mund të kërkojë, sipas Rregullës 52(3), nga Gjykata, një Urdhër që kërkon nga personi të lejojë qasjen në lokacion ose në objektin që duhet të hetohet. Siç u përmend, detajet e vizitës në lokacion ose inspektimit në objekt, përcaktohen në Rregullën 52 [Inspektimi i Lokacionit dhe Objektit], të komentuara më poshtë.

II. Titulli i Rregullës 45 është "Dorëzimi i Dëshmive nga Palët". Thelbi i Rregullës 45(2) ka të bëj ndërkaq, me përmbledhjen e dëshmive nga një gjykatës i Gjykatës. Prandaj, do të ishte më e udhës që Rregulla 45 (2) të jetë Rregull e veçantë me titullin "Përmbledhja e Dëshmisë nga Gjykata".
Qëllimi i Rregullës është sigurisht të ndihmojë punën e Gjykatës dhe të kursejë kohën e saj të çmuar, kurdo që një gjë e tillë të jetë e mundur, gjatë referimeve që nuk vënë në pah dilema të rëndësishme përkitazi me faktet ose ligjin. Meqë, sipas Rregullës, Gjykatës me gjasë i duhen dëshmitë e caktuara të faktit ose ligjit, supozohet që Rregulla është e zbatueshme në situatat, kur referimi tashmë ka kaluar fazën e Panelit Shqyrtues dhe tani është në pritje para Gjykatës së plotë. Prandaj, në këtë situatë, Gjykata mund të delegojë përmbledhjen e dëshmive të caktuara ndonjë gjykatësi të Gjykatës, për shembull, madje të delegojë edhe ndonjë Gjykatës Raportues, që tashmë është i njohur me rastin dhe mund të ketë bërë vetë përmbledhjen e dëshmive në fazën fillestare të procedurës, atëherë kur ai/ajo është caktuar për përgatitjen e Raportit Preliminar.
Edhe pse Rregulla nuk paraqet detaje rreth procedurës së përmbledhjes së dëshmive nga gjykatësit, nuk ka kurrfarë dyshimi, që gjykatësi përkatës do të duhej të raportonte në Gjykatë rreth rezultateve të përmbledhjes së dëshmive që ai/ajo ka kryer, por gjithashtu, të raportojë edhe për problemet që ai/ajo mund të ketë hasur gjatë veprimtarisë në fjalë. Pos përfshirjes në përmbledhjen e dokumenteve shtesë të përshkruara nga palët, gjykatësi mundet edhe të kontrollojë lokacionet e propozuara si dhe të inspektojë objektet dhe t'i raportojë më pas Gjykatës. Në fund, për shembull, në rast që dëshmitari nuk është në gjendje të marrë pjesë në seancën dëgjimore, për shkak të arsyeve serioze shëndetësore, gjykatësi (mundësisht, në shoqëri të palëve për të respektuar parimin e barazisë së armëve) mund të delegohet nga Gjykata për të dëgjuar atë dëshmitar të caktuar.

Rregulli 46 [Thirrjet e dëshmitarëve] i Rregullores së Punës

1. Gjykata urdhëron marrjen në pyetje në seancë dëgjimore të dëshmitarit të propozuar nga një palë, nëse pala paraqet ose dëshmon arsye të mjaftueshme për marrjen në pyetje të atij dëshmitari.

2. Nëse Gjykata urdhëron marrjen në pyetje të një dëshmitari, ajo do ta lëshojë një urdhër që përmban:
(a) emrin e plotë dhe adresën e dëshmitarit,
(b) një tregues të fakteve për të cilat dëshmitari do të merret në pyetje; dhe
(c) datën, kohën dhe vendin e marrjes në pyetje.

3. **Nëse Gjykata vendos se pala ka paraqitur dëshmi të pamjaftueshme për thirrjen e dëshmitarit, Gjykata e informon atë palë me shkrim për arsyet e këtij vendimi.**
4. **Dëshmitari mund të thirret, me kusht që, pala që kërkon thirrjen, të depozitojë në Sekretariat shumën që është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet që mund t'i bëjë dëshmitari. Nëse thirrja e dëshmitarit nuk kushtëzohet me një depozitim, Sekretariati i dërgon paraprakisht fondet e nevojshme për marrjen në pyetje të një dëshmitari të thirrur.**
5. **Sekretariati ua dërgon palëve dhe përfaqësuesve urdhrat ose vendimet për dëshmitë.**
6. **Dëshmitarët, që janë thirrur me kohë, duhet t'i përgjigjen thirrjes dhe të marrin pjesë në seancë dëgjimore. Nëse dëshmitari, që është thirrur me kohë, nuk paraqitet në seancë dëgjimore, Gjykata mund të ndëshkojë dëshmitarin me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro dhe mund të urdhërojë që dëshmitarit t'i dërgohen ftesa të tjera në shpenzime të dëshmitarit. Nëse dëshmitari i thirrur me kohë refuzon të dëshmojë, refuzon të japë betimin ose refuzon të japë deklaratën solemne pa ndonjë arsye të duhur, Gjykata mund të ndëshkojë dëshmitarin me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro.**
7. **Nëse dëshmitari më pas paraqet një arsyetim të vlefshëm për mosparaqitje, ndëshkimi i vënë financiar mund të zvogëlohet ose mund të anulohet nga Gjykata. Dëshmitari mund të kërkojë nga Gjykata zvogëlimin e ndëshkimit financiar, nëse ai është në shpërpjesëtim me mjetet financiare të tij.**

Me sa duket, Rregulli 46 nuk prek dot çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve. Megjithatë, mund të ndodh që në rastet e caktuara të paraqitura para Gjykatës, dëshmitarët dhe/ose anëtarët e familjes së dëshmitarëve të jenë kërcënuar seriozisht dhe të kenë frikë nga pasojat, në rast se këta dëshmitarë japin dëshmitë e tyre. Edhe pse kjo mund të ndodh më shpesh në rastet penale para gjykatave të rregullta sesa në referimet para Gjykatës Kushtetuese, megjithatë gjasat për të ndodhur një gjë e tillë nuk duhen përjashtuar. Në rastet e tilla, Gjykata do të duhet të vendos, se si do të trajtojë çështjen dhe mund të marrë parasysh rregullën dhe praktikat, për shembull, që ndiqen nga gjykatat penale bazuar në Ligjin për Mbrojtje të Dëshmitarëve[425].

I. Gjykata mund të zhvillojë kritere të caktuara për të arritur deri te "shkaku i mjaftueshëm" që pala duhet të tregojë ose dëshmojë, gjatë propozimit që i drejton Gjykatës për të marrë në pyetje një dëshmitar. Në çfarëdo rasti, kjo do të thotë që Gjykata mund të refuzojë të thërret një dëshmitar, nëse pala nuk ka qenë në gjendje të tregojë se dëshmia, që duhet të jepet nga dëshmitari, do të jetë relevante për rastin. Një rregull të ngjashme e gjejmë në Nenin 339.2 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore,[426] që përcakton se "Vetëm personat që mund të japin informatë mbi dëshmitë mund të thirren për të dëshmuar". Nëse cilado palë propozon një numër të dëshmitarëve, Gjykata mund të urdhërojë po atë palë të kufizojë numrin, e sidomos, nëse ai/ajo nuk është në gjendje të dëshmojë shkak të mjaftueshëm për

[425] Ligji nr. 04/L-015 i datës 1 Shtator 2011.
[426] Ligji nr. 03/L-006 i datës 30 Qershor 2008.

marrjen në pyetje të secilit prej tyre. Në lidhje me këtë, Gjykata do të duhet të marrë parasysh parimin e "armëve të barabarta", të cituar në Rregullën paraprake, në mënyrë që të ruajë bilancin e arsyeshëm midis numrit të dëshmitarëve të secilës palë, që duhet dëgjuar në gjykatë.

II. Për secilin dëshmitar që ftohet për t'u marrë në pyetje, Gjykata duhet të lëshojë një urdhër që përmban informatën e përmendur në Rregullën 46(2)(a) to (c), e që do të adresohet nga Sekretari i Përgjithshëm për atë dëshmitar dhe për të gjitha palët. Rregulla mbetet e heshtur mbi vërtetimin e identitetit të dëshmitarit në këtë fazë të procedurës. Kjo çështje rregullohet me Rregullën 47(4), që siguron që Kryetari do të vendos identitetin e dëshmitarit, atëherë kur ai/ajo të ftohet për të dhënë dëshminë në seancën gojore të dëgjimit. Do të ishte më e udhës, nëse Sekretariati do ta bënte këtë në një fazë të mëhershme, ashtu që identifikimi nga Kryetari të ishte vetëm formalitet në seancën dëgjimore.

III. Sipas Rregullës 46(3), kur Gjykata e informon palën mbi vendimin se nuk do të thërras dëshmitarët e propozuar për shkak se pala nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme që do të nxitnin Gjykatën ta bënte një gjë të tillë, nuk do të ishte tërësisht e paarsyeshme (edhe pse Rregulla mbetet e heshtur për këtë çështje), që pala të lejohej të dorëzonte dëshmi shtesë dhe të kërkonte nga Gjykata të ri vlerësonte pozicionin e vet, dhe, nëse Gjykata e refuzon një gjë të tillë (dhe e hedh poshtë kërkesën sërish), palës t'i jepej mundësia të propozonte edhe një dëshmitar dhe këtë herë, të tregonte se ka shkak të mjaftueshëm për marrjen në pyetje të atij dëshmitari.
Megjithatë, Gjykata mund të refuzojë sërish kërkesën për arsye të ngjashme. Se sa herë mundet pala të propozojë një dëshmitar të ri, varet sigurisht nga rrethanat e atij rasti. Natyrisht, siç u përmend më lartë, në rast të trajtimit të kësaj çështjeje, Gjykata duhet të marrë parasysh të drejtën e palës për gjykim të drejtë, e posaçërisht, parimin e armëve të barabarta, nëse Gjykata lejon dëshmitarin/en (dëshmitarët) e palës tjetër të dëgjohen. Kundërshtimi i palës kundër një dëshmitari të propozuar nga pala tjetër, trajtohet në Rregullën 49 [Kundërshtimet e Dëshmitarëve ose Ekspertëve] më poshtë.

IV. Rregulla 46(4) prek kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në Nenin 28 [Shpenzimet Procedurale] të Ligjit që "palët mbajnë përgjegjësi për të mbuluar shpenzimet procedural, pos nëse vendoset ndryshe nga Gjykata". Megjithatë, duhet vërejtur se parashtruesit sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës, që janë të detyruar të paguajnë shpenzimet nga xhepi i tyre, institucionet publike paguajnë shpenzimet nga buxhetet e tyre dhe si palë kundërshtuese, janë normalisht të përfaqësuar nga avokatët e tyre, derisa Neni 113.7 përcakton se parashtruesit duhet të paguajnë përfaqësimin vetë, e që do të mund t'i detyronte që për shkak të mungesës së fondeve, të mos përfaqësohen nga një përfaqësues ligjor.
Gjithashtu, dëshmitarët dhe ekspertët, të propozuar nga autoritetet publike që të marrin pjesë në seancën dëgjimore, normalisht do të paguhen nga ata. Kjo mund të krijojë një disbalans të konsiderueshëm në pozitën e palëve para Gjykatës, e që lehtë do të mund të kompromet onte parimin e "barazisë së armëve".

Në këtë kuptim, Rregulla 46(4) përcakton që Gjykata mund të thërrasë dëshmitarin me kusht, atëherë kur pala parashtruese paguan depozitën në Sekretariat, në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e pritshme që do të mund t'i ngarkoheshin dëshmitarit. Rregulla përcakton se nëse Gjykata nuk kushtëzon thirrjet në bazë të depozitës, Sekretariati do të parapaguajë shumat e nevojshme në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarit të thirrur. Prandaj, kuptimi me gjasë është se pala parashtruese duhet të mbulojë pagesën në avans ndaj Sekretariatit.

Megjithatë, Neni 28.2 përmban një përjashtim të Rregullës që palët duhet të paguajnë për shpenzimet e tyre procedural, duke përcaktuar se: "Pala që ka parashtruar kërkesë për referim sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës, do të përjashtohet nga obligimi për të mbuluar shpenzimet procedurale, nëse Gjykata Kushtetuese vendos që një referim i tillë është i pranueshëm dhe i bazuar". Por nëse Gjykata mund të vendos të lirojë palën nga pagesa e shpenzimeve procedurale të saj. Nëse Gjykata do të hidhte poshtë kërkesës dhe vetëm do të vendoste të thërret dëshmitarin nëse pala paguan depozitën (e që ai/ajo nuk mund ta bëjë), kjo seriozisht do të pengonte aftësinë e palës që në mënyrë të duhur të ndërtonte rastin e tij/saj para Gjykatës. Kjo do të mund të ngritë çështjen e të drejtës për gjykim të drejtë (parimin e barazisë së armëve) të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe Nenin 6 të KEDNJ-së, e sidomos nëse pala tjetër, si institucion publik, ka mjetet financiare për të paguar shumën e domosdoshme në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve, për të cilët ka kërkuar nga Gjykata që të thirren. Për shembull, në një rast përkitazi me pagesën e tarifave të gjykatës,427 GJEDNJ-ja vendosi që nëse shuma që duhet paguar paraqet problem për parashtruesin428, atëherë do të mund të paraqitet çështje sipas Nenit 6 të KEDNJ-së. I njëjti arsyetim do të mund të përdorej edhe për pagesën e shpenzimeve të tjera procedurale.

Ne lidhje me kërkesën e përgjithshme që palët duhet të mbulojnë shpenzimet e tyre, ekziston një referencë në Ligjin për Procedurën Kontestimore, që po ashtu kërkon, sipas Nenit 451, që "Dëshmitari, eksperti, përmbledhja e dëshmive dhe shpenzimet parapaguhen nga pala kërkuese". Po këtu, palët mund të përjashtohen nga kërkesa për të paguar shpenzimet e tilla duke u mbështetur në Nenin 468(1), duke siguruar që "Gjykata e përjashton palën nga pagesa e shpenzimeve, nëse përcaktohet se një gjë e tillë "është përtej aftësive financiaret ë palës, dhe se pagesa e shpenzimeve do të mund të dëmtonte palën ose familjen e tij/saj", në kundërshtim me Nenin 471, ku thuhet se "nëse pala përjashtohet nga të gjitha shpenzimet, atëherë gjykata do të paguajë për shpenzimet e realizuara për dëshmitarët, ekspertët, marrjet në pyetje, publikimin e akteve gjyqësore, si dhe për shpenzimet e caktimit të përfaqësuesit".

Megjithatë, Neni 452(1) i Ligjit të Procedurës Kontestimore përcakton se "Pala që e humb procesin gjyqësor duhet të mbulojë të gjitha shpenzimet e palës fituese, tërësisht, si dhe shpenzimet e ndërmjetësit, nëse ai/ajo i është bashkangjitur procesit". Prandaj, mbetet pyetja, se kush do të mbulojë shpenzimet nëse pala që humb rastin, nuk ka mjetet e mjaftueshme. Me gjasë, pala humbëse mund të

[427] Shih *Bakan kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 50939/99, Vendimi i GJEDNJ më 12 Qershor 2007.

[428] Pala përgjegjëse në procedurën para GJEDNJ-së është Shteti përgjegjës, i përfaqësuar nga agjentët e vet Qeveritarë.

parashtrojë kërkesën që sipas Nenit 468.1 të atij Ligjit, të përjashtohet nga detyrimi për të paguar këto shpenzime.

V. Sipas Rregullës 46(5), në mënyrë që të lejohen palët dhe përfaqësuesit e tyre, nëse të tillë janë caktuar, që të përgatiten për rastin sa më mirë, është e rëndësishme që ata të pranojnë nga një kopje të këtyre urdhrave të Gjykatës, në kohë, për të kuptuar se kush janë dëshmitarët e palës tjetër. Megjithatë, Rregulla nuk përcakton kufizimin kohor brenda të cilit Sekretariati (në praktikë, është Sekretari i Përgjithshëm ai/ajo që duhet të jap urdhra të tilla si dhe vendimet për dëshmitarët) do të duhej të jepte informatën e tillë.

VI. Para se të hyhet në thelb të Rregullës 46(6), çështja mund të ngritët, siç u përmend më lartë, nëse Gjykata ka pushtet të imponojë ndëshkime financiare mbi bazën e Rregullave dhe Procedurave. Pushteti për të lëshuar thirrje gjyqi si dhe pushtetin për zbatimin e tyre, rregullohet me akt parlamentar. Prandaj, ngritët çështja nëse legjislatura do të duhej të trajtonte këtë çështje në vet Ligjin[429] ose do të mundet thjeshtë t'i delegonte sipas ligjit, pushtetin Gjykatës për të imponuar ndëshkimet përmes Rregullave dhe Procedurave. Meqë Ligjit mbetet i heshtur në këtë çështje, Gjykata e ka përcaktuar këtë kompetencë në Rregullës dhe Procedurat e saj. Në të kundërt, Ligji për Procedurën Civile, për shembull, rregullon kompetencat e ngjashme të gjykatave civile në Kapitullin XX të saj [Mos-respektimi ndaj Gjykatës]. Prandaj, mund të konstatohet se Ligji do të duhej të rregullonte imponimin e ndëshkimeve financiare, pa e lënë këtë iniciativë në kompetencë të Gjykatës, sipas Rregullës 46 të saj.

Përkitazi me thelbin e Rregullës, arsyeja për mungesën e dëshmitarit mund të jetë, sëmundje serioze ose vdekja. Nëse në raste të tilla Gjykata do të mund të bazohej në dëshmitë e fjalëve, kjo varet me gjasë nga rasti në shqyrtim e sipër. Përkitazi me dëshmitarin që vuan nga shëndeti i ligë, Gjykata sigurisht se do të merrte parasysh ekzistencën e alternativave për të dëgjuar atë. Nëse dëshmitari që është ftuar për dëshmi sipas rregullave, nuk paraqitet në seancën dëgjimore pa ndonjë arsye, Gjykata në këtë rast mund të vendos ndëshkim financiar jo më shumë se 500 Euro dhe të lëshojë ftesa të reja. Kjo mund të mos e pengojë Gjykatën që të vazhdojë me dëgjimin e palëve dhe dëshmitarëve të tjerë. Pastaj, mund të shtyjë seancën dëgjimore deri në një datë tjetër, në mënyrë që të dëgjojë dëshmitarin tjetër, i cili nuk kishte ardhur. Nëse dëshmitari sërish nuk vjen, supozohet që Gjykata do të mund të vendos ndëshkimin sipas Rregullës të njëjtë.

Nëse mos-respektimi i urdhrave të Gjykatës po ashtu ndëshkohet si shpërfillje e gjykatës, kjo akoma nuk është e qartë. Gjykata gjithashtu nuk ka autoritetin e gjykatave penale, për të sjellë dëshmitarin e pavullnetshëm me ndihmën e policisë, mirëpo kjo do të mund të ishte e mundur sipas Nenit 16 [Rregulla e Përgjithshme] e Ligjit, sipas të cilit Gjykata mund të zbatojë dispozita përkatëse të ligjeve të tjera procedural, për shembull, si ato që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e dhunshme të

[429] Për shembull, Neni 34a i Aktit të Gjykatës Kushtetuese Sllovene parasheh pagesën e ndëshkimit, si vijon: "*Gjykata Kushtetuese mund të ndëshkojë një pjesëmarrës në procedurë ose përfaqësuesin e tij/saj të autorizuar me gjobë prej 100 deri ne 2,000 Euros, nëse ata shpërdorojnë të drejtat në pajtueshjëri me këtë Akt*".

seancave gjyqësore. Për më tepër, Rregulla nuk përcakton një mekanizëm zbatues për të zbatuar ndëshkimin financiar, edhe pse këtu, do të mund të kërkohej mbështetja në dispozitat e tjera relevante ose ligjeve të tjera procedurale.
Edhe pse Rregulla mbetet i heshtur në këtë çështje, Gjykata mundet, në kuptim të së drejtës së palës që ka propozuar dëshmitarin e pa vullnetshëm, të lejojë atë palë të identifikojë edhe një tjetër dëshmitar, ose, nëse jo, të propozojë një mënyrë alternative për të paraqitur dëshmitë, të cilat është dashur t'i paraqes dëshmitari.
Një çështje e ngjashme, që posa u diskutua, në kuptim të dëshmitarit të pavullnetshëm për t'u paraqitur në seancën dëgjimore, mund të ngrihet, nëse dëshmitari i ftuar, refuzon pa ndonjë arsye të vlefshme, 430, për të dhënë dëshminë në seancën dëgjimore ose të betohet ose të japë deklaratë solemne dhe të vazhdojë ta bëjë një gjë të tillë, edhe pasi që Gjykata të ketë caktuar ndëshkimin financiar kundër tij/saj. Masa e vetme që Gjykata do të mund ta ndërmerrte në këto rrethana, është që dëshmitari të largohet nga gjykatorja dhe të vazhdohet me seancën dëgjimore pa praninë e atij dëshmitari ose të shtyje seancën (për shembull, në një rast kompleks), dhe të kërkojë nga pala që ka propozuar dëshmitarin e pavullnetshëm të propozojë një tjetër dëshmitar, ose, nëse jo, të paraqes dëshminë që dëshmitari i pavullnetshëm është dashur të paraqes, në një mënyrë alternative.
Megjithatë, dëshmitari në fakt mund të ketë arsye për mos-paraqitje, për shembull, ai/ajo mund të jetë kërcënuar, e që duhet të merret seriozisht, por që thjesht ishin injoruar nga pala, që ka propozuar dëshmitarin. Dëshmitari mund të mos i ketë treguar fare palës propozuese për kërcënimin. Në këtë rast, zgjidhja do të mund të ishte që dëshmitari i pavullnetshëm do të mund të informonte gjykatësit para kamerës lidhur me rrethanat e refuzimit të tij/saj. Vërejtjet e kaluara përkitazi me mbrojtën e dëshmitarit janë njëjtë të vlefshme.

VII. Sipas Rregullës 46(7), nëse dëshmitari, për shembull, dëshmon mbi bazën e një certifikatë shëndetësore se është i sëmurë, Gjykata, thjeshtë, mund, të anulojë ndëshkimin financiar. Për më tepër, edhe pse Rregulla është e heshtur në këtë çështje, mund të ndodh që nëse dëshmitari dëshmon se është i paaftë për të paguar, Gjykata jo vetëm që mund të ul ndëshkimin, por edhe ta anulojë atë tërësisht, në një mënyrë të ngjashme siç përmendet në Nenin 468 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Rregulli 47 [Dëshmia e dëshmitarëve] i Rregullores së Punës

1. Gjykata mund të urdhërojë që dëshmitarët të përjashtohen nga pjesëmarrja në seancë dëgjimore gjatë ndonjë prezantimi me gojë të palëve, të përfaqësuesve të tyre, ose gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tjerë.
2. Palët kanë të drejtë të jenë të pranishme gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.
3. Dëshmitari ka të drejtë të refuzojë të dëshmojë për çështjet e mëposhtme:
(a) për çfarëdo që i është thënë dëshmitarit gjatë bisedës së mbrojtur me privilegj fetar;

[430] Dëshmitari mund të ketë arsye të vlefshme, siç përmendet në Rregullin 47.3 më poshtë.

(b) për çfarëdo që dëshmitari ka marrë vesh, ose për ndonjë këshillë të dhënë nga dëshmitari, në cilësinë e tij si avokat ose si mjek, apo gjatë ushtrimit të një profesioni ose të një aktiviteti tjetër, i cili nënkupton obligimin e njohur ligjor të ruajtjes së sekretit të informacioneve; dhe

(c) për faktet, ose për informacionet, që mund të inkriminojnë dëshmitarin, bashkëshortin/en e tij/saj, ose pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë dhe trashëgimtarët më të largët deri në brezin e tretë.

4. Kur dëshmitari ftohet për të dhënë dëshmi, Kryetari fillimisht duhet të përcaktojë identitetin e dëshmitarit. Pastaj, Kryetari duhet ta informojë dëshmitarin për të drejtën e tij për të refuzuar dhënien e dëshmisë, siç përcaktohet në paragrafin 3, dhe për pasojat penale për dhënie të rrejshme të dëshmisë. Dëshmitarit mund t'i kërkohet të japë betimin solemn se dëshmia e dhënë është e saktë.

5. Para dhënies së dëshmisë, dëshmitari jep betimin, ose deklaratën solemne, si në vijim: "Unë, emri, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do të tregoj të vërtetën, tërë të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës".

6. Nëse dëshmitari refuzon pa arsye të japë dëshminë, ose refuzon të betohet atë deklarohet solemnisht, Gjykata mund t'i shqiptojë një gjobë në vlerë jo më të lartë se pesëqind (500) euro. Gjykata vendos se çfarë rëndësie, nëse ka, do t'i kushtohet dëshmisë së dëshmitarëve.

7. Para se t'i bëhen pyetje dëshmitarit, ai paraqet një njoftim gojor për njohuritë e tij për faktet që janë objekt i marrjes së tij në pyetje.

8. Kryetari dhe gjyqtarët mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, e pas tyre ndonjë palë që nuk e ka kërkuar marrjen në pyetje, e pastaj pala që e ka kërkuar marrjen në pyetje. Gjyqtarët mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit në çdo kohë gjatë dhënies së dëshmisë.

9. Sekretari i Përgjithshëm siguron përpilimin e procesverbalit, i cili pasqyron në mënyrë të saktë dëshminë e secilit dëshmitar. Pastaj, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari ose nga gjyqtari përgjegjës për marrjen në pyetje të dëshmitarit.

I. Rregulla 47(1) është e ngjashme me Rregullën procedurale që ndiqen në procedurat civile dhe penale. Qëllimi i Rregullës është të evitojë rastet kur dëshmitarët, që akoma kanë për të dëshmuar në seancat dëgjimore, të mos ndikohen nga prezantimet gojore të palëve, përfaqësuesit e tyre ose dëshmitarëve të tjerë. Si rezultat, dëshmitë e tyre, mund të jenë më pak ose fare të besueshme. Në këtë rast Kryetari do të urdhërojë përjashtimin e dëshmitarëve, por ai/ajo sigurisht se do të konsultoje edhe gjykatësit tjerë, para se të marrë vendimin në fjalë.

II. Gjithashtu, Rregulla 47(2) nuk dallon nga ai që lidhet me procedurat civile dhe penale. Ky është një aspekt i së drejtës për gjykim të drejtë, e veçanërisht, është parimi i barazisë së armëve, dhe qëllimi në këtë rast është që dëshmia duhet të prodhohet në praninë e të dyja palëve në kuptim të argumentit kundërshtues, për shembull, duke mundësuar kështu palët të shtrojnë pyetje drejt dëshmitarëve në

mënyrë që të përforcojnë rastin e tyre ose pohimin që dëshmitari i palës tjetër nuk ka dëshmi të besueshme.
Gjithashtu, GJEDNJ-ja njeh faktin që kjo e drejtë është tipar shumë i rëndësishëm i parimit për gjykim të drejtë të Nenit 6[431].

III. Rregulla 47(3) nuk përmban përjashtime. Rregulla të ngjashme ekzistojnë edhe në procedurat civile dhe penale. Në Rregullën 47(3)(c), nuk është e qartë se për çfarë arsye dëshmitari ka vetëm të drejtën që të refuzojë të dëshmojë në kuptim të fakteve dhe informatës, e që do të mund të implikonte edhe pasardhësit e dëshmitarit, dhe jo edhe paraardhësit, në vijë të drejtpërdrejte (siç janë prindërit, gjyshërit dhe paraardhësit e mëtejmë). Për shembull, sipas Nenit 343 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, përmendet "secila gjeneratë në vijë të drejtpërdrejte". Sugjerohet që Rregulla të ndryshohet rrjedhimisht.

IV. Siç u përmend më lartë, në mënyrë që të evitohen problemet rreth vërtetimit nga Kryetari gjatë seancës dëgjimore, supozohet që Sekretariati të vërtetojë identitetin e dëshmitarit para seancës duke kontrolluar vlefshmërinë e kartelës së identifikimit ose pasaportës së dëshmitarit dhe nëse ky dokumentacion është lëshuar nga autoritetet kompetente. Dëshmitarët më pas do të pranojnë një paralajmërim nga Kryetari lidhur me të drejtën për të refuzuar, të jepet dëshmia si dhe lidhur me pasojat penale e të dhënit dëshmi të rrejshme. Pasojë e mëtutjeshme penale do të mund të rezultonte nga refuzimi i dëshmitarit për të dëshmuar nën bindje të rrejshme ose nën kategoritë e Rregullës 47(3). Nëse një dëshmitar në një seancë dëgjimore injoron paralajmërimin e Kryetarit dhe, megjithatë, vazhdon të japë dëshmi ose informatë të rrejshme, ngritët çështja, se kush do të informojë prokuronin publik rreth aktit të dyshuar penal. Supozohet se Sekretari i Përgjithshëm do ta bëj këtë në emër të Kryetarit të Gjykatës. Kryetari gjithashtu do të informojë dëshmitarin që ai/ajo mund të mos lejohet të betohet ose të japë deklaratën solemne që dëshmia e dëshmitarit është e vërtetë. Megjithatë, termi "mund" duhet të zëvendësohet me "duhet", në kuptim të dispozitës së Rregullës 47(5).

V. Pos obligimit të dëshmitarit që të betohet ose të japë deklaratën solemne, Rregulla 47(5) mbetet i heshtur në lidhje me faktin se kush do të lexojë betimin ose deklaratën solemne, që dëshmitari duhet ta përsëris. Supozohet se Kryetari do ta bëjë këtë. Rregulla nuk përmend kurrfarë ndëshkimesh, nëse dëshmitari shkel betimin ose deklaratën solemne. Vetëm Rregulla 47(6) parasheh përcaktimin për ndëshkim në rrethanat e përmendura këtu.

VI. Fjalia e parë e Rregullës është gati identike me fjalinë e fundit të Rregullës 46(6) e që është komentuar më lartë. Dispozita e këtij Rregullës 47(6) prandaj, mund të fshihet.
Fjalia e dytë e Rregullës, që ka të bëjë me privilegjet e Gjykatës të çmojë dëshminë e dëshmitarëve, nuk duket të jetë në kuadër të Rregullës 47(6), por do të duhej

[431] Shih, për shembull *Barbara, MessegueandJabardo kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 10590/83, Vendimi i GJEDNJ-së më 6 Dhjetor 1988, par. 78.

shtuar një paragraf për të theksuar rëndësinë që ka. Mirëpo, mund të ndodh që të jetë bërë gabim në tekst dhe se është menduar në dëshminë e "dëshmitarit refuzues". Në këtë rast, është lehtë të kuptohet që Gjykata do të përcaktojë se me çfarë rëndësie do të konsideroje dëshminë e dëshmitarëve të tillë.

VII. Sipas Rregullës 47(7), kujtesa gojore e dëshmitarit lidhur me njohurinë e tij/saj për faktet është e rëndësishme për Gjykatën dhe palët për të përcaktuar se deri në cilën masë është i njoftuar dëshmitari me rastin, e në veçanti me ato fakte për të cilat dëshmitari do të duhej të merrej në pyetje sipas propozimit të dorëzuar në Gjykata, nga pala që kërkon që ky dëshmitar të dëgjohet, sipas Rregullës 46(2)(b). Për më tepër, kjo do të mund t'i jepte Gjykatës dhe palëve tashmë një ide më të sigurte rreth besueshmërisë së dëshmitarit.

VIII. Rregulla 47(8) lejon të gjithë gjykatësit që të shtrojnë pyetje për dëshmitarin në çfarëdo kohe gjatë dëshmisë, derisa Kryetari të vendos se më nuk mund të vazhdojnë të marrin në pyetje dëshmitarin. Pastaj, pala që nuk kërkon marrjen në pyetje, vijuar nga pala kërkuese, mund të shtrojë pyetje, për sa kohë Kryetari e lejon një gjë të tillë.

IX. Siç u përmend më herët, ndryshe nga transkripti, procesverbali nuk është instrument i duhur që mund të reflektojë dëshminë e dëshmitarit në mënyrë të saktë. Meqë e tërë seanca dëgjimore normalisht regjistrohet, dëshmia e dëshmitarit, prandaj, mund të reflektohet me saktësi në transkriptin e seancës dëgjimore. Procesverbali i hartuar në lidhje më dëshminë e secilit dëshmitar, mund vetëm të përmbajë natyrën, dhe mundësisht, një përmbledhje të dëshmisë si dhe emrat e gjykatësve dhe/ose palëve që kanë shtruar pyetjet. Detajet e plota duhet të jenë në transkript. Supozohet që gjykatësi përgjegjës për marrjen në pyetje të dëshmitarit, siç përmendet në fjalinë e fundit të Rregullës 47.\9(,) është gjykatësi i deleguar nga Gjykata sipas Rregullës 45 [Dorëzimi i Dëshmisë nga Palët] paragrafi 2 për të realizuar marrjen në pyetje të dëshmitarit, e që për shembull, nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë në seancën dëgjimore për shkak të shëndetit të dobët, moshës ose ndonjë arsyeje tjetër të vlefshme, dhe prandaj, është marrë në pyetje në shtëpi ose në ndonjë lokacion tjetër të përshtatshëm[432] në prani të palëve.

Rregulli 48 [Ekspertët] i Rregullores së Punës

1. Gjykata angazhon ekspertë në këtë mënyrë:

(a) Pas kërkesës së palës që bart barrën e të provuarit për një fakt të caktuar, Gjykata mund ta caktojë një ekspert, i cili e përgatit raportin e ekspertit. Urdhri për caktimin e ekspertit përcakton fushëveprimin e punës së ekspertit dhe cakton afatet kohore brenda të cilave eksperti duhet t'ia paraqesë raportin Gjykatës.

[432] Neni 346 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përmban një rregull të ngjashëm.

(b) Çdo ekspert i caktuar, në mundësinë e tij të parë, do t'ia shpalosë Gjykatës konfliktet e mundshme të interesit që ai mund t'i ketë përkitazi me dëshminë e tyre.

2. Një person nuk caktohet ekspert për një kërkesë në të cilin ai person:

(a) Ka qenë i përfshirë më përpara si përfaqësues ose si këshilltar;

(b) Ka vepruar në ndonjë kohë për njërën prej palëve të këtij rasti;

(c) Ka lidhje, qoftë familjare ose nëpërmjet martesës, me ndonjërën nga palët; ose

(d) Është apo ka qenë zyrtar, këshilltar politik, ose kontraktues i ndonjë subjekti që është palë në këtë rast.

3. Eksperti i caktuar merr një kopje të urdhrit për caktimin e tij dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për punën e tij. Eksperti mbikëqyret nga Gjyqtari raportues, i emëruar për atë kërkesë, i cili mund të jetë i pranishëm gjatë hetimeve dhe i cili do të informohet për progresin e punës.

4. Gjykata mund të kërkojë nga pala që kërkon ekspertin që t'i paguajë një depozitë Sekretariatit në shumën që do jetë e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me raportin e ekspertit.

5. Eksperti jep mendimin e tij vetëm për çështjet dhe për faktet që i janë kërkuar atij në mënyrë të qartë.

6. Eksperti ia paraqet raportin e tij Gjykatës, ndërsa Sekretariati u jep kopje të gjithë gjyqtarëve dhe ia dërgon nga një kopje të raportit secilës palë.

7. Gjykata mund të urdhërojë marrjen në pyetje të ekspertit në seancë dëgjimore përkitazi me kërkesën, nëse palët janë njoftuar që eksperti do të dëshmojë. Të gjithë gjyqtarët dhe të gjitha palët mund t'i bëjnë pyetje ekspertit.

8. Para se të merret në pyetje në seancë dëgjimore, ose para se ta japë dëshminë e tij, eksperti jep betimin ose deklaratën solemne para Gjykatës: "Unë, emri, betohem (ose deklaroj solemnisht) se e kam kryer detyrën time me vetëdije dhe në mënyrë të paanshme; se i kam dhënë Gjykatës kopjet e të gjitha dëshmive në të cilat unë e kam bazuar mendimin tim; se besoj që të gjitha faktet në të cilat unë e kam bazuar mendimin tim janë të vërteta; dhe se në mënyrë të ndershme dhe në mirëbesim e mbaj mendimin që e kam paraqitur dhe do ta paraqes në Gjykatë".

9. Nëse eksperti refuzon pa arsyetim që të japë dëshminë ose të paraqesë raportin, apo refuzon të japë betimin ose deklaratën solemne, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë prej jo më shumë se pesëqind (500) euro. Gjykata vendos se çfarë rëndësie, nëse ka, do t'i kushtohet dëshmisë së dëshmitarëve.

Gjithashtu, e drejta e secilës palë që të ketë ekspert të emëruar është një aspekt i parimit të barazisë së armëve, që në vete është pjesë e së drejtës për gjykim të drejtë. Barazia është relevante për shembull, edhe në rastet kur dëshmitari ekspert i emëruar sipas propozimit të njërës palë nuk trajtohet me të njëjtën barazi si dëshmitari i emëruar në bazë të propozimit të palës tjetër. Ky trajtim i pa-barabartë mund të qojë deri te

shkelja e atij parimi[433]. Për më tepër, Rregulla me gjasë nuk përfshin mundësinë që Gjykata të emërojë ekspert *ex officio*.

I. Rregulla 48(1)(a) nuk përmban një dispozitë të ngjashme si ajo në Rregullën 46 [Thirrja e Dëshmitarëve] e që në paragrafin 3 të saj, përcakton që Gjykata do të thërras dëshmitarët, nëse e përcakton që pala kërkuese ka treguar "dëshmi të mjaftueshme" që dëshmitari të emërohet. Prandaj, supozohet që Gjykata do ta bëjë një gjë të tillë, vetëm nëse parashtresa e palës propozuese përmban dëshmi të mjaftueshme për emërimin e ekspertit. Urdhri i Kryetarit, me të cilin emërohet eksperti, përmendet edhe fushëveprimi (dëshmia për një fakt të posaçëm - si dhe kufizimi kohor.
Edhe pse Rregulla 48(1)(b) përcakton se eksperti do të shpalos para Gjykatës çfarëdo konflikti të interesit në mundësinë e parë që t'i jepet "pas emërimit të tij/saj", do të ishte më e logjikshme që mundësia e parë në dispozicion për ekspertin që të shpalos ekzistencën e konfliktit të mundshëm të interesit është "para emërimit të tij/saj" nga Gjykata. Në këtë rast, Gjykata do të emërojë një ekspert tjetër të propozuar nga pala, në vend se të shkohet me emërimin origjinal.

II. Edhe pse Gjykata nuk duhet të emërojë ekspertin, që ka qenë ose akoma është në marrëdhënie me njërën nga palët, sipas Rregullës 48(2), lista nuk duket të jetë e shteruar. Për shembull, mund të ketë konflikt interesi, nëse eksperti ka lidhje familjare ose përmes martesës me njërin nga dëshmitarët ose ekspertët. Prandaj, sugjerohet që t'i shtohet edhe një paragraf tjetër Rregullës 48(2) me tekstin vijues "*e) Është ose ishte në çfarëdo kapaciteti i/e lidhur me cilëndo palë, pjesëmarrës ose palë tjetër të interesuar ose persona në procedurë*".
Për më tepër, mund të ekzistojë konflikt interesi edhe nëse personi në fjalë nuk ka kurrfarë lidhshmërie me asnjërën palë, pjesëmarrës ose persona të përfshirë në procedurë, por që më parë, ka përgatitur raporte në raste të ngjashme. Nëse emërohet, konkluzionet e ekspertit prandaj, do të duhej të bëheshin të ditura.

III. Sipas Rregullës 48(3) supozohet që urdhri për emërim si dhe dokumentacioni shoqërues të dërgohen me dorëzim fizik ose poste të regjistruar nga Sekretari i Përgjithshëm. Përkitazi me mbikëqyrjen e ekspertit nga Gjykatësi Raportues, duhet përmendur që në raste të ngjashme të mbikëqyrjes, mund të mandatohet cilido gjykatës. Për shembull Rregulla 45(2) specifikon që përmbledhja e dëshmisë së caktuar mund të delegohet nga Gjykata, deri te një gjykatës, derisa Rregulla 47(9) i referohet "gjykatësit përgjegjës për të kryer marrjen në pyetje të dëshmitarit" (shih komentet në Rregullën 45(2) dhe 47(9) më lartë). Megjithatë, Rregulla 48(3) qartazi përcakton se është Gjykatësi Raportues ai që do të mbikëqyr aktivitetet e ekspertit. Një zgjidhje edhe më konsistente do të mund të ishte që Gjykatësi Raportues të ngarkohej me përgjegjësitë e përmendura në Rregullën 45(2) dhe 47(9).

[433] Shih, *mutatis mutandis*, *Bonisch kundër Austrisë*, Kërkesa nr. 8658/79, Vendimi i GJEDNJ-së më 6 Maj 1985.

IV. Derisa Rregulla 46(4) më lartë ka të bëjë me pagesën e depozitit nga pala kërkuese, të një shume të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e pritura të dëshmitarit të emëruar nga Gjykata, Rregulla 48(4) përcakton një rregull të ngjashme ku eksperti emërohet nga Gjykata. Dallimi midis të dyja Rregullave është se sipas Rregullës 48(4) pala në fjalë mund të detyrohet nga Gjykata, të paguajë depozitin në Sekretariat në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar "shpenzimet e raportit të ekspertit", që nënkupton shpenzimet e dala (si në rastin e dëshmitarit) por edhe tarifën e ekspertit. Shpenzimet e ekspertizës, mund të jenë të konsiderueshme. Rregulla nuk përcakton që Sekretariati të parapaguaj shumën e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e raportit të ekspertit si në rastin e shpenzimeve për dëshmitarin, sipas Rregullës 46(4). Rregulla, po ashtu nuk përcakton mundësinë që pala që kërkon eksperti të kërkojë nga Gjykata që ta përjashtojë nga pagesa e shpenzimeve për mendimin e ekspertit për shkak të gjendjes financiare të tij/saj. Natyrisht, në këtë rast, Gjykata thjeshtë do të mund të refuzonte emërimin e ekspertit.
Megjithatë, në mungesë të ndonjë dispozite procedurale- mund t'i referohemi edhe Nenit 16 të Ligjit (zbatimit të dispozitave relevante të ligjeve procedurale dhe të zbatojmë Nenet 468 dhe 741 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, dhe kështu të përjashtojë palën e paaftë për pagesë, nga të gjitha shpenzimet, duke përfshirë edhe shpenzimet e ekspertit, dhe duke paguar vetë për të gjitha shpenzimet (natyrisht, duke supozuar, që sipas mendimit të Gjykatës, kërkesa për raportin e ekspertit është e arsyeshme). Gjykata mund të ketë më shumë tendencë për të bërë një gjë e tillë, nëse pala tjetër, e sidomos në rastet, kur kemi të bëjmë me një institucion publik, nuk e ka problem të paguajë shpenzimet e ekspertëve të vet. Në të kundërtën, nëse Gjykata do të mund të emëronte vetëm një ekspert që do të paguhet nga njëra palë dhe jo ekspertit e kërkuar nga pala që është e paaftë të paguajë, mund të ngritët çështja e barazisë në armë.

V. Siç është përmendur më lartë, në Rregullën 48(1)(a), "fushëveprimi" – që me gjasë korrespondon me "çështjet dhe faktet" e përmendura në Rregullën 48(5) – të punës së ekspertit, gjendet në urdhrin emërues të Gjykatës, një kopje e të cilit, eksperti do të duhej ta kishte pranuar bashkë me dokumentet e domosdoshme. Eksperti obligohet të respektojë Urdhrin dhe të qëndrojë brenda kufijve të mandatit të përcaktuar aty. Çka ndodh nëse ai/ajo nuk respekton Urdhrin, është e paqartë. Nëse e bën këtë me qëllim, atëherë Gjykata mund të vendos të ndëshkojë ekspertin, nëse ai/ajo refuzon të korrigjojë raportin, sipas Rregullës 48(9) ose, të paktën, ta shkarkojë atë.

VI. Siç përcaktohet në Rregullën 48(1)(a), eksperti do të duhej të dorëzojë raportin brenda afatit kohor të specifikuar në urdhrin emërues. Megjithatë, as Rregulla 48(1)(a), e as Rregulla 48(6) nuk përcaktojnë se çka do të mund të vendoste Gjykata, nëse eksperti nuk respekton kufizimin kohor të përcaktuar në urdhrin emërues, e që do të mund të shkaktonte vonesë në procedurat para Gjykatës. Atëherë, do të duhej të ngarkonte Gjykatësin Raportues, që mbikëqyr punën e ekspertit, që të informojë Gjykatën në kohë, për një vonesë të tillë, në punën e ekspertit. Gjykata më pas mund të vendos të nxisë ekspertin që të përfundojë

ekspertizën me kohë, të lejojë vazhdim të arsyeshëm, nëse kërkohet një gjë e tillë, ose të emërojë ndonjë ekspert tjetër, nëse është e domosdoshme.

VII. Sipas Rregullës 48(7), Gjykata mund të vendos nëse raporti i ekspertit do të mjaftojë ose jo për mbarëvajtjen e procedurës së mëtejme, ose nëse eksperti do të thirret në seancën dëgjimore për të dëshmuar. Në rastin e dytë, jo vetëm gjykatësit por edhe palët mund të shtrojnë pyetje për ekspertin. Kjo e drejtë e palëve rrjedh gjithashtu nga e drejta e tyre për një seancë të drejtë dhe nga parimi për barazinë e armëve, që në mënyrë të barabartë, përfshin të drejtën e palëve për njohuri dhe për të komentuar në të gjitha dëshmitë e marra, duke përfshirë këtu edhe raportet e ekspertit.

VIII. Ngjashëm si në rastin e betimit ose deklaratës solemne nga dëshmitari, me gjasë do të jetë Kryetari i Gjykatës ai që do të kërkojë nga eksperti të lexojë betimin ose deklaratën solemne. Rregulla nuk përmend asnjë ndëshkim, nëse eksperti shkel betimin ose deklaratën solemne. Vetëm Rregulla 48(9) parasheh imponimin e një ndëshkimi në rrethanat e përmendura aty.

IX. Rregulla 48(9) është i ngjashëm me Rregullës 46(6) dhe 47(6), të cekura më lartë, në kuptim të dëshmitarit refuzues. Komentet e njëjta përkitazi me imponimin e ndëshkimit financiar nga Gjykata, përmes Rregullave dhe Procedurave të saj, në vend se të bazohen në një akt të parlamentit, duke përfshirë edhe komentet përkitazi me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, janë *mutatis mutandis*, të vlefshme në rast të ekspertëve të pavullnetshëm[434].

X. Ngjashëm me fjalinë e dytë të Rregullës 47(6) përkitazi me dëshminë e dëshmitarëve, që kanë të bëjnë me privilegjin e Gjykatës për të vlerësuar dëshminë e ekspertëve, fjalia e dytë e Rregullës 48(9) nuk duket të përshtatet aty, por do të duhej një paragraf i veçantë për të theksuar rëndësinë e tij. Megjithatë, mund të ndodh që kemi të bëjmë me ndonjë gabim teksti dhe se është menduar në dëshminë e "ekspertëve refuzues". Në këtë rast, është e lehtë të kuptohet se Gjykata do të përcaktojë se çfarë rëndësie do t'i japë dëshmive të ekspertëve të tillë.

Rregulla 49 [Vërejtjet kundër dëshmitarëve dhe ekspertëve] i Rregullores së Punës

1. Secila palë mund të bëjë vërejtje, duke iu drejtuar me shkrim Gjykatës, për rëndësinë ose për kompetencën e ndonjë dëshmitari a eksperti. Çdo vërejtje ndaj një dëshmitari, ose eksperti, mund të bëhet jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas dërgimit të urdhrit për thirrjen e dëshmitarit, ose për caktimin e ekspertit. Deklarata e vërejtjes duhet të paraqesë bazën specifike të vërejtjes përkitazi me rëndësinë dhe me kompetencën e

[434] Neni 36.2 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese Sllovene përmban qasje tjetër, që përcakton se: "*Mungesa e pjesëmarrësve dhe personave të tjerë të ftuar nuk e parandalon Gjykatën Kushtetuese që të përfundojë seancën dhe të marrë vendim për rastin ne fjalë*".

dëshmitarit, ose të ekspertit, dhe të paraqesë dëshmi dhe argumente ligjore në mbështetje të vërejtjes.

2. Gjykata njofton për këtë vërejtje palët e tjera, të cilat kanë të drejtë t'i paraqesin Gjykatës përgjigje me shkrim ndaj kërkesës. Gjykata merr vendim për kërkesën pas shqyrtimit të fakteve dhe të argumenteve të paraqitura në kërkesë dhe të ndonjë përgjigjeje të pranuar nga palët e tjera.

I. Sipas Rregullës 49 (1), kundërshtimi mund të bëhet vetëm për "rëndësinë ose kompetencën e dëshmitarit ose ekspertit". Kjo duket të jetë shumë kufizuese, pasi mund të ndodh që pala kundërshtuese ka njohuri të informacioneve tjera, të cilat mund të bëjnë që dëshmitari ose eksperti që konsiderohet relevant dhe kompetent të cilësohen si të paaftë ose jo të besueshëm për të dëshmuar[435]. Sa për pjesën e mbetur të Rregullës, është e kuptueshme që paraqitja e kundërshtimit duhet të justifikohet me provat dhe argumentet ligjore, në mënyrë për të shmangur që një palë shumë lehtë të kundërshtojë një dëshmitar ose ekspert të propozuar nga pala tjetër.

II. Sipas Rregullës 49 (2), "e drejta për t'u përgjigjur" respekton parimin e barazisë së armëve të përmendur më parë. Rregulla nuk përmend ndonjë afat kohor brenda të cilit përgjigja me shkrim nga pala tjetër (e cila, në fakt, është ajo që e propozoi dëshmitarin ose ekspertin e sfiduar) do të duhet të dorëzohet në Gjykatë. Është sugjeruar se Gjykata do të japë një periudhë të ngjashme (p.sh. pesëmbëdhjetë ditë) për dorëzimin e përgjigjes si ajo e përcaktuar në Rregullën 49(1).

Rregulli 50 [Kompensimi i dëshmitarëve dhe i ekspertëve] i Rregullores së Punës

1. Dëshmitarët e thirrur nga Gjykata dhe ekspertët e caktuar nga Gjykata kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e tyre të arsyeshme të udhëtimit. Sekretariati mund t'i paguajë paraprakisht dëshmitarët dhe ekspertët për shpenzime të tilla.

2. Dëshmitarët e thirrur nga Gjykata kanë të drejtë kompensimi për fitimin e humbur. Ekspertët e caktuar nga Gjykata kanë të drejtë të paguhen me tarifa të arsyeshme për shërbimet e tyre. Sekretariati do t'ua paguajë dëshmitarëve, ose ekspertëve, kompensimin ose tarifën e tyre pas përmbushjes së obligimeve. Lartësia e pagesave përcaktohet nga Gjykata.

Duket të jetë e përshtatshme për të komentuar mbi Rregullën si një tërësi dhe për të bërë një dallim në mes të pagesave për të cilat dëshmitarët kanë të drejtë dhe atyre për të cilat ekspertët kanë të drejtë. Duke filluar me dëshmitarët, paragrafi 4 i Rregullës 46 [Thirrja e dëshmitarëve] (shih më lart) përmend vetëm se pala duhet të paguajë një depozitë "në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e pritura të bëra nga dëshmitari" ose, ndryshe, se Sekretariati do të "parapaguajë shumat e nevojshme në lidhje me marrjen në pyetje të një dëshmitari të thirrur". Rregulla 50 duket të jetë më e

[435] Shih komentet e ngjashme për Rregullin 48.2 që kanë të bëjnë me dëshmitarët të papërshtatshëm.

saktë, pasi ajo përcakton se "dëshmitari ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme të udhëtimit" dhe "kompensim për humbjen e të ardhurave".
Për më tepër, Rregulla 50 gjithashtu parasheh shumë qartë se Sekretariati mund të paguajë paradhënie për këto shpenzime të udhëtimit dhe do të paguajë kompensim, pas përfundimit të obligimeve. Rregulla, megjithatë, nuk përmend asgjë në lidhje me ndonjë pagesë nga ana e palës, që ka kërkuar ekzaminimin e dëshmitarit. Megjithatë, duke lexuar në lidhje me Rregullën 46 (4), mund të vihet në përfundim se pala ndoshta do të duhet të paguajë "shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit", dhe se Sekretariati jo vetëm që mund të parapaguajë këto "shpenzime të arsyeshme të udhëtimit", por edhe "shumat e nevojshme në lidhje me marrjen në pyetje të një dëshmitari të ftuar" (ndoshta duke përfshirë kompensimin). Megjithatë, për të përfunduar se këto shuma, pasi janë parapaguar nga Sekretariati për dëshmitarin, duhet më pas t'i kthehen Sekretariatit nga pala kërkuese, nuk duket të jetë e mbështetur nga teksti. Por, në të njëjtën kohë, do të ishte e vështirë të besohet se të gjitha shpenzimet e dëshmitarit do të duhet të përballohen nga Gjykata.
E njëjta gjë është e vërtetë për shumat për të cilat eksperti ka të drejtë. Rregulla 48 (4) parashikon se "Gjykata mund të kërkojë nga pala që kërkon ekspertin që t'i paguajë një depozitë Sekretariatit në shumën që do jetë e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me raportin e ekspertit". Kjo mund të thotë vetëm se pala përkatëse ndoshta do të duhej të paguajë "shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit" por edhe shpenzimet e arsyeshme për shërbimet e ekspertëve, siç është përmendur në Rregullën 50. Megjithatë, Rregulla 50 përcakton qartë se, edhe pse "shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit" mund të parapaguhen ekspertit nga ana e Sekretariatit, tarifat e arsyeshme për shërbimet e ekspertëve "duhet" të paguhen nga Sekretariati. Prandaj, duket se ka një kontradiktë të caktuar në mes të dy rregullave, pasi ato nuk janë aspak të qarta, nëse, në fund, Sekretariati ose pala kërkuese do të mbulojë shpenzimet e ekspertit.
Pasi që Rregullës e mësipërme nuk duket se përputhen, njëra mund të shfaqet përsëri, duke aplikuar nenin 16 të Ligjit ndaj nenit përkatës të Ligjit të procedurës kontestimore. Sipas nenit 451 (1) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, "Shpenzimet e dëshmitarit, ekspertit, dhe mbledhjes së provave parapaguhen nga pala që i ka kërkuar...". dhe që, në bazë të nenit 452 (1), "Pala që humb në procedurat gjyqësore duhet të paguajë të tëra shpenzimet e palës fituese, si dhe shpenzimet e ndërmjetësve, në qoftë se ai/ajo i është bashkuar procedurës". Pra, kur ka parashtruar në procedurën para Gjykatës, pala e paditur, në qoftë se e humb rastin, do të duhet të paguajë të gjitha shpenzimet e parashtruesit. Por në qoftë se Gjykata nuk do të gjente një shkelje të Kushtetutës, parashtruesi, në parim, do të duhet të mbajë shpenzimet e veta dhe ato të palës kundërshtare, në zbatim të nenit 452 të Ligjit mbi procedurën kontestimore. Megjithatë, ngjashëm me nenet 468[436]dhe 471[437]të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë nga gjykata që të lirohet nga pagesa e të gjitha shpenzimeve, për shkak

[436] Neni 468 [Përjashtimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore], paragrafi 1, i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore parasheh: "*Gjykata liron një palë nga pagesa e shpenzimeve, nëse përcaktohet se kjo është përtej aftësive financiare të palëve, dhe kur një gjë e tillë do të ndikojë në familjen e tyre* ".
[437] Neni 471 parasheh: "*Në qoftë se pala është liruar nga të gjitha shpenzimet, atëherë gjykata do të paguajë për shpenzimet e dëshmitarëve, ekspertëve, këqyrjes direkte, publikimit të shpalljeve gjyqësore, si dhe për shpenzimet e përfaqësuesit të caktuar*".

të mungesës së fondeve të nevojshme, në bazë të nenit 28 [Shpenzimet procedurale] të Ligjit.
Në këto rrethana, konfuzioni që aktualisht ekziston midis Rregullave të ndryshme duhet të eliminohet duke i ndryshuar në mënyrën e duhur, duke mos lënë vend për ndonjë mospërputhje. Në këtë rast, dispozitat e Udhëzimit të Praktikës, të lëshuar nga Kryetari i GJEDNJ, mbi Përmbushjen e Kënaqshme të Kërkesave, Kapitulli 4, Kostot dhe shpenzimet, do të mund të shërbente si udhëzues.

Rregulli 51 [Dokumentet] i Rregullores së Punës

1. **Një dokument për një rast është i pranueshëm nëse ai është autentik dhe i rëndësishëm për kërkesat e bëra në atë rast. Vlera dëshmuese e një dokumenti të pranueshëm do të përcaktohet nga Gjykata gjatë vlerësimit të të gjitha dëshmive të rastit.**
2. **Pala mund të ofrojë dëshmi, duke paraqitur dokumente që janë në posedim të palës. Nëse pala që bart barrën e të provuarit të ndonjë fakti posedon një dokument, i cili përmban dëshmi për atë fakt, pala duhet ta paraqesë atë dokument si shtojcë të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë që në seancë të paraqitet dokumenti origjinal.**
3. **Nëse dëshmia për një fakt gjendet në një dokument, të cilin nuk e posedon pala që e ka barrën për të ofruar dëshmi, ajo palë mund të bëjë kërkesë me shkrim që pala tjetër në atë rast të sjellë një kopje të vërtetuar të dokumentit, nëse pala kërkuese ka arsye të besojë se pala tjetër e posedon atë dokument. Një kopje e asaj kërkese paraqitet në Gjykatë.**
4. **Nëse pala, që e ka pranuar kërkesën sipas paragrafit (3), refuzon ta paraqesë dokumentin ose nuk i përgjigjet kërkesës brenda një kohe të arsyeshme, pala që e kërkon atë mund të kërkojë nga Gjykata të urdhërojë palën tjetër ta paraqesë atë dokument. Gjykata e urdhëron palën tjetër ta paraqesë dokumentin, nëse ajo mendon se dokumenti është në posedim të palës dhe nëse paraqitja e tij është në interes të drejtësisë. Nëse pala e urdhëruar nga Gjykata që ta paraqesë dokumentin nuk e bën këtë gjë pa ndonjë arsyetim të pranueshëm, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro, ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër. Po ashtu, Gjykata mund ta heqë një pjesë, tërë kërkesën, ose përgjigjen, nëse konsideron se një gjë e tillë është e duhur për shkak të rrethanave.**
5. **Nëse pala, që bart barrën e të provuarit të një fakti, ka arsye të besojë se ky fakt gjendet në një dokument që është në posedim të një personi që nuk është palë në procedurë, atëherë ajo palë mund të bëjë kërkesë që Gjykata të urdhërojë atë person që nuk është palë në procedurë ta paraqesë atë dokument. Gjykata do ta urdhërojë atë person ta paraqesë dokumentin, nëse ajo mendon se dokumenti është në posedim të atij personi dhe nëse paraqitja e tij është në interes të drejtësisë. Nëse personi i urdhëruar nga Gjykata që ta paraqesë dokumentin nuk e bën këtë gjë pa ndonjë arsyetim të pranueshëm, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro, ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër.**

Dispozitat e Rregullës 51 supozohen të jenë njëlloj të vlefshme për "sende të tjera fizike që përmbajnë informacion të rëndësishëm për kërkesën", të përmendura në Rregullën 45 (1) (c) dhe (d) së bashku me "dokumentet" (shih komentet mbi Rregullën 45 [Paraqitja e provave nga palët] më lart). Për më tepër, dispozitat e Rregullës nuk janë shumë të ndryshme nga Rregullës e ngjashme ekzistuese në procedurat civile, si, për shembull, ato në lidhje me vërtetësinë dhe vlerën provuese të dokumenteve, të përcaktuara në nenet 329-338 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore[438].

I. Rregulla 51 (1) e bën një dallim të qartë në mes të pranueshmërisë së një dokumenti dhe vlerës së tij provuese që do të vlerësohet nga Gjykata, gjatë vlerësimit të të gjitha provave të paraqitura nga palët në procedurë. Në fund, shumë dokumente të pranueshme mund të gjenden nga Gjykata që nuk kanë asnjë vlerë provuese.

II. Është një reagim normal i njeriut për palët për të bashkëngjitur sa më shumë dokumente (të rëndësishme dhe shpesh të parëndësishme) të jetë e mundur me shpresën se gjasat e tyre se gjykata do të gjejë se ka një shkelje të ankesës së tyre kushtetuese, do të rriten. Palët mund të dorëzojnë kopje të vërtetuara të dokumenteve që përmbajnë dëshmi në lidhje me një fakt të caktuar, por gjykata ende mund të ketë dyshime në lidhje me vërtetësinë e tyre dhe të urdhërojë dorëzimin e origjinaleve në mënyrë që vet të jetë në gjendje të kontrollojë nëse dokumentet relevante janë autentike apo jo. Nëse origjinali nuk është një mashtrim apo ndryshe i pavlefshëm, gjykata do të mund t'i kthejë origjinalet palës dhe të vazhdojë të përdor kopje në procedurë.

III. Sipas Rregullës 51 (3), pala kërkuese duhet vetëm që të ketë "arsye për të besuar", dhe jo "prova të mjaftueshme", se pala e kërkuar është në posedim të dokumentit përkatës. Kjo do të thotë se pala kërkuese mund të rrezikojë që ta ketë gabim në atë besim, thjesht sepse pala e kërkuar nuk e posedon atë dokument. Nga ana tjetër, në qoftë se pala e kërkuar është me të vërtetë në posedim të dokumentit, mund të mos e konsiderojnë që është në interesin e saj për të prodhuar një kopje të vërtetuar të dokumentit të kërkuar, pasi që kjo mund të dobësojë pozitën e saj në procedimet para Gjykatës. Pra, pala e kërkuar mund të dështojë për t'u përgjigjur ose mohojë që ajo posedon dokumentin e kërkuar. Në këtë rast, pala kërkuese mund të arsyetohet me Rregullën 51(4).

IV. Rregulla 51 (4) nuk e specifikon se çfarë nënkuptohet kur pala e kërkuar ka dështuar të përgjigjet brenda një "*kohe të arsyeshme*". Çfarë për palën kërkuese mund të jetë një kohë e paarsyeshme, mund ende të jetë e arsyeshme për palën e kërkuar, në veçanti në qoftë se dokumenti në fjalë së pari duhet të gjindet (në arkiva apo diku tjetër, madje edhe jashtë vendit), që mund të marrë një periudhë të konsiderueshme kohore. Çfarëdo të jenë pikëpamjet e palëve në lidhje me "kohën e arsyeshme", në fund është pala kërkuese e cila vendos, kur durimi i saj ka ardhur në fund dhe të kërkojë një Urdhër të Gjykatës [439]të adresuar palës tjetër për të

[438] Shih, faqet 100-102 të Ligjit Nr. 03 / L-006 për procedurën kontestimore.
[439] Urdhrat e gjykatës janë urdhra të miratuara nga Gjykata e plotë dhe të nënshkruara nga Kryetari.

prodhuar dokumentin (Shënim ndryshe nga Rregulla 51 (3), paragrafi 4 vetëm flet për dokumentin, jo për kopjen e vërtetuar të dokumentit).

Sipas Rregullës, Gjykata në këtë rast nuk shqyrton së pari nëse pala kërkuese me të vërtetë e ka respektuar afatin kohor të arsyeshëm para paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës, por do të urdhërojë, "*sa më shpejt që është e bindur se dokumenti është në posedim të palës së kërkuar dhe dokumenti është i domosdoshëm në interes të drejtësisë"*, palën e kërkuar për të prodhuar dokumentin. Megjithatë, Rregulla është i heshtur në lidhje me çështjen në cilën mënyrë Gjykata do të jetë e kënaqur se dokumenti është me palën e kërkuar dhe të konsiderojë se kjo e fundit ka dështuar për të prodhuar dokumentin "*pa shkaqe të arsyeshme*". Dhënia e një dënimi financiar ose tjetër sanksioni[440] me siguri do të kërkojë prova të mjaftueshme, duke dëshmuar përtej dyshimit se pala e kërkuar është me të vërtetë në posedim të dokumentit përkatës.

Siç u komentua në Rregullën 46 [Thirrjet e dëshmitarëve] dhe 48 [Raporti i Ekspertit], gjoba mund të konsiderohet si një sanksion i shqiptuar nga Gjykata për "mospërfillje të gjykatës" dhe duhet të rregullohet me ligj.

Në vend të shqiptimit të një dënimi ose sanksioni tjetër (ose, me sa duket, në rast se pala e kërkuar me të vërtetë e paguan gjobën, por ende nuk e paraqet dokumentin), Gjykata mund të vendosë të heqë të tërën ose një pjesë të Kërkesës ose Përgjigjes siç ajo e konsideron të përshtatshme për rrethanat. Kështu, Gjykata ka tre opsione: (1) të heqë Kërkesën nga lista e çështjeve ("*të heqë tërë Kërkesën*"); (2) të vendosë për Kërkesën vetëm në bazë të parashtresave të aplikuesit ("*të heqë tërë Përgjigjen*"); dhe, (3) të vendosë për Kërkesën në bazë të dokumenteve përkatëse të pranishme në shkresat e lëndës, duke lënë mënjanë parashtresat të cilat duhej të kompletohen nga dokumenti (dokumentet) që mungojnë ("*të heqë një pjesë të Kërkesës ose Përgjigjes*").

V. Në bazë të Rregullës 51 (5), Gjykata mund të urdhërojë një person i cili nuk është palë në procedurë për të prodhuar një dokument i cili është i nevojshëm për një palë e cila mban barrën e dëshmimit për një fakt të caktuar, në qoftë se gjykata konstaton se dokumenti është në posedim të personit dhe është i domosdoshëm në interes të drejtësisë. Sipas Rregullës, duket se është e mjaftueshme që pala kërkuese ka vetëm arsye për të besuar se personi posedon dokumentin. Pra, provë më e fuqishme nuk duket të jetë e nevojshme. Nëse besimi i palës është i mjaftueshëm për Gjykatën që të jetë e kënaqur se dokumenti është në posedim të personit nuk është shumë bindës, edhe pse fjala e fundit është, natyrisht, e Gjykatës. Në çdo rast, Gjykata duhet vetëm të shqiptojë një dënim financiar apo ndonjë sanksion tjetër, nëse disponon me prova të mjaftueshme që tregojnë se personi me të vërtetë posedon dokumentin përkatës, por thjesht nuk ka dëshirë për ta paraqitur atë. Sa i përket shqiptimit të dënimit, komentet në Rregullës 46, 48 dhe 51 (4), janë njëlloj të vlefshme edhe këtu.

Neni 25 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë përmban një Rregull më të përgjithshme për paraqitjen e dokumenteve dhe informacionit, duke siguruar se:

[440] Nëse Gjykata ka autoritetin të vendosë gjoba në bazë të një rregulle në vend të një akti normativ të Kuvendit, përveç nëse nuk bazon këtë autoritet në dispozitat përkatëse të ligjeve të tjera procedurale, si të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, tashmë është diskutuar më lartë, nën Rregullës 46 dhe 48.

"(1) *Çdo njeri duhet të paraqesë në Gjykatën Kushtetuese, me kërkesën e saj, dokumentet dhe informacionet e nevojshme për zhvillimin e procedurës; (2) Përjashtimisht, në rastet kur kërkesat e përsëritura të Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 1 të këtij neni nuk janë përmbushur, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që dokumentet do të konfiskohen*".

Rregulli 52 [Inspektimi i vendit të ngjarjes ose i objektit] i Rregullores së Punës

1. **Një vizitë e një faqe interneti ose një inspektimi i një objekti mund të kërkohet nga çdo parti kur fakti që duhet vërtetuar nuk mund të vërtetohet me anë ekzaminimit të dëshmitarëve, raportet e ekspertëve ose paraqitjen e dokumenteve.**
2. **Provat siguruar nga një vizitë në terren apo një inspektimi të objektit mund të ofrohen nga pala që e bart barrën e dëshmimit për një fakt që mund të vërtetohet nga një vizitë në këtë faqe interneti ose një inspektimi të objektit.**
3. **Në qoftë se vendi ose objekti është në posedim të një personi jo një palë në procedurë, pala duke mbajtur barrën e provës mund të kërkojë nga gjykata për një urdhër duke kërkuar nga personi për të dhënë qasje në këtë faqe interneti ose të objektit të ekzaminohen. Gjykata merr Urdhrin nëse vizita Vendi apo inspektimi objekti është i domosdoshëm në interes të drejtësisë. Nëse personi i drejtuar nga Gjykata në përputhje dështon pa shkaqe të arsyeshme për të lejuar qasje në këtë faqe interneti ose të dokumentit, gjykata mund të shqiptojë një dënim financiar nuk tejkalon pesëqind (500) Euro ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër.**

I. Supozohet se pala kërkuese e paraqet kërkesën në Gjykatë dhe paraqet arsyet bindëse se një vizitë ose inspektim i tillë është e vetmja mënyrë për të provuar faktin relevant. Nëse jo, kërkesa rrezikon për t'u hedhur poshtë nga Gjykata. Nëse aprovohet, Gjykata së pari do të duhej të vendosë nëse duhet të delegojë detyrën një eksperti ose një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës, në pajtim me Rregullën 45 (2), që do të duhet të raportojnë përsëri Gjykatës së plotë. Sigurisht që vizita ose inspektimi duhet të bëhet në prani të palës tjetër dhe/ose përfaqësuesit në mënyrë që të respektohet parimi i "barazisë së armëve". Rregulla është e heshtur në lidhje me çështjen nëse Gjykata mundet apo jo të vendosë për të vizituar një vend ose të inspektojë një objekt sipas parashtresës (*ex officio*). Me sa duket, procesverbali i vizitës ose inspektimit të objektit duhet të mbahet nga një këshilltar juridik ose një anëtar i stafit të Sekretariatit.

II. Rregulla 52 (2) nuk duket të jetë mjaft e qartë. Sipas paragrafit të mëparshëm, një vizitë e një vendi të ngjarjes ose inspektimi i një objekti mund të kërkohet nga çdo palë kur fakti që duhet vërtetuar nuk mund të vërtetohet me mjete të tjera. Prandaj, nuk është e qartë se pse e njëjta palë mund tani të "ofrojë" Gjykatës të njëjtën provë të cilën Gjykata e ka mbledhur vetë gjatë vizitë ose inspektimit. Kjo rregull ndoshta nënkupton se pala që mban barrën e dëshmimit për një fakt të veçantë i ofron provën Gjykatës, të cilën Gjykata përndryshe do ta kishte siguruar nga shikimi në vendin e ngjarjes ose një inspektim i objektit.

III. Qëllimi i Rregullës 52 (3) duket të jetë që pala e cila mban barrën e provës do të kërkojë ndihmën e Gjykatës për të siguruar qasje në vendin ose objektin përkatës, pasi që ai/ajo ka frikë që do t'i refuzohet (ose në të vërtetë tashmë është refuzuar) qasje nga një person i cili është në posedim të atij vendi apo objekti, por i cili nuk është palë në procedurë. Megjithatë, siç parashikohet nga Rregulla, para dhënies së Urdhrit, Gjykata se pari do të vlerësojë nëse vizita në vend të ngjarjes apo inspektimi i objektit domosdoshëm është në interes të drejtësisë. Nëse Urdhri aprovohet, por personi në fjalë pa ndonjë shkak të arsyeshëm dështon për të lejuar qasje, duke injoruar Urdhrin (që cilësohet si "shpërfillje e Gjykatës"), Gjykata mund të shqiptojë një dënim financiar jo më të lartë se 500 Euro ose masë tjetër (ajo që nënkuptohet me "masë tjetër", e përmendur nga Rregulla, është e paqartë, por mund të thotë: sigurimi i qasjes në këtë vendngjarje ose objekt me forcë, edhe pse mund të jetë e diskutueshme nëse Gjykata ka kompetenca të tilla).
Sa i përket shqiptimit të dënimit financiar nga Gjykata sipas kësaj Rregulle për personin, i cili nuk është i gatshëm për të lejuar qasje në vendngjarje ose objekt në posedim të tij/saj (Rregulla gabimisht përmend "dokument" në vend të "objektit"), referencë është bërë për komentet në Rregullës 46, 48, 51 (4) dhe 51 (5), të cilat janë njëlloj të vlefshme këtu.

Rregulli 53 [Amicus Curiae] i Rregullores së Punës

> **Gjykata, nëse e konsideron të nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin, mund të thërrasë ose t'i sigurojë pushim një organizate ose një personi për t'u paraqitur para saj dhe për të dhënë deklaratë me gojë ose me shkrim për ndonjë çështje të specifikuar nga Gjykata[441].**

Arsyeja për të ftuar një organizatë (si grupet sociale, shoqatat e minoriteteve, shoqatat profesionale, sindikatat, institucionet e specializuara dhe grupet tjera të interesit) ose person si amicus curiae në procedurën para Gjykatës, është se amicus mund të zotërojnë njohuri të specializuara për çështjet specifike të cilat mund të ndihmojnë Gjykatën në një kuptim më të mirë të gjitha ose një pjesë të tipareve të rastit në fjalë. Gjithashtu eksperti, i emëruar nga Gjykata sipas Rregullës 49[442], ndihmon Gjykatën, por është i emëruar vetëm me kërkesë të një pale dhe fushëveprimi i punës së tij/saj është përcaktuar në mënyrë rigoroze nga Gjykata.
Për më tepër, organizatat dhe institucionet, të përmendura më lart, munden, sipas gjykimit të tyre, të kërkojnë nga Gjykata që t'u jepet leje për të paraqitur komente me shkrim ose të marrin pjesë në një seancë për të njëjtat ose arsye të tjera, si kur Gjykata mund t'i ketë ftuar ato. Kur Gjykata fton një shoqatë ose institucion profesional të caktuar si amicus curiae në procedurë, mund të bëjë këtë me qëllim të krijimit të një

[441] Shih për detaje në lidhje me përkufizimin, origjinën dhe rolin e një amicus curiae: Laura van den Eynde,"An Empirical Look at the Amicus Curiae Practice of Human Rights NGO's before the European Court of Human Rights,", Dissertation at Stanford Law School, www.globalgovernancewatch.org/docLib/20140115_on_Amicus_Curiae_Practice_of_NGOs_at_ECHR.pdf Netherlands Quarterly of Human Rights, Vol.31/3, 271-313, 2013.
[442] Shiko më sipër komentet për Rregullin 49.

komunikimi të caktuar me njerëzit, zëri i të cilëve do të mund të dëgjohet nëpërmjet amicus curiae në fjalë. Në varësi të kërkesës, Gjykata mund ta shoh këtë si pjesë e implementimit të përpjekjeve të saja për komunikim më të mirë në terren[443], me qëllim për të vënë në dijeni publikun për objektivat dhe kompetencat e Gjykatës. Pasi që janë ftuar, amicus curiae mund të ndërhyjnë në mënyrën se si e sheh të arsyeshme për ndonjë çështje të caktuar nga Gjykata dhe mund edhe të tentojë të ndikojë në opinionin e Gjykatës të mbajtur në rastet e mëparshme.

Rregulla 44 [Ndërhyrja e palëve të treta] i Rregullores së Punës së GJEDNJ përmban një Rregull të ngjashëm[444], duke siguruar: [...] *Kryetari i Dhomës mundet, në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, siç parashikohet në nenin 36.2 të Konventës, të ftoj, ose të lejojë [...] çdo person të interesuar që nuk është kërkuesi, të paraqesë komente ose, në raste të veçanta, të marrë pjesë në një seancë dëgjimore"*[445]Kështu, ftesa ose pranimi për të siguruar informacion nga një palë e tretë është në diskrecionin e Kryetarit të Gjykatës.

Në kontekstin e Kosovës, një shembull i mirë i një institucioni, kompetent për të marrë rolin e amicus curiae, është institucioni i Avokatit të Popullit, i cili, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, "*monitoron dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të autoriteteve publike*"[446]. Avokati i Popullit me siguri ka ekspertizë në çështje specifike të drejtave të njeriut, të cilat mund të jenë relevante për një kërkesë, në të cilën ai/ajo dëshiron të ndërhyjë. Ndërhyrjet e tilla me siguri do të rrisin rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe mund të shihen nga publiku si një mbështetje e fortë e punës së Gjykatës. Do të jetë interesante për të parë, kur ftohet nga Gjykata si amicus curiae, çfarë ndikimi mund të ketë Avokati i Popullit në gjykimin e çështjes.

Rregulla 53 nuk përmend mundësinë që njëra nga palët mund të kërkojë nga Gjykata që të ftojë apo të japë leje për një amicus curiae për t'u paraqitur para Gjykatës, por, në praktikë, kjo nuk mund të përjashtohet, nëse kërkesa e palës për Gjykatën përmban arsye të mjaftueshme që tregojnë ekspertizën e amicus në rastin në fjalë dhe mënyrën në të cilën amicus mund të kontribuojë për një kuptim më të mirë të specifikave të rastit. Deri tani, Gjykata i ka dhënë një organizatë ose personi leje që të ndërhyjë në procedurat si amicus curiae, për shembull, në rastin KO 97/12, *Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit*, Aktgjykimi i datës 12 prill 2013[447], ku Gjykata, në bazë të Rregullës 53, e dërgoi një ftesë për Pallaska & Associates LLC, të paraqesë një parashtresë me shkrim si Amicus Curiae për Gjykatën e cila përmban qëndrimin juridik ndaj Ligjit për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare, Nr. 04/L-093.

Shembuj të dispozitave të ngjashme për çështjen e amicus curiae mund të gjenden në, për shembull, Ligjin Federal mbi Gjykatën Kushtetuese Gjermane, ku në nenin 27A të saj, parashihet: "*Gjykata Federale Kushtetuese mund të ftojë palët e treta të ekspertëve*

[443] Shih Planin Strategjik të gjykatave 2000 – 2013.

[444] Shih World Organisation against Torture (OMCT), Neni 3 ECHR, A Practitioners Handbook, Pjesa I, Overview of the Council of Europe, the Court, andits Proceedings, Kapitulli 1.12 [ThirdPartyInterventions (AmicusCuriae), faqe 67; www.omct.org/files/2006/11/3633/handbook1_eng_01_part1.pdf

[445] Rregullorja e GJEDNJ, Korrik 2009, Regjistri i Gjykatës, Strasburg.

[446] Shih, Nenet 132 deri 135 të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës.

[447] Shih, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2013; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

për të dhënë një opinion". Gjithashtu Neni 47 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili parasheh se: "*pjesëmarrësit në procedurë do të ftohen në dëgjimin publik. Nëse është e nevojshme, Gjykata do të ftojë në dëgjimin publik personat që mund të paraqesin opinionet dhe deklaratat të ekspertëve të cilat janë relevante për miratimin e vendimit"*, mund të interpretohet si mundësi e Gjykatës Kushtetuese për të ftuar në dëgjim publik - përveç ekspertëve – po ashtu edhe amicus curiae. Megjithatë, palët e treta që do të dëshironin leje për të paraqitur informacion ose deklarata në seancë nuk janë përmendur. E njëjta është e vërtetë për nenin 51 [Thirrja e seancave publike], paragrafi 4, të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, i cili parasheh: "*Përveç pjesëmarrësve në procedurë, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të thërrasë persona tjerë për të marrë pjesë në dëgjime publike, nëse ata mund të kontribuojnë në zgjidhjen e një çështjeje e cila është objekt i procedurës. Në rast të tillë, gjyqtari raportues po ashtu vendos se cilat pjesë të shkresave të lëndës duhet t'i dërgohen këtyre personave me thirrjen".* Shprehja "*personat tjerë*" duket se përfshin si ekspertët ashtu dhe amicus curiae.

Megjithatë, siç u përmend më lart, edhe në qoftë se Rregulla nuk parashikon mundësinë që një palë e tretë të paraqesë një kërkesë në Gjykatë për t'i dhënë leje për të marrë pjesë në seancë, Gjykata mund të bëjë këtë, nëse konsideron se është në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë në rastin para saj.

Rregulla 53, megjithatë, është i heshtur për këtë çështje, nëse një kërkesë për leje nga një palë e tretë duhet të jetë në përputhje me çdo kërkesë specifike. Në këtë situatë, mund të bazohemi në Rregullën 44.2 (b) të Rregullores së GJEDNJ, ku theksohet: "*Kërkesat për leje [...] duhet të jenë të arsyetuara si duhet [...]"*[448].

Neni 26 [Bashkëpunimi me organet tjera publike]

> **Të gjitha gjykatat dhe organet publike të Republikës së Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj.**

Përveç referencës së panevojshme ndaj gjykatave të cilat janë edhe autoritete publike, titulli i nenit nuk pasqyron si duhet përmbajtjen e nenit dhe do të duhej më mirë të jetë: "Bashkëpunimi me Gjykatën Kushtetuese".

Mbështetja e punës së Gjykatës dhe bashkëpunimi me Gjykatën kanë shumë karakteristika dhe jo gjithmonë kanë të bëjnë me kompetencat vendimmarrëse të Gjykatës sipas nenit 116 të Kushtetutës, për shembull, ndarja për Gjykatën e mjeteve të nevojshme financiare nga Kuvendi, në bazë të një propozimi buxhetor të vendosur nga Gjykata, siç është parashikuar në nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës[449] dhe të neneve 2 [Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese] (1) dhe 14 [Buxheti] të Ligjit (shih komentet për nenet 2 dhe 14 më lart). Me anë të këtyre dispozitave, Gjykata gëzon pavarësi organizative, administrative dhe financiare dhe financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, të miratuar nga Kuvendi. Kjo gjithashtu do të thotë se

[448] Rregullorja e GJEDNJ, Korrik 2009, Regjistri i Gjykatës, Strasburg.

[449] Neni 112 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 2, "Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj".

autoritetet kompetente janë të obliguara për të vënë në dispozicion të Gjykatës hapësirat dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme, nëse nuk mbulohen nga buxheti i Gjykatës.

Një shembull tjetër i detyrimit të autoriteteve publike për të mbështetur punën e Gjykatës dhe për të bashkëpunuar plotësisht me Gjykatën sipas kërkesës së saj, është përcaktuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës, që autorizon Gjykatën për vendosur masa të përkohshme. Neni 116 zbatohet nga Neni 27 [Masat e përkohshme] te Ligjit, si dhe me Rregullën 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] dhe 55 [Vendimi për masa të përkohshme]) të Kapitullit VI [Masat e përkohshme] dhe Rregulla 64 [Masat e përkohshme] të Kapitullit VIII [Dispozitat e veçanta për procedurat, të caktuara në nenin 113 të Kushtetutës] të Rregullores së Punës. Këto dispozita në mënyrë të qartë nënkuptojnë se bashkëpunimi i institucioneve me Gjykatën është i detyrueshëm (shih komentet mbi këto dispozita më poshtë) dhe i nevojshëm për zbatimin e urdhrit të Gjykatës për masa të përkohshme.

Detyrimi i të gjitha organeve shtetërore të respektojnë Kushtetutën dhe rendin kushtetues është forcuar në një shtet demokratik nën sundimin e të së drejtës nga ajo që është e njohur si besnikëri institucionale midis organeve kushtetuese. Gjykata Federale Kushtetuese përcakton besnikërinë e tillë duke deklaruar se organet supreme kushtetuese janë të obliguara me Kushtetutë për të ushtruar konsideratë të ndërsjellë[450]. Nga kjo rrjedh që tashmë për shkak të besnikërisë institucionale midis organeve kushtetuese, çdo organ më i lartë shtetëror (dhe në përputhje me rrethanat, të gjitha institucionet shtetërore që janë pasuese në gradë) duhet të jenë në pajtueshmëri me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Kjo nuk është një veçori e lidhjes së organeve të larta shtetërore me Gjykatën Kushtetuese, por diçka që shkon pa thënë në një shtet demokratik nën sundimin e të së drejtës[451].

Nuk mund të ketë dyshim se zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga të gjitha gjykatat dhe autoritetet publike duhet të konsiderohet të jetë brenda fushëveprimit të nenit 26, në veçanti, kur siç thuhet shprehimisht në vendimet e Gjykatës, bashkëpunimi i tyre i plotë në zbatimin e vendimit të Gjykatës kërkohet në mënyrë shprehimore. Nuk është e qartë për çfarë arsye legjislatura nuk merret me këtë çështje në bazë të nenit 20 [Vendimet] të Ligjit, pasi që ky nen rregullon përmbajtjen, publicitetin dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të Gjykatës, por nuk merret me efektin detyrues të vendimeve të Gjykatës, siç parashihet në nenin 116 [Efekti juridik i Vendimeve] të Kushtetutës: "1. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*". Asnjë nen tjetër i ligjit nuk ka të bëjë me efektin detyrues të vendimeve të Gjykatës.

Por edhe në mungesë të zbatimit të legjislacionit detyrues në fuqi dhe zbatimit efikas të vendimeve të Gjykatës, të gjitha institucionet dhe autoritetet janë të detyruara t'i zbatojnë ato në bazë të nenit 116.1 të Kushtetutës. Për më tepër, në një shtet të vërtetë demokratik, ku ekziston besimi në mes të autoriteteve, vendimet e Gjykatës

[450] BVerfGG 35, 193(199).

[451] Shih Report "Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Lawon the Basis of the Constitutional Law, Situation in the Federal Republic of Germany" by Mr. Siegfried Bross, Judge of the German Constitutional Court, at the Conference on "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice", Baku, Azerbaijan, 14-15 Korrik 2008.

Kushtetuese do të respektohen, jo vetëm për interpretimin e tyre, por edhe duke i zbatuar në mënyrë efikase dhe pa vonesë. Zbatimi i vendimeve varet në një masë të madhe nga imazhi i Gjykatës në shoqëri, autoriteti dhe respekti i saj i demonstruar nga institucionet dhe organet e tjera. Sa më shumë që shoqëria ka njohuri në lidhje me Gjykatën, aq më shumë do të ndjek vendimet e Gjykatës dhe nuk do të tolerojë mosveprimin e ekzekutivit në zbatimin e vendimeve të tilla[452].
Në fakt, jo ligji, por Rregullorja e Punës merret me zbatimin e vendimeve të Gjykatës, për shembull, Rregulla 57 [Përmbajtja e vendimeve], paragrafi 5, si dhe Rregulla 63 [Zbatimi i vendimeve], 65 [Aktgjykimi], 66 [Efektet juridike të Aktgjykimit], 70 [Aktgjykimi], 74 [Aktgjykimi] dhe 77 [Aktgjykimi] i Kapitullit VIII. [Dispozitat e veçanta për procedurat e përcaktuara në nenin 113 të Kushtetutës]. Këto Rregulla do të komentohen në vazhdim.

Rregulli 57 [Përmbajtja e vendimeve], paragrafi 5, i Rregullores së Punës

> **Dispozitat operative [të vendimit] do të theksojnë mënyrën e zbatimit të aktgjykimit, të vendimit ose të urdhrit tjetër, datën e hyrjes në fuqi të vendimit dhe palën të cilës i dorëzohet vendimi.**

Gjatë miratimit të Rregullës 57 (5), Gjykata mund të ketë pasur për qëllim që të përcaktojë se dispozitat operative të vendimeve të saj duhet të përcaktojë qartë mënyrën e zbatimit dhe datën e hyrjes në fuqi të tyre, si dhe palët të cilave vendimi duhet t'i dorëzohet. Por Rregulla 57 (5) nuk e përcakton qartë se Gjykata gjithashtu ka nevojë për të treguar autoritetin i cili duhet të zbatojë vendimin. Është e vërtetë që, normalisht, autoritetet të cilave vendimi u dorëzohet janë edhe autoritetet zbatuese, por, për të shmangur çdo keqkuptim ose konfuzion për këtë qëllim, mund të pritej se Rregulla gjithashtu do të kishte udhëzuar Gjykatën që shprehimisht të përmend autoritetet përgjegjëse për përmbarimin e aktgjykimit.
Sa i përket mënyrës në të cilën vendimet e gjykatës duhet të zbatohen, Rregulla 57 (5) është i qartë: "*Dispozitat operative do të theksojnë mënyrën e zbatimit të aktgjykimit, të vendimit ose të urdhrit tjetër* [...]". Kështu, sipas Rregullës, mënyra e zbatimit duhet ("duhet") të theksohet, edhe pse i përket Gjykatës për të vendosur se si do të donte ta bënte këtë të saktë. Në shumicën e rasteve, dispozitat operative të vendimeve të Gjykatës janë vetë-shpjeguese, por nëse, sipas mendimit të palës që përgjigjet ose e zbaton atë mënyra në të cilën vendimi duhet të zbatohet nuk është mjaftueshëm e qartë, ajo mund të kërkojë sqarim nga Gjykata.
Deri më tani, ka pasur disa raste ku pala përgjegjëse me sa duket ka injoruar për të zbatuar vendimin dhe, në vend të kësaj, i kërkoi Gjykatës të përgjigjet në një numër të pyetjeve në lidhje me interpretimin e dispozitave operative të aktgjykimit të saj. Për shembull, në Rastin KI 08/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IMK Fabrika e çelikut në Ferizaj, Sqarimi i Aktgjykimit të datës 12 Maj 2011[453], Gjykata e dha një

[452] Shih Report "Authority of the Constitutional Court as the precondition of execution of the Decisions" by Mr. Gunars Kutris, President of the Constitutional Court of Latvia, Conference on "Execution of the Decisions of Constitutional Courts, Venice Commission, Baku, Azerbaijan, 14-15 Korrik 2008, CDL-JU(2008)028..
[453] Shih për detaje: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 214; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

sqarim të Aktgjykimit të saj më 17 Dhjetor 2010[454], në të cilën ajo kishte vendosur në pjesën operative: "*III. Mban se vendimi përfundimtar dhe detyrues i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të përmbarohet nga autoritetet kompetente, në mënyrë të veçantë, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e AKM-së"*. Një muaj më pas, Gjykata ka marrë një kërkesë për sqarim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, që përmbante dy pyetje në lidhje me vendimin e Gjykatës. Në sqarimin e saj, Gjykata ka përcaktuar limitet ligjore për vlerësimin e kërkesave të tilla, duke u shprehur se: *"Përgjigjet në pyetjet e mësipërme janë dhënë nga Gjykata duke marrë parasysh bazën ligjore të përmendur më lart, së bashku me legjitimitetin, të përkatësisë dhe rëndësisë së kërkesave dhe kufizimeve të lëndës, e cila është bazë e vendimit të marrë në rastin. Prandaj, duke pasur parasysh se Gjykata është e detyruar nga kufijtë e aktgjykimit të saj dhe nuk është e autorizuar ligjërisht për të shkuar përtej këtyre kufijve, pyetjet janë sqaruar si më poshtë në tekstin e mëtejmë"...*
Pra, nëse Gjykata, në dispozitat operative (dispozitivi), nuk e ka përmendur në mënyrë të qartë mënyrën në të cilën vendimi ka për t'u zbatuar, Sqarimi nuk mund të shkojë përtej kufijve të aktgjykimit.
Një shembull tjetër i një sqarim të aktgjykimit të Gjykatës është çështja nr. KO 29/11, Sabri Hamiti dhe deputetët tjerë, Sqarimi i aktgjykimit të datës 1 prill 2011[455], ku Gjykata i është përgjigjur tri pyetjeve të parashtruara nga ana e Kryetarit të Kuvendit, Kryetares të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë në lidhje me zbatimin e vendimit të gjykatës në rastin e datës 30 mars 2011[456].
Megjithatë, nuk është e qartë se si mund të zbatohet Aktvendimi, sepse, sipas Rregullës 56 [Llojet e vendimeve], ato vetëm kanë të bëjnë me papranueshmërinë e kërkesës. Megjithatë, në një Aktvendim mbi papranueshmërinë, Gjykata mund të përdorë mundësinë për t'i treguar palës se, pavarësisht papranueshmërisë së kërkesës, ajo do të mund të veprojë në një mënyrë të veçantë, siç ka ndodhur në Rastin nr. 14/09, trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës, Aktvendimi për papranueshmërinë i datës 15 tetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 276, ku Gjykata i përkujtoi autoritetet e Republikës së Kosovës: "për të krijuar mekanizma të pavarur për formulimin e kuadrit të politikave, legjislacionit dhe institucioneve për adresimin e çështjeve të kthimit të pronës, siç kërkohet me Aneksin VII, neni 6 (1) të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, si dhe që Kuvendi të miratojë një Ligj për Kthimin, në pajtim me nenin 143 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 (1) 3 të Shtojcës XII [Agjenda Legjislative] të Propozimit Gjithëpërfshirës për Kosovën".

Rregulli 63 [Zbatimi i vendimeve] i Rregullores së Punës

1. **Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.**
2. **Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.**

[454] Shih për detaje: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 417; dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[455] Shih për detaje: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 174; dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[456] Shih për detaje: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 128; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

3. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.
4. Gjykata Kushtetuese mund të specifikojë, me vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
5. Organi i obliguar të zbatojë vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informacionet, nëse kërkohet dhe ashtu si kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
6. Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare.
7. Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.
8. Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me Rregullën 44 e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren.

Para se të komentojmë mbi Rregullën, është e nevojshme për të thënë një fjalë në lidhje me vendndodhjen e saj në faqen 30 të Rregullores së Punës, ku në mënyrë të gabuar është pjesë e Kapitullit VIII [Dispozita të posaçme për procedurat e caktuara sipas nenit 113 të Kushtetutës]. Megjithatë, në mënyrë të qartë ky Rregull bie nën Kapitullin VII [Vendimet] dhe duhet të jetë shfaqur në faqen 30 si Rregulla 62. Rregulla 62 i tanishëm [Kërkesa për rishikim] që ka të bëjë me paraqitjen e një kërkese, sipas nenit 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës, në mënyrë të qartë i takon Kapitullit VIII të përmendur më lart, ku ajo plotëson Nenin 29 [Saktësimi i kërkesës], dhe duhet të paraqitet si Rregulla 63. Me qëllim të përmirësimit të gabimit, është sugjeruar që nenet e tanishme 62 dhe 63, duhet të ndërrohen gjatë amendamentit të ardhshëm të Rregullores së Punës. Në komentet e mëposhtme, është respektuar gjendja e tanishme.
Në lidhje me këtë dhe siç u komentua më lartë, në mënyrë të ngjashme në lidhje me rregullat tjera, është e rëndësishme të përmendet se përmbajtja e Rregullës 63 që krijon detyrime për "*gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*" më tepër i përket një akti normativ të miratuar nga Kuvendi në vend të një Rregulloreje të Gjykatës. Kjo vërejtje është po aq e vlefshme për paragrafët tjerë të Rregullës 63.

I. Teksti i Rregullës 63 (1) është identik me atë të nenit 116.1 të Kushtetutës[457]. Në mungesë të një dispozite të ngjashme në ligj, Gjykata duhet të kishte për qëllim për të riparuar këtë boshllëk duke futur një tekst identik me atë të nenit 116.1 të Kushtetutës në Rregulloren e Punës. Edhe pse as Kushtetuta dhe as Rregulla në mënyrë eksplicite nuk parashohin që vendimet e Gjykatës janë të formës së prerë, është e qartë se parimi i pothuajse të gjitha shteteve evropiane që vendimet e marra nga gjykatat e tyre kushtetuese janë përfundimtare, është po aq i vlefshëm për vendimet e Gjykatës. Si një përjashtim, për shembull, gjetjet e kundër-

[457] Neni 116.1 i Kushtetutës parasheh: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*".

kushtetutshmërisë të bëra nga Gjykata Kushtetuese e Portugalisë mund të sfidohen në kushte të caktuara[458].

Kështu, dispozita të ngjashme me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe Rregullën 63 (1) të Rregullores së Punës mund të gjenden në kushtetutat e shumicës së vendeve të tjera që kanë gjykatë kushtetuese. Nën sundimin e së drejtës në një shtet demokratik, supozimi është se të gjitha organet shtetërore veprojnë në përputhje me Kushtetutën nën përgjegjësinë e tyre dhe se, kur gjykata kushtetuese është e ftuar për të ushtruar një kontroll të fundit, në raste të jashtëzakonshme, ato janë të detyruara të ndjekin vendimet e saj.

Siç u përmend në komentet për nenin 26 [Bashkëpunimi me autoritetet e tjera publike], detyrimi i të gjitha organeve shtetërore që të zbatojnë Kushtetutën dhe rendin kushtetues është forcuar në një shtet demokratik nën sundimin e të së drejtës nga ajo që është e njohur, siç u përmend më lart, si besnikëri institucionale në mes të organeve kushtetuese që për pasojë duhet të jenë në përputhje me vendimet e gjykatës kushtetuese. Prandaj, moszbatimi i vendimeve të gjykatës kushtetuese do të ndodh vetëm në raste të veçanta, sepse çdo organ shtetëror duhet të shoh vetën si mbrojtës të Kushtetutës.

Kështu, në qoftë se gjykata kushtetuese vendos në raste të jashtëzakonshme, forca detyruese e vendimeve të saj do të jetë me rëndësi të madhe, pasi efekti i tyre nuk mundet vetëm të jetë i kufizuar për palët e përfshira në procedurë, por mund të ketë pasoja afatgjata për rendin ligjor dhe shoqërinë. Fakti që vendimet e Gjykatës Kushtetuese urdhërohen që të kenë një efekt detyrues mbi organet kushtetuese të një shteti, si dhe për gjykatat dhe autoritetet, që i jep vendimeve të tilla të njëjtën fuqi dhe efekt si një ligj i miratuar nga parlamenti, nuk do të kishte kuptim nëse Gjykata Kushtetuese do të konsiderohet si gjykatë e rregullt[459]. Përmbarimi i vendimeve gjyqësore kushtetuese mundet, pra, të mos krahasohen me atë të vendimeve të gjykatave të tilla.

Më tutje theksohet se teksti i Rregullës 63 (1) nuk përcakton ditën në të cilën forca detyruese e vendimeve të Gjykatës merr efekt. Kjo rregullohet me paragrafin 5 të nenit 20 [Vendimet] të Ligjit[460], që parasheh: "*Një vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar atë ndryshe në një vendim*". Neni 20.5 zbaton nenin 116.3 të Kushtetutës, që përcakton: "*Në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës*

[458] Kur një ligj është gjetur jo kushtetues, Presidenti i Republikës, i cili ka të drejtën e vetos së detyrueshme pezulluese, duhet ta kthejë në Kuvend. Megjithatë, vetoja e tij mund të kapërcehet, nëse Parlamenti miraton atë përsëri me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të pranishëm, ku që shumica është më e madhe se shumica absolute e anëtarëve me të drejtë vote. Në varësi të rastit, ligji mund të përfundojë sërish te Presidenti, dhe ai do të nxjerrë ligjin ose nënshkruajë traktatin ndërkombëtar - ose refuzon ta bëjë këtë (Nenet 279-2 dhe - të Kushtetutës së Portugalisë). Në këtë rast, ligji apo traktati ndërkombëtar nuk mund të miratohet dhe të zbatohet (Shih botimin e Komisionit të Venecias, III. Enforcementof the Constitutional Court decisions, Puskas Valentin Zoltan, Judgeand Benke Karoly, Assistant Magistrate in Chief, p.250), constcourt.ge/ files/ journal_2012_eng.pdf.

[459] Shih Report "Reflectionson the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic Stateunder the Rule of Lawon the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republicof Germany" by Mr. Siegfried Bross, Judge of the German Constitutional Court, at the Conference on "Execution of the Decisions of Constitutional Courts: a Cornerstone of the Process of Implementation of Constitutional Justice", Baku, Azerbaijan, 14-15 Korrik 2008.

[460] Shih, komentet e nenit 20.5 më lart.

Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës".

Kështu, në ditën në të cilën janë botuar në Gazetën Zyrtare, vendimet e gjykatës duhet të përmbarohen (përveç nëse Gjykata ka vendosur ndryshe), që do të thotë që detyrat të cilat janë të përfshira në vendimet e gjykatave duhet të zbatohen nga autoritetet zbatuese. Megjithatë, nuk ka mekanizëm ligjor në rendin juridik të Kosovës për përmbarimin aktual të vendimeve të Gjykatës. Teksti i nenit 116.1 të Kushtetutës dhe të nenit 20.5 të Ligjit sigurojnë që vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë (gjykatat, personat dhe institucionet) dhe mundet, pra, të çojnë për shembull në një ndryshim të opinionit në mes të ekspertit të së drejtës kushtetuese, gjyqtarëve të gjykatës së rregullt dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Për më tepër, mund të dalë pyetja legjitime, nëse vendimet e detyrueshme të Gjykatës janë të detyrueshme në çdo rast dhe për të gjithë (erga omnes) ose edhe në raste të tjera të krahasueshme? Apo ato janë të detyrueshme për të gjithë, por vetëm në rastin specifik të vendosur nga Gjykata, ose vetëm për palët në mosmarrëveshje?[461]

Në këtë drejtim, nenet e mësipërme 116.1 dhe 20.5 mund të interpretohen në mënyrë restriktive duke mbajtur, nga njëra anë, se vetëm vendimet e Gjykatës cilat në përgjithësi janë të detyrueshme në kuptimin e plotë janë ato të cilat anulojnë ligjet dhe aktet e tjera të përgjithshme, dhe, nga ana tjetër, që vendimet e Gjykatës që anulojnë vendimet individuale si vendimet e gjykatës duhet të respektohen vetëm nga palët e treta të interesuara sipas kushtetutës, palët dhe institucionet që ndërlidhen me rastin.

Ose, nenet e mësipërme mund të interpretohen më gjerësisht duke mbajtur që vendimet e gjykatave në përgjithësi janë të detyrueshme edhe në rastet në të cilat vendimet e gjykatave të rregullta janë të anuluara dhe që të gjithë janë të detyruar të respektojnë vendimet e Gjykatës si në rastin përkatës dhe në çdo mosmarrëveshje të krahasueshme para gjykatave të rregullta.

Një tjetër çështje interpretimi e cila shfaqet këtu ka të bëjë me atë se cila pjesë e vendimit të Gjykatës është e detyrueshme, ajo që e anulon një vendim të gjykatës së rregullt. A është vetëm pjesa operative e vendimit të Gjykatës e detyrueshme, ose edhe deklarata që përmban arsyetimin juridik është e detyrueshme? Dhe përveç kësaj, a është deklarata që përmban arsyetimin juridik e detyrueshme në çdo mosmarrëveshje të krahasueshme ligjore?

Interpretuesit restriktivë do të argumentojnë se arsyetimi juridik i gjykatës nuk është fare i detyrueshëm, dhe sigurisht jo në rastet e ardhshme, sepse Kushtetuta nuk e mbështet një interpretim të tillë. Vetëm dispozitat operative të gjykimit janë të zbatueshme dhe detyruese për palët. Megjithatë, doktrina kushtetuese zakonisht nuk gjendet në vendim, por në arsyetimin juridik, sidomos në *ratio decidendi*, të përpunuar nga Gjykata Kushtetuese. Si pasojë e kësaj, argumentet e Gjykatës janë

[461] Këto dhe sugjerimet, të cilat pasojnë, janë bazuar në Raportin e z. Vojen Guettler, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës Çeke, me titull: "Execution of Judgments of the Constitutional Court of the Czech Republic, prezantuar në Seminarin mbi "Efikasitetin e Drejtësisë Kushtetuese në Shoqëritë me Tranzicion, të mbajtur në Yerevan, Armeni, 6-7 Tetor 2000, organizuar nga Komisioni i Venedikut së bashku me Gjyaktën Kushtetuese të Armenisë (CDL-JU(2000)040).

dukshëm më të rëndësishme se vetë vendimi për të kuptuarit e përmbajtjes reale të një aktgjykimi.[462]

Nga ana tjetër, interpretuesit gjerësisht mund të konstatojnë se meqë deklarata që përmban arsyetimin juridik është pjesë e vendimit detyrues të Gjykatës, është po aq e detyrueshme.[463] Në këtë rast, arsyetimi juridik nuk është vetëm i detyrueshëm në rastin specifik të vendosur nga Gjykata, por edhe në kontestet tjera të krahasueshme ligjore. Nëse një gjykatë e rregullt nuk e respekton këtë parim, nga Gjykata mund të kërkohet të anulojë një aktgjykim të ri të gjykatës së rregullt, i cili është pothuajse identik me atë që Gjykata tashmë ka anuluar. Një situatë e tillë shkakton një humbje të energjisë dhe kohës dhe do të ketë një efekt negativ mbi qytetarët, të cilët nuk mund të kuptojnë pse gjykatat e rregullta nuk e respektojnë arsyetimin juridik të Gjykatës**.**

Për më tepër, duhet përgjigjur pyetjes nëse aktgjykimet e gjykatave të cilat shfuqizojnë aktet e përgjithshme janë të vlefshme nga dita e publikimit të këtyre vendimeve (*ex nunc*) ose në mënyrë retroaktive nga data e miratimit të akteve të tilla të përgjithshme (*ex tunc*) ose edhe në të ardhmen (*pro futuro*), nëse vendoset kështu nga Gjykata[464]. Siç mund të shihet nga vendimet e Gjykatës, ato janë kryesisht të vlefshme me efekt të menjëhershëm, që do të thotë se hyjnë në fuqi në datën e miratimit. Në këtë drejtim, i referohemi neneve 116.3 dhe (4) të Kushtetutës. Deri tani, Gjykata nuk ka dhënë fuqi prapavepruese ose të ardhshme për ndonjë prej vendimeve të saj.

Dhe, së fundmi, si mundet që gjykatat e rregullta të detyrohen për të përmbaruar vendimet e Gjykatës që anulon vendimet e tyre, në qoftë se, siç u përmend më lart, nuk ka mekanizëm ligjor në rendin juridik të Kosovës që t'i detyrojë për të bërë këtë. Dikush mund të thotë se, në qoftë se gjykatat e rregullta nuk do ta bëjnë këtë, një refuzim i tillë do të konsiderohet si një mohim i drejtësisë, që mund të çojë në procedurë disiplinore sipas Ligjit për Gjykatat dhe, ndoshta, pretendime për kompensim kundër gjyqtarëve individual nga pala- ankesa kushtetuese e së cilës është aprovuar nga Gjykata. Pala fituese mund të kthehet në Gjykatë për të kërkuar që ajo të lëshojë një deklaratë, në bazë të nenit 116.1 të Kushtetutës, se gjykata rezistuese nuk e ka përmbaruar vendimin e Gjykatës, në kundërshtim me Rregullën 63 (1) dhe (2). Megjithatë, deri më tani, gjykatat sistematikisht kanë zbatuar vendimet e Gjykatës.

Një çështje e ngjashme mund të lind, nëse gjykatat e rregullta nuk e respektojnë arsyetimin juridik të vendimeve të Gjykatës, por vetëm dispozitat operative apo e keqinterpretojnë vendimin e Gjykatës. Në raste të tilla, parashtruesi i kërkesës në fjalë duhet të jetë në gjendje të kërkojë nga Gjykata që ajo të lëshojë një sqarim të aktgjykimit të saj për gjykatën në fjalë. Për më tepër, në qoftë se gjykata e rregullt

[462] Shih Punëtoria mbi "Parimet e kontrollit kushtetues, Teknikat e Kushtetutës dhe të Interpretimit Statutore, Kiev, 5-6 Qershor 1998, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Ukrainës, ARD / Checchi dhe Komisioni i Venedikut, Techniques of constitutional interpretation by the European Constitutional Courts by Prof. Alejandro Saiz Arnaiz, University of the Basque Country (Spain), CDL-JU(98)24, www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-JU(1998) 024-e

[463] Idem.

[464] Shih, për shembull rasti nr. KI 11/09, i përmendur më lartë dhe Aktgjykimin e datës 30 Tetor 2010 në rastin nr. KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, Buletini i praktikës gjyqësore 2009-2010, fq. 344.

është e mendimit se vendimi i Gjykatës nuk është mjaft i qartë ose lë hapësirë për interpretime të ndryshme, ajo duhet të jetë në gjendje të kërkojë nga Gjykata një sqarim të tillë.

II. Rregulla 63 (2) shtjellon pasojat e efektit detyrues të vendimeve të Gjykatës të përmendura në paragrafin e mësipërm. Nocioni i "organeve kushtetuese", me siguri nënkupton që të përfshijë të gjitha organet shtetërore të përcaktuara në Kushtetutë, ndërkohë që "gjykatat dhe autoritetet", me sa duket qëndron për të gjitha gjykatat tjera dhe autoritetet publike në Kosovë.
Për shembull, për Kuvendin e Kosovës, si organ kushtetues, Rregullorja e Punës rregullon mënyrën në të cilën ai ka për të respektuar, të jetë në përputhje dhe të zbatojë vendimin e Gjykatës se një ligj, në tërësi ose në pjesë, është jo kushtetues. Për këtë qëllim, neni 35 [Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese] të Rregullores së Punës së Kuvendit parasheh se: "*1. Kryetari i Kuvendit do të informoj anëtarët e Kuvendit dhe Qeverisë për vendimin e Gjykatës Kushtetuese. 2 Kryetari i Kuvendit do të kërkoj nga sponsori i ligjit dhe organet e Kuvendit për të filluar përgatitjen e Ligjit në tërësi ose ndonjë pjesë të tij, në përputhje me përmbajtjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese"*.
Respektimi, përputhshmëria dhe zbatimi i vendimeve të Gjykatës nga të gjitha institucionet e përmendura është i domosdoshëm në mënyrë që ata të tregojnë respekt për Kushtetutën, rendin kushtetues të Kosovës dhe shtetin e të së drejtës. Kështu, siç u përmend tashmë më parë, zbatimi i vendimeve të Gjykatës varet edhe nga bashkëpunimi i mirë dhe komunikimi, si dhe mirëkuptimi i ndërsjellë dhe respekti ndërmjet Gjykatës dhe të gjitha institucioneve në Kosovë.
Për shembull, duke përdorur përsëri shembullin e Kuvendit, kur Gjykata ka deklaruar si jo kushtetuese ligjin ose një ose më shumë dispozita ligjore, ajo thjesht mund të fshijë dispozitën ose ligjin dhe t'i lejojë legjislativit për të zbatuar vendimin e saj në pajtim me nenin 35 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Megjithatë, heqja e menjëhershme e dispozitës (dispozitave) ose ligjit mund të linte një zbrazëti ligjore dhe, për këtë arsye, të krijojë një situatë të vështirë, duke marrë parasysh se legjislaturës do t'i duhet kohë për të miratuar (një) dispozitë të re ose një ligj të ri. Pra, Gjykata mund të shtyjë[465]datën e pavlefshmërisë të dispozitës (dispozitave) ose ligjit (dhe, ndoshta, të tregojë nëse dispozitat ose ligji jo kushtetues duhet të zbatohet në të njëjtën kohë, në mënyrë tjetër apo fare të mos zbatohen) dhe, në të njëjtën kohë, të sigurojë se legjislatura do të miratojë dispozita të tilla të reja ose ligjin brenda afatit të caktuar nga Gjykata.[466]
Megjithatë, zbatimi i vendimeve nuk është detyrë e Gjykatës, por ajo, edhe pse nuk përmendet shprehimisht në nenin 116 të Kushtetutës, të paktën do të monitorojë zbatimin e tyre sipas përcaktimit në Rregullën 63 (6) dhe (7) (shih komentet në tekstin e mëtejmë).

[465] Gjykata mund ta bëjë këtë në bazë të nenit 20.5 të Ligjit, duke siguruar: "Një vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar atë ndryshe në një vendim".
[466] Shih Raportin e mësipërm të Dr Siegfried Bross, Konferenca e Komisionit të Venedikut në Azerbajxhan.

III. Rregulla 63 (3) nuk i referohet vetëm "të gjithë personave" si bën Rregulla 63 (1), por i referohet më saktë për "*të gjithë personat fizikë*" (Neni 113.7 i Kushtetutës përdor termin "*individët*") dhe "*të gjithë personat juridikë*" (siç përmendet në nenin 21.4 të Kushtetutës[467]). Rregulla është e heshtur për këtë çështje, se çfarë pasoja do të ketë për ata persona, të cilët nuk e respektojnë vendimin e Gjykatës dhe nuk janë në përputhje me të. Do të ishte një gjë e mirë, në qoftë se mosrespektimi i tillë do të këtë sanksione ligjore siç është paraparë me nenin 81 [Zbatimi i vendimeve] i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, të përcaktuar me paragrafin 4 të tij se: "*Personat që nuk i zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ose pengojnë zbatimin e tyre, në qoftë se veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, do të gjobiten deri në 100.000 lekë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv".*

IV. As Kushtetuta e as Rregulla 63 (4) nuk e përcaktojnë qartë se në vendimin e saj, Gjykata mund të përcaktojë se cili institucion do të jetë i ngarkuar për ta zbatuar atë. Vetëm Rregulla 63 (5) i referohet "*Organi i detyruar të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese*", por kjo referencë nuk përcakton qartë që organi në fjalë është përmendur shprehimisht në vendimin e Gjykatës. Për shembull, Neni 35 i Ligjit të Gjykatës Federale Gjermane parashikon që Gjykata Kushtetuese Federale mund të theksojë në vendimin e saj nga kush do të zbatohet vendimi. Gjithashtu Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë është më specifik duke përcaktuar shprehimisht në nenin 40 (2) se, "nëse është e nevojshme, Gjykata Kushtetuese vendos se cili autoritet duhet të zbatojë vendimin dhe në cilën mënyrë […]".
Megjithatë, edhe në qoftë se nuk ka referenca të qarta për pushtet të tillë të Gjykatës, nuk duket të ketë ndonjë pengesë për Gjykatën të interpretojë kompetencat e saj sipas Rregullës 63 (4) në këtë mënyrë.
Në fakt, jurisprudenca dhe përvoja e Gjykatës tashmë përmban disa shembuj të rasteve, kur, sipas aktgjykimit të saj, Gjykata ka specifikuar si mënyrën ashtu dhe afatin kohor për zbatimin e tij, si dhe institucionin (institucionet) të cilat ishin të detyruara për të zbatuar vendimin. Për shembull, në rastin KO 01/09, aktgjykim i datës 18 mars 2010[468], Qemal Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, i referuar pranë Gjykatës nga ana e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete i Komunës së Prizrenit[469], ky i fundit ka kontestuar nenin 7 të Statutit të Komunës për stemën komunale, i cili rregullon se stema komunale përbëhet nga shtëpia e Lidhjes së Prizrenit, viti 1878, me mbishkrimin "Prizren". Ai pohoi se në këtë mënyrë procedurat e parapara sipas ligjit nuk janë respektuar, se kërkesat dhe vërejtjet e komuniteteve në lidhje me stemën nuk ishin marrë parasysh, dhe se kjo stemë nuk pasqyron shumë – etninë e komunës. Ai më tej pohoi se janë shkelur të drejtat kushtetuese të komuniteteve të tjera jo shumicë në komunë, në veçanti, të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të

[467] Neni 21.4 i Kushtetutës parasheh: "*Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa mund të zbatohen".*
[468] Botuar në Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2011, faqe 73 dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[469] Parashtruesi është i autorizuar që të dorëzojë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 62 [Përfaqësimi në Organet e vetëqeverisjes], paragrafi 4 të Kushtetutës.

tyre, dhe se ka pasur shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të Komunitetit.

Gjykata vendosi se neni 7 i Statutit të Komunës ishte në papajtueshmëri me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 7.1 [Vlerat], 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] dhe 59 [Të Drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre] dhe ka urdhëruar Komunën e Prizrenit të ndryshojë statutin e saj brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i vendimit në mënyrë që të sjellë atë në përputhje me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet jo-shumicë.

Një shembull tjetër është rasti nr. KI 08/09[470], i paraqitur në Gjykatë nga Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IMK Fabrika e çelikut në Ferizaj, duke kërkuar shqyrtimin kushtetues të vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Vendimin C. Nr. 340/2001, të datës 11 janar 2002, duke pretenduar shkelje të parimit *res judicata* nga dështimi për të ekzekutuar një vendim përfundimtar të Gjykatës Komunale në Ferizaj, e cila kishte miratuar kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara të ish-punëtorëve të kësaj ndërmarrje, për arsye se u përjashtuan në mënyrë të paligjshme nga puna. Ankuesi pretendoi se me mosekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, e drejta e tyre për të punë dhe ushtrimin e profesionit, si dhe e drejta e tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur. Gjykata gjeti se ka pasur një shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë] dhe 13 [E drejta për mjet efektiv] të KEDNJ dhe se vendimi përfundimtar dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente, në mënyrë të veçantë, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Gjykata gjithashtu vendosi se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të paraqesin, në një periudhë gjashtë mujore, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Kështu, aktgjykimet e mësipërme tregojnë qartë se Gjykata e kupton Rregullën në një kuptim shumë më të gjerë, duke përfshirë fuqinë për të përcaktuar shprehimisht institucionet e detyruara për të përmbaruar vendimet në një mënyrë të caktuar dhe brenda një periudhe të caktuar.

Deri në çfarë mase Gjykata do të jetë e përgatitur për të përcaktuar në dispozitat operative të aktgjykimit të saj detajet e mënyrës në të cilën Kuvendi do të ketë nevojë për të ndryshuar dispozitat ligjore të cilat Gjykata e ka gjetur të jenë jo kushtetuese, është e pasigurt[471]. Në kuadrin e parimit të ndarjes së pushteteve, Gjykata nuk përmirëson gabimet e bëra nga legjislatura. Ajo identifikon vetëm përputhjen ose papajtueshmërinë e një dispozite ligjore apo një ligji të tërë me Kushtetutën dhe, në rast se ka gjetur se dispozita apo ligji është jo kushtetuese, legjislativi është i detyruar për të korrigjuar gabimin. Megjithatë, për shkak të parimit të mësipërm, Gjykata mund të jetë në mëdyshje për të qenë shumë e sinqertë kur përcakton mënyrën në të cilën vendimi i saj duhet të ekzekutohet- për

[470] Gjithashtu referuar në lidhje me sqarimin e një vendimi, shih më lart Rregulli 57(5).

[471] Shih Raport "Authority of the Constitutional Court as the precondition of execution of the decisions" by Mr. GunarsKutris, President of the Constitutional Court of Latvia, Konferenca mbi ekzekutimin e vendimeve të gjykatave kushtetuese të organizuara nga Komisioni i Venedikut në Baku, Azerbajxhan, 14 - 15 Korrik 2008.

të shmangur përshtypjen se dëshiron të ulet në karrige të legjislativit ose ekzekutivit si një legjislaturë pozitive.
Sigurisht, siç u përmend në komentet në Rregullën 63 (1), Gjykata duhet të tregojë nëse dispozita jo kushtetuese apo ligji do të jenë (1) të pavlefshëm nga dita e miratimit të tyre (*ex tunc*), (2) të shfuqizohen në datën e publikimit të vendimit të Gjykatës në Gazetën Zyrtare (*ex nunc*) ose siç përcaktohet nga Gjykata (*pro futuro*).
Sa larg një gjykatë kushtetuese mund të shkojë për të specifikuar në vendimin e saj mënyrën në të cilën vendimi duhet të zbatohet duke ofruar një përmbledhje të detajuar të tekstit të legjislacionit të ri i cili duhet të zëvendësojë legjislacionin e gjetur të jetë jo kushtetues, është treguar nga Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë[472], e cila vendosi në vendimin e saj BVerfGE 99, 300 (304) në një rast në lidhje me ligjin e shërbimit civil dhe ligjit për gjyqtarët në Republikën Federale të Gjermanisë se situata ekzistuese ligjore ishte jo kushtetuese, por ka përcaktuar një periudhë kalimtare prej pak më shumë se një viti për një rregullore të re[473].
Për më tepër, ajo urdhëroi që nëse legjislatura nuk përmbush mandatin e saj për të miratuar përsëri rregulloren, një pagesë e veçantë duhet t'i bëhet nëpunësve civilë dhe gjyqtarëve të prekur nga dita pas skadimit të afatit të përcaktuar kohor. Në këtë rast, konkretizimi me jurisprudencë të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese Federale (BVerfGE 44, 249 dhe 81, 363), e cila, megjithatë, ishte shpërfillur nga legjislatura, ishte aq i ngushtë dhe në mënyrë shumë të diferencuar në lidhje me detajet e saj, që ishte e mundur se Gjykata Federale Kushtetuese në vetvete do të sigurojë "përmbarimin" duke përcaktuar një pagesë në një mënyrë të veçantë[474].
Në lidhje me këtë, është interesante të theksohet se në disa juridiksione zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese i është besuar një institucioni të veçantë, si në Austri, ku ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk i është lënë autoriteteve përkatëse, por Presidentit Federal[475], me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me pretendime monetare sipas ligjit publik [476]dhe atyre mbi dallimet e opinionit në lidhje me interpretimin e dispozitave që rregullojnë kompetencat e zyrës së auditimit[477], ekzekutimi i të cilave i është besuar gjykatave të rregullta. Për më tepër, në rastet e mosmarrëveshjeve në lidhje me konfliktin e kompetencave midis organeve të caktuara shtetërore (për shembull, në mes të gjykatave të rregullta dhe autoriteteve administrative, në mes të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të tjera, ndërmjet Federatës dhe një Landi, etj.)

[472] Neni 35 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese Federale parasheh që në raste të veçanta, Gjykata Kushtetuese Federale mund të rregullojë mënyrën e ekzekutimit.
[473] Vendimi i 24 Nëntorit 1998 - 2 BvL 26/91 u.a. - (BVerfGE 99, 300 <304>).
[474] Shih Raportin e Dr Siegfried Bross, në Seminarin e Komisionit të Venedikut në Azerbajxhan: Reflektimi mbi Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në një shtet demokratik sipas shtetit të së drejtës në bazë të së drejtës kushtetuese, gjendja në Republikën Federale të Gjermanisë. Konferenca mbi Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Baku, Azerbajxhan (14-15 Korrik 2008).
[475] Shih Nenin 146(2) B-VG (Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Austrisë).
[476] Shih Nenin 137 B-VG.
[477] Shih Nenin 126a B-VG.

përmbarimin i aktgjykimit është i pamundur, sepse aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese vetë zgjidh çështjen e kompetencës me anë të një akti deklarativ[478].

Një shembull tjetër ka të bëjë me aktgjykimet që anulojnë një ligj apo një dekret ose deklarojnë paligjshmërinë e një traktati ndërkombëtar, sepse anulimi ndodh eo ipso si rregull me shpalljen e gjetjeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Gazetat përkatëse Zyrtare. Detyrimi për të adoptuar konkluzionin e Gjykatës Kushtetuese mund të ekzekutohet me kusht që Gjykata e ka shpallur këtë në gjetjen e saj[479].

Së fundmi, Raporti arrin në përfundimin se Gjykata Kushtetuese e Austrisë është një organ shumë i respektuar i shtetit, jo vetëm nga publiku i gjerë, por edhe nga institucionet që i nënshtrohen shqyrtimit të saj. Prandaj, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në përgjithësi nuk shkakton ndonjë problem, pasi që, si rregull, organet e tjera shtetërore në mënyrë vullnetare janë në përputhje me këto gjykime.

Rregulla gjithashtu përcakton se në vendimin e saj Gjykata mund të përcaktojë një afat kohor për zbatimin e vendimit të saj dhe t'i kthejë rastin organit përgjegjës për aktin jo kushtetues, duke urdhëruar atë për ta përmirësuar situatën brenda këtij afati kohor. Në rastet e cituara më sipër, Gjykata me të vërtetë ka bërë kështu.

V. Referenca për organin nën detyrimin për të zbatuar vendimin e Gjykatës nuk përmban në mënyrë të qartë se organi i interesuar duhet të ketë qenë shprehimisht i përmendur në vendimin e Gjykatës.

Se Gjykata tashmë e ka bërë shprehimisht kështu, është treguar nga dispozitat operative të dy aktgjykimeve, të cituara në paragrafin e mëparshëm, ku Gjykata kërkoi nga organet zbatimin e vendimeve dhe të paraqesin informacion në lidhje me masat e marra për të ekzekutuar vendimin e saj. Në rastin 01/09, Gjykata kërkoi që Komuna e Prizrenit të raportojë mbi progresin e bërë në lidhje me pajtueshmërinë me Urdhrin e saj për ndryshimin e Statutit Komunal dhe stemës para skadimit të periudhës prej tre muajsh nga dorëzimi i vendimit. Në rastin 08/09, Gjykata kërkoi që Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Qeveria duhet të dorëzojnë në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtëmujore, informatat për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Megjithatë, siç u përmend më sipër, zbatimi i vendimeve nuk është detyrë e Gjykatës, por ajo së paku, do të monitorojë zbatimin sipas përcaktimit në Rregullën 63(7).

VI. Pasi që Gjykata nuk është e autorizuar në bazë të Kushtetutës apo ligjit të vendosë sanksione mbi palët jo bashkëpunuese, masa e vetme që Gjykata ka në dispozicion është ajo sipas Rregullës 63 (6), që siguron që Gjykata merr aktvendim në lidhje me moszbatimin e aktgjykimit të saj dhe e publikon vendimin në Gazetën Zyrtare. Në këtë mënyrë, Gjykata mund të arrijë te institucionet dhe autoritetet tjera

[478] Shih Raportin "Efektet dhe ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese", nga Znj. Britta Wagner, Sekretari i Përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese, Austri, të paraqitur në mini Konferencën mbi Efektet dhe ekzekutimin e vendimeve të rishikimit kushtetues, të organizuar nga Komisioni i Venedikut në Talin, 19 Qershor 2009, CDL-JU(2009)013.

[479] Shih Raportin nga Znj Britta Wagner më lartë.

shtetërore, si dhe te publiku dhe, për shembull, opozita (në rast se Kuvendi nuk është i gatshëm për të miratuar një ligj të ri apo dispozita të reja të një ligji të cilat janë deklaruar jo kushtetuese) që mund të jenë në gjendje dhe të gatshëm për të bërë presion mbi autoritetin përkatës për zbatimin e vendimit.

Gjithashtu Gjykata Kushtetuese Federale nuk do të ekzekutojë vet vendimet e saj, dhe problemet mund të lindin kur institucioni ose personi i prekur konsiderojnë se ekzekutimi nuk është kryer në përputhje me vendimin e gjykatës kushtetuese. Në vendimin e saj BVerfGE2, 139, Gjykata Kushtetuese Federale vendosi se:

"1. Kushdo që është i prekur nga një akt i kryer nga një autoritet administrativ që përmbaron vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale mund të bazohet vetëm në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese Federale direkt me anë të një ankese kundër aktit të tillë të përmbarimit, nëse autoriteti ka vepruar sipas një mandati konkret për përmbarim i cili është lëshuar nga Gjykata Kushtetuese Federale, dhe se nuk ka lënë asnjë liri të gjykimit të autoritetit.

2. Në rast se Gjykata Kushtetuese Federale ka caktuar përmbarimin për një autoritet në mënyrë të përgjithshme, aktet e përmbarimit kryhen në diskrecionin e vetë autoritetit dhe mund të kundërshtohen vetëm me anë të mjeteve juridike që në përgjithësi janë në dispozicion kundër akteve të tilla"[480].

Pyetja mbetet, megjithatë, se a duhet të ketë një institucion të përshtatshëm, përveç autoritetit zbatues, për të koordinuar zbatimin e shpejtë dhe të duhur të vendimeve të Gjykatës. Edhe pse ligji nuk parashikon një institucion të tillë, nuk do të ishte e paarsyeshme që të tregohet drejt Qeverisë, si Ekzekutiv, për të marrë këtë rol dhe, nëse autoriteti zbatues (në qoftë se kjo nuk është Qeveria apo një nga ministritë e saj) nuk arrin të zbatojë vendimin e Gjykatës, për të marrë përsipër përgjegjësinë.

Për shembull, Gjykata Kushtetuese e Letonisë, në aktgjykimin e dhjetorit 2007[481], tërhoqi vëmendjen e Këshillit të Ministrave për detyrën e tij për të siguruar forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës. Si pasojë, Këshilli i Ministrave miratoi një Rregullore në prill 2008, duke e ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë me detyrën për të koordinuar ekzekutimet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për të përgatitur raporte informative mbi ekzekutimet e tilla, të bashkëpunojë me Parlamentin, të kryejë analiza të vendimeve, dhe të përgatit një rishikim vjetor të rezultateve të ekzekutimit të këtyre vendimeve[482]. Ky shembull mund të jetë me vlerë të ndiqet në kontekstin e Kosovës.

VII. Sipas Rregullës 63 (7), Sekretariati (mund të ketë qenë më e përshtatshme për të përmendur Sekretarin e Përgjithshëm) ka për detyrë të monitorojë zbatimin e aktgjykimit nën mbikëqyrjen e gjyqtarit i cili në pajtim me Rregullën 44 [Pleqërimi dhe votimi] ka hartuar vendimin, dhe të raportojë përsëri në Gjykatë

[480] Shih Raportin e Dr Siegfried Bross, Seminari i Komisionit të Venedikut në Azerbajxhan: Reflektimi mbi Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në një shtet demokratik sipas shtetit të së drejtës në bazë të së drejtës kushtetuese, gjendja në Republikën Federale të Gjermanisë. Konferenca mbi Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Baku, Azerbajxhan (14-15 Korrik 2008).

[481] Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr, 2007-12-039 të 21 dhjetorit 2007.

[482] Shih Raportin (CDL-JU (2008) 028 nga z. Gunārs Kutris, kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë, prezantuar në Konferencën për "Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese: një gur themeli i procesit të Zbatimit të Drejtësisë Kushtetuese", Baku, Azerbajxhan, 14-15 korrik, 2008, të përmendura më lart.

me një rekomandim për masat e përshtatshme, kur rezulton se organi i zbatimit nuk ndjek udhëzimet e Gjykatës të përcaktuara në dispozitat operative të aktgjykimit.
Megjithatë, sipas Rregullës 63 (6) e vetmja masë e përshtatshme të cilën Gjykata është e autorizuar ta marrë, është që të sjellë një vendim dhe e publikon atë në Gazetën Zyrtare. Nuk është pra e qartë se cilat "masa të përshtatshme" të tjera Sekretariati mund t'ia rekomandojë Gjykatës.

Neni 27 [Masat e përkohshme]

27.1 Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.
27.2 Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

Siç u përmend më sipër, kompetenca e Gjykatës për të marrë masa të përkohshme rrjedh nga paragrafi 2 i nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që parasheh si më poshtë: "Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme"[483]. Për shembull, vendosja e masave të tilla mund të jetë e nevojshme për të shmangur situata ku, në qoftë se nuk janë marrë këto masa, Gjykata do të parandalohet nga trajtimi i duhur i kërkesës së paraqitur nga kërkuesi dhe nga sigurimi në mënyrë efektive që kërkuesi të gëzojë të drejtat kushtetuese, nëse do të gjendet një shkelje e të drejtave të tilla. Në situatat e përcaktuara në nenin 113 të Kushtetutës, Gjykata mund të vendosë masa të tilla sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palëve të autorizuara.
Megjithatë, Gjykata vetëm do të vendosë masa të tilla, në qoftë se pala kërkuese e masave të përkohshme ka dëshmuar një rast prima facie për meritat e referimit dhe, në qoftë se pranueshmëria e tij ende nuk është përcaktuar, një rast prima facie për pranueshmërinë e kërkesës (shikoni Rregullën 55, më poshtë). Në të njëjtën kohë, pala duhet të ketë paraqitur prova të mjaftueshme që tregojnë se, në qoftë se kërkesa nuk do të pranohet, asaj do t'i shkaktohen dëme të pariparueshme. Deri më tani, një numër i konsiderueshëm i aplikuesve ka kërkuar që Gjykata të shqiptojë një masë të përkohshme, megjithatë, në shumicën e rasteve pa sukses, pasi që kërkesat e tyre kanë qenë plotësisht të pabazuara.
Gjithashtu, në procedurën para GJEDNJ në Strasburg, masat e përkohshme luajnë një rol të rëndësishëm për të shmangur situata të pakthyeshme, të cilat do të parandalojnë GJEDNJ nga shqyrtimi i duhur i një kërkesë dhe sigurimin që kërkuesi të gëzojë të drejtat përkatëse, të garantuara nga KEDNJ, në veçanti, në rastet që kanë të bëjnë me

[483] Paragrafi 2 i nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] nuk duket të përshtatet në këtë temë, pasi ajo nuk ka të bëjë me efektin ligjor të një vendimi të Gjykatës, por faza e procedimeve para se një vendim të jetë marrë.

dëbimin e pashmangshëm apo ekstradimin e kërkuesit në një vend, ku ai/ajo do të ballafaqohet me rrezikun që t'i nënshtrohet trajtimit në kundërshtim me nenet 2 [E Drejta për Jetën] dhe 3 [Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues] të KEDNJ. Fuqia e GJEDNJ-së është përcaktuar në Rregullën 39 të Rregullores së Gjykatës, duke siguruar si më poshtë:
"1. Dhoma, ose, kur është e përshtatshme, Kryetari i saj, mundet me kërkesë të një pale ose të çdo personi të interesuar, ose me iniciativën e saj, tua shqiptojë palëve ndonjë masë të përkohshme për të cilën konsiderojnë se duhet të miratohet në interes të palëve ose për zhvillimin e drejtë të procedurës para saj.
2. Dhoma mund të kërkojë informacion nga palët për çdo çështje lidhur me zbatimin e ndonjë mase të përkohshme që ka shqiptuar".
Ndryshe nga Gjykata Kushtetuese, GJEDNJ nuk lëshon ndonjë vendim formal për përdorimin e masave të përkohshme, por Presidenti ose Dhoma informon Qeverinë e paditur për masat e përkohshme të cilat ajo mendon se duhet të miratohen në interes të palëve ose të zhvillimit të duhur të procedurës. Në praktikë, GJEDNJ zbaton Rregullën, siç u tha më lart, kryesisht në qoftë se ekziston një rrezik i pashmangshëm i dëmeve të pariparueshme, siç mund të jenë rastet e caktuara të dëbimit dhe procedurat e ekstradimit. Si GJEDNJ ka deklaruar shumë qartë: "[...] *Nëse në mënyrë të besueshme shihet se ka një rrezik të dëmtimit të pariparueshëm për realizimin nga ana e kërkuesit të një prej të drejtave themelore në bazë të Konventës, objekt i masës së përkohshme është të mbajë status quo në pritje të vendimit të Gjykatës për arsyetimin e masës*".
Si e tillë, duke pasur për qëllim për të siguruar ekzistencën e vazhdueshme të çështjes që është objekt i kërkesës, masa e përkohshme shkon në thelbin e ankesës sipas Konventës. Sa i përket kërkuesit, rezultati që ai ose ajo dëshiron të arrijë nëpërmjet aplikimit është ruajtja e drejtës sipas Konventës para se asaj t'i shkaktohet dëm të pariparueshëm. Si rrjedhojë, masa e përkohshme është kërkuar nga kërkuesi, të dhënë nga GJEDNJ, me qëllim të lehtësimit të "ushtrimit efektiv" të të drejtës së kërkesës individuale sipas nenit 34 [E Drejta e Aplikimit] të Konventës në kuptimin e ruajtjes së lëndës së aplikimit, kur kjo gjykohet të jetë në rrezik të dëmtimit të pariparueshëm nëpërmjet veprimit ose mosveprimit të shtetit të paditur"[484].
Në këto rrethana, GJEDNJ konsideron se një dështim i Qeverisë së paditur të jetë në përputhje me masat e përkohshme do të konsiderohet se e ndalon Gjykatën nga shqyrtimi efektiv i kërkesës së aplikuesit dhe pengon ushtrimin efektiv të drejtës së tij/saj dhe, në përputhje me rrethanat, si shkelje e nenit 34 të KEDNJ.

1 Neni 27.1 nuk e konsideron vetëm si një prerogativë të Gjykatës për të vendosur për masat e përkohshme me iniciativën e saj ashtu si Neni 116.2[485] i Kushtetutës sugjeron, por edhe i jep të drejtë palës, që do të thotë se çdo palë e autorizuar në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, duke paraqitur kërkesën, t'i kërkojë gjykatës vendosjen e masave të përkohshme. Në një rast të tillë, pala kërkuese duhet të

[484] Shih Mamatukulov kundër Turqisë, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe i datës 4 Shkurt 2005, Kërkesa Nr. 46951/99.
[485] Neni 116.2 i Kushtetutës parasheh: "*Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata mund të pezullojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi nëse Gjykata konstaton se aplikimi i veprimit të kontestuar, mund të rezultojë me dëme të pariparueshme".*

paraqesë prova të mjaftueshme[486] që ai/ajo do të vuaj dëme të pariparueshme, nëse kërkesa për masa të përkohshme nuk është dhënë. Edhe pse Neni 116.2 i Kushtetutës përdor formulimin e dëmeve të "pakthyeshme" dhe neni 27 i Ligjit flet për dëme të "pariparueshme", nuk duket se ka një ndryshim të madh në mes të këtyre shprehjeve. Nëse pala ka për të treguar dëme të "pariparueshme", barra e provës mund të jetë më e lehtë se sa për të treguar dëme të "pakthyeshme", që do të thotë se dëmi nuk është vetëm i pariparueshëm, por nuk mund edhe të kthehet, për shembull, me anë të pagesës së kompensimit.

Për më tepër, sipas nenit 27.1 të Ligjit, legjislatura ka zgjeruar më tej autoritetin e Gjykatës sipas nenit 116.2 të Kushtetutës, duke i dhënë asaj fuqinë për të shqiptuar një masë të përkohshme, në qoftë se masa e tillë do të ishte, sipas mendimit të Gjykatës, "në interes të publikut". Kjo do të thotë se, edhe nëse kërkuesi, i cili kërkoi masën e përkohshme, nuk do të ketë sukses që të paraqes prova të mjaftueshme se ai/ajo do të vuaj dëme të pariparueshme në qoftë se masa e përkohshme nuk do të shqiptohet, Gjykata mundet ende të marrë një masë të tillë, në qoftë se do ta konsideronte masën që të jetë "në interes të publikut", në kuptimin "për të mirën e publikut". Në Rastin Nr. 11/09, *Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerëve*[487], Gjykata vlerësoi se "*kjo kërkesë individuale nuk ka të bëjë vetëm interesin personal të kërkuesit, por edhe interesin publik dhe për këtë arsye e konsideron të përshtatshme për të aprovuar masën e përkohshme të kërkuar[…]*. Nocioni "në interes të publikut" duket të jetë mjaft i paqartë dhe mund, pra, të përdoret nga Gjykata (me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare), pa ndonjë shpjegim për të justifikuar vendosjen e masave të përkohshme. Megjithatë, për një palë të autorizuar, në veçanti, një individ, nuk është e lehtë për të provuar se masa e përkohshme do të jetë në interes të publikut. Është sugjeruar se Gjykata do të lëshojë një shënim shpjegues – si një aspekt të mëtejshëm të zbatimit të programit të saj në terren - në të cilën nocioni i masës së përkohshme, në veçanti, masa e përkohshme në interes të publikut, është i përcaktuar në mënyrë të qartë dhe koncize për një mirëkuptim nga publiku sa më në nivel.

2 Neni 27.2 përcakton se kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale. Masat e përkohshme duhet të zgjasin për aq kohë sa ato janë të nevojshme për të ruajtur status quo në pritje të aktgjykimit të Gjykatës. Prandaj, shumë do të varet nga shpejtësia me të cilën Gjykata do të merret me kërkesën. Për më tepër, kohëzgjatja e masave duhet të jetë në proporcion me qëllimin e paraparë, ndërsa masat duhet të hiqen, menjëherë pasi që nevoja për t'i mbajtur ato nuk ekziston më ose gjykata ka qenë në gjendje për të shqyrtuar në mënyrë efektive ankesën e ankuesit[488]. Në çdo rast, në qoftë se nuk hiqet gjatë

[486] Rregulli 55 [Vendimi për masat e përkohshme], paragrafi 4, shkon edhe më tej se kaq, duke përcaktuar se "...Para se Kolegji Shqyrtues mund të rekomandojë që kërkesa për masa të përkohshme të jepet, ai duhet të gjejë se: [...] (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës; […].

[487] Vendimi për masat e përkohshme / IM / lënda nr. KI 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK et al. i datës 16 Tetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 11; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

[488] Shih, për shembull, vendimi për të hedhur poshtë kërkesën ne Rastin nr. KI 11/09, Tomë Krasniqi, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/12 të Misionit të

procedurës, masat e përkohshme do të përfundojnë kur Gjykata lëshon vendimin e saj përfundimtar mbi një kërkesë, siç përcaktohet në Rregullën 55 (9), që do të komentohet në vazhdim.

Për shembull, në Rastin Nr. KI. 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit[489], të datës 15 Dhjetor 2009, ku ankuesit kanë sfiduar kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Komunës për të ndërtuar disa ndërtesa shumëkatëshe në vend të zonave të gjelbra në lagjen e tyre dhe pretendonte se Komuna ka dështuar në informimin e tyre siç duhet, ankuesit kërkuan nga Gjykata për të vendosur masa të përkohshme për të ndaluar çdo veprim ose punën e komunës në ndërtimin e ndërtesave, me synimin për të shmangur ndonjë dëm të pakthyeshëm. Duke marrë parasysh se ankuesit kishin vënë përpara argumente mjaft bindëse që tregojnë se kërkesa për masa të përkohshme ishte e arsyeshme dhe e justifikuar, pasi që me zbatimin e vendimit të kontestuar të planit urban të datës 30 prill 2009 mund të rezultojnë dëme të pariparueshme për ankuesit, Gjykata vendosi të aprovojë kërkesën për masa të përkohshme për një kohëzgjatje prej jo më shumë se 3 muaj nga data e miratimit të vendimit dhe që menjëherë të pezullojë ekzekutimin e Planit përkatës urbanistik, si dhe të urdhërojë Komunën që të pezullojë çdo ndërtim në lokacionin në fjalë për kohëzgjatjen e njëjtë. Kanë pasuar disa vazhdime të masave të përkohshme për periudha të ngjashme.

Në një rast të mëtejshëm Nr. KO. 119/10[490], Avokati i Popullit i Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të neneve 14.1, 6, 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Avokati i Popullit ka pretenduar se këto nene të Ligjit i kanë mundësuar anëtarëve të Kuvendit të Kosovës që të realizojnë pensione të cilat ishin më të favorshme se çdo përfitim tjetër të daljes në pension për qytetarët tjerë, dhe se kjo nuk ishte në përputhje me vlerat e proklamuara në Nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, i cili themelon rendin e tij kushtetues mbi parimet e demokracisë, barazisë, jo diskriminimit dhe drejtësisë sociale. Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, në mënyrë për të pezulluar zbatimin e ligjit në fjalë derisa rasti të jetë vendosur në bazë të meritave të tij. Më 22 dhjetor 2010, Gjykata vendosi të shqiptojë masë të përkohshme për një periudhë prej 3 muajsh, duke pezulluar menjëherë zbatimin e ligjit të kontestuar me arsyetimin se ankuesi kishte vënë përpara argumente të mjaftueshme dhe bindëse se zbatimi i dispozitave të kontestuara të ligjit mund të rezultojë në dëme të pariparueshme dhe se një masë e tillë e përkohshme është në interes të publikut. Disa vazhdime të masave të përkohshme për periudha të ngjashme kanë pasuar.

Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02 / L-47.

[489] Vendimi mbi kërkesën për masë të përkohshme në rastin nr. 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit të datës 15 Dhjetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 26; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

[490] Vendimi për masat e përkohshme në rastin nr. KO 119/10, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të neneve 14 (1) 6, 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, nr. 03 / L-111, i datës 22 Dhjetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 445; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Megjithatë, ne Rastin Nr. KI 121/10, Sitaram Chamlagai dhe të tjerët[491], Gjykata ka përdorur një qasje ndryshe duke aprovuar kërkesën për masë të përkohshme, me vendim të datës 13 dhjetor 2010, "*derisa [Gjykata] do të kishte gjykuar kërkesën*", duke shmangur nevojën për të zgjeruar vendimin e saj mbi masat e përkohshme disa herë, nëse konsiderohet e nevojshme. Kjo qasje duket të jetë më e përshtatshme, edhe pse kjo nuk mund të ndjek Rregullën 55.5 në letër, e cila parashikon se "asnjë vendim mbi aprovimin e masës së përkohshme nuk mund të zgjatet nëse është përcaktuar data e skadimit".

Neni 27 plotësohet me Rregullën 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] dhe 55 [Vendimi për masa të përkohshme] të kapitullit VI [Masat e përkohshme] të Rregullores së Punës të cilat përmbajnë më shumë hollësi në lidhje me vendosjen e masave të përkohshme nga Gjykata.

[Kërkesa për masa të përkohshme] e Rregullores së Punës

1. **Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.**
2. **Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet me shkrim, duhet të përshkruajë faktet përkitazi me kërkesën, argumentet për të mbështetur kërkesën, masat e kërkuara dhe pasojat e parashikuara në mënyrë të arsyeshme nëse kërkesa miratohet. Pala që kërkon masën e përkohshme mund t'i bashkëngjisë kërkesës edhe dokumente dhe dëshmi të tjera që janë të rëndësishme dhe që e mbështesin kërkesën.**
3. **Sekretari do t'u dërgojë të gjithë gjyqtarëve dhe palëve të tjera përkatëse nga një kopje të kërkesës.**

I. Jo vetëm në momentin e paraqitjes së kërkesës, por edhe gjatë kohës që rasti është duke u shqyrtuar nga Gjyqtari Raportues, Kolegji Shqyrtues, ose Gjykata e plotë para ose gjatë një seance dhe madje edhe pas kësaj, parashtruesi mund kërkojë nga Gjykata të vendosë masa të përkohshme, për sa kohë që Gjykata nuk ka shqyrtuar thelbin e kërkesës. Arsyetimi i rregullës supozohet të jetë se pavarësisht nga faza e procedurës para Gjykatës, për sa kohë që nuk janë vendosur meritat, një situatë e papritur mund të lind që do të justifikonte kërkesën për vendosjen e masave të përkohshme për të shmangur dëme të pariparueshme ose që një masë e tillë do të ishte në interes të publikut.

II. Kërkesa për masa të përkohshme nuk mund të paraqitet në mënyrë elektronike ose me gojë, por vetëm me shkrim, të dërguar me postë, me dorë ose me faks dhe duhet të përputhet me kërkesat tjera të qarta të përcaktuara me Rregullën 54 (2). Me pak fjalë, në mënyrë të ngjashme për dorëzimin e vetë, pala kërkuese duhet të

[491] Aktvendimi për papranueshmërinë e datës 14 Dhjetor 2010 në rastin 121/10, Sitaram Chamlagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chamhan dhe Hom Bahadur Battarai, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL.nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të datës 22 Nëntor 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2011, faqe 669; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

mbështet kërkesën në fjalë sa më shumë të jetë e mundur në mënyrë që të tregojë justifikimin e saj.

III. "Sekretari" supozohet se qëndron për "Sekretarin e Përgjithshëm". Jo vetëm gjyqtarët do të marrin një kopje të kërkesës (duke përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese), por edhe të gjitha palët tjera relevante, të cilave mund t'i jetë dhënë një afat nga Gjykata, brenda të cilit ata do të jenë në gjendje për të komentuar mbi kërkesën (shih gjithashtu Rregullën 55 (3) më poshtë).

Rregulla 55 [Vendimi për masa të përkohshme] i Rregullores së Punës

1. Një kërkesë për masa të përkohshme do të merret në konsideratë përshpejtuar nga Gjykata dhe do të kenë përparësi mbi të gjitha referime të tjera.

2. Kryetari do të caktojë kërkesën për masë të përkohshme të Panelit Shqyrtues të caktuar në kërkesë. Nëse nuk Paneli Shqyrtues ka ende caktuar kështu, Presidenti cakton kolegjin shqyrtues me barazim rastit. Nëse ndonjë gjykatësi në Panelit Shqyrtues është në dispozicion për shqyrtim të përshpejtuar, Presidenti do të caktojë një panel të ri shqyrtim nga barazim rastit.

3. Paneli Shqyrtues të kërkojë prova shtesë, dokumente ose informacion nga pala kërkuese masa të përkohshme dhe mund të urdhërojë një përgjigje apo fakte të tjera, dokumente ose informacion nga partitë e tjera në rastin. Kolegji shqyrtues nuk merr vendim, pa i dhënë palëve të tjera, për aq sa të jetë e mundur, një mundësi për të paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me kërkesën për masa të përkohshme.

4. Brenda shtatë (7) ditësh, Kolegji shqyrtues i rekomandon me shkrim në Gjykatën nëse kërkesa për masa të përkohshme të jepet, qoftë në tërësi ose në pjesë, apo mohuar. Para se Paneli Shqyrtues mund të rekomandojë që kërkesa për masa të përkohshme të jepet, ajo duhet të gjeni se:

(a) pala kërkuese e masave të përkohshme ka treguar një rast prima facie në meritat e referimit dhe, nëse pranueshmërinë ende nuk është përcaktuar, një rast prima facie mbi pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala kërkuese e masave të përkohshme ka treguar se ajo do të vuajnë dëme të pariparueshme në qoftë se lehtësim i përkohshëm nuk është dhënë; dhe

(c) masat e përkohshme janë në interes të publikut. Nëse pala kërkuese masa të përkohshme nuk e ka bërë këtë shfaqjeje nevojshme, Kolegji shqyrtues i rekomandon refuzimin e kërkesës.

5. Nëse kërkesa për masa të përkohshme jepet, qoftë në tërësi ose në pjesë, zgjidhja e Panelit Shqyrtues do të deklarojë arsyet që mbështesin vendimin dhe se si standardi ligjor është përmbushur, dhe duhet të përmbajë kohën e kufizuar gjatë së cilës i përkohshëm masat do të jetë efektive. Asnjë vendim dhënien e masave të përkohshme mund të lidhet nëse data e skadimit është e specifikuar; megjithatë, datat e skadimit mund të zgjatet me vendim të mëtejshëm të Gjykatës. Nëse pranueshmeri te kërkesës ende nuk është

përcaktuar, rezoluta duhet të deklarojë se masat e përkohshme do të përfundojë menjëherë nëse Gjykata përcakton referimin që të jetë e papranueshme.

6. Sekretari i përcjell rekomandimin për të gjithë gjyqtarëve. Rekomandimi i Panelit Shqyrtues të aplikimit për masat e përkohshme do të bëhet vendimi i Gjykatës, nëse një ose më shumë Gjyqtarët paraqesë një kundërshtim të Sekretarit brenda tri (3) ditë. Nëse një ose më shumë Gjyqtarët kundërshtojnë të rekomandimit, aplikimi do të përcillet në Gjykatën për shqyrtim.

7. Presidenti sipas detyrës zyrtare mund të urdhërojë informacion shtesë nga palët ose të planifikojë një seancë kur kërkohet nga një ose më shumë gjyqtarëve të Gjykatës ose Gjykata mund të diskutojë dhe të vendosë sa më shpejt që të jetë e mundur në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme pa seancë. Për të vendosur nëse do të pranojë apo refuzojë kërkesën për masë të përkohshme, gjykata duhet të zbatojë standardet ligjore të përcaktuara në këtë Rregull.

8. Me kërkesë të palës, apo sipas detyrës zyrtare, gjykata mund, në çdo kohë para gjykimit përfundimtar, të revokojë ose ndryshojë ndonjë vendim në lidhje me masat e përkohshme nëse një ndryshim në situatën e justifikon revokim ose ndryshim të tillë. Çdo palë e kërkon revokimin ose ndryshimin e tillë do të specifikojë ndryshimin e situatës që mbështet këtë ndryshim. Përpara se të përcaktohet nëse do të pranojë apo refuzojë kërkesën për revokim apo modifikim, ose para se duke vepruar sipas detyrës zyrtare, gjykata do të japë palëve një mundësi për të paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me këtë çështje.

9. Nëse nuk shprehet ndryshe nga Gjykata, masa të përkohshme që janë dhënë nga Gjykata gjatë procedimit në një rekomandim të përfundojë kur Gjykata lëshon vendimin e saj përfundimtar mbi një rekomandim.

I. Sipas Rregullës 55 (1), çdo kërkesë për masa të përkohshme duhet të merret në konsideratë të shpejtuar nga Gjykata. Megjithatë, parashtruesit mund të keqpërdorin të drejtën për të kërkuar masa të përkohshme, thjesht duke i shtuar në kërkesë pa ofruar ndonjë arsyetim. Në raste të tilla, Gjykata do të humb kohë të vlefshme, në qoftë se çdo kërkesë për masa të përkohshme duhet të marrë prioritet mbi të gjitha rastet tjera. Arsyeja për të shtuar një kërkesë të tillë për një ankesë mund të jetë se parashtruesi shpreson që, kur Gjykata i jep prioritet shqyrtimit të kërkesës për masë të përkohshme, ajo gjithashtu do të merret me kërkesën e tij/saj në mënyrë të shpejtë. Rregulla 55 (1), megjithatë, në mënyrë të qartë thekson se vetëm kërkesës do t'i jepet konsideratë e përshpejtuar nga Gjykata, e jo ankesës. Për të shmangur abuzimin e procedurës, Gjykata ka zhvilluar jurisprudencën, ku ajo vendos mbi kërkesën për masë të përkohshme dhe, nëse refuzohet, merret me ankesën në mënyrë normale të regjistrimit, së bashku me pranueshmërinë e kërkesës, kur është e qartë se kërkesa për masa të përkohshme është plotësisht e pabazuar[492].

[492] Shih, për shembull, Aktvendimi mbi papranueshmërinë i datës 12 Dhjetor 2011 në rastin nr. KI. 92/11, Muhamet Bucaliu, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLC.no. 37/11 i datës 2 Qershor 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 647; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

II. Asnjë Gjyqtar Raportues nuk është i përfshirë me sa duket në procedurat fillestare të kërkesës për masa të përkohshme. Në vend të kësaj, Paneli Shqyrtues, të caktuar për referimin, ka për detyrë të merret me të, përveç nëse ka Paneli Shqyrtues akoma nuk është caktuar për kërkesën. Procedura që Kryetari të caktojë kolegjin shqyrtues me short në atë situatë, duhet të devijojë nga procedura e përcaktuar në Rregullën 9 [Emërimi i paneleve shqyrtuese], e cila përcakton se Kolegji shqyrtues do të zgjidhet me një sistem të shortit të rastit nga Sekretariati dhe të emërohet nga Kryetari. Nuk është e qartë, për çfarë arsye Rregulla 9 nuk do të jetë e zbatueshme për emërimin e Panelit Shqyrtues të situatës siç është përshkruar në Rregullën 55 (2). E njëjta gjë është e vërtetë në rastin e caktimit të një paneli të ri Shqyrtues, në qoftë se asnjë gjyqtar i Panelit Shqyrtues nuk është në dispozicion për shqyrtim të përshpejtuar, siç është përmendur nga Rregulla 55 (2). Gjegjësisht, në kundërshtim me dispozitat e Rregullës 9, caktimi i Panelit Shqyrtues të ri bëhet në të njëjtën mënyrë si në gjendjen e mëparshme, nga Kryetari me short të rastit.

III. Kur, në bazë të Rregullës 55 (3), Paneli Shqyrtues, nëpërmjet Kryetarit të kolegjit të tij, e përcjell kërkesën e tij për informacion dhe dokumente drejtpërdrejtë palës që kërkon masat e përkohshme, supozohet se, në funksion të përshtatshmërisë së kërkesës, ai do të caktojë një afat kohor shumë të shkurtër për dorëzimin e informacionit të tillë. Po ashtu, do të caktojë afate të shkurtra të ngjashme, kur ai urdhëron një përgjigje apo fakte, dokumente ose informacion shtesë nga palët tjera në rast, duke respektuar në këtë mënyrë parimin e "barazisë së armëve", para se të rekomandojë për Gjykatën, nëse kërkesa duhet të aprovohet apo jo. Palës tjetër, në këtë mënyrë, i jepet mundësia për të paraqitur pikëpamjet e sajë mbi kërkesën, po ashtu brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore. Megjithatë, Rregulla kufizon të drejtën e palës tjetër, në një masë të caktuar, pasi që vetëm përcakton se "palëve tjera" t'i jepet mundësia për të paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me kërkesën "*për aq sa të jetë e mundur*", duke nënkuptuar se: "*për aq sa Gjykata e sheh të arsyeshme*".

Një kërkesë për masa të përkohshme mund të ketë nevojë për një vendim të menjëhershëm nga ana e Gjykatës, kur, për shembull, përfaqësuesi i një parashtruesi, i cili është gati për t'u depërtuar në një vend ku ai/ajo mund të ballafaqohet me një rrezik serioz për t'u nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose degradues (në shkelje të nenit 3 KEDNJ), kërkon nga Gjykata masë të përkohshme dhe tashmë është duke u dërguar në aeroplan, i cili do të transportonte atë/ato në atë vend. Në rast të tillë nuk do të kishte kohë për të kërkuar nga autoritetet dëbuese të paraqesin mendimin e tyre në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme. Gjykata, në këtë mënyrë, duhet të imponojë masa me efekt të menjëhershëm për të ruajtur status quo-në, në pritje të shqyrtimit të saj të pranueshmërisë dhe thelbit të çështjes[493].

[493] Shih Mamatukulov k. Turqisë, Aktgjykimi i datës 4 shkurt 2005, Kërkesa nr. 46951/99. Në rastin e mëposhtëm, parashtruesi i kërkesës nuk ishte në gjendje të paraqesë prima facie dëshmi për trajtimin e pretenduar çnjerëzor ose poshtërues, në kundërshtim me nenin 3 KEDNJ, të cilit ai do të mund t'i nënshtrohet, nëse ekstradohet në Zvicër: shikoni Vendimi për kërkesën për masa të përkohshme në rastin nr.KI 22/09, Dedë Gecaj kundër vendimit PKL-KKZ.76 / 08 të Gjykatës së Lartë, i datës 15 Dhjetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 22; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

IV. Supozohet se periudha prej "shtatë ditë" e përmendur në Rregullën 55 (4), do të fillojë të llogaritet nga momenti që Paneli Shqyrtues ka marrë të gjitha të dhënat që kishte kërkuar nga palët dhe pasi të ketë verifikuar kushtet e përcaktuara në Rregull.

Një dëshmi *prima facie* për meritat e kërkesës mund të jetë - duke përdorur të njëjtin shembull të dëbimit - që kërkuesi tregon një fillim të arsyeshëm të provave se ai/ajo do t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor dhe degradues në vendin në të cilin ai/ajo do të depërtohet[494]. Dëshmi e tillë mund të jetë, për shembull, informacion në lidhje me raste të ngjashme ose që ai/ajo tashmë ka dorëzuar për një trajtim të tillë para se të largohet nga vendi, për të cilën ai/ajo është gati për t'u deportuar (vendi pritjes)[495].

Një rast prima facie për *pranueshmërinë* e kërkesës mund të jetë, duke përdorur shembullin e mësipërm, që, përderisa rasti i dëbimit të parashtruesit është ende në pritje para autoriteteve kompetente dhe ai / ajo është, pra, ende në procesin e shterjes së të gjitha mjeteve juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, procedura e heqjes, në të cilin rasti i dëbimit në esencë nuk ka efekt, duhet të ndalet përkohësisht për t'i dhënë autoriteteve kompetente mundësinë që merren me çështjen bazë, duke shmangur situatën e turpshme që parashtruesi mund tanimë të jetë dëbuar, kur një vendim përfundimtar mbi meritat do të gjendet në favor të tij/saj.

Ndryshe nga neni 27 të Ligjit, Rregulla përdor fjalën "dëme të pakthyeshme" që në fakt është e njëjta fjalë me atë të përmendur në nenin 116.2 të Kushtetutës. Vërejtjet e bëra në nenin 27.1 të Ligjit janë njëlloj të vlefshme këtu: në qoftë se pala ka për të treguar dëme "të pariparueshme" (shprehja e përdorur në Nen), barra e provës është më e lehtë se sa për të treguar dëmin "e pakthyeshëm" që do të thotë se dëmi jo vetëm që është i pariparueshëm, por nuk mund edhe të kthehet, për shembull, me anë të pagesës së kompensimit. Pasi që shprehja "i pakthyeshëm" është duke u përdorur në nenin 116.2 të Kushtetutës, mund të konsiderohet se shprehja "i pariparueshëm" në nenin 27 të Ligjit është e pasaktë dhe duhet të zëvendësohet. Megjithatë, sa i përket jurisprudencës së Gjykatës, problemi nuk është ngritur. Në fakt, në vendimet përkatëse të Gjykatës, janë përdorur të dyja shprehjet.

Si një shembull i parë i një vendimi të Gjykatës në të cilin është shqiptuar një masë e përkohshme, i bëhet referencë vendimit mbi kërkesën për masë të përkohshme në Rastin Nr. 56/09[496], ku "*Gjykata arriti në përfundimin, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të ankesës, se parashtruesit kanë paraqitur argumente të mjaftueshme bindëse që tregojnë se kërkesa për masa të përkohshme është e*

[494] Shih, për shembull, Vendim mbi kërkesën për masë të përkohshme në rastin nr. 27/09, Rafet Hoxha kundër Vendimit nr. pn. nr. 168/2005 i Gjykatës së Lartë, 15 Dhjetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 30; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

[495] Në rastin e lartpërmendur, rasti nr. 22/09, Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk ishte në gjendje për të paraqitur ndonjë dëshmi e cila do të justifikonte pezullimin e procedurave të ekstradimit në pritje të rezultatit përfundimtar të kërkesës e tij.

[496] Vendimi mbi kërkesën për masë të përkohshme në rastin nr. 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, 15 Dhjetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 26; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

arsyeshme dhe e justifikuar, pasi që nga zbatimi i vendimit të kontestuar të datës 30 prill 2009 mund të rezultojë në dëme të paripërueshme për parashtruesit".
Rregulla 55 (4) (c) siguron gjithashtu që Paneli Shqyrtues duhet të gjejë se "masat e përkohshme janë në interes të publikut". A do të thotë kjo se në qoftë se Paneli shqyrtues nuk gjen se ka një interes publik, Paneli Shqyrtues mund të rekomandojë Gjykatës vetëm për të refuzuar kërkesën për masë të përkohshme? Për më tepër, është e vështirë për të parë se si masat e përkohshme duhet të jenë gjithmonë "në interes të publikut". Neni 27 [Masat e përkohshme] i Ligjit në mënyrë të qartë përcakton se Gjykata mund të marrë një vendim të tillë për shkak të: *"(1) në qoftë se masa të tilla janë të nevojshme për të evituar rrezikun e dëmeve të paripërueshme, ose (2) nëse një masë e tillë e përkohshme është në interes të publikut"*. Ndryshe në Rregullën 55 (4), ku fjala "dhe" është përdorur, Neni 27 nuk kërkon që arsyet të jenë kumulative. Mundet të ndodhë, pra, të jetë Rregulla 55 (4) (c) që në mënyrë të gabuar e përdor fjalën "dhe" në vend të "ose".
Është më tepër detyrë e Gjykatës për të gjykuar "*ex officio*" nëse, në një rast të caktuar, vendosja e masave të përkohshme do të jetë e justifikuar "në interes të publikut". Fjalia përmbyllëse e Rregullës 55 (4): "*Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës*", duket, pra, të jetë tepër e ashpër për një individ si pala kërkuese, pasi që ai/ajo me siguri do të ketë vështirësi të mëdha për të treguar domosdoshmërinë e vendosjes së masave të përkohshme jo vetëm në interesin e tij/saj, por edhe "*në interes të publikut*".
Në Rastin Nr. 11/09[497], parashtruesi megjithatë arriti të bind Gjykatën se masa e përkohshme e kërkuar nuk ishte vetëm në interesin e tij, duke argumentuar se ajo ka të bëj edhe me një shkelje të interesit publik siç parashihet në Nenin 27.1 të Ligjit, duke e vënë përpara të njëjtin nen si bazë ligjore për shqiptimin e masës së përkohshme sipas kërkesës.

V. Duket se Rregulla 55 (5), në fjalinë e parë dhe të fundit, gabimisht i referohet zgjidhjes së "Kolegjit Shqyrtues", ndërsa në mënyrë të qartë është menduar "të Gjykatës". Vendimet janë vendimet e Gjykatës siç është përmendur në Rregullën 57 [Përmbajtja e vendimeve]. Është sugjeruar që Rregulla të ndryshojë në përputhje me rrethanat.
Për më tepër, Rregulla, e cila në mënyrë të qartë ka të bëjë me kompetencat e Gjykatës duhet të vendoset midis paragrafëve të pranishëm 7 dhe 8 të kësaj Rregulle.
Sa i përket përmbajtjes së Rregullës, është e qartë se Gjykata duhet të arsyetojë zgjidhjen e saj dhe të tregojë se si standardet ligjore (me siguri "standardet ligjore të përcaktuara në këtë Rregull", të përmendur në fund të paragrafit 7 të kësaj Rregulle, janë menduar këtu) janë plotësuar. Ajo duhet të tregojë kohëzgjatjen e masës. Siç u përmend më sipër, Gjykata ka zgjeruar masën në disa raste, ndonjëherë më shumë se një herë gjatë gjykimit të kërkesës[498]. Megjithatë, siç

[497] Shih, vendimin për masa të përkohshme në rastin nr. 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK et al, 16 Tetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 11; dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[498] Shih, për shembull, rasti nr. KI 56/09, Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, në të cilin Gjykata ka zgjatur masën e përkohshme tre herë, çdo herë për 3 muaj.

është përcaktuar sipas Rregullës 53 (2), në një rast të fundit, Gjykata ka vendosur për një zgjidhje të ndryshme se sa për të vendosur një datë të skadimit, duke lënë datën e tillë të hapur [499]dhe vetëm duke përcaktuar se masa duhet të jetë në fuqi për aq kohë sa se do t'i marrë Gjykatës për të gjykuar kërkesën. Kjo metodë gjithashtu është duke u përdorur nga GJEDNJ duke kërkuar nga shteti në pyetje të mos ndërmarrë veprim deri në shqyrtimin e aplikimit.
Megjithatë, Ligji shqiptar për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese i lejon Gjykatës Kushtetuese, në nenin 45 të tij [Fuqia e Pezullimit][500], edhe pas vendimit të saj përfundimtar, për të mbajtur urdhrin e pezullimit. Neni nuk përmend një afat kohor, por supozohet se Gjykata në vendimin e saj do të tregojë kohëzgjatjen e masës së pezullimit. Një vazhdim i masës së pezullimit mund të konsiderohet i nevojshëm nga gjykata, për shembull, në rastet kur Gjykata dëshiron t'ia lërë autoriteteve zbatuese kohë të mjaftueshme për të ekzekutuar vendimin e saj, pa rrezikuar që parashtruesi të vuajë dëme të pariparueshme gjatë fazës së zbatimit.

VI. Gjykata mund të mos jetë në seancë, kur rekomandimi i kolegjit shqyrtues do të përcillet nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët (tjerë) të Gjykatës. Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se rekomandimi do të arrijë te ata gjyqtarë dhe, pas konfirmimit të pranimit të një kopje të rekomandimit nga ana e secilit prej tyre, të presin për 3 ditë. Nëse pas 3 ditësh, asnjë prej gjyqtarëve nuk ka kundërshtuar rekomandimin e Kolegjit Shqyrtues, teksti do të bëhet vendimi i Gjykatës, në një mënyrë të ngjashme siç është rasti me një Aktvendim për Papranueshmëri të miratuar unanimisht nga Kolegji Shqyrtues (shih komentet në nenin 22.8 të Ligjit, më sipër). Nëse një ose më shumë gjyqtarë kundërshtojnë, Gjykata e plotë do ta marrë në konsideratë kërkesën me ose pa seancë dëgjimore.

VII. Me sa duket, në bazë të Rregullës 55 (7), Kryetari mund të kërkojë me urdhër informacione shtesë nga palët sipas detyrës zyrtare, por gjithashtu mund të caktojë seancë kur kërkohet nga një ose më shumë gjyqtarë. Në rast se Kryetari ka kërkuar informata shtesë nga palët, ky informacion do të duhet të dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët. Gjykata duhet pastaj të debatojë dhe të vendosë sa më shpejt që të jetë e mundur në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme pa seancë ose, kur kërkohet nga një ose më shumë gjyqtarë, seanca duhet të mbahet si planifikohet nga Kryetari. Për shkak të përshtatshmërisë të vendimit të Gjykatës për masë të përkohshme, seanca dëgjimore për masa të tilla do të duhet të zhvillohet brenda një njoftimi të shkurtër. Megjithatë, nëse lejon koha, dëgjimi mund të përdoret edhe për t'u marrë me pranueshmërinë dhe çështjen e meritave.

---

[499] Shih komentet në Nenin 27.2 të Ligjit më sipër. Aktvendimi për papranueshmërinë e datës 14 Dhjetor 2010 në rastin 121/10, Sitaram Chamlagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chamhan dhe Hom Bahadur Battarai, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL.nos. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të datës 22 nëntor 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2011, faqe 669; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

[500] Neni 45 parasheh: "*Në vendimin e saj të formës së prerë, Gjykata Kushtetuese do të deklarojë nëse një urdhër pezullimi do të mbetet në fuqi*".

Sa për fjalinë e fundit të Rregullës, supozohet se Gjykata nuk do të aplikojë vetëm standarde ligjore të parapara në Rregull, por - në të njëjtën mënyrë si Kolegji Shqyrtues duhet të bëjë në rekomandimin e tij – të theksojë në aktvendim arsyet për dhënien apo refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.
Deri më tani, asnjë gjyqtar nuk ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës për të caktuar një seancë dëgjimore në lidhje me një kërkesë për masë të përkohshme. Kështu, të gjitha kërkesat për masa të përkohshme janë vendosur nga Gjykata në bazë të parashtresave të kërkuesit dhe, sipas rastit, palëve.

VIII. Nëse, sipas Rregullës 55 (8), një palë kërkon revokimin ose ndryshimin (për shembull, një zgjatje apo masë shtesë) të vendimit për masat e përkohshme, ajo duhet të përcaktojë ndryshimin e situatës, duke mbështetur ndryshimin në masat e përkohshme, dhe duhet të japë arsyet për ndryshimin ose revokimin e tillë, në veçanti, kur paraqet pikëpamjen e saj për këtë çështje. Në përputhje me parimin e barazisë së armëve, pala që përgjigjet në mënyrë të barabartë do të jep komentet e saj për këtë çështje. Supozohet se Gjykata mund të marrë parasysh për të vendosur një afat kohor, kur i jep palëve një mundësi për të paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me këtë çështje.
Për shembull, në mënyrë që të jep një shembull të një rasti ku Gjykata sipas detyrës zyrtare i dha fund masës së përkohshme që kishte shqiptuar me kërkesë të aplikantit, i bëhet referencë Vendimit për Heqjen e Kërkesës ne Rastin Nr. KI 11/09[501], në të cilin Gjykata ka mbajtur sipas detyrës zyrtare se "*në kohën e vendosjes së masave të përkohshme nuk kishte shkallë të mjaftueshme sigurie që rrethon këtë çështje dhe ishte e nevojshme për të mbrojtur interesat e parashtruesit të kërkesës nga dhënia e masës së përkohshme në mënyrën e përshkruar më sipër. Prandaj nuk ka nevojë më tej për të dhënë masa të mëtejshme, të përkohshme apo të përhershme. [...] Kjo çështje është në mënyrë efektive e simuluar. Mbi këtë bazë nuk është e përshtatshme për të bërë ndonjë qëllim të mëtejshëm mbi masat e përkohshme, ose të vazhdojë për të shqyrtuar kërkesën".*

IX. Rregulla 55 (9) është i ngjashme me Rregullën 55, duke siguruar që masat e përkohshme do të përfundojnë menjëherë, kur Gjykata e përcakton kërkesën si të papranueshme. Dallimi është se këtu masa e përkohshme skadon automatikisht, kur Gjykata jep një vendim përfundimtar në një rekomandim. Arsyeja e skadimit automatik pas gjykimit të kërkesës është se qëllimi i masave të përkohshme, d.m.th. për të ruajtur status quo-ja në pritje të rezultatit të kërkesës, është arritur. Megjithatë, sipas Rregullës 55, Gjykata mund të vendosë për masën për një kohë të caktuar, për shembull, në lidhje me zbatimin e duhur të aktgjykimit përfundimtar të saj nga ana e autoriteteve përkatëse.

[501] Vendimi për të hedhur poshtë kërkesën në Rastin nr. KI 11/09, Tomë Krasniqi, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/12 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe nenit 20.1 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02 / L-47, 30 Maj 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 230; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Neni 28 [Shpenzimet procedurale]

28.1 Palët i bartin shpenzimet e tyre të procedurës, përveç nëse Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.
28.2 Pala e cila ka ngritur kërkesë sipas nenit 113, pika 7 të Kushtetutës lirohet nga detyrimi për mbulimin e shpenzimeve të procedurës nëse Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa në fjalë është e lejueshme dhe e bazuar.

Duket të jetë e arsyeshme të supozojmë se shpenzimet procedurale përfshijnë shpenzimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe shpenzimet tjera, duke përfshirë kompensimin për humbjen e të ardhurave. Pagesat e tilla janë përcaktuar në paragrafin 4 të Rregullës 46 [Thirrjet e dëshmitarëve], paragrafi 4 i Rregullës 48 [Raporti i Ekspertit] dhe 50 [Rimbursimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve] të Rregullores së Punës. Komentet në nenin 28, pra, duhet lexuar së bashku me komentet në këtë Rregull.

1 Që palët në procedurat gjyqësore duhet të mbulojnë shpenzimet e tyre të procedurës është një parim i pranuar gjerësisht[502]. Neni 28.1 i Ligjit përmban një rregull të ngjashëm, duke siguruar që palët mbulojnë shpenzimet e tyre të procedurës, që do të thotë të gjitha shpenzimet e bëra për procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, neni përcakton gjithashtu, pa e shtjelluar, që Gjykata mund të bëjë përjashtime nga Rregulla. Nëse këtë mund ta bëjë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të një pale, në një masë të caktuar dhe në cilën fazë të procedurës, nuk është e qartë. Për më tepër, duke supozuar se Gjykata vendos ndryshe, neni nuk e përkufizon kush do të paguajë faturën. Gjykata ose pala tjetër apo edhe një palë e tretë? Vetëm Neni 28.2 parashikon një rast të veçantë, kur Gjykata mund të përjashtojë palën që ka bërë një kërkesë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nga pagesa e shpenzimeve procedurale.

2 Sigurisht që është e drejtë dhe e përshtatshme që institucionet publike të përfshira në ndonjë nga referimet para Gjykatës të paguajnë shpenzimet e veta procedurale, pasi që këto shpenzime janë të mbuluara zakonisht nga buxhetet e tyre. Megjithatë, individët (dhe personat juridikë), të cilët i referojnë Gjykatës shkeljet e supozuara të Kushtetutës, nuk munden gjithmonë të kenë mjetet e nevojshme financiare për të mbuluar shpenzimet e tyre procedurale. Për shembull, kur referimi është kompleks, pagesa e tarifave për ndihmë juridike profesionale mund të jetë e nevojshme. Megjithatë, neni 28.2 kufizon mundësinë e një individi i cili do të përjashtohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale në situatën ku Gjykata ka vendosur se kërkesa është e pranueshme dhe e bazuar. Kjo mund të jetë e padrejtë në një referim, ku pala e paditur është autoritet publik i cili mund të përdor shërbimet e juristëve të tij ose të një firme juridike dhe të paguajë kompensim për dëshmitarët dhe ekspertët të cilët kanë qenë të lejuara për t'u dëgjuar nga Gjykata.
Pasi që një individ mundet rrallë të jetë në të njëjtin pozicion, një situatë e tillë mund të krijojë një çekuilibër serioz midis pozicionit të palëve para Gjykatës dhe lehtë të shpie në një shkelje të parimit të barazisë së armëve. Në qoftë se një

[502] Shih, për shembull, Kapitullin XXV [Shpenzimet procedurale] të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

individ i tillë kualifikohet vetëm për një përjashtim nga pagesa e shpenzimeve të tij/saj procedurale, pasi që kërkesa e tij/saj është deklaruar e pranueshme dhe e bazuar, kjo do të thotë se një parashtrues pa mjete të mjaftueshme financiare mund të ketë një disavantazh serioz në paraqitjen e rastit të tij/saj para Gjykatës, në veçanti, në qoftë se, siç u përmend më sipër, çështja është komplekse dhe do të duhet ekspertizë për të ndërtuar atë dhe si kundër-balancë ekspertizës të paraqitur nga pala e paditur.

Duke mos e humbur pozitën e njëjtë ose të ngjashme para Gjykatës, individi mund të rrezikojë që kërkesa e tij /saj të shpallet e papranueshme ose e pa bazuar. Prandaj, do të ishte me vlerë për të reflektuar nëse mund të parashikohet një procedurë, ku një individ mund të kualifikohet për ndihmë juridike falas të paktën pasi që referimi të jetë deklaruar i pranueshëm në mënyrë që të dyja palët të kenë pozitën e njëjtë ose të ngjashme para Gjykatës në fazën e procedurës të shqyrtimit të rastit.

Sa i përket shpenzimeve procedurale të nenit 28.2, nuk është e qartë nëse ato do të përballohen nga Gjykata, në mënyrë të ngjashme me nenin 471 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, duke siguruar se "Nëse pala është liruar nga të gjitha shpenzimet, atëherë gjykata do të paguajë për të gjitha shpenzimet e bëra për dëshmitarët, ekspertët, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, publikimet e gjykatës, si dhe për shpenzimet për përfaqësuesit e caktuar". Deri më tani, asnjë kërkesë e tillë nuk është paraqitur në Gjykatë. Në çdo rast, do të ishte e logjikshme që pala përgjegjëse të mbulon shpenzimet procedurale, siç është rasti në bazë të nenit 452 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore[503]. Pasi që pala e paditur për çështjen e ngritur, në bazë të nenit 113.7, është normalisht një autoritet publik, mund të jetë e arsyeshme për Gjykatën të imponojë pagimin e shpenzimeve procedurale të ankuesit për autoritetin publik në fjalë. Megjithatë, në qoftë se gjykata konstaton se, për shembull, Gjykata Supreme ka lëshuar një vendim i cili shkel të drejtat kushtetuese, do të ishte e vështirë për Gjykatën që të imponojë pagimin e shpenzimeve procedurale të kërkuesit në Gjykatën Supreme, e cila nuk ka qenë një palë në procedurë. Në atë rast, Gjykata do të mbulojë vetë këto shpenzime procedurale. Deri tani, Gjykata me sa duket nuk është marrë me këtë çështje.

Është rregull e GJEDNJ që gjithashtu të merret me pozitën e pabarabartë të parashtruesit dhe të Palës Kontraktuese në procedurën para saj. Kryetari i Dhomës mund të japë ndihmë ligjore falas, sipas parashtresës së tij/saj ose me kërkesë të parashtruesit, kur kërkesa i është komunikuar Palës së paditur Kontraktuese (Qeveria e shtetit kundër të cilit ankesa është paraqitur). Kryetari do të bëjë këtë, nëse është e nevojshme për zbatimin e drejtë të procedurës dhe nëse parashtruesi ka mjete të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve të shkaktuara[504].

[503] Neni 452 (1) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore parasheh: "pala që humb rastin ka për të mbuluar plotësisht të gjitha shpenzimet e palës fituese, si dhe shpenzimet e ndërmjetësve të cilët u bashkuan procedurës".

[504] Shih Kapitullin X [Ndihma juridike] të Rregullores së GJEDN.

Kreu III: Procedurat e veçanta

Në nenin e saj 113.1, Kushtetuta parashikon, siç u përmend më lartë, se Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore, nga pala e autorizuar. Kjo dispozitë nënkupton që juridiksioni i Gjykatës mund të ushtrohet vetëm brenda kuadrit të rregullave procedurale të përcaktuara me ligj. Pasi që procedurat ex officio nga ana e Gjykatës nuk janë përmendur në këto rregulla, procedurat e tilla duhet përjashtuar.
Ky Kapitull i Ligjit përcakton detajet e procedurave të veçanta që duhet të ndiqen nga Gjykata për gjykimin e çështjeve të veçanta, të renditura nga neni 113.2 deri në nenin 113.9 të Kushtetutës dhe që u janë referuar palët e autorizuara në fjalë. Procedurat e veçanta për secilën prej këtyre çështjeve duhet të konsiderohen si "lex specialis" dhe janë të përcaktuara në nenet 29 deri në nenin 54 të Ligjit që në mënyrë të qartë tregojnë, siç është diskutuar në detaje paskëtaj, që shqyrtimi abstrakt, shqyrtimi konkret, dhe procedurat e ankesave individuale bashkëjetojnë në Republikën e Kosovës.
Në vende të tjera, si Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, procedura të ngjashme të veçanta janë përcaktuar në kushtetutë dhe ligj dhe do të komentohen sipas rastit.

1. Procedura në rastet e përcaktuara në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës:

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Në Kosovë, vetëm Gjykata Kushtetuese ka fuqinë për të vendosur nëse një ligj, një dekret i Presidentit, ose Kryeministrit, rregulloret e qeverisë, apo statutet komunale janë në kundërshtim me Kushtetutën (i ashtuquajturi "kontroll abstrakt"). Asnjë gjykatë e rregullt nuk ka pushtet të tillë, por ka vetëm të drejtën, që në kushte të caktuara, siç përcaktohet në nenin 113.8, e komentuar paskëtaj, të referojë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji në Gjykatë, në rast konkret në pritje para saj. Vetëm Kuvendi, Presidenti i Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të iniciojnë procedura para Gjykatës në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën e ligjeve, Dekretet Presidenciale apo të Kryeministrit, Rregulloret e Qeverisë, dhe Statutet Komunale, në abstrakt.
Prandaj, si mbrojtës të kushtetutshmërisë së akteve normative, këto institucione janë të lejuara në bazë të Kushtetutës për të ju drejtuar direkt Gjykatës në rrethanat e

mësipërme pa u zbatuar pa u zbatuar aktet e tilla normative në ndonjë grup konkret të fakteve. Në këtë kuptim, Gjykata është e detyruar të refuzojë si të papranueshme çdo kërkesë që është paraqitur drejtpërdrejtë, dhe pa marrë parasysh zbatimin e akteve të tilla në ndonjë grup konkret të fakteve, nga ndonjë person tjetër që nuk është një palë e autorizuar, sipas Nenit 113.2 të Kushtetutës.
Nenet 113.2.1 dhe 113.2.2 të Kushtetutës zbatohen nga nenet 29 [Saktësia e kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit.

Neni 29 [Saktësimi i kërkesës]

29.1 Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti I Republikës se Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.
29.2 Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikoje, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen te jene ne kundërshtim me Kushtetutën.
29.3 Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

1. Neni 29.1 zbaton nenin 113.2 të Kushtetutës, duke ritheksuar se cilat janë palët e autorizuara, në veçanti, duke ofruar numrin minimal të deputetëve të Kuvendit të nevojshëm për të qenë në gjendje të parashtrojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për kushtetutshmërinë e ligjeve të Kuvendit, dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë, si dhe statutet komunale. Pra, palët e autorizuara janë:
a) Një e katërta (1/4), që do të thotë, të paktën, tridhjetë (30) deputetë;
b) Presidenti i Republikës;
c) Qeveria e Republikës, ose
d) Avokati i Popullit.
Nëse një kërkesë është dorëzuar në Gjykatë nga një ose më shumë palë të lartpërmendura, Gjykata nuk mund ta refuzojë kërkesën si të papranueshme, me kusht që të gjitha kushtet tjera procedurale të jenë përmbushur. Nëse një kërkesë e tillë i dorëzohet Gjykatës nga një individ ose një institucion tjetër përveç palëve të autorizuara më lartë, Gjykata do ta refuzojë kërkesën si të papranueshme për arsye se Kërkesa është parashtruar nga personi i paautorizuar.[505]
Në fakt, neni 29.1 i siguron opozitës dhe/ose minoriteteve në Kuvend, nëse përbëhen nga së paku tridhjetë (30) deputetë, me një instrument të fuqishëm për të ngritur çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të instrumenteve ligjore të cekura më lartë, nëse ata i konsiderojnë ato të jenë jo kushtetuese. Në veçanti, në lidhje me një ligj të miratuar me shumicën e deputetëve kundër dëshirave të

[505] Shih Rregullin 36 par. 3 pika c, të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese që përcakton detajet e kritereve të pranueshmërisë.

opozitës (që votuan kundër ligjit, për shembull, për shkak se ata e konsideruan tashmë se është jo kushtetues), ky instrument do të ishte shumë i dobishëm.

Pra, tridhjetë a më shumë deputetë do të mund të kenë mundësinë për të ushtruar një kontroll të caktuar politik mbi shumicën në Kuvend, pasi që mund të ndalojnë Gjykatën Kushtetuese, sipas Nenit 29 të Ligjit, në bazë të kundërshtimeve, të ngjashme si ato që ata kishin paraqitur më parë në Kuvend para se shumica të ketë miratuar ligjin. Vërejtjet kushtetuese të pakicës kundër aktit të kontestuar, të cilat shumica i kishte refuzuar (për shembull, për arsye thjesht politike) mund edhe të pranohen nga Gjykata dhe të rezultojnë që një ligj ose pjesët e tyre të janë gjetur si jo kushtetuese. Opozita, në këtë shembull, pra, do të rezultojë më e fortë se shumica e deputetëve të Kuvendit.

Një shembull tjetër mund të jetë që shumica do të miratojë në heshtje një dekret të caktuar Presidencial ose Kryeministror ose një rregullore të veçantë të Qeverisë për arsye thjesht politike, në këtë mënyrë duke e privuar opozitën dhe / ose minoritetet të cilët janë kundër dekretit ose rregullores mbi baza kushtetuese, nga e drejta e tyre që të shprehin mendimin e tyre për instrumentet e sfiduara në Kuvend dhe të votojnë kundër tyre. Gjithashtu, në raste të tilla, opozita dhe / ose minoritetet do të mund të jenë të suksesshme duke dorëzuar një kërkesë të tillë në Gjykatën Kushtetuese. Skenarë të ngjashëm janë të mundshëm në lidhje me statutet komunale.

Neni 29.1 gjithashtu i mundëson Presidentit të Republikës të ushtrojë kontrollin kushtetues, përmes Gjykatës Kushtetuese, mbi ligjet e Kuvendit, dekretet Kryeministrore dhe rregulloreve të Qeverisë, si dhe statutet komunale.[506] Qeveria ka kompetenca të ngjashme, për shembull mund të sfidojnë kushtetutshmërinë e një ligji të miratuar nga Kuvendi, të iniciuar nga Qeveria, në rast se ligji shtrembërohet në mënyrë të tillë nga Kuvendi sa që kushtetutshmëria e versionit, që ky i fundit në fund e miratoi, është bërë e diskutueshme.

Së fundmi, neni 29.1 gjithashtu specifikon kompetencat e Avokatit të Popullit[507] për të ngritur drejtpërdrejt në Gjykatën çështjen e përputhshmërisë kushtetuese të instrumenteve përkatëse ligjore. Një numër i vendeve lejojnë që Ombudspersoni të sfidojë aktet normative para gjykatave kushtetuese (p.sh. Shqipëria, Armenia, Gjeorgjia, Estonia, Moldavia, Polonia, Portugalia, Rumania, Rusia dhe Spanja). Pasi që Kushtetuta parashikon se Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e paligjshme dhe të gabuara, ose dështimet për

[506] Shih për shembull Rastin nr. KO 80/10, Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit z. Qazim Qeska, Aktgjykim i datës 7 tetor 2010. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2009 – 2010*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2011. Rasti nr. KO 57/12, Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/l-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës", Aktgjykim i datës 22 tetor 2012. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2012, Vëllimi II*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2013.

[507] Shih gjithashtu nenin 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], paragrafi 4 i Kapitullit XII të Kushtetutës, Institucionet e Pavarura, duke përcaktuar: "Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

të vepruar të autoriteteve publike[508] ai / ajo ka tani një mjet të fuqishëm shtesë në bazë të nenit 113.2 të Kushtetutës për të sfiduar para Gjykatës kushtetutshmërinë e ligjeve, dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit, rregulloreve të Qeverisë, si dhe statutet komunale.

Mirëpo, deri tani, Avokati i Popullit ka paraqitur vetëm disa kërkesa për shqyrtim kushtetues në bazë të nenit 29 të ligjit në lidhje me nenin 113.2 të Kushtetutës[509].

Me përjashtim të kompetencave sipas këtyre neneve të Kushtetutës dhe të Ligjit, Institucioni i Ombudspersonit dhe kompetencat e tij janë të rregullara me Ligjin Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, i shpallur më 9 gusht 2010. Ky shfuqizon Rregulloren përkatëse të UNMIK-ut, si dhe dispozitat e tjera të cilat ishin në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 15 [Kompetencat], paragrafi 7, të Kapitulli III [Fuqitë dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, i zbaton kompetencat e tij / saj sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, duke përcaktuar se Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Kjo është për të shpresuar se, sipas ligjit të ri, Ombudspersoni do të përdor sa më shumë të jetë e mundur kompetencat që iu dhanë atij / asaj nga këto instrumente ligjore në interes të popullit të Kosovës.

2. Në kërkesë, palët e autorizuara duhet të përmendin, sipas nenit 29.2, nëse e konsiderojnë tërë aktin (aktin normativ) e sfiduar ose një apo më shumë dispozita të veçanta të aktit si jo kushtetuese. Në disa demokraci, ku kontrollet dhe balancat zakonisht janë ndërtuar në pothuajse çdo segment të shoqërisë, rrallë mund të ndodhë që një ligj i tërë, i miratuar nga Kuvendi, do të duhet të anulohet nga gjykata për shkak të papajtueshmërisë së tij me Kushtetutën. Kur një ligj i tërë është hedhë poshtë nga Gjykata, sigurisht se rregullon disa çështje mjaft të diskutueshme, të cilat tashmë kishin ndarë opinionin e deputetëve (dhe ndoshta edhe qytetarët) para miratimit të ligjit për shembull, si një ligj mbi abortin. Ose ligji mund të ketë qenë diskriminues ose në kundërshtim me një instrument ndërkombëtar.

Në një rast të tillë, një e katërta (¼) apo më shumë deputetë të Kuvendit (pa dyshim kontestuesit më të egër të aktit të kontestuar të cilët dëshirojnë të vazhdojnë betejën politike në nivel kushtetues), Presidenti dhe/ose Avokati i Popullit mund të sfidojnë kushtetutshmërinë e tërë ligjit apo vetëm pjesët e tyre.

Çuditërisht, Ligji dhe Rregullorja e Punës nuk përmbajnë ndonjë dispozitë specifike, që përcakton se kush do të mund të marrë pjesë në procedurën para Gjykatës përveç kërkuesit. Për shembull, në qoftë se Presidenti i Kosovës e dorëzon një kërkesë në Gjykatë sipas nenit 113.2 të Kushtetutës, me të cilin ai / ajo e sfidon, për shembull, kushtetutshmërinë e ligjit të nxjerrë nga Kuvendi, do të ishte e përshtatshme në qoftë se Kuvendi dhe përfundimisht Qeveria (normalisht autori i ligjit të kontestuar) do të konsiderohen si palët reaguese dhe do të

[508] Shih, Nenin 132 [Roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit], paragrafi 1, të Kushtetutës, që parasheh: "Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike".

[509] Shih për shembull ktgjykim i datws 26 dhjetor 2012. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2012, Vëllimi II.* Prishtin PRAKTIKËS GJYQËSORE 2012, Vëllimi II t të Popullit].

bashkohen me procedurën me ftesën e Gjykatës. Në një rast të tillë, Kryetari i Kuvendit do të përfaqësojë Kuvendin i cili e miratoi ligjin, si dhe Kryeministrin ose përfaqësuesit tjerë të Qeverisë. Gjykata është natyrisht e lirë për të ftuar palët tjera (të interesuara) në procedurë (me shkrim ose me gojë), nëse e gjykon të arsyeshme.

3. Sipas nenit 29.3, pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin e kontestuar ose pjesët e tij të cilat i konsideron të papajtueshme me Kushtetutën dhe duhet të japë arsyet se pse e konsideron aktin ose pjesët e tillë e tij të jenë jo kushtetuese.[510] Se sa duhet të jenë të detajuara kundërshtimet, e dorëzuara nga cilado palë e autorizuar në Gjykatë, varet nga kompleksiteti i çështjeve të ngritura nga akti i kontestuar[511].

Neni 30 [Afatet]

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

Palët e autorizuara duhet të ngrehin çështjen e pajtueshmërisë para Gjykatës brenda gjashtë (6) muajve nga data në të cilën akti i kontestuar ka hyrë në fuqi. Kjo do t'i japë palës së autorizuar kohë të mjaftueshme për të përgatitur siç duhet kërkesën, por edhe do të ishte më e preferueshme (për hir të sigurisë ligjore), në qoftë se ata do të marrin më pak kohë dhe angazhojnë Gjykatën sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që akti i kontestuar – nëse konstatohet të jetë jo kushtetues - të jetë në fuqi vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme. Megjithatë, në mënyrë që të shmangen efektet e padëshiruara që përbëjnë dëme të pariparueshme, ose në qoftë se do të jetë në interes të publikut, Gjykata mundet gjithashtu - sipas *ex offcio* ose me kërkesë të palës së autorizuar - të suspendojë aktin ose ligjin e kontestuar dhe të vendosë një masë të përkohshme, deri sa të merret vendimi përfundimtar për kërkesën (shih për detaje, komentet në nenin 27 [Masa të Përkohshme] dhe nenin 116 [Efekti juridik i Vendimeve], paragrafi 2, të Kushtetutës[512], më lart).

Praktika gjyqësore përkatëse

Një shembull i një pale të autorizuar që, në bazë të nenit 113.2 të Kushtetutës i ka referuar në Gjykatë pyetjet e pajtueshmërisë me Kushtetutën e ligjeve, dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, si dhe statuteve komunale, është si vijon:

---

[510] Për procedurën e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese shih nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

[511] Për më shumë mbi shqyrtimin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve normative, shih Jackson, Vicki C., and Mark V. Tushnet. *Comparative constitutional law*. New York: Foundation Press, 1999.

[512] Neni 116.2 i Kushtetutës parashikon*: "Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme".*

Lënda Nr. KO 119/10 e datës 8 dhjetor 2011, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 14 (1) 6, 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, Nr. 03 / L-111 e 4 qershor 2010, ku Avokat i Popullit kërkoi nga Gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e neneve të mësipërme të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve[513].
Gjykata u shpreh se kërkesa ishte e pranueshme, sepse Avokati i Popullit ishte i autorizuar nga nenet 113.2 dhe 113.4 të Kushtetutës për të bërë kërkesën, dhe se kërkesa është paraqitur brenda afatit 6-mujor të përcaktuar në nenin 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të sfiduar. Gjykata vendosi, ndër të tjera, se marrëveshja e pensioneve për deputetët ishte i papajtueshëm me Kushtetutën.

2. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 3 (1) të Kushtetutës

> **Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim para Gjykatës Kushtetuese:**
> **(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;**

Para se të komentohet shkurtimisht neni 113.3 (1) i Kushtetutës, një fjalë duhet të thuhet në lidhje me Kuvendin, të përmendur në nenin 113.3, si një nga palët e autorizuara. Ndryshe nga neni 113.2 i Kushtetutës, i cili gjithashtu përmend Kuvendin si palë e autorizuar, por që implementohet nga neni 29 i ligjit, që shpreh se me "Kuvend", si palë e autorizuar është menduar "një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit", kjo qartësi nuk ekziston në lidhje me nenin 113.3, pasi që ligji nuk tregon fare, se sa deputetë janë të nevojshëm që të jetë në gjendje që në mënyrë të ligjshme të paraqesë kërkesë në Gjykatë sipas nën-paragrafëve (1)deri (5) të nenit. Prandaj, çështja do të diskutohet në çdo nën-paragraf, nëse termi "Kuvend" do të mund të interpretohet në një mënyrë të caktuar, në mungesë të çfarëdo legjislacioni implementues për këtë qëllim.
Sa i përket tekstit të nenit 113.3 (1) vetë, ai përmban kompetencën klasike të një gjykate kushtetuese, pra, për t'u marrë me konfliktet e kompetencave mes institucioneve të ndryshme shtetërore, bazuar në parimin e "ndarjes së pushteteve" midis legjislaturës dhe ekzekutivit, që përbëhet nga të dyja, Presidentit të Kosovës dhe Qeverisë).
Neni 113.3 (1) i Kushtetutës zbatohet nga nenet 31 dhe 32 të Ligjit.

[513] Shih për tekstin e plotë të Aktgjykimit: *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2011*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2012, faqe 556, ose në faqen e internetit të Gjykatës: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ko_119_10_eng.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Neni 31 [Saktësimi i kërkesës]

> **Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar dhe që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me Rregullën e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.**

Në bazë të Neni 113.3 (1) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për konfliktet e mundshme të kompetencave kushtetuese ndërmjet Kuvendit, Presidentit të Kosovës dhe Qeverisë, në qoftë se një nga këto institucione i paraqet Gjykatës një kërkesë, duke pretenduar se një nga institucionet tjera, me anë të veprimeve të saja, i ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara në Kushtetutën ose ka marrë përsipër kompetencat e një ose më shumë institucioneve të tjera. Kjo do të thotë se roli i Gjykatës Kushtetuese është të qartësojë sistemin e kompetencave institucionale të Kushtetutës, dhe kështu të ruajë funksionimin dhe aftësinë për të funksionuar të institucioneve shtetërore në një vend bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit.
Neni 113.3 (1) i Kushtetutës numëron institucionet shtetërore që kanë të drejtë ligjore që të paraqesin kërkesa në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me një konflikt mbi kompetencat kushtetuese. Vetëm Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria janë të autorizuar të paraqesin një kërkesë pranë Gjykatës në rast të një konflikti të tillë. Në këtë drejtim, neni 31 i Ligjit nuk i përmend institucionet, por vetëm flet për *"çdo palë të autorizuar në konflikt ose nga çdo palë e autorizuar të prekur drejtpërdrejt nga konflikti në fjalë"*.
Në një konflikt rreth kompetencave ndërmjet këtyre institucioneve shtetërore, si të sugjeruara tashmë me fjalën "konflikt", të paktën dy palë konfrontohen me njëri-tjetrin, njëri që vepron si një parashtrues i kërkesës dhe tjetri si palë në përgjigjen para Gjykatës Kushtetuese apo anasjelltas. Konflikti midis këtyre institucioneve është, pra, një procedurë kontestuese në lidhje me marrëdhëniet kushtetuese ekzistuese ndërmjet kërkuesit dhe palës reaguese. Gjykimi i mosmarrëveshjes në mes të këtyre institucioneve nuk ka të bëjë me shqyrtim abstrakt të kushtetutshmërisë objektive të një akti të veçantë të institucionit të kontestuar, por është menduar më tepër të qartësojë përcaktimin e kompetencave të këtij institucioni, kur të ketë kryer aktin.
Gjatë vendimmarrjes për një konflikt të kompetencave kushtetuese të institucioneve të lartpërmendura, Gjykata duhet të interpretojë Kushtetutën për sa i përket kompetencave të institucioneve të përfshira në konflikt dhe, ndoshta, palëve të tjera të prekura nga konflikti. Gjykata duhet të vendosë, nëse institucioni, i kontestuar nga pala e autorizuar, ka vepruar në kuadër të kompetencave të veta kushtetuese, apo i ka tejkaluar ato. Për sa i përket palëve, të autorizuara që të parashtrojnë kërkesë në bazë të nenit 31 të Ligjit, dispozita nuk arrin të përcaktojë se në çfarë mënyre Kuvendi, si palë e autorizuar, duhet t'i drejtohet Gjykatës. Në fakt, ka tre mundësi:

(1) vendimi i Kuvendit për t'iu drejtuar Gjykatës për një çështje të kompetencës në bazë të nenit 113.3 (1) të Kushtetutës duhet të konsiderohet si një vendim që rregullohet me nenin 80 [Miratimi i Ligjeve], paragrafi 1[514], të Kushtetutës dhe për

[514] Neni 80.1 i Ligjit thotë si në vijim: 1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.

këtë arsye, duhet të miratohet, “me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë” (në këtë rast, shumica do të përfaqësohen para Gjykatës nga ana e Kryetarit të Kuvendit); ose

(2) Kuvendi voton me shumicë votash se nuk ka asnjë çështje të kompetencës në mes të Kuvendit dhe, për shembull, Qeverisë. Megjithatë, në këtë rast të veçantë, pakica e Kuvendit mund të mos pajtohet me këtë vendim të shumicës, sepse është e mendimit se është vërtetë një çështje kushtetuese në mes të Kuvendit dhe (në këtë shembull) të Qeverisë, që duhet të parashtrohet në Gjykatën për gjykim. Në këtë shembull, pakica (në fakt: të paktën dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit) do të mund të shfrytëzojnë mundësinë sipas nenit 113.5 të Kushtetutës (shih edhe komentet për këtë nen këtu e tutje) për të kontestuar kushtetutshmërinë e çdo vendimi të miratuar nga Kuvendi. Pra, pjesa më e madhe si dhe një pakicë prej 10 apo më shumë deputetëve do të kenë të njëjtën të drejtë në bazë të nenit 113.3 (1) për t’iu drejtuar Gjykatës në një konflikt të kompetencave me Presidentin ose Qeverinë. Nëse nuk votohet fare, situata duket të jetë e bllokuar, duke hapur mundësinë për një opsion të tretë.

(3) Mundësia e tretë është që numri i deputetëve të autorizuar t’i drejtohen Gjykatës në një konflikt të kompetencës, do të mund të jetë i ngjashëm me numrin e nevojshëm që të iniciojë procedurën e shqyrtimit kushtetues në lidhje me pajtueshmërinë e akteve normative të përmendura sipas nenit 113.2 (1) dhe (2) të zbatuar nga Neni 29 i Ligjit. Kjo do të thotë se kërkesa në bazë të nenit 31 të Ligjit, do të mundet në mënyrë të ngjashme, të dorëzohet në Gjykatë nga të paktën një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit.

Përderisa në vendet tjera, kjo çështje është trajtuar në mënyrë më të qartë, për shembull, në Kushtetutën e Bosnjës dhe Hercegovinës, anëtarët e Kuvendit si iniciatorët e procedurës para Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë janë të përcaktuara në mënyrë të qartë[515], në Kosovë kjo i lihet për interpretim Gjykatës Kushtetuese, sa herë që një kërkesë e tillë do të dorëzohet që është plotësisht në pajtim me Kushtetutën[516].

Neni 31, më në fund parashikon se përfshirja në kërkesë e çdo informate përkatëse në lidhje me konfliktin e supozuar do të përcaktohet me Rregullën e Punës së Gjykatës.

Detajet e informatave të tilla përkatëse gjenden në Rregullën 67 [Kërkesa] të Rregullores së Punës.

[515] Neni VI.3 i Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës përcakton se "palët e autorizuara për paraqitjen në Gjykatën Kushtetuese të kërkesës për shqyrtimin e kushtetutshmërisë në lidhje me konfliktin e kompetencave janë kryetari i Zëvendës kryesuesit të çdo Dhome të Asamblesë Parlamentare, një e katërta e çdo Dhome të Asamblesë Parlamentare, apo një e katërta e Anëtarëve të çdo Dhome të Legjislativit të Subjekteve”.

[516] Neni 112 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës thotë si më poshtë: "1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën".

Rregulli 67 [Kërkesa] i Rregullores së punës

1. **Kur parashtron kërkesën në pajtim me nenin 113, paragrafi 3, pika 1, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Kosovës.**
2. **Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili supozohet se shkel kompetencën e saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.**

Kërkesa në Gjykatë për të iniciuar një konflikt të kompetencave kushtetuese ndërmjet palëve të autorizuara duhet të përshkruajë detajet e një konflikti të tillë, të identifikojë aktin e sfiduar dhe Nenin(et) e Kushtetutës, të cenuar nga ai akt. Kjo do të thotë se nëse Kuvendi, Kryetari, ose Qeveria ngreh një çështje të kompetencës në Gjykatën Kushtetuese, pala e autorizuar domosdoshmërisht duhet të japë detaje në lidhje me mënyrën në të cilën institucioni tjetër ka shkelur kompetencat specifike të palës së autorizuar dhe të përfshijnë dëshmi të mjaftueshme që dëshmon se kompetencat që dyshohet se janë shkelur janë kompetencat që i janë dhënë palës së autorizuar me Kushtetutë. Pala kundërshtare duhet, pra, të tregojë se ajo nuk ka tejkaluar kompetencat, që iu atribuuan asaj sipas neneve përkatëse të Kushtetutës dhe të paraqesë prova për këtë qëllim, ku është e nevojshme. Gjatë gjykimit të kërkesës, Gjykata mund të vendosë të përfshijë të gjitha palët e autorizuar të përmendura në nenin 113.3 (1) të Kushtetutës, në mënyrë të veçantë, në qoftë se shkelja e pretenduar ka prekur ata të gjithë, në varësi të rrethanave.

Neni 32 [Afatet]

Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 31 te këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Kërkesa për shqyrtimin e kushtetutshmërisë në rast të konfliktit të kompetencave në mes të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë- paraqiten në Gjykatën Kushtetuese nga çdo palë e autorizuar, duhet të paraqitet në gjykatë brenda gjashtë (6) muajve nga data në të cilën konflikti i dyshuar i kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë ka ndodhur. Për arsye të ngjashme të shkaktuara më lart, kur të komentohet afati kohor i paraparë me nenin 30, ky afat që zgjat në mënyrë të arsyeshme është i rëndësishëm për të siguruar qartësinë ligjore dhe sigurinë ligjore dhe t'i lihet palës së autorizuar kohë e mjaftueshme për të përgatitur një rekomandim të bazuar.
Megjithatë, është më se e mundshme që pasojat e tejkalimit të kompetencave nga njëra palë mund të mos jetë gjithmonë e qartë që në fillim, pasi që mund të duhet pak kohë përpara se pala tjetër të mund të bëhet e vetëdijshme për këtë. Sigurisht, në qoftë se një konflikt i kompetencave në mes të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Qeverisë nuk është vënë re nga ndonjëra palë, kjo do të venitet me kalimin e kohës, pasi që afati merr formë të prerë dhe nuk lejon kthimin në status quo ante.

Praktika gjyqësore përkatëse

Kërkesa e parë e paraqitur në Gjykatë që kishte të bëjë me çështjen e sqarimit të kompetencave, ishte kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, për sqarim të kompetencave në rastin e Kryetarit të komunës së Rahovecit[517].
Presidenti i Kosovës ka paraqitur kërkesë duke kërkuar nga Gjykata një sqarim se cili institucion "... është përgjegjës për të vlerësuar efektshmërinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe të vlerësojë ndërprerjen eventuale të mandatit të kryetarit të komunës në bazë të një komunikate të lëshuar qytetarëve të vet... "Presidenti kërkoi këtë sqarim bazuar në rastin e dorëheqjes së kryetarit të Rahovecit përmes një njoftimi për shtyp, rikonfirmimin e dorëheqjes së tillë nga Ministria e Pushtetit Lokal, dhe më pas nga revokimi i kësaj dorëheqjeje nga vetë kryetari i komunës. Presidenti pohoi se kompetencat e institucioneve përkatëse në përcaktimin e vlefshmërisë së dorëheqjes dhe përfundimin e mandatit të kryetarit të komunës janë të paqarta, dhe si pasojë, ai si President "... nuk mund të veprojë tutje në përputhje me parimin kushtetues të zgjedhjeve të lira dhe të barabarta, të parashikuara në nenin 123 (2) të Kushtetutës për sa i përket zgjedhjeve komunale”.
Në këtë rast, Gjykata vendosi që kërkesa është e pranueshme, bazuar në autorizimet e Presidentit me Kushtetutë për të ngritur çështje të tilla kushtetuese para Gjykatës. Gjykata ka vendosur se dorëheqja e kryetarit të caktuar është përfundimtare dhe definitive dhe shënon përfundimin e mandatit të tij / saj bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe se pasojat kushtetuese të veprimit të tillë janë shpallja e zgjedhjeve të reja nga Presidenti për të siguruar që qytetarët të gëzojnë të drejtën e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme kur të themelojnë vetëqeverisjen e tyre lokale.
Një tjetër shembull i një kërkesë të paraqitur në Gjykatë nga një palë e autorizuar sipas nenit 93,10 dhe nenit 113.3 (1) të Kushtetutës është Rasti 98/11 të datës 20 shtator 2011[518], kur Qeveria si parashtrues i kërkesës ka kërkuar një interpretim të imuniteteve që i janë dhënë Presidentit të Kosovës, Deputetëve të Kuvendit dhe Anëtarëve të Qeverisë, duke specifikuar nenet 89, 75.2 dhe 98 të Kushtetutës.
Gjykata u shpreh se kërkesa ishte e pranueshme, duke përfunduar se Kryeministri ishte palë e autorizuar sipas nenit 113.3 (1), sepse pyetja ngriti një çështje në lidhje me kompetencat e Presidentit, Deputetëve të Kuvendit dhe të Anëtarëve të Qeverisë për të kryer kushtetuese funksionon e tyre në mënyrë të pavarur, duke vënë në dukje se Kapitulli III i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nuk jep afate kohore sipas nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafi 10.
Mbi meritat, Gjykata u shpreh, ndër të tjera, se Nenet 7 [Vlerat], paragrafi 1, nenet 89 [Imuniteti] dhe 98 [Imuniteti] të Kushtetutës i mundësojnë Presidentit, Deputetëve të Kuvendit dhe Anëtarëve të Qeverisë imunitetin funksional për veprimet e ndërmarra apo vendimet që merren brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre, që përfshijnë opinionet e shprehura, vota të hedhura apo vendimet e marra, që është me kohëzgjatje

[517] AKTGJYKIM, Rasti nr. KO 80/10, Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e Kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska, 7 tetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2011.faqe 30, në dispozicion në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/buletini%20eng.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).
[518] Shih për tekstin e plotë të Aktgjykimit: Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2012, faqe 340.

të pakufizuar. Gjykata sqaroi se shprehja "Përderisa kryen detyrat e tij / saj" nënkupton kryerjen e punës së Kuvendit gjatë takimeve plenare dhe të komisioneve.

3. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (2) të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 3 (2) të Kushtetutës

> **Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:**
> **(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;**

Mund të jetë e dobishme që shkurtimisht të shpjegohet se çfarë është një referendum dhe nga kush mund të propozohet, pasi që Kushtetuta përdor vetëm shprehjen pa shpjegime të mëtejshme.
Në përgjithësi, një referendum mund të përshkruhet si një parim apo praktikë e parashtrimit për votim popullor të një mase të miratuar ose të propozuar nga një organ legjislativ (në nivel kombëtar dhe të tjera) ose me iniciativë popullore. Natyra e një referendumi mund të ndryshojë sipas asaj nëse është i detyrueshëm ose jo i detyrueshëm dhe varet nga organi kompetent për ta thirrur atë. Referendumi është i detyrueshëm, kur tekstet e caktuara të dorëzohen automatikisht në një referendum, pas miratimit të tyre nga Kuvendi, ndërsa një referendum me kërkesën e një autoriteti mund të thirret nga Presidenti, legjislatura (një pjese të saj) ose një organi tjetër publik. Referendumi me kërkesën e një pjese të elektoratit do të ishte një opsion tjetër[519].
Kosova ka nevojë për një ligj që rregullon mbajtjen e referendumeve. Kuvendi nuk duhet të hezitojë më tej që të zbatojë nenin 2 [Sovraniteti] të Kushtetutës, duke paraparë në paragrafin 1 të saj: *"Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, referendumit dhe formave të tjera në përputhje me dispozitat e Kushtetutës"*. Kushtetuta, pra, në mënyrë të qartë njeh referendumin si një mekanizëm për ushtrimin e sovranitetit nga populli dhe ka nevojë për zbatimin e shpejtë në mënyrë që ti mundësojë popullit të Kosovës, që me anë të këshillimit popullor të marrë pjesë, sa më shumë të jetë e mundur, në miratimin e legjislacionit. Duke bërë kështu, Kuvendi duhet respektuar Kodin e Praktikës së Mirë mbi Referendumet, të miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike dhe Komisionit të Venedikut në dhjetor 2006 respektivisht tetor 2007,[520] i cila është i bazuar kryesisht në Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të miratuar nga të njëjtat organe në vitin 2002[521].

---

[519] Shih Tierney, Stephen. Constitutional referendums: the theory and practice of republican deliberation. Oxford, United Kingdom: Oxford University Press, 2012., në dispozicion në: http://dx.doi.org/10.1093/acprof:oso/9780199592791.001.000, fq. 20 (vizituar me datën 9 qershor 2014).
[520] Code of good practice on Referendums adopted by the Council for Democratic Elections at its 19th meeting (Venice, 16 December 2006) and the Venice Commission at its 70th plenary session (Venice, 16-17 March 2007). http://www.venice.coe.int /webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2007)008rev-e (vizituar me datën 9 Qershor 2014).
[521] Code of Good Practice in Electoral Matters: Guidelines and Explanatory Report - Adopted by the Venice Commission at its 51st and 52nd sessions (Venice, 5-6 July and 18-19 October 2002).

Përveç nenit 113.3 (2) të Kushtetutës dhe të nenit 2 të Kushtetutës, Kushtetuta përdor termin "referendum" edhe në disa raste të tjera. Për shembull, është përmendur edhe në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit]: "*Kuvendi i Republikës së Kosovës: [...] (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin*". Për më tepër, neni 81 i tij [Legjislacioni me Interes Vital], paragrafi 2, të Kushtetutës përmban një referencë për referendum: "*Asnjëri prej ligjeve me interes vital*[522] *nuk mund t'i nënshtrohet referendumit*". Në fund, termi është përdorur në nenin 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], paragrafi 1, të Kushtetutës, duke paraparë: "*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumet dhe shpall rezultatet e tyre".*

Edhe pse referendumi aktualisht nuk mund të mbahet në mungesë të legjislacionit të nevojshëm zbatues, mund të bëhet një mjet i fuqishëm për popullin e Kosovës për t'u konsultuar mbi çështjet, të cilat janë të rëndësishme për të, si ndryshimet kushtetuese[523]. Aktualisht, në bazë të nenit 144 [Amandamentimi], paragrafi 3, të Kushtetutës, ndryshimet në Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi që Kryetari i Kuvendit të Kosovës t'i ketë referuar ato në Gjykatën Kushtetuese për një vlerësim paraprak, që amendamentet e propozuara nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për shembull, në Rastin KO nr. 29/12 dhe 48/12, Parashtrues Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vendimi i datës 20 korrik 2012[524].

Për sa i përket zbatimit të nenit 113.3 (2) të Kushtetutës, nenet 33 dhe 34 të Ligjit përcaktojnë si në vijim:

---

http://www.venice.coe.int/_webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2002)023-e (vizituar me datën 9 Qershor 2014).

[522] Neni 81 [Legjislacioni me Interes Vital] i Kushtetutës thotë si vijon: 1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:

(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;

(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;

(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;

(4) ligjet për zgjedhjet lokale;

(5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;

(7) ligjet për arsimin;

(8) ligjet për përdorimin e simboleve, duke përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.

2. Asnjt e komuniteteve dhe për festat publike. t me komunitetet fetare;ë tyre

[523] Në Zvicër, konsultimi i popullsisë për një ndryshim të Kushtetutës është i detyrueshëm.

[524] K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12 datë 20 korrik 2012- Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012, Aktgjykim i datws 20 korrik 2012. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2012, Vëllimi II*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2013, faqe 436

Neni 33 [Saktësimi i Kërkesës]

> **Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 113, paragrafi 3, pika 2 të Kushtetutës parashtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës ose nga Qeveria. Kërkesa përmban çfarëdo informate të nevojshme në lidhje me papajtueshmërinë e supozuar me Kushtetutën dhe referendumin e propozuar ashtu siç përcaktohet me Rregullën e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.**

Siç ishte rasti me nenin 31 të Ligjit, ku u ngrit një problem i ngjashëm, neni 32 është po aq problematik, pasi që gjithashtu nuk arrin të përcaktojë se në çfarë mënyre Kuvendi mund të hap çështjen në Gjykatë. Për këtë arsye, kjo dispozitë e Ligjit gjithashtu duhet të qartësohet si dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë procedurën që Kuvendi duhet ta ndjekë për të adresuar çështjen e referendumit në Gjykatë. Siç e komentuam në nenin 31, në këtë drejtim, mund të ketë dy ose më shumë zgjidhje: për shembull, (1) për të zbatuar kriteret e nenit 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës dhe, kështu, të konsiderohet vendimi për marrjen në Gjykatë si një vendim që kërkon shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, ose (2) të zbatohen, mutatis mutandis, kriteret e nenit 29 të Ligjit, që do të thotë që një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit është e mjaftueshme për të paraqitur kërkesë.

Siç është rregull në të gjitha rastet në të cilat kërkesat janë paraqitur në gjykatë, parashtruesi i kërkesës e ka barrën për të prodhuar të gjitha dëshmitë relevante në mbështetje të kërkesës së adresuar në Gjykatë. Pra, edhe këtu, është pala e autorizuar ajo e cila ka për të mbështetur kërkesën në detaje dhe të përgjigjet në pyetjen, pse, sipas mendimit të vet / të tij / saj, referendumi i propozuar është në kundërshtim me një ose më shumë nene të veçanta të Kushtetutës dhe, prandaj, nuk duhet të mbahet.

Për sa i përket çështjes nëse ka ndonjë afat të dorëzimit të kërkesë në Gjykatë, e cila e ka qëllimin që vetëm të ndalojë mbajtjen e një referendumi të propozuar, rezulton nga neni 113.3 (2) i Kushtetutës, si dhe nenit 33 të Ligjit, që një palë e autorizuar duhet të paraqesë kërkesën përpara se të mbahet referendumi i propozuar, që domethënë, siç duket, më së largu një ditë përpara se të hapen qendrat e votimit.

Shumë vende evropiane, për shembull, Shqipëria, Armenia, Bullgaria, Qiproja, Estonia, Maqedonia, Gjeorgjia, Hungaria, Italia, Malta dhe Polonia parashohin një rishikim kushtetues të vendimeve rreth çështjes nëse duhet të organizohet apo të mos organizohet një referendum për një çështje të caktuar. Zakonisht, shqyrtimi nga një gjykatë kushtetuese ka të bëjë me pyetjen nëse pyetjet e parashtruara në referendum janë në përputhje me Kushtetutën[525].

Neni 33 i Ligjit plotësohet më tej me Rregullën 69 të Rregullores së Punës. Sidoqoftë, Rregulla përsërit përmbajtjen e fjalisë së dytë të nenit 33 të Ligjit, por nuk jep detaje të tjera për sa i përket dorëzimit të kërkesës në gjykatë, që e bënë atë të papërdorshëm.

[525] Shih për informacion të mëtejshëm mbi këtë çështje: "European Commission for Democracy through Law, Referendums in Europe- an Analysis of the Legal Rules in European States" (Venice Commission 2005). Available at:
http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDLAD(2005)034-e, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

Neni 34 [Afati]

34.1 Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetutshmërinë e referendumit të propozuar brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kërkesës.
34.2 Referendumi, i cili është objekt i kërkesës se ngritur ne baze te nenit 33 te këtij ligji mbahet vetëm pasi që Gjykata Kushtetuese vendos se referendumi i propozuar është në pajtim me kushtetutën.

1. Ligjvënësi i lë Gjykatës një afat kohor shumë të shkurtër për gjykimin e një kërkese kaq të rëndësishme, ndoshta me qëllim që të mos le pyetjen e papajtueshmërisë për sa i përket mbajtjes së referendumit, që tashmë duhet të është diskutuar gjerësisht në Kuvend dhe në media, të mbetet pa përgjigje për një periudhë më të gjatë kohore pas dorëzimit në Gjykatë. Në vendet e mësipërme, ekzistojnë afatet e ngjashme.

2. Teksti i nenit 34.2 në versionin anglisht, por as në shqip nuk është i saktësuar. Çfarë mund të thotë është që, në qoftë se pala e autorizuar i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të rishikuar kushtetutshmërinë e referendumit të propozuar mbi pajtueshmërinë e saj me Kushtetutën, referendumi do të mbahet vetëm, nëse Gjykata Kushtetuese vendos se referendumi i propozuar është në përputhje me Kushtetutën. Kështu, neni ka një efekt pezullues mbi procedurën e referendumit gjatë kohës kur kërkesa është nën gjykim të Gjykatës.
Si koment përfundimtar në nenet 33 dhe 34, duhet të theksohet, se këto nene aktualisht nuk janë operacionale në mungesë të një ligji që rregullon mbajtjen e një referendumi që duhet të miratohet nga Kuvendi, siç është sugjeruar më lart.

4. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (3) të Kushtetutës

Neni 113.3 (3) i Kushtetutës

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:
(3) Përputhshmërinë e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

Gjendja e jashtëzakonshme është përmendur në mesin e kompetencave të Presidentit në nenin 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 22, të Kushtetutës dhe të shprehura më me hollësi në nenin 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] të Kushtetutës.

Neni 84.22 i Kushtetutës

Presidenti I Republikës së Kosovës:
(22)vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;

Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] i Kushtetutës:

1. **Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur:**
   (1) **ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;**
   (2) **ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;**
   (3) **ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.**
2. **Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen.**
3. **Nëse paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të mbrojtjes, Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Kryeministrin, shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.**
4. **Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së emergjencës dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.**
5. **Gjendja e Jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, Gjendja e Jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për gjithsej nëntëdhjetë (90) ditë shtesë.**
6. **Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendosë që Gjendja e Jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit.**

7. **Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme.**
8. **Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.**
9. **Ligji përcakton parimet, lëmit dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme.**

Me pak fjalë, Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] të Kushtetutës përmban dispozita të veçanta që përcaktojnë: rrethanat në të cilat Presidenti mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme; procedurën për të marrë pëlqimin e Kuvendit; kohëzgjatjen dhe shtrirjen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; dhe Kompetencat e Presidentit, Kuvendit dhe Qeverisë gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, të drejtat e caktuara kushtetuese mund të kufizohen në përputhje me Kushtetutën. Sidoqoftë, Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] te Kushtetutës shprehimisht përcakton të drejtat dhe liritë, debrogimi i të cilave nuk do të lejohet në asnjë rrethanë, madje as gjatë gjendjes së jashtëzakonshme [526].
Nenet e mësipërme 113.3 (3) dhe 131 të Kushtetutës zbatohen me Nenin 35 i Ligjit:

Neni 35 [Afati]

> **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i marre ne pajtim me Nenin 113, paragrafi 3, pika 3 të Kushtetutës, mund të merret në afat prej njëzetekatër (24) orësh nga hyrja në fuqi e vendimit të lartpërmendur.**

Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta mbetet në fuqi, në përputhje me nenin 131.2 (shih tekstin më lartë) të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, Gjykata mban kompetencat e saj të përcaktuara për të. Neni 35 i Ligjit parasheh një afat prej 24 orësh brenda të cilit Gjykata *mund* të vendosë për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme. Megjithatë, kjo nuk duket që ka shumë kuptim, pasi që neni nuk e përmend ndonjë kërkesë të paraqitur nga palët e autorizuara sipas nenit 113.3 (3) të Kushtetutës. Çfarë Neni mund të nënkuptojë

[526] Neni 56 i Kushtetutës parashikon:
1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.
2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.

është të rregullojë afatin kohor prej momentit, kur pala përkatëse e autorizuar ose palët i referohet(n) çështjes së përputhshmërisë së shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të referuara aty në Gjykatë. Duke e marrë parasysh situatën e emergjencës, Gjykatës i është dhënë 24 orë që të marrë vendimin, por mund të zgjas më shumë, siç tregohet nga përdorimi i fjalëve *"mund të jepet brenda 24 orëve"*.
Për më tepër, ky nen është i pasaktë në një aspekt tjetër, pasi që flet vetëm për veprimet e përmendura në deklaratën e Gjendjes së Jashtëzakonshme, ndërsa neni 113.3 (3) i Kushtetutës i referohet veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, që domethënë veprimet e ndërmarra pasi që është shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme. Ky është një argument tjetër për mendimin e mësipërm, se afati i 24 orëve të parapara me nenin 35 të ligjit duhet të llogaritet nga momenti i dorëzimit të kërkese në Gjykatën Kushtetuese nga pala e autorizuar që dëshiron të sfidojë shpalljen e vetë Gjendjes së Jashtëzakonshme apo ndonjë veprim të ndërmarrë gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme.
Sugjerohet që teksti i nenit 35 të amendohet në përputhje me rrethanat.
Siç është rasti në lidhje me nënkreun 2 dhe 3 (nenet 31 dhe 33 të Ligjit), gjithashtu Nënkreu 4, nuk specifikon se sa deputetë të Kuvendit mund të ngrenë në Gjykatë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën të shpalljes së një Gjendje të Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme. Përsëri nuk është e qartë nga teksti, nëse vendimi i Kuvendit për t'iu drejtuar Gjykatës me çështje të pajtueshmërisë në lidhje me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme është një vendim i thjeshtë në kuptim të nenit 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, që kërkon miratimin me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, apo nëse një nga kriteret e votimit të përmendura në paragrafët e ndryshëm të nenit 131 të Kushtetutës do të jenë të zbatueshme. Pa dyshim do të ishte e dobishme, nëse Ligji për Gjykatën Kushtetuese do të kishte specifikuar këtë në një dispozitë të veçantë.
Si një vërejtje përfundimtare, duhet thënë se neni 35 i Ligjit mund të jetë vetëm operacional, kur, në bazë të nenit 131.2 të Kushtetutës, "[...] *Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj*...". Deri më tani, Kuvendi nuk ka miratuar asnjë ligj për Gjendjen e Jashtëzakonshme, i cili do të zbatojë nenin 131 të Kushtetutës dhe do të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me nenin 131.9 te Kushtetutës. Neni 35, prandaj, ende mund të mos jetë operacional.
Neni 35 i ligjit nuk është plotësuar nga ndonjë Rregull e Rregullores së Punës.

5. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 3 (4) të Kushtetutës

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

Palët e Autorizuara sipas nenit 113.3 (4) kanë të drejtë të paraqesin pyetje në Gjykatë nëse amendamenti i propozuar është në përputhje me dispozitat e një ose më shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga institucionet e Kosovës në pajtim me kërkesat e Kushtetutës dhe ligjit. Në të njëjtën kohë, palët e autorizuara mund të kërkojnë nga gjykata që të shqyrtojë nëse procedura, e ndjekur nga pala që e ka propozuar amendamentin në fjalë, është në përputhje me kërkesat kushtetuese.
Në këtë kontekst, është e duhur për t'iu referuar nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës i cili përcakton:

1. *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.*
2. *Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.*

Në gjykimin e kërkesës sipas nenit 113.3 (4) të Kushtetutës, Gjykata, pra, do të duhet të përcaktojë nëse amendamenti kushtetues i propozuar është në përputhje me marrëveshjet detyruese ndërkombëtare (të përmendura në kërkesë) të cilat janë bërë pjesë e brendshme e sistemit ligjor të Kosovës.
Megjithatë, përveç kontrollit të pajtueshmërisë së amendamentit të propozuar sipas kërkesës së palës së autorizuar me nenin 113.3 (4) të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit në saje të nenit 144.3 të Kushtetutës duhet të referojë amendamentin e propozuar në Gjykatë për një vlerësim paraprak se amendamenti i propozuar nuk e dobësون asnjë nga të drejtat dhe liritë e parashtruara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute[527].
Për më tepër, lind e njëjta pyetje edhe tek "Kuvendi" si një palë e autorizuar në paragrafët e mësipërm të nenit 113.3 të Kushtetutës.
Neni 113.3 (4) i Kushtetutës zbatohet nga nenet 36 dhe 37 të Ligjit.

Neni 36 [Efekti suspensiv]

> **Ngritja e kërkesës sipas nenit 113, paragrafi 3, pika 4 të Kushtetutës ka efekt pezullues. Kuvendi i Republikës se Kosovës vepron në bazë të ndryshimit të kontestuar vetëm pasi është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.**

Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, ndër të tjera, përcakton Rregullën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, amendamentet apo tërheqjen e marrëveshjeve të tilla dhe parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të përcaktuara me ligj. Për më tepër, Neni 19.2 i Kushtetutës përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, gjatë kohës së zbatimit të tyre, mbizotërojnë të gjitha ligjet në fuqi.

[527] Neni 144.3 i Kushtetutës parasheh: "Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

Ashtu siç e parasheh Neni 16.3 i Kushtetutës që përcakton se Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare[528], prandaj, gjithashtu, do të kërkohet të respektojë Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve[529], dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë se institucionet e Kosovës nuk do të shmangin zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të parashtruara në traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga amendimi i legjislacionit të brendshëm duke përfshirë edhe Kushtetutës, në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjeve të tilla të detyrueshme ndërkombëtare. Në këtë frymë, Kushtetuta ia jep mandatin Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar, me kërkesën e palës së autorizuar, përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur. Nëse një ose më shumë palë të autorizuara i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 113.3 (4) të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit është i detyruar, sipas nenit 36, të suspendojë miratimin e amendamentit të propozuar, deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim për çështjen e pajtueshmërisë në lidhje me amendamentin e kontestuar.
Neni 36 i Ligjit plotësohet nga Rregulla 70 [Aktgjykimi] i Rregullores së Punës.

Rregulli 70 [Aktgjykimi] i Rregullores së Punës

1. **Nëse Gjykata konkludon në aktgjykimin e saj se, në një kërkesë të parashtruar sipas nenit 113.4 të Kushtetutës, propozimi për ndryshimin e Kushtetutës është shkelje e marrëveshjeve ndërkombëtare që janë obliguese për Kosovën ose të cilat janë ratifikuar në bazë të Kushtetutës, respektivisht të dispozitave të Kushtetutës për procedurën që duhet zhvilluar për ndryshimin e Kushtetutës, atëherë Gjykata urdhëron që propozimi të mos miratohet nga Kuvendi i Kosovës.**
2. **Gjykata, në aktgjykimin e saj, mund të këshillojë për llojin e modifikimeve që mund t'i bëhet një propozimi, në mënyrë që propozimi për ndryshimin e Kushtetutës të jetë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare që janë obliguese për Kosovën ose që janë ratifikuar në bazë të Kushtetutës, respektivisht të dispozitave të përcaktuara në Kushtetutë për procedurën që duhet zhvilluar për ndryshimin e Kushtetutës.**

I. Rregulli 70 gabimisht e përmend nenin 113.4 të Kushtetutës, në vend të nenit nenit 113. [3] (4). Ky Rregull përcakton që nëse Gjykata, në bazë të një kërkese sipas nenit 113. [3] (4) të Kushtetutës, vendos se amendamenti kushtetues i propozuar është në shpërputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme ose ndryshe relevante, Gjykata do të urdhërojë Kuvendin që të mos miratojë amendamentin e propozuar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Gjykata vendos se procedura për ndryshimin e Kushtetutës, siç parashikohet në nenin 144 [Amendamentimi] të Kushtetutës është shkelur nga pala propozuese, gjykata do të urdhërojë Kuvendin njësoj të mos e miratojë amendamentin e propozuar.

[528] Shih nenin 16.3 të Kushtetutës.
[529] Konventa e Vienës mbi Ligjin e Traktateve 1155 U.N.T.S. 331, 8 I.L.M. 679 të 27 Janarit 1980, http://untreaty.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf., (vizituar së fundi më 28 Prill 2014).

II. Gjykata ka mundësi në aktgjykimin e vet të këshilloj palët që kanë propozuar amadamentin e sfiduar, që ta modifikojnë atë në mënyrë që të harmonizohet me marrëveshjet relevante ndërkombëtare. Prandaj nënkuptohet se nëse Gjykata jep një këshillë të tillë, palët përgatisin një amendament të ri në atë mënyrë që amendamenti i ri i propozuar nuk rrezikon që të dërgohet edhe një herë në Gjykatë për kontroll kushtetuese në lidhje me kompatibilitetin e saj me marrëveshjet e tilla ndërkombëtare. Megjithatë, nëse (për çfarëdo arsyeje), pala propozuese nuk vepron sipas këshillës së Gjykatës, është më se e sigurt se amendamenti i ri i propozuar përsëri do të dërgohet në Gjykatë nga pala e autorizuar sipas Nenit 113.3 (4) për gjykim.

Për më shumë, nëse Gjykata gjen se procedura e përdorur për amendamentimin e Kushtetutës është bërë në shkelje të Kushtetutës, ajo gjithashtu ka mundësinë, sipas vendimit të vet, që të këshillojë palët propozuese për procedurat adekuate që duhet kaluar për amendamentimin e Kushtetutës. Pra, në rast se Gjykata jep një këshillë të tillë dhe palët propozuese e përmbushin në përpikëri, supozohet se nuk do të ketë ankesa tjera të dorëzuara në Gjykatë nga pala e autorizuar sipas Nenit 113.3 (4) të Kushtetutës. Megjithatë, nëse (për çfarëdo arsyeje) pala propozuese nuk zbaton procedurat e këshilluara nga Gjykata, pala e autorizuar, e cila kishte kërkuar nga Gjykata shqyrtim kushtetues të procedurës së ndjekur, është më se e sigurt se përsëri do të dorëzojë një kërkesë të njëjtë në Gjykatë.

Neni 37 [Afati]

Gjykata Kushtetuese vendos mbi kërkesën e ngritur nga palët e autorizuara sipas nenit 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 37, si një *lex specialis*, niset nga afatet e përgjithshme për gjykimin e një kërkese nga Gjykata siç parashikohet në Nenin 22 të Ligjit (shih më lartë). Është interesant të theksohet, se sikurse në rastin që ka të bëjë me kërkesën e ngritur sipas Nenit 34.1 (përputhshmëria me Kushtetutën e referendumit të propozuar), afati brenda së cilës Gjykata duhet të marr vendimin është e barabartë me 30 ditë. Pra legjislatura duhet të ketë parasysh se aktgjykimi mbi përputhshmërinë e referendumit të propozuar nuk do t`i merr më shumë kohë Gjykatës se sa aktgjykimi mbi amendamentin e propozuar kushtetues. Natyrisht nëse nevojitet kohë shtesë për të hulumtuar marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, atëherë periudha mund të jetë e shkurtër. Por gjithashtu edhe hulumtimet mbi çështjet e referendumit mund të marrin kohë. Sido që të jetë, pa elaborim të mëtutjeshëm mbi çështjen, afatet kohore mbi çështjet duket se janë të arsyeshme.

Neni 37 i Ligjit nuk plotësohet nga asnjë pikë e Rregullores së Punës.

6. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 3 (5) të Kushtetutës

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

Neni 113.3 (5) I Kushtetutës implementohet me dispozitat e Nenit 38 [Saktësimi i Kërkesës] dhe të Nenit 39 të Ligjit [Afatet], tani e tutje, japin udhëzimet që duhet të ndiqen për paraqitjen e çështjeve të tilla në Gjykatë.

Neni 38 [Saktësimi i kërkesës]

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
   1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar(supozuar);
   1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se janë shkelur; dhe
   1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen kushtetuese.

Ky Nen sqaron në detaje, se si palët e autorizuara sipas Nenit 113.3 të Kushtetutës duhet të ndërtojnë rastin e tyre, kur paraqesin pyetje para Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 113.3 (5) të Kushtetutës. Megjithatë, udhëzimet nuk ndryshojnë shumë nga kërkesat e përfshira në Nenin 22 [Procedimi i Kërkesave] të Ligjit se kërkesat duhet të jenë të arsyetuara si dhe duhet të kenë të bashkangjitura informacionet dhe dokumentet e nevojshme (shiko tani e tutje). Gjithashtu Rregulla 29 [Paraqitja e Kërkesave dhe Përgjigjet] i Rregullores së Punës përmban kërkesa të ngjashme. Diferenca e vetme është se informata mbi dispozitat konkrete të Kushtetutës që supozohet se janë shkelur duhet gjithashtu të dorëzohen.[530]

Kjo, sipas interpretimit të mësipërm, se palët e autorizuara drejtpërdrejtë i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në bazë të Nenit 113.3 (5) të Kushtetutës, nuk do të thotë se në fushën e zgjedhjeve, mandati i Gjykatës është i kufizuar në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së zgjedhjeve të Kuvendit, ose që subjektet e tjera nuk kanë mundësi t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me shkeljet e supozuara (pohuara) të cilat mund të kenë ndodhur gjatë zgjedhjeve qofshin ato të përgjithshme apo lokale. Për shembull, në bazë të nenit 122 [Ankesat Zgjedhore] të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-73)[531], një person fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit i

[530] Kjo kërkesë tani është përcaktuar edhe në Formularin e rishikuar të Kërkesës, si dhe tek Udhëzimet për plotësimin e këtij formulari. FORMULAR I KËRKESËS, në dispozicion tek: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_forma_e%20_referimit_shq.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[531] Ky Ligj është ndryshuar me "Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës" të datës 01.11.2010, në dispozicion në: http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/ligji_per_plotesim_igzulrlgsv.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).

janë prekur nga vendime të caktuara të Komisionit Qendror Zgjedhor, mund të apelojë atë vendim tek Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP). Në qoftë se paditësi nuk është i kënaqur dhe *inter alia* çështja cenon një të drejtë themelore, ankesa mund të ngritët në Gjykatën Supreme në bazë të nenit 118.4 të Ligjit Zgjedhor [Vendimet]. Në rast se Gjykata Supreme refuzon rastin e paditësit, ky i fundit mund të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese një rishikim kushtetues të çështjes nëse një ose më shumë prej të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë të paditësit janë shkelur ose jo[532].

Megjithatë, siç u tha më lart, e drejta për t'iu drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, pa kaluar së pari nëpër procedurat e apelimit, me kërkesën për të shqyrtuar nëse është shkelur Kushtetuta, iu përket vetëm palëve të autorizuara dhe vetëm lidhur me zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës. Kjo procedurë është sigurisht në përputhje me frymën e Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, miratuar nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij të 52-të (Venecie, 18-19 tetor 2002), e cila përcakton një numër (minimal) udhëzimesh (standardet evropiane) për zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe procedurat e apelimit para gjykatave të zakonshme, gjykatës së posaçme ose gjykatës kushtetuese[533].

Neni 39 [Afatet]

> **Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e shterjes së mjeteve tjera juridike**.

Siç u tha më sipër, qëllimi i nenit 113.3 (5) të Kushtetutës në të vërtetë është për të mundësuar palët e autorizuara që t'i adresohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, neni 39 i ligjit duket të jetë në kundërshtim me frymën dhe përmbajtjen e Nenit 113.3 (5) të Kushtetutës, pasi kjo, në bazë të këtij neni, bën pushtetin e palëve të autorizuara, të kushtëzuara me "shterimin e mjeteve tjera juridike". Megjithatë, pavarësisht nga kjo, teksti në lidhje me afatin prej 30 ditësh mund të ketë kuptim vetëm nëse ky afat do të fillojë të numërohet (të ecë) nga dita kur shkelja e supozuar e Kushtetutës ka ndodhur, gjatë zgjedhjes së Kuvendit. Sugjerohet që legjislatura të ri-konsiderojë tekstin e nenit 39 të ligjit në dritën e kësaj vërejtje.

Nenet 38 dhe 39 të Ligjit nuk janë të plotësuara nga asnjë pikë e Rregullores së Punës.

---

[532] Shih për shembull Rastin Nr. KI 73/09. Mimoza Kusari - Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Vendim për papranueshmëri i datës 19 shkurt 2010. *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2009/2010*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës Së Kosovës, 2011, si dhe në dispozicion tek http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KI%2073_vendimi_shq.pdf (vizituar me datën 9 qershor 2014).

[533] Shih. "Code of Good Practice in Electoral Matters: Guidelines and Explanatory Report". (Venecia, 18-19 Tetor 2002) na, 18-19 practice in: http://www.regjeringen.no/upload/KRD/Kampanjer/valgportal/valgobservatorer/Code_of_good_practice_CDL_AD(2002)023rev_e.pdf, (vizituar me datCDL_ Qershor 2014).

7. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

> **4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.**

Në këtë kontekst, i bëhet referencë Nenit 11 [Mbrojtja ligjore e Vetëqeverisjes Lokale] të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale (e miratuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës më 15 tetor 1985), duke siguruar se "Autoritetet lokale do të kenë të drejtën e mbështetjes në një mjet juridik për të siguruar ushtrimin e lirë të pushtetit dhe të respektimit të parimeve të tyre të vetëqeverisjes lokale siç janë të sanksionuara në kushtetutë apo legjislacionin e brendshëm. "Në bazë të nenit 113.4, mbështetja e komunave në një mjet juridik është qasja e drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese e cila do të shqyrtojë shkeljen e pretenduar mbi përgjegjësitë e tyre dhe pakësimin e të ardhurave të tyre”.
Detyrimi për të zbatuar Kartën, parashikohet në Nenin 123 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 3 i Kapitullit X [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial] të Kushtetutës, i cili përcakton se: "[...] Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues." Vetë Kapitulli X është implementuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të miratuar nga Kuvendi më 20 shkurt të vitit 2008. Ky ligj përcakton, *inter alia* (ndër të tjera), kompetencat dhe të ardhurat e komunave por çuditërisht nuk përmend të drejtën e komunës sipas nenit 113.4 të Kushtetutës për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë në rrethanat e përmendura nga ky Nen.
Neni 113.4 i Kushtetutës zbatohet nga Nenet 40 dhe 41 të Ligjit.

Neni 40 [Saktësimi i kërkesës]

> **Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.**

Se një ligj i Kuvendit do të shkelë të drejtat kushtetuese të komunave është më pak e mundshme që të ndodh se sa që do ta bënin atë aktet individuale të Qeverisë (në veçanti, të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si autoriteti mbikëqyrës). Akte të tilla të veçanta mund të bëjnë mbi çështjet e "Kompetencave të deleguara" dhe tek financimet e nevojshme sipas Nenit 18 [Kompetencat e deleguara] të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Për më tepër, konfliktet që lidhen me shqyrtimin administrativ të komunave të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, të përcaktuar në kapitullin X [Marrëdhëniet mes pushtetit lokal Qendrore dhe] të këtij ligji, mund të detyrojë

komunat për të kapur Gjykatën direkt në bazë të nenit 113.4 të Kushtetutës, për shembull, në qoftë se Ministria do të akuzojnë një komunë e ka tejkaluar kompetencat e veta në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe shkel në mënyrë jo-proporcionale mbi përgjegjësitë e tyre.
Gjithashtu, në qoftë se, në bazë të Nenit 82 [Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë] të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt tjetër i një komune të jetë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet dhe kërkon nga komuna që të rishqyrtojë vendimin apo aktin e tillë, komuna përkatëse duhet të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Një komunë, duke e përdorur këtë mjet juridik, duhet pra që me kujdes të ndjek udhëzimet e përcaktuara në Nenin 40 të Ligjit.

Neni 41 [Afatet]

> **Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës.**

Në shikim të parë, nuk mund të jetë e qartë për çfarë arsye legjislatura ka zgjedhur një afat të tillë të gjatë. Për më tepër, pasi që, në veçanti, konfliktet që lidhen me kompetencat dhe të ardhurat duhet të zgjidhen sa më shpejt të jetë e mundur në interes të transparencës dhe sigurisë ligjore. Megjithatë, ka një logjikë në lidhje me një afat të tillë kaq të gjatë. Autoritetet komunale nuk mund të jetë në dijeni të ligjeve apo akteve të qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e tyre apo zvogëlojnë të hyrat, menjëherë pas hyrjes së tyre në fuqi. Brenda një viti, një komunë do të preket nga ligji ose akti të Qeverisë. Deri tani, Gjykata Kushtetuese ka qenë e fortë lidhur me kornizën kohore, dhe ka hedhur poshtë kërkesat nga komunat si të papranueshme, siç parashkruhet në rastet që janë dorëzuar pas afatit të fundit[534].

8. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 5 i Kushtetutës

> **5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.**

Siç u përmend edhe më parë më lart, vetëm 10 a më shumë deputetë kanë një periudhë prej 8 ditësh pas miratimit të një ligji ose të një vendimi të Kuvendit për të paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën ata mund të sfidojnë kushtetutshmërinë e atij ligji ose vendimi. Për një numër kaq të vogël të deputetëve,

[534] Shih, për shembull, Rastin nr. KO 117/10, Kerkesën e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, për emrin e Komunës së Hanit të Elezit, në gjuhën serbe të njohur si-Dženeral Jankoviq, *BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE* 2012, Vëllimi I, faqe 67, në dispozicion në: http://www.gjk ks.org/repository/docs/buletini_ang_vol_1.pdf, (vizituar me datën 9 qershor 2014).

sigurisht që ajo është një armë e rëndësishme politike, me të cilën ata mund të provojnë edhe një herë, pasi kanë humbur betejën politike në Kuvend, për të ndaluar miratimin e atij ligji ose vendimi.
Dhjetë apo më shumë deputetë nuk kanë nevojë të vijnë nga opozita apo pakicat në Kuvend. Gjithashtu disa deputetë të shumicës, të cilët thjesht nuk pajtohen me ligjin ose vendimin e miratuar, do të mund të bashkohen me grupin.
Në fakt, mundësia e deputetëve që të kërkojnë nga Gjykata kërkesën për një rishikim kushtetues të ligjeve formon tashmë pjesë të Nenit 113.2 të Kushtetutës (shih komentet më lart), që përcakton në këtë drejtim, se Kuvendi (që do të thotë një e katërta (¼) e deputetëve, siç specifikohet në Nenin 29 (1) të Ligjit) është i autorizuar për të referuar në Gjykatë "[...] (1) çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën, me ligjet, të dekreteve të Presidentit ose të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë [...] ".
Një ndryshim i mëtejshëm në mes të dy grupeve të deputetëve është që në bazë të Nenit 113.5 të Kushtetutës, 10 apo më shumë deputetë të kenë vetëm tetë (8) ditë nga data e miratimit (jo e hyrjes në fuqi) të paraqesin kërkesën e tyre në Gjykatë, ndërsa, sipas nenit 30 të Ligjit, 30 a më shumë deputetë kanë 6 muaj nga dita kur ligji i kontestuar hyn në fuqi për ta bërë këtë. Së fundmi, 10 a më shumë deputetë gjithashtu mund të sfidojnë kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit si dhe të sfidojnë procedurën e ndjekur.
Duhet gjithashtu të përmendet, që, kur 10 apo më shumë deputetë aplikojnë, Gjykata mund të ndërmarrë vetëm një kontroll abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit të miratuar rishtazi (ose vendimi), para hyrjes së tij në fuqi. Kur kjo bëhet nga një e katërta (¼) e deputetëve, ajo mund të ndërmarrë një kontroll shumë më të gjerë të efekteve praktike, pasi që ligji ishte (me siguri) tashmë duke u aplikuar për një kohë të caktuar para se deputetët ti drejtohen Gjykatës.
Ky Nen vetëm siguron një rishikim kushtetues përpara zbatimit të një akti normativ ("a apriori" rishikimi kushtetues) të iniciuar nga dhjetë ose më shumë deputetë. Ndryshe nga disa vende të tjera, asnjë dispozitë e Kushtetutës apo Ligjit, nuk i jep të drejtën Gjykatës që të fillojë procedurat për një rishikim "a apriori" të akteve normative nën iniciativën e saj ("proprio motu"). Gjithashtu një "a apriori" rishikim kushtetues nuk mund të iniciohet nga individët. Megjithatë, individët dhe organet kushtetuese munden që të dyja të iniciojnë një rishikim kushtetues pas miratimit të një akti normativ (shqyrtim kushtetues "a posteriori").
Si një shembull i një kërkesë të paraqitur sipas Nenit 113.5 të Kushtetutës, i referohemi Rastit KO 29/11 të datës 30 mars 2011, ku Gjykata ka gjykuar ankesën e parë të paraqitur në bazë të Nenit 113.5 të Kushtetutës nga 25 deputetët e LDK-së dhe 9 deputetët e AAK-së, të cilët kërkuan nga Gjykata për të vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit, me të cilin Z. Behgjet Pacolli u zgjodh President i Republikës së Kosovës. Gjykata konstatoi, me shtatë vota pro dhe dy vota kundër, se procedura e zgjedhjes me vetëm një kandidat që kandidoi për postin e Presidentit të Kosovës ishte jo-kushtetuese dhe se edhe duke supozuar se Kushtetuta do të lejojë vetëm një kandidat për të kandiduar për zyrën e Presidentit, pjesëmarrja e më pak se numri i deputetëve të kërkuar nga Neni 86 i Kushtetutës do të thoshte se procedura e votimit ishte e

pavlefshme. Gjykata konkludoi se procedura e votimit përbënte shkelje të Nenit 86 të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, si e tillë ishte jo-kushtetues.[535]
Neni 113.5 i Kushtetutës zbatohet nga Nenet 42 dhe 43 të Ligjit.

Neni 42 [Saktësimi i kërkesës]

1. **Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:**
   1.1. **emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës;**
   1.2. **dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe**
   1.3. **paraqitjen e provave mbi tapo të ndonjë akti apo ligj.**

Neni 42.1 (gabimisht tregohet si 1.1) përcakton se kërkesa duhet të përmbajë emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi. Megjithatë, teksti është konfuz, pasi që në vend të "të gjithë deputetëve", ajo duhet që më mirë të theksojë "dhjetë (10) ose më shumë deputet". Nuk ka dyshim se deputetët përkatës do të ndjekin udhëzimet për dorëzimin e kërkesës siç është saktësuar. Është tejet e rëndësishme që ata të mbështesin pretendimin e tyre mbi bazën e provave dhe neneve përkatëse të Kushtetutës dhe / ose legjislacionit përkatës mbështetës.

Praktika gjyqësore relevante

Një tjetër shembull i një kërkese të paraqitur në Gjykatë sipas Nenit 113.5 të Kushtetutës është Rasti KO 107/10, të datës 17 gusht 2011, Gani Geci dhe deputetët tjerë kundër vendimit të Kuvendit të datës 14 tetor 2010 lidhur me Projekt-Strategjinë dhe vendimin e Qeverisë për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Parashtruesit, 12 deputetë të Kuvendit, kanë paraqitur kërkesën sipas Nenit 113.5 të Kushtetutës duke pretenduar se Kryetari i Kuvendit ka vënë projekt-strategjinë dhe vendimin për të votuar pa pasur kuorumin e nevojshëm të deputetëve, që përbën shkelje të Nenit 51 (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Kuvendit, e cila kërkon një kuorum prej më shumë se 50% e deputetëve. Në përgjigje, Kryetari i Kuvendit ka argumentuar se votimi nuk ka prodhuar një vendim të nënshkruar dhe se projektet nuk janë miratuar për shkak të një ankese për mungesë të kuorumit, duke treguar se çështjet do të dorëzohen në Kuvend për shqyrtim më vonë.
Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa ishte pa objekt shqyrtimi, sepse Kryetari i Kuvendit e kishte shfuqizuar vendimin e vënë në diskutim për shkak të mungesës së kuorumit, dhe mori vendim për Heqjen e Kërkesës në pajtim me Rregullën 32.4 të Rregullores së Punës.

[535] Shih *Buletini i praktikës gjyqësore 2011*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2012, faqe 128.

Neni 43 [Afati]

43.1 Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.

43.2 Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar.

43.3 Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dorëzimit të kërkesës.

1 Teksti i dispozitës duket disi problematik, pasi që përcakton se jo vetëm "një ligj", por edhe një "vendim", i miratuar nga Kuvendi, do t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 113.5 të Kushtetutës. Kjo pasaktësi me sa duket buron nga interpretimi i gabuar i nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili, siç mund të shihet nga teksti i cituar më sipër, nuk e përmend se çfarë do të ndodhë me ligjin ose vendimin e miratuar pas skadimit të periudhës prej tetë ditësh. Hartuesit e Nenit 43.1 të Ligjit, megjithatë, duket se e kanë marrë atë për të dhënë se pas skadimit të afatit prej 8 ditësh, të dy instrumentet ligjore do të ndjekin të njëjtën procedurë, d.m.th shpalljen nga Presidenti i Kosovës.

Duke bërë kështu, hartuesit kanë anashkaluar faktin që, në bazë të neneve 80 [Miratimi i Ligjeve], paragrafi 2,[536] dhe 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 4[537] të Kushtetutës, vetëm ligjet e miratuara nga Kuvendi shpallen nga Presidenti i Kosovës. Kështu, vendimet (dhe aktet e tjera) të miratuara nga Kuvendi nuk i dërgohen Presidentit për shpallje. Sugjerohet pra që fjalët "ose vendimi" të fshihen nga neni 43.1, kurdo që Ligji të ndryshohet.

Sa i përket referimit në nenin 43.1 të afatit prej tetë ditësh të përmendur në nenin 113.5 të Kushtetutës, brenda të cilit 10 a më shumë deputetë kanë të drejtë ta kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi, hartuesit duhet të kenë pasur parasysh se një periudhë e tillë e shkurtër do të shërbejë në mënyrë të qartë parimit të sigurisë juridike, për shkak se një periudhë më e gjatë mund të çojë në një pasiguri nga ana e deputetëve të tjerë dhe publikut të gjerë nëse ligji i miratuar do të nxirret ose jo me shpallje nga Presidenti ose do t'i nënshtrohet rishikimit kushtetues.

[536] Neni 80.2 i Kushtetutës parasheh: "Ligjet e miratuara nga Kuvendi nënshkruhen nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me nënshkrimin e tij / saj brenda tetë (8) ditësh nga pranimi".

[537] Neni 84.4 i Kushtetutës parasheh: [Presidenti i Kosovës] "... (4) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës".

2 Gjithashtu Neni 43.2 gabimisht përmend "vendimin" në lidhje me procedurën e shpalljes nga Presidenti, siç e komentuam në nenin 43.1 më lart. Sugjerohet pra që fjalët "ose vendimi" në rreshtin e parë dhe të tretë të nenit të fshihen, kurdo që ligji do të ndryshohet dhe se një paragraf i veçantë të shtohet në nen, që ka të bëjë me kontestimin e një vendimi të miratuar nga Kuvendi. Ky nen i ri 43.3 mund të lexohet si vijon: "*Në rast se një vendim i miratuar nga Kuvendi kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, një vendim i tillë do të ndryshohet në përputhje me modalitetet e përcaktuara në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese për këtë kontest*".

Sa i përket përmbajtjes së nenit, kur Gjykata konstaton se një ose më shumë dispozita të ligjit të kontestuar duhet të modifikohen për shkak se janë jo kushtetuese (shih, për shembull, Rastet Nr. KO 45/12 dhe KO 46/12, kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit[538]), ligji duhet të kthehet në Kuvend i cili, pasi që të ketë ndryshuar ligjin, të njëjtin edhe një herë ia dërgon Presidentit për shpallje. Mirëpo, në qoftë se anëtarët e Kuvendit, të cilët bllokuan shpalljen e ligjit herën e parë, nuk janë të kënaqur me ndryshimet, ata munden përsëri ta paraqesin një ankesë pranë Gjykatës sipas Nenit 113.5 të Kushtetutës, duke sfiduar dispozitat e ndryshuara të ligjit si ende jo kushtetuese dhe, në këtë mënyrë, jo në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga Gjykata në vendimin e saj përfundimtar. Kjo mund të çojë në një bllokim politik.

Në lidhje me këtë, i referohemi një Raporti [Roli dhe Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese] nga Prof. Luis Lopez Guerra, të paraqitur në seminarin UniDem të organizuar në Bukuresht më 8-10 qershor 1994, ku ai konsideron se "*Vetëm një organ i shtetit ose një pjesë e rëndësishme e tij mund të akuzojë Parlamentin për shkelje të Kushtetutës. Dukshëm, qëllimi i këtij kufizimi është për të kufizuar procedurën për rastet e rënda në të cilat epërsia e Kushtetutës konsiderohet më të vërtetë të jetë në rrezik të dukshëm. Këto karakteristika e bëjnë kontrollin abstrakt kushtetues një teknikë e cila përdoret vetëm përjashtimisht në regjimet e konsoliduara demokratike. Në një mjedis të konkurrencës së hapur politike dhe opsioneve alternative politike për pushtet, partitë politike të minoriteteve në opozitë vështirë do të ndjenë nevojën për të akuzuar partitë në pushtet për shkelje të Kushtetutës. Në ndonjë rast, megjithatë, juridiksioni kushtetues thuhet se është bërë një formë e mbrojtjes për pakicat politike. Por ky pohim është i diskutueshëm. Sfidat e vazhdueshme të besnikërisë të palës shumicë, të Kushtetutës nuk duket të jenë një teknikë e përshtatshme për garantimin e stabilitetit të një regjimi. Dhe në një kornizë demokratike, minoritetet kanë mënyra të tjera, më pak ekstreme për të mbrojtur interesat e tyre. Përveç kësaj, një tjetër aspekt i kësaj teknike duhet të konsiderohet: një sfidë nga një grup minoritar të kushtetutshmërisë të një ligji të miratuar nga shumica parlamentare duhet pothuajse në mënyrë të pashmangshme të interpretohet si një akt i politikës partiake. Dhe si rezultat, vendimi i Gjykatës në këtë rast në mënyrë të pashmangshme do të ketë tone të padëshirueshme politike*".

[538] Vendimi i datës 25 Qershor 2012, Buletini i praktikës gjyqësore 2012 (I), f. 735: dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Kështu, Raporti e bën të qartë se duke përdorur këtë të drejtë në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, ekziston gjithmonë një rrezik që pakicat politike mund ta keqpërdorin për qëllime politike.

Nëse gjykata vendos se ligji në tërësi është antikushtetues, Kuvendi duhet ta riformulojë atë ose ta kthejë te autoritetet e Qeverisë që, në shumicën e rasteve, ishin iniciatorët dhe / ose hartuesit e ligjit. Një projekt i ri, atëherë mund të përcillet në Kuvend për miratim ose e gjithë ideja për të pasur një ligj të ri thjesht mund të braktiset. Në të njëjtën mënyrë si e përmendëm më lart, kundërshtarët fillestare munden edhe një herë të paraqesin një ankesë në Gjykatë duke e sfiduar e kushtetutshmërinë së disa dispozitave të ligjit të ri ose të ligjit të ri si tërësi, duke iu referuar modaliteteve të përmendura në vendimin e Gjykatës apo duke u thirrur pyetje të tjera të jo kushtetutshmërisë.

Çështja e ndryshimit të ligjit në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga Gjykata, është e rregulluar në nenin 35 [Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese] të Rregullores së Punës së Kuvendit, duke siguruar se: "1. *Kryetari i Kuvendit do të informojë anëtarët e Kuvendit dhe Qeverisë për vendimin e Gjykatës Kushtetuese. 2 Kryetari i Kuvendit do të kërkojë nga sponsori i ligjit dhe organet e Kuvendit të fillojnë përgatitjen e Ligjit në tërësi ose një pjesë të tij, në përputhje me përmbajtjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese".*

Në këtë kontekst, Komisioni për Legjislacion dhe Çështje Juridike (shih, Nenin 3 të Aneksit Nr. 2 [Fushëveprimi dhe Përgjegjësitë e Komiteteve Parlamentare]) e që është një komision i përhershëm për shqyrtimin e bazës ligjore dhe kushtetuese të çdo ligji që duhet të miratohet nga Kuvendi dhe, si i tillë, ka qenë i përfshirë në hartimin e ligjit të deklaruar, si një tërësi ose pjesë të tij, si jo kushtetuese, me siguri do të luaj një rol të rëndësishëm në "*përgatitjen e Ligjit [...] në pajtim me përmbajtjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese*". Në të njëjtën mënyrë, komisionet tjera përkatëse të Kuvendit do të jenë të përfshira.

Sa i përket kushtetutshmërisë dhe procedurës së ndjekur, në rast se ankuesit pretendojnë se procedura e ndjekur për miratimin e një ligji apo vendimi ishte jo kushtetuese, Gjykata mund të gjejë se, si rezultat i procedurës jo kushtetuese, rezultati i procedurës së kontestuar është i pavlefshëm. Gjithë procedura duhet, pra, të përsëritet në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, në pajtim me Rregullën 63 [Zbatimi i Vendimit], ose të braktiset në qoftë se shumica e Kuvendit vendos kështu.

Së fundmi, nuk është e qartë nëse Gjykata mund të deklarojë *ex officio* që dispozitat e një ligji ose të një vendimi janë jo kushtetuese, për shembull, në qoftë se gjatë gjykimit të kërkesës, ajo zbulon se jo vetëm dispozitat e kontestuara nga 10 apo më shumë deputetë, por edhe disa dispozita të tjera janë jo kushtetuese. Në një situatë të tillë, Gjykata duhet të fuqizohet për të deklaruar ligjin ose vendimin si jo kushtetues në tërësi. As Kushtetuta, dhe as ligji shprehimisht nuk e parashikojnë një rregull të tillë. Deri më tani, Gjykata nuk është marrë me këtë çështje.

Në çdo rast, do të ishte interesante për të parë situatën ligjore në disa nga vendet fqinje dhe të tjera. Për shembull, Neni 49 i kapitullit VII [Procedurat e veçanta, procedura të veçanta për rishikimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve normative të tjera me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare] të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë parashikon se: "*Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së një ligji apo akti tjetër normativ me Kushtetutën ose një marrëveshje ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga një kërkesë të [...] jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit* [...].. Kapitulli VII nuk përmban asnjë referencë për kompetencat e Gjykatës Kushtetuese sipas detyrës zyrtare.

Përjashtimi i vetëm është me sa duket Neni 48 [Kufijtë e shqyrtimit] i kreut VI [Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese] i cili autorizon gjykatën për të rishikuar dispozitat tjera të ligjeve të kontestuara se sa ato të cilat janë objekt i shqyrtimit. Neni 48 përcakton se:

"*1. Rishikimi i një rasti do të kufizohet në objektin e kërkesës dhe arsyeve të paraqitura në të.*

2. Përjashtimisht, në qoftë se ekziston një lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, Gjykata Kushtetuese vendos të gjitha çështjet".

Kështu, edhe pse Gjykata Kushtetuese mund të zgjerojë fushëveprimin e shqyrtimit të ligjeve të tjera, neni nuk duket se e lejon gjykatën për të rishikuar dispozitat tjera të ligjit të kontestuar të cilat nuk janë objekt i ankesës.

Sa i përket Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë, neni 35 i kreut IV [Rishikimi i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregulloreve të tjera], përcakton se: "*Kërkesa me të cilën procedura para Gjykatës Kushtetuese iniciohet mund të paraqitet nga: një e pesta e anëtarëve të parlamentit kroat*, [...]. Gjithashtu këtu neni nuk përmend ndonjë "*ex officio*" kompetencë të Gjykatës Kushtetuese duke e lejuar atë për të rishikuar dispozitat tjera të ligjit të kontestuar përveç atyre të kërkuara. Përjashtimi i vetëm është me sa duket neni 38, që ka të bëjë me të drejtën e çdo personi fizik ose juridik të propozojë fillimin e procedimit për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe ligjshmërinë dhe kushtetutshmërisë të rregulloreve tjera. Në bazë të nenit 38 (2), Gjykata Kushtetuese është e autorizuar për të vendosur: "[...] *Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe shqyrtimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të rregulloreve tjera*" (Shih, gjithashtu komentin 10. për Procedura në rastin e përcaktuar në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës).

Për më tepër, sipas nenit 76 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese gjermane,: "*kërkesa e [...] një e tretës së anëtarëve të Bundestagut [...] do të jetë e pranueshme vetëm nëse një nga palët ka të drejtë të aplikojnë konsideron Ligji federal apo i Landit 1. Të pavlefshme për shkak të papajtueshmërisë së saj formale ose materiale me Ligjin themelor ose Ligjin federal, apo* [...]. Megjithatë, në bazë të Nenit 78 të Ligjit Federal për Gjykatën Kushtetuese (BVG), është e autorizuar të japë gjykimin e saj për dispozitat e mëtejshme duke siguruar: "*Nëse Gjykata Kushtetuese Federale vjen në përfundimin se ligji federal është në përputhje me Ligjin themelor ose se ligji i landit nuk është në përputhje me ligjin themelor ose ligj tjetër federal, ajo duhet të deklarojë që ligji të jetë i pavlefshëm. Nëse dispozitat e mëtejshme të njëjtit ligj janë të papajtueshme me ligjin themelor ose ligj tjetër Federal për të njëjtat arsye, Gjykata Kushtetuese Federale mund të deklarojë se ato të jenë të pavlefshme*".

Kështu, sipas këtij neni, Gjykata Kushtetuese Federale ka në mënyrë të qartë të drejtën të shqyrtojë ex officio dispozitat tjera jo kushtetutshmëria e të cilave nuk ishte përmendur shprehimisht nga pala e autorizuar.

3 Neni 43.3 nuk vuan nga pasaktësia e vërejtur në nenin 43 (1) dhe (2) në lidhje me përdorimin e termit "vendim" përkrah termit "ligj", pasi ajo nuk përmban një referencë që Kuvendi e dërgon "ligjin apo vendimin te Presidenti i Kosovës për shpallje". Teksti i nenit 43.3 është, pra, i saktë në këtë drejtim.

Sa për thelbin e tij, ai vendos një periudhë prej 60 ditësh, pas "dorëzimit" të ankesës, brenda të cilës Gjykata do të marrë një vendim përfundimtar. Termi "dorëzimi" është, për fat të keq i pasaktë dhe duhet të zëvendësohet me fjalën "regjistrim", pasi që, në praktikë, data e dorëzimit nuk korrespondon domosdo me datën e regjistrimit, e cila, në bazë të Rregullës 28 (2) të Rregullores së Punës, "*është data vendimtare për ankesën që të konsiderohet si një çështje në gjykim para Gjykatës*".

Është e vështirë të vlerësohet nëse periudha maksimale prej 60 ditësh e dhënë Gjykatës për të vendosur mbi një rekomandim të tillë është shumë e shkurtër ose jo aq e gjatë sa duhet për rrethanat. Nëse gjykata gjithmonë do të jetë në gjendje të mbetet brenda afatit kohor të përcaktuar, me siguri do të varet nga ndërlikueshmëria e ligjit apo vendimit të kontestuar, në mënyrë të veçantë, pasi që Gjykata duhet të marrë një vendim për kushtetutshmërinë e thelbit dhe procedurës së ndjekur. Në fakt, mund të ndodhë që Gjykatës do t'i duhet më shumë kohë se sa 60 ditë. Deri më tani, duket se, në rastet e gjykuara sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, Gjykata ka qenë në gjendje që të mbetet brenda afatit, në shumicën e rasteve.

E vetmja periudhë tjetër prej 60 ditësh brenda të cilës Gjykata duhet të vendosë mbi një çështje të ngritur në bazë të procedurave të veçanta të kapitullit III, është e përmendur në nenin 54 [Afati], i cili zbaton nenin 113.9 të Kushtetutës duke siguruar se Kryetari i Kuvendit i referon amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, për të konfirmuar se amendamentet kushtetuese të propozuara nuk zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës[539]. Kështu, neni 54 i jep të njëjtën periudhë prej 60 ditësh Gjykatës për të gjykuar kërkesën. Hartuesit e ligjit mund të kenë zgjedhur të njëjtën periudhë në të dy situatat pa shumë reflektim, duke qenë të mendimit se, edhe pse të ndryshme, të dyja situatat janë mjaft të krahasueshme për të merituar një periudhë të ngjashme prej 60 ditësh për Gjykatën të vendosë, aq më tepër, pasi që në të dy rastet teksti konsiderohet të vjen nga i njëjti burim, respektivisht Kuvendi.

Të jetë se si është, nuk duket të jetë e paarsyeshme në qoftë se në një situatë të jashtëzakonshme, Gjykata do të kalojë afatin për shkaqe të arsyeshme. Në çdo rast, asnjë sanksion nuk mund të imponohet për Gjykatën, nëse ajo nuk do të merr vendim brenda afatit të caktuar. Në fakt, neni 54 nuk duket se përjashton një situatë të tillë, pasi që ai parashikon se Gjykata duhet të respektojë periudhën e gjashtëdhjetë ditëve "për aq sa të jetë e mundur".

[539] Neni 113.9 i Kushtetutës parasheh: "*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".*

9. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 6 të Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës

[…]

6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës..[540]

[…].

Neni nuk përmban asnjë tregues se si Gjykata duhet të interpretojë konceptin e "shkeljes serioze të Kushtetutës". Gjithashtu paragrafi 1 i nenit 91 [Shkarkimi i Presidentit][541] të Kushtetutës, që përcakton se "*Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me 2/3 e votave të gjithë deputetëve të tij, ndër të tjera, nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ai/ajo ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës"*, nuk ofron ndonjë tregues mbi interpretimin e mundshëm të këtij koncepti. Ajo vetëm përcakton sanksionin mundshëm. Kjo do të thotë se është lënë tërësisht Gjykatës për të zhvilluar kriteret e nevojshme për një gjetje të tillë serioze.

Gjykata tashmë ka pasur mundësi për të shprehur veten në çështjen në Rastin KI 47/10, Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundrejt Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, në të cilin ishte pohuar se Presidenti ka shkelur dhe vazhdon të shkelë nenin 88.2[542] të Kushtetutës i cili i ndalon Kryetarit të ushtrojnë ndonjë funksion në parti politike dhe se një shkelje e tillë ishte një shkelje serioze të Kushtetutës[543]. Duke pasur parasysh se çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të jetë i sigurt për paanësinë, integritetin dhe pavarësinë e Presidentit të tyre, Gjykata ishte e mendimit se kjo nuk mund të thuhet kur presidenti ende mban detyrën e lartë në një nga partitë më të shquara politike në vend. Gjykata, pra, e pa të nevojshme për të përcaktuar nëse "[...] *kjo shkelje është thjesht një shkelje teknike e Kushtetutës ose shkelje serioze* [...]", dhe arriti në përfundimin se Presidenti kishte bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës në bazë të nenit 88.2 të Kushtetutës "*duke vazhduar të lejojë veten që të regjistrohet si Kryetar i LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës*)".

Konsiderata e Gjykatës duket se nënkupton se kryerja e një thjeshtë "shkelje teknike" të Kushtetutës nga Presidenti jo domosdo çon në pasojat të cilat një "shkelje serioze" e Kushtetutës do të shkaktojë (shih gjithashtu komentet për nenin 44 më poshtë).

---

[540] Shkarkimi klasik i Presidentit para Gjykatës Kushtetuese.

[541] Neni 91 [Shkarkimi i Presidentit] i Kushtetutës parasheh: *"1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai / ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ai / ajo nuk është i aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të një sëmundjeje të rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ai / ajo ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës*. […]".

[542] Neni 88.2 i Kushtetutës thotë: "2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike".

[543] Rasti nr. KI 47/10, Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, vendimi i datës 28 Shtator 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2009-2010,, faqe 239; dhe gjithashtu në ueb faqe të Gjykatës.

Ankesat e paraqitura në bazë të nenit 113.6 të Kushtetutës me siguri do të mbeten të rralla. Në çdo rast të ardhshëm të këtij lloji, kur duhet vlerësuar nëse shkelja e supozuar e Kushtetutës meriton konkluzionin se kjo është me të vërtetë një shkelje "serioze", Gjykata me siguri do t'i referohet konsideratave të saja në Rastin Nr. KI 47/10.
Neni 113.6 i Kushtetutës zbatohet nga nenet 44 [Saktësimi i kërkesës] dhe 45 [Afatet] të Ligjit, të cilat janë vetë të plotësuara me Rregulloren 71 [Njoftimi], 72 [Anulimi i procedurës] dhe 73 [Tërheqja] të Rregullores së Punës.

Neni 44 [Saktësimi i kërkesës]

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
1.1. përshkrimi i fakteve për shkeljen e pretenduar (supozuar);
1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti; dhe
1.3. paraqitja e provave mbi të cilat mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës.

Pretendimi se Presidenti ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës është shumë serioze dhe duhet të jetë e qartë se 30 ose më shumë deputetë, të nevojshëm për të paraqitur kërkesën, nuk duhet lehtë të marrin një akuzë të tillë. Prandaj, kërkesa e tyre duhet të përmbajë një përshkrim të saktë dhe të detajuar të fakteve, dispozitat e shkelura të Kushtetutës dhe, në veçanti, prova të mjaftueshme dhe bindëse në mbështetje të akuzave të tyre. Në rastin 47/10, ankuesit kanë përmbushur kërkesat nga neni 44 dhe shpjeguan arsyet se pse, sipas mendimit të tyre, Presidenti kishte bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.
Siç është paraqitur tashmë nën "Komentin e Përgjithshëm" më lart, as neni 113.6 i Kushtetutës, as Neni 44 i Ligjit nuk përmbajnë ndonjë indikacion se si termi "shkelje serioze" duhet të kuptohet. Gjithashtu, Rregullorja përkatëse e Punës (Rregulla 72 [Anulimi i procedurës] dhe 73 [Tërheqja] janë të heshtura në këtë drejtim. Në mungesë të udhëzimit të përcaktuar në këto instrumente ligjore, Gjykata ka pasur rastin për të zhvilluar pikëpamjen e saj në konceptin e "shkeljes serioze të Kushtetutës", në rastin e mësipërm nr. KI 47/10.
Përveç nga citatet e përmendura më lart, Gjykata gjithashtu u shpreh se: "*Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme dhënë Presidentit sipas Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të supozojë se Presidenti i tyre, "që përfaqëson unitetin e popullit" dhe jo një interes sektorial ose parti politike, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo shtetas i Republikës ka të drejtë të jetë i sigurt për paanësinë, integritetin dhe pavarësinë e Presidentit të tyre. Kjo është veçanërisht kështu kur ai ushtron zgjedhje politike si në rastin kur zgjedh kandidatët që konkurrojnë nga koalicionet e mundshme për t'u bërë Kryeministër*".
Gjykata vazhdoi se "*Kjo nuk mund të thuhet kur presidenti ende mban zyrë në një nga partitë më të shquara politike në vend [...]"* dhe arriti në përfundimin se *"Presidenti ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës në bazë të nenit 88.2 të Kushtetutës duke vazhduar për të lejuar veten që të regjistrohen si Kryetar i LDK-së".*

Sa i përket përmbajtjes së nenit 44.1, ky nuk bën më shumë se elaborimin e Rregullave të përgjithshme për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, siç përcaktohet në Rregullën 29 [Paraqitja e kërkesave dhe përgjigjeve]. Siç u përmend më parë, në përgjithësi, kërkesa mund të mos duhet të përmend edhe nenin e veçantë të Kushtetutës ose të KEDNJ që pretendohet se është shkelur, për aq kohë sa kërkesa përmend thelbin e dispozitave të shkelura. Megjithatë, Neni 44.1 është më i saktë dhe në mënyrë të qartë tregon se "*dispozitat konkrete të Kushtetutës që pretendohet se janë shkelur nga Presidenti duhet të përmenden".* Në një rast të tillë të rëndë, është për t'u pritur se deputetët në fjalë do të bëjmë maksimumin e tyre për të përmbushur këtë kërkesë.

Neni 45 [Afatet]

> **Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.**

Shtrohet pyetja, çfarë hartuesit me të vërtetë menduan, kur e miratuan formulimin: "shkelja e supozuar e Kushtetutës nga Presidenti *është bërë publike".* Kjo duket të sugjerojë se disa institucione ose persona duhet së pari të bëjnë një shpallje publike për Presidentin ku thuhet se ka bërë shkelje të rëndë, para se afati kohor të fillojë të rrjedhë. Mund edhe të jetë rasti se Presidenti vetë do të bëjë një njoftim publik, i cili përmban edhe "shkeljen e rëndë", datën e cila do të jetë pika e fillimit të periudhës prej 30 ditësh.
Gjykata u deklarua për çështjen në gjykimin e saj në rastin e mësipërm nr. KI. 47/10, ku gjykata me sa duket konsideroi ngrirjen e pozitës si Kryetar i LDK-së, si data e fillimit të periudhës prej 30 ditësh të nenit 45. Ky informacion është bërë publik nga një komunikatë e lëshuar nga LDK-ja në fillim të mandatit të presidentit Sejdiu. Edhe pse kërkesa është paraqitur më shumë se 30 ditë pas datës së komunikatës, Gjykata shqyrtoi nëse mbajtja e postit të Presidentit dhe, në të njëjtën kohë, të Kryetarit të LDK-së, "*por ngrirje e asaj pozite"* ishte një situatë e vazhdueshme që ka mbetur në shkelje të Kushtetutës çdo ditë që Presidenti mbajti dy zyra ose në qoftë se kjo ishte një ngjarje e izoluar. Presidenti pranoi se ai kishte vazhduar të jetë Kryetar i LDK-së dhe President i Kosovës në çdo kohë që nga zgjedhja e tij në zyrën e Presidentit më 2006. Gjykata u shpreh se, në qoftë se ky ishte rasti, pasojat e ngrirjes së pozicionit vazhdojnë dhe, për këtë arsye, kjo ishte situatë ditore. Prandaj, Gjykata gjeti se situata në vazhdim ka vazhduar deri në këtë ditë dhe për këtë arsye afati 30 ditësh që kërkohet nga Neni 45 i Ligjit, nuk vlen në këtë rast[544].

Rregulli 71 [Njoftimi] i Rregullores së Punës

1. Pas parashtrimit të kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, Gjykata menjëherë e njofton Kryetarin dhe i dërgon një kopje të kërkesës Presidentit të Kosovës brenda tri (3) ditësh nga parashtrimi i saj në Gjykatë.

[544] Shiko për hollësi të mëtejshme tekstin e Aktgjykimit.

2. Gjykata kërkon nga Presidenti i Kosovës të përgjigjet ndaj kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës te Presidenti i Kosovës, përveç nëse ekziston arsyetim i mirë për një përgjigje më të vonshme.

I. Rregulla 71.1 tregon qartë se ky lloj i kërkesave është trajtuar nga Gjykata me përshtatshmëri nga momenti që është paraqitur[545]. Jo vetëm që Gjykata, ose më saktë, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë Kryetarin e Gjykatës (për të emëruar Gjyqtarin Raportues dhe Kolegjin shqyrtues menjëherë), por gjithashtu do të dërgojë një kopje të kërkesës Kryetarit të Kosovës, jo më vonë se 3 ditë nga dorëzimi i saj [546] në Gjykatë. Në mënyrë që të kursej kohë, gjyqtari raportues mundet, nëse ai/ajo e sheh të nevojshme, të kërkojë nga parashtruesi për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, si dhe të dorëzojë dokumentet shtesë dhe informacione të rëndësishme, në përputhje me nenin 22.4 të Ligjit.
Pyetja mund të shtrohet për çfarë arsye procedurat duhet të kryhen me shpejtësi dhe pse Presidenti i Kosovës i ka vetëm 15 ditë për të përgatitur një përgjigje në kërkesë në vend të ketë të drejtën për një periudhë prej 45 ditësh, siç jepet zakonisht për një parashtrues, në pajtim me nenin 22.2 të Ligjit. Pretendimi se Presidenti i Kosovës thuhet se ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës është i një natyre të tillë të rëndë, që mund të pritet që atij do t'i jepet një periudhë edhe më e gjatë kohore për përgatitjen e një përgjigjeje të duhur, e respektimit të institucionit të "Presidentit të Republikës së Kosovës". Për shembull, në një procedurë shkarkimi, Ligji shqiptar për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese [547]dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë [548]nuk përcakton asnjë afat kohor për përgjigjen e Presidentit. Gjithashtu në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë[549] nuk jepet afat kohor. Megjithatë, nuk përjashtohet që gjykatat kushtetuese në fjalë mund të caktojnë një afat të arsyeshëm gjatë të cilit Presidenti duhet të paraqesë komentet e tij/saj.

II. Sigurisht, sipas Rregullës 71 (2), një përgjigje e mëvonshme është e mundur si një favor, jo një e drejtë dhe vetëm nëse tregohet shkaku i arsyeshëm. Megjithatë, mund të thuhet se në qoftë se Presidenti vazhdon të ushtrojë funksionet e tij/saj nga dita e fajësimit të tij e deri sa Gjykata ka gjetur se ai/ajo ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, njerëzit kanë të drejtë të dinë sa më shpejt të jetë e mundur nëse pala e referuar kishte justifikim apo jo në paraqitjen e një kërkesë të tillë serioze para Gjykatës. Për më tepër, gjithashtu mund të mbahet se veprimet e kryera si

[545] Për të njëjtat arsye siç përcaktohet më lart, do të ishte më e përshtatshme për të përdorur termin "regjistruar" në vend të "dorëzuar".
[546] Fjala "regjistrimi" do të ishte më e përshtatshme.
[547] Neni 61.3 i Ligjit shqiptar parasheh: "*Gjykata Kushtetuese i dërgon Presidentit të Republikës një kopje të vendimit të Kuvendit dhe të provave mbështetëse, dhe ai ka të drejtë të japë sqarime me shkrim".*
[548] Neni 64.1 i Ligjit slloven përcakton: "*Gjykata Kushtetuese dërgon rezolutën mbi fajësimin e Presidentit të Republikës, i cili mund të paraqesë përgjigje në shkarkimin".*
[549] Neni 83 (2) i Ligjit kroat parasheh: "*Gjykata Kushtetuese do të marrë deklaratën e Presidentit të Republikës në lidhje me aktin e fajësimit të Parlamentit kroat dhe do t'i mundësojë atij për të marrë pjesë në procedurë".*

President gjatë periudhës së fajësimit mund të konsiderohen të pavlefshme[550]. Prandaj, sa më e shkurtër është periudha e procedurës së fajësimit, aq më shpejt Gjykata do të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën dhe të konfirmojë nëse apo jo kërkesa ishte e justifikuar dhe vendimet më të vogla që Presidenti mund të ketë qenë në gjendje për të marrë.

Megjithatë, ekziston një arsye më shumë të rëndësishme pse Rregulla 71 mund të jetë disi problematike, gjegjësisht, Neni 22.2 i Ligjit parasheh që pala kundërshtare ka 45 ditë nga marrja e kërkesës për ta dorëzuar pranë Sekretariatit përgjigjen e saj. Çështja është nëse kjo periudhë prej 45 ditësh mund të shkurtohet në 15 ditë nga një Rregull e Gjykatës. Parimi i hierarkisë së normave ligjore përcakton që Rregullorja e Punës (në këtë rast Rregulla 71 e Rregullores së Punës) nuk mund të kufizojë të drejtat e marra nga një akt normativ i Kuvendit (në këtë rast neni 22.2 i Ligjit).

Një çështje tjetër mund të lind, nëse një President i akuzuar për një shkelje të rëndë të Kushtetutës do të kërkojë një seancë dëgjimore në interes të publikut dhe për hir të transparencës, por gjykata do ta hedh poshtë kërkesën. Duket të jetë më shumë rregull se sa përjashtim që Ligjet për gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera sigurojnë që procedurat e shkarkimit nënkuptojnë një seancë dëgjimore, ku Presidenti ka mundësi që gojarisht të refuzojë akuzat[551] ose, të paktën, të lejojë praninë e Presidentit të akuzuar në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese, ku rasti i tij është në shqyrtim[552]. Megjithatë, as Kushtetuta dhe as ligji nuk përmbajnë ndonjë indikacion të veçantë se procedurat e shkarkimit të Presidentit kërkojnë seancë dëgjimore të palëve. Prandaj, supozohet se procedurat e tilla ndjekin parimin e përgjithshëm se Gjykata mund të vendosë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të një pale për të mbajtur një seancë dëgjimore (Shih më sipër komentet për nenin 20). Për shembull, në rastin e mësipërm nr. KI 47/10, Gjykata nuk ka caktuar seancë sipas detyrës zyrtare, dhe as Presidenti Fatmir Sejdiu nuk kërkoi një seancë dëgjimore.

Rregulla 72 [Anulimi i procedurës]

> **Gjykata anulon procedurat e filluara sipas nenit 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, në rast se, para lëshimit të aktgjykimit, Presidenti ka dhënë dorëheqje ose e ka përfunduar mandatin**.

Procedura e përcaktuar në Rregullën 72 devijon nga ajo e përcaktuar me nenin 23 të ligjit, i cili parasheh se "*Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura*". Sipas nenit 23, Gjykata vendos vetë se çfarë të bëj, kur një palë tërhiqet nga procedura, pasi ajo mund të përcaktojë se çështja e referuar do të meritojë

[550] Kushtetuta ose ligji nuk përmbajnë asnjë dispozitë, si neni 61 (2) i Ligjit Themelor Gjerman që siguron: "Pasi Presidenti Federal është akuzuar, Gjykata mund të lëshojë një urdhër të përkohshëm për të parandaluar atë nga ushtrimi i funksioneve të tij".

[551] Shih, për shembull, Neni 64 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë; Neni 55 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Federale;

[552] Shih, për shembull, Neni 62 i Ligjit Shqiptar për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të nenit 83 të ligjit kroat mbi Gjykatën Kushtetuese.

një vendim në interes të publikut, ndërsa Rregulla 72 përcakton se Gjykata "*do të anulon procedurën"*, në qoftë se Presidenti jep dorëheqje, ose ka ndërprerë ndryshe mandatin e tij/saj.
As ligji as Rregullorja e punës nuk duket se lejojnë Presidentin, pas dorëheqjes së tij ose ndërprerjes së mandatit, për të kërkuar që Gjykata të vazhdojë me procedurën, si, për shembull, është rasti me Shqipërinë[553] dhe Sllovenínë[554], ku, në qoftë se Presidenti kërkon për një vazhdim të tillë, Gjykata Kushtetuese nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të vazhdojë procedurën. Për shembull, Presidenti mund të ketë një interes të vlefshëm, pas dorëheqjes së tij/saj, për të parë nëse procedimi vazhdon në mënyrë që të pastrojë emrin e tij/saj për arsye të tjera, në qoftë se Gjykata konstaton se pretendimet e palës së autorizuar ishin të pabazuara. Në pamundësi për të kërkuar vazhdimin e procedurës, e drejta e Presidentit për një gjykim të drejtë mund të rrezikohet. Është sugjeruar se Neni 23, si dhe Rregulla 72, sigurojnë një mundësi të tillë.

Rregulli73 [Tërheqja] i Rregullores së Punës

> **Në rast se pala e autorizuar e tërheq kërkesën, Kryetari mund të kërkojë nga Gjykata të vazhdojë procedurën dhe të lëshojë aktgjykimin. Kërkesa e tillë përcaktohet nga Gjykata me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë.**

Rregulla 73 merret me situatën, kur pala e autorizuar (me 30 a më shumë deputetë) e tërheq kërkesën për çfarëdo arsye (mungesës së provave apo për arsye politike), ndërsa Presidenti i Kosovës mund të kërkojë nga Gjykata që të vazhdojë të merren me rastin. Ai ose ajo mund të dëshirojë të marrë rrezikun e llogaritur se Gjykata do të vendos në favor të tij/saj duke hedhur poshtë kërkesën, aq më tepër, pasi deputetët mund ta kenë tërhequr atë, duke kuptuar se arsyet për shkarkim nuk mund të provohen në mënyrë të mjaftueshme. Gjykata me siguri do të ketë kujdes për të mos u tërhequr në një lojë politike mes deputetëve dhe Presidentit dhe të gjykojë çështjen në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Megjithatë, është e paqartë pse sipas Rregullës 72, nëse pas dorëheqjes së tij/saj, Presidentit nuk i lejohet që të kërkojë nga Gjykata për të vazhduar me procedurën (si u sugjerua më lart), ndërsa sipas Rregullës 73, pasi që nismëtarët (30 ose më shumë deputetë) kanë tërhequr kërkesën, Presidenti në të vërtetë ka të drejtë për ta bërë këtë. Në fakt, në të dyja rastet, e drejta për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 KEDNJ është në rrezik. Siç sugjerohet në komentet mbi Rregullën 72, Presidenti mundet, për këtë arsye, të kërkojë vazhdimin e procedurës për arsye se përndryshe e drejta e tij për gjykim të drejtë do të jetë shkelur.
Ligji për Gjykatën Kushtetuese Gjermane përmban një dispozitë të ngjashme si Rregulla 73, nenin 52 (3) i cili siguron se "*Revokimi ose shkarkimi nuk do të ketë efekt nëse Presidenti Federal e kundërshton atë brenda një muaji".*

[553] Shih nenin 65 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: "Kur Presidenti i Republikës paraqet dorëheqjen e tij, ndërsa rasti për shkarkimin e tij është duke u dëgjuar, apo mandati i tij është ndërprerë, Gjykata Kushtetuese anulon procedurat. Gjykata Kushtetuese fillon procedurën, nëse kërkohet nga Kuvendi i Shqipërisë ose vetë Presidenti".
[554] Shih nenin 65 (4) të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë: "Në rast se Presidenti i Republikës jep dorëheqje apo nëse mandati i tij skadon gjatë procedurës, Gjykata Kushtetuese shtyn procedurën. Gjykata Kushtetuese vazhdon procedurën, nëse i akuzuari ose Kuvendi këtë e kërkon".

Rregulla nuk specifikon nëse, pas një faze të caktuar të procedurës, iniciatorët nuk mund të tërheqin kërkesën. Në mungesë të ndonjë treguesi të kundërt, është supozuar se iniciatorët mund ta bëjnë këtë për aq kohë që Gjykata nuk ka marrë një vendim për kërkesën.
Neni 52 (1) i Ligjit të mësipërm gjerman është i qartë në këtë drejtim, ku theksohet: "*Akuzimi mund të revokohet deri në shqiptimin e aktgjykimit për shkak të një vendimi nga organi që bën kërkesën. Ky vendim kërkon miratimin e shumicës së numrit ligjor të anëtarëve të Bundestagut ose shumicën e votave në Bundesrat".*

10. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës

[…]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.[555]

[…].

Procedura e ankesave individuale sipas nenit 113.7 të Kushtetutës i lejon personave fizikë qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që të pretendojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese nga aktet e autoriteteve publike dhe të kërkojë mbrojtjen e këtyre të drejtave përmes një deklarate të jo kushtetutshmërisë të këtyre akteve nga Gjykata.
Kjo procedurë e ankimit nuk është vetëm një privilegj i individëve, por edhe të personave juridikë, në kundërshtim me nenin 47 [Kërkesat individuale] të ligjit, që nuk përmban ndonjë referencë për personat juridikë[556]. Pasi që, në pajtim me Nenin 21.4 të Kushtetutës, "*Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa zbatohen"*, duhet të supozohet, siç e konfirmon edhe praktika gjyqësore e Gjykatës[557], personat juridikë në mënyrë të barabartë kanë të drejtë për mbrojtjen e të drejtave të tyre me anë të një ankese kushtetuese të dorëzuar në Gjykatë.
Për më tepër, Neni 113.7 kërkon nga ankuesit për të përmbushur disa kushte – respektivisht dëshmi se të drejtat dhe liritë e tyre individuale janë shkelur nga autoritetet publike dhe se ato kanë shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë - para se Gjykata do të jetë në gjendje për të gjykuar kërkesat e tyre.

[555] Ngjashëm me nenet 34 [Kërkesat individuale] dhe 35 [Kushtet e pranueshmërisë] të KEDNJ.
[556] Neni 47.1 i Ligjit parasheh: "*Çdo njeri ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike kur ai konsideron se të drejtat e tij saj individuale dhe liritë e garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik*".
[557] Rasti nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendimi i datës 27 Janar 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2009 2010, faqe 50; dhe në ueb-faqen e Gjykatës.

Detajet rreth këtyre kërkesave janë parashtruar në Ligjin dhe Rregulloren e Punës dhe do të komentohen në vazhdim.
Kjo e ashtuquajtura "qasje e drejtpërdrejtë" nga personat fizikë dhe juridikë të rishikimit kushtetues përfshin të gjitha mjetet ligjore që u jepen për parashtrimin e kërkesës Gjykatës, pa ndërhyrjen e një pale të tretë[558]. Në kontrast, në rast të "qasjes indirekte" në Gjykatë, çdo ankesë nga një person fizik ose juridik arrin në Gjykatë për gjykim vetëm përmes ndërmjetësimit të një organi tjetër, përkatësisht në kontekst të Kosovës, me anë të gjykatave të rregullta[559] ose Avokatit të Popullit[560], të cilat përbëjnë dy elemente të rëndësishme të një shoqërie demokratike që mbron të drejtat e njeriut.
Një mekanizëm i ngjashëm individual i ankesës parashihet në kushtetutat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera, si Shqipëria (neni 131.i i Kushtetutës së Shqipërisë), Kroacia (neni 129 i Kushtetutës Kroate), Maqedonia (neni 50 i Kushtetutës së Maqedonisë), Sllovenia (Neni 160 [Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës sllovene) dhe Gjermania (Neni 93 [Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese Federale] të Ligjit themelor gjerman).
Neni 113.7 i Kushtetutës zbatohet nga nenet 46 [Pranueshmëria], 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës], 49 [Afatet] dhe 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, ndërsa këto nene janë plotësuar nga Rregulla 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe 74 [Aktgjykimi] të Rregullores së Punës.

Neni 46 [Pranueshmëria]

> **Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.**

Sipas nenit 46, kërkesa e parashtruar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës së pari duhet të ketë përmbushur të gjitha kërkesat procedurale, para se të mund të deklarohet e pranueshme nga Gjykata dhe të gjykohet për meritat në mënyrë që Gjykata të përcaktojë nëse ka ardhur apo jo deri te shkelja e të drejtave dhe lirive kushtetuese të ankuesit. Pra cilat janë "të gjitha kërkesat ligjore" të përmendura në nenin 46 dhe ku mund të gjenden ato? Disa nga kërkesat ligjore për pranueshmërinë e kërkesës janë të përcaktuara në vetë nenin 113.7 të Kushtetutës. Ankuesi duhet:

(1) të përmend shkeljet e të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë;
(2) të tregojë cilat autoritete publike kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale; dhe
(3) të tregojë se ai/ajo i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë.

[558] CDL-AD (2010) 039, Studimi mbi Qasjen individuale ndaj Drejtësisë Kushtetuese, e miratuar nga Komisioni i Venedikut në Seancën Plenare të 85, Venedik, 17-18 Dhjetor 2010) në bazë të komenteve të Z. Gagik Harutyunyan (Anëtare, Armenia),,, Znj. Angelike Nussberger (Anëtare, Gjermani), dhe Z. Peter Packolay (Anëtar, Hungari).
[559] Shih, CDL-AD(2010)039 më sipër.
[560] Shiko komentet mbi kompetencën e Avokatit të Popullit për të referuar çështje në Gjykatë sipas nenit 135.4 të Kushtetutës dhe të nenit 15.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Kërkesat e tjera janë të dhëna në nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të komentuara në vazhdim. Për më tepër, Rregulla 36 [Kriteret e pranueshmërisë] që plotëson këto nene, përmban një listë të kërkesave të pranueshmërisë, duke përfshirë ato të përcaktuara tashmë në Kushtetutë dhe Ligj. Kjo rregull tashmë është komentuar në mënyrë të detajuar në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe Rregulla 34 [Raporti i Gjyqtarit Raportues], duke siguruar se Raporti i gjyqtarit raportues duhet të përmbajë: [...] *(e) një vlerësim tentativ të pranueshmerisë së kërkesës*; *[…]*".[561]

Neni 47 [Kërkesa individuale]

47.1 Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
47.2 Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

1 Ashtu sikur Neni 113.7 i Kushtetutës i cili përdor termin "individët", Neni 47.1 i referohet një nocioni të ngjashëm, respektivisht, "çdo individ". Megjithatë, edhe pse, siç u komentua në bazë të nenit 113.7, nocioni "çdo individ" do të thotë "çdo person fizik dhe juridik", asnjë nga dispozitat e Kushtetutës, ligjit apo Rregullores së Punës nuk përmban ndonjë tregues se sa shtrihet rrethi i personave fizik dhe juridik. Sa i përket personave fizik, jo vetëm një qytetari të Kosovës, por edhe shtetasi i huaj që viziton Republikën e Kosovës ose që banon atje, të drejtat e të cilit janë shkelur nga ndonjë autoritet publik në Kosovë ose jashtë Kosovës, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatë. Për shembull, në rastin nr. KI 121/10 (Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauranand Hom Bahadur Batterai)[562] Gjykata ka konfirmuar se shtetasit Nepalezë që banojnë përkohësisht në Kosovë kishin të drejtë për të sfiduar kushtetutshmërinë e procedurës në lidhje me anulimin e lejes së qëndrimit dhe dëbimit të tyre të menjëhershëm.
Për më tepër, edhe nocioni "person juridik" duhet të përcaktohet. Duke përdorur një arsyetim të ngjashëm, siç përdoret në rastin e personave fizikë, shprehja duhet të mbulojë personat jo vetëm juridik të përcaktuara sipas ligjit në Kosovë, si p.sh Universiteti AAB-RIINVEST SHPK në Rastin nr. 41/09,[563] por edhe personat juridikë të huaj përfaqësues të cilëve janë duke vizituar Kosovën ose që banojnë aty dhe të drejtat kushtetuese e të cilëve janë shkelur nga ndonjë autoritet publik në

[561] Shiko komentet e hollësishme për Rregullën 36 më sipër.
[562] Rasti nr. 121/10, Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauran dhe Hom Bahadur Batterai, respektivisht, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të vendimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL.nr. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, i datës 22 nëntor 2010, Aktvendimi mbi papranueshmërinë, i datës 14 Dhjetor 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 669; dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[563] Rasti nr. KI 41/09, AAB-RIINVEST Universiteti SHPK kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendimi i datës 27 Janar 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2009-2010, faqe 50; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Kosovë ose jashtë[564] Kosovës. Lind pyetja nëse shprehja "person juridik" përfshin si persona juridikë privatë dhe publikë. Për shembull, në rastin nr. KI 25/10,[565] në të cilin Gjykata shqyrtoi vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që është kundërshtuar nga një autoritet publik, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Gjykata u shpreh se kërkesa ishte e pranueshme, duke gjetur, ndër të tjera, se parashtruesi ishte një palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7, pasi që Ligji për AKP-në i kishte dhënë asaj "personalitet të plotë juridik".

Kështu, në parim, çdo autoritet publik me "personalitet të plotë juridik" ka të drejtë për të sjellë një ankesë kushtetuese para Gjykatës, për shembull, duke kundërshtuar një vendim të gjyqtarit me të cilin të drejtat e tij të pronësisë, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe Neni 1 [E drejta e pronës] e Protokollit 1 të KEDNJ-së, dyshohet se është shkelur. Duhet të jetë e qartë se, si person privat juridik në rastin nr. 41/09, personi përkatës juridik publik duhet në mënyrë të barabartë të përmbushë të gjitha kushtet e pranueshmërisë të nevojshme për të mundësuar Gjykatës të gjykojë ankimin e vet kushtetues mbi meritat.

Kërkesa për mbrojtje juridike nga Gjykata (ose, siç përdoret shpesh: kërkesa për rishqyrtim kushtetues)[566] e mundëson që personat fizikë dhe juridikë të sfidojnë para Gjykatës kushtetutshmërinë e aktit individual ose veprimin e një autoriteti publik, duke përfshirë gjykatën e rregullt, që (1) dyshohet se ka shkelur drejtat e tyre kushtetuese direkt ose (2) është e bazuar mbi një akt normativ (p.sh. ligj ose rregullore)[567] - që do të aplikohet nga administrata apo gjyqtari - e cila pretendohet se është jo kushtetuese. Në rastin e parë (nën (1), është më tepër akti ose veprim individual i administratës apo vendimi i gjyqtarit i cili është duke u gjykuar se sa norma,[568]ndërsa në rastin e dytë (nën (2)), është norma e cila është duke u shqyrtuar.

Me pak fjalë, personat fizik apo juridik mund të ankohen për çdo akt individual të një autoriteti publik që shkel drejtpërdrejt të drejtat e tyre kushtetuese ose mund të sfidojnë një akt normativ, i cili është drejtpërdrejt i zbatueshëm për ta, për të njëjtat arsye. Megjithatë, Gjykata nuk mund të ndërhyjë në bazë të asaj se një gjykatë vendase ka sjell një vendim të gabuar ose gabimisht ka aplikuar ligjin. Gjykata mund, pra, të mos shqyrtojë ligjshmërinë e aktit apo vendimit të kontestuar individual, por vetëm kushtetutshmërinë e tij. Përndryshe, Gjykata do të kthehet në

[564] Për shembull, në një Ambasadë ose Konsullatë të Republikës së Kosovës.

[565] Rasti 25/10, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-089, të datës 4 shkurt 2010, aktgjykimi i 31 mars 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 156; dhe në ueb faqen e Gjykatës.

[566] Deri më tani, numri i ankesave kushtetuese të individëve dhe personave juridikë të marra nga Gjykata e përfaqëson 90% të gjitha rasteve të paraqitura në Gjykatë.

[567] Sipas Studimit mbi Qasjen individuale të Drejtësisë Kushtetuese, të miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e tij të 85-të Plenare (Venedik, 17-18 Dhjetor 2010), aktet normative janë traktate ndërkombëtare, nëse këto kanë vlerë infra-kushtetues, ligjet dhe Rregullës që kanë forcën e ligjit, vendimet dhe rregulloret nga ana e ekzekutivit, Rregullës e përgjithshme të organeve lokale vetëqeverisëse që kanë një efekt përgjithësisht detyrues, që është, pa dallime në adresim.

[568] Shih, "Roli dhe Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese", Raport nga prof. Luis Lopez Guerra, Spanjë. Roli i Gjykatës Kushtetuese në konsolidimin e shtetit të së drejtës, Procedura e Seminarit UniDem, të organizuar në Bukuresht: 8-10 Qershor 1994, Komisioni i Venedikut, Press i Këshillit të Evropës, 1994, CDL-STD (1994) 010.

një gjykatë të mëtejme të apelit pra një gjykatë e shkallës së katërt[569], në vend të jetë një zëvendësues i gjykatave të zakonshme, kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut[570].

Pasi të jetë ngarkuar me një ankesë kushtetuese, Gjykata, duke vepruar si një organ gjyqësor[571], mbahet për të siguruar mbrojtje ligjore ankuesit sipas nenit 47 të Ligjit. Kështu, procedura e ankesës kushtetuese përbën thjesht një mekanizëm plotësues shqyrtimi, ndërsa gjykatat e rregullta fillimisht kanë mundësinë për të përcaktuar çështjet e ngritura në bazë të Kushtetutës nga ankuesit dhe të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e supozuar të Kushtetutës[572], natyrisht, duke supozuar se rendi juridik në Kosovë është në gjendje të ofrojë një zgjidhje të efektshme[573] që është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të riparuar shkeljen e pretenduar.

Së fundmi, termi "autoritet publik" nuk është i përpunuar nga neni, ndryshe nga, për shembull, ligjet për gjykatat kushtetuese të Kroacisë dhe Sllovenisë. Neni 62 (1) të Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë[574] thotë: "*Çdo person mund të paraqesë një ankesë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, nëse e vlerëson se akti individual i një organi shtetëror, një organi lokal dhe rajonal të vetëqeverisjes, ose personi juridik me autoritet publik, i cili vendosi për të drejtat dhe obligimet e tij/saj* […]", ndërsa neni 50 (1) i Kapitulli V. Ankesa Kushtetuese të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë parasheh[575]: "*Për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ankesa kushtetuese mund të parashtrohet, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, kundër akteve individuale nga autoritetet shtetërore, autoritetet e komunitetit lokal, apo mbajtës të autoritetit publik* […]".

Supozohet se shprehjet "autoritet publik", e përdorur në nenin 47, si dhe "autoritetet publike" të përmendura në nenin 113.7 të Kushtetutës, mbulojnë të njëjtat autoritete si ato të përmendura në dispozitat e ligjeve të mësipërme të Kroacisë dhe Sllovenisë. Nëse është kështu, parashtruesi i ankesës duhet të tregojë

---

[569] Shih, Mekanizmi unik i ankesës si një mjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut: Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, faqe 7.

[570] Shih, për shembull, Rasti nr. 06/09, X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale Nr. 217/2004, Vendimi i datës 17 Qershor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 169; dhe botuar në ueb faqen e Gjykatës.

[571] Gjykatat Kushtetuese interpretojnë Kushtetutën në bazë të fakteve që janë të vendosura nga gjykatat e rregullta dhe janë mbyllur për zbatimin e Kushtetutës në ato fakte të cilat gjykatat e rregullta kanë deklaruar si të provuara: shih raportin "Kufijtë e fakteve, ligjit dhe mjetet juridike: mitet dhe realitetet e rishikimit kushtetues të vendimeve gjyqësore, Përvoja e Gjykatës Kushtetuese të Spanjës" nga Ignacio Borrajo Iniesta, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës, Konferenca e Komisionit të Venedikut "Kufijtë e shqyrtimit Kushtetues të vendimeve të gjykatave të rregullta në procedurat e ankesave kushtetuese", Brno, Republika Çeke, 14-15 nëntor 2005. Sipas mendimit të autorit, "*gjykatat vendimet e të cilëve janë të sfiduar asnjëherë nuk janë palë në Gjykatën Kushtetuese*".

[572] Rasti nr. KI 41/09, Universiteti AAB SHPK, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendimi i datës 27 Janar 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 50; dhe në ueb faqe të Gjykatës.

[573] Shih, edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ, p.sh. Selmouni kundër Francës, Kërkesa nr. 258031/94, Aktgjykimi i 28 korrikut 1999.

[574] Gazeta Zyrtare (Narodne Novina) Nr 49/02 nga 3 Maj 2002.

[575] Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, nr. 64/07.

se shkelja e pretenduar është kryer nga një autoritet shtetëror apo komunal[576] si dhe personat juridikë me autoritet publik, duke përfshirë personat ose institucionet për aktet e të cilit një autoritet publik është përgjegjës[577]. Nëse, në rastin e personave dhe institucioneve të tilla, parashtruesi nuk mund të tregojë se një autoritet publik është përgjegjës për veprimet e tija, Gjykata do të duhet të hedhë poshtë kërkesën si *rationepersonae* të papajtueshme.

Sipas nenit 47.1 të Ligjit, vetëm shkelja e një të drejte ose lirie të garantuar me Kushtetutë mund të kërkohet para Gjykatës. Kur e drejta ose liria e supozuar nuk përmendet në Kushtetutë, duke përfshirë ndonjë nga instrumentet ndërkombëtare (Deklarata Universale, KEDNJ dhe të tjerët), të cilat në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti në Kosovë, ose kur ankesa është jashtë shtrirjes së drejtës kushtetuese ose lirisë të kërkuar nga paditësi, Gjykata do të duhet të refuzojë padinë si të papajtueshme *rationemateriae*.[578]

Megjithatë, mund të jetë se as në procedurat para gjykatave të rregullta as në referimin para Gjykatës, ankuesi nuk ka formuluar shprehimisht të drejtën e veçantë ose lirinë e garantuar nga Kushtetuta, por këtë e ka bërë këtë në mënyrë implicite ose në substancë. Në këtë drejtim, GJEDNJ ka konsideruar, për shembull në Aplikimin Nr. 56.679, *Azianas kundër Qipros*, Aktgjykimi i GJEDNJ i datës 28 prill 2004, se: "38. Përderisa në kontekstin e makinerive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut Rregulla e shterjes të mjeteve të brendshme duhet të aplikohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepërt, kjo nuk kërkon thjesht që aplikimet duhet të bëhen në gjykatat përkatëse të vendit dhe se përdorimi duhet të bëhet nga mjetet juridike të hartuara për të kundërshtuar vendimet që dyshohet se shkelin një të drejtë të Konventës. Kjo zakonisht kërkon gjithashtu që ankesat që kanë për qëllim të bëhen më pas në nivel ndërkombëtar, duhet të ishin transmetuar para këtyre gjykatave të njëjta, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në legjislacionin e brendshëm (shih, në mesin e shumë autoriteteve tjera, Fressoz dhe Roire k. Francës [GC], nr. 29183/95, § 37, ECHR 1999-I). Objekti i Rregullës së shterimit të mjeteve të brendshme është për të lejuar autoritetet kombëtare (kryesisht autoritetet gjyqësore) për të trajtuar pretendimet për shkelje të një të drejte dhe, kur është e përshtatshme, për të mundësuar rivendosje para se pretendimi t'i paraqitet Gjykatës (shih Kudla k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 152, ECHR 2000-XI). Në masën që ekziston në nivel kombëtar një mjet juridik i përshtatshëm për gjykatat kombëtare për të adresuar, të paktën në thelb, argumentin e shkeljes së të drejtës nga Konventa, ajo është mjeti i cili duhet të përdoret. Nëse ankesa që paraqitet para Gjykatës (për shembull, ndërhyrja e pajustifikuar në të drejtën e pronës) nuk është vënë, ose shprehimisht ose në thelb, para gjykatave kombëtare, kur ajo mund të ketë qenë e ngritur në ushtrimin e një mjeti juridik në dispozicion të aplikuesit, rendit juridik kombëtar i është mohuar mundësia për të adresuar çështjen e Konventës të cilin

[576] Shih, për shembull, rasti nr. KI 63/09, Bajram Santuri, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 368 / 2000 të datës 8 Maj 2003, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.46 / 2005 (C. nr. 99 / 07) të 28 Dhjetor 2006, si dhe vendimet e gjykatave suedeze dhe vendimet No. 8329 / 06 dhe 9005/07 e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

[577] Shih, praktika gjyqësore e GJEDNJ: Për shembull, Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë [GC], para. 318.

[578] Shiko komentet gjithashtu me detaje për Rregullën 36.

Rregulla në shterimin e mjeteve të brendshme juridike ka për qëllim për t'i dhënë. Nuk është e mjaftueshme që aplikanti pa sukses mund të ketë ushtruar një tjetër zgjidhje e cila do të mund të përmbysë masën e kundërshtuar për arsye të tjera, jo të lidhura me ankesën për shkeljen e një të drejte. Është ankesa për Konventën e cila duhet të ketë qenë transmetuar në nivel kombëtar që të ketë shterje të "mjeteve efektive". Do të ishte në kundërshtim me karakterin subsidiar të mekanizmave të Konventës nëse një aplikant, duke injoruar një argument të mundshëm të Konventës, do të mund të mbështetet në një bazë tjetër përpara autoriteteve kombëtare për të sfiduar një masë të kundërshtuar, por pastaj të paraqet një kërkesë para Gjykatës në bazë të argumentit të Kovencione (shih Van Oosterwijck k. Belgjikës, të datës 6 nëntor 1980, A Seria nr. 40, f. 16-17, §§ 33-34).

Në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ, Gjykata ka përcaktuar se "*nuk është e nevojshme që drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë, për sa kohë që çështja është ngritur në mënyrë implicite ose ne substance"*.[579] Megjithatë, kur ankuesi nuk ka vepruar kështu, Gjykata do të jetë e detyruar të refuzojë kërkesën si te papranueshme për arsye se ai/ajo nuk ka përmbushur kërkesën e pranueshmërisë që parashtruesi i ankesës duhet së pari të tregojë se ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë (kjo çështje do të komentohet më tej nën Rregullën e shterimit të përcaktuar në nenin 47.2 më poshtë).

Së fundmi, ankesa në abstrakte për legjislacionin ose aktet e autoriteteve publike që nuk janë aplikuar për parashtruesit personalisht nëpërmjet një mase të zbatimit apo që në ndonjë mënyrë tjetër nuk aplikohen direkt ndaj tyre, do të duhej po ashtu të refuzohen nga Gjykata si të papranueshme, pasi që parashtruesit e tillë nuk mund të konsiderohen të jenë viktimë të një shkelje të drejtave kushtetuese në kuptim të nenit 47.1. Ankesa të tilla që nuk kanë lidhje me një rast specifik janë të njohura si "*actiopopularis*,"duke lënë të kuptohet se çdo person ka të drejtë të ndërmarrë veprime kundër një akti normativ, pas miratimit të tij, pa pasur nevojë për të provuar se të drejtat e tij/saj kushtetuese janë aktualisht dhe drejtpërdrejt të prekur nga kjo dispozitë[580].

Në disa raste, Gjykata ka hedhur poshtë kërkesat duke gjetur se një ose më shumë dispozita të një akti normativ pretendohet se kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, duke deklaruar se "*Kushtetuta nuk parashikon një"actiopopularis"të iniciuar nga një individ i cili nuk mund të tregojë se ai/ajo është i prekur drejtpërdrejt nga shkelja e pretenduar kushtetuese*".[581]

---

[579] Shih, në rastin e mësipërm nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST SHPK kundër të Qeverisë së Kosovës.

[580] Shih, CDL-AD (2010) 039 rev, Studimi për qasje individuale në drejtësi kushtetuese, të miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e tij të 85-të Plenar (Venedik, 17-18 Dhjetor 2010).

[581] Shih, për shembull, rasti nr. KI 102/11, Shahe Ramaj kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Aktvendimi mbi papranueshmërinë i datës 12 Dhjetor 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 606; dhe në ueb faqen e Gjykatës. Rasti nr. KI 45/09, Teki Bokshi, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/13 (i ndryshuar dhe zëvendësuar), Aktvendimi për papranueshmërinë i datës 30 nëntor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 13; dhe në faqen e internetit të Gjykatës. Rasti KI 118/10, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 14.1.7 të Ligjit nr. 03 / L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, Aktvendimi mbi pranueshmërinë i datës 14 nëntor 2011, Buletini i praktikës gjyqësore 2011, faqe 518; dhe në faqen e internetit të Gjykatës.

Në Evropë, Kushtetuta hungareze ka parashikuar një *actiopopularis* deri kohët e fundit, ku individët mundet të nisin një proces të kontrollit abstrakt duke paraqitur një kërkesë Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se një normë ishte jo kushtetuese, pa qenë e nevojshme të provojnë se ata ishin vetë viktimë e një shkeljeje të drejtave të tyre kushtetuese.[582] Në Kroaci përdorimi i shpeshtë i *actiopopularis* ka çuar në mbingarkesën e gjykatës kushtetuese.[583] Gjithashtu KEDNJ nuk parashikon një shqyrtim të tillë dhe ankesa të tilla janë hedhur poshtë nga GJEDNJ si *"rationepersonae"* të papajtueshme[584] (Shih komentet për Rregullën 36 (3) (f).

Megjithatë, siç është diskutuar në nenet 48 dhe 49 [Afatet] më poshtë, në rrethana të caktuara aplikuesi mund të paraqesë direkt një kërkesë në Gjykatë, e cila është bërë kundër një ligji ose kur Gjykata, kur kërkohet për të vendosur mbi një kërkesë individuale, "*në mënyrë për të riparuar shkeljen [...] duhet ultra petitum të vendos mbi ligjin i cili shkakton shkeljen"*[585].

2 Në bazë të nenit 47.2, parashtruesi i ankesës duhet të tregojë:

(1) të ketë përdorur të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi në Kosovë, duke përfshirë edhe një ankesë të autoritetit më të lartë kompetent publik, dhe nëse të pasuksesshme, në gjykatat kompetente, duke përfshirë edhe shkallën më të lartë të mundshme (p.sh. në shumicën e rasteve, Gjykata Supreme e Kosovës);

(2) të ketë ngritur më parë ankesë kushtetuese, e cila tani është duke u dorëzuar në Gjykatë, të paktën në mënyrë implicite ose në substancë[586], gjatë procedimit para autoriteteve përkatëse publike dhe/ose gjykatave të rregullta gjatë procesit të shterimit.

Arsyetimi i Rregullës së shterimit është, siç u përmend në komente të detajuara për Rregullën 36 (1) (a) më sipër,[587] që autoritetet publike, duke përfshirë gjykatat, duhet të kenë mundësinë për të korrigjuar këtë çështje vetë dhe të parandalojnë ose korrigjojnë shkeljen e një të drejte kushtetuese ose të konventës[588]. Kështu, Gjykata është më tepër një institucion mbikëqyrës i instancës së fundit, ndërsa puna kryesore e zbatimit të drejtave të njeriut duhet të kryhet nga autoritetet publike, duke përfshirë gjykatat, të cilët janë në pozitë më të mirë për ta bërë

[582] Neni 32 / A (4) të Kushtetutës së Republikës së Hungarisë dhe neni 21 (2) i Ligjit hungarez për Gjykatën Kushtetuese siguron një sistem të tillë, para se ai u hoq nga parlamenti në Dhjetor 2011. *Actio popularis* është gjetur edhe në juridiksionet kushtetuese të vendeve të Amerikës Latine, si Kolumbi dhe Nikaragua. Shih për detaje, Opinionin mbi tre çështje ligjore që dalin në procesin e hartimit të Kushtetutës së re të Hungarisë, të miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e tij të 86-të Plenar (Venedik, 25-26 mars 2011), Doc. CDL-AD (2011) 001.

[583] Komisioni i Venedikut ka deklaruar në mënyrë kritike mbi këtë çështje. Shih, CDL-AD (2008) 030, Opinioni mbi Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi.

[584] Shih, për shembull, *Scordino kundër Italisë (nr 1), [GC}, nr. 36813/97, GJEDJN 2006-II.*

[585] Shih, botimin "Mekanizmi unik i ankesës si një mjet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut: Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, faqe 15.

[586] Shih, Rasti nr. 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST SHPK, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu, praktika gjyqësore e GJEDNJ: për shembull, Cardot kundër Francës, Kërkesa nr. 11069/84, GJEDNJ vendim i datës 19 mars 1991, para. 34.

[587] Rregulla 36 (1) (a) thotë: [Gjykata mund të merret me kërkesa, në qoftë se] "*Të gjitha mjetet juridike efektive që janë në dispozicion sipas ligjit kundër aktgjykimit ose vendimit të kundërshtuar janë shterur"*

[588] Shih, Rasti 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST,SHPK, Prishtinë kundër Qeverisë së Kosovës.

këtë.[589]Në bazë të nenit 47.2, nga parashtruesi varet t'i tregojë Gjykatës se shkelja e supozuar e të drejtave kushtetuese nuk është evituar nga rendi juridik i Kosovës.
Vijon se rendi juridik i Kosovës duhet t'i sigurojë të gjithëve mjete efektive juridike të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës, duke siguruar se: "*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast se ndonjë e drejte e garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj është shkelur ose mohuar dhe ka të drejtën në mjete efektive juridike nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".* Neni do të sigurojë se çdo person fizik dhe juridik duhet të ketë të drejtë për mbrojtje gjyqësore nga gjykatat sa herë që të drejtat e tyre kushtetuese janë shkelur ose mohuar dhe, pasi që gjykata gjen një shkelje të tillë, presim që gjykata duhet të jetë në gjendje për të përmirësuar situatën jo kushtetuese në mënyrë adekuate dhe efektive ose nëpërmjet një mjeti efektiv.
Në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, duhet t'i referohemi nenit 13 KEDNJ i cili parashikon për një të drejtë të ngjashme: "*Të gjithë të drejtat dhe liritë e të cilëve, siç përcaktohet në këtë Konventë janë të shkelura, kanë një ilaç efektiv para një autoriteti kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga një person që vepron në cilësi zyrtare*". Sipas GJEDNJ-së në Udhëzuesin e saj praktik mbi kriteret e pranueshmërisë, të lëshuara në dhjetor 2010[590], "ekzistenca e mjeteve juridike duhet të jetë mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Në përcaktimin nëse ndonjë mjet i veçantë i plotëson kriteret e disponueshmërisë dhe efektivitetit, duhet kushtuar rëndësi rrethanave të veçanta të çështjes. Gjykata (GJEDNJ) duhet të marrë parasysh në mënyrë reale jo vetëm mjetet juridike formale në dispozicion në sistemin e brendshëm juridik, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin vepron, si dhe rrethanat personale të parashtruesit.[591] Ajo duhet të shqyrtojë nëse, në të gjitha rrethanat e çështjes, parashtruesi bëri gjithçka që në mënyrë të arsyeshme mund të pritet prej tij/saj për të shterur mjetet e brendshme".[592]
Sa i përket fushëveprimit të Nenit 13 KEDNJ, Gjykata kujton, për shembull në rastin nr. 06/10, se "*në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në (nivel kombëtar) të një mjeti për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdo forme që mund të ndodhë për të shërbyer në rendin e brendshëm juridik. Efekti i nenit 13 është prandaj të kërkojë ofrimin e një mjeti të brendshëm për t'u marrë me thelbin e një "pretendimi të argumentuar" sipas Konventës dhe për të dhënë ndihmë të përshtatshme. Shtrirja e detyrimit sipas nenit 13 të Konventës ndryshon në varësi nga natyra e ankesës së parashtruesit; megjithatë, mjeti që kërkohet nga neni 13 duhet të jetë "efektiv" si në praktikë ashtu edhe në ligj. As "autoriteti" i përmendur në dispozitë domosdoshmërisht duhet të jetë një autoritet gjyqësor; por në qoftë se nuk është, kompetencat e tij dhe garancitë që ai ofron janë relevante për të përcaktuar nëse mjeti që ofron është efektiv. Gjithashtu,*

[589] Shih, për qasjen e GJEDNJ: A Practisioner's Guide to the European Conventionon Human Rights by Karen Reid.
[590] Të shkarkohet nga ueb faqja e GJEDNJ.
[591] Shih, për shembull, *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë* nr. 57942/00 dhe 57945/00, Aktgjykimi i GJEDN i datës 24 Shkurt 2005, para. 116-117.
[592] Shih, për shembull, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* [DHM], nr. 57325/00, GJENDJ 2007-XII, para 116-22.

edhe në qoftë se një mjet i vetëm, tërësisht vetvetiu nuk i kënaq kërkesat e nenit 13, shuma e mjeteve të parapara me ligjin e vendit mund të bëjë këtë (shih, Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykim i datës 25 mars 1983, Seria A nr. 61, f. 42, para. 113)".

Megjithatë, mund të jetë se rendi juridik i Kosovës nuk parasheh mjete efektive ligjore siç kërkohet me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 KEDNJ. Në këtë rast, varet nga parashtruesit për të provuar se ky është rasti dhe se ai/ajo duhet të përjashtohen nga kërkesa e shterimit, pasi që nuk ka mjet ose mjeti juridik ekzistues është i paefektshëm[593] ose i papërshtatshëm[594] në rrethanat e rastit ose se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta të shfajësimin e atij / asaj nga kërkesa e shterimit sipas parimeve të përcaktuara nga Gjykata në rastin e mësipërm. Kështu, nëse parashtruesi është i suksesshëm duke bërë këtë, Gjykata mund të marrë parasysh në mënyrë të ngjashme si në rastin e mësipërm të GJEDNJ se ai/ajo nuk duhet të jetë në përputhje me Rregullën e shterimit (Shih, për shembull, rasti nr. KI. 06/10)[595].

Siç ka ndodhur në këtë rast,[596] Gjykata së pari mori parasysh pyetjen nëse mungesa e një mjeti juridik efektiv në vetvete përbënte një shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës në bazë të nenit 54 të Kushtetutës. Megjithatë, duke analizuar Aktgjykimin, duket se parashtruesi nuk është bazuar, si i tillë, në nenin 54 të Kushtetutës, por vetëm është ankuar "*se nuk ka pasur mjete juridike në Kosovë që do të mund të përdoren për të korrigjuar gjendjen e tij*". Sipas atij, "*ka pasur një nevojë për të krijuar mekanizma brenda shtetit për qytetarët e Kosovës që janë në situatën e tij për të parandaluar shkelje të mëtejshme e të drejtës për t'u pajisur me pasaportë".* Gjykata me të vërtetë gjeti se parashtruesi nuk duhej që të shterojë mjetet e jashtëzakonshme juridike që nuk dukej të jenë efektive, dhe u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, duke konfirmuar se do të ishte e mjaftueshme për parashtruesin për t'u bazuar në të drejtën e dhënë me nenin 54 në mënyrë "implicite" ose "në substancë".

Në të njëjtin rast, Gjykata gjithashtu konfirmoi se, "*Sipas jurisprudencës të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, parashtruesit i kërkohet t'i shterin mjetet juridike vendore që janë në dispozicion dhe efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepërt.*[597] *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut më tej pranoi se Rregulla e shterimit nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet automatikisht; në shqyrtimin nëse ishte respektuar, është e domosdoshme që të merren parasysh*

[593] Shih, për shembull, Rasti nr. KI 108/10, Fadil Selmanaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit A.no.170 / 2009 i Gjykatës së Lartë, datë 25 Shtator 2009, vendimi i datës 5 Dhjetor 2011, Buletini i praktikës gjyqësore 2011, faqe 579; dhe botuar në ueb faqen e Gjykatës.

[594] Shih, *mutatis mutandis*, *Akdivar kundër Turqisë,* 16 Shtator 1996, 1996-IV, nr. 15.

[595] Rasti nr. KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, vendim i datës 30 Tetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 344; dhe në ueb faqe të Gjykatës.

[596] Shih gjithashtu, praktikën gjyqësore të GJEDNJ, për shembull, *Vanek kundër Sllovakisë,* Vendimi mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 31 Maj 2005.

[597] Shih, *Lehtinen kundër Finlandës*, Kërkesa nr. 39076/97, Vendimi mbi pranueshmërinë, GJEDNJ 1999-VII.

rrethanat e veçanta të çdo rasti individual. Kjo do të thotë ndër të tjera se duhet të merret parasysh në mënyrë reale jo vetëm ekzistenca e mjeteve juridike formale në sistemin juridik të vendit në fjalë, por edhe konteksti i përgjithshëm juridik dhe politik në të cilin ata veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesve (shih Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Akdivar k. Turqisë, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996). Për më tepër, kur një mjet i sugjeruar nuk ofron në të vërtetë perspektivë të arsyeshme për sukses, për shembull në dritën e praktikës gjyqësore vendore, fakti se parashtruesi nuk e ka përdorur atë nuk është pengesë për pranueshmërinë (shih Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Pressos Compania Naviera SA kundër Belgjikës i 20 nëntorit 1995, paragrafi 27;.... Radio Franca kundër Francës, nr. 53984/00, Aktgjykim i datës 23 shtator 2003, paragrafi 33).. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, autoritetet administrative përbëjnë një element të një shteti që respekton sundimin e së drejtës dhe interesat e tyre përkojnë me nevojën për administrimin e duhur të drejtësisë. Kur autoritetet administrative refuzojnë ose nuk janë në përputhje, apo edhe vetëm shtyjnë bërjen, garancitë që i gëzon një palë ndërgjyqësе gjatë fazës gjyqësore të procedurës janë vlerësuar si të zhveshura nga qëllimi i tyre (shih mutatis mutandis, Hornsby k. Greqisë, Aktgjykim i datës 19 mars 1997, Raportet 1997-II, f. 511, para. 41)".

Kështu, në rastin nr. KI. 06/10, Gjykata e ka ndjekur praktikën gjyqësore të GJEDNJ, se Rregulla e shterimit, e cila nuk është as absolute as në gjendje të zbatohet automatikisht, duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepërt. Gjykata më tej përmend një numër kriteresh të tjera të shterjes të cilat një parashtrues i ardhshëm duhet t'i lexojë me kujdes së bashku me vendimet e GJEDNJ[598].

Për shembull, mund të jetë që një gjykatë e zakonshme e lejon një rast të zvarritet për një periudhë të paarsyeshme kohore, pa pasur ndonjë tregues serioz se ajo do të përfundojë punimet në të ardhmen e afërt[599]. Nëse gjykata në fjalë injoron kundërshtimin e ankuesit, ai/ajo nuk duhet të ketë të nevojshme për të shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion duke pasur nevojë të pres përfundimin e procedurës, por duhet të lejohet të paraqesë ankesë direkt në një gjykatë më të lartë, ose, nëse është e aplikueshme, drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese[600]. Kështu, kërkuesi mund të ankohet, nga njëra anë, që për shkak të vonesave të gjata procedimet e gjykatës në fjalë nuk mund të konsiderohen si një zgjidhje efektive, duke e përjashtuar atë nga detyra për t'i shterur ato, dhe, nga ana tjetër, që e drejta e tij/saj për gjykim të drejtë brenda një periudhe të arsyeshme kohore është shkelur (e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 KEDNJ)[601].

---

[598] Është gjithashtu interesante për të lexuar Udhëzuesin Praktik të Këshillit të Evropës/GJEDNJ mbi kriteret e pranueshmërisë, të botuar në vitin 2011, Kapitulli I. Bazat procedurale për papranueshmëri, A. Mos-shterimi i mjeteve të brendshme juridike, faqet 15 deri 20.

[599] Shih, për shembull, *Bati dhe të tjerët kundër Turqisë,* nr. 33097/96 dhe 57834/00, Aktgjykimi i GJEDN i datës 3 Qershor 2004.

[600] Shih, për shembull, *Sussmann kundër Gjermanisë, nr.* 20024/92, Aktgjykimi i GJEDN i datës 16 Shtator 1996.

[601] Shih, për shembull, praktika gjyqësore e GJEDNJ:. *Castells kundër Spanjës*, nr. 11798/85, Aktgjykimi i GJEDNJ 23 prill 1992.

Gjithashtu, në rastet kur parashtruesi është në gjendje të tregojë se respektimi i shterimit do të shkaktonte dëme të pariparueshme, duhet zakonisht që shterimi i mjeteve juridike nuk do të jetë i nevojshëm. Ky mund të jetë rasti, nëse parashtruesi do të jetë ekspozuar ndaj rrezikut të përsëritjes ose masave të tjera nga autoritetet, nëse ai/ajo do të përpiqet të paraqesë ankesat e tij/saj të drejtave të njeriut për autoritetet kompetente[602].

Megjithatë, kjo situatë mund të ndodhë edhe në procedurat e rishikimit kushtetues para gjykatës kushtetuese. Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka vendosur se e drejta për drejtësi kushtetuese nënkupton gjithashtu se gjykatat kushtetuese të miratojnë vendimet e tyre brenda një vonesë të duhur për të respektuar këtë të drejtë (shih, GJEDNJ, 16 shtator 1996, *Suessmannk Kundër Gjermanisë*, Aplikimi Nr. 20024/92). Pra, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, Gjykata do të duhet të zbatojë këtë vendim të GJEDNJ në vendosjen e kërkesave.

Përveç këtij rasti, GJEDNJ ka zhvilluar jurisprudencë në bazë të nenit 6 të KEDNJ, për pyetjen kur kohëzgjatja e procedurave gjyqësore shkel KEDNJ, duke marrë parasysh periudhën përkatëse dhe arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës (kompleksiteti i rastit, sjellja e parashtruesit; sjellja e gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike; dhe arsyet për kujdes të veçantë). Sipas prof. dr. Martin Kuijer, kjo çështje e vetme ende përbën më shumë aktgjykime të GJEDNJ-se sa çdo çështje tjetër. "*Është e qartë se pse procedurat e shpejta gjyqësore konsiderohen esenciale nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, është shprehje që shpesh përdoret në këtë drejtim. Nëse shoqëria e sheh se zgjidhja gjyqësore e mosmarrëveshjeve, funksionon shumë ngadalë, ajo do të humb besimin e saj në institucionet gjyqësore. Edhe më e rëndësishmja, administrimi i ngadalshëm i drejtësisë do të minojë besimin e shoqërisë në zgjidhjen paqësore të konflikteve. Në çështje gjyqësore të korporatave, palët në procedurë duhet të kenë siguri ligjore brenda një afati të arsyeshëm ose kjo do të ndikojë në aktivitetet ekonomike dhe gatishmërinë e korporatave për të bërë investime financiare. Në kontest civil, siç janë çështjet e kujdestarisë, ka një interes të madh personal që të ketë një rezultat të shpejtë të procedurës, edhe për shkak se kalimi i kohës mund të forcojë situata de facto të cilat nuk mund të jenë në përputhje metë drejtat de jure. Në të drejtën administrative, mund të referohemi mungesës së dëshirës për të zgjatur ndihmën azilkërkuesve (të refuzuar). Frenimi i të drejtës penale do të jetë efektiv vetëm nëse shoqëria e sheh se autorët e krimit janë të dënuar brenda një kohe të arsyeshme, ndërsa subjektet e pafajshme të pamohueshme kanë një interes të madh në përcaktimin e shpejtë të pafajësisë së tyre* (shënim: shih, e drejta për gjykim të drejtë:. mjet efektiv për procedurat tepër të gjata (nenet 6 dhe 13 të GJEDNJ, nga Prof. dr. Martin Kuijer, 28 shkurt 2013 Krakov, Poloni, Seminar EJTN "Mjetet efektive, procedura të zgjatura dhe Qasja në Drejtësi në BE).

Kështu, një pyetje është: kur kohëzgjatja e procedurës konsiderohet tepër e gjatë dhe se çfarë lloj të kompensimit mund të jetë në dispozicion të parashtruesit në rast se është gjetur shkelje. Sigurisht, Gjykata mund të vendosë që Kosova është e obliguar që të organizojë sistemin e saj ligjor për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e Kushtetutës dhe KEDNJ. Megjithatë, pyetja është, çfarë kompensimi

[602] Shih, për shembull, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, [DHM], 16 Shtator 1996, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV.

mund t'i ofrohet parashtruesit. (Fusnota: GJEDNJ ka vendosur shkallët për vlerësimin e drejtë të dëmit jo-monetar të pësuar si rezultat i zgjatjes së procedurave dhe konsiderohet se një shumë e ndryshme në mes 1.000 dhe 1.500 euro për kohëzgjatjen e vitit të procedurës është një bazë për llogaritjen siç është përmendur nga Prof. dr. Martin Kuijer).

Sa i përket numrit të referimeve në të cilat parashtruesit ankohen për kohëzgjatjen e procedurës, mund të jetë se kjo çështje është përgjegjëse për më shumë vendime të GJEDNJ- se çdo çështje tjetër, por kjo sigurisht nuk është rasti për numrin e referimeve të tilla të paraqitura në Gjykata. Në Kosovë duket të jetë një përjashtim dhe jo rregull, që një palë ankohet në gjykatë në lidhje me zvarritjen e procedurës; nuk është përjashtim se procedurat në çdo rast, pa ndonjë arsye të dukshme mund të zgjasin me vite.

Në rastin nr. KI 23/10, Jovica Gadzic, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 04 / 4-351-114 i Komunës së Prizrenit të datës 23 mars 2001, në të cilën parashtruesi u ankua se kishte pasur një zgjatje të paarsyeshme të procedurave, pasi që Gjykata e Qarkut në Prizren nuk kishte marrë një vendim për 2 vjet. Gjykata, megjithatë, arriti në përfundimin se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të tij në bazë të ligjit në fuqi.[603] Në një rast tjetër, rasti 26/10, Emin Behrami, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit nr. 14/2008 i Gjykatës Komunale të Vushtrrisë, parashtruesi gjithashtu pohoi qartë se kohëzgjatja e procedurës gjyqësore ka qenë e tepruar, por Gjykata e refuzoi kërkesën për mos shterje.

Deri më tani, rastet si në rastin e cituar janë një përjashtim, por është për t'u pritur se më shumë parashtrues do të gjejnë rrugën e tyre në Gjykatë për t'u ankuar për zgjatje të tepruar të procedurës pranë gjykatave të ndryshme dhe autoriteteve të tjera.

Një përjashtim i mëtejshëm i kërkesës sipas nenit 47.2, se një parashtrues ka për të shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën, është një rast në të cilin parashtruesi është në gjendje të tregojë se ku respektimi i shterimit do të shkaktonte dëme të pariparueshme, shterja e mjeteve nuk duhet zakonisht të jetë e nevojshme. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, kjo mund të jetë rasti, nëse parashtruesi do të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut të përsëritjes ose masave të tjera nga autoritetet, nëse ai/ajo do të përpiqet të paraqesë ankesat e tij/saj të drejtave të njeriut për autoritetet kompetente[604].

Për më tepër, nëse parashtruesi ka dyshime të caktuara, si për efektivitetin ose perspektivat e suksesit të një mjeti juridik, që ai/ajo duhet t'i shterojë. Megjithatë, kjo nuk do ta shpëtojë atë nga përdorimi i një mjeti të tillë, përveç nëse ai/ajo mund të tregojë në Gjykatë që mjeti me të vërtetë nuk është efektiv dhe, për këtë arsye, nuk ka nevojë të jetë i shterur[605].

---

[603] Shih, Rezolutën mbi papranueshmërinë, të datës 19 Shtator 2013 në ueb faqen e Gjykatës.

[604] Shih, për shembull, *Akdivar dhe të tjerët kundër. Turqisë*, [GC], 16 Shtator 1996, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV.

[605] Shih, për shembull, rasti nr. KI 108/10, Fadil Selmanaj, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 170/2009 të datës 25 Shtator 2009, vendimit të datës 5 Dhjetor 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 579; dhe gjithashtu në ueb faqe të Gjykatës.

Në mënyrë që të jetë i sigurt, parashtruesi mund të bëjë përpjekje për të shfrytëzuar mjetin gjoja joefektiv para se ta paraqes një kërkesë në Gjykatë. Pasi që përpjekja dështon dhe parashtruesi me të vërtetë paraqet kërkesën në Gjykatë, kjo e fundit mund të vendos se mjeti juridik duhet të konsiderohet si jo efektiv dhe nuk duhet të jetë shterur. Mirëpo, në ndërkohë, periudha prej katër muaj ka vazhduar të ecë nga data e vendimit të fundit apo aktgjykimit të shkallës kundër të cilit nuk kishte asnjë mjet juridik, mjeti efektiv ka skaduar tashmë[606]. Si pasojë, Gjykata nuk do të ketë zgjidhje tjetër përveç ta hedhë poshtë kërkesën sipas nenit 49 të Ligjit sipas afatit (shih, komentet e hollësishme në nenin 49 [Afatet] të Ligjit më poshtë).

Në raste të ngjashme, për shembull në rastin e Universitetit AAB-RIINVEST, të cekur më lartë, Gjykata konfirmoi, se "*Nëse një parashtrues ka provuar një mjet që Gjykata e konsideron të papërshtatshëm, koha e marrë për ta bërë këtë nuk do të ndërpresë rrjedhën e afatit katër mujor (neni 49 [Afatet] të Ligjit),i cili mund të çojë në ankesë duke u refuzuar si jashtë kohe (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Prystavka, Rezgui k. Franca, nr. 49859/99, vendim i datës 7 nëntor 2000)*".

Në rastet, kur një palë e paditur pretendon se parashtruesi ka shterur një mjet të veçantë juridik, GJEDNJ u shpreh se, në përgjigje të kërkesës, pala e paditur duhet: "[...] *të bind Gjykatën se mjeti ishte efektiv dhe i disponueshëm në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë, se ishte i arritshëm, ishte një i cili ishe i aftë për të siguruar zgjidhje në lidhje me ankimet e ankuesit dhe ofronte mundësi të arsyeshme për sukses. Megjithatë, pasi që kjo barrë e provës është e kënaqur, i takon parashtruesit për të vendosur se mjeti i avancuar nga Qeveria (pala e përgjigjur) ishte në fakt e shterur ose për disa arsye i pamjaftueshëm dhe jo efektiv në rrethanat e veçanta të rastit, ose se ka ekzistuar rrethanat e veçanta që e kanë shfajësuar atë nga kërkesa[…]*[607].

Në rastin e lart përmendur nr. 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme (Rasti i pasaportave), Gjykata konfirmoi se "Palët kundërshtare, siç u përmend më lart, shpjeguan praktikën aktuale në detaje, por asnjëra prej tyre nuk tregoi se cilat mjete juridike janë në dispozicion parashtruesit të kërkesës dhe sa ishin të efektshme"[608].

Kështu, Gjykata mund të kërkojë prej autoriteteve publike për të provuar ekzistencën e mjeteve juridike në dispozicion dhe efektive në një rast të veçantë. Në të njëjtën kohë, Gjykata mund t'i kërkojë parashtruesit për të mbështetur pretendimin e tij/saj se mjetet e kontestuara janë të pamjaftueshme për të mundësuar rivendosje ose se mjetet juridike nuk janë në dispozicion dhe, në këtë mënyrë, nuk kanë nevojë të shteren ose nuk ka asnjë mjet për t'u shterur,[609] për shembull, duke ofruar shembuj të rasteve të ngjashme, ku mjeti i kontestuar është parë të jetë i paefektshëm ose tregojë në ndonjë mënyrë tjetër se mjeti në fjalë nuk

[606] Shih, për shembull, rasti nr. KI 23/10, Ahmet Arifaj kundër Komunës së Klinës, Aktvendimi mbi papranueshmërinë i datës 20 prill 2010; botuar edhe në ueb faqen e Gjykatës.

[607] Shih, për shembull, *Akdivar dhe të tjerët kundër. Turqisë,* [GC], 16 Shtator 1996, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV.

[608] Rasti nr. KI 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, vendim i datës 30 Tetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 344; dhe në ueb faqe të Gjykatës.

[609] Shih, rastin e mësipërm nr. KI. 06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.

mund të jetë efektiv në situatën e tij/saj dhe, në këtë mënyrë, do të përjashtojë atë nga kërkesa e shterimit. Pasi që ka marrë mendimet e të dyja palëve, gjykata mund të nxjerrë konkluzionin e saj.

Në një nga rastet e saj të para, rasti nr. 11/09, Krasniqi kundër RTK-së et al, parashtruesi i kërkesës, pa shterur të gjitha mjetet juridike, ka paraqitur një kërkesë të drejtpërdrejtë në Gjykatë duke kërkuar nga ajo për të vendosur një masë të përkohshme gjatë kohës që Gjykata do të merret me kërkesën, për arsye se shkelja e supozuar kishte të bënte me interesin publik, siç parashihet në nenin 27 [Masat e përkohshme], paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Sipas mendimit të Gjykatës, edhe pse parashtruesi kishte kërkuar, in abstracto, rishikimin e kushtetutshmërisë të disa dispozitave që rregullojnë punën e Radio Televizionit të Kosovës (RTK), kërkesa e tij për një masë të përkohshme nuk ishte një *actionpopularis*, si mund të dukej në shkallë të parë, pasi që çështja nuk kishte shqetësim një interes individual, por edhe një interes publik gjithashtu. Pyetja nëse parashtruesi duhej të ketë shterur mjetet juridike në dispozicion, nëse ka, megjithatë, nuk u shqyrtua nga Gjykata[610].

Një mundësi tjetër, në rast se ankuesi ka dyshime serioze në lidhje me efektivitetin e mjetit juridik, është që të paraqesë një rekomandim Gjykatës pa e shteruar (ende), por në të njëjtën kohë për të vazhduar të shterë atë në mënyrë që të ketë një shans të dytë para Gjykatës, nëse kjo e fundit do të refuzojë argumentet e tij/saj se mjeti juridik i kontestuar ishte i paefektshëm dhe, prandaj, nuk ka nevojë të jetë i shterur. Në këtë rast, kërkuesi mund të paraqesë një kërkesë të re në Gjykatë pasi ka shterur përfundimisht mjetin e kontestuar. Për shembull, në rastin tjetër, Gjykata shpalli kërkesën e papranueshme për arsye se parashtruesi nuk kishte shterur të gjitha mjetet juridike. Megjithatë, në të njëjtën kohë, Gjykata i tregoi parashtruesit të kërkesës që ai mund të paraqesë një kërkesë të re pasi ka shteruar mjetet e nevojshme[611].

Në lidhje me Rregullën e shterjes së mjeteve juridike, mund të jetë e përshtatshme për të konsideruar nivele të ndryshme gjyqësore që një rast duhet të kalojë para se një palë normalisht do të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë në Gjykatë, sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës. Kështu, sa herë që një gjykatë në zinxhirin gjyqësor cenon ndonjë të drejtë të një personi fizik ose juridik, pala duhet të apelojë në nivelin tjetër të zinxhirit, duke përfshirë një rishikim (të apelimit për pikat e ligjit) para Gjykatës Supreme. Nëse është vetë Gjykata Supreme e cila dyshohet se shkel një të drejtë ose në qoftë se refuzon kërkesën e ankuesit që një gjykatë më e ulët e ka shkelur të drejtat e tij/saj kushtetuese, parashtruesi i ankesës mund të paraqesë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Ligjet mbi gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit përmbajnë dispozita të ngjashme të përmendura në nenin 47 (dhe nenet 48 dhe 49 të komentuara më poshtë). Për shembull, Kapitulli V. [Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore] të Ligjit kroat për Gjykatën Kushtetuese; Kapitulli V. [Arkivimi dhe Shqyrtimi paraprak i Ankesave] të Ligjit shqiptar për Gjykatën Kushtetuese (me sa

[610] Shih, rasti KI. 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK et al, Vendimi për masa të përkohshme të datës 16 Tetor 2009, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 11 a dhe e publikuar edhe në ueb faqe të Gjykatës.

[611] Shih, Aktvendimi mbi papranueshmërinë.

duket Kapitulli nuk përmend se parashtrueset janë të detyruara për të treguar në kërkesën e tyre të cilës i janë shkelur të drejtat kushtetuese); Kapitulli 2) [Rregulla e procedurës] të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnje-Hercegovinës.
Për më tepër, Nën-Kapitulli 2 [Procedura për shqyrtimin e një kërkese] të kreut IV. [Shqyrtimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregulloreve dhe akteve të përgjithshme të lëshuar për ushtrimin e autoritetit publik të Sllovenisë] të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese sllovene, megjithatë, ngarkon gjyqtarin raportues për të mbledhur informacion dhe për të marrë sqarimet e nevojshme për Gjykatën Kushtetuese për të vendosur nëse duhet filluar procedurën; dhe gjithashtu, Procedura e seksionit të pesëmbëdhjetë në rastet në pajtim me nenin 13 (8a)[612] (Ankesat kushtetuese) të Ligjit Gjerman për Gjykatën Kushtetuese Federale (Megjithatë, sipas nenit 90 (2), Gjykata Kushtetuese Federale mund të mos respektojë kërkesën e shterimit të mjeteve juridike, dhe "*të vendosë menjëherë për një ankese kushtetuese të depozituar para se të gjitha mjetet juridike janë shterur, në qoftë se ajo është me rëndësi të përgjithshme ose në qoftë se kërkesa në gjykata të tjera së pari do të shkaktonte një dëm të rëndë dhe të pashmangshëm për ankuesit*".
Neni 47.1 nuk është plotësuar nga një rregull specifike, ndërsa neni 47.2 plotësohet nga Rregulla 36 (1) (a) (që shkruan: "[*Gjykata mund vetëm të shqyrtojë kërkesat nëse: a) të gjitha mjetet juridike efektive që janë në dispozicion sipas ligjit kundër Aktgjykimit apo vendimit të jenë shterur, ose* [...] "). Rregulla tashmë është komentuar gjerësisht në bazë të nenit 22 të Ligjit dhe lexuesi, pra, me mirësi mund t'i referohet këtyre komenteve.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

> **Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.**

Përmbajtja e nenit tanimë është diskutuar gjerësisht dhe komentuar nën Rregullën 29 më sipër [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] që plotëson Nenin 22 **[**Procedimi i kërkesës], paragrafi 1, fjalia e dytë e ligjit si dhe nën Rregullën 36 që plotëson nenin 22.3, fjalia e parë. Megjithatë, për të qenë gjithëpërfshirës, Neni 48 do të komentohet ngjashëm.
Në parashtresat në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë hollësitë e shkeljes së pretenduar të të drejtave dhe lirive të parashkruara në Kushtetutë dhe të tregojë veprimet konkrete (ose mosveprimet) e autoriteteve publike që kanë shkaktuar ato shkelje duke ia bashkëlidhur kërkesës të gjitha vendimet përkatëse administrative dhe aktgjykimet e gjykatës me qëllim që Gjykata të ketë një pasqyrë të qartë të fakteve të rastit dhe të problemeve të ngritura. Në këtë mënyrë gjykata do të jetë në gjendje që të përcaktojë nëse rasti është i pranueshëm, dhe nëse është i pranueshëm, atëherë duhet të

[612] Neni 13(8a) i Ligjit Gjerman mbi Gjykatën Kushtetuese Federale thotë: [*Gjykata Kushtetuese Federale do të vendos në rastet e caktuara nga Ligji Themelor, […] 8a. Mbi ankesat kushtetuese (Neni 93(1)(4a) dhe (4)(b) i Ligjit Themelor).*

përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës. Është interesante të ceket se as Kushtetuta e as Ligji nuk i referohen nocionit të viktimës, vetëm rregulla 36(2)(c) i referohet, me këtë fjali "*kur Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë*".[613]
Për dallim, neni 34 [Kërkesat individuale] i KEDNJ kërkon nga parashtruesi i kërkesës që të pretendojë se është viktimë e njërës nga të drejtat e parashkruara në Konventë dhe në Protokollet e saj, ashtu që vetëm parashtruesit e kërkesës të cilët e konsiderojnë veten viktima të shkeljes së KEDNJ mund të ankohen para GJEDNJ[614].Praktika gjyqësore relevante e Strasburgut është përmbledhur si vijon:Pyetja nëse parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së pretenduar është relevante në të gjitha fazat e procedurës para gjykatës[615]. Tutje, nocioni i "viktimës" interpretohet në mënyrë autonome[616] dhe nuk nënkupton ekzistencën e paragjykimit; ku mund të mjaftojë një veprim nga ndonjë autoritet publik që ka vetëm efekte të përkohshme[617]. Një interpretim i shprehjes "viktimë" mund të nxirret nga kushtet e shoqërisë moderne dhe duhet të aplikohet pa formalizma të tepruar[618]. GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se çështja e statusit të viktimës mund të lidhet me meritat e rastit[619]. Edhe pse veprimi ose mosveprimi kundër të cilit parashtrohet ankesa duhet të ketë ndikuar direkt tek parashtruesi i kërkesës, GJEDNJ nuk e ka aplikuar këtë kriter në mënyrë mekanike dhe të ngurtë[620] por ka pranuar kërkesat nga viktimat e mundshme të cilat nuk mund të ankohen nga ndonjë shkelje direkte, për shembull në një rast të përgjimit të telefonit[621] dhe një rasti të ekstradimit[622]. Tutje, parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë se ndonjë ligj shkelë të drejtat e tyre në mungesë të një mase individuale të zbatimit, nëse ai i obligon që të modifikojnë sjelljen ose përballen me persekutim,[623] ose nëse janë pjesëtarë të ndonjë klase të njerëzve që mund të ndikohen direkt nga legjislacioni[624].
GJEDNJ mund të pranojë një rast nga ndonjë parashtrues i kërkesës i cili konsiderohet se është viktimë indirekte, kur ka lidhje personale dhe specifike në mes të viktimës direkte dhe parashtruesit të kërkesës, për shembull nën nenin (ndalimi i torturës ose trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose degradues) kërkesa e parashtruar nga nëna e një burri i cili është zhdukur përderisa ishte në mbajtje,[625] ose një rast e gruas së ve e të pandehurit i cili ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të tij të paragjykimit të

[613] Shih edhe komentet për Rregullin 36(2)(c).
[614] Shih të sipërpërmendurin Udhëzuesi praktik për kriteret e pranueshmërisë të publikuara nga GJEDNJ që siguron informata të hollësishme rreth nocionit të viktimës, faqet 12 gjer 14.
[615] Shih për shembull, *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [GC], nr. 36813/97, GJEDNJ 2006-V, para. 179.
[616] Shih për shembull, *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr. 62543/00, GJEDNJ 2004-III, para 35.
[617] Shih për shembull, *Monnat kundër Zvicrës*, nr. 73604/01, GJEDNJ 2006-X, para. 33.
[618] Shih për shembull, *Stukus dhe të tjerët kundër Polonisë*, nr. 12534/03, 1 prill 2008, para 35.; dhe *Zietal kundër Polonisë*, nr. 64972/01, 12 Maj 2009, paragrafët 54 gjer 59.
[619] Shih për shembull, *Siliadin kundër Francës*, nr. 73316/01, GJEDNJ 2005-VII, para 63.
[620] Shih për shembull, *Karner kundër Austrisë*, nr. 40016/98, GJEDNJ 2003-IX, para 25.
[621] Shih për shembull, *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, 6 Shtator 1978, Seria A nr. 28, para. 34.
[622] Shih për shembull, *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 Korrik 1989, Seria A nr. 161.
[623] Shih për shembull, *Norris kundër Irlandës*, 26 Tetor 1988, Seria A nr. 142.
[624] Shih për shembull, *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 13378/05, GJEDNJ 2008, para. 34.
[625] See *Kurt kundër Turqisë*, 25 Maj 1998, Raportet 1998-III.

pafajësisë[626]. Sipas GJEDNJ, kërkesat mund të parashtrohen vetëm nga personat e gjallë apo në emër të tyre, prandaj personat e vdekur ose përfaqësuesit e tyre nuk mund të parashtrojnë kërkesën[627]. Megjithatë, familja e parashtruesit të kërkesës mund ta vazhdojë procedurën e kërkesës nëse ka interesa të mjaftueshme në atë kërkesë[628]. Tutje, nëse parashtruesi i kërkesës vdes, GJEDNJ ka autoritetin për të vlerësuar nëse ia vlen të vazhdohet ekzaminimi i kërkesës për qëllimet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut,[629] ose për shkak të ekzistencës së interesit të përgjithshëm,[630] në veçanti kur kërkesa ka të bëj me legjislacion apo sistem ligjor ose praktikë brenda shtetit kundër së cilës është parashtruar kërkesa[631].

Sa i përket tekstit të nenit 48 të ligjit, është më logjike nëse fillimisht përmenden veprimet e kontestuara të autoritetit publik, e kështu edhe shkeljen e pretenduar nga veprimi i kontestuar. Duke kthyer mbrapsht renditjen, neni do të ishte si vijon: "Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin parashtruesi e konteston dhe cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar nga ai akt". Aktet konkrete të autoritetit publik janë për shembull refuzimi nga gjykatat të kërkesës pronësore të parashtruesit të kërkesës, ose refuzimi për të dëgjuar dëshmitarin në emër të parashtruesit të kërkesës, që përbën lëshim procedural që përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, në veçanti, parimi i "barazisë së mjeteve"[632].

Kur të dorëzohet kërkesa, është imperativ që parashtruesi të ndërtojë rastin, që do të thotë:(1) të japë detaje të qarta rreth autoritetit publik i cili pretendohet se ka shkaktuar shkeljen; (2) të tregojë aktet e kontestuara të autoritetit publik; (3) në çfarë mënyre aktet kanë ndërhyrë në të drejtat themelore të parashtruesit të kërkesës dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, dhe (4) t'i tregojë gjykatës se gjatë shterimit të mjeteve juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës, ai/ajo ka njoftuar autoritetin publik për shkeljen e pretenduar (duke përfshirë gjykatat relevante)[633]. Së paku parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes prova të mjaftueshme *prima facie*[634] në përkrahje të pretendimeve të tij me qëllim të shmangies së rrezikut që Gjykata do ta shpallte kërkesën të papranueshme ashtu që kërkesa nuk është qartazi e bazuar[635].Nuk është detyrë e Gjyqtarit Raportues, panelit shqyrtues ose e gjykatës që të ndërtojë rastin e parashtruesit të kërkesës, edhe pse mund të kërkohen informata shtesë, por mbetet përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për të paraqitur dokumentet e nevojshme me rastin e parashtrimit të kërkesës.

---

[626] Shih *Noelkenbockhoff kundër Gjermanisë*, 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123, para. 33.
[627] Shih për shembull, *Kaya dhe Polat kundër Turqisë* (dec), nr. 2794/05 dhe 40345/05, 21 Tetor 2008.
[628] Shih për shembull, *Raimondo kundër Italisë*, 22 shkurt 1994, Seria A nr. 281-A, para. 2.
[629] Shih për shembull, *Karner kundër Austrisë*, nr. 40016/98, GJEDNJ 2003-IX, paragrafët 25 et seq.
[630] Shih për shembull, *Marie-Louise Loven dhe Bruneel kundër Francës*, nr. 55929/00, 5 Korrik 2005, para. 29.
[631] Shih për shembull, *Karner kundër Austrisë*, nr. 40016/98, GJEDNJ 2003-IX, paragrafët 26 dhe 28.
[632] Lëshimet procedurale gjenden në procesverbalet gjyqësore të gjykatave përkatëse.
[633] Shih për shembull rastin nr. KI 11/10, Feti Islami, Shqyrtim kushtetues i vendimit 395/2008 të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe vendimit ac. nr. 306/06 të Gjykatës së qarkut të Komunës së Pejës, Vendim për papranueshmëri e datës 25 Janar 2011, Buletini i praktikës gjyqësore 2011; dhe në faqen e gjykatës në internet.
[634] Provat *Prima facie* janë të ngjashme me "fillimin e provës".
[635] Shih komentet për rregullin 36(1)(c) më sipër.

Mund të ndodhë që autoriteti publik nuk ka shkelë të drejtat ose liritë kushtetuese të parashtruesit të kërkesës sepse ka vepruar gabim, por sepse nuk ka vepruar fare kur është dashur të veprojë ose ka qenë nën obligim ligjor për të vepruar. Me fjalë tjera, ai ka shkelur një apo më shumë të drejta të garantuara të parashtruesit të kërkesës përmes mosveprimit. Kur u përball me aso situate për herë të parë në rastin nr. KI 14/09, gjykata nuk shkoi aq larg për të konstatuar shkelje, por përkujtoi autoritetet Kosovare rreth obligimit "*për të krijuar një mekanizëm të pavarur për të formuluar kornizën e politikave, legjislative dhe institucionale për të adresuar çështjen e kthimit të pronës, siç kërkohet nga shtojca VII, neni 6(1) i propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, dhe Kuvendit për të miratuar Ligjin për kthimin e pronave, në pajtim me nenin 143 të Kushtetutës të lidhur me nenin 2(1)3 të shtojcës XII (Agjenda legjislative) të Propozimit gjithëpërfshirës*"[636].

Siç u përmend më sipër, arsyetimi prapa nenit 48 është se Gjykata duhet të jetë në gjendje që me lehtësi të kuptojë se për çka ka të bëj kërkesa e nuk duhet që të supozojë se çka dëshiron të thotë parashtruesi i kërkesës, pasi që gjykata nuk mund ta dërgojë rastin. Këtu përsëritet se me qëllim të përgatitjes së duhur të kërkesës, parashtruesit e mundshëm të kërkesës mund të shfrytëzojnë: "Formularin e kërkesës"[637] dhe "Udhëzuesin" për parashtrimin e kërkesës,[638] të përgatitura nga Gjykata dhe që përmban pyetjet që duhet të përgjigjen, si dhe që përmban përshkrimin e hollësishëm të mënyrës së parashtrimit të kërkesës. Informatat tjera relevante mund të merren nga "Udhëzuesi praktik për kriteret e pranueshmërisë" që u përmend më sipër,[639] i përpiluar nga GJEDNJ, i cili përmban informata objektive dhe gjithëpërfshirëse rreth praktikës së saj gjyqësore në lidhje me kriteret e pranueshmërisë, të cilat në pajtim me nenin 53 [interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut][640] të Kushtetutës, duhet të zbatohen nga gjykata. Është e qartë se parashtruesit e mundshëm të kërkesës duhet të shfletojnë praktikën gjyqësore të publikuar në Buletinet e praktikës gjyqësore 2009-2010 dhe 2011 si dhe faqen në internet të gjykatës, por edhe gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës për të parë rastet e ngjashme me ato që i paraqesin para gjykatës. Parashtruesit e kërkesës duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje Rregullores së Punës së Gjykatës. Për shembull, nëse nuk posedojnë ndonjë dokument të caktuar, për shkak se autoriteti në fjalë kurrë nuk e ka lëshuar atë, atëherë parashtruesi duhet ta përmendë në kërkesë. Si rezultat, në pajtim me Rregullën 51 të Rregullores së Punës, Gjyqtari Raportues, paneli shqyrtues ose Gjykata mund ta vlerësojnë dokumentin në fjalë mjaft të rëndësishëm sa për ta kërkuar nga autoriteti i cili nuk e ka lëshuar[641].

---

[636] Rasti nr. KI 14/09, trashëgimtarët e Ymer Loxha dhe Sehit Loxha, shqyrtim kushtetues të vendimit nr. PKL.Nr 21107 të Gjykatës Supreme, me datë 17 Dhjetor 2008, Vendim për papranueshmëri të datës 15 Tetor 2010, Buletin i praktikës gjyqësore 2009-2010, faqe 276; dhe në faqen e gjykatës në internet.

[637] "Formulari i kërkesës për parashtrimin e kërkesës nga neni 113,7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës".

[638] "Udhëzues për të ndihmuar palët në parashtrimin e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nga neni 133,7 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës".

[639] Udhëzuesi praktik për kriteret e pranueshmërisë i dedikohet kryesisht ushtruesve të profesionit të juridikut dhe në veçanti juristëve që mund të thirren për të përfaqësuar parashtruesit e kërkesës pranë GJEDNJ-së.

[640] "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

[641] Shih në veçanti komentet për Rregullin 51 [Dokumentet] e Rregullores së Punës.

Edhe pse neni 48 parashkruan se kërkuesi duhet të qartësojë saktësisht të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, kërkuesi nuk ka nevojë të tregojë saktë se cilat nene të Kushtetutës ose të KEDNJ janë shkelur, nëse i përmendin së paku në mënyrë implicite ose në substancë (siç u përshkrua hollësisht në komentet e nenit 47 dhe në praktikën gjyqësore të gjykatës dhe të GJEDNJ[642]). Në çdo rast, është vështirë për parashtruesin e kërkesës që të tejkalojë kërkesën për të treguar se cilat të drejta kushtetuese pretendohet se janë shkelur, pasi që formulari i kërkesës përmban pyetjen specifike në lidhje me këtë[643].

Siç u përmend në komentet rreth nenit 47.1 më sipër, ligjet për gjykatat kushtetuese të shteteve në rajon përmbajnë dispozitat e ngjashme me nenin 48. Edhe neni 34 [Kërkesat individuale] KEDNJ[644] përmban një dispozitë të ngjashme.

Përfundimisht "është e mundshme që gjykata të mos vendosë për një kërkesë individuale të kërkuesit, por të vendosë njëkohësisht *in abstracto* për çështjen e caktuar që ka relevancë direkte me shkeljen e prezumuar se është shkaktuar në rastin individual që gjykohet. *Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët* është ilustrim i praktikës ku nga gjykata kërkohet që të vendosë për një kërkesë individuale, por me qëllim të riparimit të shkeljes, gjykata duhet të vendosë *ultra petitum* për ligjin i cili supozohet se ka shkaktuar shkeljen"[645]. Në këtë rast Gjykata konstatoi se *"Kërkesa e z. Tomë Krasniqit [...] ka të bëj me ligjet vendore dhe praktikat administrative të cilat bazohen në to. Në kërkesën e tij, z. Tomë Krasniqi kërkon kontrollin in abstracto të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-së. Megjithatë, kërkesa e palës kërkuese, z. Tomë Krasniqi, nuk është actio popularis, siç mund të duket në fillim.* [...]" Gjykata përfundoi, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ se "[...] *procedura e filluar nga një kërkesë individuale, sipas nenit 113 paragrafi 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 47 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës merr karakter objektiv. Gjykata konstaton se në rastin në fjalë nuk mund të flitet për një actio popularis, dhe se këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një interes personal por edhe me një interes publik si tërësi. Për më tepër, Gjykata konsideron se ky rast "përfshin në vetvete konsiderata të natyrës politike, ekonomike dhe sociale për të cilat në një shoqëri demokratike mendimet mund të dallojnë në mënyrë të dukshme" (Cf. James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së bashkuar, Seria A nr. 98, par. 46, 22. shkurt 1986)*".[646]

Prandaj ankesa kushtetuese kundër një ligji që ndikon direkt parashtruesin e kërkesës nuk është e ngjashme me "*actio popularis* " që nënkupton se çdo person ka të drejtën të

[642] Shih komentet e hollësishme për nenin 47 [Kërkesat individuale] më sipër.

[643] Në formularin e kërkesës, pyetja është formuluar si vijon: "III. Arsyetimi i kërkesës dhe shkeljet e pretenduara të Kushtetutës: Ju lutemi, shpjegoni se cilat janë ankesat tuaja sipas Kushtetutës. Saktësoni nenin e Kushtetutës që është shkelur, e veçanërisht saktësoni pse mendoni që akti i autoritetit publik ka shkelur të drejtat dhe liritë tuaja të garantuara me Kushtetutë".

[644] Neni 34 [Kërkesat individuale] i KEDNJ parashkruan: "Gjykata mund të pranojë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup i individëve që pretendojnë se janë viktimë e shkeljes nga një nga palët e larta kontraktuese të të drejtave të parashkruara nga Konventa ose protokollet e saj. Palët e larta kontraktuese zotohen që mos të pengojnë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte".

[645] Shih publikimin "Mekanizmi për ankesat individuale si mjet për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe lirive të njeriut: Rasti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, Dren Doli dhe Fisnik Korenica, faqe 15.

[646] Shih rastin nr. KI. 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët, Vendimi për masat e përkohshme, 16 Tetor 2009.

kërkojë shqyrtim kushtetues të aktit normativ pas hyrjes në fuqi, pa pasur nevojë të provojë se edhe tash po ndikohet direkt nga ai[647].
Neni 48 plotësohet nga Rregulla 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së Punës. Pasi që, siç u përmend më sipër, të dyja Rregullës janë komentuar gjerësisht nën nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, këto Rregulla nuk do të trajtohen tutje nën Nenin 48 të Ligjit.

Neni 49 [Afatet]

> **Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.**

Duket se teksti i nenit është i pasaktë, kur përmendet *"vendimi gjyqësor"*. Në të vërtetë, nuk është vetëm *vendimi gjyqësor*, por *vendimi i gjykatës së shkallës së fundit* (që do të thotë vendimi i marrë nga shkalla më e lartë gjyqësore, tek e cila shkallë parashtruesi mund të ankohet në lidhje me rastin) me qëllim që t'i tregojë gjykatës se ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme juridike sipas ligjit të Kosovës, siç u diskutua më sipër.
Në kërkesë, parashtruesi ka nevojë të tregojë se në cilën datë i është dorëzuar vendimi i gjykatës i formës së prerë dhe të parashtrojë provat (për shembull kopjen e fletëkthesës)[648]. Data është thelbësore për gjykatën për të përcaktuar nëse parashtruesi ka respektuar periudhën 4 mujore. Në rast të dyshimit, siç ndodhi në disa raste[649], gjykata mund të kërkojë nga gjykata e rëndomtë për kopjen e fletëkthesës që përmban datën kur aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit, dhe në shumicën e rasteve[650], nënshkrimin e tij.
Siç parashkruhet në fjalinë e dytë të nenit, "n*ë të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht*". Siç duket, fjalia ka të bëj me rastet ku pasi që autoriteti publik të ketë marrë *"vendimin ose aktin"* e kontestuar nga ankuesi, procedura gjyqësore nuk ka qenë në dispozicion për të, dhe si pasojë, mundësia e vetme është parashtrimi i ankesës kushtetuese direkt Gjykatës, që do të thotë brenda periudhës 4 mujore pas ditës kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Megjithatë, në këtë aspekt, neni 48 duket se anashkalon një çështje të rëndësishme, do të thotë numrin e muajve ose ditëve që ka ankuesi në dispozicion për të përgatitur kërkesën për Gjykatë, pas pranimit të vendimit ose hollësive rreth aktit "të shpallur publik".Nën fjalinë e parë, është e qartë se për përgatitjen e kërkesës, ankuesi ka në dispozicion 4 muaj nga dita kur ka pranuar vendimin gjyqësor, përderisa në fjalinë e dytë, ankuesi nuk e ka idenë se kur do ta merr kopjen e vendimit i cili nevojitet për të përgatitur kërkesën ose hollësitë rreth aktit të shpallur publikisht,

[647] Shih opinionin për tri pyetjet ligjore që rrjedhin nga procesi i hartimit të kushtetutës së re të Hungarisë, të miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën 86 plenare, Venedik, 25-26 mars 2011.
[648] Formulari i kërkesës përmban një pyetje specifike në lidhje me këtë.
[649] Në IV. [Shterimi i mjeteve juridike] i formularit të kërkesës, parashtruesi duhet të tregojë "Datën e pranimit të vendimit".
[650] Është e mundshme që parashtruesi i kërkesës, i pakënaqur me aktgjykimin, ka refuzuar nënshkrimin e pranimit.

përderisa periudha 4 mujore tanimë ka filluar të ecë nga dita kur ai "vendim" ose "akt" është shpallur publikisht. Kjo do të krijonte mospërputhje në trajtimin e ankuesve nga neni 48 dhe do të përbënte diskriminim të qartë të ankuesit nga fjalia e dytë e nenit.
Tutje, mund të ketë raste ku vendimi ose akti në fjalë nuk është shpallur publikisht (me gabim ose mosveprim).Këto raste mund të mbulohen nga neni 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, të komentuar më poshtë, i cili përveç tjerash, shkruan se parashtruesi i cili pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të caktuar (prej 4 muaj), Gjykata Kushtetuese, në bazë të kërkesës, është e obliguar që ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme.
Siç u përmend më sipër, neni 35(1) i KEDNJ përmban afatin 6 mujor. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ,[651] parashtruesi i kërkesës ka nevojë vetëm të shfrytëzojë mjetet juridike shtetërore të cilat me gjasë janë efektive dhe të mjaftueshme[652].Kur është e qartë nga fillimi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte mjete efektive, GJEDNJ ka vendosur se periudha gjashtëmujore fillon të ecë nga data kur akti i ankuar ka ndodhur apo në datën kur parashtruesi i kërkesës është ndikuar direkt ose është njoftuar për atë akt ose ka kuptuar për efektet negative[653].Kur parashtruesi i kërkesës shërbehet me mjetet e qarta ekzistuese dhe vetëm më pas kupton për rrethanat të cilat e bëjnë mjetin joefikas, mund t'ia vlejë fillimi i periudhës gjashtëmujore nga data kur parashtruesi i kërkesës ka kuptuar ose do të kuptojë për ato rrethana.[654]
Tutje, GJEDNJ konstaton[655] se parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatin kohor të parashkruar në Konventë duke synuar bërjen e kërkesave të pavend ose të gabuara organeve ose institucioneve që nuk kanë autoritet ose fuqi për t'i ofruar zgjidhje efektive për ankesën në lidhje me rastin sipas Konventës[656].GJEDNJ ka theksuar tutje se Rregulla e shterimit nuk kërkon nga parashtruesi i kërkesës të aplikojë për rihapjen e procedurës ose të ketë shfrytëzuar mjete të ngjashme të jashtëzakonshme, dhe nuk mundëson shtyrjen e periudhës 6 mujore mbi bazën e ushtrimit të atij mjeti[657].Megjithatë, nëse një mjet juridik i jashtëzakonshëm është mjeti i vetëm juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, afati kohor 6 mujor mund të llogaritet nga data e vendimit në lidhje me atë mjet juridik.[658]
Parashtruesit e kërkesës që dëshirojnë të dalin para Gjykatës Kushtetuese duhet të dinë Rregullën e GJEDNJ e cila, në rastet kur procedurat janë rihapur ose është shqyrtuar vendimi i formës së prerë, nisja e afatit kohor në lidhje me procedurën fillestare ose vendimin e formës së prerë do të ndërpritet vetëm në lidhje me ato çështje të KEDNJ (ose kushtetuese) të cilat kanë shërbyer si bazë për shqyrtim ose rihapje të rastit dhe ishin subjekt i ekzaminimit para organit apelues të jashtëzakonshëm.[659]

[651] Shih informatat nga Udhëzuesi praktik i GJEDNJ-së për kriteret e pranueshmërisë, Këshilli i Evropës, Dhjetor 2010, i cituar këtu.
[652] Shih, *Moreira Barbosa kundër Portugalisë*, nr. 65681/01, GJEDNJ 2004-V.
[653] Shih, *Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi nr. 76573/01, 2 Korrik 2002.
[654] Shih, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], nr. 16064/90 gjer 16066/90 dhe 16068/90 gjer 16073/90, GJEDNJ 2009.
[655] Shih Udhëzuesin praktik për kriteret e pranueshmërisë të publikuara nga GJEDNJ.
[656] Shih, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar, (*vendim), nr. 14881/04, 5 Janar 2006.
[657] Shih, *Berdzenichvili kundër Rusia*, (vendim), nr. 31687/03, GJEDNJ2004-II.
[658] Shih, *Ahtinen kundër Finlandës,* (vendim), nr. 48907/99, 31 Maj 2005.
[659] Shih, *Sapeyan kundër Armenisë*, nr. 35738/03, 13 Janar 2009.

Përfundimisht është me rëndësi të përmendet nocioni i "*gjendjes së vazhdueshme*",[660] ku nuk aplikohet afati 4 mujor. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, gjendja e vazhdueshme shfaqet kur nuk ka mjete juridike fare ose nuk ka mjete efektive për të përfunduar gjendjen që përbën shkeljen e pretenduar. Vetëm kur gjendja e vazhdueshme të ketë përfunduar, atëherë fillon llogaritja e afatit gjashtëmujor. Sipas GJEDNJ:"Qëllimi i Rregullës [6 mujor] është promovimi i sigurisë së ligjit, për të siguruar se rastet që ngrehin çështje nga Konventa trajtohen brenda afatit të arsyeshëm kohor dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat tjerë nga prolongimi i padrejtë kohor. Rregulla gjithashtu i jep parashtruesit të kërkesës kohë për të konsideruar nëse të parashtrojë kërkesën apo jo, e nëse po, të vendosë për ankesat dhe argumentet specifike që do të ngrihen".[661] Prandaj në kontekst të KEDNJ, ajo i referohet gjendjes që operon me aktivitetet e vazhdueshme në anën e shtetit për t'i bërë viktima parashtruesit e kërkesës. Si rezultat, sa më gjatë që vazhdon gjendja, Rregulla gjashtëmujore nuk aplikohet[662].Megjithatë, sipas GJEDNJ, fakti se një ngjarje ka pasoja të mëdha me kohë, nuk nënkupton se ngjarja ka prodhuar "gjendje të vazhdueshme"[663].

Gjykata ka aplikuar këtë nocion në disa raste para saj, për shembull në rastin nr. KI 40/09, Imer Ibrahimi dhe 48 ish punonjësit tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës[664], ku gjykata konstatoi se "*afati kohor i parashkruar nga KEDNJ nuk fillon të llogaritet, nëse ankesa nga Konventa rrjedh nga situata e vazhdueshme. Shembuj të situatave të vazhdueshme përfshijnë ankesat në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të gjykatave vendore, paraburgim dhe pamundësi të gëzimit të posedimeve".*Gjykata konstatoi se, pasi që parashtruesi i kërkesës ende vuan nga anulimi i njëanshëm i marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u (ashtu që pagesa e rregulluar me kontratë ishte shkëputur pa njoftim), kishte gjendje të vazhdueshme, që do të përjashtonte afatet ligjore për parashtrimin e kërkesave.

Sa i përket afateve kohore brenda së cilës ankesa kushtetuese duhet të parashtrohet pranë gjykatës kushtetuese të shteteve në rajon, afatet ndryshojnë shumë:nga 30 ditë në 2 vite. Për shembull, neni 64 i Ligjit Kroat për Gjykatën Kushtetuese parashkruan afatin prej 30 ditëve[665]; sipas nenit 52(1) ligjit slloven për Gjykatën Kushtetuese, ankesa kushtetuese duhet të parashtrohet brenda 60 ditëve nga dita e dorëzimit të aktit individual i cili kontestohet në gjykatë; neni 30 [afatet kohore për parashtrimin e ankesave] i ligjit shqiptar parashkruan se ankesat individuale në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese parashtrohen jo më vonë se dy (2) vite[666]; neni 15 i rregullores së

---

[660] Shih edhe komentet për Rregullin 36,3(h).

[661] Shih për shembull, *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, vendimi i 25 gushtit 2005.

[662] Shih për shembull, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 gjer 16066/90, 106068/90 gjer 16073/90, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 14 prillit 1998.

[663] Shih, "Nga de Becker tek Varnava: gjendja e situatës së vazhdueshme në praktikën gjyqësore të Strasburgut" Yves Haeck dhe A van. Pachtenbeke, Ghent University, Human Rights Law Review.

[664] KI 40/09, Imer Ibrahimi dhe 48 ish punonjësit tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të gjykatës supreme të Republikës së Kosovës, aktgjykim i datës 23 Qershor 2010, buletin i praktikës gjyqësore 2009-2010, faqe 188; dhe në faqen e gjykatës në internet.

[665] "Ankesa kushtetuese mund të parashtrohet gjatë afatit 30 ditor nga dita e pranimit të vendimit".

[666] Neni 30.2 shkruan: "Ankesat individuale në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese parashtrohen jo më vonë se dy vite nga konstatimi i shkeljes. Nëse ligji parashkruan se individi mund t'i adresohet autoritetit tjetër, individi mund të parashtrojë ankesën pranë Gjykatës Kushtetuese vetëm pas shterimit të të gjitha

punës të gjykatës kushtetuese të Bosnje & Hercegovinës, parashkruan afatin 60 ditor[667].Në fund, neni 93(1) i ligjit gjerman për Gjykatën Kushtetuese federale (BGVerfGG) parashkruan se ankesa kushtetuese parashtrohet dhe materializohet brenda një muaji.[668]

Duke marrë parasysh periudhat e ndryshme të sipërpërmendura, pyetja mund të shfaqet nëse periudha 4 mujore e rregulluar me nenin 49 është e arsyeshme dhe e mjaftueshme për parashtruesin e kërkesës ose avokatin e tij që ta përgatis mirë dhe me kohë kërkesën. Shumë do të varet nga rrethanat e secilit rast, por duke marrë parasysh afatin 6 mujor të KEDNJ, dhe në anën tjetër afatin nga neni 93(1) të BVerfGG prej një muaji, periudha 4 mujore e parashkruar në nenin 49 nuk duket e paarsyeshme.

Sa i përket fjalisë së fundit të nenit 49 i cili thotë, *"Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi,*" nuk do të ndodhë shpesh që parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë ankesën kushtetuese në lidhje me ndonjë ligj direkt në Gjykatë[669] pa shteruar mjetet juridike. Në atë rast, parashtruesi i kërkesës duhet të tregojë se (1) ai ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive nga Kushtetuta që nga hyrja në fuqi e ligjit të kontestuar, dhe (2) ai nuk ka mjete juridike për të kërkuar Rregullimin e gjendjes. Megjithatë, në rastin e sipërpërmendur nr. KI. 11/09, Tomë Krasniqi kundër RTK dhe të tjerët,[670] çështja e 4 muajve nuk ishte ngrehur nga asnjëra palë e as nga gjykata e cila në vendimin e saj [për masën e përkohshme], në mes tjerash vendosi që "[…] III. Pas 1 dhjetorit 2009 e tutje, gjykata vendosë për meritat e kërkesës […]".Mund të nxirret përfundimi se, duke vendosur kështu, gjykata konkludoi se kërkesa plotësonte të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, duke përfshirë rregullën 4 mujore.

Tutje, siç u përmend më herët për komentet e nenit 48, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, parashtruesit e kërkesës mund të kontestojnë se një ligj shkelë të drejtat e tyre në mungesë të masës individuale të zbatimit, nëse nga ata kërkohet që të modifikojnë sjelljen e tyre ose të përballen me prokurorinë (shih për shembull Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 13378/05, GJEDNJ 2008, para. 34) ose nëse janë pjesëtarë të klasës së njerëzve që rrezikojnë prekjen nga kjo (shih për shembull Norris kundër Irlandës, 26 tetor 1988, Seria A. nr. 142).

Në shumicën e rrethanave, megjithatë parashtruesi i kërkesës nuk do të ketë mundësinë e ankesës direkte kundër ndonjë ligji, por kundër ndonjë akti individual, të aplikuar në rastin e tij dhe në bazë të ligjit i cili pretendohet se është anti-kushtetues. Në atë rast aplikohet Rregulla e shterimit si dhe Rregulla e 4 muajve.

Botimi "Udhëzimet rreth parashtrimit të ankesës në gjykatën federale kushtetuese të Gjermanisë" konfirmon se Rregulla në lidhje me ankesën direkte kundër ligjit është

---

mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij. Në atë rast, afati kohor për parashtrimin e ankesës është 2 vite nga data e marrjes së vendimit nga autoriteti".

[667] Neni 15 parashkruan: "Gjykata mund të ekzaminojë një kërkesë vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion me ligj kundër vendimit apo aktgjykimit të kundërshtuar, dhe nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit 60 ditor nga data e pranimit të vendimit nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me mjetin e fundit juridik të shfrytëzuar".

[668] Neni 93(1) i BVerfGG parashkruan, në mes tjerash: "Ankesa kushtetuese parashtrohet dhe materializohet brenda një muaji. […].

[669] Shih edhe komentet për Rregullin 48 më sipër.

[670] Vendimi i 16 tetorit 2009, Buletini praktikës gjyqësore 2009-2010; si dhe faqen e gjykatës në internet.

përjashtim, e jo rregull i rëndomtë”[671]:*"Ligjet, dispozitat ligjore ose statutet vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të ndikohen direkt nga parashtruesi i kërkesës, nëse ato shkaktojnë pengesa direkte dhe të menjëhershme ndaj vet parashtruesit. Në atë rast, kërkesa duhet të parashtrohet brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit, etj. Si rregull, megjithatë ato ligje dhe dispozita duhet të zbatohen, d.m.th. të aplikohen në raste individuale përmes vendimit administrativ ose gjyqësor kundër së cilit parashtruesi i kërkesës duhet të shterojë të gjitha mjetet para gjykatave kompetente. Prandaj në të gjitha rastet kërkesa kushtetuese nuk është e pranueshme gjersa gjykata e shkallës së fundit të ketë nxjerrë vendimin (neni 90(2) BVerfGG[672])*”.

Prandaj, edhe pse BVerfGG gjermane pranon mundësinë e parashtrimit të kërkesës kushtetuese kundër një ligji direkt pranë Gjykatës Kushtetuese Federale, neni 92(4)[673] megjithatë parashkruan afatin shumë më të gjatë prej një viti, për dallim nga neni 49 i cili nuk bën dallim në mes të dy kërkesave.

Neni 49 (si dhe nenet përkatëse të kushtetutës, ligjit dhe rregullores së punës që përfshijnë afatet) plotësohet nga Rregulla 27 [Llogaritja e periudhës kohore] i rregullores së punës që përcakton hollësitë për llogaritjen e periudhës kohore që parashkruhen nga Kushtetuta, ligji ose kjo rregullore e punës.

Rregulla 27 [Llogaritja e periudhës kohore] i rregullores së punës

Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:

3. **Kur periudha e shprehur me muaj përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore; ose sipas nevojës, në ditë e parë të muajit pasues.**
5. **Periudhat përfshijnë të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare.**
6. **Nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.**

Rregulla 27 qartë përcakton llogaritjen e periudhave të ndryshme kohore. Sa i përket aplikimit të Rregullës për afatin e përshkruar në fjalinë e parë të nenit 49, duket se gjer tani nuk ka pasur kundërthënie. Rregulla prandaj nuk ka nevojë për komente shtesë.

[671] I botuar nga Inter Nationes si pjesë e ligjit për Gjykatën Kushtetuese federale, i redaktuar nga Sigrid Born.

[672] Neni 90(2) BGVerfGG parashkruan: "Nëse veprimi ligjor kundër shkeljes është i pranueshëm, kërkesa kushtetuese nuk mund të parashtrohet gjersa të shterohen të gjitha mjetet. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese Federale mund të vendosë menjëherë mbi kërkesën kushtetuese të parashtruar para shterimit të të gjitha mjeteve, nëse është me rëndësi të përgjithshme ose nëse rekursi në gjykatat tjera do të rezultonte në dëme serioze dhe të pashmangshme për parashtruesin e kërkesës".

[673] Neni 92(4) BGVerfGG parashkruan: "Nëse kërkesa drejtohet kundër ndonjë ligji ose akti sovran kundër së cilit nuk pranohen veprimet ligjore, kërkesa mund të parashtrohet brenda një viti prej kur ligji të ketë hyrë në fuqi ose kur është shpallur akti sovran".

Neni 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme]

> **Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.**

Siç u përmend nën nenin 49 [Afatet] të ligjit më sipër, arsyeja e afateve është që të promovojë qartësi ligjore duke siguruar se rastet që rrjedhin nga Kushtetuta të ekzaminohen brenda afatit të caktuar dhe që vendimet e formës së prerë të mos jenë të hapura për kundërshtim gjatë gjithë kohës[674].Megjithatë, mund të ketë situata, ku afati 4 mujor, brenda së cilit duhet të parashtrohet kërkesa në Gjykatë, ka skaduar kurse parashtruesi nuk ka arritur ta respektojë afatin pa fajin e vet.

Për shembull, kjo mund të ndodhë (shih komentet edhe për nenin 49 të ligjit), nëse vendimi ose akti nuk është shpallur publikisht (me gabim ose mosveprim) dhe parashtruesi nuk ka qenë i njoftuar për të, kurse kur ka kuptuar për atë vendim ose akt, është mënjanuar pengesa. Në atë rast, parashtruesi duhet të provojë se ka treguar interesim të mjaftueshëm, zell dhe iniciativë për të kuptuar gjë në lidhje me vendimin ose me aktin përmes komunikimit të rregullt me autoritetet apo institucionet në fjalë.

Në atë rast, parashtruesi duhet të kërkojë nga Gjykata, së paku 15 ditë pas mënjanimit të pengesës, për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe nëse arsyet tregojnë se ai nuk ka qenë në gjendje që të parashtrojë kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 muajve, Gjykata obligohet që ta kthejë rastin në gjendjen e mëparshme. Megjithatë, sipas nenit, Gjykatës nuk i lejohet që ta kthejë në gjendjen e mëparshme, nëse ka kaluar mbi një vit nga dita e skadimit të afatit 4 mujor pas nxjerrjes së vendimit ose aktit të kontestuar.

Edhe pse dispozita është e heshtur në lidhje me këtë çështje, supozohet se pasi që t'i dorëzohet parashtruesit vendimi i Gjykatës për kthim në gjendjen e mëparshme, parashtruesi do të ketë 4 muaj për të materializuar kërkesën e tij.

Tutje, situata e ngjashme mund të shfaqet për shembull kur parashtruesi sëmuret rëndë, para apo menjëherë pas vendimit të formës së prerë për rastin e tij, përderisa ai kishte për synim të parashtrojë kërkesën ose ishte në proces të përgatitjes së ankesës kushtetuese brenda afatit 4 mujor pas marrjes së vendimit të formës së prerë. Në atë rast, supozohet se parashtruesi do të ketë maksimum një vit pas skadimit të afatit 4 mujor për ta kaluar sëmundjen dhe një periudhë 15 ditore pas shërimit ta dorëzojë kërkesën për rikthim në gjendjen e mëparshme, të shoqëruar me arsyetimin e nevojshëm, siç për shembull të gjitha vërtetimet mjekësore.

Në shembull tjetër, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund t'i dorëzohet parashtruesit, por është humbur pa fajin e parashtruesit, para se ta parashtronte kërkesën në Gjykatë. Përderisa parashtruesi ende mundohej ta nxirrte kopjen e re, afati 4 mujor kishte skaduar. Edhe në këtë shembull parashtruesi duhet të ketë të drejtën e parashtrimit të kërkesës nga neni 50 pranë Gjykatës brenda 15 ditëve pas nxjerrjes së

[674] Shih, *mutatis mutandis, Finucane kundër MB*, nr. 29178/95, 2 Korrik 2002.

kopjes së re të vendimit gjyqësor të formës së prerë (natyrisht me kusht se kthimi në gjendjen e mëparshme nuk do të lejohet nëse ka kaluar një vit nga skadimi i afatit 4 mujor pas vendimit të formës së prerë për atë rast).
Neni 93(2) i BGVerfGG parashkruan një rregull të ngjashëm me këtë fjali:"*Nëse parashtruesi nuk ka arritur ta respektojë këtë afat*[675] *pa fajin e tij, atij i sigurohet restitutio in integrum në bazë të kërkesës. Kjo kërkesë bëhet brenda dy javëve nga largimi i pengesës. Arsyet për kërkesë materializohen gjatë bërjes së kërkesës ose gjatë procedurës. Veprimi i penguar ligjor duhet të realizohet brenda afatit për kërkesën; nëse kjo bëhet, parashtruesit mund t'i sigurohet kthimi i gjendjes pa nevojë të kërkesës formale. Kërkesa anulohet nëse bëhet një vit pas skadimit të afatit. Faji i avokatit të parashtruesit konsiderohet i njëjtë sikurse faji i vet parashtruesit".*
Edhe neni 66 i Ligjit kroat për Gjykatën Kushtetuese[676] përmban Rregullën e ngjashme, kurse neni 52(3) i ligjit slloven ia lë Gjykatës Kushtetuese të vendosë nëse ta trajtojë ankesën kushtetuese pa përmendur kurrfarë afatesh[677].
Edhe pse KEDNJ nuk përmban ndonjë rregull të ngjashëm, GJEDNJ ka përpiluar kritere të caktuara në praktikën e saj gjyqësore, për shembull në rastet e zhdukjes, ku ka vendosur se është e domosdoshme që të afërmit e personit të zhdukur të mos vonohen pa arsye në parashtrimin e kërkesës rreth mos-efikasitetit ose mungesës së hetimit para gjykatës. Kur kemi të bëjmë me zhdukjet, parashtruesit nuk mund të presin pambarim para se të vijnë në Strasburg. Ata duhet të demonstrojnë zell dhe iniciativë dhe të parashtrojnë kërkesat pa vonesë të panevojshme[678].

Efektet ligjore të vendimeve të Gjykatës të nxjerra në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës

Edhe pse çështja e efekteve juridike e vendimeve të Gjykatës është trajtuar nën nenin 20 [Vendimet] të Ligjit dhe Rregullës 63 [Zbatimi i vendimeve], 65 [Aktgjykimi] dhe 66 [Efektet ligjore të aktgjykimit] të Rregullores së Punës,[679] ia vlen të komentohen ndarazi efektet ligjore të vendimeve të Gjykatës nga neni 113.7 i Kushtetutës. Prandaj pasi që Gjykata ta miratojë kërkesën për mbrojtjen kushtetuese, mund të shtrohet pyetja

[675] Kjo do të thotë: afati nga neni 93(1) parashkruan: "Ankesa kushtetuese parashtrohet dhe materializohet brenda një muaji […]".
[676] Neni 66 i Ligjit Kroat për Gjykatën Kushtetuese parashkruan: "(1) Gjykata Kushtetuese ia lejon kthimin e gjendjes personit i cili për shkak të arsyeve të pranueshme ka huq afatin për parashtrimin e ankesës kushtetuese, nëse gjatë afatit 15 ditor pas ndërprerjes së arsyes që ka shkaktuar pengesën për parashtrimin e propozimit për kthim të gjendjes së mëparshme dhe njëkohësisht parashtron ankesën kushtetuese. (2) Pas skadimit të tre muajve nga data e pengesës, kthimi në gjendjen e mëparshme nuk mund të kërkohet. (3) Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse është kaluar afati për parashtrimin e propozimit për lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme".
[677] Neni 52(3) i ligjit slloven për Gjykatën Kushtetuese parashkruan: "Në rastet e bazuara në mënyrë të veçantë, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë në mënyrë të jashtëzakonshme për një ankesë kushtetuese e cila është parashtruar pas skadimit të afatit nga paragrafi i parë i këtij neni". Paragrafi i parë i nenit parashkruan: "Ankesa kushtetuese parashtrohet brenda 60 ditëve nga dita e dorëzimit të aktit individual kundër së cilës parashtrohet ankesa kushtetuese".
[678] Shih për shembull, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], nr. 16064/90 gjer 16066/90 dhe 16068/90 gjer 16073/90, GJEDNJ 2009-para. 165, dhe për çështjen e "vonesës së panevojshme": paragrafët 162-166.
[679] Shih komentet për nenin 20 dhe Rregullës 63, 65 dhe 66 më sipër.

se cilat janë efektet ligjore të vendimit. Në parim, ai do të zgjidhë lëndë specifike (*in concreto* juridiksionin e gjykatës) dhe do të hyn në fuqi kryesisht *inter partes*. Për dallim, nëse konstatohet se ligji ose rregullorja shkelë një të drejtë të garantuar me Kushtetutë (*in abstracto* juridiksionin e Gjykatës) dhe dispozitat ose ligji shpallen të pavlefshme, vendimi i gjykatës do të aplikohet *erga omnes*[680].Megjithatë, neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], paragrafi 1 I Kushtetutës shkruan se *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*, nuk bën dallim në mes të dy kategorive të vendimeve, por thjeshtë parashkruan se të gjitha vendimet e Gjykatës janë obliguese për palët si dhe të tjerët, d.m.th. efekti "*erga omnes*". Prandaj përmes ankesës individuale kushtetuese, "Gjykata do të mund të drejtojë veprimin e autoriteteve gjyqësore, ekzekutive dhe legjislative në të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat themelore. Ankesa kushtetuese mund t'i jap gjykatës mundësinë për kreativitet gjyqësor përmes interpretimit gjyqësor"[681].

Nën-kapitulli 10 [Procedura për lëndët që është parashkruar në nenin 113, paragrafi 7 i kushtetutës] i ligjit nuk përmban dispozita specifike (*lex specialis*) në lidhje me efektet ligjore të vendimeve të Gjykatave për ankesat individuale kushtetuese. Duket qartë se vetëm Rregulla 74 [Aktgjykimi] e Rregullores së Punës parashkruan hollësitë në lidhje me efektet e vendimeve të nxjerra në bazë të nenit 113.7.

Rregulli 74 [Aktgjykimi] i Rregullores së Punës

1. **Në rast se kërkesa është bërë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nëse Gjykata përcakton se një gjykatë ka lëshuar vendim duke shkelur Kushtetutën, ajo do ta shpallë të pavlefshëm atë vendim dhe do t'ia kthejë atë gjykatës që e ka lëshuar për shqyrtim, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës.**
2. **Në rast se Gjykata ka përcaktuar që një ligj ka shkelur Kushtetutën, atëherë ajo duhet të shpallë të pavlefshëm ligjin, në pajtim me dispozitat e Rregullës 64 dhe të Rregullës 65 të kësaj Rregulloreje.**

I. Është e paqartë se për çfarë arsye Rregullorja i referohet vetëm vendimeve të gjykatës e jo vendimeve të autoriteteve tjera publike ose thjeshtë akteve individuale. Në çdo rast, sa i përket vendimeve të gjykatës, në shumicën e rasteve flitet për vendimin e Gjykatës supreme si gjykatë e shkallës së fundit e cila Gjykatë bën shqyrtimin në procedurë të ankesës kushtetuese të iniciuar nga ndonjë person fizik ose juridik sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Për shembull, parashtruesit mund të ankohen se gjykatat kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese duke:

(1) Aplikuar ndonjë normë e cila është jo kushtetuese,
(2) Aplikuar ndonjë normë kushtetuese në aso mënyre që shkelë të drejtat e tyre kushtetuese,
(3) Konfirmuar ndonjë akt të nxjerrë nga administrata e cila shkelë të drejtat e tyre kushtetuese,

[680] Shih, CDL-STD(1993)002, Modelet e Juridiksionit Kushtetues nga Helmut Steinberger, Komisioni i Venedikut.
[681] Shih rolin e gjykatës kushtetuese në konsolidimin e sundimit të ligjit, Bukuresht, 8-10 Qershor 1994, Komisioni i Venedikut, CDL-STD (1994) 010.

(4) Aplikuar ndonjë procedurë e cila bazohet në normë jo kushtetuese,
(5) Aplikuar procedurën e gabuar ose duke aplikuar procedurën gabimisht, e kështu ka shkelur të drejtat e tyre kushtetuese,
(6) Marrë vendim që në çfarëdo mënyre shkelë të drejtat e tyre kushtetuese.

Kjo listë nuk pretendohet të jetë e mbyllur dhe gjithëpërfshirëse, por vetëm tregon disa shembuj të bazave ligjore për pretendimet nga neni 113.7 i Kushtetutës. Sa i përket aplikimit të një norme jo kushtetuese nga gjykatat, parashtruesi duhet të pretendojë se shkelja e të drejtave të tij rezulton nga akti administrativ ose gjyqësor që aplikon ose zbaton normën jo kushtetuese. Si rezultat, Gjykata mund të shqyrtojë kushtetutshmërinë e normës, dhe nëse konstaton se është jo kushtetuese, e shpallë normën të pavlefshme, ose një pjesë të saj, si jo kushtetuese (shih Rregullën 74(2) më poshtë).

Rregulla 74(1) vetëm mbulon rastin kur një parashtrues ka parashtruar një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës duke pretenduar se një gjykatë e rregullt si shkallë e fundit ka nxjerrë një vendim i cili shkelë të drejtat e tij kushtetuese dhe kërkon nga Gjykata shfuqizimin e vendimit. Sipas Rregullës, nëse gjykata konstaton se vendimi i gjykatës së rregullt shkelë Kushtetutën, ajo shpallë aktgjykimin të pavlefshëm dhe kërkon nga gjykata përkatëse që të rishqyrtojë lëndën në pajtim me vendimin e Gjykatës[682]. Prandaj Gjykata nuk është kompetente për të vendosur për materien e lëndës, siç është rasti për shembull në Slloveni.[683]

Megjithatë, Rregulla nuk përmend kërkesat në lidhje me vendimet e kontestuara të cilat nuk rrjedhin nga gjykata, por nga ndonjë autoritet tjetër publik, pa pasur mundësinë e inicimit të procedurës gjyqësore. Gjithashtu në ato raste, supozohet se Gjykata shpallë vendimin e kontestuar të pavlefshëm dhe kthen vendimin tek autoriteti që e ka nxjerrë atë për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës. Për hir të transparencës dhe qartësisë juridike, sugjerohet shtjellimi i Rregullës në lidhje me këtë.

Në lidhje me Rregullën 74(1), është interesante të shikojmë deklaratën e dhënë nga Profesori Luis Lopez Guerra[684], Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës: "nuk shqyrtohet kushtetutshmëria e ligjit të aplikuar nga ana e gjyqtarit ose nga ana e administratës, por shqyrtohet çështja nëse janë shkelur të drejtat themelore të një apo më shumë individëve me aplikimin e tij. Do të thotë gjykohet akti i gjyqtarit, e jo vet norma. Duke korrigjuar shkeljen e këtyre të drejtave, Gjykata [kushtetuese e Spanjës] mund të nxjerrë udhëzime *pro futuro* për të gjitha autoritetet e shtetit se si të drejtojnë veprimet e tyre në aplikim dhe respektim të të drejtave themelore. Për të qenë të qartë, vendimet e nxjerra në rastet e ankesave kushtetuese zgjidhin vetëm rastet specifike të parashtruara. Por arsyetimi në aktgjykim nxitë një vendim të përgjithshëm i cili, si i tillë, ka vlerën e *erga omnes*. Përmes ankesës individuale kushtetuese, Gjykata do të mund të drejtojë veprimin e autoriteteve gjyqësore,

[682] Shih për shembull rastin KI 58/09 [dhe të tjerët], Gani Prokshi dhe 15 ish punonjësit tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të gjykatës supreme të Republikës së Kosovës, aktgjykim i datës 18 Tetor 2010, buletin i praktikës gjyqësore 2009-2010, faqe 312; dhe në faqen e gjykatës në internet.

[683] Shih nenin 60 të Ligjit Slloven për Gjykatën Kushtetuese.

[684] Shih rolin dhe kompetencat e gjykatës kushtetuese, Raport nga Profesori Luis Lopez Guerra, Spanjë, roli i gjykatës kushtetuese në konsolidimin e sundimit të ligjit, puna e seminarit UniDem, Bukuresht 8-10 Qershor 1994, Komisioni i Venedikut 1994.

ekzekutive dhe legjislative në të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat themelore. Kjo ka rëndësi të veçantë në ato raste ku përcaktimi i fushës së të drejtave themelore kërkon shqyrtimin e interesave të kundërta shoqërore, siç është rasti i baraspeshimit të lirisë së shprehjes dhe informimit me të drejtën e privatësisë ose emrit të pastër".

Në pajtim me citatin e sipërm, vendimet e Gjykatës për ankesat kushtetuese, në kontekstin e Kosovës, nuk mund të kenë vetëm efekt juridik *inter partes*, por edhe efekt juridik *erga omnes*, pasi që sipas nenit 116 [Efekti juridik i vendimeve] dhe Rregulla 63 [Zbatimi i vendimeve], paragrafi 1 i Kushtetutës *"Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*, që do të thotë se efekti i vendimeve prekë të gjithë personat privat të tretë dhe subjektet publike që nuk kanë qenë palë në procedurën në fjalë.

Në shtetet fqinje, përmbajtja e Rregullës 74(1) nuk është shkruar në rregulloren e punës së gjykatave kushtetuese në fjalë, por në aktet e gjykatës kushtetuese, për shembull neni 77 [Efektet ligjore të vendimeve të gjykatës] i Ligjit Shqiptar për Gjykatën Kushtetuese që përmban një dispozitë të ngjashme si Rregulla 74(1), që parashkruan:*"Vendimet e gjykatave të çdo shkalle të cilat nuk janë hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese, humbin autoritetin juridik në momentin kur të nxirret vendimi në lidhje me to [nga Gjykata Kushtetuese]"*.

Për dallim, Rregulla 74(1), nenet 76(1) dhe (2) dhe 77(2) i Ligjit Kroat për Gjykatën Kushtetuese nuk kufizohen me vendimet e gjykatave. Neni 76(1) dhe (2) parashkruan:*"(1) Me vendim të saj për të pranuar ankesën kushtetuese, Gjykatat Kushtetuese shfuqizon aktin e kontestuar i cili ka shkelur një të drejtë kushtetuese.(2) Nëse organi kompetent gjyqësor ose administrativ, organ ose njësi e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, ose person juridik i autoriteti publik, obligohen që të miratojnë një akt të ri që zëvendëson aktin i cili ishte shfuqizuar me vendim në paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata Kushtetuese ia kthen çështjen organit i cili ka nxjerrë aktin e shfuqizuar për përsëritjen e procedurës. […]"*.

Neni 77(2) parashkruan:*"Kur të miratohet akti i ri nga neni 76(2) i aktit kushtetues, organi kompetent gjyqësor ose administrativ, organ ose njësi e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, ose person juridik i autoriteti publik, obligohet të respektojë mendimin juridik të Gjykatës Kushtetuese të theksuar në vendimin i cili shfuqizon aktin i cili ka shkelur të drejtën kushtetuese të parashtruesit"*.

Edhe neni 59(1) i Ligjit Slloven për Gjykatën Kushtetuese përmban tekstin e ngjashëm sikurse Rregulla 74(1), por nuk përmend "gjykatën", por shfrytëzon shprehjen e duhur "autoriteti kompetent" i cili përfshinë gjykatat dhe autoritetet tjera publike. Ai deklaron:*"Me vendim të Gjykatës Kushtetuese hidhet poshtë ankesa kushtetuese si e pabazë ose konfirmohet në tërësi ose pjesërisht ose shfuqizon pjesërisht ose tërësisht aktin individual, dhe kthen rastin tek autoriteti kompetent për vendim në lidhje me atë akt"*.

Edhe neni 64, paragrafi 5 i rregullores së punës së Bosnje Hercegovinës përfshinë si gjykatat ashtu edhe autoritetet tjera:*"Gjykata ose autoriteti vendimi i së cilit është anuluar, obligohet që të miratojë një vendim tjetër ashtu që obligohet që të respektojë opinionin juridik të Gjykatës në lidhje me shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe liritë themelore të ankuesit"*.

Tutje, neni 95(2) BGverfGG gjithashtu përmend "gjykatën" kompetent, si vijon:*"Nëse konfirmohet ankesa kundër një vendimi, Gjykata Kushtetuese Federale prishë vendimin dhe në rastet në pajtim me fjalinë e parë të nenit 90(2) më sipër, e kthen prapa gjykatës kompetente"*.

II. Shfrytëzohet në Rregullën 64 [masat e përkohshme][685] dhe 65 [Aktgjykimi][686], paragrafi 1, dhe përfshinë: "ligjet, dekretet, rregulloret ose statutet komunale", siç është shkruar në Rregullën 65(2).
Tutje, referenca në Rregullën 74(2) për tek Rregulla 64 [masat e përkohshme] nuk duket e qartë, pasi që Rregulla 64 vetëm parashkruan për pezullimin e përkohshëm nga gjykata e instrumentit normativ, "gjersa të nxirret vendimi". Siç u përmend më sipër, Gjykata mund të pezullojë zbatimin e aktit normativ ose individual të kontestuar, nëse zbatimi mund të rezultojë në dëme ose shkelje të mëtejshme që janë të pariparueshme pasi që të konstatohet shkelja kushtetuese e aktit të kontestuar. Prandaj referenca në Rregullën 74(2) në pezullimin e përkohshëm të ligjit për të cilin gjykata ka konstatuar se ka shkelur Kushtetutën, nuk ka fort kuptim. Është e vërtetë se në disa raste Gjykata në aktgjykimin e saj vendosë që pezullimi i përkohshëm i zbatimit të (dispozitave të caktuara të) instrumentit të kontestuar normativ, i cili është shpallur se nuk është në pajtim me Kushtetutën, bëhet urdhër permanent i Gjykatës, gjersa autoriteti kompetent të miratojë një instrument të ri normativ. Por është e paqartë nga teksti i Rregullës 74(2) nëse referenca në Rregullën 64 është menduar që t'i përfshijë këto raste.
Mund të jetë interesant nëse jepet një shembull i një urdhri të tillë permanent për pezullimin e instrumentit normativ të cilin Gjykata e ka konstatuar si jo kushtetues, edhe pse nuk është shfaqur në ankesë individuale nga neni 113.7 i Kushtetutës, por në një rast që ka të bëj me kontroll abstrakt (neni 113.2(1) i Kushtetutës).Kjo ka të bëj me rastin nr. KO 119/10,[687] tanimë të përmendur për sipër, ku Ombudspersoni ka kundërshtuar dispozitat e caktuara të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit që pretendohet se siguron një sistem pensional fitimprurës për Deputetët, në shkelje të neneve 3.2, 7 dhe 74 të Kushtetutës. Në dispozitat funksionale të aktgjykimit, gjykata konstatoi se dispozitat e urdhrit të përkohshëm të gjykatës më datë 18 tetor 2011 që pezullon zbatimin e nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, nr. 03/L-111 të datës 4 qershor 2010, e vazhduar më 20 tetor 2010, bëhet urdhër permanent i gjykatës.

---

[685] Rregulli 64 parashkruan: "Gjykata mund të urdhërojë, ex officio, ose me kërkesën e palës, si masë të përkohshme, që efektet e instrumentit normativ, i cili kundërshtohet, ose ndonjë pjesë e tij, të pezullohen deri sa Gjykata të marrë vendim për atë kërkesë, në pajtim me pjesën VI të kësaj Rregulloreje".

[686] Rregulli 65 parashkruan: "(1) Nëse Gjykata përcakton se dispozita të caktuara të instrumentit normativ nuk janë në pajtim me Kushtetutën, ajo do t'i shpallë ato dispozita të pavlefshme. (2) Gjykata shpall tërë ligjin, aktin, rregulloren ose statutin komunal të pavlefshëm, në rast se përcakton se instrumenti normativ nuk përmbush qëllimin legjislativ ose, në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën".

[687] Rasti nr. KO 119/10, Ombudspersoni i Republikës së Kosovës re. Shqyrtimi kushtetues i nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, nr. 03/L-111 të datës 4 Qershor 2010, aktgjykimi i 8 dhjetorit 2011, buletini i praktikës gjyqësore 2011, faqe 556, dhe në faqen e gjykatës në internet.

Sa i përket referencës në Rregullën 74(2), në Rregullën 65 [aktgjykimi], është e qartë se kjo referencë nuk do të ishte e nevojshme nëse teksti i Rregullës 65 thjeshtë do të përsëritej në Rregullën 74(2). Prandaj në mënyrën e njëjtë sikurse tek Rregulla 65, Gjykata, në vendosjen e ankesës kushtetuese nga neni 113.7 i Kushtetutës, mund t'i shpall të pavlefshme disa dispozita të instrumentit normativ (Rregulla 65(1)) ose mund ta shpallë tërë instrumentin normativ të pavlefshëm, nëse instrumenti nuk përmbushë qëllimin e tij legjislativ ose është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar jo kushtetuese (Rregulla 65(2)).

Megjithatë, asnjë nga nenet e sipërme të Ligjit ose Rregullës e Rregullores së Punës nuk trajtojnë pyetjen nëse dispozitat e ligjit ose ligjit në përgjithësi të cilat Gjykata i ka konstatuar si jo kushtetuese shpallen të pavlefshme *ex tunc* (akti normativ jo kushtetues konsiderohet se kurrë nuk ka qenë pjesë e rendit ligjor të Kosovës) ose *ex nunc* (aktet e bazuara në aktin normativ të deroguar para hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës vazhdojnë të jenë të vlefshme). Siç përmendet në Studimin për qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, të miratuar nga Komisioni i Venedikut, është e qartë se anulimi (*ex tunc*) i një akti të rëndësishëm normativ mund të ketë pasoja të rënda. Zgjidhja [për gjykatën] në mes të anulimit dhe derogimit mund të ketë efekte në gatishmërinë e personit për të parashtruar ankesën kundër aktit normativ. Nëse [gjykata] shpall të pavlefshme normën me efekt në të ardhmen (*ex nunc*), lënda e parashtruesit nuk do të zgjidhet duke mënjanuar normën e përgjithshme jo kushtetuese, përveç nëse aplikohet efekti prapaveprues vetëm për lëndën e parashtruesit të kërkesës (i ashtuquajturi "premia për kapësin")[688]. Studimi përmend se vendimet *ex tunc* nuk ndikojnë në vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe se qartësia juridike në lidhje me vendimet gjyqësore të formës së prerë i jepet prioritet në shumicën e shteteve me vendimet prapavepruese të gjykatës kushtetuese (p.sh. Italia dhe Portugali). Është e qartë se në ligjin e Kosovës nuk ekziston kjo rregull e theksuar.

Megjithatë, Rregulla 66 [Efektet ligjore të aktgjykimit] i Rregullores së Punës jep një përgjigje ndaj kësaj pyetjeje vetëm për "legjislacionin sekondar dhe aktet administrative që janë nxjerrë në bazë të dispozitave të ligjit, dekretit, rregullores ose statutit komunal që është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata", i cili sipas Rregullës, "nuk aplikohet nga data e hyrjes në fuqi të aktgjykimit". Prandaj Rregulla qartë i referohet anulimit të instrumenteve përkatëse ligjore nga Gjykata *ex nunc*.

Tutje, Rregulla 74(2) nuk tregon se çka ndodhë me vendimin e kundërshtuar të gjykatës së rregullt pasi që gjykata të ketë shpallur të pavlefshëm ligjin në të cilin është bazuar vendimi. Në praktikë, Gjykata prishë atë vendim dhe kthen lëndën tek gjykata e rregullt për rivendosje në pajtim me aktgjykimin e gjykatës në mënyrën e theksuar në Rregullën 74(1). Megjithatë, është e mundshme që vendimi i gjykatës që shpall dispozitat e kontestuara të ligjit si jo kushtetuese është i tillë që gjyqtari i rregullt, i cili obligohet që të rivendosë në pajtim me atë aktgjykim, ka vështirësi në nxjerrjen e vendimit të ri në bazë të dispozitave të mbetura të ligjit të cilat do të

[688] Shih studimin për qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, Komisioni i Venedikut, CDL-AD(2010)039rev, faqe 50.

përmbushnin konstatimin e gjykatës[689]. Në këto rrethana, gjykata e rregullt mund të ndihet e pafuqishme për të rivendosur lëndën, përderisa legjislatura të mos plotësojë mangësinë juridike të shkaktuar nga shpallja e pavlefshme e dispozitave të ligjit të cilat janë aplikuar në atë lëndë. Si pasojë, lënda që pret rivendosje nuk mund të zgjidhet gjersa të ndërhyjë legjislatura.

Edhe një herë, Rregulla 66 [Efektet ligjore të aktgjykimit] të Rregullores së Punës shfaqet si shpëtimtar me këtë fjali:*"Nëse Gjykata ka nxjerrë një vendim për një lëndë penale, në bazë të dispozitës së ligjit, rregullores ose statutit komunal që është shpallur jokushtetues, personi kundër të cilit është nxjerrë vendimi mund të rihapë procedurën në lëndën penale"*.Edhe pse shprehjet e Rregullës 66(2) nuk specifikojnë se kanë të bëjnë me Procedurën e veçantë nën 113.7 të Kushtetutës, ai qartë trajton situatën ku parashtruesi, i cili ka qenë subjekt i procedurës penale, ka parashtruar kërkesën në Gjykatë me ankesën ndaj vendimit të gjykatës së rregullt i cili vendim është nxjerrë në bazë të një dispozite të ligjit, dekreti ose rregulloreje të cilën Gjykata e ka shpallur jo kushtetuese (efekti *ex tunc* për lëndët penale).Në atë situatë, aktgjykimet e nxjerra nga gjykatat penale në bazë të ligjit, dekretit ose rregullores jo kushtetuese duhet të rivendosen me kërkesë të parashtruesit për të rihapur lëndën penale. Në të vërtetë, vendimi i gjykatës ka efekt *ex tunc* dhe është i aplikueshëm *erga omnes*, gjë që i mundëson të gjithë personave, të cilët janë dënuar në bazë të dispozitës së njëjtë të ligjit, dekretit ose rregullores së shpallur jo kushtetuese, të rihapin lëndët e tyre penale, gjë që mund të rezultojë në lirimin e menjëhershëm të atyre personave. Në rast se rrezikohet etiketimi i emrit të personit të vdekur, këto procedura mund të iniciohen nga familjarët.

Një rregull i ngjashëm është parashkruar në nenin 79(2) të BGVerfGG i cili parashkruan:*"Mund të iniciohet procedura e re në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kundër dënimit të formës së prerë të bazuar në një rregull i cili është shpallur se nuk është në pajtueshmëri me ligjin themelor ose është shpallur i pavlefshëm sipas nenit 78 më sipër, ose në interpretimin e një Rregulle të cilën Gjykata Kushtetuese Federale e ka shpallur se nuk është në pajtueshmëri me ligjin themelor"*.

Edhe neni 58(1) i Ligjit Kroat për Gjykatën Kushtetuese përmban një rregull të ngjashëm sikurse Rregulla 66, që parashkruan: *"Dënimi i formës së prerë për vepër penale i bazuar në dispozitën ligjore që është përsëritur sepse nuk është në pajtim me Kushtetutën, nuk prodhon efekte ligjore nga data kur hyn në fuqi vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon ligjin në bazë të së cilit është shqiptuar dënimi, dhe dënimi i formës së prerë mund të ndryshohet me aplikimin përkatës të dispozitave gjatë procedurës së përsëritur penale"*.

Sa i përket anulimit të tërë ligjit nga gjykata, asnjë nga Rregullat e sipërme nuk trajton situatën ku gjykata e rregullt obligohet që të zbatojë vendimin e Gjykatës përmes së cilit i tërë ligji është shpallur i pavlefshëm, ligj i cili është shfrytëzuar nga gjyqtari për të nxjerrë aktgjykimin. Në mungesë të ligjit jokushtetues dhe pa ligj të ri të miratuar nga legjislatura, do të jetë e vështirë jo vetëm për gjykatën e

[689] Shih marrëdhëniet e gjykatës kushtetuese me gjykatat e rregullta dhe autoritetet tjera publike, raport nga profesor Michel Melchior, Kryetar i gjykatës belge të arbitrazhit, punimet e seminarit UniDem "Roli i gjykatës kushtetuese në konsolidimin e sundimit të ligjit", i organizuar në Bukuresht më 8-10 Qershor 1994 nga Komisioni i Venedikut, shtypi i Këshillit të Evropës, 1994.

rregullt që të rivendosë lëndën, por edhe për gjykatat tjera të rregullta që trajtojnë çështjet e ngjashme të cilat përballen me vendimin përkatës. Siç u kontestua nga profesori Michel Melchior në raportin e tij të cituar më sipër: *"Por sa lëndë të reja janë e sa në pritje të ligjit të ri?"*

Gjykata e rregullt me siguri se do të ketë vështirësi për gjetjen e rregulloreve zëvendësuese në bazë të së cilit do të rivendoset lënda për të përmbushur vendimin e Gjykatës. Pasi që, në pajtim me nenin 116 [Efektet ligjore të vendimeve], vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë obliguese për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës, legjislatura do të obligohet që të miratojë një ligj të ri i cili duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe me aktgjykimin e Gjykatës. Në aktgjykimin e saj, Gjykata mund të tregoj madje periudhën kohore brenda së cilës legjislatura duhet ta nxjerrë ligjin. Megjithatë gjer tani Gjykata nuk ka trajtuar kërkesat nga neni 113.7 të Kushtetutës, në të cilin legjislatura urdhërohet miratimi i legjislacionit të ri brenda afatit të caktuar kohor të cilën do ta aplikonte gjykata e rregullt në vendimin e ri që zëvendëson vendimin e prishur nga Gjykata.

Edhe pse ende nuk ka ndonjë shembull të këtij rasti nga neni 113.7 të Kushtetutës, Gjykata ka shfrytëzuar autoritetin në ndonjë lëndë të parashtruar pranë saj nga neni 62.4 të Kushtetutës. Në lëndën nr. KO. 01/09, Qemailj Kurtisi dhe kuvendi komunal i Prizrenit, ku Gjykata "[urdhëroi] komunën e Prizrenit që të ndryshojë statutin e saj dhe emblemën e saj brenda tre muajve nga nxjerrja e këtij aktgjykimi me qëllim që të sillen ato në pajtim me Kushtetutën dhe të mos përjashtohen komunitetet jo shumicë; "dhe kërkoi "nga komuna e Prizrenit që t'i raportojë gjykatës rreth përparimit në lidhje me pajtueshmërinë me atë Urdhër para skadimit të periudhës tremujore nga nxjerrja e këtij Aktgjykimi; "dhe mbajti çështjen të pezulluar në pritje të pajtueshmërisë me Urdhrin"[690]. Gjer tani Gjykata nuk ka nxjerrë urdhër të ngjashëm për Kuvendin, kur konstatoi se një ligj, ose një pjesë e tij, ishte jo kushtetues.

Sa i përket efektit ligjor të vendimeve të nxjerra nga gjykatat kushtetuese për kërkesat individuale në disa shtete fqinje, neni 58 i Ligjit Kroat për gjykatë kushtetuese përmban një zgjidhje, ku një parashtrues duhet t'i kthehet organit i cili ka nxjerrë aktin final individual për dispozitën e shfuqizuar dhe dorëzon kërkesën për ndryshimin e atij akti në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Neni 58(2) parashkruan:*"Çdo individ ose person juridik që ka parashtruar pranë Gjykatës Kushtetuese propozimin për shqyrtim të kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore, ose kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitës së ndonjë rregulloreje tjetër, dhe Gjykata Kushtetuese ka pranuar propozimin dhe ka shfuqizuar dispozitën e ligjit, ose dispozitën e ndonjë rregulloreje tjetër, ka të drejtën që të parashtrojë kërkesën pranë organit kompetent për të ndryshuar aktin final individual që ka shkelur të drejtat e tij, dhe i cili është miratuar në bazë të dispozitës së shfuqizuar të ligjit, ose dispozitës së shfuqizuar të rregullores tjetër, përmes aplikimit të dispozitës për përsëritje të procedurës"*.

Teksti i nenit 67 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnje e Hercegovinës është i ngjashëm me atë të nenit 58 të Ligjit Kroat për Gjykatën

[690] Shih aktgjykimin e Gjykatës nga 18 marsi 2010, Buletini i praktikës gjyqësore 2009-2010, dhe në faqen e gjykatës në internet.

Kushtetuese, pasi që edhe ai drejton parashtruesin tek autoriteti i cili ka nxjerrë aktin individual në bazë të dispozitave të shpallura jo kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Neni 67 shkruan:*"Të gjithë ata, të drejtat e së cilëve janë shkelur me akt individual final ose të anuluar, që është miratuar në pajtim me dispozitat të cilat anulohen në pajtim me nenin 63 të Rregullores së Punës, kanë të drejtën që të kërkojnë nga autoriteti kompetent të ndryshojnë atë akt individual përderisa autoriteti kompetent obligohet që të përsëris procedurën dhe ta sjellë aktin në pajtim me vendimin e Gjykatës".*

Neni 76 [Efektet ligjore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese] i Ligjit Shqiptar për Gjykatën Kushtetuese ka natyrë më të përgjithshme, i cili parashkruan: "*1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cili ka shfuqizuar një ligj ose akt normativ për shkak të papajtueshmërisë me Kushtetutën ose me një marrëveshje ndërkombëtare, si rregull, sjellë efekte ligjore nga data kur hyn në fuqi. 2. Vendimi ka efekte prapavepruese vetëm [në këto raste]:[...] b. Për rastet që shqyrtohen nga gjykata, përveç nëse vendimi i saj nuk është i formës së prerë; […]".*

Edhe neni 95(2) dhe (3) i Ligjit Gjerman për Gjykatën Kushtetuese ka përmbajtjen e ngjashme, si vijon:*"(2) Nëse konfirmohet ankesa kundër një vendimi, Gjykata Kushtetuese Federale prishë vendimin dhe në rastet në pajtim me fjalinë e parë të nenit 90(2) më sipër, ia kthen prapa gjykatës kompetente".(3) Nëse konfirmohet ankesa kundër një ligji, ligji shpallet i pavlefshëm. E njëjta vlen nëse ankesa në pajtim me paragrafin 2 më sipër konfirmohet sepse vendimi i prishur bazohet në një ligj jo kushtetues. […]*".

11. Procedura në rastin e përcaktuar nën nenin 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuar], paragrafi 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

Procedura e veçantë për lëndët e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës që njihet edhe si "shqyrtimi ose kontrolli konkret ose i rastësishëm kushtetues". Shprehja e mëtejshme është: "pyetja ose kërkesa preliminare" i referohet Gjykatës nga gjykatat e rregullta[691], për dallim nga "kontrolli abstrakt" i cili është komentuar më sipër nën nenin 113.2 të Kushtetutës[692] dhe nenet 29 dhe 30 të Ligjit. Prandaj gjykata e rregullt ka autoritetin për të parashtruar kërkesën në Gjykatë, (1) kur ngrihet pyetja e

[691] Mundësia e ngritjes së çështjeve për kontroll të rastit para gjykatës kushtetuese ekziston në shumë shtete, për shembull në Shqipëri, Austri, Belgjikë, Bosnje e Hercegovinë, Kroaci, Çekí, Gjermani, Itali, Sllovaki, Slloveni dhe Spanjë. Për hollësitë për shtetet fqinje, shih më poshtë.

[692] Neni 113.2(1) i Kushtetutës parashkruan: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën në procedurën gjyqësore para saj; (2) kur është e paqartë nëse ligji i kontestuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën, dhe në fund, (3) kur vendimi i gjykatës referuese për lëndën që shqyrtohet varet nga pajtueshmëria e ligjit të kontestuar me Kushtetutën.

Sa i përket dispozitës (1) nga teksti i nenit 113.8, nuk është mjaft e qartë se kush ka të drejtë që të ngrehë çështjen e pajtueshmërisë: Pala në procedurë ose vet gjykata e rregullt? Në lidhje me këtë, dispozita (2) mund të jetë e dobishme, pasi që i referohet "ligjit të kontestuar" që vetëm mund të nënkuptojë se pala duhet të ketë kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit përkatës. Pa dyshim se edhe gjykata e rregullt mund të ngrehë çështjen e pajtueshmërisë në procedurën pranë saj, por neni 113.8 nuk është mjaft i qartë në lidhje me të. Prandaj, mund të kërkohet udhëzim tek zbatimi i neneve 51 dhe 53 të ligjit. Por edhe aty nuk ka shpjegim të qartë. Vetëm paragrafi 1 i Rregullës 75 [Parashtrimi i kërkesës] të Rregullores së Punës që plotëson nenin 51 të ligjit është i qartë në Rregullën se gjykata referuese mund ta referojë çështjen preliminare në Gjykatë me kërkesë të palës ose *ex oficio*[693]. Prandaj gjykata referuese ose pala duhet të ketë ngrehur çështjen e pajtueshmërisë në procedurën gjyqësore, para se ta parashtrojë në Gjykatë.

Sa i përket dispozitave (2) dhe (3), ato nënkuptojnë se gjykata referuese duhet të jetë e qartë nëse ligji i kontestuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe se vendimi i saj në lidhje me lëndën të cilën e trajton mund të varet nga pajtueshmëria e ligjit të kontestuar. Prandaj përderisa gjykata e rregullt është e sigurt se ligji në fjalë është në pajtim me Kushtetutën, përkundër ngritjes së çështjes nga pala në procedurë, ajo nuk ka nevojë që ta referojë çështjen e papajtueshmërisë kushtetuese në Gjykatë, por duhet të vazhdojë shqyrtimin e lëndës. Megjithatë, gjykata e rregullt nuk mund të injorojë me lehtësi çështjen e ngrehur nga pala, natyrisht përveç vendimit, i cili sipas mendimit të gjykatës, nuk varet nga ligji i kontestuar nga pala, por nga një ligj tjetër të cilin gjykata e konsideron se është në pajtim me Kushtetutën.

Por edhe nëse gjykata e rregullt është e pasigurt rreth pajtueshmërisë së ligjit përkatës me Kushtetutën, ajo mund të ngurojë para parashtrimit të "çështjes preliminare" pranë Gjykatës sipas detyrës zyrtare, d.m.th. para se pala ta ngrehë atë çështje. Kjo mund të jetë arsyeja pse vetëm pak pyetje preliminare nga neni 113.8 i Kushtetutës janë ngrehur pranë Gjykatës gjer tani.

Vendimi në lidhje me kërkesën nga neni 113.8 prekë një nga kompetencat kryesore të Gjykatës, që është shkruar në nenin 112.1[694] të Kushtetutës, që parashkruan se Gjykata Kushtetuese është autoriteti i fundit për interpretimin e Kushtetutës dhe pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën. Prandaj është me rëndësi që gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës, kurdoherë që kanë dyshime rreth papajtueshmërisë së një ligji në bazë të së cilit mund të varet vendimi, ose kurdoherë që çështja ngrehet nga njëra palë, ta referojë çështjen në Gjykatë për shqyrtim konkret nga neni 113.8 i Kushtetutës.

[693] Rregulli 75(1) parashkruan: "Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë".

[694] Neni 112.1 i Kushtetutës parashkruan: "Kushtetuta afirmon se Gjykata Kushtetuese është 'autoriteti final për interpretimin e Kushtetutës dhe pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutë".

Siç u tha në Studimin e qasjes individuale në drejtësinë kushtetuese të miratuar nga Komisioni i Venedikut:*"Shqyrtimi i rastësishëm bëhet në çfarëdo faze të procedurës së rregullt nga gjyqtari i rregullt. Për dallim nga ankesat specifike kushtetuese, kontestimi i kushtetutshmërisë së normave përmes shqyrtimit të rastësishëm është i hapur për çdo person i cili është pjesëmarrës në procedurën e rregullt. Efektiviteti i këtij lloji të shqyrtimit varet nga njohja individuale e të drejtave dhe nga kapaciteti dhe vullneti i gjyqtarit të rregullt për të hetuar shkeljet e të drejtave themelore. Të dyja kushtet nuk janë plotësisht të qarta".*[695]

Komentet e hollësishme për procedurën e veçantë siç përkufizohet me nenin 113.8 të Kushtetutës tanimë janë bërë gjatë trajtimit të (1) Neneve 51 [Saktësimi i kërkesës], 52 [Procedura para gjykatës] dhe 53 [Vendimi] i Ligjit që zbatojnë nenin 113.8, si dhe me (2) Rregullës 64 [Masat e përkohshme], 65 [Aktgjykimi], 75 [Parashtrimi i kërkesës], 76 [Njoftimi] dhe 77 [Aktgjykimi] i Rregullores së Punës që plotëson këto nene.

Sa i përket gjendjes në shtetet tjera të rajonit, neni 37 i Kapitullit IV [Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregulloreve tjera] të Ligjit Kroat për Gjykatën Kushtetuese parashkruan për kontrollin e rastësishëm të procedurës dhe kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të njoftojë Gjykatën Supreme për ato kërkesa të parashtruara nga gjykatat tjera të rregullta. Neni 134.1(e) në lidhje me nenin 145, paragrafi 2, i Kushtetutës Shqiptare dhe neni 68, përveç tjerash, i Kapitullit për procedurën e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve që kërkohen nga Gjykatat nga Ligji Shqiptar për Gjykatën Kushtetuese, rregullon çështjen e kontrollit të rastësishëm nga Gjykata Kushtetuese. Tutje, Neni VI. 3(c) i Kushtetutës së Bosnje e Hercegovinës parashkruajnë procedurën e ngjashme.

Edhe neni 156 [Shqyrtimi Kushtetues] i Kushtetutës Sllovene përmban procedurën e kontrollit të rastësishëm që iniciohet nga gjykata e rregullt, kurse neni 23 i Kapitullit IV [Shqyrtimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së rregulloreve dhe akteve të përgjithshme të nxjerra për ushtrimin e autoritetit publik, 1. Kërkesat dhe peticionet për inicimin e procedurës së shqyrtimit] i Ligjit Slloven për Gjykatën Kushtetuese, parashkruajnë procedurën e njëjtë dhe rregullojnë shprehimisht situatën në të cilën Gjykata Supreme parashtron çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit ose pjesëve të tij pranë Gjykatës Kushtetuese[696]. Përfundimisht, neni 100 [Shqyrtimi konkret gjyqësor] i Ligjit Themelor Federal i Gjermanisë parashkruan procedurën e ngjashme, përderisa nenet 80 gjer 82 të Procedurës nga Seksioni Njëmbëdhjetë në rastet në pajtim me nenin 13(11) [Shqyrtimi i ligjeve specifike] i Ligjit për Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë[697] ka dhënë hollësi shtesë rreth procedurës së kontrollit të rastësishëm.

[695] Studimi është miratuar në seancën 85 plenare (Venedik 17-18 Dhjetor 2010) në bazë të komenteve nga z. Gagik Harutyunyan (anëtar, Armenia), znj. Angelika Nussberger (anëtare zëvendësuese, Gjermania) dhe z. Peter Paczolay (anëtar, Hungaria), CDL-AD(2010)039rev, Studimi nr. 538/2009, Strasburg, 27 Janar 2011

[696] Nenet 23(2) dhe (3).

[697] Neni 13.11 i Ligji Gjerman për Gjykatën Federale Kushtetuese parashkruan: "Gjykata Federale Kushtetuese vendosë [...] për pajtueshmërinë e ligji federal apo republikan me Ligjin Themelor ose pajtueshmërinë e statutit të republikës ose ligjet tjera të republikave me ndonjë ligj federal, kur ai vendim kërkohet nga ndonjë gjykatë (neni 100(1) i ligjit themelor).

Neni 51 [Saktësimi i kërkesës]

51.1 Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

51.2 Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

1 Si vërejtje preliminare, duhet të përmendet se shprehja "ligjshmëri" në rreshtin e katër të nenit duket se është e pavend. Nuk është "ligjshmëria"" e ligjit të kontestuar që shqyrtohet në Procedurën e veçantë, por është "pajtueshmëria kushtetuese", siç ceket në nenin 113.8 të Kushtetutës. Prandaj në komentet e poshtme do të shfrytëzohet shprehja 'pajtueshmëri kushtetuese' ose 'kushtetutshmëria' në vend të 'ligjshmërisë'.

Teksti i nenit 51 duket paksa i ndryshëm nga ai i nenit 113.8 të Kushtetutës, të cilin e plotëson. Në dukje të parë, neni 51.1 nuk duket se parashkruan në mënyrë eksplicite se çështja e pajtueshmërisë duhet të ngrihet në procedurë. Megjithatë, ai shfrytëzon shprehjen "ligjin e kontestuar" që duhet të kuptohet se njëra palë në procedurë duhet të ketë kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit duke ngrehur çështjen. Prandaj, në bazë të nenit 51.1, vetëm kur gjykata e rregullt ka nevojë që ta aplikojë direkt ligjin e kontestuar nga njëra palë, dhe vetëm kur kushtetutshmëria e atij ligji është parakusht për vendimin, atëherë gjykata e rregullt parashtron kërkesën pranë Gjykatës.

Prandaj, nëse gjykata e rregullt është e mendimit se ligji i kontestuar nuk aplikohet direkt në lëndën në shqyrtim dhe kushtetutshmëria e tij nuk është parakusht për vendimin për atë lëndë, mund të vendoset që mos të parashtrohet çështja preliminare pranë Gjykatës. Kjo do të thotë se në këto rrethana gjykata e rregullt mund të injorojë çështjen e pajtueshmërisë kushtetuese të ngrehur nga pala, thjeshtë për arsyen se pala konteston një ligji i cili nuk aplikohet në lëndën në shqyrtim. Megjithatë nëse njëra palë ngrehë çështjen e pajtueshmërisë në lidhje me një ligj, të cilin gjykata e rregullt e aplikon për lëndën në shqyrtim, gjykata e rregullt nuk duket se mund të refuzojë referimin e çështjet pranë Gjykatës, edhe nëse nuk e preferon këtë gjë. Megjithatë, pasi që as neni 113.8 i Kushtetutës, e as nenet 51 e 53 të ligjit ose Rregullës 75 e 77 nuk përmendin shprehimisht mundësinë që gjykata e rregullt të refuzojë kërkesën e palës për ta ngrehur çështjen e pajtueshmërisë pranë Gjykatës, gjykata e rregullt ndoshta e ka më të lehtë ta refuzojë atë kërkesë (thirret në Studimin për Qasjen Individuale në Drejtësinë Kushtetuese: "përjashtimi nga jokushtetutshmëria")[698], përveç nëse pala ka qenë plotësisht e gabuar ose kërkesa e saj ishte plotësisht e pabazuar. Në çdo rast, edhe nëse një gjykatë e rregullt do ta refuzonte "përjashtimin e kushtetutshmërisë" së ngrehur nga një palë, pala mund ta ngrehë atë përsëri në procedurën e apelit, dhe nëse është e pasuksesshme në të gjitha shkallët, mund ta ngrehë pranë Gjykatës në kërkesën e parashtruar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

[698] Faqe 17 e studimit.

Në çdo rast, nëse njëra palë nuk ngrehë çështjen e pajtueshmërisë fare, gjykata e rregullt duket se ka lirinë e plotë, në pajtim me Rregullën 75(2), që mos të kërkojë nga Gjykata për vendim preliminar nga neni 113.8 i Kushtetutës, edhe kur ka dyshime rreth kushtetutshmërisë së ndonjë ligji të cilin synon ta aplikojë në lëndën që e shqyrton.

Vetëm kohëve të fundit po parashtrohen kërkesat për vendim paraprak pranë Gjykatës[699]. Kjo nuk nënkupton se gjykatat e rregullta kurrë nuk kanë dyshime rreth kushtetutshmërisë së aktit normativ të aplikueshëm në rastet konkrete që shqyrtohen nga to, ose që asnjë palë nuk ka dyshime të ngjashme, por nuk ngrehin çështjen e pajtueshmërisë pranë gjykatës së rregullt. Siç u përmend më sipër, ndoshta gjykatat e rregullta ngurrojnë në marrjen e iniciativës dhe në shfrytëzimin e mundësisë për shqyrtim konkret gjyqësor, për shkak të mosnjohjes së procedurës dhe kërkesës për të arsyetuar kërkesën e vet para gjykatës.

Sipas Studimit për qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, "efektiviteti i procedurës për vendosje preliminare varet shumë nga kapaciteti dhe vullneti i gjyqtarëve të rregullt për të identifikuar aktet normative që mund të jenë jo kushtetuese dhe ta parashtrojnë çështjen pranë gjykatës kushtetuese"[700]

Prandaj nuk është detyrë e lehtë për gjykatën referuese që të formulojë bazat legjitime të kërkesës së vet për vendim preliminar, por shpresojmë se është vetëm çështje kohe para se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve të gjejnë rrugën për tek Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose pasi që palët të ngrehin çështjen (më shpesh) në procedurat gjyqësore.

2 Në kërkesën e saj për shqyrtim konkret kushtetues të ligjit që aplikohet në lëndën në shqyrtim, gjykata referuese duhet t'i specifikojë, sipas nenit 51.2, dispozitat e ligjit kontestues (ose ligjin në tërësi) të cilat konsiderohen si jo kushtetuese. Në kërkesën e parashtruar pranë Gjykatës me kërkesë të palës në procedurë pranë gjykatës referuese, ajo palë duhet t'i specifikojë dispozitat e kontestuara, dhe nëse nuk bëhet mirë, do të kërkohet nga gjykata referuese që ta materializojë atë kërkesë.

Por gjykata referuese nuk duhet vetëm të kërkojë nga pala kërkuese që të jap hollësi për kërkesën e saj, por duhet t'i mundësojë palës tjetër në procedurë para se t'i parashtrojë komentet e saj, nëse ka, të cilat i bashkëlidhen opinionit të palës kërkuese. Prandaj Gjykata do të ketë më shumë opinione të ndryshme rreth çështjeve kushtetuese të cilat i janë referuar.

Në rastin të cilën e parashtron sipas detyrës zyrtare (shih komentet për Rregullën 75(1) më poshtë), gjykata referuese duhet që t'i specifikojë dispozitat jo kushtetuese dhe t'i jep arsyet për shqyrtim. Njëkohësisht mund të kërkojë nga palët që të japin komente në kërkesë. Neni 51.2 nuk parashkruan shprehimisht se gjykata referuese mund të komunikojë me Gjykatën gjatë procedurës për shqyrtim kushtetues ose të paraqitet si palë në procedurë (shih edhe komentet për Rregullën 75(3) më poshtë).

[699] Shih lëndën nr. KO 04/11, Parashtrues i kërkesës Gjykata Supreme, aktgjykim i 1 marsit 2012.
[700] Faqe 17 e studimit.

Kjo lidhje, Prof. Michel Melchior në raportin e tij për marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e rregullta dhe me autoritet tjera publike[701] ngrehë një temë interesante dhe të rëndësishme. Në mendimin e tij, për shumë shtete Evropiane është me rëndësi që të merr parasysh faktin se institucionet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë gjasë që të konfirmojnë zgjidhjen e dhënë nga Gjykata Evropiane në aktgjykimin Ruiz Matoes[702] sipas së cilës garancitë e nenit 6 të Konventës aplikohen në procedurën preliminare pranë gjykatës kushtetuese[703], pasi që kjo procedurë mund të jetë vendimtare për procedurën gjyqësore në lidhje me përcaktimin e të drejtave civile ose obligimeve ose për akuzë penale për të cilën duhet të vendosë gjyqtari i cili ka bërë kërkesën.

Në mendimin e saj "duket se është e dëshirueshme (e madje e domosdoshme, në aplikimin e nenit 6(1) të KEDNJ) që palët në një rast para gjyqtarit kërkues të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre para gjykatës kushtetuese në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj. Kjo mund të bëhet përmes parashtrimit të mendimeve me shkrim ose duke vëzhguar seancën publike ose me kombinim të të dyjave. Ky duket se është minimumi i nënkuptuar nga KEDNJ. Kjo nënkupton se në lëndën penale, prokuroria do ta ketë mundësinë që të shpreh pikëpamjet e veta. Ngjashëm, çdo palë që pretendon dëmet ose individ që ka parashtruar padi private, ka të drejtën që të dëgjohet. Mund të jetë e dëshirueshme për autoritetet e ndryshme publike që kanë interes në ligjin në fjalë që edhe ata të përfshihen, për shembull autori apo autorët e ligjit që shqyrtohet, d.m.th. kuvendet të cilat kanë miratuar ligjin ose përgjegjësin ekzekutiv për sanksionimin, shpalljen ose aplikimin e tij[704].[...] Dikush mund të mendojë që çdo individi privat ose publik t'i jepet interesi brenda rastit, dhe me mundësi të përfshirjes. Kjo mund të zgjerohet, për shembull, tek organizatat bamirëse aktiviteti i së cilave lidhet ngushtë me ligjin që shqyrtohet[705].Përveç kësaj, mund të përfshihen edhe personat që janë palë në një lëndë identike ose të krahasueshme me atë që ka nxitë kërkesën.[…] Kjo mundësi ka gjasë që të shkaktojë vështirësi serioze për gjykatën kushtetuese në trajtimin e lëndëve të referuara për shkak të numri të madh të personave që mund të përfshihen”.[706]

---

[701] Shih marrëdhëniet e gjykatës kushtetuese me gjykatat e rregullta dhe autoritetet tjera publike, raport nga profesor Michel Melchior, Kryetar i gjykatës belge të arbitrazhit, punimet e seminarit UniDem "Roli i gjykatës kushtetuese në konsolidimin e sundimit të ligjit", i organizuar në Bukuresht më 8-10 Qershor 1994 nga Komisioni i Venedikut, shtypi i Këshillit të Evropës, 1994.

[702] Shih, *Ruiz-Mateos kundër Spanjës*, aktgjykim i GJEDNJ i 23 qershorit 1993, Seria A nr. 262.

[703] Me "procedurën preliminare pranë gjykatës kushtetuese" nënkuptohet procedura e rastësishme për kontrollin e normës.

[704] Për shembull, neni 82 i Ligjit për Gjykatën Federale Kushtetuese parashkruan se organet kushtetuese të përmendura në nenin 77 (Bundestag, Bundesrat, qeveria federale) mund të përfshihen në procedurë në çdo fazë.

[705] Në cilësinë e “*amicus curiae*”.

[706] Fusnota e tekstit origjinal: "Në Belgjikë dispozita e Ligjit Special për Gjykatën e Arbitrazhit që i mundëson çdo personi që mund të tregojë se ka interes në atë lëndë para gjykatës referuese të parashtrojë memorial në Gjykatë ishte subjekt i interpretimit shumë strikt përkundër faktit se aktgjykimi i nxjerrë për çështjen preliminare të ligjit mund të ketë efekt indirekt në lëndët e krahasueshme me atë për të cilën është parashtruar çështja. Në të vërtetë është shumë e mundshme që gjykata kushtetuese do të konfirmojë praktikën e mëhershme gjyqësore kur të trajtojë ndonjë problem ligjor analog me atë për të cilin tanimë është vendosur".

Këto sugjerime interesante, të propozuara në vitin 1994 nga Profesori Melchior, në atë kohë kur ishte Kryetar i Gjykatës Belge të Arbitrazhit (tani Gjykata Kushtetuese Belge), mund të jetë shumë i dobishëm për t'u shqyrtuar në lidhje me kërkesat që kërkojnë vendosje preliminare në kontekst të Kosovës. Përkundër autoriteteve publike të përmendura në raportin e sipërm, mund të parashihet që ta ftojë edhe Ombudspersonin që të merr pjesë në procedurë.
Komentet e mëtejshme janë dhënë në Rregullën 75 [Parashtrimi i kërkesës] së Rregullores së Procedurës, që plotëson nenin 51 të Ligjit.

Rregulla 75 [Parashtrimi i kërkesës] i Rregullores së Punës

1. **Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.**
2. **Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.**
3. **Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113,8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.**

I. Përkundër nenit 113.8 të Kushtetutës dhe Nenit 51.1 të Ligjit, Rregulla 75(1) deklaron qartë se nuk mundet çdo gjykatë e rregullt në Kosovë të parashtrojë kërkesën nga neni 113.8 i Kushtetutës me kërkesën e njërës palë, por edhe *ex officio*. Megjithatë, çështja legjitime mund të ngrihet nëse një gjykatë e rregullt e cila është e autorizuar, në pajtim me Nenin 113.8 të Kushtetutës dhe Nenin 51.1 të Ligjit, që të parashtrojë kërkesën në Gjykatë kur çështja e pajtueshmërisë ngrihet në procedurën në shqyrtim, mund ta ketë të drejtën që *ex officio* ta bëj këtë në pajtim me Rregulloren e Punës së Gjykatës. Mund të jetë gjithashtu që gjykata e rregullt ka nevojë autorizim me ligj për ta bërë këtë.
Siç përmendet më sipër, mund të ngritët problemi i mëtejmë kur një palë ngritë "përjashtimin e kushtetutshmërisë" me një gjykatë të rregullt, ku pala tjetër mund të jetë kundër parashtrimit të kërkesës në Gjykatë, pasi që mund të vonojë gjykimin e lëndës në shqyrtim. Prandaj, në rast se gjykata e rregullt vendosë që të parashtrojë kërkesën në Gjykatë, pala e fundit mund të mundohet të ankohet kundër këtij vendimi, nëse mundet.
Sipas Profesorit Michel Melchior[707], "Në parim nuk është e dëshirueshme që ankesa të parashtrohet kundër vendimit të gjyqtarit i cili dërgon çështjen preliminare të ligjit[708]. Kjo ankesë me gjasë mund të çojë drejt shqyrtimit kushtetues të ligjit në fjalë. Në përgjithësi, dhe në parim, nuk është e dëshirueshme që ligji "i dyshimtë" të figurojë në sistemin gjyqësor. Kjo pikëpamje duket se

[707] Shih, raporti i tij për marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese me Gjykatat e Rregullta dhe autoritetet tjera publike të përmendura më sipër.
[708] Në vend të shprehjes "kontrolli konkret ose i rastësishëm i normës", Profesori Melchior shfrytëzon shprehjen "çështja preliminare e ligjit ose procedura preliminare".

tejkalon kritikën. Por nuk mund të imagjinohet situata në të cilën çështja preliminare e ligjit dërgohet nga gjyqtari vetëm pasi që është i obliguar - pa qenë në gjendje që të vlerësojë rëndësinë e çështjes. Mund të imagjinohet se lënda ku gjyqtari "normal" kurrë nuk do ta referonte çështjen, pasi që duket qartë se nuk ka dyshim valid për kushtetutshmërinë e dispozitës në fjalë. Pyetja themelore është si vijon: Kush në sistemin ligjor të brendshëm është i kualifikuar, madje i kualifikuar në mënyrë ekskluzive, për të vendosur për atë çështje kushtetuese? Përgjigjja është e qartë: Është gjyqtari kushtetues. Në lidhje me këtë, nuk është e pazakontë që një dispozitë, e cila pajtohet nga të gjithë se është kushtetuese, të shpallet e pavlefshme nga gjyqtari kushtetues! Por është e vërtetë se çështjet "e çmendura" mund të referohen nga gjyqtarët me iniciativë të vet, ose kundër iniciativës së vet, pasi që janë çështje të referuara nga palët në atë lëndë pa ushtruar kurrfarë shqyrtimi. Në fund, ekziston arsyeja për t'u frikësuar se palët për të cilët gjyqtari nuk mundet, ose mendon se nuk mundet t'i kundërshtojë (për çfarëdo arsye) për të referuar çështjet preliminare të ligjit vetëm si taktikë të vonimit. Këtu hyjnë në lojë kërkesat për administrim të kënaqshëm të drejtësisë. Dy zgjidhje janë të mundshme: t'i lejohet gjykatës së rregullt më të lartë që të hedh poshtë çështjen preliminare të ligjit (edhe pse mund të ketë qenë temë e shqyrtimit kushtetues), ose t'i jepet mundësia gjykatës kushtetuese që të nxjerrë përgjigje negative ndaj asaj çështjeje për prezumimin e absurditetit, përmes procedurës së thjeshtëzuar dhe pothuajse të menjëhershme".

Në rrethanat e sipërme, zgjidhja më e mirë, siç është sugjeruar më sipër, mund të jetë që gjykata e rregullt të vendosë që thjeshtë ta referojë çështjen e pajtueshmërisë pranë Gjykatës dhe të bashkëlidhë kërkesës opinionet e të dyja palëve.

II. Rregulla 75.2 pak a shumë përsëritë përmbajtjen e Nenit 51.1 të Ligjit, në mënyrë më koncize. Prandaj komentet për nenin 51.1 janë të vlefshme edhe këtu.

Çështja e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën mund të ngritët, nëse në rast hipotetik, për shembull në procedurë civile para gjykatës së rregullt, njërës palë nuk i lejohet të ketë kundërshtim, sepse dispozita e aplikueshme e ligjit që duhet të aplikohet nga gjykata e rregullt nuk parasheh kundërshtimin. Pala më pas mund të ankohet pranë gjykatës së rregullt për mos aplikimin e ligjit të kontestuar, i cili siç pretendohet, nuk respekton të drejtën e saj për gjykim të drejtë, do të thotë nuk është në pajtim me Kushtetutën. Nën nenin 51.1 të Ligjit, gjykata e rregullt mund të parashtrojë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, duke i shpjeguar nevojën për opinionin e Gjykatës rreth pajtueshmërisë së dispozitës së kontestuar me Kushtetutën, para aplikimit të saj në rastin në shqyrtim.

Në rast se gjykata referuese është Gjykata Supreme[709], kjo gjykatë mund ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese se mendon që dispozita e kontestuar në të vërtetë është jo kushtetuese. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë nëse të pajtohet me interpretimin e Gjykatës Supreme ose jo. Nëse nuk pajtohet me opinionin e Gjykatës Supreme, atëherë mund të shfaqet konflikti në mes të dy

[709] Një kompetencë e rëndësishme e Gjykatës Supreme është interpretimi i ligjeve dhe sigurimi i uniformitetit të interpretimit në gjykatat më të ulëta.

gjykatave, pasi që nuk është lehtë për Gjykatën Supreme të aplikojë në lëndën në shqyrtim një interpretim të ligjit të cilin e konsideron jokushtetues.
Sa i përket fjalisë së dytë të Rregullës 75.2, nuk mjafton që kërkesës t'i bashkëngjitet dosja e lëndës, siç ceket nga Rregulla, por duhet të bashkëngjiten edhe opinionet e palëve, madje edhe nëse gjykata referuese parashtron kërkesën *ex officio*. Nëse gjykata e rregullt nuk e bën këtë, Gjykata mund të kërkojë opinionin nga të dyja palët si dhe nga palët e treta, siç sugjerohet nga Profesori Melchior, si dhe të prokurorit, nëse lënda ka të bëj me vepër penale.

III. Kuptimi i Rregullës 75(3) është identik me nocionin e parashtrimit të kërkesës *ex officio*, të shfrytëzuar në Rregullën 75(1). Komentet e bëra në Rregullën e fundit aplikohen njësoj për Rregullën 75(3).
Këtu mund të shqyrtohet pyetja e ngrehur më sipër, që nëse gjatë pezullimit të lëndës para gjykatës referuese, gjykata referuese mundet të komunikojë me Gjykatën gjatë procedurës së shqyrtimit kushtetues ose të shfaqet si palë në procedurë, nëse kërkesa është parashtruar *ex officio*. Në mendimin e Prof. Melchior, "në shumë sisteme shtetërore të cilat rregullojnë procedurën për çështjet preliminare të ligjit, është rregulluar përfshirja e së paku (dhe doemos në pajtim me implikimet e aktgjykimit Ruiz-Mateos të GJEDNJ [të cituar më sipër]) palëve para gjyqtarit kërkues[710].Çfarë është situata e gjyqtarit i cili referon çështjen preliminare? A mundet edhe ai të komunikojë me gjykatën kushtetuese?Duket se jo sepse kjo do të ndryshonte marrëdhënien e pavarësisë së ndërsjellë që duhet të ekzistojë në mes të dy gjykatave. […]. Duket se ekziston vetëm një zgjidhje e këtij problemi: që gjyqtari i rregullt të deklarojë në vendimin e tij për ta referuar lëndën me arsyet pse shtrohet çështja e kushtetutshmërisë së ligjit, ose kur çështja nuk ngrihet nga ai, por nga njëra nga palët, duhet të deklarojë mendimin e tij në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit në fjalë"[711].
Në shtetet tjera, ligji mund të parashkruaj shprehimisht mundësinë që gjykata referuese të jetë e pranishme në procedurë pranë gjykatës kushtetuese, për shembull, në nenin 15.1 të nënkapitullit 1 [Pjesëmarrësit në procedurë] të Kapitullit II [Dispozitat e përgjithshme procedurale] të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese parashihet që *"pjesëmarrësit në procedurë të jenë:[...] (d) gjykata e cila ka referuar çështjen tek Gjykata Kushtetuese dhe dekretuesi i ligjit në të cilin varet vlefshmëria e vendimit të gjykatës (neni VI. 3(c) i Kushtetutës)"*.

[710] Për shembull, Neni 82(3) i Ligji Gjerman për Gjykatën Federale Kushtetuese parashkruan: "Gjykatat Federale Kushtetuese i jep mundësi për të dhënë deklaratë palëve në procedurë pranë gjykatës e cila ka parashtruar kërkesën, i thërret ata në seancë gojore dhe i lejon të flasë agjentët e lidhur me lëndën".
[711] Shih më sipër Raportin e Prof. Melchior.

Neni 52 [Procedura para gjykatës]

> **Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.**

Neni 52 parashkruan se, pasi që gjykata referuese të ketë parashtruar kërkesën pranë Gjykatës Kushtetuese, procedura para saj pezullohet. Nga teksti nuk është e qartë nëse gjykata referuese vendosë që të pezullojë procedurën para saj me kërkesë të saj (*ex officio*) ose duhet që Gjykata Kushtetuese ta udhëzojë gjykatën që të pezullojë procedurën para saj. Rregulla 76 [Njoftimi] i Rregullores së Punës konfirmon se Gjykata e cila Gjykata duhet ta urdhërojë gjykatën e rregullt që *"të pezullojë çdo ndonjë procedurë që është duke u zhvilluar përkitazi me rastin në fjalë, derisa Gjykata të ketë lëshuar një endim"* (shih komentin për Rregullën 76 më sipër).
Rregulla 76 [Njoftimi] i Rregullores së Punës plotëson Nenin 52.

Rregulla 76 [Njoftimi] i rregullave të punës

> **Gjykata, pas parashtrimit të kërkesës, e urdhëron gjykatën që të pezullojë ndonjë procedurë që është duke u zhvilluar përkitazi me rastin në fjalë, derisa Gjykata të ketë lëshuar një vendim**.

Sipas rregullës 76, është gjykata ajo që pas parashtrimit të kërkesës e udhëzon gjykatën kërkuese që ta pezulloj procedurën pranë saj, edhe pse nuk mund të përjashtohet që gjykata kërkuese tashmë ka vepruar kështu *ex officio* në vendimin e saj për ta parashtruar kërkesën pranë Gjykatës. Por, përderisa neni 52 i Ligjit në këtë çështje nuk është mjaftë i qartë, ndryshimi në kuptim të Rregullës 76, do ta ofrojë qartësinë e nevojshme. Në këtë drejtim, është me interes të iu referohemi Nenit 23 të Ligjit të Sllovenisë për Gjykatën Kushtetuese i cili e rregullon rastin kur Gjykata Supreme e inicion procedurën e shqyrtimit të kushtetutshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese. Ajo përcakton: " *(1)Kur në procesin e vendosjes, ndonjë gjykatë e konsideron ndonjë ligj apo pjesë të ligjit që duhet ta zbatoj se është jo kushtetuese ajo gjykatë do ta pezulloj procedurën dhe më kërkesë e inicion procedurën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë;(2) Nëse Gjykata Supreme e konsideron ndonjë ligj ose pjesë të ligjit që duhet ta zbatojë si jo kushtetuese, i pezullon procedurat në të gjitha rastet në të cilat duhet ta zbatoj atë ligj ose pjesë të atij ligji kur vendos për mjetet juridike dhe më kërkesë e inicion procedurën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë; (3) Nëse Gjykata Supreme me kërkesë e inicion procedurën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ndonjë ligji ose pjesë të atij ligji, gjykata e cila kur vendos duhet ta zbatojë atë ligj apo pjesë të tij mund ta shtyjë procedurën deri në vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese duke mos e iniciuar procedurën për shqyrtim të kushtetutshmërisë të atij ligji ose pjesë të tij me kërkesë tjetër".*
Legjislativi Slloven siç shihet ka vendosur për rregull tjetër, sipas së cilës Gjykata Supreme e inicion shqyrtimin e procedurës së kushtetutshmërisë të ligjit apo pjesës së ligjit që e konsideron si jo kushtetuese. Në këtë rast, të gjitha gjykatat e rregullta të cilat duhet ta zbatojnë të njëjtin ligj për rastet në pritje pranë tyre, mund ta pezullojnë

procedurën dhe pasi që Gjykata Kushtetuese të ketë vendosur për shqyrtimin e kushtetutshmërisë, ta zbatojë atë aktgjykim për rastet në pritje.

Neni 53 [Vendimi]

> **Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese**.

Gjykata, sipas formulimit të këtij Neni, nuk lejohet që të zgjerojë fushëveprimin e vendimit preliminar duke vendosur për pajtueshmërinë me Kushtetutë të dispozitave ligjore të tjera se të tjerave të cekura në kërkesë nga gjykata referuese. Dikush mund të mendojë se një interpretim i tillë është shumë i ngushtë, posaçërisht ngase sipas Nenit 4.6 të Kushtetutës, "Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës", ndërsa sipas Nenit 112.1 të Kushtetutës, Gjykata do të jetë: "autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". Gjykata mund t'i interpretojë këto Nene deri në atë masë që e konsideron vetën kompetente për ta kontrolluar përputhshmërinë me Kushtetutë e dispozitave të tjera se sa ato që janë shtruar në kërkesë. Çështja e tillë mund të shtrohet kur gjykata e rregullt ka kërkuar gabimisht vendim preliminar lidhur me dispozitat e gabuara ligjore ose vetëm për disa dispozita "të dyshuara" ligjore, por jo për asgjë. Nëse Gjykata do të ndihej e detyruar që të veproj asisoj *ex officio,* Gjykata, ndoshta, mund t'ia tërheq vëmendjen gjykatës referuese për çështjen në fjalë, duke ia mundësuar parashtrimin e një kërkesë shtesë për shqyrtim.

Mjeti tjetër që mund të përdoret është i cekur në Rregullën 65 (2) të Rregullave të Punës,[712] Gjykata mund të vendos se (tërë) instrumenti normativ nuk përmbush qëllimin legjislativ ose, në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Pra, në vend se t'i deklarojë dispozitat kontestuese të aktit normativ si jo kushtetuese dhe t'i lërë dispozitat e tjera jo kushtetuese në vend, ngase nuk janë të cekura në kërkesë, Gjykata mund ta shpall të tërë instrumentin normativ të pavlefshëm (shih, po ashtu, komentet shtesë të Rregullës 65 (2) më poshtë).

Pra, përmes interpretimit të Neneve përkatëse të Kushtetutës dhe Ligjit, mundet që Gjykata të jetë në gjendje t'i injorojë dispozitat ligjore jo kushtetuese për arsye gjykata referuese nuk i ka përfshirë ato në kërkesën e vet.

Për shembull, Neni 78 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Federale Gjermane, sipas Nenit 82(1)[713] të po të njëjtit Ligji, zbatohet njëjtë në rastet e kontrollit të rastësishëm, ia jep pushtetin Gjykatës Kushtetuese Federale për të shqyrtuar dispozita të mëtejme të ligjit që nuk janë cekur në kërkesë, duke përcaktuar se "*Nëse Gjykata Kushtetuese Federale del në përfundim se Ligji Federal është në shpërputhje me Ligjin themelor*

[712] Rregulli 65(2) i Rregullave të Punës parasheh që Gjykata shpall tërë ligjin, aktin, rregulloren ose statutin komunal të pavlefshëm, në rast se përcakton se instrumenti normativ nuk përmbush qëllimin legjislativ ose, në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

[713] Neni 82(1) thotë: "*Dispozitat e Neneve 77 dhe 79 më lartë do të zbatohen përshtatshmërisht*".

ose se Landi është në shpërputhje me Ligjin Themelore ose ndonjë ligj tjetër federal, do ta shpallë ligjin të pavlefshëm. Nëse dispozita të po të njëjtit ligj janë në shpërputhje me Ligjin Themelore ose ndonjë ligj tjetër Federal për po të njëjtat arsye, Gjykata Kushtetuese Federale mundet që po ashtu këto t'i shpallë të pavlefshme".

Sa i përket dispozitës së Nenit 53 që përcakton se Gjykata nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese, kjo mund të burojë nga fakti se Gjykata, sikurse të gjitha Gjykatat Kushtetuese Evropiane, i takojnë sistemit Kelsian, që do të thotë se kjo bie jashtë organizimit gjyqësor e administrativ të gjykatave të rregullta, ashtu siç u cek në fillim të këtij komenti. Prandaj, Gjykata mund të vendos vetëm për çështje ligjore ose faktike që nevojiten për të vendosur lidhur me pajtueshmërinë e dispozitave ligjore me Kushtetutën. Të gjitha çështjet tjera ligjore e faktike që kanë të bëjnë me kontestin duhet të vendosen nga gjykata referuese. Njëkohësisht, kjo e fundit është e detyruar që ta zbatojë shqyrtimin e Gjykatës për pajtueshmërinë për rastet që i ka në pritje. Megjithatë, edhe pse Gjykata mund ta anulojë punën e legjislativit si "legjislativ negativ" kjo nuk mund të ndërhyj në kompetencën e gjykatës të cilën nuk e ka në vartësi.[714] Gjykata, pra, nuk ka ndikimin në mënyrën se si gjykata referuese do ta zbatonte vendimin e vet. Mirëpo mund të ndodh që, kur gjykata referuese e zbaton vendimin e Gjykatës ndaj rastit që e ka në pritje, pala e pakënaqur me vendimin e gjykatës, të parashtroj ankesë kushtetuese tek Gjykata sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës, kundër atij vendimi (pas shterjes se të gjitha mjeteve juridike, ose drejtpërdrejt, nëse gjykata referuese është Gjykata Supreme), duke u ankuar se gjykata referuese e ka zbatuar vendimin e Gjykatës gabimisht ose në atë mënyrë që e ka shkelur të drejtën themelore të tij/saj të garantuar me Kushtetutë. Gjykata mu për këtë do të duhej të gjykoj nëse vendimi i gjykatës së rregullt i ka shkelur të drejtat kushtetuese të ankuesit për shkak të gjoja zbatimit të gabuar të interpretimit të Gjykatës për ligjin apo për çfarëdo arsye tjetër.

Siç u cek më lartë, gjykata referuese mundet që vërtet të ketë vështirësi në zbatimin e ligjit për rastin që e ka në pritje para vetës, kur Gjykata i ka deklaruar disa prej dispozitave të ligjit, ose ligjin e tërë, të pavlefshëm, mirëpo që gjykata referuese nuk di se si t'i zbatojë dispozitat e mbetura të ligjit ose se si ta gjykoj rastin në mungesë të ligjit që është shpallur i pavlefshëm. Gjykata referuese në raste të tilla mund të parapëlqejë që të pres deri sa legjislativi t'i ketë zëvendësuar dispozitat e pavlefshme me dispozita të reja apo ka miratuar ligj tërësisht të ri në vend se ta përdor ndonjë ligj zëvendësues, për shembull, ligjin e mëparshëm. Ky mosveprim i gjykatës së rregullt mund ta shtyj palën që të ankohen për shkeljen e të drejtave të tij/saj për qasje efektive në gjykatë po ashtu edhe të drejtën që rasti i tij/saj të merret brenda kohës së arsyeshme[715]. Lidhur me " çështjen e kohës së arsyeshme" është dhënë referenca tek Studimi për Qasjen e Individëve në Drejtësi Kushtetuese[716], sipas së cilës "në rastet e pretendimeve për kohëzgjatje të tepruar procedurale, ankesa e individit tek gjykata kushtetuese duhet t'i mundësojë individit që të urdhërojë rifillimin e shpejtë dhe

[714] Shih, Studim për qasjen në Drejtësinë Kushtetuese të miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 85të, Venecia, 18-20 Dhjetor 2010, CDL-AD(2010)039rev.

[715] Neni 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe Paanshëm] i Kushtetutës dhe Neni 6 [e Drejta për gjykim të drejtë] ECHR.

[716] Shih, Studim për qasjen në Drejtësinë Kushtetuese të miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 85të, Venecia, 18-20 Dhjetor 2010, para 194, faqe 51, CDL-AD(2010)039rev, i referuar me lart.

përfundimin e procedurës pranë gjykatave të rregullta ose ta zgjidh çështjen vetë në meritat e saj. Në këtë lloj të rasteve, gjykata kushtetuese duhet të jetë në gjendje të siguroj kompensimin[717] e barasvlershëm me atë që paraqitësi i ankesës do të merrte nga Gjykata e Strasburgut".
Neni 53 i Ligjit plotësohet me Rregullën 77 [Aktgjykimet], 78 [Pranueshmëria për Shqyrtim] dhe 79 [Shqyrtimi nga Gjykata] të Rregullave të Punës.

Rregulla 77 [Aktgjykimi] i Rregullave të Punës

> **Rregulla 64 dhe Rregulla 65 zbatohen njëlloj për kërkesat e filluara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës.**

Komentet e Rregullës 64 [Masat e përkohshme] dhe 65 [Aktgjykimi] të bëra më lartë tek Rregulla 62 [Kërkesa për Shqyrtim] që kanë të bëjnë me Procedurën e Posaçme të theksuar në Nenin 113.2(1) dhe (2) të Kushtetutës vlejnë njëjtë edhe këtu. Veç se disa komente shtesë për këto Rregulla do të bëhen më poshtë në kontekst të Procedurës së Posaçme sipas Nenit 113.8 të Kushtetutës. Formulimi i Rregullave 64 dhe 65 për kuptim më të mirë është përsëritur këtu:

Rregulla 64 [Masat e Përkohshme] i Rregullave të Punës

> **Gjykata mund të urdhërojë, ex officio, ose me kërkesën e palës, si masë të përkohshme, që efektet e instrumentit normativ, i cili kundërshtohet, ose ndonjë pjesë e tij, të pezullohen deri sa Gjykata të marrë vendim për atë kërkesë, në pajtim me pjesën VI të kësaj Rregulloreje.**

Instrumenti ose pjesa e instrumentit normativ, kushtetutshmëria e të cilit është duke u kundërshtuar pranë Gjykatës nga ana e gjykatës referuese, mundet po ashtu që të ketë efekte të padëshiruara për palën në procedurë pranë gjykatës referuese, për shembull, nëse efektet e instrumentit normativ do të shpinin tek dëmi i pariparueshëm. Prandaj, Gjykata mund ta gjejë të arsyeshme që ta pezullojë efektin e procedurës së kontestuar të ligjit ose të tërë ligjin, deri kur të ketë vendosur për çështjen në fjalë. Gjykata, sipas Rregullës, mund të veproj asisoj *ex officio* ose me kërkesë të palës. Prandaj, në kontekst të Procedurës së Posaçme nga Neni 113.8 të Kushtetutës, pala në procedurë pranë gjykatës referuese dhe jo gjykata referuese është ajo që mund ta parashtrojë kërkesën për masa të përkohshme tek Gjykata dhe të japë arsye të hollësishme për këtë. Sipas Rregullës 64, procedura për lëshimin e urdhrit nga Gjykata për pezullim të efektit të instrumentit normativ që kundërshtohet ose çfarëdo pjesë të tij do të jetë në përputhje me Rregullën e përcaktuar në Pjesën VI [Masat e Përkohshme], të Rregullave të Punës, Nenet 54 [Kërkesa për Masa të Përkohshme[] dhe 55 [Vendimi për Masa të Përkohshme]i komentuar me lartë.

[717] Shih, *Cocchiarella kundër. Italisë*, aktgjykimi i GJEDNJ, 26 mars 2006, para. 76-80 dhe 93-97.

Rregulla 65 [Aktgjykim] i Rregullave të Punës

1. **Nëse Gjykata përcakton se dispozita të caktuara të instrumentit normativ nuk janë në pajtim me Kushtetutën, ajo do t'i shpallë ato dispozita të pavlefshme.**
2. **Gjykata shpall tërë ligjin, aktin, rregulloren ose statutin komunal të pavlefshëm, në rast se përcakton se instrumenti normativ nuk përmbush qëllimin legjislativ ose, në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.**

I. Siç u cek më lartë, duket se Neni 113.8 i Kushtetutës po ashtu Nenet 51 dhe 53 të Ligjit nuk e lejojnë Gjykatën që *ex officio* ta shtjellojë pyetjen e kushtetutshmërisë të dispozitave të tjera ose dispozitave shtesë të ligjit kontestues jashtë atyre që janë kundërshtuar nga gjykata referuese. Edhe nëse gjykata referuese kishte të drejtë në qëndrimin se dispozitat e caktuara ishin jo kushtetuese dhe, mu për këtë, ka kërkuar nga Gjykata që t'i shpallë ato jo kushtetuese dhe, si rrjedhojë, të pavlefshme, mund të jetë që e njëjta gjykatë referuese (duke përfshirë edhe palën kërkuese)- që nuk ka ekspertizë në çështje kushtetuese – i lë anash dispozitat shtesë jo kushtetuese, të cilat, përderisa nuk janë cekur në kërkesën tek Gjykata nga ana e gjykatës referuese, Gjykata nuk është lejuar që ta shqyrtojë. Sipas Nenit 113.8 të Konventës, Gjykata e ka pushtetin ta konsiderojë çështjen e përshtatshmërisë kushtetuese të ligjit të ngritur nga gjykata referuese. Neni nuk duket se e kufizon pushtetin e Gjykatës deri në masën që do ta lejonte shqyrtimin të vetëm atyre dispozitave të ligjit kontestues të cekur në kërkesën e gjykatës referuese. Po ashtu Neni i mësipërm 51.2, që përcakton se "*[K]kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën"*, vetëm kërkon nga gjykata referuese që t'i tregoj dispozitat e tilla.

Megjithatë, kjo nuk duket se e përjashton mundësinë që, nëse Gjykata ka mendimin se nuk janë "dispozitat e tilla" por dispozitat tjera ose dispozitat shtesë ose ligji i tëri është jo kushtetues, atëherë këtë mund ta bëj thjesht *ex officio.* Për më tepër, në përputhje me Nenin 112.1 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, pra, Gjykata mund ta shpall vetën kompetente *proprio motu* për të shqyrtuar dispozita të tjera apo dispozitat shtesë të ligjit të kontestuar (ose tërë ligjin, shih Nenin 65.5 më tutje) për përshtatshmërinë e tyre me Kushtetutën. Sugjerohet që Ligji të ndryshohet përshtatshmërisht me qëllim që të lexohet në mënyrë të ngjashme sikurse Neni 78 i Ligjit Gjerman për Gjykatën Federale Kushtetuese, i cituar më lartë.

Këtu kemi nevojë ta shtrojmë edhe një çështje tjetër, pra, Nenet 51 dhe 53 të Ligjit e po ashtu edhe Rregullës 75 deri 77 të Rregullores janë të heshtura rreth pyetjes se në cilën datë dispozitat e kontestuara të instrumenteve normative (ose i tërë instrumenti normativ) të cilin Gjykata e ka gjetur të ketë qenë jo kushtetues, do të bëhet i pavlefshëm. Në përputhje me Nenin 20.5 të Ligjit, Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe (shih komentet për Nenin 20.5 më lart). Pra, i takon Gjykatës

që të vendos se prej cilës datë e më tej dispozitat e ligjit ose ligji i tërë, që janë gjetur jo kushtetuese, do të jenë të pavlefshme dhe se cili do të jetë efekti i vendimit të tillë.[718] Gjykata mund të vendos që vendimi preliminar bëhet i plotfuqishëm: (1) prej datës së miratimit të ligjit që është deklaruar i pavlefshëm (*ex tunc);* (2) prej datës së marrjes së vendimit të Gjykatës (*ex nunc)*; ose (3) prej datës së publikimit të aktvendimit në Gazetën Zyrtare; dhe (4) prej datës së caktuar të venë nga ana e Gjykatës. Për gjykatën referuese është më rendësi të di nëse ligji i kontestuar do të mund të vazhdoj së zbatuari, përveç dispozitave të deklaruara si të pavlefshme, apo nëse ligji si i tërë është hequr nga sistemi ligjor i Kosovës krejtësisht dhe nëse është ashtu, nga cila datë e më tej.

Megjithatë, nëse Gjykata ka gjetur disa dispozita ose ligjin e tërë jo kushtetuese, aktgjykimi i Gjykatës nuk krijon efekte vetëm për gjykatën referuese. Përderisa, në përputhje me Nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, aktgjykimi i Gjykatës ka efekt *erga omnes.* Prandaj, po ashtu edhe legjislativi i cili ka miratuar dispozita ose ligje jo kushtetuese është i detyruar sipas aktgjykimit. Megjithatë, duke pas parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, legjislativi është i pavarur kur vendos për miratimin ose jo të dispozitave të reja ose qoftë edhe ligjit të ri ose për të ndryshuar dispozitat që janë gjetur si jo kushtetuese në mënyrën e sugjeruar nga Gjykata, sikurse Rasti i "Logos së Prizrenit" ku Gjykata ka konsideruar ky [propozimi i komuniteteve jo-shumicë në Prizren] ishte propozim i arsyeshëm që do t'i përmbushte shqetësimet legjitime të Komuniteteve".[719] Sa i përket gjykatës referuese, nuk është e sigurt, në mungesë të dispozitave ose ligjit të ri, se në çfarë mënyrë do ta zbatoj aktgjykimin e Gjykatës (Shih komentimin e mësipërm).

Vetëm nëse Gjykata shpallë se dispozitat ose ligji kontestuese është kushtetutës, do jetë e qartë për gjykatën referuese se ajo mund të vazhdoj me procedurë dhe t'i zbatojë dispozitat ose ligjin ashtu siç është, por, siç u cek më lartë, nëse dispozitat ose ligji kontestues janë jo kushtetuese, gjykata referuese nuk mund të jetë e sigurt se si ta zbatojë vendimin e Gjykatës ose të pres që legjislativi ta miratojë legjislacionin e ri. Ose mund ta zbatojë aktvendimin në mënyrën që është e kundërt me pritjet e palës kërkuese në procedurë. Sidoqoftë, pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë tek gjykata e apelit, nëse është e pasuksesshme, tek Gjykata Supreme dhe më pas tek Gjykata Kushtetuese ose, nëse gjykata referuese ka qenë Gjykata Supreme, të parashtrojë kërkesë drejtpërdrejt tek Gjykata, sipas Nenin 113.7 të Kushtetutës.

Për ta respektuar sa më shumë parimin e sigurisë juridike, Gjykata nuk do t'i shpall dispozitat e një akti normativ lehtësisht si të pavlefshme (*ex tunc)*, ngase në atë rast tërë efektet ligjore të dispozitave jo kushtetuese do të duheshin zhbërë e që do të

[718] Po ashtu Rregulli 66 [Efektet Ligjore të Aktgjykimit] i cili e plotëson Neni 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës si dhe Nenet 29 dhe 30 të Ligjit, nuk del në ndihmë, ngase edhe ky po ashtu i referohet vetëm datës së hyrjes në fuqi të aktgjykimit, dhe jo datës së zhvleftësimit të ligjit. Duke paraparë siç vijon:*(1) "Legjislacioni sekondar dhe aktet administrative që janë nxjerrë në bazë të dispozitës së ligjit, rregullores ose statutit komunal që është shfuqizuar nga Gjykata, nuk zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të aktgjykimit".*

[719] Rasti Nr. KO. 01/09, Qemailj Kurtisi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, Aktgjykimi i 18 marsit 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, si dhe në ueb faqen e Gjykatës.

shkaktonte dëme madhore tek palët e treta dhe do ta cenonte parimin e sigurisë juridike. Natyrisht se në rastet ku dispozitat penale janë shpallur jo kushtetuese, do të ishte jo relevante që dispozitat jo kushtetuese të shfuqizoheshin me efekt retroaktiv, ashtu që jo vetëm pala në fjalë, por edhe të gjithë ata në pozitë të ngjashme do të mund ta shfrytëzonin gjendjen e re nga momenti kur norma jo kushtetuese është miratuar në fillim. Siç u cek më lartë, Rregulla 66.2 e Rregullave të Punës shprehimisht merret me këtë gjendje, [720] po ashtu edhe ligjet përkatëse të shteteve Evropiane.[721]

Në vend të kësaj Gjykata mund vendos që shpallja e jo kushtetutshmerisë për dispozitat relevante ose aktin normativ si të tërë do të hyjë në fuqi në ditën kur është marr aktgjykimi (*ex nunc).* Prandaj, në interes të sigurisë juridike, aktet e mëparshme ligjore të arritura sipas dispozitave të normës ose norma në tërësi, para se ato të shpalleshin jo kushtetuese nga ana e Gjykatës, do të vazhdojnë së vlejturi. Në fakt kjo është edhe praktika e Gjykatës deri me tani. Pa e cekur ndonjërin nga vendimet e tilla në veçanti, shprehja e përdorur nga Gjykata është siç vijon: "Vendimi hynë në fuqi menjëherë".

Gjykata mund ta përdor opsionin e tretë, d.m.th. efektet e shpalljes se jo kushtetutshmërisë do të binin në një datë të caktuar nga Gjykata, me kujdes. Ashtu siç u cek më lartë, Gjykata mund të veprojë asisoj, në veçanti, kur ajo dëshiron që legjislativit, ose organeve, ose institucioneve tjera përkatësi t'iu lë kohë të mjaftueshme që t'i zëvendësojnë dispozitat jo kushtetuese të aktit normativ me dispozita të reja, të cilat, tani, do të ishte e pritur që të jenë në përputhje me të drejtat kushtetuese të shkelura me dispozitat që janë gjetur jo kushtetuese.

II. Edhe pse sipas Nenit 53 të Ligjit, Gjykata vendos vetëm për "pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën" (që, supozohet se do të thotë: dispozitat juridike që ia ka parashtruar gjykata referuese) dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese, Rregulla 65 (2) duket se e zgjeron mjaftë shqyrtimin e kufizuar të Gjykatës duke përcaktuar se Gjykata shpall tërë ligjin, aktin, rregulloren ose statutin komunal të pavlefshëm, në rast se përcakton se instrumenti normativ (1) nuk përmbush qëllimin legjislativ ose (2) në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat (e pavlefshme) të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Ashtu siç u përcaktua më lart, Rregullat e Punës nuk mund të rregullojnë çështje të cilat do të duhej të rregulloheshin me akt normativ të miratuar nga legjislativi.

Sipas praktikës së vet, kur është e ngarkuar me kërkesën e një gjykate të rregullt sipas Nenit 113.8 të Kushtetutës, Gjykata njofton në llogari të vet, pa qenë e detyruar të veproj ashtu me ligj, organet përkatëse (Gjykatën Supreme, Kuvendin, Qeverinë dhe Avokatin e Popullit) rreth parashtrimit të kërkesës.

[720] Rregulli 66(2) parasheh: "*Nëse Gjykata ka nxjerrë një vendim për një lëndë penale, në bazë të dispozitës së ligjit,rregullores ose statutit komunal që është shpallur jo kushtetuese, personi kundër të cilit është nxjerrë vendimi mund të rihapë procedurën në lëndën penale".*

[721] Shih, Studim për qasjen në Drejtësinë Kushtetuese të miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 85të, Venecia, 18-20 Dhjetor 2010, para 194, faqe 51, CDL-AD(2010)039rev.

Rrjedhimisht, pasi të ketë vendosur (varësisht nga rrethanat, pas dëgjimit të palëve) për apo kundër zhvleftësimit të ligjit përkatëse apo dispozitave kontestuese të tij, Gjykata i njofton po të njëjtat institucione për aktgjykimin e vet[722].

12. Procedura në rastin e përcaktuar sipas Nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 9 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

Kurdo që Kuvendi parasheh miratimin e ndryshimit të Kushtetutës, duhet të jetë në dijeni se ndryshimi i propozuar mund t'i zvogëlojë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, që përmbajnë listën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat në përputhje me Nenin 21 të Kushtetutës [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 1, janë: "...*janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Kosovës*".[723] Për më tepër, sipas Nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] paragrafi 2, i Kushtetutës "*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë"*.

Këto nene qartazi tregojë se sa janë të paprekshme të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara nga Kushtetuta, dhe në cilën mënyrë ato duhet të respektohen nga të gjitha institucionet që janë pjesë e Republikës së Kosovës, duke përfshirë Kuvendin. Prandaj, para se Kuvendi të jetë në gjendje që ta miratoj një ndryshim të tillë, Gjykata e ka për detyrë që së pari të kontrollojë se ndryshimi i propozuar do t'i zvogëlojë të drejtat dhe liritë e njeriut nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Megjithatë, është e paqartë se pse Neni 113.9 i Kushtetutës thotë vetëm se amendamenti i propozuar nuk duhet t'i zvogëlojë të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës. Do të ishte me po aq rendësi që amendamentet e propozuara nuk do të duhej t'i zvogëlonin të drejtat e Komuniteteve, të parapara në Kapitullin III [Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre] apo të cekura tjetër kund në Kushtetutë. Për shembull, ashtu siç është paraparë në Nenin 57, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit III [Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës, *"Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute"*. Për çfarë arsye kjo dispozitë është haptazi anashkaluar nga ana e

[722] Neni 71.3 Aktit për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë përcakton shprehimisht: "*Nëse Gjykata Kushtetuese e shfuqizon ligjin si jo kushtetuese, ajo do ta njofton Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për vendimin e saj.".*

[723] Neni 21 i Kushtetutës thotë siç vijon: *(1) Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, dhe (2) Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*

hartuesve dhe nga Kuvendi gjatë miratimit të Nenit 113.9 të draft Kushtetutës, është pyetje e vështirë për t'u përgjigjur. Megjithatë, në ndërkohë, ky lëshim është ndrequr nga vet Gjykata në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O 48/12, Propozim amendamentet e Kushtetutës, të parashtruara tek Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 23 mars 2012, përkatësisht, ku Gjykata ka deklaruar se:

"[...] *61. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që, sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë se cilitdo amendament të propozuar të Kushtetutës, sipas nenit 144.3, amendamenti i tille duhet të konsiderohet në vështrim të Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, i cili sipas nenit të vet 21 [Parimet e Përgjithshme], përbehet nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat janë baza e rendit juridik të Republikës se Kosovës.*

62. Përveç kësaj, Gjykata konsideron që Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre] dhe të drejta tjera mund të jenë të zbatueshme në këtë proces, pasi të drejtat specifike të përcaktuara janë zgjerim i të drejtave dhe lirive të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, në veçanti, i atyre të drejtave të përcaktuara në nenin 24 [Barazia para Ligjit].

63. Kjo është veçanërisht kështu edhe nga pikëpamja e dispozitave të nenit 21.2 të Kushtetutës, i cili përcakton qe Republika e Kosovës do t'i mbroje dhe garantoje të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me Kushtetute, jo doemos ato të përfshira vetëm në Kapitullin II.

64. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykate nuk do t'i marre parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut të përfshira në Kapitullin II, por edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetute dhe të parashikuara me shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës se Kosovës.[…]".[724]

Prandaj, Gjykata ka dhënë interpretim të hollësishëm të nocionit të "të drejtave dhe lirive të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës" të Nenit 113.9 të Kushtetutës duke përfshirë në të "të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe ka menduar në letër dhe frymë të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës". Në këtë mënyrë qëndrueshëm është vërtetuar fushëveprimi i Nenit 113.9.

Neni 113.9 i Kushtetutës zbatohet nga Neni 54 i Nën-Kapitullit 12 [Procedura për rastet e përcaktuara sipas Nenit 113.9 të Kushtetutës] të Ligjit.

Neni 54 [Afati]

> **Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas mundësisë, duhet të merret brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të kërkesës.**

Siç duket, për të mos e vonuar pa nevoje për periudhë të gjatë kohore procesin legjislativ të ndryshimit të propozuar kushtetues nga ana e Kuvendit, Gjykata mbështetet në këtë Nenë për të marr vendim brenda periudhës prej gjashtëdhjetë (60) ditëve. Megjithatë, dihet se në rast të ndryshimit të propozuar i cili ka të bëj me Nenin e caktuar të Kushtetutës ose qoftë edhe paragrafin e ndonjë Neni, Gjykata sigurisht se do të merrte më pak kohë për të marr vendim se sa do të merrte kohë nëse kërkesa do të

[724] Rastet 29/12 dhe 48/12, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2012, faqe:, si dhe në ueb faqen e Gjykatës.

përmbante ndryshimet e propozuara të 10 apo më shumë Neneve, e lere më të 35 Neneve, duke përfshirë numër edhe më të madh të paragrafëve ashtu siç ka ndodhur në rastet e mësipërme K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Formulimi "sipas mundësisë" tashmë tregon se hartuesit kanë parashikuar situata dhe mu për këtë e kanë zbutur afatin duke i shtuar këto fjalë, pra duke lejuar Gjykatën që të marr venim më vonë se sa periudha e kërkuar prej 60 ditëve, nëse nevojitet. Për rastet e lartcekura Gjykatës iu janë dashur 120 ditë për ta marr vendimin e saj, që duket shumë e arsyeshme në krahasim me detyrën e madhe të Gjykatës që me kujdes të kontrollojë ndryshimet e propozuara kundrejt Kapitullit II të Kushtetutës ashtu siç interpretohet nga Gjykata.

Shembuj të tjerë të qasjes së drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese nga organet publike sipas Kushtetutës, të mos cekura në Kapitullin III [Procedurat e Posaçme] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese

Ashtu siç është cekur më lartë në komentet e Nenit 22.1, fjalia e parë dhe e dytë, të Ligjit, palët e autorizuar për të referuar çështje tek Gjykata në mënyrë ligjore nuk janë vetëm ato të cekura në Nenin 113 të Kushtetutës, por edhe tjetër kund në Kushtetutë. Megjithatë, Kapitulli III [Procedurat e Posaçme] nuk ofron ndonjë procedurë të posaçme e cila do të duhej respektuar në raste të tilla. Këta shembuj të mëtejmë të palëve të autorizuara që kanë qasje drejtpërdrejt në Gjykatë sipas neneve të tjera të Kushtetutës dhe mu për këtë, janë komentuar ndaras.

(1) Presidenti

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 9, i Kushtetutës parasheh që Presidenti i Republikës së Kosovës ka kompetencën që "*të referoj çështje kushtetuese në Gjykata Kushtetuese".* Kjo kompetencë po ashtu është përsëritur në Ligjin për Presidentin[725]. Kjo ia lejon Presidentit që të referojë çfarëdo pyetje në Gjykatë, përderisa ka të bëj me Kushtetutën. Siç duket neni nuk ka ndonjë kufizim kohor sa i përket paraqitjes së kërkesës në Gjykatë.
Për shembull, me 27 gusht 2010, Presidenti i Kosovës, përmes përfaqësueseve ligjor ka parashtruar Kërkesë në Gjykatë[726] duke kërkuar qartësim se "*Cili institucion në Republikën e Kosovës është përgjegjës për ta vlerësuar fuqinë dhe vlefshmërinë e dorëheqjes dhe konfirmimin e skadimit eventual të mandatit të kryetarit të Komunës, sipas komunikatës së adresuar publikut, pasiguria e të cilës ka penguar veprimet e mëtejme të presidentit në përputhje me parimet kushtetuese të zgjedhjeve të lira dhe të barabarta".* Sipas Presidentit, ky është palë e autorizuar që të parashtrojë këtë çështje kushtetuese në Gjykatë dhe, duke konsideruar se është i obliguar sipas Kushtetutës për të siguruar përputhshmëri me parimet kushtetuese të zgjedhjeve të lira dhe të drejta, ai duhet të qartësojë se cilët janë hapat vijues që duhet ndërmarr pas dorëheqjes së kryetarit të caktuar të komunës.

[725] Ligji 2008/03-L-094, i shpallur me 7 Janar 2009.
[726] Rasti Nr. 80/10, Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për Shpjegime rreth Juridiksionit për rastin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z. Qazim Qeska, Aktgjykimi i 7 tetorit 2010, Buletini i Praktikes Gjyqësore 2009 – 2010, faqe 257; si dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Gjykata vendosi që Kërkesa ishte e pranueshme ngase "*[...] faktet e cekura në fillim duket se kanë ngritur çështje kushtetuese bazuar në autorizimet e Presidentit në Kushtetutë për të ngritur çështje të tillë pranë Gjykatës. Veçanërisht sepse kjo ndërlidhet me dy dispozita kushtetuese, pra, Nenin 123 [Parimet e përgjithshme të qeverisjes lokale dhe organizimit Territorial] dhe Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës"*.
Gjykata sa u përket meritave vendosi që, bazuar në Ligjin për vet-qeverisjen lokale, dorëheqja e kryetarit të caktuar të komunës është e plotfuqishme dhe përfundimtare dhe shënon mbarimin e mandatit të tij/saj, dhe se rrjedhojat kushtetuese të veprimit të tillë janë shpallja e zgjedhjeve të reja nga Presidenti për të siguruar se qytetarët gëzojnë të drejtën për zgjedhje të lira dhe të barabarta kur vendosin vet-qeverisjen e tyre lokale[727].
Shembull tjetër është Rasti Nr. KO 97/10, i parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, sa i përket mbajtjes së postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës.[728] Gjykata mori qëndrim, veçanërisht, se kërkesa sipas Nenit 84.9 nuk parashkruan afatin brenda të cilit çështjet kushtetuese mund t'iu referohen Gjykatës.

(2) Qeveria

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafi 10, i Kushtetutës, i jep Qeverisë kompetencën e njëjtë me atë të Presidentit të Kosovës sipas nenit të mësipërm 84.9, që përcakton se Qeveria "*mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese"*.
Për shembull, me 20 korrik 2011, Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka dorëzuar Kërkesën[729] në Gjykatë, e cila kishte tri pyetje të ndara lidhur me imunitetet e organeve të ndryshme shtetërore, pra deputetët e Kuvendit, Presidenti, si dhe anëtarët e Qeverisë. Sipas mendimit të Qeverisë, "*kjo çështje ka ndikim direkt në funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës"*.
Gjykata konsideroi se çështjet e ngritura nga Qeveria ishin të natyrës kushtetuese ngase ishin të lidhura me formën e qeverisjes së Shtetit dhe kishte të bëjnë me mekanizmat e ushtrimit të ndarjes së pushteteve në Republikën e Kosovës. Po ashtu Gjykata vendosi që nuk ka pasur ndonjë kufizim kohor sa i përket paraqitjes së Kërkesës sipas Nenit 93.10 të Kushtetutës.[730]

---

[727] Idem.
[728] Rasti Nr. KO 97/10 Në çështjen e Kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, sa i përket mbajtjes së postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës, Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010, Buletini i praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 438, si dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[729] Rasti Nr. KO 98/11, Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetet e deputetët e Kuvendit, Presidentit, si dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2011, faqe 340, si dhe në ueb faqen e Gjykatës
[730] Qeveria parashtroi Kërkesën sipas, që të dy, Nenit 93.10 dhe Nenit 113.3.1 të Kushtetutës. Gjykata doli në përfundim se çështjet e ngritura ishin çështje kushtetuese ashtu siç mendohet nga Neni 93.10 i Kushtetutës prandaj nuk ka nevojë që Kërkesa të konsiderohet në kontekst të Nenit 113.1.1. Në këtë drejtim Gjykata vendosi që ngase ekzistojnë kufizime kohore të parapara në Kapitullin III, Procedurat e Posaçme, të

(3) Avokati i Popullit

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], paragrafi 4, Kapitulli II [Institucionet e pavarura] i Kushtetutës parasheh që Avokati i Popullit e ka kompetencën e *"referimit të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese në pajtim më dispozitat e kësaj Kushtetute".* Për dallim nga kompetencat e Presidentit të Kosovës dhe Qeverisë sipas pikës (1) dhe (2) më lartë, kompetencat e Avokatit të Popullit duket se janë të kufizuara nga formulimi " *në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".* Megjithatë, e vetmja dispozitë në të cilën është cekur Avokati i Popullit është Neni 113.2 i Kushtetutës, sipas të cilit, Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë çështje të përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë si dhe përputhshmërinë e statuteve të komunave me Kushtetutën (shih komentet e hollësishme të Nenit 113.2 të Kushtetutës më lartë).

Megjithatë, sipas Nenit 15 [Kompetencat], paragrafi 7, i Ligjit për Avokatin e Popullit[731]duke paraparë që "Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatë Kushtetuese", i japin Avokatit të Popullit kompetenca shtesë me ndikim në kompetencat e tij/saj për të iniciuar shqyrtimin kushtetutës të akteve normative me propozimin e tij/saj ose pas ankesës së individit lidhur me atë akt.

Për individin, qasja në Gjykatë përmes Avokatit të Popullit do të thotë vetëm qasje e tërthortë në Gjykatë, e cila mundet, megjithatë, të mos e zëvendësojë qasjen e drejtpërdrejt të tij/saj në Gjykatë sipas 113.7 të Kushtetutës. Megjithatë, Kërkesa e parashtruar nga Avokati i Popullit mundet, përmes ekspertizës së tij/saj ligjore, të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së peticioneve.[732]Sa u përket afateve dhe kushteve të tjera të provueshmërisë të cilat duhet të përmbushen nga ana e individit në rastin e shqyrtimit kushtetuese është logjike se Avokati i Popullit do të duhet të u përmbahet po të njëjtave kushte sikurse individi(ët) që ai/ajo i përfaqëson në Gjykatë.

(4) Zëvendëskryetari për Komunitete i Kuvendit të Komunës

Neni 62 [Përfaqësimi në organet e Pushteti Lokal] i Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës ia jep kompetencën zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës që të parashtrojë drejtpërdrejt në Gjykatë çështjet e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të Nenit 62. Paragrafët përkatës të Nenit 62 thonë siç vijon:

Neni 62.3:*"Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto*

Ligjit për Gjykatën Kushtetuese për paraqitjen e Kërkesave sipas nenit 113 të Kushtetutës, nuk ka kufizime kohore për paraqitjen e Kërkesës së tillë sipas Nenit 93.10.

[731] Ligji Nr. 03/L-195 i shpallur me 9 gusht 2010.

[732] Studim për qasjen në Drejtësi Kushtetuese, Komisioni i Venecias, CDL-AD(2010)039rev.

çështje ia referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit apo të vendimit të marrë".

Neni 62.4: *"Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin apo vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës".*

Çështjet të cilave Nenet 62.3 dhe 62.4 iu referohen bien në fushëveprimin e Kapitullit III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës që përcakton, në Neni 57 [Parimet e Përgjithshme] se Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute. E drejta për përfaqësim në Institucionet e Qeverisë Lokale e përcaktuar në Nenin 62 është një nga ato të drejtat specifike dhe përfshin rezervimin e postit të Zëvendëskryetarit për Komunitete të Kuvendit të Komunës në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë. Sipas Nenit 62.2 2 postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për Kuvendin e Komunës.

Nenet 62.3 dhe 62.4 me kujdes i përcaktojnë rrethanat në të cilat Zëvendës Kryetari për Komunitete ka qasje direkt në Gjykatë. Megjithatë, i takon Gjykatës që të vendos për pranimin ose jo të çështjes për shqyrtim. Neni 62 nuk ka ndonjë kufizim kohor të cilit Zëvendës Kryetari për Komunitete do të duhej t'iu përmbahet për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë. Duhet supozuar se në rrethana normale, ai/ajo do ta ngarkonte Gjykatën menjëherë pas kërkesës së tij/saj për rikonsiderim të aktit të kontestuar ose vendimi i Kuvendit Komunal është mohuar ose Kuvendi Komunal më të vërtetë e ka rikonsideruar aktin ose vendimin e kontestuar, por ka refuzuar që ta ndryshoj ose e ka ndryshuar në atë mënyrë që, në pikëpamje të Zëvendës Kryetarit, rezultatet akoma paraqesin shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë për Komunitetet dhe pjesëtaret e tyre.

Sipas Nenin 62.4, Gjykata, pa elaborim, mund të vendos për pranimin ose jo të çështjes për shqyrtim. Rregulla 78 i Rregullave të Punës përmban detaje më të hollësishme.

Shënim. Neni 62, paragrafët 1 deri 4, të Kushtetutës nuk zbatohen nga ndonjë dispozitë e Ligjit, por nga Nenet 54 dhe 55 të Ligjit për Vet-Qeverisjen Lokale,[733] që përmban tekstin fjalë për fjalë nga paragrafët 1 deri 4 të Nenit 62 të Kushtetutës. Prandaj, komentet e lartcekura për këta paragrafë vlejnë njëjte edhe për Nenet 54 dhe 55 të Ligjit për Vet-Qeverisjen Lokale. Neni 62 është plotësuar me Rregullën 78 dhe 79 të Rregullave të Punës.

[733] Ligji Nr. 2008/03-L-040, i shpallur më 15 Qershor 2008.

Rregulla 78 [Pranueshmëria për Shqyrtim] i Rregullave të Punës

> **Edhe kur një çështje është e pranueshme, Gjykata mund të përcaktojë nëse do të pranojë për shqyrtim një çështje të parashtruar nga Zëvendëskryetari i kuvendit komunal, në pajtim me nenin 62, paragrafi 4, të Kushtetutës. Zëvendëskryetari i kuvendit komunal që parashtron çështjen, duhet të deklarojë në mënyrë precize të drejtat e garantuara kushtetuese që janë shkelur. Gjykata, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, përcakton nëse do të pranojë një çështje për shqyrtim.**

Edhe pse Rregulla 78 në fjalët e veta hapëse i referohet kërkesës që çështja së pari duhet të jetë e pranueshme, para se gjykata të vendos për apo mos pranimin e çështjes për shqyrtim, nuk cek posaçërisht ndonjë bazë për pranueshmërinë e kërkesës. Padyshim se Gjykata nuk do ta pranoj Kërkesën për Shqyrtim nëse Zëvendës Kryetari nuk mund të tregoj se e ka referuar çështjen në fjalë tek Kuvendi Komunal për rikonsiderim. Për më tepër, edhe pse nuk është cekur ndonjë afat kohorë diku në Nenin 62 apo në Rregullën 78, Gjykata mund të vendos që të mos e pranoj kërkesën për shqyrtim për arsye se ka kaluar shumë kohë prej vendimit apo aktit të kontestuar, aq sa pretendimi është diskutabil ose për ndryshe nuk paraqet rast kundërshtues.[734] Gjykata sigurisht se nuk do të konsiderojë të pranueshme ankesën nëse është e pavlerë ose haptazi se është e pabazë ose e papranueshme për çfarëdo arsye tjetër të vlefshme. Përfundimisht, Zëvendës Kryetari do të duhej të tregojë se rezultati i rikonsiderimit nga Kuvendi Komunal akoma paraqet shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë për Komunitetet dhe Pjesëtarët e tyre.

Kur çështja është e pranueshme, Rregulla 78 parasheh që Gjykata do të vendos për pranimin ose jo të çështjes së parashtruar nga Zëvendës Kryetari (Rregulla e ka lënë jashtë fjalën "Për Komunitete" pas fjalës "Zëvendës Kryetari") i Kuvendit Komunal. Gjykata pasi të këtë vepruar asisoj do t'i shqyrtojë meritat e rastit dhe do vendos nëse akti ose vendimi i Kuvendit Komunal i shkel apo jo të drejtat e garantuara me kushtetutë Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Gjykata tashme e ka pasur mundësinë që të vendos për rast të tillë.

Me 22 prill 2009, Zëvendës Kryetari për Komunitete i Kuvendit Komunal të Prizrenit ka paraqitur një Kërkesë në Gjykatë (Rasti Nr. KO 01/09[735]), duke kundërshtuar Nenin 7 të Statutit Komunal për Emblemën e Komunës që parashihte se emblema e Komunës është "Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit", e rrethuar me fjalët në vijim "1878-Prizren". Zëvendës Kryetari ka pretenduar se procedura e paraparë me ligj nuk është respektuar, që kërkesat dhe vërejtjet e komuniteteve lidhur me emblemën nuk janë marr parasysh, dhe se kjo emblemë nuk e ka pasqyruar multietnicitetin e Komunës. Ai më tej ka pretenduar se të drejtat kushtetuese të komuniteteve tjera jo-shumica në komunë ishin shkelur për barazi para ligjit, mbrojtje, ruajtje, dhe zhvillim të identitetit të tyre dhe se ka pasur shkelje të Ligjit për Vet-Qeverisjen Lokale, si dhe Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve.

---

[734] Shiko Rregullin 32 [Tërheqja e Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullave të Punës.

[735] Shih Rastin Nr. KO. 01/09, Qemailj Kurtisi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, Aktgjykimi i 18 marsit 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010, faqe 73, si dhe në ueb faqen e Gjykatës.

Gjykata ka gjetur se Zëvendës Kryetari e ka pozitën dhe autoritetin e duhur ligjor për ta parashtruar këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata vendosi se, kur Komuna ka vendosur të shpallë emblemën e Shtëpisë së Lidhjes së Prizrenit të pasuar me vitin 1878, ata kanë promovuar trashëgiminë dhe traditën Shqiptare, pa vëmendje ndaj komuniteteve tjera, duke shkelur të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Prizren, për mbrojtje, mirëmbajtje dhe promovim të identitetit të tyre. Gjykata ka dalë në përfundim se Neni 7 i Statutit të Komunës ka qenë në papajtueshmëri me Kushtetutën, dhe e ka urdhëruar Komunën e Prizrenit që këtë ta ndryshojë për të siguruar pajtueshmëri me Kushtetutën.

Rregulla 79 [Shqyrtimi nga Gjykata] i Rregullave të Punës

> **Nëse Gjykata pranon për shqyrtim një çështje të referuar sipas nenit 62, paragrafi 4, të Kushtetutës, atëherë ajo e trajton kërkesën në mënyrën e përcaktuar sipas kësaj Rregullore për të gjitha kërkesat. Në këtë rast, aplikohen Rregulla 64 dhe Rregulla 65, njëlloj për të gjitha kërkesat e iniciuara sipas nenit 62.4 të Kushtetutës.**

Fjalia e parë e Rregullës mund të nënkuptojë vetëm se, pasi që Gjykata të ketë pranuar çështjen për shqyrtim, do ta shqyrtoj atë për meritat e saj "në mënyrën e përcaktuar sipas kësaj Rregulloreje për të gjitha kërkesat". Pra, masa të përkohshme mund të vendosen nga gjykata sipas Rregullës 64 (ashtu siç thuhet në fjalinë e dytë të Rregullës 79), prova të tjera mund të kërkohen prej palëve dhe Gjykata mund ta mbaj dëgjimin, duke përfshirë edhe marrjen në pyetje të dëshmitarit dhe ekspertit e po ashtu edhe parashtresat gojore nga amicus curiae, nëse thirret nga ana e Gjykatës.
Në pajtim me fjalinë e dytë të Rregullës 79, Gjykata mund të vë *ex officio* ose me kërkesë të palës masën e përkohshme në cilëndo fazë të procedurës në Gjykatë, në përputhje me Rregullën 64 [Masat e Përkohshme].
Sipas Rregullës 79, Gjykata mund t'i shpallë dispozitat e caktuara të aktit normativ në fjalë (në këtë rast aktin ose vendimin kontestues të Kuvendit Komunal) ose instrumentin normativ si të tërë si të pavlefshëm më përputhje me Rregullën 65 [Aktgjykimi]. Për shembull, në rastin e lartcekur Nr. KO 01/09, Gjykata e ka shpallur Nenin 7 të Statutit të Komunës të papajtueshëm me Kushtetutën.

Kapitulli IV: Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Neni i vjetër 55 [Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

1. **Gjykata Kushtetuese do të jetë e përbërë siç përcaktohet në Nenin 152 të Kushtetutës gjatë periudhës së paraparë në të.**
2. **Asgjë në këtë ligj, përfshirë dispozitat të cilat rregullojnë kriteret për përshtatshmëri, kualifikime profesionale dhe kompensim për gjyqtarët, nuk aplikohen për të penguar apo ndryshe kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, të përcaktuar në Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, të datës 26 mars 2007. Këto përgjegjësi dhe kompetenca ushtrohen në pajtim me instrumentet e aplikueshme pavarësisht ndonjë dispozite të këtij ligji.**

Me 31 gusht 2012, Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-114 [Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës], i cili ka propozuar disa ndryshime të Kushtetutës, që ishin pjesë e pakos se ndryshimeve kushtetuese të nevojshme për të njohur fundin e Pavarësisë së mbikëqyrur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) në korrik 2012, ku ai ka shpallur Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës (tutje si "Plani Gjithëpërfshirës") të datës 26 mars 2007 që është zbatuar plotësisht nga Qeveria e Kosovës. Po ashtu edhe ligjet tjera u ndryshuan.
Neni 2 i Ligjit 04/L-115 e ndryshon Nenin 55 [Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese mjaftë, duke i shlyer paragrafët fillestar dhe duke i zëvendësuar me tekst të ri. Për ta kuptuar më mirë sfondin dhe kontekstin e emërimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, duket se është e përshtatshme që së pari të komentohet teksti fillestar i Nenit i pasuar me komente për tekstin e ri.

1 Ashtu siç përcaktohet në këtë Nen, detajet e përbërjes së përkohshme të Gjykatës kanë qenë të përcaktuara në Nenin 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës (tash të fshira), që thoshin:
"Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet siç vijon:
1. Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit.
2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.

3. *Nga gjashtë (6) gjyqtarët, katër (4) do të zgjidhen votat e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy (2) do të zgjidhen me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së anëtarëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve të cilat nuk janë në Kosovë.*
4. *Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen dhe shkarkohen nga prania civile ndërkombëtare pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre(3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.*
5. *Prania Ndërkombëtare Civile do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë.*

Neni 152 i Kushtetutës, para se të shlyhej nga Kuvendi, nuk është marr vetëm më përbërjen e përkohshme të Gjykatës, por edhe me procedurën, sipas së cilës gjashtë gjyqtar (Kosovar) të cekur në kushtetutë (pra, katër gjyqtar dhe dy gjyqtar që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë), u zgjodhën nga Kuvendi. Në fakt, procedura nga Neni 152.3 sipas së cilës gjashtë gjyqtarët (Kosovar) u zgjodhën nga Kuvendi, ishte e njëjtë me procedurën (normale) të zgjedhjes së gjyqtarëve e paraparë në Nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 3, i Kushtetutës. Edhe pse Neni 152.3 nuk iu është referuar Nenit 114 ishte e dukshme se paragrafët 4[736] dhe 5[737] të atij Neni vlenin njëjtë, që kishin të bëjnë me mandatin e gjyqtarit si dhe me zgjedhjen e Kryetarit përkatësisht Zëvendës Kryetarit.

Për më tepër, që Kuvendi t'i propozojë gjashtë gjyqtarë për emërim tek Presidenti i Kosovës, procedura e paraparë në Nenin 6 [Procedura për shqyrtimin e Kandidatëve për Emërim në Gjykatën Kushtetuese] të Ligjit, ku Komision i Posaçëm do të përgatiste listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për t'ia dorëzuar Kuvendit, së pari është dashtë të respektohet. Emërimi i të gjashtë (6) gjyqtarëve, të cilët Kuvendi i ka propozuar tek Presidenti i Republikës së Kosovës, është mbajtur me 26 qershor 2009.

Tre (3) gjyqtar ndërkombëtar (me kombësi Amerikane, Bullgare dhe Portugeze) u emëruan nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) në pajtim me Nenin 152.4 (tash i shlyer) të Kushtetutës për periudhë fillestare 3 vjeçare, e cila ka skaduar në qershor 2012. Megjithatë, sa u përket autoriteteve përgjegjëse për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, duket se ka pasur dallime në qasje në Kushtetutë dhe në Propozimin Gjithëpërfshirës. Në këtë drejtim Neni 152.4 ka përcaktuar se "*Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen dhe shkarkohen nga prania civile ndërkombëtare*[738]*, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të*

[736] Neni 114.4 i Kushtetutës parasheh: *Nëse mandati i gjyqtarit përfundon para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet në pajtim me këtë nen, me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.*

[737] Neni 114.5 i Kushtetutës parasheh: *Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës, për mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit.*

[738] Shih Nenet 146 [Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar] dhe 147 [Autoriteti përfundimtar i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar] nga Kapitulli XIV [Dispozitat Kalimtare] të Kushtetutës (të shlyer që të dy) dhe Shtojcën IX [Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar] nga Propozimi Gjithëpërfshirës] nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (që nuk është më në fuqi).

Drejtat e Njeriut". Ndërsa Neni 6 [Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë], paragrafi 1.3 i Shtojcës I [Dispozitat Kushtetuese] i Propozimit Gjithëpërfshirës, përcaktonte se "*Tre gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas konsultimeve me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar".* Nga Neni 152.4 ishte e qartë se hartuesit zgjodhën procedurë tjetër të emërimit se ajo që ishte fillimisht e paraparë në Nenin 6.1.3 të Shtojcës I të Propozimit Gjithëpërfshirës, ngase autoriteti emërues sipas Nenit 152.4 nuk ishte edhe më tej Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Neni 152.4 i Kushtetutës dallon edhe në një aspekt tjetër nga Neni 6.1.3 i Shtojcë I të Propozimit Gjithëpërfshirës, ngase hartuesit e Kushtetutës ia shtuan paragrafit edhe një fjali të dytë, që parashihte "Tre (3) gjyqtarët ndërkombëtarë nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj". Kjo sigurisht se është bërë me qëllimin të qartë se përzgjedhja e gjyqtarëve ndërkombëtar nga PCN-ja nuk do të mund të kritikohej ose të rrezikohej nga dyshimi edhe më i vogël për anim ose mungesë pavarësie nëse kandidatët do të ishin shtetas të Kosovës ose ndonjërit nga shtetet fqinje, nëse do të emëroheshin.

Pastaj mos-vazhdimi i mandatit tre vjeçar të dy gjyqtarëve Kosovar në Gjykatë përfundoi më 26 qershor 2012. Ngase mandati i tyre nuk mund të vazhdohej, ashtu siç ishte përcaktuar me Nenin fillestar 152 të Kushtetutës, procedura e paraparë në Nenin 8 [Përfundimi i mandatit] të Ligjit, ishte vënë në lëvizje, me efekt që "*Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës me qëllim që të filloj procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri".* Pasi që Kryetari kishte vepruar ashtu, në dhjetor të 2011, procedura për propozimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të ri, ashtu siç parashihet në Nenin 6 [Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese] të Ligjit filloi në pajtim me Nenin 7 [Emërimi dhe fillimi i mandatit] të Ligjit, së paku tre (3) muaj para skadimit të mandatit të gjyqtarëve të mëparshëm.

2 Neni 55.2 duke se ka një gabim në fund të rreshtit të dytë në fjalinë e parë. Fjalët "nuk" në mes të fjalës "do të" dhe "aplikohet" do të duhej fshirë, ngase përdorimi i tyre në lidhje me fjalën "Asgjë" në fillim të fjalisë është i pasaktë. Fjalia do të duhej, supozohet, të thoshte "Asgjë në këtë Ligj [...] do të zbatohet, pengoj ose kufizoj kompetencat [...]". Për me tepër, me përdorimin e formulimit "autoritetet kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar të paraparë me Kushtetutë dhe me Propozimin Gjithëpërfshirës" hartuesit e Ligjit mund të kenë supozuar se autoritetet e parapara në të dy tekstet ishin po i njëjti, ndërsa, siç u komentua më lart, autoriteti emërues sipas Planit Gjithëpërfshirës ishte Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa autoriteti emërues sipas Kushtetutës ishte PCN-ja. Mospërputhja e tillë në mes të Kushtetutës dhe Propozimit Gjithëpërfshirës ra brenda fushëveprimit të Nenit 143.3 të Kushtetutës (tash i shlyer), i cili parashihte se "[...]Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë dhe duhet të zgjidhet përshtatshmërisht".

Neni i ri 55

> **Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtar të emëruar në përputhje me Kushtetutën do të vazhdoj sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin për emërim.**

Teksti i ri i Nenit 55 i referohet mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtar "të emëruar në përputhje me Kushtetutën". Megjithatë, kurdo që studenti kureshtar e lexon tekstin dhe dëshiron ta shoh dispozitën përkatëse të Kushtetutës lidhur me emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, ai ose ajo do të zhgënjehen kur të kuptojnë se nuk ka dispozita të tilla ngase çdo referim për mandatin dhe emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar e po ashtu edhe për Propozimin Gjithëpërfshirës sikurse edhe për PCN është shlyer nga Kuvendi.
Gjithashtu, vendimi i emërimit të PCN nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare apo në ueb faqen e Gjykatës, sepse PCN mund t'i këtë konsideruar konfidenciale kushtet e emërimit. Duke pasë parasysh që PCN para se të hiqte dorë e kishte vazhduar mandatin e tyre deri me 31 Gusht 2014, kushtet e zgjatjes po ashtu siguristh se janë mbajtur konfidenciale.
Për më tepër, në pajtim me Nenin 2 të Ligjit Nr. 04/L-114 [Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. L/03-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës] të datës 31 gusht 2012, Kuvendi ia ka shtuar edhe një paragraf Nenit 14 [Paga e gjyqtarëve] në Ligjin Nr. 03/L-121 (Shih komentet për Nenin 15 të Ligjit për Gjykatën më lartë).
Nuk do të ketë komente të tjera për nenin 55, në mungesë të ndonjë dokumenti tjetër zyrtar që i përmban detajet rreth mandatit dhe emërimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë.

Neni 56 [Rastet Paraprake]

> **Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.**

Nuk është lehtë të kapet i tërë kuptimi i këtij Neni. Qëllimi i këtij neni duhet parë ashtu që ua jap të drejtën palëve të autorizuara që të paraqesin kërkesa në Gjykatë për çështje gjyqësor që tashme ishin duke vijuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës me 15 qershor 2008, mirëpo rezultati përfundimtar i saj ka dalë në apo pas kësaj date. Prandaj, edhe pse Kushtetuta tashmë e ka përcaktuar juridiksionin e Gjykatës, akoma duhet që Kuvendi ta miratojë ligjin e ri për t'i zbatuar dispozitat kushtetuese në fjalë dhe ta themelojë Gjykatën Kushtetuese. Për të paraqitur kërkesë ishte, si rezultat i kësaj, e mundshme vetëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese më 16 janar 2009. Për shembull, paraqitësi i kërkesës i cili do dëshironte të fillojë procedurën pranë Gjykatës në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës që të ankohej për shkelje të së drejtës kushtetuese të tij/saj nga gjykata e shkallës së fundit, që ka ndodhur para ose menjëherë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që iu është dërguar atij/asaj me ose pas 15 qershorit 2008, do të mund ta bënte këtë, vetëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit me 16 janar 2009, edhe pse vet Gjykata akoma nuk ishte e themeluar.

Për shkak të Nenit 56, afati kohor prej katër muajve brenda të cilëve paraqitësi i mundshëm i kërkesës është dashur ta parashtrojë kërkesën (shih Nenin 49 [Afatet] të Ligjit), pra, nuk do të fillonte të numërohej në ditën në të cilën aktgjykimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës, ashtu siç është rasti sipas Nenit 49 të Ligjit, por do të fillonte të numërohej vetëm më 16 janar 2009[739] dhe do skadonte më 16 maj 2009.
Pra, për shkak se Kushtetuta nuk mund të zbatohet me retroaktivitet, Gjykata nuk ka kompetencë "*ratione temporis"* që të merret me shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Ndonëse ekzistojnë rrethana në të cilat Gjykata mund të bëj përjashtim nga Rregulla dhe i merr parasysh gjendjen që ka ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, mirëpo që efektet e kësaj vazhdojnë më pas, e ashtuquajtura "gjendje e vazhdueshme" që përbën shkelje të të drejtave kushtetuese, ku paraqitësi i kërkesës nuk ka ndonjë mjet efektiv në dispozicion për ta ndalur këtë gjendje (Shih po ashtu komentet e Nenit 49 [Afatet] të Ligjit si dhe Rregullën 36(3)(h) më lartë).[740] Për shembull, në rastin Nr. KI. 08/09, Sindikata e pavarur e Punëtorëve të IMK Fabrika e Çelikut në Ferizaj, Shqyrtimi Kushtetues i vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, Vendimi C. Nr. 340/2001, të datës 11 janar 2002,[741]ku aktgjykimi i Gjykatës Komunale në favor të paraqitësit të kërkesës ishte bërë *res judicata* me 11 mars 2001, Gjykata gjeti se punëtorët akoma po prisnin zbatimin e atij vendimi të gjykatës dhe se "*Gjendja e mos-zbatimit të aktgjykimit të 11 janarit 2002 është, si rezultat i kësaj, duke vazhduar deri me sot".* Po ashtu në rastet Nr. KI 76-2010, KI 82-2010, KI 83-2010, KI 102/2010, KI 111-2010, KI 122-2010, KI 127 -2010, KI 11-2011, KI 15-2011, KI 18-2011, KI 45-2011, KI 47-2011, KI 48-2011, KI 50 2011, KI 57-2011, KI 60-2011, KI 69-2011, KI 71 2011, KI 73 -2011, KI 75-2011, KI 79-2011, *Ilaz Halili dhe 20 ish punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës,* Aktgjykimi i 27 dhjetorit 2011, Gjykata ka gjetur se "*Pasi rrethanat për të cilat parashtruesit ankohen kanë vazhduar, afati prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit, nuk është i zbatueshëm për këto raste.*
GJEDNJ është ballafaquar me situata të ngjashme kur i ka gjykuar kërkesat në të cilat ankuesi është ankuar se fakti që përbën shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut i takon periudhës para ratifikimit të KEDNJ nga shtetet në fjalë.[742] Në raste të tilla, afati kohor prej gjashtë muajve i KEDNJ do të fillonte së numëruari në datën kur gjendja ka përfunduar[743].

Neni 57 [Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

> **Themelohet sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese do të vepron deri në kohën kur Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese e përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji të jetë funksionale. Sekretaria e përkohshme kryen detyrat në pajtim me**

[739] Ligji është miratuar nga Kuvendi me 16 Dhjetor 2008 dhe ka hyrë në fuqi me 16 Janar 2009.
[740] Shih Praktikën Gjyqësore të cekur aty.
[741] Aktgjykimi i datës 17 Dhjetor 2010, Buletini i Praktikës Gjyqësore 2009-2010; dhe në ueb faqen e Gjykatës.
[742] Shih, *De Becker kundër Belgjikës,* Kërkesa nr. 214/56, Vendimi i 9 Qershorit 1958.
[743] Shih, *Antonenkov kundër Ukrainës,* Kërkesa nr. 14183/02, Aktgjykimi i GJEDNJ, 22 nëntor 2005.

mjetet e aplikueshme deri në kohën kur Sekretari i Përgjithshëm, i emëruar në pajtim me nenin 12 të këtij ligji vendos që Sekretariati të jetë funksional.

Neni 57 nuk e specifikon se cilat përgjegjësi do t'i ushtronte Sekretaria e përkohshme dhe përmes cilit mekanizëm të rekrutimit do të emërohej Kryesuesi i Sekretarisë së Përkohshme (dhe stafi tjetër). Po ashtu, neni nuk tregon nëse të gjitha kompetencat, përgjegjësit dhe detyrimet kontraktuese të Sekretarisë së Përkohshme do të transferoheshin në Sekretarinë e Gjykatës pasi që Sekretari i Përgjithshëm të vendos që Sekretaria është funksionale. Do të ishte shumë më e qartë për paraqitësit e mundshëm të kërkesës nëse Neni 57 të mos kishte përcaktuar me dykuptimësi se Sekretaria e Përkohshme do të kishte mandatin që përkohësisht të regjistrojë kërkesa. Kjo veçanërisht do të ishte me rëndësi për paraqitësit e kërkesave që mbulohen nga Neni 56 [Rastet paraprake] të Ligjit kërkesat e të cilëve kishin të bëjnë më çështje që binin në juridiksion të Gjykatës dhe të cilat janë ngritur para hyrjes së ligjit në fuqi (16 janar 2009). Për shembull, në rastin e paraqitësit të kërkesës sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës, afati ishte 16 maj 2009, pra katër muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Në mungesë të ndonjë udhëzimi të hollësishëm në Ligj, individët në fjalë mund të mos e kenë kuptuar se kërkesa e tyre duhet të dorëzohet para 16 majit 2009, por mund të kenë menduar se mund të presin për parashtrimin e kërkesës së tyre deri sa Gjykata të jetë funksionale.
Sido që të jetë, Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës,[744] plotësisht është themeluar me 2 shkurt 2009 për të filluar shërbimin ndaj Institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës duke iu siguruar atyre kursin ligjor për të sjellë ankesa në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e cila zyrtarisht është themeluar në janar 2009, ashtu siç është shpallur nga njoftimi për shtyp i po të njëjtës datë.
Sekretaria e Përkohshme gjatë ekzistimit të vet më të vërtetë ka pranuar disa kërkesa sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës. Vet Gjykata është bërë funksionale pasi që të gjithë gjyqtarët e bën betimin në gusht të 2009. Pas emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm nga gjyqtarët e Gjykatës në pajtim me Nenin 12 [Sekretaria] të Ligjit, është themeluar Sekretaria e Gjykatës duke e zëvendësuar Sekretarinë e Përkohshme në fillim të shtatorit 2009.

Neni 58 [Hyrja në fuqi]

Ky ligj hynë në fuqi në datën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi më 16 dhjetor 2008, i shpallur më 30 dhjetor 2008, dhe ka hyrë në fuqi më 16 janar 2009, në datën kur është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

[744] East West Managment Institute – Instituti i Menaxhimit Lindje Perëndim (EWMI)- organizatë jo fitimprurëse e vendosur në SHBA, me grant të UK DFID, ka siguruar asistencë teknike kryesore për grupin punues të qeverisë së Kosovës që ishin të ngarkuar për themelimin e Gjykatës. Presidenti Sejdiu në letrën e tij për EWMI, e ka përshëndetur këtë arritje madhore dhe e ka ofruar mbështetjen e tij dhe të institucioneve Kosovare në zhvillimin e mëtejshëm të Gjykatës.

Aneksi 1:

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI IV / Nr. 46 / 15 JANAR 2009

LIGJI Nr. 03/L-121
PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të rregullimit të mëtejshëm të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU I
ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Fushëveprimi

Ky ligj rregullon më tej organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, kualifikimet tjera përkatëse për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje tjera organizative.

Neni 2
Organizimi i punës së Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetutën") dhe me ligj.
2. Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.

Neni 3
Selia dhe simbolet

1. Selia e Gjykatës Kushtetuese është në Prishtinë.
2. Gjykata Kushtetuese zhvillon seancat në selinë e saj, por përjashtimisht, me vendimin e saj mund të zhvilloj seanca edhe në vendet tjera të Republikës së Kosovës.
3. Gjykata Kushtetuese ka simbolin dhe vulën e vet të cilat përcaktohen me rregullore të punës.

Neni 4
Kushtet shtesë për emërimin e gjyqtareve

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë:
1.1. shtetas të Republikës së Kosovës;
1.2. jurist të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, mes tjerash, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar dhe punë tjera të rëndësishme të natyrës juridike;
1.3. individ me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për vepër penale.

Neni 5
Papajtueshmëria e funksionit

1. Gjatë mandatit të tij gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të jetë:
1.1. anëtar i një partie, lëvizje ose çfarëdo organizate tjetër politike;
1.2. anëtar i bordit drejtues të një ndërmarrje publike, shoqërie tregtare ose organizate jo qeveritare;
1.3. anëtar i një sindikate;
2. Përveç ndalesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të drejtë të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehet me pagesë, përveç ushtrimit të funksionit të ligjëruesit të shkencave juridike në një universitet të akredituar.
Për veprimtari shkencore, apo pa pagesë angazhohet si anëtar në institute ose shoqata të juristëve, në qëllime të këtij ligji, nuk konsiderohet detyrë publike apo profesionale nëse gjyqtari pa pagesë merret me organizata humanitare, kulturore, sportive dhe organizata tjera, përderisa këto aktivitete nuk kanë lidhje me punën e ndonjë partie politike.
3. Gjyqtari i propozuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk mund të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës nëse nuk paraqet dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga funksionet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Secili gjyqtar ka për detyrë të njoftojë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese me shkrim për çdo aktivitet që kryen jashtë funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të cilën kompensohet me mëditje ose çfarëdo forme tjetër të kompensimit. Në rast se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese shpreh kundërshtimin e vet, gjyqtari ka të drejtë të

kërkojë që vendimi i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të rishqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë mund të hidhet poshtë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 6
Procedura për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese

1. Me këtë ligj themelohet Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë "Komisioni"). Ky Komision i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me procedurën e përcaktuar në këtë nen.
2. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:
2.1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo një anëtar i Kuvendit përfaqësues i deleguar i tij/saj;
2.2. Udhëheqësit e secilit grup parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo anëtarët e Kuvendit përfaqësues të deleguar të tyre;
2.3. Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
2.4. Avokati i Popullit;
2.5. Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete;
2.6. Përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese.
3. Komisionin e thërret dhe kryeson Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesi i deleguar i tij/saj. Komisioni ka dy zëvendës kryesues të cilët zgjidhen në mesin e anëtarëve të tij, ku njëri nga ta do të jetë nga radhët e deputetëve të komunitetit tjetër nga komuniteti i kryesuesit.
4. Komisioni vendos me shumicën e thjeshtë të votave. Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo përfaqësuesit të tij/saj të deleguar është vendimtare.
5. Në rast se ndonjëri nga anëtaret e Komisionit ka konflikt të interesit në lidhje me rastin, atëherë ai/ajo nuk merr pjesë në punën e Komisionit për atë rast.
6. Procedurën për përcaktimin e listës së ngushtë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e fillon Komisioni. Komisioni publikon thirrjen/ftesën në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe ato të cilat kryesisht lexohen nga komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, të Kuvendit, institucioneve gjyqësore, fakulteteve juridike, Odës së Avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, partive politike, personave të tjerë relevant juridik dhe individëve që të propozojnë kandidat për zgjedhjen e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë ftesa/thirrja). Një person mund të propozojë veten për kandidat.
7. Në thirrje/ftesë ceken kushtet për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, afati për paraqitjen e propozimit për kandidatin Komisionit, i cili nuk duhet të jetë më i shkurtër se 15 apo më i gjatë se 20 ditë, dhe dokumentet përcjellëse të cilat dorëzohen me propozim.
8. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e mëparshëm, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, shqyrton nëse kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë dhe me këtë ligj, dhe hedhë poshtë kandidaturat që nuk plotësojnë këto

kushte. Në zbatimin e kësaj përgjegjësie, Komisioni aplikon përvojat e krijuara për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve tjerë të gjyqësorit në Republikën e Kosovës.
9. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për tu zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidateve të kualifikuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.
10. Lista e ngushtë përmban më shumë kandidatë sesa numri i gjyqtarëve të cilët do të zgjedhën, por jo më tepër se pesë (5) kandidatë për një post të lirë.
11. Komisioni, bashkangjitur me listën e ngushtë, i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës listën e të gjithë kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
12. Propozimi i Komisioni përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.

Neni 7
Emërimi dhe fillimi i mandatit

1. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri, sipas këtij ligji, fillon të paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak.
2. Mandati i gjyqtarit të ri fillon në ditën kur përfundon mandati i gjyqtarit paraprak. Gjyqtari i ri emërohet nga Presidenti dhe e jep betimin para Presidentit para fillimit të mandatit të tij. Në rast se mandati i gjyqtarit përfundon sipas nenit 8 të këtij ligji mandati i gjyqtarit zëvendësues fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.
3. Përjashtimisht prej paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, mandati i gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese fillon në ditën kur emërohen nga Presidenti dhe japin betimin para Presidentit.
4. Teksti i betimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është si vijon:
"Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës do t'i qëndroj besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe do të ushtroj funksionin e gjyqtarit me nder, përgjegjësi dhe paanshmëri, duke e respektuar rregullat e etikës profesionale."

Neni 8
Përfundimi i mandatit

1. Mandati i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përfundon me:
1.1. skadimin e kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur;
1.2. ndërprerjen e mandatit para kohe sipas nenit 9 te këtij ligji.
2. Gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Gjykatës njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës me qëllim që të filloj procedurën për propozimin e gjyqtarit të ri.

Neni 9
Përfundimi i mandatit para kohës

1. Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur në rast të:
1.1. dorëheqjes;
1.2. vdekjes;
1.3. humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
1.4. sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;
1.5. shkarkimit sipas nenit 118 të Kushtetutës.
2. Përfundimi i mandatit sipas pikës 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni duhet të bazohet në vendimin e marrë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese pas shqyrtimit të të gjitha analizave dhe konstatimeve relevante mjekësore. Miratimi i vendimi sipas nenit në fjalë kërkon 2/3 e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të gjyqtarit mandati i të cilit është nën shqyrtim.

Neni 10
Detyrat e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ushtrojnë me ndërgjegje dhe në mënyrë të paanshme funksionin e gjyqtarit dhe të vendosin sipas bindjes së lirë në pajtim me Kushtetutën.
2. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë për detyrë të ruajnë reputacionin dhe dinjitetin e Gjykatës Kushtetuese.
3. Secili gjyqtar ka për detyrë të marrë pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe të kryej punët tjera të caktuara me ligj dhe me rregulloren e punës.

Neni 11
Kryetari dhe Zëvendëskryetari

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese:
1.1. koordinon aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese dhe punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese;
1.2. thërret dhe drejton seancat verbale të Gjykatës Kushtetuese;
1.3. përfaqëson Gjykatën Kushtetuese;
1.4. nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese;
1.5. kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë ligj ose me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
2. Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese ushtron detyrat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese kur ky i fundit mungon ose për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e tij. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund t'ia delegojë Zëvendëskryetarit disa detyra të caktuara për të mbështetur Kryetarin në ushtrimin e detyrave të tij.
3. Administrimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 12
Sekretaria

1. Gjykata Kushtetuese ka Sekretarinë e vet e cila kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese.
2. Sekretaria kryen punët administrative dhe ka për detyrë të mbështesë punën e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria:
2.1. pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet tjera zyrtare;
2.2. mban regjistrin e Gjykatës;
2.3. siguron incizimet e përcaktuara me ligj;
2.4. përgatitë transkriptet dhe procesverbalet;
2.5. kryen punët e informimit publik dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese;
2.6. mban vulën e Gjykatës Kushtetuese; dhe
2.7. kryen punët tjera të përcaktuara me ligj dhe me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
3. Organizimi dhe mënyra e punës së Sekretarisë rregullohen me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
4. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretarisë. Sekretari përzgjidhet dhe emërohet nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicë të votave. Hollësitë lidhur me përzgjedhjen, emërimin, kushtet e punës dhe pagën e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Sekretari i Përgjithshëm i raporton Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për punën e tij i'u përgjigjet të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
5. Sekretari i Përgjithshëm emëron dhe shkarkon të punësuarit e Sekretarisë në pajtim me ligjin në fuqi për shërbimin civil. Ndaj të punësuarve të Sekretarisë zbatohen dispozitat ligjore për shërbyesit civil.

Neni 13
Këshilltarët Juridik

Këshilltarët juridik mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kushtet për emërimin, shkarkimin, dhe statusin e këshilltarëve juridik caktohen me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese. Pagat e këshilltarëve juridik caktohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 14
Buxheti

1. Gjykata Kushtetuese financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
2. Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve tjera, Gjykata Kushtetuese përgatit propozimin e buxhetit të saj vjetor dhe i'a dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës. As Qeveria apo ndonjë organizatë tjetër buxhetore nuk ka të drejtë të ndryshojë ose në çfarëdo mënyre tjetër të modifikojë ose të ndikojë në propozimin e buxhetit të përgatitur nga Gjykata Kushtetuese. Buxheti i propozuar nga

Gjykata Kushtetuese përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
3. Gjykata Kushtetuese menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 15
Pagat e Gjyqtarëve

Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë sa ajo e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

KREU II
PROCEDURA

1. Dispozitat e përgjithshme procedurale

Neni 16
Rregulli i përgjithshëm

1. Dispozitat e kësaj pjese zbatohen ndaj të gjitha procedurave gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.
2. Në rast të mungesës së dispozitave procedurale, Gjykata zbaton në mënyrë të arsyeshme dhe analoge dispozitat përkatëse të ligjeve tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën e çështjes, si dhe veçoritë e procedurës para Gjykatës Kushtetuese.

Neni 17
Parimi i Publicitetit

1. Seancat, përfshirë edhe shpallja e aktgjykimeve janë të hapura për publikun.
2. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të përjashtojë publikun kur vlerëson që është e nevojshme për ruajtjen e:
2.1. sekretit shtetëror, rendit ose moralit publik;
2.2. informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi publik;
2.3. jetës private ose sekretit afarist të palës në procedurë.
3. Procedura për përjashtimi e publikut nga paragrafi 2 mund të iniciohet me kërkesën e palës.
4. Gjatë procesit të këshillimit dhe votimit në kuadër të marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, marrin pjesë vetëm gjyqtarët.

Neni 18
Përjashtimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës kur gjyqtari,

1.1. është i përfshirë në çështjen e cila është objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese;
1.2. është në lidhje martesore ose jashtëmartesorë ose në lidhje familjare më një palë në procedurë, në pajtim me ligjin në fuqi; ose
1.3. sipas detyrës zyrtare është marrë më herët me çështjen para se ajo t'i jetë referuar Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjykatësi nuk është i përfshirë në çështje në kuptimin e paragrafit 1, pika 1.1. vetëm pse i takon një grupi shoqëror ose gjinor, një profesioni ose një partie politike interesat e së cilës mund të preken nga rezultati i procesit para Gjykatës Kushtetuese.
3. Paragrafi 1, pika 1.3. nuk përfshin pjesëmarrjen në procedurë legjislative si dhe shprehjen e mendimit profesional ose akademik për një çështje juridike, e cila mund të jetë me rëndësi për procesin para Gjykatës Kushtetuese.
4. Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar.
5. Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërish.

Neni 19
Marrja e vendimeve

1. Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese
2. Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.
3. Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.
4. Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit.

Neni 20
Vendimet

1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.
3. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruara, nga kryetari i gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtari raportues. Përfundimet e arritura nga shumica e gjyqtareve përcaktojnë vendimin e gjykatës. Vendimet shpallen publikisht.
4. Vendimi i dërgohet secilës palë sipas detyrës zyrtare dhe shpallet në Gazetën Zyrtare.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, përveç nëse Gjykata Kushtetuese në vendim ka caktuar ndryshe.

Neni 21
Përfaqësimi

Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.

Neni 22
Procedimi i kërkesës

1. Fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kërkesat dorëzohen me shkrim në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria regjistron menjëherë të gjitha kërkesat në regjistrin e Gjykatës Kushtetuese sipas radhës në të cilën janë parashtruar. Kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet të ju bashkëngjiten provat e nevojshme.
2. Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Pala kundërshtare ka dyzet e pesë (45) ditë nga pranimi i kërkesës për të dorëzuar në Sekretari përgjigjen e saj në kërkesë së bashku me arsyetimin dhe provat e nevojshme.
3. Sekretari ia dërgon kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë gjyqtarit raportues i cili përgatit raportin paraprak lidhur me faktet, lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës. Gjyqtari raportues caktohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.
4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.
5. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë gjyqtari raportues ia dërgon kolegjit shqyrtues raportin paraprak. Në rast se përgjigja në kërkesë nuk dorëzohet brenda afatit të paparë ose sipas natyrës së procedurës së veçantë nuk kërkohet një përgjigje në kërkesë, gjyqtari raportues përgatit raportin paraprak vetëm në bazë të kërkesës.
6. Kolegji shqyrtues vlerëson lejueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues përbëhet nga tre gjyqtarë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës
7. Nëse kolegji shqyrtues unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e lejueshme, kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë. Kolegji shqyrtues merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të siguroj se kopja e propozim-vendimit u është dërguar gjyqtarëve që mund të mos jenë në territorin e Republikës së Kosovës.
8. Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve prej pranimit të propozim-vendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozim-vendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë.

9. Në rast se kolegji shqyrtues vjen në përfundim se kërkesa është e lejueshme apo nëse të paktën njëri prej gjyqtarëve që nuk ka qenë anëtar i kolegjit shqyrtues kundërshton propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa, lënda i dërgohet trupit gjykues. Trupi gjykues gjatë shqyrtimit verbal shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 23
Tërheqja e palës

Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që i'u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.

Neni 24
Shqyrtimi verbal

Shqyrtimi verbal kryesohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Procedura e shqyrtimit verbal përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 25
Provat

Procedura e administrimit dhe shqyrtimit të provave përcaktohet në rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 26
Bashkëpunimi me organet tjera publike

Të gjitha gjykatat dhe organet publike të Republikës së Kosovës kanë për detyrë të mbështesin punën e Gjykatës Kushtetuese dhe të bashkëpunojnë me Gjykatën Kushtetuese sipas kërkesës së saj.

Neni 27
Masat e përkohshme

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.
2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 28
Shpenzimet e procedurës

1. Palët i bartin shpenzimet e tyre të procedurës, përveç nëse Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.

2. Pala e cila ka ngritur kërkesë sipas nenit 113, pika 7 të Kushtetutës lirohet nga detyrimi për mbulimin e shpenzimeve të procedurës nëse Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa në fjalë është e lejueshme dhe e bazuar.

KREU III
PROCEDURAT E VEÇANTA

1. Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 29
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit
2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikoje, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Neni 30
Afatet

Kërkesa e ngritur ne pajtim me nenin 29 te këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit te kontestuar.

2. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës

Neni 31
Saktësimi i kërkesës

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar dhe qe cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate te dobishme ne lidhje me konfliktin e supozuar ne pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
Afatet

Kërkesa e ngritur në bazë te nenit 31 te këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

3. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (2) të Kushtetutës

Neni 33
Saktësimi i Kërkesës

Kërkesa e ngritur në bazë te nenit 113, paragrafi 3, pika 2 te Kushtetutës parashtrohet nga Kuvendi i Republikës se Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës ose nga Qeveria. Kërkesa përmban çfarëdo informate te nevojshme në lidhje papajtueshmërinë e supozuar me Kushtetutën dhe referendumin e propozuar ashtu siç përcaktohet me rregullat e procedurës se Gjykatës Kushtetuese.

Neni 34
Afati

1. Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetushmërinë e referendumit të propozuar brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të kërkesës.
2. Referendumi, i cili është objekt it kërkesës se ngritur në bazë te nenit 33 të këtij ligji mbahet vetëm pasi që Gjykata Kushtetuese vendos se referendumi i propozuar është në pajtim me kushtetutën.

4. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (3) të Kushtetutës

Neni 35
Afati

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i marrë ne pajtim me Nenin 113, paragrafi 3, pika 3 te Kushtetutës, mund te merret në afat prej njëzetekatër (24) orësh nga hyrja ne fuqi e vendimit te lartpërmendur.

5. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës

Neni 36
Efekti suspensiv

Ngritja e kërkesës sipas nenit 113, paragrafi 3, pika 4 të Kushtetutës ka efekt pezullues. Kuvendi i Republikës se Kosovës vepron në bazë të ndryshimit te kontestuar vetëm pasi është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 37
Afati

Gjykata Kushtetuese vendos mbi kërkesën e ngritur nga palët e autorizuara sipas nenit 113, paragrafi 3 (4) të Kushtetutës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

6. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës

Neni 38
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 3 (5) të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar(supozuar);
1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se janë shkelur; dhe
1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen kushtetuese.

Neni 39
Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e shterjes së mjeteve tjera juridike.

7. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës

Neni 40
Saktësimi i kërkesës

Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 4 të Kushtetutës, komuna paraqet, ndër të tjera, informatat përkatëse në lidhje me ligjin apo aktin e kontestuar të Qeverisë, cila dispozitë e Kushtetutës supozohet se është shkelur dhe cilat përgjegjësi apo të hyra komunale janë prekur nga një ligj apo akt i tillë.

Neni 41
Afatet

Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës.

8. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës

Neni 42
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit te Republikës së Kosovës;
1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe
1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.

Neni 43
Afati

1. Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.
2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund ti dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar.
3. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dorëzimit të kërkesës.

9. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës

Neni 44
Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar (supozuar);
1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti; dhe
1.3 paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës.

Neni 45
Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

10. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës

Neni 46
Lejueshmëria

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

Neni 47
Kërkesa individuale

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
Afatet

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

Neni 50
Kthimi në gjendjen e mëparshme

Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.

11. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës

Neni 51
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Nenin 52
Procedura para gjykatës

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53
Vendimi

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

12. Procedura në rastin e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 9
të Kushtetutës së Kosovës

Neni 54
Afati

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas mundësisë, duhet të merret brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të kërkesës.

KREU IV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 55
Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese

1. Për periudhën e përcaktuar në nenin 152 të Kushtetutës, përbërja e Gjykatës kushtetuese do të jetë sikurse është përcaktuar në atë nen.
2. Asgjë në këtë ligj, përfshirë dispozitat të cilat rregullojnë kriteret për përshtatshmëri, kualifikime profesionale dhe kompensim për gjyqtarët, nuk aplikohen për të penguar apo ndryshe kufizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar, të përcaktuar në Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Republikës së Kosovës, të datës 26 mars 2007. Këto përgjegjësi dhe kompetenca ushtrohen në pajtim me instrumentet e aplikueshme pavarësisht ndonjë dispozite të këtij ligji.

Neni 56
Rastet Paraprake

Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 57
Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese

Themelohet sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese. Sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese do të vepron deri në kohën kur Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese e përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji të jetë funksionale. Sekretaria e përkohshme kryen detyrat ne pajtim me mjetet e aplikueshme deri në kohën kur Sekretari i Përgjithshëm, i emëruar në pajtim me nenin 12 të këtij ligji vendos që Sekretariati të jetë funksional.

Neni 58
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-121
16 Dhjetor 2008
Shpallur me dekretin Nr. DL-070-2008, datë 30.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu

RREGULLORE E PUNËS
E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I. Organizimi i Gjykatës Kushtetuese

Rregulli 1
Dispozitat e përgjithshme

Kjo Rregullore e punës plotëson dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për organizimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të procedurave para Gjykatës dhe të çështjeve të tjera përkitazi me funksionimin e Gjykatës.

Rregulli 2
Selia e Gjykatës

(1) Selia e Gjykatës është në Prishtinë, ku Gjykata mban seancat dhe dëgjimet e veta. Gjykata mund të mbajë seanca dhe dëgjime edhe në vende të tjera të përshtatshme brenda Republikës së Kosovës.
(2) Me kërkesë të Gjykatës, Sekretariati përgatit dhe i paraqet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Kryetari) listën e vendeve që janë të përshtatshme për mbajtjen e seancave dhe të dëgjimeve të Gjykatës.
(3) Vendimi për mbajtjen e seancave jashtë selisë së Gjykatës merret me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: gjyqtarët) që janë të pranishëm dhe që votojnë. Gjykata merr parasysh pikëpamjet e palëve, para marrjes së vendimit.

Rregulli 3
Simboli dhe vula e Gjykatës

(1) Simboli i Gjykatës vendoset nëpërmjet votimit nga shumica, e përbërë nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve.
(2) Vula e Gjykatës përmban emblemën e Republikës së Kosovës, të rrethuar me mbishkrimin: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës - Ustavni sud Republike Kosova.

Rregulli 4
Përparësia e gjyqtarëve

(1) Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të emëruar në pajtim me nenin 114 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 6 e me nenin 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
(2) Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore të punës, gjyqtarët kanë status të barabartë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre, pavarësisht moshës, rendit të emërimit, kohëzgjatjes së shërbimit, ose kohëzgjatjes së mandatit.

(3) Me rastin e përcaktimit të rendit të votimit, gjyqtarët votojnë me përparësi, sipas datës dhe sipas kohës së fillimit të mandatit të tyre: ata që janë emëruar më së voni, votojnë së pari. Nëse gjyqtarët janë emëruar në të njëjtën kohë, atëherë ata votojnë me radhë sipas alfabetit.
(4) Me rastin e përcaktimit ose të zëvendësimit të gjyqtarëve raportues dhe të kryesuesve të kolegjeve shqyrtuese, përparësia e gjyqtarëve përcaktohet nëpërmjet sistemit të tërheqjes së shortit dhe të emërimit të gjyqtarit përkatës nga Kryetari.

Rregulli 5
Dorëheqja e gjyqtarëve

(1) Gjyqtari i dorëzon dorëheqjen me shkrim Presidentit të Republikës së Kosovës, duke njoftuar me nga një kopje Kryetarin e Gjykatës dhe Sekretariatin.
(2) Sekretariati njofton menjëherë me nga një kopje të dorëheqjes të gjithë gjyqtarët e tjerë dhe palët përkatëse.
(3) Për të qenë efektive, dorëheqja e gjyqtarit nuk varet nga pranimi i saj.
(4) Përveç nëse në dorëheqje me shkrim përcaktohet ndonjë datë tjetër, dorëheqja hyn në fuqi në ditën e dorëzimit të saj te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Rregulli 6
Procedurat për shkarkim

(1) Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet vetëm në këto raste:
(a) në rast të kryerjes së ndonjë krimi të rëndë,
(b) në rast të mospërfilljes së rëndë të detyrave të punës,
(c) në rast të humbjes së përhershme të aftësisë për të vepruar, ose
(d) në rast të sëmundjes a të ndonjë problemi tjetër shëndetësor, që e bën të pamundur ushtrimin e përgjegjësive dhe të funksionit të gjyqtarit.
(2) Shkarkimi mund të propozohet nëpërmjet një dokumenti të shkruar, ku përshkruhet baza për shkarkim, dhe i cili nënshkruhet nga një ose më shumë gjyqtarë dhe i dorëzohet Kryetarit. Dokumentet që përmbajnë çfarëdo fakti të rëndësishëm, duhet t'i bashkëngjiten propozimit për shkarkim. Propozimi për shkarkim duhet të jetë konfidencial dhe të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen me të sa më shpejt që të jetë e mundur.
(3) Kryetari njofton me shkrim gjyqtarin e propozuar për shkarkim mbi bazën e propozimit për shkarkim dhe i jep gjyqtarit përkatës propozimin e shkruar dhe të gjitha faktet relevante të bashkëngjitura. Në rast se Kryetari propozohet për shkarkim, Zëvendëskryetari i bën njoftimin e njëjtë Kryetarit.
(4) Gjyqtarët mbajnë takim konfidencial, për të diskutuar shkarkimin e propozuar. Gjyqtari i propozuar për shkarkim ka të drejtë të jetë i pranishëm në takimin konfidencial dhe ka të drejtë të përgjigjet ndaj propozimit për shkarkim, të japë ose të paraqesë shpjegime ose informacione dhe t'u përgjigjet pyetjeve të gjyqtarëve.
(5) Gjyqtarët mbajnë një takim tjetër konfidencial nga i cili përjashtohet gjyqtari i propozuar për shkarkim. Në këtë takim, gjyqtarët përcaktojnë nëse do t'ia propozojnë këtë shkarkim Presidentit të Republikës së Kosovës. Kryetari i Gjykatës e kryeson këtë takim dhe diskutimet e gjyqtarëve mbesin konfidenciale. Për t'i propozuar shkarkimin

Presidentit të Republikës së Kosovës, propozimi për shkarkim duhet të votohet nga 2/3 e të gjithë gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës. Gjyqtarët duhet të kenë të drejtë, po ashtu nëpërmjet shumicës prej 2/3, të vendosin sanksione ose masa disiplinore që janë më pak të ashpra sesa shkarkimi, në rast se rrethanat e lejojnë një gjë të tillë.

Rregulli 7
Procedurat për përjashtim

(1) Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim të arsyeshëm përkitazi me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës. Një kopje e atij informacioni do t'u dërgohet të gjithë gjyqtarëve.
(2) Cilado palë në procedurë mund të paraqesë kërkesë për përjashtimin e një gjyqtari sapo t'i kuptojë arsyet për përjashtim dhe jo më vonë se një javë para fillimit të seancës dëgjimore, nëse ka, ose para se të merret vendimi nga Gjykata.
(3) Në informacion ose në kërkesë, gjyqtari ose pala duhet t'i prezantojë faktet dhe rrethanat me të cilat e arsyeton përjashtimin. Arsyet e cekura në peticionin paraprak për përjashtimin që ishte refuzuar nuk mund të përfshihen në kërkesën për përjashtim. Kopje të asaj kërkese do t'u dërgohen të gjithë gjyqtarëve.
(4) Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar nga cilado palë, një deklaratë do të merret nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk mund marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit.
(5) Gjykata, me shumicë votash të gjyqtarëve, do të vendosë përkitazi me përjashtimin, nëse vendos që përjashtimi është i bazuar mirë dhe i mbështetur.

Rregulli 8
Emërimi i Gjyqtarit raportues

(1) Gjyqtari, të cilit i caktohet një kërkesë, zgjidhet nëpërmjet sistemit të tërheqjes së shortit dhe emërohet nga Kryetari.
(2) Në rast se është e domosdoshme të zëvendësohet Gjyqtari raportues, lënda i caktohet një gjyqtari tjetër nëpërmjet tërheqjes së shortit dhe pastaj, ai gjyqtar, emërohet nga Kryetari.
(3) Me kalimin e kohës, të gjithë gjyqtarëve do t'u caktohet numër i barabartë i lëndëve në të cilat ata janë gjyqtarë raportues.

Rregulli 9
Përcaktimi i kolegjeve shqyrtuese

(1) Për secilën kërkesë të regjistruar në Gjykatë, me short caktohet Kolegji shqyrtues i përbërë nga tre gjyqtarë, i cili pastaj emërohet nga Kryetari, për të shqyrtuar pranueshmërinë e kërkesës.
(2) Kryetari përcakton njërin nga gjyqtarët e caktuar në Kolegjin shqyrtues të shërbejë si kryesues i Kolegjit shqyrtues.

(3) Me kalimin e kohës, të gjithë gjyqtarëve do t'u caktohet numër i barabartë i lëndëve për të shërbyer si gjyqtarë në kolegje shqyrtuese dhe si kryesues të kolegjeve shqyrtuese.
(4) Gjyqtari raportues, i caktuar për të përgatitur raportin për kërkesën që shqyrtohet nga Kolegji shqyrtues, nuk mund të jetë anëtar i atij Kolegji shqyrtues.

Rregulli 10
Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit

(1) Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Gjykatës zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës dhe mandatet e tyre fillojnë nga data e cekur në vendimin e Gjykatës për zgjedhjen e tyre.
(2) Zgjedhja për Kryetar dhe për Zëvendëskryetar mbahet një muaj para skadimit të mandatit të Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit në detyrë. Kryetari i Gjykatës, nëse është ende gjyqtar dhe kurdo të jetë e mundshme, vazhdon të ushtrojë funksionet e Kryetarit deri në zgjedhjen dhe deri në marrjen e funksionit nga Kryetari i ri. Në rast se posti i Kryetarit mbetet menjëherë i zbrazët, zgjedhja për Kryetar duhet të mbahet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe Zëvendëskryetari ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të mandatit të Kryetarit të ri. Në rast se nuk ka Zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën më të gjatë në Gjykatë ushtron rolin e Kryetarit të përkohshëm. Nëse një ose më shumë gjyqtarë në Gjykatë kanë kaluar kohë të njëjtë në Gjykatë, atëherë gjyqtari më i vjetër për nga mosha konsiderohet gjyqtari me përvojë më të gjatë për qëllim të këtij rregulli.
(3) Kryetari udhëheq zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit. Nëse Kryetari nuk është më gjyqtar, ose nuk është në gjendje të ushtrojë detyrën e tij/saj, zgjedhjet udhëhiqen nga Zëvendëskryetari. Nëse Zëvendëskryetari nuk është më gjyqtar, ose nuk është në gjendje të ushtrojë detyrën e tij/saj, zgjedhjet udhëhiqen nga gjyqtari më i vjetër.
(4) Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit bëhet ndaras, në mënyrë të njëjtë dhe nëpërmjet votimit të fshehtë. Të gjithë gjyqtarët duhet të njoftohen brenda një kohe të mjaftueshme për të marrë pjesë në zgjedhje. Të paktën shtatë gjyqtarë duhet të jenë të pranishëm në takimin në të cilin do të mbahen zgjedhjet. Gjyqtari, i cili merr votat e shumicës së të gjithë gjyqtarëve që marrin pjesë në zgjedhje dhe që votojnë, shpallet i zgjedhur dhe Gjykata përcakton datën kur gjyqtari merr përsipër përgjegjësinë e atij posti.
(5) Në rast se, pas tri radhëve të votimit, asnjë gjyqtar nuk merr shumicën e votave, gjyqtarët zgjedhin në mes të dy gjyqtarëve që kanë marrë numrin më të madh të votave dhe zgjidhet gjyqtari që merr shumicën e votave në radhën e katërt të votimit. Për të përcaktuar nëse një gjyqtar ka marrë shumicën e votave, numërohen vetëm votat për dy kandidatët e fundit. Nëse, në radhën e tretë të votimit, tre gjyqtarë marrin nga tri vota, dy kandidatët e fundit 5 përcaktohen me short. Nëse, në radhën e katërt të votimit, asnjëri gjyqtar nuk merr shumicën e votave, zgjedhja përcaktohet me short.

Rregulli 11
Dorëheqja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit

(1) Kryetari ia dorëzon dorëheqjen e vet, si Kryetar, Zëvendëskryetarit dhe Sekretariatit. Zëvendëskryetari ia dorëzon dorëheqjen e vet, si Zëvendëskryetar, Kryetarit dhe Sekretariatit.
(2) Në secilin rast, Sekretariati njofton menjëherë të gjithë gjyqtarët dhe palët e tjera përkatëse me nga një kopje të dorëheqjes.
(3) Dorëheqja hyn në fuqi nga data e përcaktuar me shkrim, ose, në rast se nuk është përcaktuar asnjë datë, atëherë ajo hyn në fuqi menjëherë. Dorëheqja nuk varet nga pranimi i saj.
(4) Administrimi i përkohshëm i Gjykatës dhe zgjedhja e Kryetarit ose e Zëvendëskryetarit bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullit 10.

Rregulli 12
Funksionet e Kryetarit

(1) Përveç funksioneve të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në dispozitat e tjera në këtë Rregullore, Kryetari:
(a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Gjykatës;
(b) koordinon punën e gjyqtarëve dhe thërret seancat gjyqësore dhe administrative të Gjykatës;
(c) koordinon dhe mbikëqyr administrimin e të gjitha aktiviteteve të Gjykatës;
(d) përfaqëson Gjykatën, themelon dhe siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe me autoritetet publike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
(e) krijon grupe punuese, për të diskutuar dhe për të bërë rekomandime për çështjet që meritojnë shqyrtim të gjerë ose interdisiplinar;
(f) kryeson të gjitha takimet gjyqësore dhe administrative të Gjykatës;
(g) siguron respektimin e Kodit të mirësjelljes dhe mban rendin brenda objektit dhe gjatë seancave të Gjykatës; dhe
(h) informon të gjithë gjyqtarët për të gjitha çështjet në zhvillim e sipër dhe për ato të ardhshme, për proceset dhe për veprimet që kanë të bëjnë me Gjykatën.
(2) Zëvendëskryetari kryen detyrat e Kryetarit, kur Kryetari mungon ose kur për çfarëdo arsye tjetër nuk është në gjendje të kryejë detyrat e Kryetarit.
(3) Kryetari mund t'u delegojë detyra dhe përgjegjësi Zëvendëskryetarit ose gjyqtarëve të tjerë.

Rregulli 13
Uniforma zyrtare

Gjyqtarët bartin uniformën zyrtare në formë të togës gjyqësore, në rastet kur publikisht ushtrojnë funksionet e tyre. Nëse është e përshtatshme, gjyqtarët mund të bartin uniformën zyrtare kur marrin pjesë në ngjarjet e tjera publike. Gjyqtarët miratojnë dizajnin dhe ngjyrën e togës gjyqësore.

Rregulli 14
Seancat administrative

(1) Gjyqtarët takohen në seanca administrative për të diskutuar dhe për të vendosur për çështjet e politikave që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës. Kur është e nevojshme, nën udhëheqjen e Kryetarit, Sekretariati harton propozimet e politikave për shqyrtim dhe për miratim nga Gjykata.
(2) Seancat administrative të Gjykatës thirren nga Kryetari, i cili kryeson takimet. Gjykata takohet në seanca administrative së paku dy herë në vit, ose në bazë të kërkesës me shkrim të bërë nga ndonjëri gjyqtar ose nga Sekretariati.
(3) Çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e Gjykatës përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:
(a) buxhetin e Gjykatës;
(b) personelin;
(c) shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objektit;
(d) bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
(e) gjobat për shkeljet e bëra gjatë procedurës;
(f) organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Gjykatës;
(g) statusin dhe çështjet kontraktuese që përfshijnë Sekretariatin dhe këshilltarët juridikë;
(h) kushtet e punësimit, orarin e punës, kompensimin dhe Kodin e etikës për stafin administrativ të Sekretariatit; dhe
(i) miratimin e raportit vjetor.
(4) Në seanca administrative vendimet merren me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që të jenë të pranishëm të paktën pesë (5) gjyqtarë.

Rregulli 15
Sekretariati

(1) Përveç funksioneve dhe përgjegjësive të caktuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Sekretariati) ka përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve administrative, teknike dhe shërbimeve të tjera mbështetëse për Gjykatën, përfshirë, por jo të kufizuar në:
(a) shërbimet mbështetëse për seancat dëgjimore të Gjykatës;
(b) shtypjen e dokumenteve dhe të materialeve të tjera;
(c) shërbimet e përkthimit;
(d) shërbimet e ndërlidhura me buxhetin, me pagesat, me auditimin e brendshëm, me prokurimin dhe me personelin;
(e) shërbimet e menaxhimit të objektit, shërbimet teknike, pajisjet e zyrave, shërbimet për automjete, shërbimet postare, kujdesin kundër zjarrit dhe shërbimet e tjera të sigurisë;
(f) shërbimet mbështetëse për hartimin dhe për botimin e raportit vjetor; dhe
(g) shërbime të tjera mbështetëse që mund të përcaktohen nga Gjykata.
(2) Struktura organizative e Sekretariatit përcaktohet nga gjyqtarët në seancë administrative, pas propozimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm. Me miratimin e gjyqtarëve, Sekretari i Përgjithshëm mund të themelojë ose të mbyllë sektorë apo njësi,

kur kjo është e nevojshme për zbatimin efikas të funksioneve dhe të përgjegjësive të Sekretariatit.

Rregulli 16
Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendëssekretari i Përgjithshëm

(1) Sekretari i Përgjithshëm është kryeshef ekzekutiv i Sekretariatit. Ai i raporton Kryetarit dhe është përgjegjës për:
(a) administrimin e përgjithshëm dhe për menaxhimin e Sekretariatit, si dhe për të siguruar se funksionet e caktuara të tij përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase;
(b) nxjerrjen e rregulloreve dhe të udhëzimeve për çfarëdo çështjesh që kanë të bëjnë me funksionimin e Sekretariatit dhe të çështjeve të ndërlidhura administrative;
(c) të siguruar se vendimet e Gjykatës përkitazi me çështjet administrative zbatohen brenda afateve kohore dhe në mënyrë efikase;
(d) menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve;
(e) organizimin dhe për plotësimin me personel të Sekretariatit, për të siguruar se rekrutimi i personelit për Sekretariat është i bazuar në kualifikime profesionale, në aftësi dhe në merita dhe se ai bëhet me konkurs të drejtë e të hapur; dhe
(f) zbatimin e politikave jodiskriminuese, sa i përket personelit brenda Sekretariatit, përfshirë përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjithë lëmenjtë dhe nivelet, dhe për të siguruar se përbërja e personelit pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës.
(2) Sekretari i Përgjithshëm emërohet në seancë administrative, me shumicë të thjeshtë votash të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Emërimi duhet të jetë i bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues, të përzgjedhjes.
(3) Kushtet e punësimit dhe paga:
(a) Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është 3 vjet me mundësi vazhdimi.
(b) Vlerësimi i performancës bëhet në fund të çdo viti në bazë të planit vjetor që paraqet Sekretari i Përgjithshëm.
(c) Paga e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohet me vendim të Gjykatës.
(4) Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë, së paku, kualifikimet minimale të përcaktuara më poshtë:
(a) përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, në ato ekonomike, në menaxhim ose në administratë;
(b) pesë vjet përvojë pune, nga të cilat së paku dy vjet përvojë profesionale në administratë dhe në menaxhim; dhe
(c) të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.
(5) Konkursi për postin e Sekretarit të Përgjithshëm shpallet së paku në tri (3) gazeta që shpërndahen gjerësisht në Kosovë. Aplikacionet do të shqyrtohen nga komisioni përzgjedhës, i përbërë nga tre gjyqtarë të emëruar nga Kryetari. Komisioni përzgjedhës ua paraqet gjyqtarëve listën e personave që kanë konkurruar dhe që i përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafin (3).
(6) Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet, ose të suspendohet përkohësisht, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në seancë administrative të Gjykatës.

(7) Kryetari emëron Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm, i cili do të jetë përgjegjës posaçërisht për logjistikën, për prokurimin dhe për financat e Gjykatës. Zëvendëssekretar i Përgjithshëm do të jetë njëri nga drejtorët e Sekretariatit, i cili njëkohësisht do të ushtrojë funksionin e tij/saj të drejtorit. Mandati i Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm do të jetë tri (3) vjet dhe paga e tij/saj do të jetë për 15 % më e ulët se paga e Sekretarit të Përgjithshëm.

Rregulli 17
Personeli i Sekretariatit

(1) Sekretariati do të ketë personel të nevojshëm për t'i mundësuar atij të përmbushë funksionet në mënyrë efektive dhe efikase, brenda resurseve buxhetore të ndara për Gjykatën.
(2) Pas punësimit nga Gjykata, punëtorët e Sekretariatit janë personel administrativ. Sekretari i Përgjithshëm siguron që rekrutimi i personelit bazohet në kualifikime profesionale, në aftësi dhe në merita, dhe bëhet me konkurs të drejtë dhe të hapur, në pajtim me Ligjin.
(3) Statusi i stafit administrativ të parashikuar në nenin 12 të Ligjit zbatohet deri në atë masë sa ai status të mos ketë ndikim në pavarësinë e Gjykatës, të garantuar me nenin 112.2 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
(4) Në mënyrë që të ruhet pavarësia kushtetuese dhe juridike e Gjykatës dhe duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të Gjykatës në interpretimin kushtetues, rregullat e 9 përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil për rekrutimin e personelit, për pagat, për shtesat, për orarin e punës dhe për pushimet, nuk zbatohen.
(5) Me miratimin e gjyqtarëve, Sekretari i Përgjithshëm mund të kontraktojë ekspertë dhe profesionistë të tjerë për të kryer shërbime të caktuara për Gjykatën.
(6) Të gjithë të punësuarit në Sekretariat duhet të japin betimin dhe të veprojnë në pajtim me Kodin e etikës.

Rregulli 18
Këshilltarët juridikë

(1) Këshilltarët juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza. Këshilltarët juridikë ndihmojnë në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike, të krijuara nga Gjykata. Gjyqtarët përcaktojnë numrin e këshilltarëve juridikë që duhet punësuar, duke marrë parasysh nevojat e Gjykatës dhe resurset buxhetore në dispozicion.
(2) Këshilltarët juridikë nuk janë shërbyes civilë. Kushtet e kontratës së këshilltarëve juridikë përcaktohen nga Gjykata, në pajtim me ligjin përkatës.
(3) Për qëllime të këtij rregulli, me termin "ligj" nënkuptohen: Ligji për Gjykatën Kushtetuese (Nr. 03/L-121), Ligji i Punës (Nr. 03/L-212) dhe vendimet e Gjykatës.
(4) Niveli i pagës së këshilltarëve juridikë caktohet me vendim të Gjykatës në seancë administrative.
(5) Këshilltarët juridikë emërohen me shumicën e thjeshtë të votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, duke u bazuar në një proces transparent, të hapur dhe konkurrues të përzgjedhjes. Këshilltarët juridikë kanë statusin e këshilltarëve

profesionalë. Një këshilltar juridik mund të punësohet vetëm nëse përmbush këto kushte:
(a) të ketë përgatitje superiore shkollore në shkencat juridike, preferohen trajnime apo specializime në të drejtën kushtetuese, në të drejtat e njeriut, në të drejtën ndërkombëtare publike, ose ndonjë drejtim tjetër i së drejtës publike;
(b) të ketë së paku dy (2) vjet përvojë përkatëse profesionale në çështje juridike; dhe
(c) të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.
(6) Konkurset për postet e këshilltarëve juridikë shpallen së paku në tri (3) gazeta që shpërndahen gjerësisht në Kosovë. Aplikacionet për postet e këshilltarëve juridikë shqyrtohen nga kolegji përzgjedhës i përbërë nga tre gjyqtarë, të emëruar nga Kryetari. Komisioni përzgjedhës ua paraqet gjyqtarëve listën e personave që përmbushin kriteret e përcaktuara në paragrafin (3).
(7) Këshilltari juridik mund të shkarkohet, ose të suspendohet përkohësisht, me vendimin e shumicës së gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, në pajtim me legjislacionin përkatës.
(8) Këshilltarët juridikë mbikëqyren nga Këshilltari i parë juridik, të cilin e zgjedhin gjyqtarët nga radhët e këshilltarëve juridikë të punësuar në Gjykatë. Atij/asaj do t'i ndihmojnë dy Zëvendës të Këshilltarit të parë juridik, të cilët i emëron Kryetari i Gjykatës.
(9) Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik emërohen në bazë të 10 rotacionit nga këshilltarët juridikë, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Gjykata.
(10) Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik i raportojnë Kryetarit. Pas konsultimit me Kryetarin dhe me gjyqtarët, Këshilltari i parë juridik/Zëvendësit e Këshilltarit të parë juridik mund të shkarkohen nga funksioni, kurdoherë, me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë në seancë administrative.
(11) Mandati i Këshilltarit të parë juridik dhe zëvendësve të Këshilltarit të parë juridik është një (1) vit.
(12) Paga e Këshilltarit të parë juridik do të ketë rritje për 10 % gjatë kohës sa ai/ajo ushtron atë funksion; ndërsa paga e Zëvendës këshilltarëve do të jetë 5% më e ulët se sa ajo e Këshilltarit të parë juridik.
(13) Gjykata ka themeluar Njësinë Ligjore. Struktura dhe organizimi i Njësisë Ligjore, që përfshin pozitën e këshilltarëve juridikë dhe personelin tjetër ligjor, rregullohet më tutje me Udhëzimin për praktikat, të miratuar nga Gjykata.

Rregulli 19
Konfidencialiteti

Të gjithë gjyqtarët, Sekretari i Përgjithshëm, personeli i Sekretariatit dhe këshilltarët juridikë, nuk shprehin në publik kurrfarë komentesh dhe mendimesh përkitazi me çështjet që kanë të bëjnë me lëndët që i janë parashtruar ose që mund t'i parashtrohen Gjykatës, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore.

Rregulli 20
Buxheti dhe taksat

(1) Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Kryetarin, përgatit propozimin për buxhet dhe ia paraqet atë gjyqtarëve për shqyrtim dhe për miratim.
(2) Në seancë administrative, gjyqtarët shqyrtojnë, dhe, nëse është e nevojshme, e ndryshojnë dhe e miratojnë propozimin përfundimtar të buxhetit. Kryetari nënshkruan propozimin e miratuar të buxhetit, i cili dorëzohet nga Sekretari i Përgjithshëm në procedurë të mëtejshme, në pajtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
(3) Sekretari i Përgjithshëm ua propozon gjyqtarëve listën e tarifave për shërbimet administrative.

Rregulli 21
Bashkëpunimi i brendshëm dhe ndërkombëtar

(1) Nën udhëheqjen e Kryetarit, Gjykata vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet e tjera të themeluara në Kosovë, me gjykatat e huaja kushtetuese dhe me organizatat vendore e ndërkombëtare, të cilat janë aktive në lëmin e sundimit të ligjit.
(2) Bashkëpunimi duhet të zbatohet në atë mënyrë që e ruan pavarësinë e Gjykatës, siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Rregulli 22
Qasja në punën e Gjykatës

(1) Puna e Gjykatës është transparente, e hapur për publikun dhe me qasje në të deri në shkallën më të lartë të mundshme, në pajtim me Kushtetutën, në pajtim me Ligjin dhe me kriteret për ruajtjen e konfidencialitetit, përfshirë, por jo të kufizuar në:
(a) informimin e publikut për datën dhe për kohën e mbajtjes së dëgjimeve;
(b) ofrimin e informacioneve për rrjedhën e procedurës;
(c) lejimin e shikimit të dosjeve dhe të dokumenteve;
(d) botimin e aktgjykimeve dhe të vendimeve; dhe
(e) çfarëdo forme tjetër të komunikimit të përcaktuar nga Gjykata.
(2) Sekretari i Përgjithshëm boton aktgjykimet dhe vendimet në ueb-faqen e Gjykatës, menjëherë pas miratimit të tekstit përfundimtar të tyre dhe siguron botimin e rregullt të versioneve të shtypura të aktgjykimeve dhe të vendimeve.
(3) Sipas nevojës, Gjykata mund të lëshojë komunikata ose mund të mbajë konferenca për medie. Komunikatat për medie të Gjykatës lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm vetëm pas miratimit të përmbajtjes nga Kryetari. Gjyqtarët marrin kopjet e të gjitha komunikatave për medie sa më shpejt që të jetë e mundur.

Rregulli 23
Qasja në dosje dhe dokumente

(1) Palët kanë të drejtë të shikojnë dosjet dhe dokumentet zyrtare për lëndën në të cilën ata janë palë në procedurë, përveç nëse ajo dosje ose ai dokument është përcaktuar

nga Gjykata të jetë konfidencial. Palët kërkojnë shikimin e dokumentit së paku 24 orë më parë. Shikimi kryhet brenda objektit të Gjykatës, gjatë orarit të punës dhe në prani të personelit të Sekretariatit.
(2) Palët kanë të drejtë të marrin kopjet e dosjeve dhe të dokumenteve për lëndën në të cilën ata janë palë në procedurë, përveç nëse ajo dosje ose ai dokument është përcaktuar nga Gjykata të jetë konfidencial. Gjykata mund të caktojë taksë administrative për kopje të tilla.
(3) Raporti i Gjyqtarit raportues, projektvendimi i Kolegjit shqyrtues, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e gjyqtarëve, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të gjyqtarëve gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, si dhe materiali tjetër i përcaktuar nga Gjykata, duhet të jetë konfidencial dhe në të nuk do të kenë qasje as palët, e as publiku. Gjykata mund të autorizojë lëshimin e dokumentit konfidencial, në rast se përcakton që një gjë e tillë është e domosdoshme për interesin publik.

Rregulli 24
Informacionet për statusin e procedurës

Në bazë të kërkesës me shkrim nga cilido person, Sekretari i Përgjithshëm ofron informacione për statusin e procedurës para Gjykatës.

II. Dorëzimi i dokumenteve dhe afatet kohore

Rregulli 25
Adresa për dorëzimin e dokumenteve

(1) Adresë për dorëzimin e dokumenteve të palëve në procedurë është adresa e përfaqësuesit të asaj pale, ose, në rast se pala nuk është e përfaqësuar, adresa e vendbanimit të palës. Pala përcakton adresën për dorëzimin e dokumenteve në kërkesën e saj, ndërsa pala e kundërt përcakton adresën për dorëzimin e dokumenteve në përgjigjen e saj.
(2) Cilado palë mund të pajtohet që dorëzimi i dokumenteve të bëhet me telefaks ose me mjete të tjera elektronike të komunikimit. Në raste të tilla, pala i ofron Sekretariatit të gjitha informacionet e nevojshme për dorëzimin e dokumenteve, duke përdorur telefaksin ose mjetet e tjera elektronike të komunikimit.

Rregulli 26
Zbatimi i dorëzimit

(1) Në rastet kur ligji, ose kjo Rregullore e punës, kërkon që një dokument t'i dorëzohet palës, Sekretariati siguron që dërgimi i atij dokumenti bëhet në adresën e përcaktuar nga ajo palë, qoftë nëpërmjet:
(a) dërgesës së kopjes së dokumentit nëpërmjet postës së porositur, së bashku me formularin për nënshkrimin e marrjes së dokumentit, ose
(b) personalisht, nëpërmjet korrierit.

(2) Në rastet kur ky dorëzim mund të bëhet nëpërmjet telefaksit ose mjeteve të tjera për komunikim elektronik, çfarëdo dokumenti procedural, përveç aktgjykimit ose vendimit të Gjykatës, dërgohet nëpërmjet përcjelljes së kopjes së atij dokumenti me mjete të tilla. Në rast se dorëzimi nëpërmjet mjeteve elektronike nuk është praktik, dokumenti i dërgohet palës në pajtim me procedurën e përcaktuar në paragrafin (1) dhe pala njoftohet për këtë nëpërmjet telefaksit ose mjeteve të tjera elektronike të komunikimit.
(3) Konsiderohet se dokumenti është dorëzuar:
(a) në rast të dërgesës së kopjes së dokumentit nëpërmjet postës së porositur, në ditën kur marrësi ka vërtetuar pranimin e tij, ose në rast se ai/ajo ka refuzuar të pranojë dokumentin apo ta nënshkruajë vërtetimin për marrjen e dokumentit, ditën e pestë pas dërgesës së postës së porositur në zyrën postare;
(b) në rast të dërgesës të dokumentit nëpërmjet korrierit, ditën kur marrësi ka vërtetuar pranimin, ose në rast se ai/ajo ka refuzuar të pranojë dokumentin apo ta nënshkruajë vërtetimin për marrjen e dokumentit, ditën kur është tentuar të zbatohet dorëzimi. Personi, i cili e dorëzon dokumentin, mban shënim për pranimin ose për refuzimin e dokumentit;
(c) në rast të dërgimit të dokumentit nëpërmjet telefaksit ose mjeteve të tjera elektronike të komunikimit, ditën kur është përfunduar dhe kur është vërtetuar dërgimi i dokumenteve me sukses. Nëse dërgimi ka qenë i pasuksesshëm për shkak të gabimit të qëllimshëm të marrësit, atëherë dërgimi i dokumenteve përfundon dhe hyn në fuqi në ditën kur është bërë dhe kur është vërtetuar tentimi për të dërguar dokumentet.

Rregulli 27
Llogaritja e periudhës kohore

Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:
(1) Kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita në të cilën ndodh një ngjarje, mirëpo dita kur ndodh ajo ngjarje ose veprim nuk llogaritet se bën pjesë në atë periudhë;
(2) Kur periudha shprehet me javë, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të javës me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;
(3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;
(4) Kur periudha shprehet në muaj dhe në ditë, së pari llogariten muajt e plotë e pastaj ditët;
(5) Periudhat përfshijnë të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare;
(6) Ndryshe,, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.

III. Fillimi i procedurës

Rregulli 28
Fillimi i procedurës

Procedura para Gjykatës fillon me dorëzimin e kërkesës në Sekretariat. Pasi të jetë dorëzuar kërkesa, apo çfarëdo dokumenti fillestar, kërkesës i caktohet numri i regjistrimit të saj nga Sekretariati.

Rregulli 29
Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve

(1) Kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim, në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Kërkesa i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të përfshijë datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e parashtron atë.
(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
(a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën;
(b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka;
(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka;
(d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet;
(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;
(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;
(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla.
(4) Dokumentet mund të parashtrohen në cilëndo gjuhë zyrtare të Kosovës, ose në ndonjërën nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë. Kur dokumenti që i është bashkëngjitur kërkesës nuk është në njërën nga gjuhët zyrtare, ose në gjuhët në përdorim zyrtar, atëherë ai duhet të jetë i shoqëruar nga përkthimi i certifikuar në njërën nga këto gjuhë. Përkthimi mund të kufizohet në pjesë përkatëse të dokumentit, por, në këtë rast, përkthimi duhet të shoqërohet me një shpjegim që tregon se cilat pjesë të dokumentit janë përkthyer. Gjykata mund të kërkojë përkthim më të gjerë ose përkthim të plotë të dokumentit.
(5) Sekretariati duhet të krijojë procedurë për kontrollimin e saktësisë së përkthimeve të paraqitura.
(6) Kërkesa mund të parashtrohet personalisht në zyrën e Sekretariatit të Gjykatës, gjatë orarit të rregullt të punës, ose nëpërmjet postës apo mjeteve të komunikimit elektronik.
(7) Gjykata, për të ndihmuar palët në dorëzimin e kërkesës, duhet të përcaktojë formularin e kërkesës dhe duhet ta publikojë atë në ueb-faqen e vet.
(8) Përgjigjet në kërkesa duhet të parashtrohen nga palët kundërshtare në mënyrë të njëjtë, si dorëzimi i kërkesës, të përcaktuara në këtë rregull.

Rregulli 30
Regjistrimi i kërkesës dhe i përgjigjes

(1) Sekretari i Përgjithshëm e regjistron kërkesën menjëherë pasi të jetë dorëzuar ajo, apo çfarëdo dokumenti, madje edhe në rastet kur kërkesa nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme. Sekretariati mban një listë kontrolluese të dokumenteve të nevojshme dhe mund të ndihmojë palët duke shpjeguar se çfarë mungon në kërkesë.
(2) Nëse një kërkesë nuk përmban të gjitha dokumentet e nevojshme, Sekretariati e njofton parashtruesin e kërkesës se kërkesa duhet të plotësohet me dokumentet e specifikuara në kërkesë dhe e përcakton saktë se këto dokumente duhet të dorëzohen brenda afatit 30-ditësh.
(3) Sekretariati mban regjistrin në të cilin regjistrohen të gjitha kërkesat dhe përgjigjet, përfshirë këto të dhëna:
(a) datën dhe kohën e parashtrimit;
(b) emrin e personit ose të personave që e kanë parashtruar kërkesën;
(c) numrin e regjistrimit të caktuar të kërkesës;
(d) Gjyqtarin raportues, të caktuar për këtë kërkesë; dhe
(e) Kolegjin shqyrtues, të caktuar për këtë kërkesë.
(4) Për secilën kërkesë të regjistruar, Sekretariati krijon nga një dosje, e cila përmban të gjitha dokumentet dhe materialet e ndërlidhura me kërkesën, përgjigjen, nëse ka, dhe dokumentet e materialet e tjera të krijuara gjatë procedurës.

Rregulli 31
Përmirësimi i kërkesave dhe përgjigjeve

(1) Në çfarëdo kohe, para se Gjyqtari raportues të ketë paraqitur raportin e tij, pala, e cila e ka parashtruar kërkesën, ose Gjykata, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, mund të dorëzojë në Sekretariat përmirësimin e gabimeve teknike ose numerike në materialin e parashtruar.
(2) Sekretariati njofton palën tjetër për çfarëdo përmirësimesh që janë bërë.

Rregulli 32
Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.
(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.
(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj.
(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest.

(5) Sekretariati i njofton me shkrim të gjitha palët për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur përkitazi me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.

Rregulli 33
Emërimi i Gjyqtarit raportues

(1) Pas regjistrimit të kërkesës në Sekretariat, ajo duhet t'i përcillet Kryetarit, i cili emëron Gjyqtarin raportues, në pajtim me mënyrën e përcaktuar në rregullin 8. Sekretariati e njofton personin që ka parashtruar kërkesë dhe cilëndo palë kundërshtare ose cilëndo palë të interesuar për regjistrimin e kërkesës dhe për numrin e regjistrimit.
(2) Pas emërimit të Gjyqtarit raportues, Sekretariati menjëherë ia përcjell atij kërkesën, përfshirë edhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura. Pasi Sekretariati të marrë ndonjë përgjigje në kërkesë, përfshirë edhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura, do t'ia përcjell ato Gjyqtarit raportues.

Rregulli 34
Raporti i Gjyqtarit raportues

(1) Raporti i Gjyqtarit raportues përmban:
(a) përshkrimin e fakteve të rastit;
(b) paraqitjen e fakteve të kontestuara dhe të pakontestuara;
(c) indikacionin se cila palë bart barrën e të provuarit të fakteve të kontestuara;
(d) argumentet juridike të paraqitura nga të gjitha palët;
(e) vlerësimin fillestar për pranueshmërinë e kërkesës; dhe
(f) vlerësimin fillestar për aspektet kryesore juridike të kërkesës.
(2) Periudha kohore tridhjetë (30) ditë për dorëzimin e raportit nga Gjyqtari raportues, e përcaktuar në nenin 22.5 të Ligjit, nuk fillon derisa Gjyqtari raportues të mos ketë marrë nga dosja të gjitha dokumentet, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, përkthimin e të gjitha dokumenteve që duhet përkthyer.
(3) Gjyqtari raportues ia dorëzon raportin Sekretariatit, i cili ia përcjell Kolegjit shqyrtues një kopje të raportit dhe kopjet e shkresave të lëndës, të cilat përfshijnë kërkesën, çfarëdo përgjigjje ndaj saj dhe dokumentet e bashkëngjitura. Të gjithë gjyqtarët e tjerë marrin nga një kopje të raportit të përgatitur nga Gjyqtari raportues.

Rregulli 35
Kolegjet shqyrtuese

(1) Në secilin rast, Kolegji shqyrtues kryesohet nga kryesuesi i Kolegjit shqyrtues, në pajtim me dispozitat e rregullit 9.
(2) Kolegji shqyrtues mund të kërkojë nga pala që e parashtron kërkesën, ose nga pala që e parashtron përgjigjen, të paraqesin fakte, dokumente ose informacione shtesë, nëse kjo është e nevojshme për ta përcaktuar pranueshmërinë e kërkesës.
(3) Kolegji shqyrtues e dorëzon vendimin e tij për pranueshmërinë e kërkesës brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së raportit të Gjyqtarit raportues dhe dosjes së lëndës.

Nëse kërkohen informacione shtesë nga palët, aktvendimet dorëzohen brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të të gjitha informacioneve shtesë.
(4) Në rast se Kolegji shqyrtues konstaton që kërkesa është e papranueshme, kryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit projektaktvendimin, i cili përmban arsyet për papranueshmërinë e kërkesës dhe ia dërgon atë projektaktvendim Sekretariatit. Sekretari i Përgjithshëm ua përcjell të gjithë gjyqtarëve për shqyrtim të mëtejmë atë projektaktvendim, në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
(5) Nëse Kolegji shqyrtues konkludon se kërkesa është e pranueshme, kryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit projektaktvendimin, i cili përmban arsyet për pranueshmëri, dhe ia dërgon atë aktvendim Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm ua përcjell rekomandimin të gjithë gjyqtarëve.
(6) Nuk lejohen mendime mospajtuese me shkrim nga gjyqtari në Kolegjin shqyrtues, përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës.
(7) Gjyqtari, i cili kundërshton përfundimin e Kolegjit shqyrtues se kërkesa është e papranueshme, ia paraqet kundërshtimin e tij Sekretarit të Përgjithshëm brenda afatit kohor të përcaktuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Sekretari i Përgjithshëm i informon menjëherë gjyqtarët për kundërshtimin.

Rregulli 36
Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose
c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.
(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose
d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:
a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;
b) kërkesa është anonime;
c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;
d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;
e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;
f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
g) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën; ose
h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.

(4) Nëse kërkesa është e pakompletuar, ose nuk përmban informacione të domosdoshme për 18 zhvillimin e procedurave, Gjykata mund të kërkojë nga parashtruesi t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda 30 ditësh.
(5) Nëse parashtruesi, pa ndonjë arsye objektive, dështon t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda afatit të caktuar kohor të përcaktuar me paragrafin 5 të këtij rregulli, atëherë kërkesa do të procedohet.

Rregulli 37
Bashkimi dhe ndarja e kërkesave

(1) Sekretariati njofton Kryetarin dhe Gjyqtarin raportues se kërkesa mund të jetë e ndërlidhur, për nga çështja e trajtuar në të, me një kërkesë tjetër të parashtruar para Gjykatës, dhe të jetë e drejtuar kundër aktit të njëjtë të një autoriteti publik. Kryetari, me rekomandimin e Gjyqtarit raportues, mund të urdhërojë bashkimin e kërkesave të ndara.
(2) Nëse kërkesa trajton dy ose më shumë ligje, ose akte të tjera të autoritetit publik, Gjyqtari raportues e njofton Sekretariatin dhe Kryetarin. Me rekomandimin e Gjyqtarit raportues, Kryetari mund të urdhërojë shqyrtimin e ndarë të elementeve përkatëse të kërkesës, nëse shqyrtimi i tyre së bashku nuk favorizon një shqyrtim të drejtë dhe të shpejtë.
(3) Nëse pala nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës për t'i bashkuar ose për t'i ndarë kërkesat, ajo mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit, së bashku me çfarëdo argumenti faktik ose ligjor, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e urdhrit të Kryetarit për t'i bashkuar ose për t'i ndarë disa kërkesa.

Rregulli 38
Aktgjykimet testuese

(1) Kur paraqiten kërkesa të ngjashme, ose të njëjta, që janë rrjedhojë e të njëjtit veprim të kontestuar, Gjykata, me shumicë votash të gjyqtarëve, mund të zgjedhë njërën kërkesë ose më shumë kërkesa për t'i trajtuar me prioritet.
(2) Kur një kërkesë trajtohet si rast testues për aktgjykim, Gjykata mund ta pezullojë shqyrtimin e të gjitha rasteve të ngjashme, ose identike, për një periudhë të caktuar kohore. Palët në procedurat që janë pezulluar do të informohen për të gjitha zhvillimet në rastet testuese të aktgjykimeve dhe, në çdo kohë, Gjykata mund t'i rihapë kërkesat e pezulluara për shqyrtim të mëtutjeshëm.

IV. Seancat dëgjimore dhe shqyrtimet

Rregulli 39
E drejta në dëgjim dhe heqja dorë

(1) Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsyetimi të mirë.
(2) Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore, në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar provat.

(3) Seanca dëgjimore është publike, përveç nëse Gjykata urdhëron ndryshe, kur ka arsyetim të 19 mirë sipas Ligjit ose sipas kësaj Rregulloreje.

Rregulli 40
Orari i seancave dëgjimore

(1) Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Kryetarin, cakton seanca dëgjimore në mënyrë të duhur.
(2) Kryetari, me kërkesën e palës, e cila demonstron pse një kërkese duhet t'i jepet përparësi, dhe me miratimin e 2/3 të të gjithë gjyqtarëve, mund të urdhërojë që një kërkese t'i jepet përparësi për dëgjim ndaj të tjerave.

Rregulli 41
Pjesëmarrja në seancë dëgjimore

(1) Të gjitha seancat dëgjimore do të jenë të hapura për qytetarët, përveç kur Gjykata urdhëron përjashtimin e qytetarëve nga seanca, nëse një përjashtim i tillë kërkohet për sigurinë e ndonjërës nga palët ose të përfaqësuesve të tyre, apo për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.
(2) Çdo palë, përfaqësuesi, dëshmitari ose pjesëmarrësi tjetër në seancë dëgjimore, sjellja e të cilit ndaj gjyqtarit ose Sekretarit të Përgjithshëm nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës, ose i cili sillet në mënyrë fyese ndaj palës tjetër apo të ndonjë përfaqësuesi të palës tjetër, mund t'i shqiptohet vërejtje nga Kryetari dhe t'i jepet mundësia të mbrojë veten. Kryetari, në konsultim me gjyqtarët, mund të urdhërojë shqiptimin e masave disiplinore, përfshirë shqiptimin e gjobës, në pajtim me normat e vendosura nga Gjykata, ose, në raste të jashtëzakonshme, përjashtimin nga seanca dëgjimore.
(3) Kryetari mund ta përjashtojë një vëzhgues nga seanca, nëse sjellja e tij, ose e saj, nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës apo nëse ai ose ajo shkakton shqetësim në Gjykatë.

Rregulli 42
Njoftimi për seancë dëgjimore

(1) Palët do të ftohen në seancën e parë dëgjimore nëpërmjet një njoftimi me shkrim që u dërgohet nga Sekretariati, sipas mënyrës së përcaktuar në rregullin 26. Njoftimi përmban datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe u dërgohet palëve jo më vonë se dy javë para datës së mbajtjes së seancës, përveç nëse Gjykata cakton një periudhë më të shkurtër për shkaqe të urgjencës.
(2) Pas paraqitjes së kërkesës nga cilado palë, Kryetari mund të shtyjë seancën, nëse pala dëshmon se, për ndonjë arsye të rëndësishme, nuk mund të marrë pjesë në seancë. Palës tjetër mund t'i jepet mundësia të bëjë komente për atë kërkesë. Kryetari vendos nëse do të urdhërojë shtyrjen e seancës dëgjimore dhe Sekretariati i njofton palët me një vendim të tillë. Kur urdhëron shtyrjen e seancës, Kryetari mund të urdhërojë që pala, e cila ka bërë kërkesë, të paguajë shpenzimet që ajo palë ia ka shkaktuar palës tjetër ose palëve të tjera, si rezultat i kërkesës për shtyrje.

Rregulli 43
Procedura gjatë seancës dëgjimore

(1) Kryetari hap seancën dëgjimore dhe është përgjegjës për sjelljen e duhur gjatë seancës. Kryetari konstaton pjesëmarrjen e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, nëse ka.
(2) Gjykata siguron që, gjatë gjithë seancës, të jenë në dispozicion shërbimet e përkthimit, për cilëndo nga palët ose për përfaqësuesit që kërkojnë përkthim.
(3) Pala që është e përfaqësuar mund t'i drejtohet Gjykatës përmes përfaqësuesit, përveç nëse gjyqtari i bën ndonjë pyetje drejtpërsëdrejti palës.
(4) Palëve mund t'u jepet mundësia që shkurtimisht t'i paraqesin argumentet e tyre nëpërmjet prezantimeve verbale, duke i kufizuar ato prezantime vetëm në fakte dhe në çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me kërkesën. Kryetari mund t'ia kufizojë secilës palë periudhën kohore të caktuar për këtë prezantim.
(5) Gjatë seancës, gjyqtarët mund t'u parashtrojnë pyetje përfaqësuesve të palëve, ose drejtpërsëdrejti cilësdo palë.
(6) Pas deklaratave hyrëse, Gjykata mund të dëgjojë dhe të pranojë prova në pajtim me rregullat 45 – 53.
(7) Pas përfundimit të mbledhjes së provave, palëve do t'u jepet mundësia të paraqesin vërejtjet përmbyllëse përkitazi me faktet dhe me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me kërkesën. Kryetari mund të kufizojë kohën e paracaktuar të prezantimit për secilën palë.
(8) Kryetari shtyn seancën dëgjimore dhe cakton seanca shtesë, vetëm nëse të gjitha dëshmitë dhe parashtresat nuk kanë mundur të paraqiten në një seancë.
(9) Sekretari i Përgjithshëm siguron përpilimin e transkriptit dhe të procesverbalit, të cilat nënshkruhen nga Kryetari.

Rregulli 44
Këshillimet dhe votimi

(1) Pas përfundimit të seancës dëgjimore, sa më parë që të jetë e mundur, Gjykata do të tërhiqet për këshillim. Këshillimet e Gjykatës nuk janë të hapura për qytetarët dhe do të mbeten konfidenciale.
(2) Vetëm gjyqtarët mund të marrin pjesë aktive në këshillimet e Gjykatës. Sekretari i Përgjithshëm, Këshilltari i parë juridik dhe anëtarët e tjerë të personelit të Sekretariatit, ose këshilltarët juridikë, mund të jenë të pranishëm nëse një gjë të tillë e kërkon ndonjë gjyqtar dhe nëse kjo nuk kundërshtohet nga asnjë gjyqtar tjetër. Asnjë person që merr pjesë në këshillim, përveç gjyqtarëve, nuk do të marrë pjesë në këshillim ose të flasë nëse nuk i kërkohet nga ndonjë gjyqtar.
(3) Sekretari i Përgjithshëm përgatit procesverbalin e këshillimeve, ku regjistrohet vetëm titulli ose natyra e temave a e çështjeve të diskutuara dhe rezultatet e ndonjë votimi. Në procesverbal nuk do të regjistrohen as hollësitë e diskutimeve dhe as pikëpamjet e shprehura, mirëpo secili gjyqtar ka të drejtë të kërkojë që deklarata e tij të regjistrohet në procesverbal.
(4) Pas votimit, nëse Gjyqtari raportues është në mesin e shumicës së Gjykatës, Kryetari do t'ia 21 caktojë Gjyqtarit raportues detyrën e përgatitjes së tekstit

përfundimtar të vendimit të Gjykatës. Nëse Gjyqtari raportues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë cilindo gjyqtar nga shumica e Kolegjit shqyrtues për të përgatitur një projektvendim të Gjykatës. Nëse asnjë anëtar i Kolegjit shqyrtues nuk është në mesin e shumicës, Kryetari do të caktojë cilindo gjyqtar nga shumica për të përgatitur një projektvendim të Gjykatës.

V. Dëshmitë

Rregulli 45
Paraqitja e dëshmive nga palët

(1) Palët mund të paraqesin në Gjykatë dëshmitë e mëposhtme:
(a) emrin dhe adresën e dëshmitarit dhe përmbledhjen e dëshmisë që dëshmitari pritet ta japë;
(b) kërkesën për dëshminë dhe përmbledhjen e ekspertit, që paraqesin fakte të cilat duhet të përcaktohen nga raporti i ekspertit;
(c) kopjet e dokumenteve, ose gjësendet e tjera fizike, që përmbajnë informacione të rëndësishme për kërkesën;
(d) përshkrimin e dokumentit, ose të gjësendeve të tjera fizike, që përmbajnë informacione të rëndësishme për kërkesën, por që nuk janë në posedim ose në kontroll të palës, bashkë me identifikimin e personit që besohet të ketë në posedim ose në kontroll këtë dëshmi dhe arsyet pse besohet ashtu; ose (e) identifikimin e lokacionit që duhet vizituar, ose objektin që duhet inspektuar, bashkë me përshkrimin e dëshmisë që duhet të përcaktohet nga ajo vizitë ose inspektim.
(2) Mbledhja e dëshmive të rëndësishme për kërkesën që nuk krijon probleme të mëdha me faktet ose me ligjin, me një vendim të Gjykatës, mund t'i delegohet një gjyqtari të Gjykatës. Mbledhja e dëshmive nga gjyqtari duhet të bëhet në pajtim me këto rregulla.

Rregulli 46
Thirrjet e dëshmitarëve

(1) Gjykata urdhëron marrjen në pyetje në seancë dëgjimore të dëshmitarit të propozuar nga një palë, nëse pala paraqet ose dëshmon arsye të mjaftueshme për marrjen në pyetje të atij dëshmitari.
(2) Nëse Gjykata urdhëron marrjen në pyetje të një dëshmitari, ajo do ta lëshojë një urdhër që përmban:
(a) emrin e plotë dhe adresën e dëshmitarit;
(b) një tregues të fakteve për të cilat dëshmitari do të merret në pyetje; dhe 22 (c) datën, kohën dhe vendin e marrjes në pyetje.
(3) Nëse Gjykata vendos se pala ka paraqitur dëshmi të pamjaftueshme për thirrjen e dëshmitarit, Gjykata e informon atë palë me shkrim për arsyet e këtij vendimi.
(4) Dëshmitari mund të thirret, me kusht që, pala që kërkon thirrjen, të depozitojë në Sekretariat shumën që është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet që mund t'i bëjë dëshmitari. Nëse thirrja e dëshmitarit nuk kushtëzohet me një depozitim, Sekretariati i dërgon paraprakisht fondet e nevojshme për marrjen në pyetje të një dëshmitari të thirrur.

(5) Sekretariati ua dërgon palëve dhe përfaqësuesve urdhrat ose vendimet për dëshmitë.
(6) Dëshmitarët, që janë thirrur me kohë, duhet t'i përgjigjen thirrjes dhe të marrin pjesë në seancë dëgjimore. Nëse dëshmitari, që është thirrur me kohë, nuk paraqitet në seancë dëgjimore, Gjykata mund të ndëshkojë dëshmitarin me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro dhe mund të urdhërojë që dëshmitarit t'i dërgohen ftesa të tjera në shpenzime të dëshmitarit. Nëse dëshmitari i thirrur me kohë refuzon të dëshmojë, refuzon të japë betimin ose refuzon të japë deklaratën solemne pa ndonjë arsye të duhur, Gjykata mund të ndëshkojë dëshmitarin me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro.
(7) Nëse dëshmitari më pas paraqet një arsyetim të vlefshëm për mosparaqitje, ndëshkimi i vënë financiar mund të zvogëlohet ose mund të anulohet nga Gjykata. Dëshmitari mund të kërkojë nga Gjykata zvogëlimin e ndëshkimit financiar, nëse ai është në shpërpjesëtim me mjetet financiare të tij.

Rregulli 47
Dëshmia e dëshmitarëve

(1) Gjykata mund të urdhërojë që dëshmitarët të përjashtohen nga pjesëmarrja në seancë dëgjimore gjatë ndonjë prezantimi me gojë të palëve, të përfaqësuesve të tyre, ose gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të tjerë.
(2) Palët kanë të drejtë të jenë të pranishme gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.
(3) Dëshmitari ka të drejtë të refuzojë të dëshmojë për çështjet e mëposhtme:
(a) për çfarëdo që i është thënë dëshmitarit gjatë bisedës së mbrojtur me privilegj fetar;
(b) për çfarëdo që dëshmitari ka marrë vesh, ose për ndonjë këshillë të dhënë nga dëshmitari, në cilësinë e tij si avokat ose si mjek, apo gjatë ushtrimit të një profesioni ose të një aktiviteti tjetër, i cili nënkupton obligimin e njohur ligjor të ruajtjes së sekretit të informacioneve; dhe
(c) për faktet, ose për informacionet, që mund të inkriminojnë dëshmitarin, bashkëshortin/en e tij/saj, ose pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë dhe trashëgimtarët më të largët deri në brezin e tretë.
(4) Kur dëshmitari ftohet për të dhënë dëshmi, Kryetari fillimisht duhet të përcaktojë identitetin e dëshmitarit. Pastaj, Kryetari duhet ta informojë dëshmitarin për të drejtën e tij për të refuzuar dhënien e dëshmisë, siç përcaktohet në paragrafin 3, dhe për pasojat penale për dhënie të rrejshme të dëshmisë. Dëshmitarit mund t'i kërkohet të japë betimin solemn se dëshmia e dhënë është e saktë.
(5) Para dhënies së dëshmisë, dëshmitari jep betimin, ose deklaratën solemne, si në vijim: "Unë, emri, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do të tregoj të vërtetën, tërë të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës".
(6) Nëse dëshmitari refuzon pa arsye të japë dëshminë, ose refuzon të betohet atë deklarohet solemnisht, Gjykata mund t'i shqiptojë një gjobë në vlerë jo më të lartë se pesëqind (500) euro. Gjykata vendos se çfarë rëndësie, nëse ka, do t'i kushtohet dëshmisë së dëshmitarëve.
(7) Para se t'i bëhen pyetje dëshmitarit, ai paraqet një njoftim gojor për njohuritë e tij për faktet që janë objekt i marrjes së tij në pyetje.

(8) Kryetari dhe gjyqtarët mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, e pas tyre ndonjë palë që nuk e ka kërkuar marrjen në pyetje, e pastaj pala që e ka kërkuar marrjen në pyetje. Gjyqtarët mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit në çdo kohë gjatë dhënies së dëshmisë.
(9) Sekretari i Përgjithshëm siguron përpilimin e procesverbalit, i cili pasqyron në mënyrë të saktë dëshminë e secilit dëshmitar. Pastaj, procesverbali nënshkruhet nga Kryetari ose nga gjyqtari përgjegjës për marrjen në pyetje të dëshmitarit.

Rregulli 48
Ekspertët

(1) Gjykata angazhon ekspertë në këtë mënyrë:
(a) Pas kërkesës së palës që bart barrën e të provuarit për një fakt të caktuar, Gjykata mund ta caktojë një ekspert, i cili e përgatit raportin e ekspertit. Urdhri për caktimin e ekspertit përcakton fushëveprimin e punës së ekspertit dhe cakton afatet kohore brenda të cilave eksperti duhet t'ia paraqesë raportin Gjykatës.
(b) Çdo ekspert i caktuar, në mundësinë e tij të parë, do t'ia shpalosë Gjykatës konfliktet e mundshme të interesit që ai mund t'i ketë përkitazi me dëshminë e tyre.
(2) Një person nuk caktohet ekspert për një kërkesë në të cilin ai person:
(a) Ka qenë i përfshirë më përpara si përfaqësues ose si këshilltar;
(b) Ka vepruar në ndonjë kohë për njërën prej palëve të këtij rasti;
(c) Ka lidhje, qoftë familjare ose nëpërmjet martesës, me ndonjërën nga palët; ose
(d) Është apo ka qenë zyrtar, këshilltar politik, ose kontraktues i ndonjë subjekti që është palë në këtë rast.
(3) Eksperti i caktuar merr një kopje të urdhrit për caktimin e tij dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për punën e tij. Eksperti mbikëqyret nga Gjyqtari raportues, i emëruar për atë kërkesë, i cili mund të jetë i pranishëm gjatë hetimeve dhe i cili do të informohet për progresin e punës.
(4) Gjykata mund të kërkojë nga pala që kërkon ekspertin që t'i paguajë një depozitë Sekretariatit në shumën që do jetë e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me raportin e ekspertit.
(5) Eksperti jep mendimin e tij vetëm për çështjet dhe për faktet që i janë kërkuar atij në mënyrë të qartë.
(6) Eksperti ia paraqet raportin e tij Gjykatës, ndërsa Sekretariati u jep kopje të gjithë gjyqtarëve dhe ia dërgon nga një kopje të raportit secilës palë.
(7) Gjykata mund të urdhërojë marrjen në pyetje të ekspertit në seancë dëgjimore përkitazi me kërkesën, nëse palët janë njoftuar që eksperti do të dëshmojë. Të gjithë gjyqtarët dhe të gjitha palët mund t'i bëjnë pyetje ekspertit.
(8) Para se të merret në pyetje në seancë dëgjimore, ose para se ta japë dëshminë e tij, eksperti jep betimin ose deklaratën solemne para Gjykatës: "Unë, emri, betohem (ose deklaroj solemnisht) se e kam kryer detyrën time me vetëdije dhe në mënyrë të paanshme; se i kam dhënë Gjykatës kopjet e të gjitha dëshmive në të cilat unë e kam bazuar mendimin tim; se besoj që të gjitha faktet në të cilat unë e kam bazuar mendimin tim janë të vërteta; dhe se në mënyrë të ndershme dhe në mirëbesim e mbaj mendimin që e kam paraqitur dhe do ta paraqes në Gjykatë".
(9) Nëse eksperti refuzon pa arsyetim që të japë dëshminë ose të paraqesë raportin, apo refuzon të japë betimin ose deklaratën solemne, Gjykata mund ta ndëshkojë me

gjobë në vlerë prej jo më shumë se pesëqind (500) euro. Gjykata vendos se çfarë rëndësie, nëse ka, do t'i kushtohet dëshmisë së dëshmitarëve.

Rregulli 49
Vërejtjet kundër dëshmitarëve dhe ekspertëve

(1) Secila palë mund të bëjë vërejtje, duke iu drejtuar me shkrim Gjykatës, për rëndësinë ose për kompetencën e ndonjë dëshmitari a eksperti. Çdo vërejtje ndaj një dëshmitari, ose eksperti, mund të bëhet jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas dërgimit të urdhrit për thirrjen e dëshmitarit, ose për caktimin e ekspertit. Deklarata e vërejtjes duhet të paraqesë bazën specifike të vërejtjes përkitazi me rëndësinë dhe me kompetencën e dëshmitarit, ose të ekspertit, dhe të paraqesë dëshmi dhe argumente ligjore në mbështetje të vërejtjes.
(2) Gjykata njofton për këtë vërejtje palët e tjera, të cilat kanë të drejtë t'i paraqesin Gjykatës përgjigje me shkrim ndaj kërkesës. Gjykata merr vendim për kërkesën pas shqyrtimit të fakteve dhe të argumenteve të paraqitura në kërkesë dhe të ndonjë përgjigjeje të pranuar nga palët e tjera.

Rregulli 50
Kompensimi i dëshmitarëve dhe i ekspertëve

(1) Dëshmitarët e thirrur nga Gjykata dhe ekspertët e caktuar nga Gjykata kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e tyre të arsyeshme të udhëtimit. Sekretariati mund t'i paguajë paraprakisht dëshmitarët dhe ekspertët për shpenzime të tilla.
(2) Dëshmitarët e thirrur nga Gjykata kanë të drejtë kompensimi për fitimin e humbur. Ekspertët e caktuar nga Gjykata kanë të drejtë të paguhen me tarifa të arsyeshme për shërbimet e tyre. Sekretariati do t'ua paguajë dëshmitarëve, ose ekspertëve, kompensimin ose tarifën e tyre pas përmbushjes së obligimeve. Lartësia e pagesave përcaktohet nga Gjykata.

Rregulli 51
Dokumentet

(1) Një dokument për një rast është i pranueshëm nëse ai është autentik dhe i rëndësishëm për 25 kërkesat e bëra në atë rast. Vlera dëshmuese e një dokumenti të pranueshëm do të përcaktohet nga Gjykata gjatë vlerësimit të të gjitha dëshmive të rastit.
(2) Pala mund të ofrojë dëshmi, duke paraqitur dokumente që janë në posedim të palës. Nëse pala që bart barrën e të provuarit të ndonjë fakti posedon një dokument, i cili përmban dëshmi për atë fakt, pala duhet ta paraqesë atë dokument si shtojcë të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë që në seancë të paraqitet dokumenti origjinal.
(3) Nëse dëshmia për një fakt gjendet në një dokument, të cilin nuk e posedon pala që e ka barrën për të ofruar dëshmi, ajo palë mund të bëjë kërkesë me shkrim që pala tjetër në atë rast të sjellë një kopje të vërtetuar të dokumentit, nëse pala kërkuese ka arsye të besojë se pala tjetër e posedon atë dokument. Një kopje e asaj kërkese paraqitet në Gjykatë.

(4) Nëse pala, që e ka pranuar kërkesën sipas paragrafit (3), refuzon ta paraqesë dokumentin ose nuk i përgjigjet kërkesës brenda një kohe të arsyeshme, pala që e kërkon atë mund të kërkojë nga Gjykata të urdhërojë palën tjetër ta paraqesë atë dokument. Gjykata e urdhëron palën tjetër ta paraqesë dokumentin, nëse ajo mendon se dokumenti është në posedim të palës dhe nëse paraqitja e tij është në interes të drejtësisë. Nëse pala e urdhëruar nga Gjykata që ta paraqesë dokumentin nuk e bën këtë gjë pa ndonjë arsyetim të pranueshëm, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro, ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër. Po ashtu, Gjykata mund ta heqë një pjesë, tërë kërkesën, ose përgjigjen, nëse konsideron se një gjë e tillë është e duhur për shkak të rrethanave.
(5) Nëse pala, që bart barrën e të provuarit të një fakti, ka arsye të besojë se ky fakt gjendet në një dokument që është në posedim të një personi që nuk është palë në procedurë, atëherë ajo palë mund të bëjë kërkesë që Gjykata të urdhërojë atë person që nuk është palë në procedurë ta paraqesë atë dokument. Gjykata do ta urdhërojë atë person ta paraqesë dokumentin, nëse ajo mendon se dokumenti është në posedim të atij personi dhe nëse paraqitja e tij është në interes të drejtësisë. Nëse personi i urdhëruar nga Gjykata që ta paraqesë dokumentin nuk e bën këtë gjë pa ndonjë arsyetim të pranueshëm, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro, ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër.

Rregulli 52
Inspektimi i vendit të ngjarjes ose i objektit

(1) Nga palët mund të kërkohet një vizitë ose një inspektim në vendin e ngjarjes, kur fakti që duhet të dëshmohet nuk mund të dëshmohet me marrjen në pyetje të dëshmitarit, me raportet e ekspertëve, ose me paraqitjen e dokumenteve.
(2) Dëshmitë nëpërmjet vizitës në vendin e ngjarjes, ose nëpërmjet inspektimit të një objekti, ofrohen nga pala që bart barrën e të provuarit të ndonjë fakti që mund të dëshmohet nëpërmjet një vizite në vendin e ngjarjes ose nëpërmjet inspektimit të objektit.
(3) Nëse vendi i ngjarjes ose objekti është në posedim të një personi që nuk është palë në procedurë, pala që bart barrën e të provuarit duhet të kërkojë nga Gjykata një urdhër ku kërkohet që ai person të lejojë qasjen në vendin e ngjarjes, ose në objektin përkatës. Gjykata e jep ketë urdhër nëse vizita në vendin e ngjarjes ose inspektimi i objektit është medoemos në interes të drejtësisë. Nëse personi i urdhëruar nga Gjykata, pa ndonjë arsyetim të pranueshëm, nuk lejon qasje në vendin e ngjarjes ose në dokumente, Gjykata mund ta ndëshkojë me gjobë në vlerë jo më shumë se pesëqind (500) euro, ose mund të urdhërojë ndonjë masë tjetër.

Rregulli 53
Amicus Curiae

Gjykata, nëse e konsideron të nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin, mund të thërrasë ose t'i sigurojë pushim një organizate ose një personi për t'u paraqitur para saj dhe për të dhënë deklaratë me gojë ose me shkrim për ndonjë çështje të specifikuar nga Gjykata.

VI. Masat e përkohshme

Rregulli 54
Kërkesa për masa të përkohshme

(1) Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.
(2) Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet me shkrim, duhet të përshkruajë faktet përkitazi me kërkesën, argumentet për të mbështetur kërkesën, masat e kërkuara dhe pasojat e parashikuara në mënyrë të arsyeshme nëse kërkesa miratohet. Pala që kërkon masën e përkohshme mund t'i bashkëngjisë kërkesës edhe dokumente dhe dëshmi të tjera që janë të rëndësishme dhe që e mbështesin kërkesën.
(3) Sekretari do t'u dërgojë të gjithë gjyqtarëve dhe palëve të tjera përkatëse nga një kopje të kërkesës.

Rregulli 55
Vendimi për masa të përkohshme

(1) Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave të tjera.
(2) Kryetari do t'ia caktojë kërkesën për masë të përkohshme Kolegjit shqyrtues të caktuar për atë kërkesë, nëse nuk është caktuar akoma ndonjë kolegj shqyrtues. Kryetari e cakton një kolegj shqyrtues me anë të shortit. Nëse ndonjë gjyqtar në Kolegjin shqyrtues nuk është në dispozicion për shqyrtim të shpejtë, Kryetari e cakton një kolegj të ri me anë të shortit.
(3) Kolegji shqyrtues mund të kërkojë fakte, dokumente ose informacione shtesë, nga pala që kërkon masën e përkohshme dhe mund të kërkojë përgjigje ose fakte, dokumente ose informacione shtesë, nga palët e tjera të përfshira në rast. Kolegji shqyrtues nuk merr vendim pa ua dhënë mundësinë palëve të treta, për aq sa është e mundur, për t'i paraqitur pikëpamjet e tyre sa i përket kërkesës për masë të përkohshme.
(4) Brenda shtatë (7) ditësh, Kolegji shqyrtues i rekomandon me shkrim Gjykatës nëse duhet të pranohet kërkesa për masë të përkohshme, tërësisht ose pjesërisht, ose e njëjta duhet të refuzohet. Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:
(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;
(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe
(c) masa e përkohshme është me interes publik. Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.

(5) Nëse kërkesa për masë të përkohshme pranohet, qoftë tërësisht ose pjesërisht, vendimi i Kolegjit shqyrtues do të paraqesë arsyet për të mbështetur vendimin dhe si janë përmbushur standardet ligjore, dhe do të paraqesë kohën e kufizuar gjatë të cilës masa e përkohshme do të jetë në fuqi. Nuk mund të merret vendim për masë të përkohshme, përveç nëse specifikohet data e skadimit të tij. Sidoqoftë, data e skadimit mund të zgjatet me vendim tjetër të Gjykatës. Nëse ende nuk është vendosur për pranueshmëri, vendimi do të përcaktojë se masa e përkohshme do të skadojë menjëherë nëse Gjykata vendos se kërkesa është e papranueshme.
(6) Sekretari i Përgjithshëm ua përcjell këtë rekomandim të gjithë gjyqtarëve. Rekomandimi i Kolegjit shqyrtues për aplikimin e masës së përkohshme bëhet vendim i Gjykatës, përveç nëse një ose më shumë gjyqtarë ia paraqesin ndonjë vërejtje Sekretarit të Përgjithshëm brenda tri (3) ditësh. Nëse një ose më shumë gjyqtarë e kundërshtojnë rekomandimin, kërkesa do t'i dërgohet Gjykatës për shqyrtim.
(7) Kryetari, sipas detyrës zyrtare, mund të kërkojë nga palët informacione shtesë, apo të caktojë seancë dëgjimore, ose kur një gjë e tillë kërkohet nga ana e një apo më shumë gjyqtarëve të Gjykatës, ose Gjykata mund të diskutojë dhe të vendosë kërkesën për masë të përkohshme pa seancë dëgjimore. Gjatë marrjes së vendimit për të pranuar ose për të refuzuar kërkesën për masë të përkohshme, Gjykata duhet të zbatojë standardet ligjore të përcaktuara në ketë rregull.
(8) Me kërkesë të palës, ose sipas detyrës zyrtare, Gjykata, në çdo kohë para gjykimit të fundit, mund të revokojë apo të modifikojë çdo vendim që ka të bëjë me masat e përkohshme, nëse një revokim ose modifikim i tillë arsyetohet nga ndryshimi i situatës. Çdo palë që kërkon një revokim ose ndryshim të tillë, duhet të specifikojë ndryshimin e situatës në të cilën ajo e mbështet atë ndryshim. Para marrjes së vendimit për pranimin ose për refuzimin e kërkesës për revokim a për ndryshim të tillë, ose para se të veprojë ex officio, Gjykata do t'u japë mundësi palëve të paraqesin pikëpamjet e tyre për çështjen.
(9) Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga Gjykata, masa e përkohshme që caktohet nga Gjykata gjatë procedurës për një kërkesë skadon kur Gjykata lëshon aktgjykimin përfundimtar për atë kërkesë.

VII. Vendimet

Rregulli 56
Llojet e vendimeve

Gjykata miraton këto lloje të vendimeve:
(1) Aktgjykimet, kur Gjykata vendos në bazë të meritave të një kërkese;
(2) Aktvendimet, kur vendos për pranueshmërinë e një kërkese;
(3) Vendimet, kur Gjykata vendos përkitazi me kërkesat për masë të përkohshme;
(4) Vendimet administrative, sa herë që Gjykata vendos në seanca administrative për çështje administrative; dhe
(5) Urdhra të tjerë të atillë që kohë pas kohe konsideron si të duhur.

Rregulli 57
Përmbajtja e vendimeve

(1) Aktgjykimet, aktvendimet, vendimet ose urdhrat e tjerë të Gjykatës Kushtetuese do të përmbajnë minimumin e të dhënave, si në vijim: emrat e gjyqtarëve të Gjykatës; një hyrje, një deklaratë për bazën juridike për vendosje të rastit; një deklaratë që përmban arsyetimin e Gjykatës; dhe dispozitat operative.
(2) Deklarata e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, që miraton aktgjykimin, aktvendimin, vendimin ose urdhër tjetër, do të theksojë rezultatin e votimit dhe emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që kanë paraqitur mendime të tjera.
(3) Pjesa hyrëse do të theksojë emrat e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë ose të personave të autorizuar nga palët, nëse ka, datën e seancës publike, nëse është mbajtur, dhe datën e seancës kur është miratuar vendimi.
(4) Deklarata që përmban arsyetimin e Gjykatës do të ketë një përmbledhje të fakteve dhe të pretendimeve të pjesëmarrësve në procedurë dhe arsyet për vendimin e Gjykatës.
(5) Dispozitat operative do të theksojnë mënyrën e zbatimit të aktgjykimit, të aktvendimit, të vendimit ose të urdhrit tjetër, datën e hyrjes në fuqi të vendimit dhe palën të cilës i dorëzohet vendimi.
(6) Aktgjykimet, aktvendimet dhe vendimet i nënshkruan Kryetari i Gjykatës dhe Gjyqtari raportues.
(7) Në rastet kur një gjyqtar nuk ka mundësi të nënshkruajë vendimin e Gjykatës për shkak të përfundimit të mandatit, të pushimit, të dorëheqjes, të shkarkimit apo të përjashtimit, aktgjykimin apo aktvendimin e nënshkruan Kryetari i Gjykatës dhe gjyqtari kryesues i Kolegjit shqyrtues apo anëtari tjetër më i vjetër i Kolegjit shqyrtues.

Rregulli 58
Mendimet mospajtuese

(1) Gjyqtari i Gjykatës ka të drejtë të përgatisë një mendim mospajtues me aktgjykimin e Gjykatës, mbi bazë të ligjshmërisë së kërkesës. Gjyqtarët e tjerë mund t'i bashkëngjiten mendimit mospajtues, i cili duhet të shpjegojë arsyet përse gjyqtari nuk pajtohet me mendimin e shumicës së Gjykatës. Për aq sa është e mundur, mendimi mospajtues ndaj një aktgjykimi të Gjykatës paraqitet së bashku me aktgjykimin, bëhet pjesë e dosjes së lëndës, botohet së bashku me aktgjykimin dhe u dërgohet palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin.
(2) Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim mospajtues për vendimin e Gjykatës sa i përket masës së përkohshme. Çdo gjyqtar ka të drejtë të cekë në vendim se ka votuar kundër masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata.
(3) Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim mospajtues për aktvendimin e Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës. Secili gjyqtar ka të drejtë të cekë në aktvendim se nuk është pajtuar me aktvendimin për pranueshmërinë e kërkesës.

Rregulli 59
Mendimi konkurrues

(1) Gjyqtari i Gjykatës ka të drejtë të përgatisë një mendim konkurrues me aktgjykimin e Gjykatës, mbi bazë të ligjshmërisë së kërkesës. Mendimi konkurrues nënkupton pajtimin me aktgjykimin e Gjykatës, por jo edhe me arsyetimin e dhënë. Prandaj, një mendim konkurrues mund të shkruhet nga një gjyqtar, i cili voton njëjtë me shumicën, duke mbështetur vendimin e Gjykatës. Gjyqtarët e tjerë mund t'i bashkohen mendimit konkurrues dhe në mënyrë specifike duhet t'i shpjegojnë arsyet pse gjyqtari pajtohet me rezultatin, por nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë nga shumica e Gjykatës. Për aq sa është e mundur, një mendim konkurrues me aktgjykimin e Gjykatës paraqitet së bashku me aktgjykimin, bëhet pjesë e dosjes së lëndës, botohet me aktgjykimin dhe u dërgohet palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin.
(2) Gjyqtari i Gjykatës nuk ka të drejtë të përgatisë mendim konkurrues ndaj vendimeve ose ndaj aktvendimeve të Gjykatës, por mund të tregojë se ka mendim konkurrues vendimin ose për aktvendimin.

Rregulli 60
Teksti përfundimtar i aktgjykimit dhe arkivimi

(1) Teksti përfundimtar i një vendimi të miratuar nga Gjykata përgatitet nga Gjyqtari raportues. Nëse Gjyqtari raportues nuk pajtohet me aktgjykimin, ose me kryesuesin e Kolegjit shqyrtues, dhe voton kundër masës së përkohshme, Kryetari përcakton një gjyqtar tjetër i cili ka votuar me shumicën për të përgatitur aktgjykimin ose vendimin e Gjykatës.
(2) Gjyqtari, i cili përgatit aktgjykimin, aktvendimin ose vendimin e Gjykatës, përfshirë edhe vendimin për masë të përkohshme, duhet të finalizojë tekstin e aktgjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është përcaktuar nga Gjykata, nga data e miratimit nga Gjykata. Teksti përfundimtar u dorëzohet gjyqtarëve për rishikim dhe secili gjyqtar mund t'i japë komentet e veta brenda pesë (5) ditësh. Pasi të shqyrtohet nëse do të bëhen ose nuk do të bëhen ndryshimet e sugjeruara nga gjyqtarët e tjerë, gjyqtari, i cili e përgatit aktgjykimin e Gjykatës, i bën ndryshimet e nevojshme. Teksti përfundimtar u dorëzohet gjyqtarëve, të cilët mund të takohen për të miratuar versionin përfundimtar, ose ndryshe mund të përcaktohen për miratimin e versionit përfundimtar të tekstit. Pas miratimit përfundimtar nga gjyqtarët, teksti përfundimtar dorëzohet për nënshkrim, për arkivim dhe për dorëzim te palët.
(3) Gjyqtarët, që përgatisin mendim mospajtues ose konkurrues, duhet ta finalizojnë tekstin e mendimeve të tyre brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i tekstit përfundimtar te Kryetari. Për aq sa është e mundur, mendimet e tilla do të arkivohen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe do t'u dërgohen palëve në të njëjtën kohë me aktgjykimin e Gjykatës.

Rregulli 61
Përmirësimi i aktgjykimeve dhe vendimeve

(1) Gjykata, ex officio, ose pas kërkesës nga pala, e cila bëhet brenda dy javësh nga dërgimi i 30 aktgjykimit apo i vendimit, mund ta korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik që është bërë në aktgjykim ose në vendim.
(2) Urdhri për korrigjim i bashkëngjitet origjinalit të aktgjykimit ose vendimit të korrigjuar.

Rregulli 62
Kërkesa për shqyrtim

Kur parashtron kërkesë për shqyrtim të ligjit, të aktit, të rregullores ose të statutit komunal, siç është përcaktuar nën Nenin 113, paragrafi 2, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të specifikojë dispozitën ose dispozitat e instrumentit normativ të kontestuar.

VIII. Dispozitat e veçanta për procedura, të caktuara sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 63
Zbatimi i vendimeve

(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
(2) Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
(3) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.
(4) Gjykata Kushtetuese mund të specifikojë, me vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(5) Organi i obliguar të zbatojë vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informacionet, nëse kërkohet dhe ashtu si kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës.
(6) Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare.
(7) Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.
(8) Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 44 e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës me rekomandimin për procedurat e mëtejmë ligjore që duhet të ndërmerren.

Rregulli 64
Masa e përkohshme

Gjykata mund të urdhërojë, ex officio, ose me kërkesën e palës, si masë të përkohshme, që efektet e instrumentit normativ, i cili kundërshtohet, ose ndonjë pjesë e tij, të pezullohen deri sa Gjykata të marrë vendim për atë kërkesë, në pajtim me pjesën VI të kësaj Rregulloreje.

Rregulli 65
Aktgjykimi

(1) Nëse Gjykata përcakton se dispozita të caktuara të instrumentit normativ nuk janë në pajtim me Kushtetutën, ajo do t'i shpallë ato dispozita të pavlefshme.
(2) Gjykata shpall tërë ligjin, aktin, rregulloren ose statutin komunal të pavlefshëm, në rast se përcakton se instrumenti normativ nuk përmbush qëllimin legjislativ ose, në ndonjë mënyrë tjetër, është i pakuptimtë pa dispozitat të cilat janë përcaktuar të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.

Rregulli 66
Efektet ligjore të aktgjykimit

(1) Legjislacioni sekondar dhe aktet administrative që janë nxjerrë në bazë të dispozitës së ligjit, rregullores ose statutit komunal që është shfuqizuar nga Gjykata, nuk zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të aktgjykimit.
(2) Nëse Gjykata ka nxjerrë një vendim për një lëndë penale, në bazë të dispozitës së ligjit, rregullores ose statutit komunal që është shpallur jokushtetues, personi kundër të cilit është nxjerrë vendimi mund të rihapë procedurën në lëndën penale.

Rregulli 67
Kërkesa

(1) Kur parashtron kërkesën në pajtim me nenin 113, paragrafi 3, pika 1, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Kosovës.
(2) Pala e autorizuar duhet të identifikojë aktin, i cili supozohet se shkel kompetencën e saj dhe dispozitën përkatëse të Kushtetutës, e cila është shkelur nga një akt i tillë.

Rregulli 68
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm njofton autoritetin akti i të cilit është sfiduar nga pala e autorizuar për parashtrimin e kërkesës. Për të parashtruar përgjigjen në kërkesë, pala kundërshtare ka deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e njoftimit, përveç nëse ekziston arsyetim i mirë për një përgjigje më të mëvonshme.

Rregulli 69
Kërkesa

Kur parashtrimi i kërkesës bëhet sipas nenit 113, paragrafi 3, pika 2, të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të deklarojë në mënyrë të qartë përse referendumi nuk është në pajtim me Kushtetutën.

Rregulli 70
Aktgjykimi

(1) Nëse Gjykata konkludon në aktgjykimin e saj se, në një kërkesë të parashtruar sipas nenit 113.4 të Kushtetutës, propozimi për ndryshimin e Kushtetutës është shkelje e marrëveshjeve ndërkombëtare që janë obliguese për Kosovën ose të cilat janë ratifikuar në bazë të Kushtetutës, respektivisht të dispozitave të Kushtetutës për procedurën që duhet zhvilluar për ndryshimin e Kushtetutës, atëherë Gjykata urdhëron që propozimi të mos miratohet nga Kuvendi i Kosovës.
(2) Gjykata, në aktgjykimin e saj, mund të këshillojë për llojin e modifikimeve që mund t'i bëhet një propozimi, në mënyrë që propozimi për ndryshimin e Kushtetutës të jetë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare që janë obliguese për Kosovën ose që janë ratifikuar në bazë të Kushtetutës, respektivisht të dispozitave të përcaktuara në Kushtetutë për procedurën që duhet zhvilluar për ndryshimin e Kushtetutës.

Rregulli 71
Njoftimi

(1) Pas parashtrimit të kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, Gjykata menjëherë e njofton Kryetarin dhe i dërgon një kopje të kërkesës Presidentit të Kosovës brenda tri (3) ditësh nga parashtrimi i saj në Gjykatë.
(2) Gjykata kërkon nga Presidenti i Kosovës të përgjigjet ndaj kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës te Presidenti i Kosovës, përveç nëse ekziston arsyetim i mirë për një përgjigje më të vonshme.

Rregulli 72
Anulimi i procedurës

Gjykata anulon procedurat e filluara sipas nenit 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, në rast se, para lëshimit të aktgjykimit, Presidenti ka dhënë dorëheqje ose e ka përfunduar mandatin.

Rregulli 73
Tërheqja

Në rast se pala e autorizuar e tërheq kërkesën, Kryetari mund të kërkojë nga Gjykata të vazhdojë procedurën dhe të lëshojë aktgjykimin. Kërkesa e tillë përcaktohet nga Gjykata me shumicën e votave të gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

Rregulli 74
Aktgjykimi

(1) Në rast se kërkesa është bërë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nëse Gjykata përcakton se një gjykatë ka lëshuar vendim duke shkelur Kushtetutën, ajo do ta shpallë të pavlefshëm atë vendim dhe do t'ia kthejë atë gjykatës që e ka lëshuar për shqyrtim, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës.
(2) Në rast se Gjykata ka përcaktuar që një ligj ka shkelur Kushtetutën, atëherë ajo duhet të shpallë të pavlefshëm ligjin, në pajtim me dispozitat e rregullit 64 dhe të rregullit 65 të kësaj Rregulloreje.

Rregulli 75
Parashtrimi i kërkesës

(1) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.
(2) Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.
(3) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

Rregulli 76
Njoftimi

Gjykata, pas parashtrimit të kërkesës, e urdhëron gjykatën që të pezullojë ndonjë procedurë që është duke u zhvilluar përkitazi me rastin në fjalë, derisa Gjykata të ketë lëshuar një vendim.

Rregulli 77
Aktgjykimi

Rregulli 64 dhe rregulli 65 zbatohen njëlloj për kërkesat e filluara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës.

Rregulli 78
Pranueshmëria për shqyrtim

Edhe kur një çështje është e pranueshme, Gjykata mund të përcaktojë nëse do të pranojë për shqyrtim një çështje të parashtruar nga Zëvendëskryetari i kuvendit komunal, në pajtim me nenin 62, paragrafi 4, të Kushtetutës. Zëvendëskryetari i kuvendit komunal që parashtron çështjen, duhet të deklarojë në mënyrë precize të drejtat e garantuara kushtetuese që janë shkelur. Gjykata, me shumicën e votave të

gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë, përcakton nëse do të pranojë një çështje për shqyrtim.

Rregulli 79
Shqyrtimi nga Gjykata

Nëse Gjykata pranon për shqyrtim një çështje të referuar sipas nenit 62, paragrafi 4, të Kushtetutës, atëherë ajo e trajton kërkesën në mënyrën e përcaktuar sipas kësaj Rregullore për të gjitha kërkesat. Në këtë rast, aplikohen rregulli 64 dhe rregulli 65, njëlloj për të gjitha kërkesat e iniciuara sipas nenit 62.4 të Kushtetutës...

IX. Dispozitat përfundimtare

Rregulli 80
Ndryshimet

Kjo Rregullore e punës mund të ndryshohet me propozimin e së paku dy osë më shumë gjyqtarëve dhe me miratim më shumicë të votave të të gjithë gjyqtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

Rregulli 81
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e punës hyn në fuqi pas miratimit të saj me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë dhe pesëmbëdhjeëe (15) ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare.

Rregullore e punës, 11f. 126-3/2013
17 qershor 2013

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

INDEKSI/LISTA E FJALËVE KYÇE

A

Adresa për dorëzimin e dokumenteve, Rregulli 25
Adresat e palëve, Rregulli 25
Amicus Curiae, Rregulli 53
Auditimi, i brendshëm, Rregulli 15
Autorizimi i lëshimit të dokumenteve konfidenciale, Rregulli 23
Amendamentet kushtetuese të propozuara në Kuvend, kontrolli i Gjykatës, Procedurë e veçantë 12, lidhur me Nenin 113.9 të Kushtetutës, Neni 54
Ankesat individuale, Rregulli 64, 65, 74
Auditimi i brendshëm, Rregull 15
Aktgjykim, në bazë të meritave të një kërkese, Rregulli 56
Aktgjykim, përgatitja e tekstit përfundimtar, Rregulli 60
Aktgjykimet dhe vendimet, botimi, Rregulli 22
Arsyetimi, procedural dhe substantiv, Rregulli 29
Analizë ligjore, Rregulli 18
Aktgjykimet testuese, Rregulli 38
Autorizimi për përfaqësuesin ligjor, Rregulli 29
Aktvendim, për pranueshmërinë e kërkesës, Rregulli 56

B

Buxheti dhe taksat, Rregulli 20
Buxheti i Gjykatës, Rregulli 14
Buxheti, menaxhimi i pavarur në Gjykatë, Neni 14
Buxheti, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, Neni 14
Bashkëpunimi me organet tjera publike, Rregulli 26
Bashkëpunimi, kombëtar dhe ndërkombëtar, Rregulli 14
Bashkëpunimi i brendshëm dhe ndërkombëtar, Rregulli 21
Betimi, refuzimi për të bërë, Rregulli 47
Betimi, personeli i Sekretariatit, Rregulli 17
Betimi, gjyqtarët, Neni 7
Bashkimi i kërkesave, Rregulli 37
Botimi i aktgjykimeve dhe vendimeve, Rregulli 22

Ç

Çështjet administrative, Rregulli 56
Çështjet kontraktuese, Sekretariati dhe këshilltarët juridikë, Rregulli 14

D

Delegimi i detyrave nga Kryetari te Zëvendëskryetari, Neni 11
Dinjiteti i Gjykatës Kushtetuese, Neni 10, Rregulli 41
Dokumentacion, informacione, mbështetëse, Rregulli 29
Dokumentet, Rregulli 51
Dokumentet, autentik dhe të rëndësishëm, Rregulli 51
Dokumentet, mosparaqitje, Rregulli 51
Dokumentet, ndëshkim me gjobë financiare, Rregulli 51
Dokumentet, vlerën dëshmuese përcakton Gjykata, Rregulli 51
Dokumentet, paraqitja nga palët, Rregulli 51
Dokumentet, paraqitja nga pala e tretë, Rregulli 51
Dokumentet, heqja e kërkesës ose e përgjigjes ose të një pjese, Rregulli 51
Detyrat e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Neni 11
Detyrat e gjyqtarëve, Neni 10

Detyrat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Neni 11
Dëshmitë, refuzimi i dhënies, Rregulli 47
Dosje dhe dokumente, lejimi i shikimit, Rregulli 22
Diskutueshme (pa objekt shqyrtimi), Rregulli 32
Dispozitat operative të Aktgjykimit, Aktvendimit dhe Vendimit ose urdhrave të tjerë, Rregulli 57
Dispozitat procedurale të Gjykatës, mungesa, Neni 16
Dorëzimi i dokumenteve, Rregulli 4, 26
Dorëheqja e gjyqtarëve, Rregulli 5, 9
Dorëheqja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, Rregulli 11
Deklarata hyrëse në seancë dëgjimore, Rregulli 43
Dëshmia e dëshmitarit, Rregulli 47
Dëshmitari dhe eksperti, kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, Rregulli 50
Dërgimi i fondeve të nevojshme për dëshmitarin e thirrur, Rregulli 46
Dëshmitari, ruajtja e sekretit të dëshmisë, Rregulli 47
Dëshmitari, përjashtimi nga dëgjimi, Rregulli 47
Dëshmitari, arsyetimi për mospjesëmarrje, Rregulli 46
Dëshmitari, dëshmia e rrejshme, Rregulli 47
Dëshmitari, gjoba për mosparaqitje, Rregulli 46
Dëshmitari, identiteti, Rregulli 47
Dëshmitari, mosparaqitja, gjoba joproporcionale me mjetet financiare të dëshmitarit, Rregulli 46
Dëshmitari, detyrimi për tu paraqitur 46
Dëshmitari, pagesa e depozitës për thirrje, Rregulli 46
Dëshmitari, prezenca e palëve gjatë marrjes në pyetje, Rregulli 47
Dëshmitari, refuzimi për të dhënë dëshminë ose për të dhënë betimin ose për të dhënë deklaratën solemne, Rregulli 46
Dëshmitari, e drejta për të refuzuar për të dhënë dëshminë, Rregulli 47
Dëshmitari, dëshmia, Rregulli 47

E

Emërimi dhe fillimi i mandatit të gjyqtarëve, Neni 4, 7, Rregulli 4
Ekspertë, Rregulli 48, 50
Ekzekutimi i vendimeve, Rregulli 63
Efektet ligjore të aktgjykimit të Gjykatës, Rregulli 66
E drejta për mbrojtje juridike nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje, Neni 47

F

Faktet, përmbledhja e shkurtër, Rregulli 29
Fillimi i procedurës, Rregulli 28
Format e kërkesës, Rregulli 29

G

Gazeta Zyrtare, Neni 20

Gj

Gjykata Kushtetuese, simboli, Rregulli 3
Gjobat për shkeljet e bëra gjatë procedurës, Rregulli 14
Gjyqtar raportues, Neni 22
Gjyqtar raportues, emërimi, Neni 22, Rregulli 4, 8
Gjyqtar raportues, kërkesa për informata shtesë, Neni 22
Gjyqtari, procedurat për përjashtim, Rregulli 7
Gjyqtari, kërkesë për përjashtim, Rregulli 7
Gjyqtarët, disiplina, Rregulli 6

Gjyqtarët, procedura për shkarkim, Rregulli 6
Gjyqtarët, kohë e njëjtë pune, Rregulli 4
Gjyqtarët, përparësia; Rregulli 4
Gjyqtarët, rendi i emërimit, Rregulli 4
Gjyqtarët, propozim për shkarkim, Rregulli 6
Gjuhë, zyrtare, Rregulli 29
Gjyqtar kryesues, Rregulli 9

H

Hyrja në fuqi e Ligjit, Neni 58
Hyrja në fuqi e Rregullores së Punës, Rregulli 81
Hulumtim ligjore, Rregulli 18
Humbje e përhershme e aftësisë së të vepruarit, Rregulli 6

I

Informacione për rrjedhjen e procedurës, Rregulli 22
Inspektimi i vendit ose objektit, Rregulli 45, 52

J

Juridiksion, Gjykata nuk ka, Rregulli 36

K

Keqpërdorimi i të drejtës për peticion, Rregulli 36
Kërkesë anonime, Rregulli 36
Kryeshef ekzekutiv, Rregulli 16
Këshilltari i parë juridik, Rregulli 18
Kodi i mirësjelljes për gjyqtarët, Rregulli 12
Kodi i mirësjelljes për personelin e shërbyesve civil të Sekretariatit, Rregulli 14
Kodi i etikës, personeli i Sekretariatit, Rregulli 17
Komunitetet, kërkesa nga Zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal, Rregulli 78
Konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë, Procedurë e veçantë 2, lidhur me Nenin 113.3(1) të Kushtetutës, Neni 31, 32, Rregulli 67, 68
Kushtetutshmëria e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale, Procedurë e veçantë 7, lidhur me Nenin 113.3(4) të Kushtetutës, Neni 40, 41, Rregulli 70
Konkurs, i drejtë dhe i hapur, Rregulli 16
Konfidencialiteti i këshillimeve, Rregulli 44
Konfidencialiteti i dosjeve dhe dokumenteve, Rregulli 23
Konflikti në mes të kompetencave kushtetuese, Procedurë e veçantë 2, lidhur me Nenin 113.3(1) të Kushtetutës, Neni 31, 32, Rregulli 67, 68
Kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale LGJK, Procedurë e veçantë 7, lidhur me Nenin 113.4 të Kushtetutës, Neni 40, 41, Rregulli 70
Kushtetutshmëria e ligjit/vendimit të Kuvendit, e kontestuar nga 10 ose më shumë deputetë, Procedurë e veçantë 8, lidhur me Nenin 113.5 të Kushtetutës, Neni 42, 43
Këshillimet dhe votim, Rregulli 44
Kushtet e punësimit, Rregulli 14
Kujdes kundër zjarrit, Rregulli 15
Kontrolli incidental në gjykatat e rregullta, Neni 113.8 i Kushtetutës, Neni 51, 52, 53, Rregulli 75, 76, 77
Kërkesa është e pakompletuar, Rregulli 36

Kryetari ose Zëvendëskryetari i përkohshëm, Rregulli 10
Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese në kohen e hyrjes në fuqi të Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Neni 56
Këshilltarët juridik. Neni 13, Rregulli 18
Karakteri shumetnik i personelit, Rregulli 16
Kryetari dhe Zëvendëskryetari, Neni 11
Kryetari dhe Zëvendëskryetari, zgjedhja, Rregulli 10
Kryetari dhe Zëvendëskryetari, mandati, Rregulli 10
Kryetari dhe Zëvendëskryetari, zbrazëtia, Rregulli 10
Kryetari i Kosovës, shkelje serioze e Kushtetutës, Neni 113.6 i Kushtetutës, Neni 44, 45, Rregulli 71, 72, 73
Kryetari i Gjykatës, funksionet, Rregulli 12
Kundërshtim i përfundimit të Panelit shqyrtues, Rregulli 35
Komunikata ose konferenca për medie, Rregulli 22
Kuorumi i gjyqtarëve, Neni 19
Kërkesa e gjykatave të rregullta lidhur me përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën, Rregulli 75
Kërkesa e gjykatave të rregullta, masat e përkohshme, Rregulli 77
Kërkesa e gjykatave të rregullta, pavlefshmëria e ligjit, Rregulli 77
Kërkesa e gjykatave të rregullta, pezullimi i procedurave, Rregulli 76
Kërkesë, përgjigje e arsyetuar, Neni 22
Kërkesat, kopjet për palën kundërshtare, Neni 22
Kërkesat, përpunimi, Neni 22
Kërkesat, afati për përgjigje, Neni 22
Kërkesat, e paqartë ose e jo e kompletuar, Neni 22
Kthimi në gjendjen e përparshme, Neni 50
Kolegji shqyrtues, Neni 22, Rregulli 9, 35

L

Lejueshmëria e kërkesave, Neni 22
Ligjet e Kuvendit, Neni 42, 43
Lista kontrolluese e dokumenteve të nevojshme, Rregulli 30
Ligji për Shërbyesit Civil, Rregulli 17

Ll

Llogaritja e periudhës kohore, Rregulli 27

M

Mungesa ose pamundësia e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Neni 11
Mosha e gjyqtarëve, Rule 4
Mbledhja e dëshmive nga gjyqtari, Rregulli 45
Mendimet konkurruese, Rregulli 59
Mendimet mospajtuese, Rregulli 58
Mendimi mospajtues i gjyqtarit në Kolegjin shqyrtues nuk lejohet, Rregulli 35
Mjetet elektronike të komunikimit, Rregulli 25
Marrja në pyetje e dëshmitarit, Rregulli 46
Masat e përkohshme, Rregulli 55
Masat e përkohshme, kohëzgjatja, Neni 27, Rregulli Rule 55
Masat e përkohshme, seanca dëgjimore, Rregulli 55
Masat e përkohshme, procedura, Neni 113.2 (1) dhe (2) i Kushtetutës, Rregulli 64
Masat e përkohshme, interesi publik, Neni 27, Rregulli 55
Masat e përkohshme, kërkesa, Rregulli 54
Masat e përkohshme, revokimi ose modifikimi, Rregulli 55

Masat e përkohshme, rrezik i dëmeve të paripërueshme, Neni 27, Rregulli 55
Mandati i gjyqtarëve, Neni 8, 9, Rregulli 4
Menaxhimi i Financat Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji për Rregulli 20
Mbrojtja juridike, e kërkuar, Rregulli 29
Masat e sigurisë, Rregulli 15

N

Ndryshimet e Rregullores së Punës, Rregulli 80
Nuk është palë në procedurë, Rregulli 51
Njoftimi për seancë dëgjimore, Rregulli 42
Numri i regjistrit të kërkesës, caktimi, Rregulli 29
Ndarja e kërkesave, Rregulli 37

O

Objektet, Rregulli 14
Organizimi i brendshëm dhe funksionimi, Rregulli 14
Objekti që duhet inspektuar, identifikimi, Rregulli 45
Organizimi i Gjykatës, Neni 1, 2
Organet publike, bashkëpunimi me, Neni 26
Orari i punës, Rregulli 14

P

Procedura e emërimit të gjyqtarëve, Neni 6
Palët e autorizuara, Neni 113.2 (1) dhe (2) i Kushtetutës, Neni 29
Propozimi për buxhet, Rregulli 20
Propozimi për buxhet, miratim në Kuvend, Neni 14
Përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet ndërkombëtare/procedurën e ndjekur, Procedurë e veçantë 5, lidhur me Nenin 113.3(4) të Kushtetutës, Neni 36
Përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën, Procedurë e veçantë 3, lidhur me Nenin 113.3(2) të Kushtetutës, Neni 33, 34, Rregulli 69
Përputhshmëria e Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën, Procedurë e veçantë 4, lidhur me Nenin 113.3(3) të Kushtetutës, Neni 35
Përputhshmëria e ligjeve, e dekreteve, e rregulloreve dhe e statuteve të komunave me Kushtetutën, Procedurë e veçantë 1, lidhur me Nenin 113.2(1) dhe (2) të Kushtetutës, Neni 30, Rregulli 62, 64, 65, 66
Përbërja e Gjykatës Kushtetuese, e përkohshme, Neni 55
Përmbajtja e vendimeve, Rregulli 57
Përmirësimi i gabimeve teknike ose numerike në kërkesë, Rregull 31
Përmirësimi i aktgjykimeve dhe vendimeve, Rregulli 61
Procesi i vendimmarrjes, Neni 2, 10
Projektaktvendimi për (pa)pranueshmëri, Rregulli 35
Pranimi i provave gjatë seancës, Rregulli 43
Provat, procedura e administrimit, Neni 25
Përjashtimi nga seanca dëgjimore, Rregulli 41
Përjashtimi i gjyqtarit, Neni 18
Përjashtimi i publikut nga seancat, Neni 17
Përjashtimi nga pagesa e shpenzimeve të procedurës, Neni 28
Problem shëndetësor, Rregulli 6
Paanshmëria dhe ndërgjegjja e gjyqtarëve, Neni 10
Paanshmëria, dyshim i arsyeshëm, Rregulli 6
Përfshirje në kërkesë, Rregulli 29
Papajtueshmëria e funksionit, Neni 5

Papranueshmëri ratione materiae, Rregulli 36
Papranueshmëri ratione personae, Rregulli 36
Papranueshmëri ratione temporis, Rregulli 36
Pavarësia e Gjykatës, Rregulli 21
Pavarësia, organizative, administrative, financiare, Neni 2
Pavlefshmëria e instrumentit normativ, Rregulli 74
Procesverbal dhe transkript, përgatitja, Neni 12
Procesverbali i seancës dëgjimore, Rregulli 43
Procesverbali i këshillimeve, Rregulli 44
Përgjegjësitë Komunale, cenimi me ndryshime kushtetuese, Neni 113.4 i Kushtetutës, Neni 40, 41, Rregulli 70
Pajisjet e zyrave, Rregulli 15
Personeli,përmbajtja, Rregulli 16
Politika, zbatimi i politikave jo-diskriminuese, Rregulli 16
Përparësia e gjyqtarëve, Rregulli 4
Përgatitja e projektvendimit të Gjykatës, Rregulli 44
Përgatitja e tekstit përfundimtar të aktgjykimit, Rregulli 44
Prima facie e arsyetuar, Rregulli 36
Përfundimi i mandatit të gjyqtarit para kohës, Neni 9
Procedura për shqyrtimin e kandidatëve, Neni 6
Procedura, rregull i përgjithshëm, Neni 16
Prokurimi, Rregulli 15
Përbërja e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese, Neni 55
Punët e informimit publik, kryerja, Neni 12
Publiciteti, parimi, Neni 17
Postë rekomande, Rregulli 26
Pagat e gjyqtarëve, Neni Art. 5, 15
Përfaqësimi para Gjykatës, Neni 21
Përfaqësuesi i palës, Rregulli 43
Përgjegjësitë e gjyqtarëve, Rregulli 4
Paraqitja e dëshmive nga palët, Rregulli 45
Pretendimi nuk është dëshmuar mjaft, Rregulli 36
Person i paautorizuar, Rregulli 36

Q

Qasje në dosje dhe dokumente, Rregulli 23
Qasje në punën e Gjykatës, Rregulli 22
Qartazi e pabazuar, Rregulli 36

R

Raporti Vjetor, hartimi dhe botimi, Rregulli 15
Rastet paraprake, Neni 56
Rendi i votimit të gjyqtarëve, Rregulli 4
Raporti paraprak, Neni 22, Rregulli 34
Ratione materiae, mospajtueshmëri, Rregulli 36
Ratione personae, mospajtueshmëri, Rregulli 36
Ratione temporis, mospajtueshmëri, Rregulli 36
Regjistrimi, përgjegjësia, Neni 12
Rekrutimi i personelit, Rregulli 16
Referendumi, pajtueshmëria, Rregulli 69
Regjistri, mirëmbajtja, Neni 12
Reputacioni i Gjykatës Kushtetues, Neni 10
Reputacioni i gjyqtarëve, Neni 4
Resurset, menaxhim efektiv dhe efikas, Rregulli 16

Rr

Rregulli i katër muajve, Neni 49, 50, Rregulli 36

S

Seancat administrative, Rregulli 14
Saktësia e përkthimeve, Rregulli 29
Sjellja gjatë seancës, e duhur, Rregulli 43
Sjellja, nuk është në pajtim me dinjitetin e Gjykatës, Rregulli 41
Status i barabartë, Rregulli 4
Skadimi i mandatit, Rregulli 10
Seancë dëgjimore dhe heqje dorë, e drejta, Rregulli 39
Seancë dëgjimore, njoftimi, Rregulli 42
Seancë dëgjimore, procedura, Rregulli 43
Seancë dëgjimore, pjesëmarrja e palëve, Rregulli 43
Seancë dëgjimore, vërejtjet përmbyllëse, Rregulli 43
Seancat dëgjimore, Rregulli 15
Seancë dëgjimore, data dhe koha, Rregulli 22
Seancat dëgjimore, pjesëmarrja, Rregulli 41
Seancat, orari, Rregulli 40
Sëmundje e gjyqtarëve, Neni 9
Sëmundje, Rregulli 6
Sekretaria e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese, Neni 57
Sjellja në mënyrë fyese, Rregulli 41
Selia e Gjykatës, Neni 3
Struktura organizative e Sekretariatit, Rregulli 15
Seancat dëgjimore, Rregulli 41
Selia e Gjykatës, Rregulli 2
Sekretariati, Neni 12, Rregulli 15, 17
Sekretari i përgjithshëm, Neni 12, Rregulli 16
Statusi i procedurës, Rregulli 24
Simboli i Gjykatës, Rregulli 3

Sh

Shtyrja e seancës dëgjimore, Rregulli 43
Shërbimet për buxhet, Rregulli 15
Shërbimet e menaxhimit të objektit, Rregulli 15
Shërbyesit civil, punësimi, Rregulli 17
Shërbyesit civil, Ligji për, Rregulli 17
Shërbyesit civil, këshilltarët juridik, Rregulli 18
Shërbyesit civil, personeli i Sekretariatit, Rregulli 17
Shqyrtim konkret kushtetues (kontrolli incidental), Neni 113.8 i Kushtetutës, Neni 51, 52, 53, Rregulli 75, 76, 77
Shqyrtim kushtetues, kërkesa të individëve sipas Nenit 113.7 të Kushtetutës, Rregulli 74
Shpenzimet i bartin palët, Neni 28
Shkarkimi i gjyqtarëve, Neni 9, Rregulli 6
Shterja e të gjitha mjeteve efektive juridike, Rregulli 36
Shterja e të gjitha mjeteve juridike, Neni 47
Shqiptimi i gjobës, Rregulli 41
Shkeljet, e bëra nga gjyqtarët, Rregulli 14
Shërbimet e përkthimit, Rregulli 15, 43
Shqyrtimi verbal, procedura, Neni 24
Shqyrtimi verbal, heqje dorë, Neni 20
Shërbimet e pagesave, Rregulli 15
Shërbimet e personelit, Rregulli 15
Shërbimet postare, Rregulli 15
Shtyrja e seancës dëgjimore, shpenzimet e domosdoshme, Rregulli 42
Shtyrja e seancës dëgjimore, me kërkesë, Rregulli 42
Shqyrtim verbal, Neni 22
Shtypja e dokumenteve dhe materialeve të tjera, Rregulli 15
Shpenzimet e procedurës bartë pala, Neni 28
Shërbimet mbështetëse të Sekretariatit, Rregulli 15
Shërbimet teknike, Rregulli 15
Shërbimet e automjeteve, Rregulli 15

Shkelje e Kushtetutës gjatë zgjedhjes së Kuvendit 6. Procedura Neni 113.3 (5) i Kushtetutës
Shkelje e të drejtave dhe lirive individuale nga autoritetet publike 10. Procedura Neni 113.7 i Kushtetutës

T

Tarifat për shërbimet administrative, Rregulli 20
Tërheqja e shortit, Rule 10
Të punësuarit e Sekretariatit, zbatueshmëria e Ligjit për Shërbimin Civil, Neni 12
Taksë, administrative, Rregulli 23
Tarifat për shërbimet administrative, Rregulli 20
Të drejtat individuale, shkelje nga autoritetet publike, Neni 113.7 i Kushtetutës, Nenet 46, 47, 48, 49, 50, Rregulli 74
Toga gjyqtare, Rregulli 13
Tërheqja e shortit, sistemi, Rregulli 4
Transkripti i seancës dëgjimore, Rregulli 43
Transparente, e hapur dhe e qasshme, Rregulli 22
Telefaks, Rregulli 25
Tërheqja e palës, Neni 23
Tërheqja e kërkesës nga pala e autorizuar, Rregulli 73
Tërheqja e kërkesave dhe përgjigjeve, Rregulli 32

Th

Thirrja e dëshmitarit, Rregulli 46
Thirrja në seancë dëgjimore, Rregulli 42

U

Uniforma, zyrtare, Rregulli 13
Urdhri për shqiptimin e masave disiplinore, Rregulli 41
Urdhrat, tjerë, Rregulli 56
Uniforma zyrtare, Rregulli 13
Ueb-faqja e Gjykatës, Rregulli 22

V

Vendimet administrative, vendim për çështjet administrative, Rregulli 56
Vdekja e gjyqtarëve, Neni 9
Vendimet, për masat e përkohshme, Rregulli 56
Vendimet, zbatimi, fuqia obliguese dhe implementimi, Rregulli 63
Vendimet, hyrja në fuqi, Neni 20
Vendimet, shqyrtim verbal, Neni 20
Vendimet, shpallja publike, Neni 20
Vendimet, shpallja në Gazetën Zyrtare, Neni 20
Vendimet, raportet, hartimi, Rregulli 18
Vendimet, marrja, Neni 19
Vendimet, llojet, Rregulli 56
Vërejtjet kundër dëshmitarëve ose ekspertëve, Rregulli 4, 49
Votim i fshehtë, zgjedhja e Kryetarit, Zëvendëskryetarit, Rregulli 10
Votimi dhe konsultimi, pjesëmarrja e gjyqtarëve, Neni 17
Votimi, renditja, Rregulli 4